REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

BULETINI
I PRAKTIKËS GJYQËSORE
2012

Vëllimi II

Botues:
Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Bordi redaktues:

Prof.Dr. Enver Hasani, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Prof.Dr. Ivan Čukalović, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese
Almiro Rodrigues, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese
Prof.Dr. Snezhana Botusharova, Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese
Mr.Sc. Arbëresha Raça-Shala, Sekretare e Përgjithshme e Gjykatës Kushtetuese

Përgatitur nga:
Prof. Dr. Bengt Beutler, Ekspert Ligjor
Z. Volkmar Theobald, Menaxher i Projektit, GIZ
Dr. Avni Mazrreku, Ekspert Ligjor
Znj. Pranvera Ejupi- Hajzeraj, Kordinatore e projektit, GIZ

© 2013 Gjykata Kushtetuese e Kosovës

Të drejtat e autorit:

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetesh, elektronike apo mekanike, duke përfshirë fotokopjimin dhe incizimin, apo ruajtjen në sisteme ripërdorimi, pa lejen paraprake me shkrim nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës dhe Deutsche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ) , përveç nëse një kopjim i tillë në mënyrë të qartë lejohet nga ligji përkatës për të drejtat e autorit.

Përjashtim i përgjegjësisë:

Sipas nenit 116.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, e cila është burim primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Ky Buletin nuk zëvendëson burimin primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Në rast të ndonjë konflikti apo mospërputhje në mes të vendimeve të botuara në këtë Buletin dhe vendimeve të botuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, mbizotëron versioni i botuar në Gazetën Zyrtare.

Qëllimi i përmbledhjes së vendimeve është për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme faktike dhe juridike të rasteve dhe një përmbledhje të shkurtër të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Përmbledhja e vendimeve dhe aktgjykimeve është përpiluar nga "Projekti për Reformë Juridike" implementuar nga Deutsche Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ), dhe si i tillë, nuk zëvendëson vendimet e Gjykatës Kushtetuese, dhe nuk përfaqësojnë formulimin e vërtetë të vendimeve/aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese.

BULETINI
I PRAKTIKËS GJYQËSORE
2012

I GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Ky Buletin është përgatitur nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammendarbeit (GIZ) GmbH, Projekti „ Reforma Juridike“ në Kosovë, në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Përmbatja

Nr.1 KI 43/11 datë 19 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. Nr. 628/2004, të 8 marsit 2007, dhe të aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë Ap. Nr. 84/2009, të 3 dhjetorit 2009 dhe PKL-KZZ Nr. 31/2010, të 1 nëntorit 2010..... 13

Nr. 2 KI 78/11 datë 19 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan P. nr. 162/2003, të 7 prillit 2005, dhe aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë Ap. nr. 393/2006 të 20 maj 2008, Ap. nr. 04/2009 të 16 shtatorit 2009 dhe PKL nr. 30/2010 të 1 shkurtit 2011. 28

Nr. 3 KI 81/11 datë 19 qershor 2012- Kërkesë për vlerësim të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan P. Nr. 162/2003, të datës 7 prill 2005, aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë Ap. Nr. 393/2006 të datës 20 maj 2008, Ap. Nr. 04/2009 të datës 16 shtator 2009 dhe PKL Nr. 30/2010 të datës 1 shkurt 2011..... 42

Nr.4 KO 45/12 dhe KO 46/12 datë 27 qershor 2007 Kërkesa e Liburn Aliut dhe 11 deputetëve të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe dhe të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit..... 57

Nr.5 KI 152/11 datë 10 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Kosovës (11/279), të 07.11.2007..... 83

Nr.6 KI 156/11 datë 10 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 378/09, të 1 tetorit 2009, dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 509/2009, të 5 gushtit 2011..... 91

Nr.7 KI 08/12 datë 10 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 1107/2010, të 28 qershorit 2011..... 102

Nr.8 KI 19/12 datë 10 korrik 2012- Kërkesë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtine AC.nr. 1496/2011 të 24 janarit 2012..... 112

Nr.9 KI 06/12 datë 28 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 67/2011, të 12 dhjetorit 2011..... 125

Nr.10 KI 130/10 datë 25 korrik 2012- Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-09-0045, të 8 marsit 2010..... 146

Nr.1 1 KI 145/11 datë 12 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut P. nr. 2003/2006 të 9 nëntorit 2007 dhe aktgjykimeve të Gjykatës Supreme AP. nr. 190/2009 të 27 janarit 2010, API. nr. 1/2010 të 26 nëntorit 2010 dhe PKL-36/11 të 10 gushtit 2011. 157

Nr.12 KI 51/11 datë 10 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Ac. nr. 359/10, të 14 dhjetorit 2010..... 168

Nr.13 KI 37/10 datë 26 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme Nr. SCEL-06-0016 të datës 10 tetor 2006 dhe Aktvendimit Nr. SCEL 06-016 të datës 31 janar 2007..... 188

Nr.14 KI 30/12 datë 12 korrik 2012- Kërkesa për vlerësimin e Kushtetutshmërisë të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.1496/2011 të datës 24 janar 2012..... 201

Nr.15 KI 49/12 datë 12 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Pkl. nr. 135/09 të 22 shkurtit 2011..... 212

Nr.16 KI 34/12 datë 16 korrik 2012- Kërkesë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës A. nr. 29/2011 të 15 shkurtit 2011..... 221

Nr.17 KI 113/11 datë 16 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë të aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës KRJA nr. 3/2010 të 4 majit 2011..... 229

Nr.18 KI 13/12 datë 16 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 443/2009, të datës 8 dhjetor 2011..... 239

Nr.19 KI 111/11 datë 16 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PKL. Nr. 117/09, të datës 12 tetor 2010..... 249

Nr.20 KI 133/11 datë 16 korrik 2012- Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit..... 257

Nr.21 KI 140/11 datë 24 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. 383/2008, të 10 qershorit 2011..... 274

Nr.22 KI 39/12 datë 24 korrik 2012- Kërkesë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës A. nr. 693/2011 të 23 shtatorit 2011..... 283

Nr.23 KI 44/12 datë 24 korrik 2012 - Vlerësim i kushtetutshmërisë të aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës P. z. D. 96/2011 të 23 dhjetorit 2011 292

Nr.24 KI 22/12 datë 26 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Rev.I. br.58/2008 të 27 dhjetorit 2011 302

Nr.25 KI 38/10 datë 26 korrik 2012- Kërkesa për vlerësimin e procedurës gjyqësore në Gjykatën Komunale në Prishtinë lidhur me lëndën E.nr 34/2001 të datës .19.04.2001 (tejzgjatje e procedurës)..... 314

Nr.26 KI 55/11 datë 20 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 518/2010, të 26 nëntorit 2010..... 325

Nr.27 KI 159/11 datë 20 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Pn. nr. 530/2011, të 13 tetorit 2011..... 347

Nr.28 KI 47/12 datë 20 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev. Nr. 188/2009, të 7 dhjetorit 2011..... 357

Nr.29 KI 50/12 datë Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 153/2011, të 4 tetorit 2011, dhe Vendimit Nr. 02 (207) 2010, të 4 tetorit 2010, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës nga komuna e Junikut..... 376

Nr.30. KI 24/12 datë 24 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 1/2010, të 3 dhjetorit 2010..... 396

Nr.31 KI 129/11 datë 20 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. nr. 158/2011 të 5 korrikut 2011 dhe vendimit nr. 02/197/2010 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës nga ana e Komunës së Klinës..... 405

Nr.32 KI 117/11 datë 24 korrik 2012 - Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit Komunal në Prizren nr. 01/011-4539 të 18 qershorit 2009..... 425

Nr.33 K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12 datë 20 korrik 2012- Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012..... 436

Nr.34 KI 04/12 datë 24 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 647/2011, të 30 nëntorit 2011..... 525

Nr.35 KI 63/11 datë 31 gusht 2012- Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. Br. 1239/2010 të 23 marsit 2011..... 555

Nr.36 KI 40/12 datë 07 shtator 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren P. nr. 208/09 të 15 qershorit 2011..... 565

Nr.37 KI 07/11 datë 07 shtator 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së moszbatimit të pretenduar të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Kamenicë C. nr 79/96, të datës 7 tetor 1997..... 575

Nr.38 KI 158/11 datë 07 shtator 2012- Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Serbisë, Tu. Nr 367/90, të datës 21.03.1991 584

Nr.39 KI 13/11 datë 07 shtator 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, P.nr. 211/06 të 1 nëntor 2007, të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.nr. 48/2008, të datës 14 maj 2008 dhe të Akgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Pzd. nr. 118/2010..... 595

Nr.40 KI 125/10 datë 24 shtator 2012- Vlerësim kushtetues i vendimeve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, AC. Nr. 440/07, i 17 dhjetorit 2008, dhe të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. I. nr. 41/2008, i 13 gushtit 2010..... 606

Nr.41 KI 151/11 datë 24 shtator 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjilan, C. nr. 494/06, të 11 prillit 2007; Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Ac. nr. 219/07, të 11 shtatorit 2009; dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr. 1120/83, të 19 janarit 1984..... 612

Nr.42 KI 81/10 datë 24 shtator 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. I. Nr. 363/09 të datës 6 maj 2010..... 620

Nr.43 KI 89/10 datë 24 shtator 2012- Vlerësimi kushtetues i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr. 68/2008, të datës 14 shtator 2010..... 627

Nr.44 KI 131/10 datë 24 shtator 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatë Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, P. nr. 46/2001, të 8 tetorit 2001; Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. nr. 14/2002, të 27 qershorit 2002, dhe API. nr. 3/'07, të 23 nëntorit 2007; dhe Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pr. nr. 20/2010, të 11 marsit 2010..... 635

Nr.45 KI 56/12 datë 28 shtator 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ka. nr. 417/11, të 23 marsit 2012..... 644

Nr.46 KO 57/12 datë 22 tetor 2012- Kërkesa e Presidentes së Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Saj, Atifete Jahjaga, me të cilën konteston votimin për miratimin e Ligjit nr. 04/l-084 "Për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës" 656

Nr.47 KI 93/11 datë 28 shtator 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PPA 9/2008, të datës 29 prill 2011..... 676

Nr.48 KI 55/12 datë 17 tetor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 132/2009, të 17 janarit 2012..... 684

Nr.49 KI 88/11 datë 28 shtator 2012- Vlerësim i Vendimit të Gjykatës Supreme nr. AP 306/2011, të 6 prillit 2011..... 691

Nr.50 KI 78/12 datë 25 shtator 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012..... 703

Nr.51 KI 163/11 datë 28 shtator 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl-Kzz-91/10 të 23 gushtit 2011..... 716

Nr.52 KI 20/12 datë 28 shtator 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr. 590/2011, të 23 shtatorit 2011..... 730

Nr.53 KI 75/10 datë 28 shtator 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 942/2009, të 24 marsit 2010..... 737

Nr.54 KI 59/12 datë 17 tetor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 254/2009 të 16 janarit 2012..... 753

Nr.55 KI 62/12 datë 17 tetor 2012- Kërkesë për interpretimin e Kushtetutës..... 763

Nr.56 KI 132/10, KI 28/11, KI 82/11, KI 85/11, KI 89/11, KI 100/11, KI 104/11, KI 109/11, KI 118/11, KI 123/11, KI 142/11, KI 143/11, KI 144/11, KI 154/11, KI 01/12, KI 02/12, KI 14/12 datë 17 tetor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së 17 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës..... 770

Nr.57 KI 43/12 datë 18 tetor 2012- Kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë se Aktvendimit te Gjykatës Supreme P.P.A.nr.3/ 2008 te datës 03.05.2011..... 796

Nr.58 KI 76/11 datë 17 tetor 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 25/2011, të 22 marsit 2011, dhe të Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Kp. nr. 255/2010, të 2 nëntorit 2010..... 808

Nr.59 KI 21/11 datë 22 tetor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Ap. Nr. 329/09, të 3 qershorit 2010, si dhe i Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, P. Nr. 187/2008, të 30 qershorit 2009..... 817

Nr.60 KI 70/12 datë 21 nëntor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2005/2005, të 13 tetorit 2008; të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 76/2007, të 22 tetorit 2008; dhe të Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 27/2009, të 14 majit 2012..... 826

Nr.61 KI 78/10 datë 21 nëntor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 137/2007, i 13 prillit 2010 835

Nr.62 KI 74/11 datë 21 nëntor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së dështimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë për të nxjerrë aktgjykim në një padi..... 844

Nr.63 KI 121/11 datë 21 nëntor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. 134/2010, të 17 majit 2011..... 852

Nr.64 KO 63/12 datë 07 nëntor 2012- Kërkesa e Alma Lamës dhe e 10 deputetëve të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82..... 863

Nr.65 KI 60/12 datë 08 nëntor 2012 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 58/2007, të 15 marsit 2010..... 883

Nr.66 KO 61/12 datë 21 nëntor 2012- Konfirmim i amendamenteve të propozuara kushtetuese, të paraqitura nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 22 qershor 2012, nëpërmjet shkresës Nr. 04-DO-1095..... 892

Nr.67 KI 03/12 datë 29 nëntor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PKL. Nr. 88/2011, të 21 shtatorit 2011..... 908

Nr.68 KI 53/12 datë 21 nëntor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, të 23 shkurtit 2011, me të cilin parashtruesit i mohohet pensioni i invalidit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)..... 918

Nr.69 KI 12/12 datë 08 nëntor 2012- Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Mitrovicë, E. nr. 709/2006, të 10 dhjetorit 2007..... 925

Nr.70 KI 36/12 datë 27 nëntor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Ac. Nr. 116/2011, të 17 janarit 2012..... 933

Nr.71 KI 08/09 datë 06 dhjetor 2012- Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Fabrikës së Çelikut, IMK, në Ferizaj, e përfaqësuar nga z. Ali Azemi, kryetar i Sindikatës – Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit C. Nr. 340/2001, të 11 janarit 2002..... 943

Nr.72 KI 96/12 datë 13 dhjetor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev. 311/2009 të 15 korrikut 2009, Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 393/08, të 18 shkurtit 2009 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale C.nr.749/07 të 4 korrikut 2008..... 956

Nr.73 KI 120/11 datë 13 dhjetor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. Nr. 551, të 20 qershorit 2011..... 963

Nr.74 KI 72/12 datë 17 dhjetor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr. 1053/2008, të 31 majit 2012..... 976

Nr.75 KO 63/12 datë 13 dhjetor 2012- Kërkesa e Alma Lamës dhe e 10 deputetëve të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82 998

Nr.76 KI 78/12 datë 14 dhjetor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012..... 1008

Nr.77 KI 126/12 datë 14 dhjetor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Mlc. nr. 21/2012, të 8 dhjetorit 2012 1013

Nr.78 KO 97/12 datë 26 dhjetor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012..... 1032

Nr.79 KO 131/12 datë 28 dhjetor 2012 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësinë, Nr. 04/L-125; të miratuar nga Kuvendi, më 13 dhjetor 2012..... 1047

Nr.80 KO 148/11 datë 28 dhjetor 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë të nenit 11 par. 1, nenit 32 par. 1 dhe 2, nenit 34 par. 2, dhe të nenit 38 në lidhje me nenin 11, 32 e 34 të Ligjit për Avokatin e Popullit, ligji Nr. 03/L-195 të 27 gushtit 2010, dhe i kërkesës për masë të përkohshme..... 1060

Indeksi i termave..... 1073

Indeksi i nenëve të kushtetutës..... 1076

KI 43/11 datë 19 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. Nr. 628/2004, të 8 marsit 2007, dhe të aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë Ap. Nr. 84/2009, të 3 dhjetorit 2009 dhe PKL-KZZ Nr. 31/2010, të 1 nëntorit 2010

Rasti KI 43/11, vendim i 11 qershorit 2012

Fjalët kyçe: cenim i të drejtave dhe lirive kushtetuese, kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, ligji i procedurës penale, vepra penale e vrasjes.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat dhe liritë e tij kushtetuese janë cenuar me aktgjykimet e gjykatave të rregullta të të gjitha shkallëve, me ç'rast p arashtruesi ishte dënuar me burg lidhur me akuzat mes tjerash për kryerje të veprës penale të vrasjes. Parashtruesi pohoi se gjykatat e rregullta të të gjitha shkallëve kanë cenuar të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte e papranueshme bazuar në Rregullin 36 të Rregullores së Punës për shkak se ishte qartazi e pabazuar. Gjykata vendimin e saj e arsyetoi duke theksuar se gjykatat e rregullta i kanë marrë parasysh dhe iu kanë përgjigjur ankesave të parashtruesit në çështje ligjore që kanë të bëjnë me pranimin e provave dhe vërtetësinë e tyre, vërtetimin e gjendjes faktike dhe zhvillimin e procedurës penale. Gjykata poashtu përsëriti se nuk është gjykatë e apelit apo gjykatë e shkallës së katërt dhe se vërtetimi i plotë dhe i drejtë i gjendjes faktike është juridiksion i gjykatave të rregullta. Duke cituar vendimin e GJEDNJ-së në rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* Gjykata më tutje arsyetoi se fakti që parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të të drejtave dhe lirive kushtetuese. Për shkak të arsyeve të

përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

Prishtinë, më 11 qershor 2012

Nr. ref.: RK249/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 43/11

Parashtruesi

Jeton Sefer KIQINA

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. Nr. 628/2004, të 8 marsit 2007, dhe të aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë Ap. Nr. 84/2009, të 3 dhjetorit 2009 dhe PKL-KZZ Nr. 31/2010, të 1 nëntorit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Jeton Sefer Kiqina, qytetar i Kosovës me nënshtetësi të Suedisë, i lindur në fshatin Baicë, komuna e Gllogocit, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, Ibrahim Z. Dobruna, avokat nga Gllogoci. Faktet dhe pretendimet e kësaj kërkese, të regjistruar nën KI43/11, janë në thelb të ngjashme me faktet dhe pretendimet e paraqitura në kërkesat KI46/10, KI52/10, KI78/11 dhe KI81/11.

Baza juridike

2. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi e ka parashtruar kërkesën mbi bazën që Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. Nr. 628/2004, i 8 marsit 2007 dhe Aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë Ap. Nr. 84/2009, i 3 dhjetorit 2009, dhe PKL-KZZ Nr. 31/2010, i 1 nëntorit 2010, kanë rezultuar në shkeljen e drejtës së tij kushtetuese për gjykim të drejtë sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm].

Procedura në Gjykatë

4. Parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatë më 29 mars 2011, e cila u regjistrua po të njëjtën ditë nën Nr. KI43/11.

5. Para kësaj, më 25 qershor 2010, znj. Sebahate Shala, nga Krajkova e Drenasit, kishte parashtruar kërkesë sipas autorizimit të Këshillit Organizativ "Drejtësi për Rastin Kiqina", e cila u regjistrua nën Nr. KI46/10.

6. Po ashtu para kësaj, më 29 qershor 2010, Arben Kiqina parashtroi kërkesë në Gjykatë, e cila u regjistrua të njëjtën ditë nën Nr. KI52/10. Më 1 qershor 2011, parashtruesi paraqiti dokumente shtesë në Gjykatë.

7. Më 7 qershor 2011, Burim Ramadani, Arsim Ramadani, Arben Kiqina dhe Blerim Kiqina dorëzuan një kërkesë në Gjykatë, e cila u regjistrua nën Nr. KI78/11.

8. Më 13 qershor 2011, Burim Ramadani dhe Arsim Ramadani dorëzuan një kërkesë në Gjykatë, e cila u regjistrua nën Nr. KI81/11.

9. Më 11 nëntor 2010, Kryetari e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese në kërkesën KI 46/10. Të njëjtën ditë, Kryetari e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

10. Më 19 korrik 2011, Kryetari, me Urdhrin BK-46/10, i bashkoi të gjitha këto kërkesa të ndara KI46/10, KI52/10, KI43/11, KI78/11 dhe KI81/11 për shkak të lidhshmërisë me njëra-tjetrën sa i përket objektit të çështjes dhe personave që i parashtrojnë kërkesat. Gjyqtarja raportuese dhe Kolegji shqyrtues mbetën të njëjtit për të gjitha kërkesat.

11. Më 14 maj 2012, për shkak të mungesës së përkohshme të gjyqtarit Ivan Čukalović, Kryetari, Enver Hasani, e caktoi veten si gjyqtar zëvendësues në Kolegj shqyrtues.

12. Më 15 maj 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve sipas dokumenteve të dorëzuara në Gjykatë nga parashtruesi

13. Në mbrëmjen e 20 gushtit 2001, H. H., bashkë me bashkëshorten dhe fëmijët e vet, kishin qenë në një dasmë në fshatin Baicë. Pasi u larguan nga dasma, më vonë atë natë, vetura e tij hasi në pusi dhe ai, bashkëshortja e tij, djali i tij dhe dy vajzat e tij vdiqën nga të shtënat. Një vajzë e re mbijetoi.

14. Të nesërmen, Blerim Kiqina dhe Jeton Kiqina u takuan me Burim Ramadanin, Arsim Ramadanin, Arben Kiqinën dhe një tjetër jashtë restorantit Era në Gllogoc. Burim Ramadani u tha që aksioni kishte shkuar shumë mirë dhe që S. K. ia kishte dhënë ose do t'ia jepte paratë. Biseduan si t'i ndanin paratë.

15. Më 4 korrik 2002, Blerim Kiqina u paraqit në stacion të policisë. Me këtë rast u arrestua, iu komunikuan të drejtat dhe më pas u mor në pyetje. Blerim Kiqina hoqi dorë nga e drejta për të heshtur dhe për ndihmë juridike dhe vazhdoi me dhënien e deklaratës. Blerim Kiqina i pranoi vrasjet dhe i implikoi pjesëmarrësit e tjerë në krim. Personat që i implikoi ishin: Burim Ramadani, Arsim Ramadani, Arben Kiqina, Jeton Kiqina dhe të tjerët.

16. Më 7 korrik 2002, kur Berim Kiqina u paraqit para Gjyqtarit hetues, ai përsëriti pothuaj fjalë për fjalë atë që ia kishte thënë policisë gjatë marrjes në pyetje më 4 korrik 2002.

17. Pavarësisht deklaratave që i kishte dhënë në polici më 4 dhe 7 korrik 2002, më 11 tetor 2002, Blerim Kiqina e tërhoqi deklaratën mbi bazën se e kishte trilluar tregimin.

18. Pas ngritjes së aktakuzës dhe gjykimit pasues në Gjykatën e Qarkut në Gjilan (Aktgjykimi P. nr. 162/03, i 7 prillit 2005), Burim Ramadani, Arben Kiqina, Arsim Ramadani, Blerim Kiqina dhe të tjerët u dënuan për vrasjen e pesë anëtarëve të familjes H.

19. Hetimet ndaj Jeton Kiqinës dhe të dyshuarve të tjerë filluan më 9 korrik 2002. Jeton Kiqina ishte duke jetuar në Suedi gjatë kohës që hetimet ishin duke u zhvilluar. Jeton Kiqina u kthye në Kosovë në vitin 2004 gjoja për të ofruar prova në emër të S. H. dhe të pandehurve të tjerë që ishin duke u gjykuar për këto vrasje. Jeton Kiqina u arrestua më 9 nëntor 2004 sipas fletarrestimit të 11 korrikut 2002. Jeton Kiqina ka qenë nën arrest që nga ajo kohë pasi ishte nën hetime dhe ishte njëri prej të dyshuarve për vrasjen e familjes H.

20. Më 8 mars 2007, me Aktgjykimin P. Nr. 628/04, Gjykata e Qarkut në Prishtinë e shpalli Jeton Kiqinën fajtor për kryerjen e

veprave penale: vrasje, vrasje në tentativë (në lidhje me vajzën që u mbijetoi të shtënave) dhe marrëveshje për të kryer vepër penale të vrasjes. Si rrjedhojë, ai u dënua me 16 vjet burg.

21. Më 3 mars 2008, avokati i Jeton Kiqinës ushtroi ankesë kundër këtij aktgjykimi, duke pretenduar: shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale (duke përfshirë zëvendësimin e një gjyqtari në Trupin gjykues); vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; shkelje të ligjit penal dhe vendimit të padrejtë lidhur me dënimin.

22. Më 3 dhjetor 2009, me Aktgjykimin Ap. Kz. Nr. 84/2009, Gjykata Supreme e Kosovës pjesërisht e miratoi ankesën. Jeton Kiqina u lirua nga vepra penale: marrëveshje për të kryer vepër penale. Megjithatë, aktgjykimet lidhur me veprat penale: vrasje dhe vrasje në tentativë mbetën të pandryshuara.

23. Më 4 mars 2010, avokati i Jeton Kiqinës, në emër të tij, paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.

24. Më 1 nëntor 2010, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Kzz. Nr. 31/2010, e refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar. Në pjesën e arsyetimit, Gjykata Supreme e trajtoi secilin prej pretendimeve në vijim:

    a. Shkelje substanciale e ligjit penal, që do të thotë:

        i. Përbërja jo e drejtë e kolegjit të shkallës së parë;

        ii. Lirimi i anëtarëve të familjes Kiqina nga detyra e dëshmimit para Gjykatës;

        iii. Pranueshmëria e deklaratave të Blerim Kiqinës më 4 dhe 7 korrik 2002;

        iv. Pranueshmëria e procesverbalit të shqyrtimit të policit ndërkombëtar dhe listës së thirrjeve me telefon mobil; dhe

        v. Mungesa e motivit për shkak të shfajësimit të S. K.

b. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike; dhe

c. Vendimi mbi dënimin.

25. Sa i përket pretendimit të përmendur në paragrafin (a) (i) më sipër, Gjykata Supreme, në shkallë të tretë, e refuzoi këtë pikë të ankesës si të pabazë për shkak se neni 305 i Ligjit për procedurën penale [apo dispozita përkatëse e Kodit të Procedurës Penale] përcakton se nëse Trupi gjykues është ndryshuar, Trupi gjykues mund të vendosë që dëshmitarët të mos merren sërish në pyetje apo të mos bëhet këqyrja e vendit, por mund t'i konsiderojë deklarimet e incizuara të dëshmitarëve. Gjykata Supreme theksoi se gjyqtarit të ri i ishte dhënë i tërë materiali i gjykimit para rifillimit të gjykimit. Gjykata Supreme nuk gjeti prova që gjyqtarët e tjerë kanë ushtruar ndikim në gjyqtarin e ri.

26. Përveç kësaj, zëvendësimi i një gjyqtari ndërkombëtar në trupin gjykues ishte i lejuar me ligj dhe kushtet për këtë zëvendësim ishin plotësuar. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese i referohet rastit P.K. kundër Finlandës, Kërkesa Nr. 37442/97, në të cilin Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), në seancën e 9 korrikut 2002, vendosi që pavarësisht zëvendësimit të një gjyqtari gjatë rrjedhës së gjykimit të P.K.-së "*Detyra e Gjykatës është të konstatojë nëse procedurat në tërësi, duke përfshirë mënyrën e marrjes së provave, ishin të drejta. ... Megjithatë, Gjykata konsideron që, në rrethanat specifike të këtij rasti, kjo e metë më vete nuk përbën shkelje të nenit 6. Së pari, edhe pse kryetari i trupit gjykues ishte ndërruar, tre gjyqtarët e tjerë porotë mbetën të njëjtit gjatë tërë procedurës. Së dyti, kredibiliteti i dëshmitarit në fjalë nuk është kontestuar në asnjë fazë, e as që ka ndonjë indikacion në shkresa të lëndës që i justifikojnë dyshimet për kredibilitetin e saj. Në këto rrethana, fakti që kryetari i ri i trupit gjykues kishte në dispozicion procesverbalin e seancës në të cilën dëshmitari ishte dëgjuar (khs. Karjalainen kundër Finlandës, Kërkesa Nr. 30519/96, Vendimi i Komisionit i 16 prillit 1998, i paraportuar) e kompenson në masë të madhe mungesën e tij të drejtpërdrejtë në procedurë. Së treti, dënimi i parashtruesit nuk ishte i bazuar vetëm në dëshminë e dëshmitarit H. Së*

fundi, nuk ka asgjë që sugjeron se kryetari i trupit gjykues ishte ndërruar për të ndikuar në përfundimin e rastit apo për ndonjë motiv tjetër të pavend. ... Konkluzionet e nxjerra nga gjykatat vendëse në këtë rast nuk duken të jenë arbitrare për të ngritur çështje sipas nenit 6...” Edhe një rast tjetër i GJEDNJ-së tregon se fakti i thjeshtë i zëvendësimit të një gjyqtari gjatë rrjedhës së gjykimit nuk përbën, vetvetiu, shkelje të nenit 6 të Konventës (*shih Barbera, Messegue dhe Jabardo kundër Spanjës, Kërkesa Nr. 10590/83, e 6 dhjetorit 1988, Moiseyev kundër Rusisë (Kërkesa Nr. 62936/00), e 9 tetorit 2008, dhe Ocalan kundër Turqisë (Kërkesa Nr. 46221/99), e 15 majit 2005*). Duke pasur tërë këtë parasysh, kjo Gjykatë është e mendimit që Gjykata Supreme kishte të drejtë kur konstatoi që nuk kishte shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm me rastin e zëvendësimit të gjyqtarit ndërkombëtar.

27. Një aspekt tjetër i ankesës kishte të bënte me pranueshmërinë e provave në të cilin mbështeteshin gjykatat e shkallëve më të ulëta, siç ceket në paragrafin (a) (iii) më sipër. Gjykatat e shkallëve më të ulëta u kushtuan rëndësi të madhe deklaratave të dhëna nga: Blerim Kiqina në fazën hetimore, dëshmitari “MB” dhe vajza që u mbijetoi të shtënave. Këto burime të dëshmive u kundërshtuan mbi bazën se ishin të pasigurta. Gjykata Supreme e refuzoi ankesën dhe konkludoi si vijon:

    a. Pas ekzaminimit të videoincizimit të dhënies së dëshmisë nga Blerim Kiqina, doli që rrëfimi i tij ishte i vërtetë dhe nuk kishte arsye të besohej që i kishte trilluar dëshmitë. Shpjegimi i hollësishëm i vrasjeve do të mund të bëhej vetëm nga dikush që kishte njohuri të drejtpërdrejtë të ngjarjes;

    b. Pas shqyrtimit të hollësishëm të deklaratave të Blerim Kiqinës të 4 korrikut 2002, 7 korrikut 2002 dhe 11 tetorit 2002, janë identifikuar disa mospërputhje, posaçërisht në lidhje me lëvizjet e Blerim Kiqinës më 20 gusht 2001. U konstatua që e gjithë dëshmia e tij nuk duhet dhe nuk mund të hidhet tej vetëm pasi nuk është pjesërisht e besueshme. Pas shqyrtimit të pjesëve të pranueshme të dëshmisë së tij, ishte më se e qartë që Blerim Kiqina ndodhej në vend të ngjarjes në kohën e caktuar dhe që i kishte kryer veprat penale të cilat pranoi t’i kishte kryer.

Besueshmëria e deklaratës së dhënë nga Blerim Kiqina para Gjyqtarit hetues më 7 korrik 2002 ishte vërtetuar nga motivet e rrëfimit të tij, saktësia dhe përputhshmëria e deklaratave të tij, mungesa e mospërputhjeve të mëdha dhe mospërputhja e alibisë së të pandehurve të tjerë;

c. Aktgjykimet morën parasysh edhe provat mbështetëse të rrëfimit, si përshkrimi i saktë, nga Blerim Kiqina, i të akuzuarve të tjerë, ekzistenca e vendit prej nga janë marrë armët, koha e largimit të familjes H. nga dasma, kronologjia e ngjarjeve në urë dhe pozita e makinës tek ura. Ato u mbështetën me dëshminë e vajzës që u mbijetoi të shtënave, dëshmitë e "MB-së", R. K., S. K., E. K., S. K., G. K., Y. K. dhe B. K., regjistrimet e thirrjeve telefonike, si dhe ekzaminimet balistike të plumbave që vërtetuan deklarimin e Blerim Kiqinës për llojin e armës së përdorur për kryerjen e krimit;

d. Pretendimi se dëshmia e "MB-së" ishte e papranueshme ishte refuzuar mbi bazën se ishte e pabazuar. "MB" ofroi dëshmi se Burim Ramadani i kishte treguar asaj se ai i kishte kryer vrasjet. Në ankesë u tha që: 1) "MB" nuk ishte këshilluar lidhur me të drejtën për të mos dëshmuar pasi ajo kishte bashkëjetuar me Burim Ramadanin; 2) publiku ishte përjashtuar në mënyrë të paligjshme nga dëshmia e saj gojore gjatë seancës, dhe Kolegji nuk kishte lëshuar vendim me shkrim lidhur me masat mbrojtëse që i janë dhënë "MB-së"; dhe 3) Burim Ramadanit i ishte mohuar e drejta për t'i bërë pyetje "MB-së", gjë që rezultoi në shkelje të nenit 314 të dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale;

e. Si përgjigje ndaj këtyre pretendimeve, Gjykata Supreme theksoi se lirimi nga dëshmia vlente vetëm për bashkëshortët dhe se "MB" nuk ishte liruar pasi nuk ishte bashkëshortja e Burim Ramadanit. Në pajtim me nenet 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/20, Trupi gjykues zbatoi masat mbrojtëse ndaj "MB-së" pasi ajo ishte një dëshmitare të cilën i pandehuri e njihte mirë dhe kishte lidhje intime me të. Vendimi gjyqësor përmbante vendimin për përjashtimin e publikut nga seanca kur "MB-ja" duhej të jepte dëshminë me gojë. Së fundi, Burim Ramadanit nuk i ishte mohuar mundësia për t'i bërë pyetje "MB-së" gjatë

dëshmisë së saj. Në përgjithësi, dëshmia e "MB-së" u konsiderua e besueshme, posaçërisht duke marrë parasysh faktin se ishte thirrur nga policia të dëshmonte, ishte e arsyeshme në përshkrimin e ngjarjeve dhe e vazhdoi dëshminë e saj përkundër kërcënimeve nga anëtarët e familjes së të pandehurve;

f. Ankesa përmbante një argument se Gjykata e kishte shkelur procedurën penale me mënyrën se si kishte dëshmuar vajza që u mbijetoi të shtënave. Gjykata konstatoi që nuk ka pasur shkelje të procedurës penale me rastin e përjashtimit të publikut gjatë dëshmisë së vajzës që u mbijetoi të shtënave për shkak se ajo kishte dëshmuar përmes video lidhjes. Avokati mbrojtës pati mundësi ta merrte atë në pyetje edhe në gjykimin kryesor;

g. Gjykata e hodhi poshtë pretendimin se ka pasur vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike për shkak të zhdukjes së provave të rëndësishme materiale mbi bazën se kjo nuk e ka penguar përcaktimin e drejtë të gjendjes faktike. Ankesat u referoheshin gjurmëve në parafinë të marra nga F. K. dhe Arben Kiqina më 21 gusht 2001 dhe ekzaminimit të disa eksponateve të mbledhura në vendet e hetuara, që duhej të ekzaminoheshin për t'i gjetur gjurmët e gishtave ose mostrat ADN-së.

28. Gjykata Supreme, në shkallë të tretë, e konfirmoi aktgjykimin e shkallës së dytë në tërësi.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Ankesa e përgjithshme në këtë kërkesë është se gjykatat më të ulëta kanë kryer vetëm gjetje, vlerësime dhe konkluzione të përgjithshme duke shkelur kështu dispozitat procedurale të cilat kërkojnë që gjykatat të bëjnë vlerësim të sinqertë të secilës provë veç e veç dhe në lidhje me provat e tjera. Prandaj, në bazë të kësaj, parashtruesi pretendon që aktgjykimi është i paqëndrueshëm.

30. Shkurtimisht, parashtruesi e konteston besueshmërinë e provave të përdorura nga gjykatat më të ulëta në formulimin e

aktgjykimeve dhe pretendon se shqyrtimi i këtyre provave ishte i pavend. Parashtruesi i kërkesës pohoi me sa vijon:

a. Gjykatat nuk i kanë vërtetuar pohimet e dëshmitarëve kryesorë me prova të mjaftueshme, si materiali mjekoligjor;

b. Prova e dëshmitarit "MB" nuk është dashur të shqyrtohej nga gjykatat për shkak se ajo kishte qenë në lidhje me Burim Ramadanin deri në kohën e arrestimit të tij dhe kërkonte t'i hakmerrej Burim Ramadanit pasi nuk u martua me të;

c. Dëshmia e Blerim Kiqinës, të cilës gjykatat i kishin dhënë prioritet të lartë, ishte kundërthënëse dhe me të meta sepse ai ishte i mitur në kohën kur vrasja kishte ndodhur, ishte mashtruar nga hetuesit me mundësinë për t'u larguar nga vendi dhe ishte kërcënuar nga policia për ta ndërruar dëshminë e tij;

d. Dëshmia e vajzës që u mbijetoi të shtënave nuk do të duhej të merrej parasysh për shkak të mospërputhjes me provat e tjera;

e. Në bazë të nenit 157 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, gjykatat nuk do të duhej t'i shpallnin të pandehurit fajtorë duke u mbështetur vetëm në një dëshmi;

f. Gjykata e Qarkut e shkeli procedurën penale (nenet 354-359 dhe 403 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës) sepse pas caktimit të një gjyqtari të ri në Trup gjykues gjatë procedurës, gjykimi nuk kishte rifilluar nga fillimi.

Vlerësimi i pranueshmërisë

31. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur

kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.

32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

33. Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është Gjykatë e verifikimit të fakteve, Gjykata Kushtetuese dëshiron të theksojë se vërtetimi i drejtë dhe i plotë gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt", (*shih, mutatis mutandis, ndër të tjera, Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R. J. D, 1996-IV, para. 65; shih, gjithashtu, Aktvendimin për Papranueshmëri në Rastin Nr. KI-86/11 – Parashtrues i kërkesës Milaim Berisha – Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 20/09, të 1 marsit 2011 – të nxjerrë nga Gjykata më 5 prill 2012*).

34. Nga faktet e paraqitura së bashku me kërkesën shihet që parashtruesi i kërkesës i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe që gjykatat e rregullta i kanë marrë parasysh dhe iu kanë përgjigjur ankesave të tij në çështje ligjore që kanë të bëjnë me pranimin e provave dhe vërtetësinë e tyre, vërtetimin e gjendjes faktike dhe zhvillimin e procedurës penale. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se gjykatave, gjatë dëgjimit të rastit, u mungonte paanshmëria apo që procedura ishte e padrejtë.

35. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk e ka mbështetur me prova pohimin e tij për të sqaruar si dhe pse është bërë shkelja, apo

nuk ka ofruar prova për të dëshmuar se është shkelur e drejta e garantuar me Kushtetutë.

36. Përveç kësaj, kërkesa nuk tregon që Gjykata Supreme ka vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave që t'i vlerësojnë provat që i kanë përpara. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (*shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, Kërkesa Nr. 13071/87, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, para. 34, e 10 korrikut 1991*).

36. Vetë fakti që parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës (*shih, mutatis mutandis, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, Kërkesa Nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005*).

37. Në këto rrethana, parashtruesi nuk e ka mbështetur me prova pretendimin e tij për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], sepse faktet e paraqitura nga ai nuk tregojnë në asnjë mënyrë që gjykatat e rregullta, të të tri shkallëve, ia kanë mohuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë si e papranueshme në përputhje me rregullin 36 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 15 maj 2012, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'i komunikohet parashtruesit; dhe

III. Ky Vendim do të publikohet në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Snezhana Botusharova Prof. Dr. Enver Hasani

KI 78/11 datë 19 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan P. nr. 162/2003, të 7 prillit 2005, dhe aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë Ap. nr. 393/2006 të 20 maj 2008, Ap. nr. 04/2009 të 16 shtatorit 2009 dhe PKL nr. 30/2010 të 1 shkurtit 2011.

Rasti KI 78/11, vendim i 11 qershorit 2012

Fjalët kyçe: cenim i të drejtave dhe lirive kushtetuese, kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, ligji i procedurës penale, vepra penale e vrasjes.

Parashtruesit paraqitën kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat dhe liritë e tyre kushtetuese janë cenuar me aktgjykimet e gjykatave të rregullta të të gjitha shkallëve, me ç'rast parashtruesit ishin dënuar me burg lidhur me akuzat mes tjerash për kryerje të veprës penale të vrasjes. Parashtruesit pohuan se gjykatat e rregullta të të gjitha shkallëve kanë cenuar të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara me nenin 30 të Kushtetutës së Kosovës.Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesve ishte e papranueshme bazuar në Rregullin 36 të Rregullores së Punës për shkak se ishte qartazi e pabazuar. Gjykata vendimin e saj e arsyetoi duke theksuar se gjykatat e rregullta i kanë marrë parasysh dhe iu kanë përgjigjur ankesave të parashtruesve në çështje ligjore që kanë të bëjnë me pranimin e provave dhe vërtetësinë e tyre, vërtetimin e gjendjes faktike dhe zhvillimin e procedurës penale. Gjykata poashtu përsëriti se nuk është gjykatë e apelit apo gjykatë e shkallës së katërt dhe se vërtetimi i plotë dhe i drejtë i gjendjes faktike është juridiksion i gjykatave të rregullta. Duke cituar vendimin e GJEDNJ-së në rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* Gjykata më tutje arsyetoi se fakti që parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të të drejtave dhe lirive kushtetuese. Për

shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

Prishtinë, më 11 qershor 2012

Nr. ref.: RK252/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 78/11

Parashtrues

Burim Ramadani, Arsim Ramadani, Arben Kiqina dhe Blerim Kiqina

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan P. nr. 162/2003, të 7 prillit 2005, dhe aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë Ap. nr. 393/2006 të 20 maj 2008, Ap. nr. 04/2009 të 16 shtatorit 2009 dhe PKL nr. 30/2010 të 1 shkurtit 2011.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Cukalovic, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtrues

1. Kërkesa u parashtrua nga Burim Ramadani, Arsim Ramadani, Arben Kiqina dhe Blerim Kiqina (bashkërisht: Parashtruesit) përmes përfaqësuesit të autorizuar, Mahmut Halimi nga Mitrovica dhe Haxhi Millaku nga Prishtina.

Baza juridike

2. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit nr. 03/L-21 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejmë:Ligji) dhe Rregulli 56 (2) i

Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi ka parashtruar kërkesën mbi bazën që Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan P. Nr. 162/2003, i 7 prillit 2005, dhe aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë Ap. Nr. 393/2006 i 20 majit 2008, Nr. 4/09 i 16 shtatorit 2009 dhe PKL-KZI Nr. 30/2010 i 1 shkurtit 2011, kanë rezultuar me shkeljen e drejtave të tyre kushtetuese, përkatësisht nenit 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit].

Procedura në Gjykatë

4. Më 7 qershor 2011, parashtruesit dorëzuan në Gjykatë një kërkesë të regjistruar me numër nr. KI78/11.

5. Para kësaj, më 25 qershor 2010, znj. Sebahate Shala, nga Krajkova e Gllogovcit, ka parashtruar një kërkesë të bazuar në autorizimin e Këshillit Organizativ "Drejtësi për rastin Kiqina" e regjistruar me numrin e referencës nr. KI46/10.

6. Gjithashtu para kësaj, më 29 qershor 2010, Arben Kiqina parashtroi ankesë në Gjykatë që është regjistruar në të njëjtën datë me nr. KI52/10.
7. Gjithashtu më 29 mars 2011, Jeton Sefer Kiqina parashtroi kërkesë në Gjykatë që është regjistruar në të njëjtën datë me nr. KI43/11.

8. Më 13 qershor 2011, Burim Ramadani dorëzoi në Gjykatë një kërkesë që është regjistruar me nr. KI81/11.

9. Më 11 nëntor 2010, Kryetari caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese në kërkesën KI46/10. Të njëjtën ditë, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

10. Më 19 korrik 2011, Kryetari, me Urdhrin BK-46/10, i bashkoi kërkesat e ndara KI46/10, KI52/10, KI43/11, KI78/11 dhe KI81/11, për shkak të ndërlidhjes së njëra tjetrës me objektin e çështjes. Gjyqtari raportues dhe Kolegji shqyrtues mbetën të njëjtët për të gjitha kërkesat.

11. Më 14 maj 2012, për shkak të mungesës së përkohshme të Gjyqtarit Ivan Čukalovič, Kryetari caktoi veten, Enver Hasani, si gjyqtar zëvendësues në Kolegjin Shqyrtues.

12. Më 15 maj 2012 Kolegji Shqyrtues shqyrtoi Raportin Paraprak të Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve sipas dokumenteve që parashtruesi i kishte parashtruar në Gjykatë

13. Në mbrëmjen e datës 20 gusht 2001, H. H., së bashku me gruan dhe fëmijët e tij kishin qenë në një dasmë në fshatin Baicë. Pasi u larguan nga dasma, më vonë at natë, vetura e tij ishte zënë në pritë dhe ai, gruaja e tij, djali i tij dhe dy vajzat ishin vrarë nga të shtënat. Vajza më e re kishte mbijetuar.

14. Ditën e nesërme Blerim Kiqina dhe Jeton Kiqina takuan Burim Ramadanin, Arsim Ramadanin, Arben Kiqinën dhe një tjetër jashtë restorantit Era në Gllogoc. Burim Ramadani u kishte thënë që aksioni kishte shkuar shumë mirë dhe se S. H. i kishte dhënë ose do t'ia jepte atij të hollat. Kishte një diskutim se si të ndaheshin të hollat.

15. Më 4 korrik 2002, Blerim Kiqina u vetëdorëzua në stacionin e policisë. Me këtë rast ai u arrestua, iu komunikuan të drejtat e tij dhe pastaj u morr në pyetje. Blerim Kiqina hoqi dorë nga e drejta për të heshtur dhe në ndihmë juridike dhe vazhdoi dhënien e deklaratës.

16. Më 7 korrik 2002, kur Berim Kiqina u paraqit para Gjyqtarit hetues ai gati fjalë për fjalë e përsëriti atë që ia kishte thënë policisë gjatë marrjes në pyetja më 4 korrik 2002.

17. Pavarësisht nga dëshmitë e dhëna në polici më 4 dhe 7 korrik 2002, më pas, më 11 tetor 2002, Blerim Kiqina tërhoqi përshkrimin e ngjarjeve në bazë të asaj që ai e kishte trilluar tregimin sepse gjoja ai ishte manipuluar gjatë procesit të dhënies së deklaratës.

18. Pas aktakuzës dhe gjykimit pasues në Gjykatën e Qarkut në Gjilan (Aktgjykimi P. Nr. 162/03, i datës 7 prill 2005) Burim Ramadani, Arben Kiqina, Arsim Ramadani, Blerim Kiqina, dhe të tjerët, ishin dënuar për vrasjen e pesë anëtarëve të familjes H.H.

19. Të gjithë të pandehurit parashtruan ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan Nr. 162/2003, të datës 7 prill 2005. Pas seancës së mbajtur më 20 maj 2008, Gjykata Supreme e Kosovës, në shkallë të dytë, e shpalli Aktgjykimin e vet (AP - KZ 393/2006) duke i refuzuar ankesat e Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit, Arben Kiqinës dhe Blerim Kiqinës në bazë të papranueshmërisë. Gjykata Supreme e konfirmoi aktgjykimin e shkallës së parë në lidhje me katër ankuesit. Megjithatë, të akuzuarit e tjerë u liruan në mungesë provash që ata e kishin kryer veprën penale për të cilën ishin akuzuar.

20. Ankesat e parashtruara nga Burim Ramadani, Arsim Ramadani dhe Arben Kiqina kontestuan aktgjykimin e shpallur nga Gjykata Supreme në shkallë të dytë me pretendimin që kishte: shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale (duke përfshirë zëvendësimin e gjyqtarit në Kolegjin e gjyqtarëve); zbatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; shkeljen e të drejtës penale dhe vendimin e gabuar për dënimin. Gjykata Supreme i shqyrtoi aspektet procedurale dhe thelbësore që paraqiteshin në ankesë.

21. Të pakënaqur me rezultatin e ankesës, parashtruesit parashtruan edhe një ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme. Gjykata Supreme, në Kolegjin e shkallës së tretë, i refuzoi ankesat si të papranueshme (Aktgjykimi API. Nr. 04/2009, i datës 16 shtator 2009).

22. Një nga çështjet e para të ngritura në këtë ankesë kishte të bënte me përbërjen e Kolegjit gjykues të Gjykatës së Qarkut

(gjykata e shkallës së parë). Gjatë gjykimit, një gjyqtar ndërkombëtar në Kolegj u zëvendësua me një gjyqtar tjetër ndërkombëtar. Parashtruesi pretendonte që kjo iu kishte mundësuar gjyqtarëve tjerë që të ndikojnë në gjyqtarin e ri dhe që gjykimi do të duhej të rifillonte nga fillimi. Ai pretendonte që Gjykata Supreme në shkallën e dytë kishte refuzuar që kishte shkelje të Kodit të Procedurës Penale.

23. Gjykata Supreme, në shkallën e tretë, e hodhi poshtë këtë pjesë të ankesës si të pathemeltë në bazë nenit 305 të Ligjit të Procedurës Penale, dhe konstatoi: *"Në atë kohë Kolegji zbatoi nenin 305 të Ligjit të Procedurës Penale i cili, në rast të zëvendësimit të një gjyqtari tjetër, përveç kryetarit të Kolegjit, ofron mundësinë që Kolegji ose të rifillojë shqyrtimin gjyqësor prej fillimit ose të vendosë ta vazhdojë atë dhe të lexojë procesverbalet e shqyrtimeve të mëparshme. Gjyqtari i ri ka marrë të gjitha procesverbalet e gjykimit dhe palët pranuan dhe kështu të gjitha shënimet u lexuan".*

24. Përveç kësaj, zëvendësimi i një gjyqtari ndërkombëtar në trupin gjykues ishte i lejuar me ligj dhe ishin përmbushur kriteret për këtë zëvendësim. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese i referohet rastit P.K. kundër Finlandës, Kërkesa Nr. 37442/97, në të cilin Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), në seancën e 9 korrikut 2002, vendosi që pavarësisht zëvendësimit të një gjyqtari gjatë rrjedhës së gjykimit të P.K.-së "*Detyra e Gjykatës është të konstatojë nëse procedurat në tërësi, duke përfshirë mënyrën e marrjes së provave, ishin të drejta. ... Megjithatë, Gjykata konsideron që, në rrethanat specifike të këtij rasti, kjo e metë më vete nuk përbën shkelje të nenit 6. Së pari, edhe pse kryetari i trupit gjykues ishte ndërruar, tre gjyqtarët e tjerë porotë mbetën të njëjtit gjatë tërë procedurës. Së dyti, kredibiliteti i dëshmitarit në fjalë nuk është kontestuar në asnjë fazë, e as që ka ndonjë indikacion në shkresa të lëndës që i justifikojnë dyshimet për kredibilitetin e saj. Në këto rrethana, fakti që kryetari i ri i trupit gjykues kishte në dispozicion procesverbalin e seancës në të cilën dëshmitari ishte dëgjuar (khs. Karjalainen kundër Finlandës, Kërkesa Nr. 30519/96, Vendimi i Komisionit i 16 prillit 1998, i paraportuar) e kompenson në masë të madhe mungesën e tij të drejtpërdrejtë në procedurë. Së treti, dënimi i parashtruesit nuk ishte i bazuar vetëm në dëshminë e dëshmitarit H. Së*

fundi, nuk ka asgjë që sugjeron se kryetari i trupit gjykues ishte ndërruar për të ndikuar në përfundimin e rastit apo për ndonjë motiv tjetër të pavend. ... Konkluzionet e nxjerra nga gjykatat vendëse në këtë rast nuk duken të jenë arbitrare për të ngritur çështje sipas nenit 6...” Edhe një rast tjetër i GJEDNJ-së tregon se fakti i thjeshtë i zëvendësimit të një gjyqtari gjatë rrjedhës së gjykimit nuk përbën, vetvetiu, shkelje të nenit 6 të Konventës (*shih Barbera, Messegue dhe Jabardo kundër Spanjës, Kërkesa Nr. 10590/83, e 6 dhjetorit 1988, Moiseyev kundër Rusisë (Kërkesa Nr. 62936/00), e 9 tetorit 2008, dhe Ocalan kundër Turqisë (Kërkesa Nr. 46221/99), e 15 majit 2005*). Duke pasur tërë këtë parasysh, kjo Gjykatë është e mendimit që Gjykata Supreme kishte të drejtë kur konstatoi që nuk kishte shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm me rastin e zëvendësimit të gjyqtarit ndërkombëtar.

25. Në lidhje me ankesën e Blerim Kiqinës, të datës 2 shtator 2008, Gjykata Supreme konstatoi se ankesa është paraqitur jashtë rasteve të parapara me ligj në përputhje me nenin 391 të Ligjit për Procedurën Penale. Për më tepër, Gjykata Supreme konsideroi se mjeti juridik i propozuar në ankesa nuk ishte i lejuar sipas Ligjit. Për këto arsye, Gjykata Supreme hodhi poshtë ankesën në përputhje me nenin 383 të Ligjit për Procedurë Penale.

26. Një pjesë tjetër thelbësore e ankesës të cilën parashtruesit ia kishin parashtruar Gjykatës Supreme, si shkallë e tretë, kishte të bënte me lejueshmërinë e dëshmive të përdorura prej gjykatave më të ulta. Që të dyja aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe të Gjykatës Supreme në shkallën e dytë janë kryesisht të bazuara në deklaratat e dhëna nga: Blerim Kiqina në fazën hetimore, dëshmitari “MB” dhe vajza që i mbijetoi të shtënave. Të gjitha këto burime të dëshmive janë kundërshtuar me ankesë (dhe janë përsëritur në kërkesë). Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Ap. Nr. 04/2009, të datës 16 shtator 2009, e kishte hedhur poshtë ankesën dhe kishte konkluduar siç vijon:

    a. Pas shqyrtimit të video incizimeve të deklaratave të dëshmisë së Blerim Kiqinës, rrëfimi i tij ishte i vërtetë dhe nuk kishte arsye për të besuar se ai kishte sajuar dëshmitë. Të dhënat e hollësishme të vrasjes mund të kishin ardhur vetëm nga dikush i cili kishte njohuri të afërta të ngjarjes;

b. Pas shqyrtimit të deklaratave të Blerim Kiqinës të 4 korrikut 2001, 7 korrikut 2002 dhe 11 tetorit 2002, janë identifikuar disa mospërputhje veçanërisht në lidhje me lëvizjet e Blerim Kiqinës më 20 gusht 2011. U konstatua se e gjithë dëshmia e tij nuk mund dhe nuk do të duhej të hidhej tej, thjesht, vetëm se nuk është pjesërisht e besueshme në disa pjesë. Pas shqyrtimit të pjesës së pranueshme të dëshmisë së tij, ishte e qartë se Blerim Kiqina kishte dalë në vendngjarje në kohën e caktuar dhe kishte kryer veprat penale që ai pranoi t'i ketë kryer. Besueshmëria e deklaratës së dhënë nga Blerim Kiqina para gjykatësit hetues më 7 korrik 2002, ishte vërtetuar nga motivet e rrëfimit të tij, nga saktësia dhe përputhshmëria e deklaratave të tij, mungesa e mospërputhjeve të rëndësishme dhe paqëndrueshmëria e alibisë së parashtruesve;

c. Aktgjykimet gjithashtu marrin parasysh provat mbështetëse të rrëfimit, siç janë: përshkrimi i saktë i të akuzuarve të tjerë nga Blerim Kiqina, ekzistenca e vendit prej nga janë marrë armët, koha e nisjes së familjes Hajra nga dasma, rendi i ngjarjeve në urë dhe pozita e makinës në urë. Është vërtetuar nga dëshmitë e vajzës që u kishte mbijetuar të shtënave, dëshmia e dëshmitares "MB", e R.K. S.K, E.K, S.K, G.K, Y.K. dhe B. K., regjistrimet e thirrjeve telefonike si dhe ekzaminimet balistike të plumbave që verifikuan dëshminë e Blerim Kiqinës për llojin e armës së përdorur për të kryer krimin;

d. Pretendimi se dëshmia e "MB" ishte e papranueshme ishte refuzuar sepse ishte e pabazuar. "MB" ka dhënë dëshmi se Burim Ramadani kishte zbuluar para saj se ai kishte kryer vrasjet. Është argumentuar në ankesë se: 1)"MB" nuk ishte këshilluar lidhur me të drejtën për të mos dëshmuar duke marrë parasysh se ajo kishte bashkëjetuar me Burim Ramadanin; 2) Publiku ishte përjashtuar në mënyrë të paligjshme nga dëshmia e saj gojore gjatë seancës, dhe Kolegji nuk kishte lëshuar një vendim me shkrim lidhur me masat mbrojtëse që i janë dhënë "MB"; 3)Burim Ramadanit i mohohet e drejta për t'i bërë pyetje "MB",që rezulton në shkelje të dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale;

e. Në përgjigje ndaj ankesës, Gjykata theksoi se përjashtimi nga dëshmia aplikohet vetëm në bashkëshortët dhe "MB" nuk ishte përjashtuar sepse nuk ishte bashkëshortja e Burim Ramadanit. Në pajtim me nenet 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/20, Trupi gjykues aplikoi masat mbrojtëse ndaj "MB" sepse ishte një dëshmitare që njihte mirë të pandehurin dhe kishte lidhje intime me të. Vendimi gjyqësor përmbante vendimin për të përjashtuar publikun nga seanca kur "MB" kishte për të dhënë dëshminë me gojë. Së fundi, Burim Ramadanit nuk i ishte mohuar mundësia për t'i bërë pyetje "MB" gjatë dëshmisë së saj. Në përgjithësi, dëshmia e "MB" është konsideruar e besueshme veçanërisht në dritën e faktit se ajo ishte ftuar nga policia për të dhënë dëshminë, kjo ishte arsyetuar në të dhënat e ngjarjeve dhe ajo ka mbajtur dëshmitë e saja pavarësisht kërcënimeve nga anëtarët e familjes së të pandehurve;

f. Ankesa përmbante një argument që procedura penale ishte shkelur nga Gjykata me mënyrën se si është dhënë dëshmia e vajzës që u kishte mbijetuar të shtënave. Gjykata konstatoi se nuk ka pasur shkelje të procedurës penale me mospërfshirjen e publikut gjatë dëshmisë së vajzës që u kishte mbijetuar të shtënave, duke marrë parasysh se ajo kishte dëshmuar me anë të lidhjes së videos. Gjithashtu, në gjykimin kryesor, avokati kishte mundësinë që ta ekzaminonte atë; dhe

g. Pretendimi se ka pasur një përcaktim jo të plotë të gjendjes faktike për shkak të zhdukjes së provave materiale të rëndësishme, u hodh poshtë nga Gjykata në bazë të asaj se kjo nuk ka penguar përcaktimin e saktë të gjendjes faktike. Ankesat i referoheshin shenjave të pëllëmbës në parafinë, të marra më 21 gusht 2001 nga F.K. dhe Arben Kiqina dhe shqyrtimit të disa eksponateve të mbledhura në vendet e hetuara, që duhej të ekzaminoheshin në mënyrë që të gjinden shenjat e gishtërinjve ose mostrat ADN-së.

27. Gjykata Supreme në shkallën e tretë pohoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë në tërësi.

28. Parashtruesit konsideruan aktgjykimin e lartpërmendur si "jashtëzakonisht të padrejtë dhe jo të bazuar në prova të besueshme dhe bindëse". Prandaj, ata paraqitën një kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë nga ana e Gjykatës Supreme. Sidoqoftë, me aktgjykimin PKL. Nr. 30/10, të 1 shkurtit 2011, Gjykata Supreme edhe një herë hodhi poshtë kërkesën.

Pretendimet e parashtruesit

29. Ankesa e përgjithshme që përmban kërkesa është se gjykatat më të ulëta kanë bërë vetëm gjetjet, vlerësimet dhe konkluzionet e përgjithshme duke shkelur dispozitat procedurale me të cilat kërkohet nga gjykatat që të vlerësojnë me ndershmëri çdo pjesë të provave ndaras dhe në ndërlidhje me provat e tjera. Prandaj, në bazë të kësaj, parashtruesit pohojnë se aktgjykimet nuk mund qëndrojnë.

30. Në përgjithësi, parashtruesit kontestojnë besueshmërinë e provave të përdorura nga gjykatat më të ulëta në formulimin e gjykimeve dhe pretendojnë se ka pasur shqyrtim të papërshtatshëm të provave. Parashtruesit në kërkesë kanë pohuar si në vijim:

    a. Gjykatat nuk i kanë mbështetur pohimet e dëshmitarëve kyç me prova të mjaftueshme, siç është materiali mjeko-ligjor;

    b. Provat e dëshmitarit "MB" nuk është dashur të merren parasysh nga gjykatat duke konsideruar se ajo ka qenë në lidhje me Burim Ramadanin deri në kohën e arrestimit të tij, dhe kërkoi të hakmerrej ndaj Burim Ramadanit që nuk u martua me të;

    c. Dëshmia e Blerim Kiqinës, të cilës i është dhënë prioritet nga gjykatat, ishte kontradiktore dhe me defekte sepse ai ishte i mitur kur ndodhi vrasja, ai ishte mashtruar nga hetuesit me mundësinë që të largohej jashtë vendit dhe ishte kërcënuar nga policia që të ndërronte dëshminë e tij;

d. Dëshmia e vajzës që u kishte mbijetuar të shtënave nuk do të duhej të merrej parasysh për shkak të mospërputhjes me dëshmitë e tjera;

e. Në bazë të nenit 157 të KPPK, gjykatat nuk do të duhej të kishin shpallë të pandehurit fajtorë vetëm në bazë të një dëshmie të vetme; dhe

f. Gjykata e Qarkut ka shkelur procedurën penale (nenet 354-359 dhe 403 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës) sepse pas emërimit të një gjyqtari të ri në panel gjatë procedurës, gjykimi nuk kishte rifilluar nga e para.

Vlerësimi i pranueshmërisë

31. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj dhe në Rregullore të punës.

32. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton se:

> "*Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj*".

33. Në rastin konkret, Gjykata thekson se parashtruesit kanë përmbushur kërkesat e caktuara në nenin 113.7 të Kushtetutës.

34. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e verifikimit të fakteve, dhe me këtë rast dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i saj është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (*shih mutatis mutandis, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R. J. D, 1996-IV, para. 65. Gjithashtu shih edhe Aktvendimin e*

papranueshmërisë në rastin Nr. KI-86/11 – Parashtruesi i kërkesës Milaim Berisha – Kërkesa për vlerësimin kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 20/09, të datës 1.3.2011 – marrë nga Gjykata më 5 prill 2012).

35. Nga faktet e paraqitura në kërkesë vërehet se, parashtruesit e kërkesës kanë shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore në dispozicion, dhe se gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh dhe njëmend i janë përgjigjur ankesave të tyre në pikat e ligjit lidhur me pranimin e dëshmive dhe vërtetësisë së tyre, përcaktimit të situatës faktike dhe rrjedhës së procedurës penale. Kështu që, Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në këtë kërkesë që do të tregonte se në dëgjimet e gjykatave të këtij rasti mungonte paanshmëria apo se procedurat ishin përndryshe të padrejta.

36. Në lidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës nuk i kanë mbështetur pretendimet e tyre, duke shpjeguar se si dhe pse është bërë ndonjë shkelje, ose duke ofruar dëshmi për të vërtetuar se u është shkelur ndonjë e drejtë e garantuar me Kushtetutë.

37. Për më tepër, kërkesa nuk tregon se Gjykata Supreme ka vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të zëvendësojë vlerësimin e saj të fakteve me atë të gjykatave të rregullta, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave të vlerësojnë dëshmitë para vetes. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është që të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë ato dëshmi, (shih Aktgjykimin GJEDNJ *App. Nr 13071/87 Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, paragrafi 3, të 10 korrikut 1991*).

38. Fakti se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë që të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të neneve 30 [e Drejta e të akuzuarit] & 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës (shih *mutatis mutandis* Aktgjykimi GJEDNJ Appl. nr. 5503/02, Mezotur–Tiszazugi Tarsulat vs. Hungary, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

39. Në këto rrethana, parashtruesit nuk kanë mbështetur me prova pretendimet e tyre e as shkeljet e nenit 30 [e Drejta e të akuzuarit] & 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës, sepse faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk tregojnë se gjykatat e rregullta të tri instancave ua kanë mohuar atyre të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

40. Kërkesa e regjistruar me numrin KI78/11 është qartazi e pabazuar dhe duhet të hedhet poshtë si e papranueshme në pajtueshmëri me rregullin 36 të Rregullores.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, pas shqyrtimeve më 15 maj 2012, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve; dhe

III. Ky Vendim do të publikohet në Gazetën Zyrtare, pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Dr. Snezhana Botusharova Prof. Dr. Enver Hasani

KI 81/11 datë 19 qershor 2012- Kërkesë për vlerësim të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan P. Nr. 162/2003, të datës 7 prill 2005, aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë Ap. Nr. 393/2006 të datës 20 maj 2008, Ap. Nr. 04/2009 të datës 16 shtator 2009 dhe PKL Nr. 30/2010 të datës 1 shkurt 2011.

Rasti KI 81/11, vendim i 11 qershorit 2012.

Fjalët kyçe: cenim i të drejtave dhe lirive kushtetuese, kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, ligji i procedurës penale, vepra penale e vrasjes.

Parashtruesit paraqitën kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat dhe liritë e tyre kushtetuese janë cenuar me aktgjykimet e gjykatave të rregullta të të gjitha shkallëve, me ç'rast parashtruesit ishin dënuar me burg lidhur me akuzat mes tjerash për kryerje të veprës penale të vrasjes. Parashtruesit pohuan se gjykatat e rregullta të të gjitha shkallëve kanë cenuar të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara me nenin 30, 31, 33 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 5 (1), nenit 6 (1) (2) dhe nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesve ishte e papranueshme bazuar në Rregullin 36 të Rregullores së Punës për shkak se ishte qartazi e pabazuar. Gjykata vendimin e saj e arsyetoi duke theksuar se gjykatat e rregullta i kanë marrë parasysh dhe iu kanë përgjigjur ankesave të parashtruesve në çështje ligjore që kanë të bëjnë me pranimin e provave dhe vërtetësinë e tyre, vërtetimin e gjendjes faktike dhe zhvillimin e procedurës penale. Gjykata poashtu përsëriti se nuk është gjykatë e apelit apo gjykatë e shkallës së katërt dhe se vërtetimi i plotë dhe i drejtë i gjendjes faktike është juridiksion i gjykatave të rregullta. Duke cituar vendimin e GJEDNJ-së në rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë,* Gjykata më tutje arsyetoi se fakti që parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të të drejtave dhe lirive kushtetuese. Për shkak të arsyeve të

përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

Prishtinë, më 11 qershor 2012

Nr. ref.: RK253/12

AKTVENDIM PËR PAPRANRSHMËRI

në

Rasti Nr. KI 81/11

Parashtrues

Burim Ramadani dhe Arsim Ramadani

Kërkesë për vlerësim të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan P. Nr. 162/2003, të datës 7 prill 2005, aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë Ap. Nr. 393/2006 të datës 20 maj 2008, Ap. Nr. 04/2009 të datës 16 shtator 2009 dhe PKL Nr. 30/2010 të datës 1 shkurt 2011.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa ishte paraqitur nga Burim Ramadani dhe Arsim Ramadani (bashkërisht: parashtruesit e kërkesës) përmes përfaqësueses së tyre të autorizuar, Vahide Braha, avokate nga Prishtina.

2. Faktet dhe pretendimet në përmbajtje të kësaj kërkese janë regjistruar me numrin KI81/11 dhe në përmbajtje janë identike me faktet dhe pretendimet e paraqitura në kërkesat KI46/10, KI52/10, KI43/11 dhe KI78/11.

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit nr. 03/L-21 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesën me arsyetimin se Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan P.Nr.162/2003, i datës 7 prill 2005, dhe aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës: Ap.Nr.393/2006 i datës 20 maj 2008, Ap. Nr. 04/2009 i datës 16 shtator 2009 dhe PKL.Nr. 30/2010 i datës 1 shkurt 2011, rezultuan me shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese, gjegjësisht nenit 30 [Të drejtat e të akuzuarit], nenit 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], nenit 33 [Parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale]si dhe nenit 5 (1), nenit 6 (1) (2) dhe nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa).

Procedura në Gjykatë

5. Më 13 qershor 2011, parashtruesit e kërkesës i dorëzuan Gjykatës kërkesën që u regjistrua me numrin KI81/11.

6. Para kësaj, më 25 qershor 2010, znj. Sebahate Shala nga Krajkova e Gllogovcit ka parashtruar kërkesë në bazë të autorizimit nga Këshilli Organizativ “Drejtësi për rastin Kiqina” i cili ishte regjistruar me numër KI46/10.

7. Gjithashtu, para kësaj, më 29 qershor 2010, Arben Kiqina i parashtroi kërkesë Gjykatës e cila ishte regjistruar po atë ditë me numër KI52/10.

8. Gjithashtu, para kësaj, më 29 mars 2011, Jeton Sefer Kiqina i parashtroi kërkesë Gjykatës e cila u regjistrua po atë ditë me numër KI43/11.

9. Gjithashtu, para kësaj, më 7 qershor 2011, Burim Ramadani, Arsim Ramadani, Arben Kiqina dhe Blerim Kiqina dorëzuan në Gjykatë kërkesën e cila u regjistrua me numër KI78/11.

10. Më 11 nëntor 2010, Kryetari emëroi gjyqtaren Snezhana Botusharova si Gjyqtare raportuese për kërkesën KI46/10. Po të njëjtën ditë, Kryetari emëroi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

11. Më 19 korrik 2011, Kryetari, me Vendimin BK-46/10, i bashkoi të gjitha këto kërkesa të veçanta KI46/10, KI52/10, KI43/11, KI78/11 dhe KI81/11, për shkak të lidhjeve të njërës me tjetrën sa i përket objekti të çështjes dhe personave që parashtruan kërkesat. Gjyqtarja raportuese dhe Kolegji shqyrtues mbetën po të njëjtit për të gjitha kërkesat.

12. Më 14 maj 2012, për shkak të mungesës së përkohshme të gjyqtarit Ivan Čukalović, Kryetari emëroi veten si zëvendësim për gjyqtarin e Kolegjit shqyrtues.

13. Më 15 maj 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit raportues dhe i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve sipas dokumentacionit të parashtruar në Gjykatë nga parashtruesit e kërkesës

14. Në mbrëmjen e 20 gushtit 2001, H. H., gruaja e tij dhe fëmijët kishin marrë pjesë në një dasmë në fshatin Baicë. Pas largimit nga dasma, më vonë atë natë, vetura e tyre kishte rënë në pritë dhe, ai, gruaja e tij, i biri dhe dy të bijat ishin qëlluar për vdekje. Një vajzë e re mbijetoi.

15. Ditën e nesërme Blerim Kiqina dhe Jeton Kiqina takuan Burim Ramadanin, Arsim Ramadanin, Arben Kiqinën dhe një tjetër jashtë restorantit Era në Gllogovc. Burim Ramadani u

kishte thënë që aksioni kishte shkuar shumë mirë dhe që S.H. ia kishte dhënë ose do t'ia jepte paratë. U zhvillua një diskutim se si do të ndaheshin paratë.

16. Më 4 korrik 2002, Blerim Kiqina u vetëdorëzua në stacionin e policisë. Me këtë rast ai u arrestua, iu komunikuan të drejtat e tij dhe pastaj u morr në pyetje. Blerim Kiqina hoqi dorë nga e drejta për të heshtur dhe në ndihmë juridike dhe vazhdoi dhënien e deklaratës.

17. Më 7 korrik 2002, kur Blerim Kiqina u soll para Gjyqtarit hetues dhe ai e përsëriti gati fjalë për fjalë atë që ia kishte thënë policisë gjatë marrjes në pyetje më 4 korrik 2002.

18. Pavarësisht nga provat e ofruara më 4 dhe 7 korrik 2002, Blerim Kiqina, më 11 tetor 2002, më pas tërhoqi rrëfimin e tij të ngjarjeve me arsyetimin se atij i ishte fabrikuar tregimi sepse gjoja ishte manipuluar gjatë procesit të intervistimit.

19. Pas akuzës dhe gjykimit pasues në Gjykatën e Qarkut në Gjilan (Aktgjykimi P. Nr. 162/03, i datës 7 prill 2005) Burim Ramadani, Arben Kiqina, Arsim Ramadani, Blerim Kiqina, dhe të tjerë, ishin dënuar për vrasjen e pesë anëtarëve të familjes H.

20. Të gjithë të pandehurit parashtruan ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan Nr. 162/2003, të datës 7 prill 2005. Pas seancës së mbajtur më 20 maj 2008, Gjykata Supreme e Kosovës, në shkallë të dytë, e shpalli Aktgjykimin e vet (AP - KZ 393/2006) duke i refuzuar ankesat e Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit, Arben Kiqinës dhe Blerim Kiqinës në bazë të papranueshmërisë. Gjykata Supreme e konfirmoi aktgjykimin e shkallës së parë në lidhje me katër ankuesit. Megjithatë, të akuzuarit e tjerë u liruan në mungesë provash që ata e kishin kryer veprën penale për të cilën ishin akuzuar.

21. Ankesat e parashtruara nga Burim Ramadani, Arsim Ramadani dhe Arben Kiqina kontestuan aktgjykimin e shpallur nga Gjykata Supreme në shkallë të dytë me pretendim që kishte: shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale (duke përfshi zëvendësimin e gjyqtarit në

Trupin gjykues); zbatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; shkeljen e të drejtës penale dhe vendimin e gabuar për dënimin. Gjykata Supreme i shqyrtoi aspektet procedurale dhe thelbësore që paraqiteshin në ankesë.

22. Të pakënaqur më rezultatin e ankesës, parashtruesit e kërkesës parashtruan edhe një ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme. Gjykata Supreme, në Kolegjin e shkallës së tretë, i refuzoi ankesat si të papranueshme (Aktgjykimi API. Nr. 04/2009, i datës 16 shtator 2009).

23. Një nga çështjet e para të ngritura në këtë ankesë kishte të bënte me përbërjen e Trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut (gjykata e shkallës së parë). Gjatë gjykimit, një gjyqtar ndërkombëtar në Kolegj u zëvendësua me një gjyqtar tjetër ndërkombëtar. Parashtruesi argumentoi që kjo ua kishte mundësuar gjyqtarëve të tjerë që të ndikojnë në gjyqtarin e ri dhe që gjykimi do të duhej të rifillonte nga fillimi. Ai pretendonte që Gjykata Supreme në shkallën e dytë kishte refuzuar që kishte shkelje të Kodit të Procedurës Penale

24. Gjykata Supreme, në shkallën e tretë, në bazë nenit 305 të Ligjit të Procedurës Penale e hodhi poshtë këtë pjesë të ankesës si të pabazë, dhe deklaroi se: *"Në atë kohë trupi gjykues zbatoi nenin 305 të Ligjit për Procedurë Penale i cili, në rast të zëvendësimit të një gjyqtari, përveç kryesuesit të trupit gjykues, ofron mundësinë që kolegji të rifillojë shqyrtimin gjyqësor prej fillimit ose të vendosë ta vazhdojë atë dhe të lexojë procesverbalet e shqyrtimeve të mëparshme. Gjyqtari i ri ka marrë të gjitha procesverbalet e gjykimit dhe palët pranuan dhe kështu të gjitha shënimet u lexuan"*.

25. Përveç kësaj, zëvendësimi i një gjyqtari ndërkombëtar në trupin gjykues ishte i lejuar me ligj dhe kushtet për këtë zëvendësim ishin plotësuar. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese i referohet rastit P.K. kundër Finlandës, Kërkesa Nr. 37442/97, në të cilin Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), në seancën e 9 korrikut 2002, vendosi që pavarësisht zëvendësimit të një gjyqtari gjatë rrjedhës së gjykimit të P.K.-së "*Detyra e Gjykatës është të konstatojë nëse procedurat në tërësi, duke përfshirë mënyrën e marrjes së provave, ishin të drejta. ... Megjithatë, Gjykata konsideron që, në rrethanat specifike të këtij rasti, kjo e metë më vete nuk*

përbën shkelje të nenit 6. Së pari, edhe pse kryetari i trupit gjykues ishte ndërruar, tre gjyqtarët e tjerë porotë mbetën të njëjtit gjatë tërë procedurës. Së dyti, kredibiliteti i dëshmitarit në fjalë nuk është kontestuar në asnjë fazë, e as që ka ndonjë indikacion në shkresa të lëndës që i justifikojnë dyshimet për kredibilitetin e saj. Në këto rrethana, fakti që kryetari i ri i trupit gjykues kishte në dispozicion procesverbalin e seancës në të cilën dëshmitari ishte dëgjuar (khs. Karjalainen kundër Finlandës, Kërkesa Nr. 30519/96, Vendimi i Komisionit i 16 prillit 1998, i paraportuar) e kompenson në masë të madhe mungesën e tij të drejtpërdrejtë në procedurë. Së treti, dënimi i parashtruesit nuk ishte i bazuar vetëm në dëshminë e dëshmitarit H. Së fundi, nuk ka asgjë që sugjeron se kryetari i trupit gjykues ishte ndërruar për të ndikuar në përfundimin e rastit apo për ndonjë motiv tjetër të pavend. ... Konkluzionet e nxjerra nga gjykatat vendëse në këtë rast nuk duken të jenë arbitrare për të ngritur çështje sipas nenit 6...” Edhe një rast tjetër i GJEDNJ-së tregon se fakti i thjeshtë i zëvendësimit të një gjyqtari gjatë rrjedhës së gjykimit nuk përbën, vetvetiu, shkelje të nenit 6 të Konventës (*shih Barbera, Messegue dhe Jabardo kundër Spanjës, Kërkesa Nr. 10590/83, e 6 dhjetorit 1988, Moiseyev kundër Rusisë (Kërkesa Nr. 62936/00), e 9 tetorit 2008, dhe Ocalan kundër Turqisë (Kërkesa Nr. 46221/99), e 15 majit 2005*). Duke pasur tërë këtë parasysh, kjo Gjykatë është e mendimit që Gjykata Supreme kishte të drejtë kur konstatoi që nuk kishte shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm me rastin e zëvendësimit të gjyqtarit ndërkombëtar.

26. Një pjesë tjetër thelbësore e ankesës të cilën parashtruesit ia kishin parashtruar Gjykatës Supreme, si shkallë e tretë, kishte të bënte me lejueshmërinë e dëshmive të përdorura prej gjykatave më të ulëta. Që të dyja aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe të Gjykatës Supreme në shkallën e dytë janë kryesisht të bazuara në deklaratat e dhëna nga: Blerim Kiqina në fazën hetimore, dëshmitari “MB” dhe vajza që mbijetoi të shtënat. Të gjitha këto burime të dëshmive janë kontestuar në ankesë (dhe janë përsëritur në kërkesë). Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Ap. Nr. 04/2009, të datës 16 shtator 2009, e kishte hedhur poshtë ankesën dhe ka theksuar si vijon:

a. Pas shqyrtimit të video incizimeve të deklaratave të dëshmisë së Blerim Kiqinës, rrëfimi i tij ishte i vërtetë dhe nuk kishte arsye për të besuar se ai kishte sajuar dëshmitë. Të dhënat e hollësishme të vrasjes mund të kishin ardhur vetëm nga dikush i cili kishte njohuri të afërta me ngjarjen;

b. Pas shqyrtimit të deklaratave të Blerim Kiqinës të datave 4 korrik 2001, 7 korrik 2002 dhe 11 tetor 2002, janë identifikuar disa mospërputhje veçanërisht në lidhje me lëvizjet e Blerim Kiqinës më 20 gusht 2001. U konstatua se e gjithë dëshmia e tij nuk duhet dhe nuk mund të hidhet tej vetëm pasi nuk është pjesërisht e besueshme. Pas shqyrtimit të pjesës së pranueshme të dëshmisë së tij, ishte e qartë se Blerim Kiqina ishte ndodhur në vendngjarje në kohën e caktuar dhe kishte kryer shkeljet që ai pranoi t'i ketë kryer. Besueshmëria e deklaratës së dhënë nga Blerim Kiqina para Gjyqtarit hetues më 7 korrik 2002 ishte vërtetuar nga motivet e rrëfimit të tij, nga saktësia dhe përputhshmëria e deklaratave të tij, mungesa e mospërputhjeve të rëndësishme dhe paqëndrueshmëria e alibisë së të ankuarve;

c. Aktgjykimet gjithashtu morën parasysh provat mbështetëse të rrëfimit, siç janë: përshkrimi i saktë i të akuzuarve të tjerë nga Blerim Kiqina, ekzistenca e vendit prej nga janë marrë armët, koha e nisjes së familjes H nga dasma, rendi i ngjarjeve në urë dhe pozita e makinës në urë. Është vërtetuar nga dëshmitë e vajzës së mbijetuar, dëshmia e dëshmitares "MB", e RK, SK, EK, SK, GK, YK dhe BK, regjistrimet e thirrjeve telefonike si dhe ekzaminimet balistike të plumbave që verifikuan dëshminë e Blerim Kiqinës për llojin e armës së përdorur për të kryer krimin;

d. Pretendimi se dëshmia e "MB" ishte e papranueshme ishte refuzuar sepse ishte e pabazuar. "MB" ka dhënë dëshmi se Burim Ramadani kishte zbuluar para saj se ai kishte kryer vrasjet. Është argumentuar në ankesë se: 1)"MB" nuk ishte këshilluar lidhur me të drejtën për të mos dëshmuar duke marrë parasysh se ajo kishte bashkëjetuar me Burim Ramadanin; 2) Publiku ishte përjashtuar në mënyrë të paligjshme nga dëshmia e saj gojore gjatë seancës, dhe Kolegji nuk kishte lëshuar një vendim me shkrim lidhur me

masat mbrojtëse që i janë dhënë "MB"; dhe 3)Burim Ramadanit i ishte mohuar e drejta për t'i bërë pyetje "MB"që rezulton në shkelje të dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale;

e. Në përgjigje ndaj këtyre ankesave, Gjykata theksoi se përjashtimi nga dëshmia aplikohet vetëm me bashkëshortët, dhe se "MB" nuk ishte përjashtuar sepse nuk ishte bashkëshortja e Burim Ramadanit. Në pajtim me nenet 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/20, Trupi gjykues aplikoi masat mbrojtëse ndaj "MB" sepse ishte një dëshmitare që njihte mirë të pandehurin dhe kishte lidhje intime me të. Vendimi gjyqësor përmbante vendimin për të përjashtuar publikun nga seanca kur "MB" kishte për të dhënë dëshminë me gojë. Së fundmi, Burim Ramadanit nuk i ishte mohuar mundësia për t'i bërë pyetje "MB" gjatë dëshmisë së saj. Në përgjithësi, dëshmia e "MB" është konsideruar e besueshme, veçanërisht në dritën e faktit se ajo ishte ftuar nga policia për të dhënë dëshminë, kjo ishte arsyetuar në të dhënat e ngjarjeve dhe ajo ka mbajtur dëshmitë e saja pavarësisht kërcënimeve nga anëtarët e familjes së të pandehurve;

f. Ankesa përmbante argumentin që procedura penale ishte shkelur nga Gjykata me mënyrën se si është dhënë dëshmia e vajzës që mbijetoi të shtënat. Gjykata konstatoi se nuk ka pasur shkelje të procedurës penale me mospërfshirjen e publikut gjatë dëshmisë së vajzës që mbijetoi të shtënat, duke pasur parasysh se ajo kishte dëshmuar me anë të lidhjes së videos. Gjithashtu, në gjykimin kryesor avokati kishte mundësinë që ta ekzaminonte atë; dhe

g. Pretendimi se ka pasur një përcaktim jo të plotë të gjendjes faktike për shkak të zhdukjes së provave materiale të rëndësishme, u hodh poshtë nga Gjykata në bazë të asaj se kjo nuk ka penguar përcaktimin e saktë të gjendjes faktike. Ankesat i referoheshin shenjave të pëllëmbës në parafinë të marra nga FK dhe Arben Kiqina, më 21 gusht 2001, dhe ekzaminimit të disa eksponateve të mbledhura në vendet e hetuara, që duhej të ekzaminoheshin në mënyrë që të gjinden shenjat e gishtërinjve ose mostrat ADN-së.

27. Gjykata Supreme, në shkallën e tretë, konfirmoi aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së dytë në tërësi.

28. Parashtruesit konsideruan aktgjykimin e lartpërmendur si "jashtëzakonisht të padrejtë dhe jo të bazuar në prova të besueshme dhe bindëse". Prandaj, ata paraqitën një kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë nga ana e Gjykatës Supreme. Sidoqoftë, me aktgjykimin PKL. Nr. 30/10, të 1 shkurtit 2011, Gjykata Supreme edhe një herë hodhi poshtë kërkesën.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

29. Ankesa e përgjithshme në kërkesë është se gjykatat e rregullta kishin kryer vetëm gjetje të përgjithshme. Kështu që, vlerësimet dhe konkluzionet ishin nxjerrë duke shkelur dispozitat procedurale, që kërkojnë nga gjykatat vlerësim të sinqertë të secilës dëshmi në veçanti dhe në lidhje me njëra tjetrën. Prandaj, në bazë të kësaj, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se aktgjykimet janë të paqëndrueshme.

a. Në përgjithësi, parashtruesit e kërkesës kontestojnë besueshmërinë e dëshmive të përdorura nga gjykatat e rregullta në formulimin e aktgjykimeve dhe pretendojnë se shqyrtimi i këtyre dëshmive nuk ishte i duhur. Parashtruesit e kërkesës në kërkesën e tyre pohojnë si vijon:

b. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se këto vendime gjyqësore janë marrë në kundërshtim me nenet 31 dhe 33 të Kushtetutës, dhe në kundërshtim me nenin 6 (2) e nenin 14 të Konventës, duke shkelur të drejtat e parashtruesit për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm;

c. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta janë marrë me anë të shkeljeve procedurale duke vënë nën presion dëshmitarët, duke manipuluar dhe dhënë premtime dëshmitarëve në këmbim të dhënies së deklaratave dhe duke mos vlerësuar dëshmitë që u shkojnë në favor të akuzuarve si dhe duke mos i verifikuar dëshmitë akuzuese me prova shkencore;

d. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se në rastin e tyre janë shkelur neni 152.1 dhe neni 155 paragrafi 1 pika 3 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës lidhur me marrjen në pyetje të Blerim Kiqinës, më 7 korrik 2002, para Gjyqtarit hetues pa praninë e avokatit mbrojtës dhe të akuzuarve;

e. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se në rastin konkret janë shkelur të drejtat bazë dhe ato kushtetuese, si dhe neni 5.1 i Konventës;

f. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Kolegji ndërkombëtar i cili e ka trajtuar rastin e tyre nuk ka qenë i pavarur dhe i paanshëm sikurse parashihet me nenin 6.1 të Konventës, dhe se nuk është respektuar supozimi i pafajësisë, siç garantohet me nenin 6(2) të Konventës dhe nenin 3 paragrafi 1.2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës;

g. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se gjykatat e rregullta vendimet e tyre në tërësi i kanë bazuar në dëshmi të papranueshme, sepse deklaratat e Blerim Kiqinës, të datës 4 korrik 2002 dhe 7 korrik 2002, si dhe të dëshmitares "MB" që kishte konflikt interesi me të akuzuarin Burim Ramadani, janë ligjërisht të papranueshme;

h. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se deklaratat e të bashkëakuzuarit Blerim Kiqina, në bazë të nenit 157 paragrafi 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, nuk mund të përdoren si dëshmi për të vërtetuar fajin e të akuzuarit, pikërisht se edhe vetë ai është bashkëakuzuar dhe se gjykatat e rregullta në vendimet e tyre supozuan se i bashkëakuzuari me dëshirë dha deklaratën inkriminuese, dhe se vetëm në bazë të deklaratës në fjalë parashtruesit e kërkesës u shpallën fajtorë;

i. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se pohimet e dhëna para policisë, ose Prokurorit publik, nuk konsiderohen si pohim gjyqësor. Pohimi do të konsiderohej pohim gjyqësor po të jepej në seancën për konfirmimin e aktakuzës, ose gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe do të pranohej nga gjykata si i tillë. Parashtruesit e kërkesës kurrë nuk e pranuan fajësinë e tyre;

j. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese t'i konsiderojë deklaratat e Blerim Kiqinës të datës 7 korrik 2002, dhe ato të dëshmitares "MB" të datës 6 nëntor 2002, si dëshmi të tërthorta, si dhe procesverbalin e datës 27 maj 2004 si provë apo dëshmi e papranueshme, sepse në bazë të dëshmive në fjalë Burim Ramadani, Arsim Ramadani dhe Arben Kiqina ishin dënuar me 90 vjet burgim;

k. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se 98 % e deklaratës së Blerim Kiqinës ishte eliminuar, me ç'rast shtatë të akuzuar të tjerë u liruan, pikërisht në bazë të deklaratës në fjalë, përfshirë edhe të akuzuarin e parë SK, i cili dyshohet të ketë mashtruar parashtruesit e kërkesës. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se motivi i aktakuzës së tyre ishte bazuar në pretendimet se ata ishin mashtruar nga SK; dhe

l. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se Kolegji ndërkombëtar i EULEX-it, përkundër të gjitha shkeljeve ligjore që e përcollën rastin e tyre, në fund refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe vërtetoi fajësinë duke i dënuar parashtruesit e kërkesës.

Vlerësimi i pranueshmërisë

30. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.

31. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton se:

> "*Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj*".

32. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e verifikimit të fakteve, dhe me këtë rast dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është

vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumentet tjera ligjore, prandaj, nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (*shih mutatis mutandis, ndër të tjera, Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65. gjithashtu shih edhe Aktvendimin për papranuenueshmëri në rastin Nr. KI-86/11 – Parashtruesi i kërkesës Milaim Berisha – Kërkesa për vlerësimin kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.20/09, të datës 1.3.2011 – marrë nga Gjykata më 5 prill 2012).*

33. Nga faktet e paraqitura në kërkesë vërehet se, parashtruesit e kërkesës kanë shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore në dispozicion, dhe se gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh dhe njëmend i janë përgjigjur ankesave të tyre në pikat e ligjit lidhur me pranimin e dëshmive dhe vërtetësisë së tyre, përcaktimit të situatës faktike dhe rrjedhës së procedurës penale. Kështu që, Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në këtë kërkesë që do të tregonte se në dëgjimet e gjykatave në këtë rast mungonte paanshmëria apo se procedurat ishin të padrejta.

34. Në lidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës nuk i kanë mbështetur pretendimet e tyre duke shpjeguar se si dhe pse ishte kryer shkelja, ose duke ofruar dëshmi për të vërtetuar se u është shkelur e drejta e garantuar me Kushtetutë.

35. Për më tepër, kërkesa nuk tregon se Gjykata Supreme veproi në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të zëvendësojë vlerësimin vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave të vlerësojnë dëshmitë para vetes. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është që të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregulltarë, në tërësi, përfshirë edhe mënyrat se si janë marrë ato dëshmi, kanë qenë të drejta (shih Aktgjykimin GJEDNJ *App. Nr 13071/87 Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, para 34 të 10 korrikut 1991*).

36. Fakti se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë që të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) (2) e Konventës, sepse faktet që ata i kanë paraqitur në asnjë mënyrë nuk tregojnë se gjykatat e rregullta, të të tri instancave,

ua kanë cenuar atyre të drejtat e garantuara e Kushtetutë. Andaj, kërkesa e regjistruar me numrin KI81/11 është qartazi e pabazuar dhe duhet hedhë poshtë si e papranueshme në pajtueshmëri me rregullin 36 të Rregullores.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, pas shqyrtimit më 15 maj 2012, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, njëzëri:

VENDOSI

I. TË HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'i komunikohet palës; dhe

III. Ky Vendim do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Snezhana Botusharova Prof. Dr. Enver Hasani

KO 45/12 dhe KO 46/12 datë 27 qershor 2012- Kërkesa e Liburn Aliut dhe 11 deputetëve të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe dhe të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit

Rastet KO 45/12 dhe KO 46/12, vendim i 25 qershorit 2012.

Fjalët kyçe: barazia para ligjit, diskriminim, kërkesë e deputetëve të Kuvendit, këshillat komunal, margjinalizim, parimi i laicitetit dhe neutralitetit, prezumimi i kushtetushmërisë së ligjeve, trashëgimia fetare dhe kulturore, vetëqeverisja lokale.

Parashtruesit paraqitën kërkesën bazuar në Nenin 113.5 të Kushtetutës, duke pohuar se Neni 4.3.3 i Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe, Neni 14.1.2 i Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, janë në kundërshtim me Kushtetutën. Parashtruesit pohuan se Neni 4.3.3 i Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe ishte në kundërshtim me parimin e laicitetit dhe neutralitetit në çështje fetare dhe se krijon privilegje për një bashkësi fetare duke i margjinalizuar dhe diskriminuar bashkësitë tjera fetare dhe qytetarët që nuk kanë orientim apo besim fetar. Parashtruesit paraqitën argumente të njëjta në lidhje me Nenin 14.1.2 të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit.

Neni 4 i Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe parasheh themelimin e një këshilli nga komuna e Rahovecit. Këshilli në fjalë përbëhet nga pesë (5) anëtarë, ku njëri prej tyre zgjedhet nga kisha ortodokse serbe dhe se duhet të jetë anëtar i fshatit Hoçë e Madhe. Parashtruesit theksuan se është e domosdoshme që përbërja e Këshilllit për fshatin Hoçë e Madhe të mos perfshijë asnjë anëtar të caktuar nga kisha ortodokse serbe sepse kjo me automatizem krijon pozitë të privilegjuar për të, dhe se në atë rast *mes tjerash* shkelet neni 24 [Barazia para Ligjit], i Kushtetutës duke krijuar kështu pabarazi të hapur për kishën ortodokse serbe në raport me anëtarët e bashkësive të tjera fetare dhe personave që nuk i përkasin asnjë orientimi fetar.

Neni 14.1.2 i Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit parasheh themelimin e Këshillit për Trashëgimi Kulturore nga komuna e Prizrenit. Këshilli në fjalë përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, ku bashkësia islame, kisha ortodokse serbe dhe kisha katolike përzgjedhin nga një anëtar për përfaqësim në atë Këshill. Sa i përket shkeljes së nenit 24 [Barazia para Ligjit], Parashtruesit pohuan se përfshirja e tri bashkësive fetare në Ligj qartazi favorizon ato kundrejt bashkësive tjera fetare dhe qytetarëve pa orientim fetar, dhe se *mes tjerash* përbën shkelje të Nenit 24 të Kushtetutës. Për t'i mbështetur pohimet e tyre parashtruesit cituan raste nga praktike gjyqësore e GJEDNJ-së, si dhe një rast nga praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme të SHBA-ve.

Gjykata konstatoi se parashtruesit janë palë e autorizuar dhe kërkesat janë parashtruar brenda afatit të paraparë kohor, ata i kanë përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë dhe, si rrjedhojë, kërkesat e tyre janë të pranueshme.

Lidhur me meritat e kërkesave, Gjykata ua rikujtoi parashtruesve se Kapitulli III i Kushtetutës parashikon mbrojtje të posaçme për komunitetet që tradicionalisht kanë qenë të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës, dhe se Kapitulli II, Neni 45.3 parasheh që institucionet shtetërore mbështesin mundësitë e çdonjërit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike. Për më tepër, Gjykata theksoi se ligjet që miratohen në Kuvend kanë bazë kushtetuese për mandat të gjerë për të ofruar procese konsultative për planifikim që janë propozuar në Ligjet për fshatin Hoçë e Madhe dhe Qendrën Historike të Prizrenit. Gjykata më tutje theksoi se ndonëse Këshillave në të dy rastet u është dhënë shkallë e lartë e përgjegjësisë konsultative, ato nuk kanë kompetenca ekzekutive, dhe se vendimet për çështje të planifikimit merren në fund, pas konsultimit përkatës nga komunat perkatëse, e jo nga Këshillat e themeluara me Ligjet në fjalë. Gjykata poashtu theksoi se paragrafi 3 i Nenit 24 të Kushtetutës avancon të drejtat e individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarbartë, ndërsa parashtruesit kishin lexuar paragrafët 1 dhe 2 të nenit 24 të Kushtetutës shkëputur nga paragrafi 3 i po të njëjtit nen.

Gjykata më tutje theksoi se rastet nga praktika gjyqësore të cituara nga parashtruesit nuk përkonin me të drejtën e bashkësive fetare që të kenë zë konsultativ në vendimet për planifikim që ndikojnë në fshatin Hoçë e Madhe dhe në Qendrën Historike të Prizrenit, dhe se

nuk u ndihmojnë atyre për ta argumentuar rastin e tyre se nenet e ligjeve të kontestuara nuk janë në përputhje me Kushtetutën. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata konstatoi se kërkesa është e pranueshme nga aspekti procedural – formal; që neni 4.3.3 i Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës; që neni 14.1.2 i Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës; urdhëroi që Aktgjykimi t'u komunikohet palëve dhe, në përputhje me nenin 2004 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare; dhe deklaroi që Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Prishtinë, më 25 qershor 2012

Nr.Ref.:AGJ 255/12

AKTGJYKIM

në

Rastet KO 45/12 dhe KO 46/12

Kërkesa e Liburn Aliut dhe 11 deputetëve të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe dhe të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare, dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë Liburn Aliu dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Kosovës: Albana Gashi, Albana Fetoshi, Albin Kurti, Rexhep Selimi, Glauk Konjufca, Florin Krasniqi, Visar Ymeri, Albulena Haxhiu, Afrim Kasalli, Emir Gerbeshi, dhe Nait Hasani (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës).

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes së këtyre kërkesave është kushtetutshmëria e nenit 4.3.3 të Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe, dhe e nenit 16.1.2 të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit. Këto dy Ligje u miratuan nga Kuvendi i Kosovës më 20 prill 2012.

Baza juridike

3. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenet 20 dhe 43 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

4. Më 27 prill 2012, parashtruesit i dorëzuan dy kërkesa në Gjykatën Kushtetuese, në të cilat pohonin se nene të caktuara të Ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, pra të Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe, të regjistruar nën Nr. KO45-12, dhe të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, të regjistruar nën Nr. KO46-12, ishin në kundërshtim me nenet e Kushtetutës, siç ceket më poshtë.

5. Më 30 prill 2012, Kryetari, me Vendimet Nos. GJR. 45/12 dhe 46/12, e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese për të dy kërkesat. Të njëjtën datë, Kryetari i caktoi Kolegjet shqyrtuese për të dy kërkesat të përbëra nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Kadri Kryeziu.

6. Më 7 maj 2012, Kërkesa KO45-12, në lidhje me Ligjin për fshatin Hoçë e Madhe, iu komunikua përfaqësuesve të kishës ortodokse në Kosovë, Qeverisë, Kuvendit dhe përfaqësuesit civil ndërkombëtar, z. Peter Feith. Nga ta u kërkua t'i jepnin komentet në lidhje me këtë kërkesë, po të dëshironin.

7. Po ashtu më 7 maj 20120, Kërkesa KO45-12, në lidhje me Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit iu komunikua përfaqësuesve të kishës ortodokse serbe, përfaqësuesve të kishës katolike dhe përfaqësuesve të bashkësisë islame, Qeverisë, Kuvendit dhe përfaqësuesit civil ndërkombëtar, z. Peter Feith. Nga ta u kërkua t'i jepnin komentet në lidhje me këtë kërkesë, po të dëshironin.

8. Më 15 maj 2012, Kryetari, me rekomandim të Gjyqtares raportuese, i bashkoi këto dy kërkesa për shkak të lidhshmërisë së tyre me njëra-tjetrën sa i përket objektit të çështjes dhe personave që i parashtrojnë kërkesat. Gjyqtarja raportuese dhe Kolegji shqyrtues mbetën të njëjtit për të dy kërkesat.

9. Përfaqësuesi i kishës katolike iu përgjigj Gjykatës më 9 maj 2012. Përgjigja trajtohet më poshtë.

10. Përfaqësuesi i kishës ortodokse serbe iu përgjigj Gjykatës më 14 maj 2012. Përgjigja trajtohet më poshtë.

11. Përfaqësuesi i bashkësisë islame iu përgjigj Gjykatës më 14 maj 2012. Përgjigja e tyre trajtohet më poshtë.

12. Kuvendi iu përgjigj Gjykatës më 14 maj 2012. Përgjigja e tyre trajtohet më poshtë.

13. Qeveria iu përgjigj Gjykatës më 17 maj 2012. Përgjigja e tyre trajtohet më poshtë.

14. Më 29 maj 2012, nga parashtruesit u kërkua ta sqaronin autorizimin që i ishte dhënë z. Liburn Aliu nga të gjithë deputetët për t'i paraqitur kërkesat në Gjykatën Kushtetuese. Sqarimi i tyre u pranua më 4 qershor 2012.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

15. Për të gjykuar për kërkesat e parashtruesve, së pari duhet të shqyrtohet nëse ata i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

16. Gjykata së pari duhet të përcaktojë nëse parashtruesit mund të konsiderohen palë e autorizuar sipas nenit 113.1 të Kushtetutës, i cili përcakton: *"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar"*.

17. Neni 113.5 i Kushtetutës përcakton që: *"Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur"*.

18. Kërkesat u parashtruan tetë ditë pas miratimit të ligjeve nga Kuvendi. Prandaj, parashtruesit janë palë e autorizuar, kanë të drejtë ta parashtrojnë këtë rast në Gjykatë, sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, dhe kërkesat janë parashtruar brenda afatit të paraparë kohor.

19. Pasi parashtruesit janë palë e autorizuar dhe kërkesat janë parashtruar brenda afatit të paraparë kohor, ata i kanë përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë dhe, si rrjedhojë, janë të pranueshme. Kjo do të thotë që Gjykata mund t'i shqyrtojë meritat e ankesës së paraqitur në kërkesa. Shtrirja

e meritave do të kufizohet brenda fushëveprimit të nenit 113.5 të Kushtetutës, pra të vendosë nëse nenet e kontestuara të Ligjeve, të miratuara nga Kuvendi i Kosovës, janë kushtetues, vetëm sa i përket substancës së tyre. Parashtruesit nuk e kontestojnë procedurën e zbatuar nga Kuvendi. Duke pasur parasysh vendimin e Gjykatës për t'i bashkuar kërkesat, substanca e tyre do të shqyrtohet bashkërisht në këtë Aktgjykim.

Argumentet e parashtruesve

Ligji për fshatin Hoçë e Madhe

20. Parashtruesit pohojnë që neni 4.3.3 është në kundërshtim me parimin e laicitetit dhe neutralitetit në çështje fetare dhe se krijon privilegje për një bashkësi fetare duke i margjinalizuar dhe diskriminuar bashkësitë e tjera fetare dhe qytetarët që nuk kanë orientim apo besim fetar.

21. Neni 4 i Ligjit parasheh themelimin e një Këshilli nga komuna e Rahovecit, i cili ka për detyrë t'i përfaqësojë interesat e fshatit në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë fetare dhe kulturore dhe në fushën e planifikimit rural. Neni 4.3 i Ligjit parasheh përbërjen e Këshillit me sa vijon:

Neni 4

Këshilli

3. Këshilli përbehet prej pese (5) anëtarëve:

3.1. dy (2) anëtarë zgjedhën nga Kuvendi i Komunës dhe

3.2. dy (2) anëtarë zgjedhën drejtpërdrejtë nga banorët e fshatit Hoçë e Madhe.

3.3. një anëtarë (1) zgjidhet nga Kisha ortodokse serbe, i cili duhet të jetë anëtarë i fshatit Hoçë e Madhe.

22. Parashtruesit konsiderojnë që miratimi i Ligjit me një përmbajtje të tillë i shkel këto nene të Kushtetutës:

1) Nenin 8 [Shteti Laik],
2) Nenin 24 [Barazia para Ligjit],
3) Nenin 123.3 [Parimet e Përgjithshme], dhe
4) Nenin 124.3 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale]

23. Parashtruesit gjithashtu theksojnë se Ligji për lirinë fetare në Kosovë, Ligji Nr. 02/L-31, përcakton në nenin 5 që bashkësitë fetare janë të ndara nga autoritetet publike.

24. Parashtruesit thonë që parimet e laicitetit dhe neutralitetit në çështje fetare paraqesin obligim për të gjitha institucionet publike që gjatë ushtrimit të autorizimeve të tyre kushtetuese ta ruajnë paanshmërinë e tyre ndaj bashkësive fetare dhe ndaj koncepteve ateiste dhe agnostike. Ata gjithashtu theksojnë se institucionet publike nuk duhet ta favorizojnë apo anashkalojnë asnjë person apo kolektivitet të themeluar mbi konceptet e besimit fetar dhe se duhet të mbesin neutrale në të gjitha çështjet e besimit fetar dhe që, duke i përfshirë përfaqësuesit e bashkësive fetare në një organ publik, Ligji shkel parimin e laicitetit dhe neutralitetit të organeve publike.

25. Ata theksojnë se është e domosdoshme që përbërja e Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe të mos përfshijë asnjë anëtar të caktuar nga kisha ortodokse serbe sepse kjo me automatizëm krijon pozitë të privilegjuar për të.

26. Sa i përket shkeljes së nenit 24 [Barazia para Ligjit], parashtruesit pohojnë që Ligji krijon pabarazi të hapur për kishën ortodokse serbe në raport me anëtarët e bashkësive të tjera fetare dhe personave që nuk i përkasin asnjë orientimi fetar.

27. Sa i përket nenit 123.3 [Parimet e Përgjithshme] dhe nenit 124.3 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale], parashtruesit pohojnë që Ligji paraqet shkelje të autonomisë komunale, e cila buron nga Kapitulli X i Kushtetutës. Ata pohojnë që kompetenca për menaxhimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe planifikimin rural i janë marrë komunës në mënyrë arbitrare.

Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit

28. Parashtruesit kanë paraqitur argumente të njëjta në lidhje me Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit. Ata pohojnë që neni 14.1.2 është në kundërshtim me parimin e laicitetit dhe neutralitetit në çështje fetare dhe se krijon privilegje për një bashkësi fetare duke i margjinalizuar dhe diskriminuar bashkësitë e tjera fetare dhe qytetarët që nuk kanë orientim apo besim fetar.

29. Neni i Ligjit parasheh themelimin e Këshillit nga komuna e Prizrenit, roli i të cilit është të vëzhgojë dhe këshillojë rreth aktiviteteve në Qendrën Historike të Prizrenit për ruajtjen e trashëgimisë së saj kulturore. Neni 14.1 i Ligjit parasheh përbërjen e Këshillit me sa vijon:

Neni 14

Këshilli për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit

1. Këshilli për Trashëgiminë Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit duhet të themelohet nga Komuna e Prizrenit brenda (katër)4 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji dhe përbëhet nga shtatë (7) anëtarë:

1.1. gjashtë (6) anëtarë të shquar nga shoqëria civile e Kosovës që kanë përvojë në ruajtjen, zhvillimin dhe/ose promovimin e trashëgimisë kulturore të Prizrenit;
1.2. tre (3) anëtarë nga shoqëria civile sipas nënparagrafit 1.1. të këtij neni, do të përzgjidhen:

1.2.1. një (1) anëtar përzgjidhet nga Bashkësia Islame;

1.2.2. një (1) anëtar përzgjidhet nga Kisha Ortodokse Serbe dhe

1.2.3. një (1) anëtar përzgjidhet nga Kisha Katolike;

1.3. së paku dy (2) prej anëtarëve nga shoqëria civile do të jenë ekspertë të njohur në fushën e trashëgimisë kulturore, me kualifikim apo përvojë profesionale në fushë të tillë. Preferencë do të kenë kandidatët që i përmbushin të dy kriteret;

1.4. anëtari i shtatë do të jetë përfaqësues i Zyrës Komunale përgjegjëse për Komunitete dhe Kthim.

30. Parashtruesit pohojnë që miratimi i Ligjit që përmban nenin 16.1.2 shkel të njëjtat nene të Kushtetutës siç ceket në paragrafin 23 më sipër. Parashtruesit gjithashtu i paraqesin të njëjtat argumente lidhur me laicitetin dhe neutralitetin në çështje të besimit fetar dhe obligimet e të gjitha institucioneve publike për të mbetur të paanshme ndaj bashkësive fetare.

31. Sa i përket shkeljes së nenit 24 [Barazia para Ligjit], parashtruesit pohojnë që përfshirja e tri bashkësive fetare në

Ligj qartazi i favorizon ato kundrejt bashkësive të tjera fetare dhe qytetarëve pa orientim fetar.

32. Parashtruesit theksuan Aneksin 5, nenin 4.17, të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i cili përcakton:

"*4.1.7 Zona e mbrojtur për Qendrën Historike të Prizrenit do të përcaktohet nga organet komunale të Prizrenit në bashkëpunim me KZM-në dhe do të përfshijë objektet e Kishës Ortodokse, objektet otomane, katolike, laike dhe objektet tjera të rëndësisë së veçantë historike dhe kulturore.*"

33. Edhe një herë, parashtruesit përsëritën argumentin e shkeljes së Kapitullit X të Kushtetutës në lidhje me Vetëqeverisjen Lokale në kuptimin që janë shkelur neni 123.3 [Parimet e Përgjithshme] dhe neni 124.3 [Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale]. Ata pohojnë që e drejta për menaxhimin e Qendrës Historike të Prizrenit i është marrë komunës së Prizrenit në mënyrë arbitrare.

34. Në lidhje me këto dy Ligje, parashtruesit i referohen praktikës gjyqësore jashtë Kosovës për t'i mbështetur argumentet e veta. Së pari, ata citojnë rastin Epperson kundër Arkanzasit, një rast i vitit 1968 nga Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me ç'rast e citojnë atë Gjykatë duke theksuar se Qeveria duhet të jetë neutrale në çështje të teorisë, doktrinës dhe praktikës fetare dhe se nuk mund ta nxisë apo mbështesë një fe apo teori fetare kundër tjetrës.

35. Së dyti, ata citojnë rastet Hasan dhe Chaush kundër Bullgarisë, rast nga viti 2000, dhe Alexandridis kundër Greqisë nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), një rast nga viti 2008. Ata pohojnë që këto raste mbështesin pikëpamjen që GJEDNJ mbështeti parimin e neutralitetit të shtetit përballë feve.

Përgjigjet e palëve të interesuara

Kisha katolike

36. Kisha katolike u përgjigj më 9 maj 2012 duke dorëzuar një kopje të deklaratës publike të lëshuar nga kisha më 9 shkurt 2007. Në kontekst të komentimit të propozimeve për trashëgiminë kulturore dhe fetare në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, ajo deklaratë publike e kishës shprehte vërejtjet mbi trashëgiminë e përbashkët të Kosovës që nga mijëvjeçari i parë dhe vinte në pah shumë komplekse që përmbanin shembuj të rëndësisë kulturore dhe arkeologjike. Përmbajtja dhe mësymja e deklaratës publike ishte në mbështetje të neneve të Propozimit për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i cili parashikonte trashëgiminë fetare dhe kulturore.

Kisha ortodokse serbe

37. Kisha ortodokse serbe theksoi në përgjigjen e vet trashëgiminë kulturore dhe historike të zonave të mbuluara me këtë Ligj "në të cilat jetojmë së bashku". Ata iu referuan Konventave të UNESCO-s për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Botërore dhe Konventës për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore jo-materiale. Ata theksuan se Kuvendi njohu dhe pranoi mbrojtjen e tillë me rastin e miratimit të këtyre Ligjeve. Ata theksuan se trashëgimia "jo-materiale" nuk përfshinte vetëm zakonet, teknologjitë dhe artizanatet, por edhe besimet, praktikat, traditat dhe ritet fetare, dhe mësimet morale. Ata theksuan se në këto dy zona të mbrojtura me këto ligje kishte shumë objekte të rëndësisë historike dhe kulturore.

38. Ata theksojnë se dispozita e Kushtetutës në nenin 8 që ka të bëjë me natyrën laike të shtetit, ndiqet menjëherë nga neni 9, i

cili e detyron Republikën e Kosovës që ta sigurojë ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë së vet kulturore dhe fetare.

39. Ata theksojnë se shkronja dhe fryma e Kushtetutës dhe shkronja dhe fryma e Ligjit për trashëgiminë kulturore që kujdesen për trashëgiminë kulturore është nën juridiksion të pronarëve të trashëgimisë kulturore dhe të autoriteteve qendrore. Autoritetet qendrore mund t'ua bartin atë kujdes autoriteteve lokale, të cilat duhet të bashkëpunojnë me pronarët e trashëgimisë kulturore në territorin e tyre.

40. Kisha ortodokse serbe thekson se në rastin Epperson kundër Arkanzasit, të cilit i referohen parashtruesit në mbështetje të kërkesës, kishte të bënte me mësimdhënien e biologjisë evolucionare në sistemin arsimor të shtetit të Arnakzasit dhe se Ligjet që po kontestohen nuk kanë të bëjnë me imponimin e besimit apo mësimit fetar në fushën e shkencave natyrore. Ata gjithashtu thonë që rasti Hasan dhe Chaush kishte të bënte me ndërhyrjen e shtetit të Bullgarisë në përzgjedhjen e kryemyftiut në atë shtet dhe, si rrjedhojë, nuk ishte relevant.

41. Ata gjithashtu i referohen Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit në mbështetje të kushtetutshmërisë së këtyre Ligjeve dhe në veçanti Aneksit V, nenit 4.1.4, i cili përcakton që do të ketë zona të mbrojtura për lokacionet e përmendura.

42. Ata gjithashtu theksojnë se bashkësitë fetare, zakonet dhe ritualet e tyre dhe objektet e zotëruara nga to lidhen jo vetëm me një grup të posaçëm të njerëzve (besimtarëve të një bashkësie fetare të veçantë) por edhe me shoqërinë e përgjithshme dhe zotimin e përgjithshëm të civilizimit dhe se e gjithë shoqëria përkufizohet nga vlerat e trashëguara nga gjeneratat e mëparshme. Prandaj, ata pohojnë se është e papranueshme të mos u lejohet bashkësive të tilla fetare të marrin pjesë në procese shoqërore, që është masë e përbashkët e cilësdo shoqëri të arsimuar.

Bashkësia islame e Kosovës

43. Në përgjigjen e vet të 15 majit 2012, bashkësia islame e Kosovës e përkrahu, në parim, rregullimin e çështjeve që ajo i konsideronte interesa të veta vitale me miratimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit. Ndonëse nuk është kundër mbrojtjes së objekteve fetare të bashkësive të tjera fetare, ajo konsideron se po bëhet "diskriminim" pozitiv ndaj trashëgimisë ortodokse serbe. Bashkësia islame konsideron se po diskriminohet sepse nuk i lejohet ta rindërtojë një objekt që më parë kishte ekzistuar në Kalanë e Prizrenit dhe Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit qartazi nuk e lejon rindërtimin e saj as tani.

Qeveria

44. Në përgjigjen e vet të 17 majit 2012, edhe Qeveria iu referua Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës dhe Aneksit V të tij, i cili parashikon rol të posaçëm për kishën ortodokse serbe, të cilës duhet t'i mundësohet mbrojtja dhe gëzimi i të drejtave, privilegjeve dhe imuniteteve të veta, ashtu siç është përcaktuar në atë Aneks. Përgjigja theksonte që Aneksi XII i Propozimit kërkonte miratimin e një Ligji mbi themelimin e zonave të mbrojtura. Ai u miratua në vitin 2008; Ligji Nr. 03/L-039, i 20 shkurtit 2008. Ai kërkonte miratimin e mëtejmë të Ligjeve për zonat e posaçme për Qendrën Historike të Prizrenit dhe për fshatin Hoçë e Madhe.

45. Pas përmendjes së natyrës konsultative të Këshillave të themeluar me Ligjet e kontestuara, Qeveria theksoi se vendimet në raste të konfliktit administrativ do të nxirren në fund nga Gjykata kompetente. Në fund, Qeveria theksoi se këto Ligje janë të domosdoshme për t'i dhënë efekt Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit.

Kuvendi

46. Kuvendi ia dorëzoi Gjykatës transkriptin e debatit të mbajtur në Kuvend. Procesverbali i debatit është dokument publik. Ligjet u miratuan me shumicën e kërkuar me Kushtetutë pas përmbushjes së të gjitha proceseve formale. Në procesverbal është përmendur edhe komenti i ministrit Dardan Gashi gjatë debatit mbi Ligjin për fshatin Hoçë e Madhe, se themelimi i këshillit qo do të formohet nuk i jep fuqi ekzekutive kishës ortodokse serbe. Ajo që ishte dhënë ishte roli konsultativ në çështje që kanë të bëjnë me çështje të planifikimit në fshatin Hoçë e Madhe.

Meritat

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara

47. Kosova është pjesë e lashtë e Evropës dhe ka trashëgimi të pasur kulturore parahistorike dhe historike. Rajoni që përbën Kosovën, siç ishte rasti me shumë pjesë të Evropës, e posaçërisht me Ballkanin, ishte ndikuar nga perandoritë dhe civilizimet e kohëve më të hershme. Njerëz të ndryshëm kanë jetuar këtu dhe i kanë lënë trashëgimitë e veta kulturore gjatë shekujve të kaluar. Kështu që Kosova sot është përzierje e historisë së vet dhe e popujve të vet, dhe ky diversitet dhe shumetnicitet pasqyrohet në gjashtë yjet e flamurit të Republikës së Kosovës.

48. Të gjitha bashkësitë i kanë kulturat dhe trashëgiminë e veta të ndryshme dhe Kushtetuta i njeh këto diversitete dhe ofron një strukturë për ruajtjen e asaj kulture dhe trashëgimie. Kjo bëhet jo vetëm për të mirën e një bashkësie individuale, por për të mirën e çdokujt në shtet.

49. Ky shumetnicitet dhe shumetnicitet pasqyrohet edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Neni 1 thotë se Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet. Neni 3 thotë se Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera. Neni 4 thotë se Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Neni 5 thotë që gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë gjuha shqipe dhe gjuha serbe. Ai gjithashtu përcakton që gjuha turke, boshnjake dhe rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune.

50. Këto janë vetëm disa nene që e përkufizojnë natyrën shumetnike të Kosovës dhe statusin e bashkësive brenda saj. Gjykata rikujton Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre], i cili parashikon mbrojtje të posaçme për banorët që i përkasin grupit të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës. Ata gëzojnë të drejta të veçanta krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj Kushtetute. Nga Kapitulli II, neni 45.3, shihet që institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.

51. Mund të thuhet që shteti ka për detyrë t'i respektojë të drejtat që u jepen bashkësive dhe anëtarëve të tyre me Kushtetutë. Të drejtat mund të mbrohen dhe parashikohen me miratimin dhe zbatimin e atyre ligjeve.

52. Prandaj, ligjet që miratohen në Kuvend kanë bazë kushtetuese për mandat të gjerë për të ofruar procese konsultative për planifikim që janë propozuar në Ligjet për fshatin Hoçë e Madhe dhe Qendrën Historike të Prizrenit.

53. Nenet që kontestohen nga parashtruesit janë nenet që përcaktojnë anëtarësimin e bashkësive në Këshilla të cilat duhet të konsultohen në procese për planifikim për Hoçë të Madhe dhe Qendrën Historike të Prizrenit.

Anëtarësia e Këshillave

54. Në rastin e fshatit Hoçë e Madhe, është paraparë që kisha ortodokse serbe ta propozojë një anëtar për Këshillin pesë-anëtarësh; ai anëtar duhet të jetë banor i fshatit. Këshilli do të themelohet nga kuvendi komunal i Rahovecit. Dy anëtarë të Këshillit zgjidhen nga kuvendi komunal; dy të tjerë zgjidhen nga banorët e fshatit. Parashtruesit nuk e kundërshtojnë Këshillin, por përfaqësimin e një personi të përzgjedhur nga kisha ortodokse serbe. Ai anëtar i Këshillit nuk duhet të jetë anëtar i kishës, por duhet të përzgjidhet nga kisha.

55. Në rastin e Qendrës Historike të Prizrenit, kuvendi komunal i Prizrenit do ta themelojë një Këshill shtatë-anëtarësh. Gjashtë anëtarë do të jenë anëtarë të shquar nga shoqëria civile e Kosovës që kanë përvojë në ruajtjen, zhvillimin dhe/ose promovimin e trashëgimisë kulturore të Prizrenit. Prej këtyre gjashtë anëtarëve, është paraparë që kisha ortodokse serbe, bashkësia islame dhe kisha katolike ta propozojnë nga një anëtar; nuk është kriter që anëtarët e propozuar të banojnë në Prizren. Anëtari i shtatë i Këshillit do të jetë përfaqësues i Zyrës komunale përgjegjëse për komunitete dhe kthim. Parashtruesit nuk e kundërshtojnë Këshillin, por përfaqësimin në Këshill të personave të përzgjedhur nga kisha ortodokse serbe, bashkësia islame dhe kisha katolike. Ata anëtarë të Këshillit nuk duhet të jenë anëtarë të kishës ortodokse serbe, bashkësisë islame apo kishës katolike, por duhet të përzgjidhen nga ato organe.

Konsultimi me Këshilla

56. Në rastin e fshatit Hoçë e Madhe, theksohet që Këshilli përfaqëson interesat e fshatit në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe në fushën e planifikimit rural. Autoritetet komunale apo qendrore do ta shqyrtojnë, zbatojnë apo integrojnë kontributin, vlerësimet dhe propozimet/rekomandimet e Këshillit siç përcaktohet me Ligj dhe me legjislacionin tjetër në fuqi. Komuna do t'i hartojë dhe

miratojë dokumentet e planifikimit për këtë fshat në përputhje me Ligjin Nr. 2003/14 për planifikimin hapësinor dhe Ligjin Nr. 03/L-106 për ndryshimin e Ligjit për planifikimin hapësinor Nr. 2003/14 dhe Ligjin Nr. 02/L-88/2006 për trashëgiminë kulturore. Në rast të marrëveshjeve në mes të Këshillit dhe autoriteteve komunale e qendrore, palët do t'ia referojnë çështjen Këshillit Zbatues dhe Monitorues, siç përcaktohet në Ligjin Nr. 03/L-039/2008 për zonat e veçanta të mbrojtura.

57. Në rastin e Qendrës Historike të Prizrenit, roli i Këshillit është të vëzhgojë dhe këshillojë rreth aktiviteteve në Qendrën Historike të Prizrenit për ruajtjen e trashëgimisë së saj kulturore. Drejtoria për urbanizëm do t'i dërgojë Këshillit kopjet e të gjitha kërkesave për projekte për leje urbanistike për ndërtim, rrënim apo modifikim të objekteve dhe aktivitete të tjera të ngjashme. Ai do të konsultohet me pronarin institucional të pronës institucionale që do të preket nga kërkesa për projekt. Këshilli do ta kërkojë pëlqimin e kishës ortodokse serbe për aktivitetet që do t'i preknin pronat e kishës. Ekziston një dispozitë për kërkesën për konsultime shtesë. Në fund, në mungesë të pëlqimit, ekziston një dispozitë për dorëzimin e rastit në Këshillin Zbatues dhe Monitorues, siç përcaktohet me Ligjin Nr. 03/L-039/2008 për zonat e veçanta të mbrojtura, i cili mund të japë udhëzime në lidhje me kërkesën për projekte.

58. Është me rëndësi të theksohet se ndonëse Këshillave në të dy rastet u është dhënë shkallë e lartë e përgjegjësisë konsultative, ato nuk kanë kompetenca ekzekutive. Vendimet për çështje të planifikimit merren në fund, pas konsultimit përkatës, nga komunat përkatëse, e jo nga Këshillat e themeluara me këto dy Ligje.

59. Efekti i themelimit të propozuar është që t'u japë rol konsultativ palëve që ka të ngjarë të preken nga propozimet për planifikim për Hoçën e Madhe dhe Qendrën Historike të Prizrenit. Megjithatë Këshillat nuk kanë veto në propozime. Në vend të kësaj, natyra e rolit të tyre është pjesëmarrëse, siç parashihet në nenin 3 të Ligjit Nr. 2003/14, i cili përcakton:

Neni 3

Parimet

Rregullimi dhe planifikimi urban duhet të bazohen në këto parime të pranuara ndërkombëtare:

(a) Promovimin e interesave të përbashkëta të Kosovës duke mbrojtur resurset natyrore dhe duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm.

(b) Promovimin e procesit demokratik të pjesëmarrjes dhe përfshirjes në formulimin e strategjive zhvillimore dhe planeve fizike.

(c) Promovimin e transparencës së plotë në planifikim dhe procesin e marrjes së vendimeve duke iu lejuar pjesëmarrësve qasjen në të dhëna dhe hartat e nevojshme.

60. Gjykata Kushtetuese, në Aktgjykimin e vet në rastin Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë kundër komunës së Prizrenit, KI 56/09, të 3 marsit 2011, në paragrafin 60 tha me sa vijon:

Neni 52 (2) i Kushtetutës garanton që:

> *"Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton."*

61. Në atë rast, një zhvillim që ndikonte në banorët e lagjes kishte filluar pa konsultime adekuate lokale dhe kjo Gjykatë gjeti që komuna në fjalë e shkeli të drejtën e garantuar me Kushtetutë.

Duke u dhënë të drejtë që të marrin pjesë në procese të planifikimit lokal, këto dy Ligje që janë nën shqyrtim lejojnë përfshirjen e kishës ortodokse serbe, bashkësisë islame dhe kishës katolike. Por, duke lejuar këtë, askush nuk përjashtohet nga pjesëmarrja në proces. Ajo që dispozitat e Ligjeve të kontestuara bëjnë është formalizimi i pjesëmarrjes dhe konsultimit me organet e përmendura. Ai e bën këtë në germën dhe frymën e Kushtetutës dhe sipas pozitës së posaçme të bashkësive në Republikën e Kosovës dhe të karakterit shumetnik të shtetit.

62. Në këto kërkesa, parashtruesit ankohen se ligjet e kontestuara janë në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit]. Ata i referohen në veçanti paragrafit 1 dhe 2 të atij neni. Megjithatë, ata nuk përmendin paragrafin 3. Neni 24 i plotë thotë me sa vijon:

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

63. Kjo Gjykatë shpesh e ka theksuar rëndësinë e parimit të barazisë, siç përcaktohet në nenin 24. Parimi i mosdiskriminimit, në baza të ndryshme në paragrafin 2, është themel që e forcon zbatimin joarbitrar të ligjeve, rregullave dhe rregulloreve. Këto janë vlerat dhe etika që e mbështesin sundimin e ligjit në një shoqëri demokratike. Dy paragrafët e parë të nenit 24 nuk duhet të lexohen të veçuar nga i treti. Paragrafi i tretë avancon të drejtat e individëve dhe të grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Është në kuadër të lirisë së vlerësimit të Kuvendit, sipas nenit 24.3, të lejojë role të posaçme konsultative që i janë dhënë kishës ortodokse serbe, bashkësisë islame dhe kishës katolike, siç është bërë në ligjet e kontestuara.

64. Parashtruesit i avancojnë argumentet e tyre duke cituar nenin 8 [Shteti Laik], i cili thotë që *"Republika e Kosovës është shtet laik dhe neutral në çështje të besimeve fetare"*. Kjo është shprehje e qatë e pozitës së shtetit në çështje të besimit fetar. Kjo do të thotë, ndër të tjera, që Shteti mund të mos ndërhyjë në punë të brendshme të organizatave fetare. U konstatua që Bullgaria veproi në kundërshtim me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa) kur ndërhyri ndërmjet grupeve kundërshtare brenda bashkësisë islame në Bullgari duke zgjedhur për udhëheqës të bashkësisë kandidatin e pëlqyer të njërit fraksion. Ky rast shqyrtohet më në detaje në paragrafin 67 më poshtë, Hasan dhe Chaush kundër Bullgarisë.

65. Parim i laicitetit, siç përcaktohet në nenin 8, gjithashtu parashikon që shteti dhe organizatat fetare veprojnë në mënyrë të pavarur brenda sferës së vet dhe nuk ushtrojnë autoritet ndaj punëve të të tjerëve. Prandaj, laiciteti lejon që organizatat fetare t'i kryejnë punët e veta pa ndërhyrje të pavend nga shteti dhe organizatat fetare nuk mund të urdhërojnë çfarë shteti mund apo nuk mund të dekretojë me ligje. Kjo nuk do të thotë që organizatat fetare përjashtohen nga debati në çështje të sferës publike apo që shtetit i ndalohet t'i rregullojë çështjet brenda sferës së vet kushtetuese. Secili duhet ta respektojë tjetrin dhe të pranojë se kanë përgjegjësi të ndryshme.

66. Por natyra laike e shtetit, siç përcaktohet në nenin 8, nuk i zëvendëson të gjitha dispozitat e tjera të Kushtetutës. Neni 9 [Trashëgimia Kulturore dhe Fetare] vjen menjëherë pas nenit për shtetin laik në Kushtetutë. Neni 9 përcakton që Kosova *"siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë së vet kulturore dhe fetare"*. Neni 24, në të cilin parashtruesit mbështeten, është në Kapitullin II të Kushtetutës, Të Drejtat dhe Liritë Themelore, dhe Kapitulli III, të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre, vjen menjëherë pas Kapitullit II. Ky Kapitull përmban të drejta specifike të u jepen grupeve kombëtare, etnike, gjuhësore dhe fetare përveç të drejtave të parapara në Kapitullin II. Gjykata duhet t'i shqyrtojë të gjitha dispozitat kushtetuese së bashku e jo të mbështetet vetëm në një me rastin e interpretimit të Kushtetutës.

Autoritetet në të cilat mbështeten parashtruesit

67. Parashtruesit e citojnë aktgjykimin e GJEDNJ-së, Hasan dhe Chaush kundër Bullgarisë, për t'i mbështetur kërkesat e tyre. Ky rast, i vendosur në vitin 2000, kishte të bënte me një kontest përbrenda bashkësisë myslimane bullgare lidhur me atë se kush duhet të jetë udhëheqës kombëtar. Qeveria e Bullgarisë u përfshi në këtë kontest dhe e zëvendësoi një person me një tjetër në postin e udhëheqësit kombëtar të bashkësisë myslimane. Parashtruesit e kërkesës në GJEDNJ theksuan se kishte pasur shkelje të nenit 9 të Konventës, bashkë me nenet e tjera. Gjykata gjeti që ka pasur ndërhyrje në organizimin e brendshëm të bashkësisë fetare myslimane dhe në të drejtën e parashtruesve për liri të fesë, të mbrojtur me nenin 9 të Konventës. Gjykata konstatoi që ndërhyrja në punët e brendshme nuk ishte përcaktuar me ligj, ishte arbitrare dhe ekzekutivit i lejonte diskrecion të lirë dhe nuk i përmbushte standardet e kërkuara të qartësisë dhe parashikueshmërisë. Ky rast është shembull i qartë i paragjykimit që shteti nuk mund të ndërhyjë në punët e brendshme të një bashkësie ose organizate fetare. Parashtruesit pohojnë se ky rast nënvizon lirinë e fesë, që është e vërtetë, por nuk mund të mbështeten në të si shembull, siç pohojnë parashtruesit, për sigurimin e një kornize

për bashkësi të caktuara fetare për të marrë pjesë në procesin e planifikimit

68. Parashtruesit gjithashtu kërkojnë të mbështeten në rastin e GJEDNJ-së Alexandridis kundër Greqisë, një aktgjykim nga viti 2008. Ky rast përfshinte një avokat nga Athina, i cili ishte i detyruar të betohej se nuk ishte i krishterë ortodoks për t'u pranuar për ta ushtruar profesionin e avokatit në gjykatën e shkallës së parë në Athinë. GJEDNJ konstatoi që liria për ta manifestuar besimin e vet përmbante edhe një aspekt negativ, pra të drejtën e individit për të mos qenë i detyruar për ta manifestuar fenë apo besimet e tij/saj fetare në mënyrë të tillë që të mund të konkludohet nëse ai/ajo mbante – nuk mbante – besime të tilla. Kjo ishte esenca e vendimit në rastin Alexandridis. Ky rast kishte të bënte me liri të fesë dhe posaçërisht për të mos e zbuluar faktin që personi nuk i përket një feje; nuk ishte rast, siç pohojnë parashtruesit, i kritikimit të rolit të kishës ortodokse greke në institucione publike. Ky rast nuk u ndihmon parashtruesve të pohojnë që bashkësitë fetare duhet të kenë zë konsultativ në vendimet për planifikim që ndikojnë në fshatin Hoçë e Madhe dhe në Qendrën Historike të Prizrenit.

69. Parashtruesit gjithashtu citojnë rastin Epperson kundër Arkanzasit, një aktgjykim i Gjykatës Supreme të SHBA-së nga viti 1968. Në këtë rast, shteti i Arkanzasit miratoi një ligj në vitin 1928 me të cilin ndalohej mësimdhënia e "teorisë ose doktrinës që njerëzimi rrjedh ose e ka prejardhjen nga një rend më i ulët i kafshëve", apo përdorimin e librave shkollorë që përfshinin material mbi evolucionin. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme e anuloi ligjin e shtetit me të cilin ndalohej mësimdhënia e evolucionit të njeriut në shkolla. Siç tha Gjykata Supreme, ligji i Arkanzasit nuk kërkoi ta hiqte nga kurikulumi i shkollave dhe universiteteve të veta tërë diskutimin për prejardhjen e njeriut. Përpjekja e ligjit kufizohej në një përpjekje për ta fshehur një teori të posaçme për shkak të konfliktit të saj të supozuar me leximin tekstual të mënyrës së krijimit që shpjegohet në Bibël. Ky rast është shembull se si besimi fetar nuk duhet të lejohet të futet në fushën publike, në këtë rast mësimdhënia e evolucionit. Ky rast mbështet parimin

se si shteti laik mund t'i ndalojë përhapjet e besimeve fetare për ta përjashtuar teorinë laike ose shkencore. Ky rast nuk është shembull për ta përjashtuar një proces të konsultimit me bashkësitë fetare në çështje të planifikimit në komuna kur kërkohet të ruhet trashëgimia kulturore. Epperson kundër Arkanzasit nuk u ndihmon parashtruesve për ta argumentuar rastin e tyre se nenet e ligjeve të kontestuara nuk janë në përputhje me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE

Në përputhje me nenin 113.5 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 43 të Ligjit, dhe rregullin 56 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese

VENDOSI

I. Njëzëri, të konstatojë që kërkesat janë të pranueshme;

II. Njëzëri, të konstatojë që neni 4.3.3 i Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës;

III. Me shumicë, të konstatojë që neni 14.1.2 i Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës;

IV. Urdhëron që ky Aktgjykim t'u komunikohet palëve dhe, në përputhje me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare; dhe

V. Deklaron që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Snezhana Botusharova Prof. Dr. Enver Hasani

KI 152/11 datë 10 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Kosovës (11/279), të 07.11.2007

Rasti KI 152/11, vendim i 26 qershorit 2012

Fjalët kyçe: Vendim i Qeverisë, kërkesë individuale, kërkesë e paafatshme, ratione temporis në papajtueshmëri me Kushtetutën, e drejta e konkurrencës, marrëdhëniet ekonomike

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat e tij kushtetuese janë cenuar me Vendimin e Qeverisë së Kosovës (111/279), të 7 nëntorit 2007, me të cilin përcaktohet së Bashkësia Islame e Kosovës është i vetmi institucion legjitim për të organizuar shkuarjen në haxh për qytetarët e Kosovës. Parashtruesi konsideron se, duke qenë pronar i një agjencie turistike të licencuar, i janë cenuar të drejtat e tij për të ushtruar aktivitet ekonomik, që parashihen me nenin 10 dhe 109 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte e papranueshme bazuar në Rregullin 56.2 të Rregullores së Punës për shkak se parashtruesi nuk kishte dorëzuar ndonjë provë *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave kushtetuese. Gjykata vendimin e saj e arsyetoi duke theksuar se vendimi i kontestuar i Qeverisë ishte marrë më 7 nëntor 2007, domethënë para hyrjes në fuqi të Kushtetutës (15 qershor 2008). Rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të trajtojë kërkesat që kanë të bëjnë me ngjarjet që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Kështu që, Gjykata konkludoi se kërkesa ishte e papranueshme për arsye se ishte *ratione temporis* në papajtueshmëri me Kushtetutën.

Prishtinë, 26 qershor 2012

Nr.Ref.:RK259/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Në

Rastin Nr. KI 152/11

Parashtruesi

Bekim Murati

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Kosovës

(11/279), të 07.11.2007

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan Gjyqtar

Altay Suroy, Gjyqtar

Almiro Rodrigues, Gjyqtar

Snezhana Botusharova, Gjyqtare

Ivan Čukalović, Gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, Gjyqtare dhe

Iliriana Islami, Gjyqtare

Parashtruesi i Kërkesës

1. Parashtruesi i Kërkesës është Bekim Murati nga Prishtina, i përfaqësuar nga Bajram Morina, avokat nga Gjakova.

Objekti i çështjes

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Qeverisë së Kosovës 11/279, të datës 06/11/2007 (në tekstin e mëtejmë: Vendimi).

Baza juridike

3. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) , nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 30 e 75 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovë (në tekstin e mëtejmë:Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

4. Më 24 nëntor 2011, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

5. Më 17 janar 2012, Kryetari emëroi gjyqtarin Almiro Rodrigues si Gjyqtar Raportues dhe Kolegjin Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Enver Hasani dhe Kadri Kryeziu.

6. Më 24 janar 2012, Gjykata ia komunikoi kërkesën Zyrës së Kryeministrit (në tekstin e mëtejmë: ZKM).

7. Më 27 shkurt 2012, Gjykata i dërgoi letër ZKM duke kërkuar informata shtesë, më saktësisht nëse Vendimi ishte ende në fuqi.

8. Më 27 shkurt 2012, Gjykata i dërgoi letër parashtruesit të kërkesës duke kërkuar informata shtesë, më saktë nëse parashtruesi i kërkesës ka marrë hapat e mëtejshëm në institucionet përgjegjëse për të kontestuar Vendimin.

9. Më 9 mars 2012, ZKM u përgjigj se "vendimi në fjalë ishte marrë duke pasur parasysh rrethanat dhe kushtet në atë kohë dhe i njëjti vendim është ende në fuqi". Përveç kësaj, ZKM informoi se "deri më tani nuk ka pranuar ndonjë ankesë lidhur me vendimin apo kërkesë për të shfuqizuar Vendimin e lartpërmendur nga palët e interesuara dhe nga Komisioni i Konkurrencës si autoritet kompetent për zbatimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për mbrojtjen e Konkurrencës (Gazeta Zyrtare Nr. 88, 25 nëntor 2010)".

10. Më 19 mars 2012, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës paraqiti informatat e kërkuara shtesë, duke sqaruar se parashtruesi i kërkesës ka kontaktuar autoritetet publike në mënyrë që të ngrejë brengat e veta lidhur me Vendimin, por ai ka marrë vetëm këshilla verbale që t'i drejtojë këtë çështje Gjykatës Kushtetuese.

11. Më 20 qershor 2012, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmeri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesi i kërkesës është pronar i agjencisë turistike "Royal Travel", e cila operon në Prishtinë dhe, më 14 janar 2011, Departamenti i Turizmit në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (në tekstin e mëtejmë: MTI) i dha agjencisë turistike "Royal Travel" "lejen për ushtrimin e veprimtarive turistike për një periudhë tri vjeçare si: **Agjenci Turistike-Organizatore".**

13. Sidoqoftë, më 7 nëntor 2007, Qeveria e Kosovës mori Vendim, përmes të cilit përcaktohet se "Bashkësia Islame e Kosovës është i vetmi institucion legjitim për të organizuar shkuarjen në haxhillëk për qytetarët e Kosovës".

14. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i Qeverisë së Kosovës shkel nenin 119.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), ku përcaktohet se "Veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj". Parashtruesi i kërkesës pohon se atij i ishte shkelur "e drejta themelore për punë, e garantuar me nenin 49.1 të Kushtetutës së Kosovës".

15. Me pak fjalë, parashtruesi i kërkesës ankohet se Vendimi shkel nenin 10 [Ekonomia] dhe nenin 119.3 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit IX [Marrëdhëniet Ekonomike] të Kushtetutës, pasi që ai krijon pozitë dominuese për Bashkësinë Islame si të vetmin institucion legjitim për organizimin e Haxhillëkut për qytetarët e Kosovës.

16. Parashtruesi i kërkesës përfundon duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) "të

anulojë Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr. 11/279, të datës 7 nëntor 2007".

Vlerësim paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

17. Para së gjithash, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës e ka justifikuar kërkesën me fakte relevante dhe referim të qartë të shkeljeve të pretenduara; shprehimisht konteston Vendimin si akt konkret i autoriteteve dhe objekt shqyrtimi; qartë tregon ndihmën e kërkuar, qartazi thekson ndihmën që kërkon; dhe bashkangjet vendime të ndryshme si dhe informata e dokumente mbështetëse.

18. Sidoqoftë, me rastin e vlerësimit të kushtit të afateve, Gjykata vëren se neni 56 (Rastet paraprake) i Ligjit parasheh:

> *"Afatet e përcaktuara në këtë ligj për fillimin e një procedure për çështjet për të cilat është kompetente Gjykata Kushtetuese dhe të cilat janë ngritur para hyrjes në fuqi të këtij ligji fillojnë të llogariten në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji".*

19. Në anën tjetër, në nenin 49 (Afatet) të Ligjit thuhet:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor".*

20. Duke pasur parasysh këto dy dispozita ligjore, mund të konkludohet se juridiksioni kohor i Gjykatës Kushtetuese për rastet e mëhershme fillon nga dita e hyrjes në fuqi të Kushtetutës, që ishte më 15 qershor 2008, dhe përfundon më 15

maj 2009, domethënë katër muaj (shih nenin 49 të Ligjit) pas hyrjes në fuqi të Ligjit, që ishte më 15 janar 2009.

21. Gjykata vëren se, në këtë rast, Vendimi ishte marrë më 7 nëntor 2007,domethënë, para hyrjes në fuqi të Kushtetutës më 15 qershor 2008. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij më 24 nëntor 2011.

22. Për më tepër, Gjykata vëren se agjencisë turistike "Royal Travel" i ishte dhënë "leja për ushtrimin e veprimtarive turistike (...) si: Agjenci Turistike-Organizatore" më 14 janar 2011. Vendimi ishte në fuqi që nga 7 nëntori 2007.

23. Rrjedhimisht, Vendimi ishte marrë para 15 qershorit 2008, data kur hyri në fuqi Kushtetuta. Gjykata nuk mund të merret me kërkesën që ka të bëjë me ngjarjet që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës (shih, Aktvendimi i Gjykatës për papranueshmërinë në rastin Nr. 18/10, Denic et al të datës 17 gusht 2011).

24. Gjykata po ashtu rikujton se ZKM ka informuar se "deri më tani nuk kanë pranuar asnjë ankesë lidhur me atë vendim ose kërkesës për të shfuqizuar Vendimin e lartpërmendur nga palët e interesuara".

25. Për më tepër, rregulli 36 (3) h) i Rregullores parasheh se *"Një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese"* kur *"kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën"*. Kështu që, Gjykata konsideron se kërkesa është paafatshme "*ratione temporis*".

26. Kështuqë, Gjykata konkludon se kërkesa është e paafatshme dhe kështu "*ratione temporis*" në mospajtim me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 20 qershor 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim to ti komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në përputhje me nenin 20 (4) të Ligjit;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Prof. Dr. Enver Hasani

KI 156/11 datë 10 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 378/09, të 1 tetorit 2009, dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 509/2009, të 5 gushtit 2011

Rasti KI 156/11, vendim i 26 qershorit 2012.

Fjalët kyçe: alimentacion, cenim i të drejtave dhe lirive kushtetuese, kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, ligji për familjen, kodi i përkohshëm penal i Kosovës.

Parashtruesja paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat dhe liritë e saj kushtetuese janë cenuar me aktgjykimet e gjykatave të të gjitha shkallëve lidhur me të drejtën e parashtrueses për të marrë alimentacion nga babai i fëmijës së saj të mitur. Parashtruesja pohoi se të drejtat dhe liritë e saj kushtetuese ishin cenuar pa përmendur ndonjë dispozitë kushtetuese në veçanti.Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtrueses ishte e papranueshme bazuar në Rregullin 56.2 të Rregullores së Punës për shkak se parashtruesja nuk ka provuar si dhe pse gjykatat, në të gjitha shkallët, i kanë cenuar të drejtat e saj kushtetuese. Duke cituar praktikën e saj gjyqësore në rastin *Nr. KI. 06/09, Parashtruesi X kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, nr. 215/2006; Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, nr. 741/2005; Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, nr. 217/2004,* Gjykata më tutje përsëriti se roli i saj është vetëm të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si gjykatën e shkallës së katërt. Gjykata po ashtu konstatoi se gjykatat e rregullta kishin arsyetuar vendimet e tyre duke dhënë sqarime pse ishin mbështetur në prova të caktuara. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtrueses si të papranueshme.

Prishtinë,më 26 qershor 2012

Nr. ref.: RK260/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rasti Nr. KI 156/11

Parashtruesi

Zahide Samadraxha

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 378/09, të 1 tetorit 2009, dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 509/2009, të 5 gushtit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almira Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Cukalovic, gjyqtar

Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është Zahide Samadraxha nga fshati Banjë i komunës së Malishevës. Nuk është e përfaqësuar.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 378/09, të 1 tetorit 2009, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 509/2009, të 5 gushtit 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës ka të bëjë me kërkesën e parashtrueses për të marrë alimentacion nga babai i fëmijës së saj të mitur. Parashtruesja nuk ishte e martuar me babanë e fëmijës së saj të mitur dhe fëmija i saj jeton me babanë.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 2 dhjetor 2011.

6. Më 17 janar 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues. Po të njëjtën ditë, Kryetari e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

7. Me anë të shkresës së 20 shkurtit 2012, Gjykata bëri të ditur për pranimin e kërkesës dhe kërkoi informata shtesë nga parashtruesja lidhur me kërkesën.

8. Parashtruesja u përgjigj më 27 shkurt 2012. Gjykata e mori këtë përgjigje më 1 mars 2012. Parashtruesja theksoi në përgjigjen e saj se nuk ishte e punësuar dhe nuk merrte asnjë ndihmë financiare nga babai i fëmijës së saj të mitur. Ajo gjithashtu pohoi se rrethanat familjare dhe financiare të babait ishin të mira, se bashkërisht posedonte disa ngastra kadastrale, se nëna e tij gëzon pension nga jashtë dhe se vëllezërit e tij jetojnë dhe punojnë në Itali.

9. Më 18 qershor 2012, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e përgatitur nga Gjyqtari Raportues dhe, po atë ditë, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përshkrimi i fakteve të rastit të evidentuara nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesja

10. Më 17 qershor 2009, Gjykata Komunale në Malishevë, me Aktgjykimin C. nr. 269/2006, e refuzoi kërkesëpadinë e parashtrueses për alimentacion nga babai i fëmijës së saj të mitur dhe aprovoi kontaktin me fëmijën e saj të mitur një ditë në muaj. Gjykata konstatoi se fëmija i mitur tani ishte pjesë e bashkësisë familjare me babanë, bashkëshorten e tij dhe dy djemtë e tij.

11. Parashtruesja ushtroi ankesë kundër atij vendimi në Gjykatën e Qarkut në Prizren, e cila, në Aktgjykimin e vet Ac. nr. 378/09, të 1 tetorit 2009, e vërtetoi vendimin e Gjykatës Komunale. Gjykata e Qarkut theksoi se kërkesëpadia në lidhje me kontaktin ndërmjet parashtrueses dhe fëmijës së saj të mitur ishte tërhequr.

12. Parashtruesja ushtroi edhe një ankesë kundër atij vendimi në Gjykatën Supreme, e cila në Vendimin Rev. nr. 509/2009, të 5 gushtit 2011, i aprovoi vendimet e mëparshme me të cilat parashtrueses i refuzohej alimentacioni. Ky vendim iu dorëzua më 13 shtator 2011.

Shkeljet e supozuara të Kushtetutës

13. Parashtruesja pohon që, në përgjithësi, gjykatat, në çdo shkallë, e kanë shkelur Ligjin për familjen të Kosovës, Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës dhe garancitë kushtetuese. Kërkesa nuk hyn në detaje më të mëdha.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

14. Për të gjykuar për kërkesën e parashtrueses, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, të specifikuara më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës.

15. Neni 113, paragrafët 1 dhe 7, i Kushtetutës përcakton kornizën e përgjithshme ligjore që kërkohet për pranueshmëri. Ai përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *(...)*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

16. Përveç kësaj, neni 48 i Ligjit thotë:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*

17. Së fundi, rregulli 36 i Rregullores së punës thotë:

"1. Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

c) kërkesa është qartazi e bazuar.

2. Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

c) Gjykata gjen se parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të së drejtave të garantuara me Kushtetutë, ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

18. Parashtruesja pohon që gjykatat, në të gjitha shkallët, kanë bërë shkelje të ndryshme. Në aktgjykimet e veta, gjykatat u referohen numrave ose neneve përkatëse të Ligjit për familjen të Kosovës, Ligji Nr. 2004/32, më përkatëset nga to ishin:

Neni 279. Gjendja e nevojshme (skamja)

Vetëm personat të cilët financiarisht nuk munden të mbajnë vetën janë të pranueshëm për mbajtje financiare.

Neni 281. Detyrimet për njoftim të ndërsjellë për gjendjen financiare

(1) Të afërmit në vijë të drejtë janë të detyruar, në bazë të kërkesës t'i paraqesin njëri tjetrit të hyrat dhe gjendjen financiare.

(2) Në bazë të kërkesës, personi i cili është i detyruar të jap mbajtje, do të paraqesë dëshmi me shkrim dhe dokumente për të dëshmuar të ardhurat e tij dhe gjendjen financiare.

Neni 307. Mundësia për të dhënë ushqimi

(1) Personat të cilët duke marrë parasysh të gjitha detyrimet tjera nuk janë në gjendje të japin ushqimi pa rrezikuar mbajtjen e tyre të arsyeshme, nuk janë të detyruar të japin mbajtjen.

(2) Detyrimi mbetet për aq sa ata janë në gjendje të sigurojnë ushqimi.

Neni 330. Parimet e përcaktimit të mbajtjes dhe alimentacionit

(1) Detyrimi për të dhënë mbajtje financiare ose alimentacion përcaktohet në proporcion me të gjitha mjetet e të paditurit dhe brenda kufijve të nevojave të paditësit.

(2) Gjykata duhet të ketë parasysh gjendjen financiare të të paditurit, aftësinë për të punuar, mundësinë faktike për punësim, kushtet shëndetësore, nevojat personale, detyrimet ligjore dhe të gjitha kushtet tjera relevante.

(3) Kur alimentacioni kërkohet për fëmiun, gjykata merr parasysh moshën e fëmiut dhe të gjitha nevojat për edukim dhe arsimimin.

19. Në vendimin e 17 qershorit 2009 të Gjykatës Komunale, Gjykata ofroi një gjykim të arsyetuar pse ishte mbështetur në prova të caktuara për të arritur në vendimin e vet, duke përfshirë, por jo të kufizuar në, rrethanat aktuale të familjes së fëmijës së mitur dhe të ardhurat e babait.

20. Siç është thënë nga Gjykata Kushtetuese në Rastin Nr. KI. 06/09, Parashtruesi X kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, nr. 215/2006; Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, nr. 741/2005; Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, nr. 217/2004:

"...Gjykata dëshiron të theksojë se nuk është gjykatë e apelit për gjykatat e tjera në Kosovë dhe se nuk mund të ndërhyjë mbi bazën se gjykatat e tilla kanë marrë vendim të gabuar ose kanë bërë vlerësim të gabuar të fakteve. Roli i Gjykatës është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si gjykatë "e shkallës së

katërt" (shih, mutatis mutandis, ndër të tjera, Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R. J. D, 1996-IV, para. 65).

21. Siç është thënë më tej nga Gjykata Kushtetuese në Rastin Nr. KI. 06/09, Parashtruesi X kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, nr. 215/2006; Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, nr. 741/2005; Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, nr. 217/2004:

"Fakti i thjeshtë që parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih, mutatis mutandis, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, Kërkesa Nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005)."

22. Parashtruesja nuk ka treguar si dhe pse gjykatat, në të gjitha shkallët, ia kanë shkelur të drejtat e saj kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, pas shqyrtimit të kërkesës, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullin 56.2 të Rregullores së Punës, më 18 qershor 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'i komunikohet parashtrueses së kërkesës; dhe

III. Do të botohet në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar Raportues	**Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 08/12 datë 10 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 1107/2010, të 28 qershorit 2011

Rasti KI 08/2012, vendimi i datës 20 qershor 2012
Fjalët kyçe:Kontest pronësor, kërkesa individuale, kërkesa qartazi e pabazuar

Parashtruesi e kishte dorëzuar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke pretenduar se Gjykata e Qarkut në Prishtinë, duke ia hedhur poshtë kërkesën për përsëritje të procedurës, ia kishte shkelur të drejtat e tij Kushtetuese te garantuara me Nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], Nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], Nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], Nenin 54 [E Drejta për Mbrojtje Gjyqësore], si dhe Nenin 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në këtë rast Gjykata, i është referuar nenin 48 qe përcakton se "parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar. Gjithashtu, ishte thirrur në rregullin 36 i Rregullores së punës që përcakton se "Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

Gjykata konstatoi se, parashtruesi nuk i kishte mbështetur pretendimet e tij në baza kushtetuese, duke treguar pse dhe si Gjykata e Qarkut ia ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane dhe nuk ka ofruar prova që të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga Gjykata e Qarkut. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk ka mundur te gjej pse dhe si procedurat përkatëse në Gjykatën e Qarkut ishin në ndonjë mënyrë të padrejta

apo arbitrare dhe për këtë fakt Gjykata ka përmendur rastin *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06 i 30 qershorit 2009. Si përfundim Gjykata gjen se kërkesa nuk i përmbushte kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe të rregullit 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së punës, prandaj, si e tillë, kërkesa është konsideruar si qartazi e pabazuar.

Prishtinë, më 26 qershor 2012

Nr.Ref.:RK256/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Rasti Nr. KI 08/12

Parashtrues

Nexhat Shala

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 1107/2010, të 28 qershorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Cukalovic, gjyqtar

Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Pareshtruesi i Kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Nexhat Shala (parashtruesi) me vendbanim në Barilevë, komuna e Prishtinës, i përfaqësuar nga Hasan Rexha, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 1107/2010, të 28 qershorit 2011, të cilin e ka pranuar me 7 korrik 2011 dhe me të cilin u vendos t'i refuzohej kërkesa e tij për përsëritje të procedurës në gjykatën e shkallës së parë.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës ka të bëjë me shkeljet e pretenduara të të drejtave në pronë, të garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe patundshmërinë kontestuese (banesën).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në gjykatë

5. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) më 9 nëntor 2011.

6. Më 11 nëntor 2011, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi informata shtesë për shterimin e mjeteve juridike.

7. Më 13 janar 2012, Gjykata sërish kërkoi nga parashtruesi ta kompletonte kërkesën dhe ta dorëzonte vendimin përfundimtar për çështjen e tij.

8. Më 30 janar 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën e kompletuar së bashku me dokumentacionin e kërkuar nga Gjykata.

9. Më 1 mars 2012, Kryetari, me Vendimin nr. GJR 08/12, caktoi gjyqtarin Almiro Rodriguez Gjyqtar raportues dhe me Vendimin nr. KSH 08/12 caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Mr. sc. Kadri Kryeziu (anëtar) dhe Prof. Dr. Enver Hasani (anëtar).

10. Më 20 qershor 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

11. Në qershor të vitit 2005, parashtruesi i kërkesës kishte lidhur kontratë me Ali Gashin për blerjen e banesës 85.13 m^2, që gjendet në rrugën "Gjergj Fishta" në Lipjan. Kontrata e shitblerjes është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Lipjan më 9 shtator 2005. Më 14 qershor 2005, Ali Gashi (shitësi) ia shiti Rasim Shabanit (blerësi) të njëjtën patundshmëri. Pasi objekti i shqyrtimit në këto dy kontrata kishte të bënte me patundshmërinë e njëjtë, kjo rezultoi në kontest ligjor. Si rrjedhojë, u zhvilluan procedura të ndryshme civile dhe penale në mënyrë që palët e interesuara t'i siguronin të drejtat e tyre.

12. Në të vërtetë, më 6 shtator 2006, Gjykata Komunale në Lipjan (Aktgjykimi C. nr. 248/06) ia njohu Rasim Shabanit të drejtën e pronësisë së banesës. Parashtruesi ushtroi ankesë kundër këtij aktvendimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë. Më 12 shkurt 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, (Aktgjykimi Ac. nr.

971/2006) e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Lipjan.

13. Më 13 shkurt 2007, parashtruesi ushtroi kërkesë në Gjykatën Komunale në Lipjan për përsëritje të procedurës për lëndën C. nr. 248/2006, të 6 gushtit 2006, duke kërkuar përjashtimin e gjyqtarit që kishte vendosur në shkallë të parë. Më 28 tetor 2010, Gjykata Komunale në Lipjan (Aktvendimi C. nr. 216/2010) e hodhi poshtë si të papranueshme kërkesën e parashtruesit sepse Aktgjykimi C. nr. 248/2006, i 6 gushtit 2006, u bë i plotfuqishëm dhe nuk ishte i bazuar në dëshmi të rreme. Parashtruesi ushtroi ankesë kundër këtij aktvendimi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

14. Më 28 qershor 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktvendimi Ac. nr. 1107/2010) e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar për shkak se aktvendimi i ankimuar (C. nr. 216/2010) nuk përmbante shkelje thelbësore që do të ndikonin në ligjshmërinë e vendimit të ankimuar.

15. Më 26 gusht 2011, parashtruesi paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Prokurorinë e Shtetit në Prishtinë kundër Aktvendimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Lipjan, C. nr. 216/2010. Më 9 shtator 2011, Prokuroria e Shtetit e njoftoi parashtruesin se kërkesa e tij për mbrojtje të ligjshmërisë ishte refuzuar për shkak se nuk ishte gjetur asnjë bazë ligjore për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon që i janë shkelur të drejtat e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për mjete juridike.

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Gjykata e Qarkut në Prishtinë, duke ia hedhur poshtë kërkesën për përsëritje të procedurës, ia ka shkelur të drejtat e tij të përcaktuara në dispozitat Kushtetuese në vijim:Neni 21 [Parimet e Përgjithshme], Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike], Neni 54 [E Drejta për Mbrojtje Gjyqësore], si dhe Nenin 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

18. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese, ndër të tjera, anulimin e Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Lipjan, C. nr. 216/2010, të 28 tetorit 2010, dhe Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 1107/2010, të 28 qershorit 2010.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

19. Së pari, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës. Gjykata konsideron që parashtruesi e ka arsyetuar kërkesën me një përmendje të qartë të shkeljeve të supozuara; ai posaçërisht konteston vendimin e Gjykatës së Qarkut si aktin konkret të organit publik që është objekt i shqyrtimit; qartazi tregon se çfarë dëshiron të arrijë; dhe bashkëngjit vendime të ndryshme dhe informata e dokumente të tjera mbështetëse.

20. Megjithatë, me rastrin e shqyrtimit të mbështetjes me prova të kriterit të kërkesës, Gjykata vëren që neni 48 përcakton që *"parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të*

qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar".

21. Në anën tjetër, rregulli 36 i Rregullores së punës përcakton që *"Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

22. Së fundi, neni 46 i Ligjit përcakton që *"Gjykata Kushtetuese pranon dhe procedon kërkesën (...) nëse konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore".*

23. Gjykata vëren që vlerësimi i ligjshmërisë së kontratave është kompetencë e gjykatave të rregullta. Rasti duhet të ndërtohet në baza kushtetuese në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të ndërhyjë.

24. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk tregon pse dhe si Gjykata e Qarkut ia ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane as nuk ofron prova për shkeljen e supozuar.

25. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me lajthitjet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) gjoja të kryera nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, përveç nëse dhe për aq sa ato mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Prandaj, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së tretë në këtë rast. Është detyrë dhe obligim i gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz

kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

26. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).

27. Në të vërtetë, parashtruesi nuk i ka mbështetur pretendimet e tij në baza kushtetuese, duke treguar pse dhe si Gjykata e Qarkut ia ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane dhe nuk ka ofruar prova që të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga Gjykata e Qarkut. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të gjejë pse dhe si procedurat përkatëse në Gjykatën e Qarkut ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

28. Nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata gjen që kërkesa nuk i përmbush kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe të rregullit 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së punës, prandaj, si e tillë, është qartazi e pabazuar dhe, në pajtim me nenin 46 të Ligjit, nuk mund të pranohet dhe procedohet.

29. Rrjedhimisht, në pajtim ne nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56.2 të Rregullores së Punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 46 të Ligjit, rregullin 36.2 (b) dhe (d), rregullin 56.2 të Rregullores së punës, më 20 qershor 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodriguez Prof. Dr. Enver Hasani

KI 19/12 datë 10 korrik 2012- Kërkesë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtine AC.nr. 1496/2011 të 24 janarit 2012

Rasti KI 19/2012, vendimi i datës 3 korrik 2012
Fjalët kyçe:Kontest pronësor, Patandeshmeri (hipotekë), kërkesa individuale, palë e paautorizuar, kërkesa qartazi e pabazuar

Parashtruesi e kishte dorëzuar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke pretenduar se me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AC. nr. 1496/2011 të 24 janar 2012, i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
Gjykata, ka vërejtur që parashtruesi i kësaj kërkese, z. Naser Peci, ishte në fakt përfaqësuesi i përkohshëm i të ndjerit Murat Plakolli, debitori-garantuesi i pronës së lënë në hipotekë. Ky Përfaqësues i përkohshëm ishte caktuar me Vendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë E.nr.1168/10 më 21 korrik 2011, për ta përfaqësuar përkohësisht të ndjerin (hipotekëlënesin) në çështjen juridike të iniciuar nga kreditori "Pro Credit Bank". Në kete rast Gjykata kishte konkluduar se parashtrimi i kërkesës nuk ishte në pajtueshmëri me nenin 113 të Kushtetutës pasi që ai ka dështuar të provojë se ende është palë e autorizuar për qëllime të parashtrimit të kësaj kërkese. Gjykata në këtë rast i është referuar edhe rregullit 36.1 c) të Rregullores së punës qe përcakton se Kërkesa duhet te jete qartazi e bazuar në mënyrë qe e njëjta të ndërhyjë ne rast.
Gjykata, lidhur me pretendimin e përfaqësuesit, kishte theksuar se, nuk është i mjaftueshëm arsyetimi i shkeljes së të drejtës së garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], për faktin që të njëjtit nga Gjykata Komunale në Prishtinë, i është refuzuar e drejta në ankesë për caktimin e tij si përfaqësues të përkohshëm i debitorit-garantuesit, tani të ndjerit Murat Plakolli, titullar i pronës së lënë në hipotekë. Gjykata me tutje ka rikujtuar se nuk është Gjykatë e verifikimit të fakteve, Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë

pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente tjera ligjore, prandaj, nuk mund të veproje si "gjykate e shkallës së katërt" dhe i është referuar rastit *Akdivar kunder Turqise* të 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65. Në fund Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit nuk ishte në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 113 të Kushtetutës, si dhe kërkesat e parapara me rregullin 36.2 (c) të rregullores së punës.

Prishtinë, më 26 qershor 2012

Nr.Ref.:RK257/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 19/12

Parashtruesi

Naser Peci, avokat i cili e përfaqëson të ndjerin Murat Plakolli

Kërkesë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtine AC.nr. 1496/2011 të 24 janarit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Cukalovic, gjyqtar

Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i Kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Naser Peci, avokat nga Prishtina i cili e përfaqëson përkohësisht të ndjerin Murat Plakolli.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik është Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AC.nr. 1496/2011 i 24 janarit

2012, i cili i është dorëzuar parashtruesit te kërkesës me datë 22 shkurt 2012.

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) është vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktvendimi i Gjykatës se Qarkut ne Prishtine AC.nr. 1496/2011 i 24 janarit 2012, lidhur me patundshmërinë e lënë në hipotekë nga i ndjeri Murat Plakolli.

4. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të mos i zbulohet identiteti.

Shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë

5. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AC. nr. 1496/2011 i datës 24 janar 2012, i janë shkelur të drejtat e garantuara me Nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

Baza juridike

6. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregullit 28 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 28 shkurt 2012, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë, dhe e njëjta u regjistrua me nr. KI 19/12.

8. Më 29 shkurt 2012, Kryetari, me vendimin GJR. KI 19/12 caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë Kryetrari me vendimin KSH. KI 19/12 caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtareve: 1. Altay Suroy (kryesues), 2. Dr. Gjyljeta Mushkolaj (anëtare) dhe 3. Dr. Iliriana Islami (anëtare).

9. Më 13 mars 2012, Gjykata kërkoi nga përfaqësuesi i përkohshëm i të ndjerit që të dorëzojë në Gjykatë autorizimin nga trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit Murat Plakolli, që do të provonte se i njëjti është i autorizuar për përfaqësim të kësaj çështje në Gjykatë.

10. Më 19 mars 2012 Gjykata, njoftoi Gjykatën e Qarkut në Prishtinë për regjistrimin të kërkesës.

11. Më 20 mars 2012, përfaqësuesi i përkohshëm i të ndjerit, i është përgjigjur kërkesës së gjykatës dhe ka pohuar që i njëjti ishte caktuar me aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtine E.nr 1168/10 të 19 korrikut 2011. Për caktimin e tij gjykata është mbështetur në nenin 36.4 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), nenin 82 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK). Përfaqësuesi i të ndjerit mendon se, ky ligj aplikohet edhe për çështjet tjera që nuk i rregullon (LPP), ndër të tjera në përgjigjen e tij thuhet: *Unë mbi bazën e aktvendimit të Gjykatës e kam për obligim që të ndjerin Murat Plakolli ta përfaqësoi lidhur me çështjen, derisa gjykatës nuk i paraqiten trashëgimtaret e të ndjerit personalisht apo i autorizuari i tyre*

me prokure, gjegjësisht deri sa organi i kujdestarisë nuk cakton kujdestarin sipas kërkesës se gjykatës.

12. Më 20 qershor 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 21 korrik 2011 Gjykata Komunale në Prishtinë në bazë të Konkluzionit mbi Shitjen me nr. E. nr. 1168/10, përmes ankandit të dytë publik, caktoi shitjen e patundshmërisë së të ndjerit, (debitori-garantuesi) e regjistruar në fletën poseduese UL-71914059, e evidentuar si ngastër kadastrale me nr. 1994-0, sipas kulturës shtëpi dhe oborr, në vendin e quajtur Kolonia e re ZK Prishtinë, në sipërfaqe prej 224 m2.

14. Më 21 korrik 2011 Gjykata Komunale në Prishtinë, nxori Aktvendimin E.nr.1168/10 me ç'rast miratoi propozimin e paditësit (Pro Credit Bank), për caktimin e një përfaqësuesi të përkohshëm që ta përfaqësonte z. Murat Plakolli, pasi që i njëjti kishte vdekur më 2 prill 2010. Gjykata, më pas, si përfaqësues të përkohshëm e kishte caktuar z. Naser Peci, përderisa trashëgimtarët e të ndjerit apo i autorizuari i tij të paraqiteshin në Gjykatë, e që më pas i njëjti do t'i ketë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përfaqësuesit ligjorë. Ndaj këtij Aktvendimi Gjykata nuk ka lejuar të ushtrohet e drejta për ankesë.

15. Më 8 gusht 2011 përfaqësuesi i përkohshëm z. Naser Peci, dorëzoi një parashtresë në Gjykatën Komunale në Prishtinë, ku kishte kërkuar që Gjykata Komunale të vlerësojë edhe një herë Akvendimin E.nr.1168/10 të 21 korrikut 2011, lidhur me caktimin e tij si përfaqësues i përkohshëm në këtë çështje juridike, për faktin se, siç pohon i njëjti në parashtresën e tij:

"dispozita e nenit 36 paragrafi 4 i LPP saktëson se, debitorit i caktohet përfaqësuesi i përkohshëm vetëm në rastin kur nuk ka përfaqësues të autorizuar apo "përfaqësues ligjor", edhe radha e caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm është saktësuar, pra nga radha e personave që janë në posedim të pronës.

16. Më 12 shtator 2011 Gjykata Komunale në Prishtinë në bazë të Konkluzionit E.nr.1168/10 për Shitjen e patundshmërisë nr. UL-71914059-04949, pronë e debitorit garantuesit Murat Plakolli (hipotekëlënës), përcaktoi se kreditori Pro Credit Bank, si blerës, ishte ofertuesi më i volitshëm që ka ofruar çmimin më të lartë të blerjes së patundshmërisë në fjalë.

17. Më 6 tetor 2011 Gjykata Komunale në Prishtinë , nxori Aktvendimin E.nr.1168/10 me ç'rast konstaton se, patundshmëria e lënë në hipotekë nga i ndjeri, i është shitur kreditorit Pro Credit Bank, si ofertues i vetëm, me i volitshëm dhe që ka ofruar çmimin më të lartë për blerjen e kësaj pronë të paluajtshme. Debitori-garantuesi është urdhëruar që brenda afatit prej 7 ditësh t'ia dorëzonte blerësit, kreditorit Pro Credit Bank, në posedim pronën lënë në hipotekë.

18. Më 5 dhjetor 2011 përfaqësuesi i përkohshëm i të ndjerit, së bashku me debitorin tjetër z. Afrim Kalaja, përfaqësues i N.T.P. "Ideal" nga Prishtina, kishin parashtruar Ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale E. Nr. 1168/10 të 6 tetorit 2011 dhe kanë kërkuar anulimin e këtij vendimi për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave të procedurës përmbarimore.

19. Më 24 janar 2012 Gjykata e Qarkut në Prishtinë, nxori Aktvendimin Ac.nr.1496/2011 me ç'rast refuzoi si të pa bazë ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i përkohshëm i parashtruesit të kërkesës, vërteton Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë E.nr.1168/2010 i 6 tetorit 2011. Kjo

gjykatë kishte konstatuar se nuk ka gjetur shkelje te procedurës përmbarimore, siç është pretenduar nga debitori, me arsyetimin që, çmimi përfundimtar i objektit të përmbarimit, pas dy shitjeve të pa suksesshme, është caktuar në kuptim të nenit 203 paragrafi 5 të Ligjit mbi procedurën përmbarimore.

20. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar prova mbështetëse që do ta arsyetonte kërkesën e tij për mos-zbulim të identitetit.

Pretendimet e parashtruesit

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AC.nr. 1496/2011 të 24 janar 2012, i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Gjykata, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregulloren e punës së Gjykatës.

23. Lidhur më këtë, Gjykata i referohet nenit 113 të Kushtetutës që parasheh:

Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".

24. Gjykata, ka vërejtur që parashtruesi i kësaj kërkese, z. Naser Peci, është në fakt përfaqësuesi i përkohshëm i të ndjerit Murat Plakolli, debitori-garantuesi i pronës së lënë në hipotekë. Përfaqësuesi i përkohshëm ishte caktuar me Vendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë E.nr.1168/10, më 21 korrik 2011, që ta përfaqësonte përkohësisht të ndjerin (hipotekëlënesi) në çështjen juridike të iniciuar nga kreditori "Pro Credit Bank".

25. Duke u përgjigjur në shkresën e Gjykatës të 13 marsit 2012, parashtruesi i kërkesës ka dështuar të përgjigjet nëse trashëgimtarët e Murat Plakollit apo përfaqësuesit e tyre të autorizuar ishin paraqitur në Gjykatën Komunale në Prishtinë në mbrojtje të pretendimit për pronën e tij të paluajtshme. Prandaj, duket se përfaqësuesi i përkohshëm i parashtruesit të kërkesës, të ndjerit Murat Plakolli, nuk ka provuar se gëzon të drejtën e përfaqësimit ligjor në këtë çështje, duke qenë se procedura e caktimit te trashëgimisë është e rregulluar me ligj të veçantë. Parashtruesi i kërkesës e bart barrën e të provuarit se ai apo ajo është palë e autorizuar. Në këtë kontest gjykata konsideron se i njëjti nuk mund ta përfaqësojë pronën e të ndjerit, z. Murat Plakolli, pasi që nuk ka dorëzuar në gjykatë autorizim nga radhët e trashëgimtareve ligjorë të të ndjerit Murat Plakolli apo nuk ka provuar se trashëgimtarët ligjorë nuk janë paraqitur në gjykatë në emër të pronës së Murat Plakollit.

26. Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata, konkludon që parashtrimi i kërkesës nuk është në pajtueshmëri me nenin 113 të Kushtetutës pasi që ai ka dështuar të provojë se ende është palë e autorizuar për qëllime të parashtrimit të kësaj kërkese.

27. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse kërkesa është qartazi e bazuar dhe nëse faktet e prezantuara paraqesin bazë kushtetuese, në mënyrë që Gjykata të lëshohet me tutje në meritat e rastit.

28. Lidhur më këtë, Gjykata i referohet rregullit 36 te Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetutës që përcakton se:

> "*Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
> *c) Kërkesa është qartazi e bazuar:*

29. Neni 46 i Kushtetutës parashikon që:

> *1. E drejta e pronës është e garantuar.*
>
> *2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
>
> *3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.*
>
> *4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykatakompetente.*

30. Më 12 shtator 2011 Gjykata Komunale në Prishtinë në bazë të Konkluzionit E.nr.1168/10 për Shitjen e patundshmërisë nr. UL-71914059-04949, pronë e debitorit garantuesit Murat Plakolli (hipotekëlënës), përcaktoi se kreditori Pro Credit Bank, si blerës, ishte ofertuesi më i volitshëm që ka ofruar çmimin më të lartë të blerjes së patundshmërisë në fjalë.

31. Më 6 tetor 2011 Gjykata Komunale në Prishtinë , nxori Aktvendimin E.nr.1168/10 me ç'rast konstaton se, patundshmëria e lënë në hipotekë nga i ndjeri, i është shitur kreditorit Pro Credit Bank, si ofertues i vetëm, më i volitshëm dhe që ka ofruar çmimin më të lartë për blerjen e kësaj pronë të paluajtshme. Debitori-garantuesi është urdhëruar që brenda afatit prej 7 ditësh t'ia dorëzonte blerësit, kreditorit Pro Credit Bank, në posedim pronën lënë në hipotekë.

32. Duket se parashtruesi i kërkesës është i pakënaqur me gjetjet e fakteve dhe konkludimet e ligjit që i nxori Gjykata Komunale në rastin e tij por nuk është në gjendje të demonstrojë se si këto gjetje apo konkluzione mund t'i kenë cenuar të drejtat e tij kushtetuese.

33. Gjykata, lidhur me pretendimin e përfaqësuesit, thekson se, nuk është i mjaftueshëm arsyetimi i shkeljes së të drejtës së garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], për faktin që të njëjtit nga Gjykata Komunale në Prishtinë, i është refuzuar e drejta në ankesë për caktimin e tij si përfaqësues të përkohshëm i debitorit-garantuesit, tani të ndjerit Murat Plakolli, titullar i pronës së lënë në hipotekë.

34. Gjykata Kushtetuese, nuk është Gjykatë e verifikimit të fakteve, Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente tjera ligjore, prandaj, nuk mund të veproje si "gjykate e shkallës së katërt", (shih, *mutatis mutandis,* i.a., Akdivar kunder Turqise, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).

35. Është detyre dhe obligim i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I). Duket se Gjykata Komunale në Prishtinë e ka kryer këtë funksion në këtë rast.

36. Gjykata Kushtetuese, nga shkresat e lëndës vëren se parashtruesi i kërkesës ka dështuar së provuari që të drejtat e tij të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës i janë shkelur, sepse faktet dhe argumentet e ofruara nga i njëjti nuk paraqesin bazë Kushtetuese të ndonjë shkeljeje procedurale të ecurisë së procesit gjyqësor në gjykatat e rregullta. Kontesti i tij pronësor është zgjidhur nga ana e një gjykate kompetente dhe nuk ka prova se ai apo personat për të cilët ai pretendon se i përfaqëson janë privuar në mënyrë arbitrare nga të drejtat e tyre pronësore.

37. Vërtet palët duhet të argumentojnë me prova, që me vendimet gjyqësore a te autoriteteve publike u janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë dhe Instrumente ndërkombëtare që drejtpërdrejt janë të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Nëse parashtruesi nuk arrin që t'i mbështesë pretendimet e shkeljeve të garantuara me Kushtetutë, nuk është obligim i Gjykatës që të ndërtojë rastin e tij/saj. Andaj, në këtë kontest gjykata kërkesën e parashtruar do ta konsiderojë si qartazi të pabazuar.

38. Është detyrë dhe obligim i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

39. Ndërsa, sa i përket kërkesës për mbrojtjen e identitetit, përfaqësuesi nuk ka ofruar asnjë provë qe do të vërtetonte se

bërja publike e identitetit të tij paraqet ndonjë dem për të njëjtin, prandaj, Gjykata nuk ka gjetur bazë ligjore për ruajtjen e identitetit të përfaqësuesit dhe të ndjerit.

40. Nga arsyet e cekura me lartë, del se kërkesa e parashtruesit nuk është në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 113 të Kushtetutës, si dhe kërkesat e parapara me rregullin 36.2 (c) të rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës, rregullin 36.2 (c) dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, më 20 qershor 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Prof. Dr. Enver Hasani

KI 06/12 datë 28 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 67/2011, të 12 dhjetorit 2011.

Rasti KI 06/12**,** aktgjykimi i 9 majit 2012
Fjalët kyçe: kërkesa individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, shkelje të të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi Z. Bajrush Gashi ka parashtruar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar aktvendimin e Gjykatës Supreme Pzd. nr. 67/2011, si të marrë me shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Parashtruesi ankohet veçanërisht që Gjyqtari që ka qenë Kryetar Kolegji në Gjykatën e Qarkut në Prizren, si dhe ka vendosur rastin e tij, ka marrë pjesë edhe në vendimin e Gjykatës Supreme në kërkesën e tij për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit (gjyqtari i njëjtë në fjalë). Për më tepër, parashtruesi pretendon që gjyqtari në fjalë është dashur ta njoftojë Gjykatën Supreme që ka qenë Kryetar Kolegji në Gjykatën Supreme në Prizren, si dhe do të duhej diskualifikuar nga pjesëmarrja në kolegjin e Gjykatës Supreme.

Sa i përket çështjes së pranueshmërisë së Kërkesës, Gjykata theksoi që në bazë të gjuhës së përdorur në nenin 113.7, kërkesa ishte e papranueshme, sepse në rastin konkret Z. Bajrush Gashi konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit Pzd. nr. 67/2011 të Gjykatës Supreme, të datës 12 dhjetor 2011. Kështu, Parashtruesi duhet konsideruar si palë e autorizuar, me të drejtë që të parashtrojë rastin në Gjykatë, si dhe të shterojë gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës. Sa i përket dispozitës së nenit 49 të Ligjit, që Parashtruesi duhet të parashtrojë Kërkesën brenda një periudhe katër (4) mujore, Gjykata gjeti nga parashtresat e Parashtruesit që Parashtruesi kishte pranuar aktvendimin e përmendur të Gjykatës Supreme në një datë të pacaktuar, derisa Parashtruesi kishte dorëzuar Kërkesën në Gjykatë më 27 janar 2012, pra brenda afatit katër mujor, siç përcaktohet me nenin 49 të Ligjit. Tutje, Parashtruesi ka theksuar në hollësi të drejtat sipas Kushtetutës dhe KEDNj-së që pretendon të jenë shkelur, si dhe autoritetet publike që i kanë cenuar ato. Kështu, Gjykata gjithashtu gjeti që Parashtruesi ka përmbushur kërkesat e nenit 48 të Ligjit.

Në lidhje me meritat e Kërkesës, Gjykata vendosi që në rrethanat e këtij rasti, paanshmëria e Gjykatës Supreme ka mundësi të vihet në dyshim, si dhe që brengat e Parashtruesit në këtë kuptim mund të konsiderohen të arsyetuara subjektivisht dhe objektivisht. Gjykata gjithashtu konsideron që çështja nëse ka pasur apo jo gjyqtarë të mjaftueshëm për të vendosur për zbutje të dënimit është çështje krejtësisht brenda juridiksionit të gjyqësorit, si dhe që mund të diskutohet, sipas nevojës, mes gjyqësorit dhe Qeverisë. Përgjegjësia kryesore për administrimin e duhur të drejtësisë i përket Qeverisë, derisa çështjet organizative nuk mund të shfrytëzohen si justifikim për mosrespektimin e Kushtetutës (shih Rastin nr. KO 4/11, Gjykata Supreme e Kosovës, kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së neneve 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr. 03/L-139, Aktgjykim i datës 1 mars 2012). Në këto rrethana, Gjykata thekson që e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nga një tribunal i pavarur, siç garantohet me nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 [E drejta për proces të rregullt gjyqësor] të KEDNJ-së, është cenuar. Në marrjen e vendimit të saj, Gjykata gjithashtu është bazuar në vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilat merren me çështjen e njëjtë apo të ngjashme. Gjykata e shpalli të pavlefshëm dhe pa efekt juridik aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, si dhe obligoi Gjykatën Supreme që të rigjykojë rastin në përputhje me aktgjykimin e kësaj Gjykate.

Prishtinë, më 27 qershor 2012

Nr. ref.:AGJ262/12

AKTGJYKIM

në

Rastin Nr. KI 06/12

Parashtruesi

Bajrush Gashi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 67/2011, të 12 dhjetorit 2011.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Bajrush Gashi, me vendbanim në fshatin Hoçë e Vogël, Rahovec.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Vendimin e Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 67/2011, të 12 dhjetorit 2011, i cili iu dorëzua në një datë të pacaktuar.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) më 27 janar 2012, me të cilën kërkonte vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 67/2011.

4. Parashtruesi pohon që vendimi i kontestuar ia ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për

Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009, (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56 (1) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 27 janar 2012.

7. Më 30 janar 2012, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. 06/12, e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. 06/12, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Enver Hasani dhe Kadri Kryeziu.

8. Më 6 mars 2012, Gjykata ia komunikoi kërkesën Gjykatës Supreme dhe kërkoi nga ajo që t'i dorëzonte komentet e veta në lidhje me këtë kërkesë.

9. Më 21 mars 2012, Gjykata kërkoi nga Gjykata Supreme që ta dorëzonte dosjen e rastit Pzd. nr. 67/2011, të 12 dhjetorit 2011, dhe komentet shtesë.

10. Gjykata Supreme u përgjigj më 22 mars 2012, duke i dërguar komentet e veta në lidhje me kërkesën, por nuk e dorëzoi dosjen e lëndës.

11. Në përgjigjen e vet të 22 marsit 2012, Gjykata Supreme e informoi Gjykatën se:

"...

Nga shkresat e lëndës rezulton se i dënuari Bajrush Gashi pretendon se atij i është cenuar e drejta për një gjykim të paanshëm e të drejtë, ngase në panelin gjyqësor pranë Gjykatës Supreme, me rastin e shqyrtimit të kërkesës së tij për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, paska marr pjesë një anëtar paneli, i cili në çështjen e njëjtë ndaj tij ka marrë pjesë edhe në shkallë të parë.

Është e vërtetë se në procedurën e shqyrtimit të kërkesës për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit pran kësaj Gjykate një anëtar i panelit ka qenë edhe kryetare e panelit në gjykatën e shkallës së parë, mirëpo kjo rrethanë nuk paraqet asnjë pengesë ligjore për këto arsye:

Në procedurën e zbutjes së jashtëzakonshme të dënimit mund të merr pjesë gjyqtari që ka qenë kryetar i trupit gjykues apo anëtar i trupit gjykues edhe në procedurën e shkallës së parë. Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit i paraqitet gjykatës së shkallës së parë-kryetarit të trupit gjykues që ka kryesuar panelin në shkallë të parë apo që ka vepruar si gjyqtar i vetëm (neni 450 i KPPK), i cili ndërmerr disa veprime procedurale e pastaj lëndën, me propozim të e arsyetuar, ia dërgon Gjykatës Supreme, e cila vendos lidhur me kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore që në panele të marrë pjesë ndonjë anëtar apo të gjithë anëtarët që kanë marr pjesë edhe më parë në panele gjyqësore për çështjen e njëjtë.

Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme mund të paraqitet disa herë (nga i njëjti i dënuar), sa herë që konsideron se është paraqitur ndonjë rrethanë e re që ai e vlerëson me ndikim për zbutje të dënimit. Mirëpo, po të përjashtoheshin anëtarët që kanë qenë të përfshirë në ndonjë fazë të procedurës, atëherë Gjykata Supreme s'do të kishte gjyqtar për të vendosur lidhur me kërkesën, kështu që kërkesat do ngelnin të pashqyrtuara.

Te ky mjet i jashtëzakonshëm juridik bëhet fjalë për rrethana të reja, për të cilat gjyqtari, edhe po të ketë qenë pjesë e panelit të mëhershëm, s'ka mundur të krijojë paragjykime, (sepse kjo rrethanë shqyrtohet për herë të parë).

Për të qenë më i qartë, unë po ju dërgoj një pjesë të komentit që bën fjalë për këtë situatë, ku thuhet qartë se gjyqtari që ka marrë pjesë në marrjen e aktgjykimit, mund të marr pjesë edhe me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit.

Në zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, gjyqtarët që kanë marrë pjesë në marrjen e vendimit mund të marrin pjesë edhe në procedurën e gjykatës së shkallës së parë (neni 414 – refuzimi i kërkesës, hetimi dhe propozimi) dhe në vendimin përfundimtar në gjykatën kompetente. Situata është e ngjashme me atë të përsëritjes së procedurës penale: bëhet fjalë për material të ri apo rrethana të reja për të cilat gjyqtari nuk mund të ketë paragjykime, prandaj edhe zgjidhja duhet të jetë pa paragjykime.

…"

12. Më 30 mars 2012, Gjykata e njoftoi parashtruesin se Gjykata Supreme i kishte dërguar komentet e veta dhe kërkoi komentet e tij, nëse ka, lidhur me përgjigjen e Gjykatës Supreme. Gjykata nuk ka marrë asnjë përgjigje deri më tani.

13. Më 9 maj 2012 Gjykata mbajti këshillime dhe votoi për rastin.

Përmbledhje e fakteve

14. Më 19 maj 2009, Gjykata e Qarkut në Prizren, e shpalli parashtruesin fajtor për kryerje të veprës penale nga neni 138.6 lidhur me 138.1 dhe nenin 328.2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK) dhe e dënoi me 4 vjet e 4 muaj burg (Aktgjykimi P. nr. 26/09). Parashtruesi u ankua kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme për shkak të *"shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim me propozimin që aktgjykimi të ndryshohet në mënyrë që i pandehuri të lirohet nga aktakuza apo të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim"*. Prokurori publik u ankua kundër këtij aktgjykimi lidhur me pjesën që kishte të bënte me të bashkëpandehurin G.M.

15. Më 8 dhjetor 2010, Gjykata Supreme e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe ankesën e prokurorit publik dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut (Aktgjykimi Ap. nr. 259/2009). Gjykata Supreme konstatoi që aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut është i bazuar në gjendjen faktike dhe gjykata e shkallës së parë e vërtetoi gjendjen faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë, dhe gjykata e shkallës së parë gjithashtu ka dhënë arsyet ligjore për faktet vendimtare. Përveç kësaj, Gjykata Supreme konkludoi që aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut nuk përmbante shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, siç pretendohej nga parashtruesi.

16. Më 12 dhjetor 2011, Gjykata Supreme e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit (Aktgjykimi Pzd. nr. 67/2011). Gjykata Supreme, duke marrë parasysh mendimin e Gjykatës së Qarkut, të prokurorit publik të qarkut dhe të prokurorit të shtetit, që kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit ishte e pabazuar, vendosi që arsyet e parashtruesit për kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit nuk ishin të një natyre të tillë që do ta justifikonin zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit të parashtruesit.

Pretendimet e parashtruesit

17. Parashtruesi pohon që gjyqtari që ishte kryetar i trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe kishte vendosur në rastin e tij, mori pjesë edhe në vendimin e Gjykatës Supreme lidhur me kërkesën e tij për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit (gjyqtari në fjalë).

18. Përveç kësaj, parashtruesi pohon që gjyqtari në fjalë është dashur ta njoftonte Gjykatën Supreme se i njëjti ishte kryetar i trupit gjykues në Gjykatën e Qarkut në Prizren dhe se gjyqtari në fjalë është dashur të përjashtohej nga pjesëmarrja në kolegjin e Gjykatës Supreme.

19. Prandaj, parashtruesi konsideron që gjyqtari i Gjykatës Supreme ka shkelur nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

Dispozitat e ligjit të zbatueshëm lidhur me procedurat për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit

Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës (Rregullorja e UNMIK-ut 2003/26), e 6 korrikut 2003

20. Procedura për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit rregullohet me Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPPK).

Përjashtimi i gjyqtarit

21. Neni 40

"...

(1) Gjyqtari ose gjyqtari laik përjashtohet nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në rastin kur:

5) Në të njëjtën çështje ka marrë pjesë në marrjen e vendimit në gjykatën më të ulët ose nëse në gjykatën e njëjtë ka marrë pjesë në marrjen e vendimit i cili kundërshtohet me ankesë.

..."

22. Neni 41

"...

(1) Gjyqtari ose gjyqtari laik posa të mësojë se ekziston ndonjë arsye për përjashtim nga neni 40 paragrafi 1 ose 2 i këtij Kodi ndërpret çdo aktivitet lidhur me çështjen dhe për këtë e njofton kryetarin e gjykatës, i cili sipas rregullave të brendshme të gjykatës cakton zëvendësimin e tij. Në rastin e përjashtimit të kryetarit të gjykatës, ai kërkon drejtpërdrejt nga kryetari i gjykatës më të lartë të caktojë zëvendësimin.

(2) Në qoftë se gjyqtari ose gjyqtari laik mendon se ekzistojnë rrethana të cilat arsyetojnë përjashtimin e tij (neni 40 paragrafi 3 i këtij Kodi) për këtë e njofton kryetarin e gjykatës. Derisa të merret vendim për përjashtim, gjyqtari ose gjyqtari laik mund të ndërmerr vetëm ato veprime të cilat janë domosdo të nevojshme për të penguar shtyrjen ose vonesën e palejueshme të çështjes.

…"

Zbutja e jashtëzakonshme e dënimit

23. Neni 448

"*Zbutja e jashtëzakonshme e dënimit lejohet kur pas formës së prerë të aktgjykimit paraqiten rrethana të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën e marrjes së aktgjykimit ose, megjithëse kanë ekzistuar në atë kohë, gjykata nuk ka qenë në dijeni për to, kurse ato dukshëm do të ndikonin në dënim më të ulët."*

24. Neni 449

"...

(1) Kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit mund të paraqesë prokurori publik kur procedura është zbatuar me kërkesë të tij, i dënuari dhe mbrojtësi i tij.

(2) Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit nuk e pezullon ekzekutimin e dënimit.

..."

25. Neni 450

"...

(1) Për kërkesën mbi zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit vendos Gjykata Supreme e Kosovës.

(2) Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit i paraqitet gjykatës e cila ka marrë aktgjykimin në shkallë të parë.

(3) Kryetari i trupit gjykues i gjykatës së shkallës së parë e hudh kërkesën e paraqitur nga personi i paautorizuar për paraqitjen e saj.

(4) Gjykata e shkallës së parë vërteton se a ekzistojnë shkaqe për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit dhe pas dëgjimit të prokurorit publik, nëse procedura është zbatuar sipas kërkesës së tij, personit të dënuar ose mbrojtësit të tij e pastaj shkresat me propozimin e arsyetuar ia dërgon Gjykatës Supreme.

(5) Kur vepra penale e cila ndiqet sipas kërkesës së prokurorit publik, Gjykata Supreme, para marrjes së vendimit mbi zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit ia dërgon shkresat Prokurorit Publik të Kosovës i cili mund t'i paraqesë propozim me shkrim gjykatës. Mbrojtësi ka qasje në këto shkresa.

(6) Gjykata Supreme e Kosovës refuzon kërkesën kur çmon se nuk ka baza ligjore për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit. Kur e aprovon kërkesën, gjykata me aktvendim e ndryshon aktgjykimin e formës së prerë lidhur me vendimin mbi dënimin.

..."

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

26. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe në Rregullore të punës.

27. Gjykata duhet të përcaktojë së pari nëse parashtruesi është palë e autorizuar sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë që "*Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*" Në këtë drejtim, kërkesa është dorëzuar në Gjykatë nga një individ. Prandaj, parashtruesi është palë e autorizuar, ka të drejtë ta ngrejë këtë rast në Gjykatë sipas nenit 113.7 të Kushtetutës.

28. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës në pajtim me nenin 49 të Ligjit duhet ta dorëzojë kërkesën brenda 4 muajve pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë. Më 12 dhjetor 2011, Gjykata Supreme nxori Vendimin Pzd. nr. 67/2011, , kurse parashtruesi e mori atë vendim në një datë të pacaktuar. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 27 janar 2012. Prandaj, parashtruesi e ka përmbushur afatin kohor për parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

29. Përveç kësaj, në bazë të nenit 450.1 të KPPPK-së, Gjykata Supreme konsiderohet "si gjykatë e shkallës së fundit për të gjykuar për çështje që lidhen me zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit". Si rrjedhojë, Gjykata po ashtu përcakton se parashtruesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të Kosovës.

30. Përfundimisht, neni 48 i Ligjit përcakton që: *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."* Në këtë drejtim, Gjykata vëren që parashtruesi e konteston Vendimin e Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 67/2011, i cili, gjoja, ia ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës gjithashtu e ka përmbushur këtë kriter.

31. Pasi parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, pasi i ka përmbushur afatet kohore për të parashtruar kërkesë në Gjykatë, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, dhe pasi e

ka qartësuar saktësisht shkeljen e supozuar të të drejtave dhe lirive, duke përfshirë vendimin që e konteston, Gjykata konkludon që parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri.

Vlerësimi kushtetues i kërkesës

32. Pasi parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret procedurale për pranueshmëri, Gjykata duhet t'i shqyrtojë meritat e ankesës së parashtruesit.

33. Gjykata vëren që parashtruesi e konteston Vendimin e Gjykatës Supreme, Pzd. nr. 67/2011, të 12 dhjetorit 2011, me të cilin iu refuzua si e pabazuar kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit.

34. Në fakt, Gjykata Supreme, duke marrë parasysh mendimin e Gjykatës së Qarkut, të prokurorit publik të qarkut dhe të prokurorit të shtetit, vendosi që arsyet e parashtruesit për kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit nuk ishin të një natyre të tillë që do ta justifikonin zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit të parashtruesit dhe e refuzuan kërkesën si të pabazuar.

35. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese vëren që gjyqtari që ishte kryetar i trupit gjykues në Gjykatën e Qarkut në Prizren kur parashtruesi u dënua me burg po ashtu ka marrë pjesë në procesin e marrjes së vendimit në Gjykatën Supreme në lidhje me kërkesën e parashtruesit për zbutjen e dënimit të shqiptuar nga Gjykata e Qarkut në Prizren..

36. Gjykata rikujton se procedura që ka të bëjë me zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit nuk parashikon procedurë publike në të cilën parashtruesi mund të marrë pjesë. Kjo procedurë bazohet vetëm në parashtresat me shkrim. Prandaj, parashtruesi nuk ka mundur të dinte që gjyqtari kryesues i trupit gjykues në Gjykatën e Qarkut në Prizren gjithashtu po

merrte pjesë në vendimin e Gjykatës Supreme lidhur me kërkesën e tij për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit. Ai e kuptoi këtë vetëm pasi mori vendimin me të cilin i refuzohej kërkesa.

37. Gjykata vëren që neni 40.1 (5)i KPPPK-së përcakton "*Gjyqtari ose gjyqtari laik përjashtohet nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në rastin kur: Në të njëjtën çështje ka marrë pjesë në marrjen e vendimit në gjykatën më të ulët ose nëse në gjykatën e njëjtë ka marrë pjesë në marrjen e vendimit i cili kundërshtohet me ankesë".*

38. Përveç kësaj, në përputhje me nenin 41 të KPPPK-së, në qoftë se *"gjyqtari ose gjyqtari laik mëson se ekziston ndonjë arsye për përjashtim nga neni 40 paragrafi 1 ose 2 i këtij Kodi ndërpret çdo aktivitet lidhur me çështjen dhe për këtë e njofton kryetarin e gjykatës, i cili sipas rregullave të brendshme të gjykatës cakton zëvendësimin e tij."* E njëjta vlen *"Në qoftë se gjyqtari ose gjyqtari laik mendon se ekzistojnë rrethana të cilat arsyetojnë përjashtimin e tij (neni 40 paragrafi 3 i këtij Kodi) për këtë e njofton kryetarin e gjykatës".*

39. Përveç kësaj, Gjykata Supreme konfirmoi në përgjigjen e vet se në procedurën për shqyrtimin e kërkesës për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit një anëtar i trupit gjykues ishte edhe kryetar i trupit gjykues në gjykatën e shkallës së parë ku ishte shqiptuar i njëjti dënim. Gjykata Supreme më tej theksoi se kjo nuk paraqiste kurrfarë pengese për shkak se kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit së pari i ishte paraqitur gjykatës së shkallës së parë, kryetarit të trupit gjykues që e kishte kryesuar trupin gjykues në shkallën e parë ose kishte vepruar si gjyqtar i vetëm që kishte marrë masa procedurale dhe më pas, me propozim të arsyetuar, i ishte paraqitur Gjykatës Supreme. Përveç kësaj, Gjykata Supreme tha se sikur të përjashtoheshin të gjithë anëtarët që kanë qenë të përfshirë në ndonjë fazë të procedurës, atëherë Gjykata Supreme nuk do të kishte gjyqtarë për të vendosur për kërkesën.

40. Megjithatë, parashtruesi pohon që nuk ka pasur "gjykim të drejtë" nga një "tribunal i paanshëm i themeluar me ligj" në

kuptim të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i cili në pjesën përkatëse përcakton:

> *"2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm ... për cilëndo akuzë penale ... nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".*

dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, i cili në pjesën përkatëse përcakton:

> *"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht ... nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj... e cila do të vendosë në lidhje me çdo akuzë penale në ngarkim të tij..."*,

41. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjyqtari në fjalë është dashur ta kishte njoftuar Gjykatën Supreme se ajo ka qenë kryetare e trupit gjykues në Gjykatën e Qarkut në Prizren dhe, për këtë arsye, duhej të përjashtohej nga pjesëmarrja në kolegjin e Gjykatës Supreme. Gjyqtari në fjalë ka mundur të përjashtohej ex officio nga ana e Gjykatës Supreme, pasi që fakti se ka qenë gjyqtar kryesues në Gjykatën e Qarkut në Prizren ishte informacion zyrtar që përmendej në objektin e çështjes së lëndës.

42. Parashtruesi më tej ankohet se pasi nuk ishte në dijeni që gjyqtari në fjalë kishte marrë pjesë në procedurën për shqyrtimin e kërkesës të tij, pasi kjo procedurë ishte mbajtur në mungesë të tij, ai nuk e dinte kush kishte marrë pjesë në këtë procedurë.

43. Gjykata tani duhet të shqyrtojë nëse një gjyqtar i përfshirë si kryetar i trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut në dënimin e një personi, do të mund të merrte pjesë më vonë, si gjyqtar i

Gjykatës Supreme, në kolegjin që merret me kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit për të njëjtin person të dënuar.

44. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron që paanësia e një tribunali sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së duhet të përcaktohet sipas një testi subjektiv, pra në bazë të bindjes dhe sjelljes personale të një gjyqtari në një rast të caktuar, dhe gjithashtu sipas testit objektiv, pra konstatimit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për ta përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë drejtim (shih ndër autoritete të tjera, Hauschildt kundër Danimarkës, aktgjykim i 24 majit 1989, Seria A nr. 154, f. 21, para. 46, dhe Thomann kundër Zvicrës, aktgjykim i 10 qershorit 1996, Raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve 1996-III, f. 815, para. 30).

45. Sa i përket testit subjektiv, për shkak të natyrës së shkruar të procedurës, as parashtruesi as avokati nuk kanë mundur të jenë në dijeni, derisa nuk e kanë marrë vendimin e Gjykatës Supreme, se e njëjta gjyqtare që ishte kryetare e trupit gjykues në Gjykatën e Qarkut në Prizren mori pjesë edhe në trupin gjykues të Gjykatës Supreme që vendosi për kërkesën e tij për zbutjen e dënimit. Prandaj, nuk mund të konkludohet që parashtruesi ka hequr dorë nga e drejta për përcaktimin e të drejtave të tij nga një "tribunal i paanshëm" (shih, *mutatis mutandis*, Oberschlick kundër Austrisë, nr. 11662/85, aktgjykim i 23 majit 1991).

46. Në këtë drejtim, Gjykata Supreme është dashur që gjyqtari në fjalë në pajtim me nenin 41 të KPPPK-së ta tërheq ose është dashur të tërhiqet *ex officio* nga procedura për shqyrtimin e dënimit.

47. Sa i përket testit objektiv, Gjykata vëren që duhet të përcaktohet nëse, ka fakte të vërtetueshme që mund të ngrenë dyshime se a mundet një gjyqtar i caktuar të jetë i drejtë dhe i paanshëm në një rast të caktuar. Në këtë drejtim, mënyra se si duket diçka është me rëndësi. Ajo që është në rrezik është besimi që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet ta frymëzojnë në publik, dhe, mbi të gjitha, në të akuzuarin, sa u

përket procedurave penale. Si rrjedhojë, cilido gjyqtar për të cilin ka arsye legjitime për të pasur frikë për mungesë të paanshmërisë duhet të tërhiqet (shih ndër autoritete të tjera, Hauschildt kundër Danimarkës, aktgjykim i 24 majit 1989, Seria A nr. 154, f. 21, para. 46).

48. Gjykata vëren që në rastin në fjalë frika për mungesë të paanshmërisë rrjedh nga fakti se gjyqtari në fjalë si kryetar i trupit gjykues në Gjykatën e Qarkut në Prizren, e dënoi parashtruesin me burg. I njëjti gjyqtar gjithashtu ishte anëtar i kolegjit të Gjykatës Supreme kur ky kolegj vendosi se kërkesa e parashtruesit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit ishte e pabazuar.

49. Gjykata vëren që nenet 40 dhe 41 të KPPPK-së manifestojnë brengën e ligjvënësit për t'i hequr të gjitha dyshimet e arsyeshme sa i përket paanshmërisë së Gjykatës. Si rrjedhojë, dështimi i Gjykatës Supreme për të vepruar në përputhje me këtë rregull do të thotë që kërkesa e parashtruesit për zbutje të dënimit u dëgjua nga një tribunal, paanshmëria e të cilit u njoh nga KPPPK-ja si e hapur për dyshime (shih, *mutatis mutandis*, Oberschlick kundër Austrisë, nr. 11662/85, aktgjykim i 23 majit 1991).

50. Prandaj, Gjykata është e mendimit se në rrethanat e këtij rasti, paanshmëria e Gjykatës Supreme mund të duket e hapur për dyshime dhe se frikët e parashtruesit në këtë drejtim mund të konsiderohen subjektivisht dhe objektivisht të arsyetueshme.

51. Gjykata Supreme argumentoi se sikur të përjashtoheshin të gjithë anëtarët që kanë qenë të përfshirë në ndonjë fazë të procedurës, atëherë Gjykata Supreme nuk do të kishte gjyqtarë për të vendosur për kërkesën. Gjykata konsideron që çështja nëse ka apo nuk ka numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve për të vendosur për kërkesat për zbutje të dënimit është çështje krejtësisht nën juridiksion, dhe për diskutim, po qe nevoja, ndërmjet gjyqësorit dhe Qeverisë. Përgjegjësia primare për administrimin e mirëfilltë të drejtësisë i takon Qeverisë dhe çështjet organizative nuk mund të përdoren si arsyetim për mosrespektim të Kushtetutës (shih Rastin Nr. KO 4/11, Gjykata Supreme e Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 35,

36, 37 dhe 38 të Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme, Nr. 03/L-139, aktgjykim i 1 marsit 2012)

52. Në këto rrethana, Gjykata konstaton që është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm nga një tribunal i pavarur, siç garantohet me nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56 (1) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 9 maj 2012, njëzëri vendosi

I. TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;

II. TA SHPALLË të pavlefshëm Vendimin e Gjykatës Supreme Pzd. nr. 67/2011 të 12 dhjetorit 2011, i cili shkel nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

III. TA KTHEJË Vendimin Pzd. nr. 67/2011 të Gjykatës Supreme të 12 dhjetorit 2011 në Gjykatën Supreme për rishqyrtim në pajtueshmëri me aktgjykimin e kësaj Gjykate në bazë të rregullit 74 (1) të Rregullores së Punës;

IV. Në bazë të rregullit 63 (5) të Rregullores së Punës, Gjykata Supreme duhet t'i dorëzojë informacione Gjykatës Kushtetuese për masat e ndërmarra në zbatimin e këtij aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese;

V. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

VI. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Snezhana Botusharova Prof. Dr. Enver Hasani

KI 130/10 datë 25 korrik 2012- Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-09-0045, të 8 marsit 2010

Rasti KI 130/10, vendimi i 18 qershorit 2012

Fjalët kyçe: mbrojtja shëndetësore dhe sociale, kërkesa individuale, mbrojtja gjyqësore e pronës, qartazi e pabazuar, mbrojtja e pronës, e paafatshme, e drejta për mjete juridike, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit, shkelja e të drejtave dhe lirive individuale.

Parashtruesi parashtroi kërkesë në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke pretenduar se të drejtat e saj nga neni 32 [E Drejta në Mjete Juridike], neni 46 [Mbrojtja e Pronës], neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], neni 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale], neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], dhe neni 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] i ishin shkelur me Aktgjykimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, që konsideronte se Vendimi i Trupit Gjykues SCEL-08-003-0102, ishte i drejtë sepse parashtruesi kishte ushtruar ankesë kundër listës përfundimtare të AKM-së në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, pas skadimit të afatit për dorëzimin e ankesës. Kërkesa e parashtruesit për kthim në gjendjen e mëparshme ishte refuzuar gjithashtu, për shkak se propozimi për kthim në gjendjen e mëparshme, në pajtim me nenin 118 të Ligjit për Procedurën Kontestimore ("Gazeta Zyrtare e RSFJ", Nr. 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596) është dashur të dorëzohet brenda pesëmbëdhjetë ditësh, prej ditës kur arsyeja për mosveprim kishte pushuar së ekzistuari, respektivisht deri më 3 shtator 2008.

Gjykata konstatoi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesi kishte dështuar të ofrojë dëshmi se procedurat relevante ishin në ndonjë mënyrë të padrejta ose të prekura nga arbitrariteti. Prandaj, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (1.c) të Rregullores së punës. Përveç kësaj, Gjykata konstatoi se kërkesa ishte e paafatshme, në pajtim me nenin 49 të Ligjit sepse Aktgjykimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ASC-09-0045 të 8 marsit 2010, i ishte dorëzuar

parashtruesit më 22 mars 2010, derisa parashtruesi e kishte dorëzuar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 28 dhjetor 2010, d.m.th. më shumë se 4 muaj pasi parashtruesit i ishte dorëzuar Aktgjykimi.

Prishtinë, më 27 qershor 2012

Nr. ref.: RK261/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 130/10

Parashtruesja

Cyma Agović

Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-09-0045, të 8 marsit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesja e Kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Cyma Agović me vendbanim në Pejë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e konteston aktgjykimin e Panelit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: "Paneli i Ankesave"), ASC-09-0045, të 8 marsit 2010, të cilin parashtruesja e ka pranuar më 22 mars 2010.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së lëndës së parashtruar më 28 dhjetor 2010, në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: "Gjykata Kushtetuese") është vlerësimi i Kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Panelit të Ankesave, ASC-09-0045, të 8 marsit 2010.

4. Parashtruesja pretendon se vendimi i lartpërmendur shkel të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: "Kushtetuta"), më saktë neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike], neni 46 [Mbrojtja e Pronës], neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], neni 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale], neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] si dhe neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare].

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009, (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejmë: "Ligji"), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: "Rregullorja").

Procedura në Gjykatë

6. Më 28 dhjetor 2010, parashtruesja dorëzoi Kërkesën në Gjykatë.

7. Më 14 shkurt 2011, Kryetari, me vendimin Nr. GJR 130/10, e caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues. Të njëjtën

datë, Kryetari, me vendimin Nr. KSH. 130/10, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Iliriana Islami.

8. Më 27 janar 2011, Gjykata njoftoi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Agjencinë Kosovar të Privatizimit.

9. Më 18 qershor 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmerinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesja ka punuar në lavanderi të Hotelit Rugova në Pejë nga viti 1978 deri në vitin 1999.

11. Më 3 shtator 2003, Drejtoria e Hotelit Rugova në Pejë kishte përpiluar listën e punëtoreve të kualifikuar që kanë të drejtë në 20% e mjeteve nga privatizimi i ndërmarrjeve publike, dhe e njëjta ishte përcjellë në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: "AKM") për procedim. Parashtruesja kishte qenë e përfshirë në atë listë.

12. Më 7, 8, 10 dhe 11 maj 2008, AKM-ja kishte publikuar listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar për realizimin e 20 % të mjeteve të realizuara nga privatizimi i ndërmarrjes në fjalë, dhe kishte potencuar që afati i fundit për paraqitjen e ankesave ishte 2 qershor 2008. Parashtruesja nuk ishte në këtë listë.

13. Më 6 maj 2009, parashtruesja ankohet në Trupin Gjykues të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: "Trupi Gjykues") pasi që parashtruesja nuk ishte e përfshire në listën e hartuar nga AKM-ja.

14. Më 9 korrik 2009, Trupi Gjykues hidhi poshtë ankesën e parashtrueses duke bazuar në seksionin 10.6 (a) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/03 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore (në

tekstin e mëtejme: "Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/13"), sepse afati për paraqitjen e ankesave kishte skaduar, d.m.th. 2 qershor 2008 (Aktvendim SCEL-08-003-0102).

15. Më 12 gusht 2009, parashtruesja kishte dorëzuar një ankesë tek Paneli për Ankesa, ku kërkonte që të hidhet poshtë Aktvendimin e Trupit Gjykues, SCEL-08-003-0102, dhe kërkoi kthimin në gjendjen e mëparshme sepse parashtruesja ishte e shtrirë në spital, 4 deri më 14 prill 2008, prej 28 maj deri më 28 maj 2009 si dhe më 29 maj, në kohën kur është dashur të paraqitet ankesa kundër listës përfundimtare të AKM-së.

16. Më 8 mars 2010, Paneli i Ankesave hidhi poshtë ankesën e parashtrueses dhe vërtetoi aktvendimin e Trupit Gjykues (aktgjykimi ASC-09-0045). Paneli i Ankesave theksoi se aktvendimi i Trupit Gjykues, SCEL-08-003-0102, ishte i drejtë pasi që parashtruesja kishte paraqitur ankesën kundër listës përfundimtare të AKM-së pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, pas mbarimit të afatit për parashtrimin e ankesave. Gjithashtu edhe kërkesa e parashtrueses për kthim në gjendje të mëparshme u hidh poshtë për shkak që, propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme sipas nenit 118 të Ligjit për Procedurën Kontestimore ("Gazeta zyrtare e RSFJ", Nr. 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596) është dashur të paraqitet brenda pesëmbëdhjetë dite duke llogaritur që nga dita kur ka pushuar arsyeja që ka shkaktuar ometimin, respektivisht deri më 3 shtator 2008.

17. Më 12 gusht 2010, parashtruesja kishte dërguar një letër të Kryesuesi i Misionit të EULEX-it, ku kishte kërkuar që edhe një herë të rishikohet aktgjykimi ASC-09-0045 i Panelit të Ankesave, i cili sipas saj nuk ishte i drejtë.

18. Më 30 shtator 2010, Kryesuesi i Misionit të EULEX-it, ishte përgjigjur në shkrese duke theksuar se EULEX-i nuk ka mandat dhe as autoritet që të shqyrtojë vendimet e organeve gjyqësore. Mirëpo pasi që parashtruesja kishte vënë në pikëpyetje korrektësinë dhe drejtësinë e stafit të EULEX-it, Kryesuesi i Misionit të EULEX-it ankesën e 30 shtatorit 2010 e kishte drejtuar tek Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut.

19. Më 8 dhjetor 2010, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut gjeti ankesën e parashtrueses si të pabazuar për shkak se Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut në bazë rregullit 25, paragrafi 1 të Rregullores së Punës të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut nuk ka juridiksion për ta shqyrtuar procedurat juridike që janë kryer nga gjykatat e Kosovës.

Pretendimet e parashtrueses

20. Parashtruesja pretendon se me aktgjykimin e Panelit të Ankesave, ASC-09-0045, të 16 marsit 2010, i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë, pasi që parashtrueses iu është mohuar e drejta e marrjes së 20% të mjeteve pas privatizimit të ndërmarrjes në të cilën ajo kishte punuar për më shumë se 20 vite dhe për shkak se Paneli i Ankesave gjatë gjykimit të rastit nuk e kishte marrë parasysh gjendjen e saj shëndetësore në të cilën ajo kishte qenë gjatë kohës kur është dashur të parashtrohet ankesa kundër listës përfundimtare të AKM-së.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Gjykata vëren se, për të gjykuar për kërkesën e parashtrueses, Gjykata së pari duhet të shqyrtoje nëse parashtruesja i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregulloren e punës.

22. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit që përcakton se:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht."*

23. Nga dokumentet e parashtruara, duket që kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit kohor sipas nenit 49 të Ligjit, sepse aktgjykimi, ASC-09-0045 i 8 marsit 2010, i Panelit të Ankesave është pranuar nga parashtruesja më 22 mars 2010. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesja ka parashtruar kërkesën në Gjykatë më 28 dhjetor 2010.

24. Përveç kësaj, parashtruesja i ka dërguar letër Kryesuesit të Misionit të EULEX-it më 30 shtator 2010, dhe më 8 dhjetor 2010, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut gjeti ankesën e parashtrueses si të pabazuar. Në këtë drejtim, Gjykata dëshiron të ritheksojë gjetjet e saj në Rastin KI 64/11, të 14 shkurtit 2012, në të cilin përcaktoi që: "letra i dërguar Kryesuesit të Misionit të EULEX-it nuk është mjet juridik i paraparë me ligj dhe nuk ka e ka fuqinë të ndikojë në aktgjykimin e Gjykatës Supreme" (shih Rastin nr. KI 64/11, Feti Gashi, Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 184/2008 të 27 janarit 2009, Aktvendim për Papranueshmëri, të 3 marsit 2011).

25. Gjithashtu, në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane, parashtruesit janë vetëm të obliguar t'i shterojnë mjetet juridike që janë në dispozicion në teori dhe në praktike në kohen përkatëse, pra, mjetet që janë të qasshme, që sigurojnë kompensim lidhur me ankesat e tyre dhe që ofrojnë mundësi të arsyeshme për sukses (Aktgjykim i Dhomës së Madhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Sejdovic kundër Italisë, Kërkesa nr. 56581/00 e 1 marsit 2006, paragrafi 46).

26. Prandaj, Gjykata konkludon që Kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit kohor sipas nenit 49 të Ligjit.

27. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 të Rregullores së Punës së Gjykatës që përcakton se:

> *"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) Kërkesa është qartas e bazuar:"*

28. Para së gjithash, parashtruesja nuk i parashtroi ankesë në Trupin Gjykues brenda afatit ligjor.

29. Në fakt, Paneli i Ankesave konkludoi se parashtruesja nuk e ka parashtruar ankesën e saj brenda afatit ligjor të paraparë me seksionin 10.6 (a) Rregullorja e UNMIK-ut 2003/13 dhe neni 118 të Ligjit për Procedurën Kontestimore ("Gazeta zyrtare e RSFJ", Nr. 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596).

30. Parimi i subsidiaritetit parasheh që parashtruesja të shterë të gjitha mundësitë procedurale në procedurat e rregullta, në mënyrë që t'i parandalojë shkeljet e Kushtetutës, ose, nëse ka, të korrigjojë shkelje të tilla të të drejtave themelore. Kështu që, parashtruesja duke dështuar për të ndërmarrë veprime procedurale në gjykatat e rregullta në pajtim me afatet e parapara, faktikisht, mban përgjegjësinë pse rasti i saj deklarohet i papranueshëm, meqë do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për procedim të mëtejshëm për të kundërshtuar shkeljen.

31. Gjykata gjithashtu konsideron se dyshimi i thjeshtë mbi perspektivën e çështjes nuk është i mjaftueshëm për të ndaluar parashtruesen nga detyrimet e saj për t'u ankuar para organeve kompetente në kohën e duhur (shih Whiteside kundër Mbretërisë së Bashkuar, Vendimi i 7 marsit 1994, parashtresa nr. 20357/92, DR 76, fq.80).

32. Në vazhdim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e fakteve ose ligjit (ligjshmërisë) gjoja të kryera nga ana e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, përveç nëse dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Kështu që, Gjykata nuk duhet vepruar si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrtohen vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat e caktuara të të drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis,* García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

33. Si përfundim, Gjykata mund vetëm të vlerësoi nëse dëshmitë janë paraqitur në mënyrë të tillë, dhe nëse procedurat në

përgjithësi, parë si tërësi, janë kryer në atë mënyrë që parashtruesja ka pasur gjykim të ndershëm (shih mes tjerash, Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, App. Nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).

34. Për më tepër, parashtruesja thjeshtë konteston nëse Dhoma e Posaçme të Gjykatës Supreme ka zbatuar plotësisht ligjin në fuqi dhe nuk pajtohet me gjetjet faktike të gjykatave lidhur me rastin e saj.

35. Në të vërtetë, parashtruesja nuk i ka mbështetur pretendimet e saj në baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se të drejtat dhe liritë e saj janë shkelur nga autoritetet publike. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të përfundoi se procedurat relevante në çfarëdo mënyre ishin të padrejta apo arbitrare (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, GJEDNJ Vendimi për Pranueshmëri Nr. 17064/06 i 30 qershorit 2009).

36. Në fakt parashtruesja përpos shprehjes së mos kënaqësisë për aktgjykimin e Panelit të Ankesave, ASC-09-0045, të 8 marsit 2010, nuk ka argumentuar në mënyrë bindëse se pse gjykimi "nuk ka qenë i drejtë dhe i paanshëm" se në cilën mënyrë ajo ka qenë e trajtuar si e pabarabartë apo cila fazë e procedurës ka qenë kundër kushtetuese.

37. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme për arsye të parashtrimit të kërkesës jashtë afatit dhe, edhe sikur Kërkesa të ishte brenda afatit, Kërkesa është qartazi e pabazë në pajtim me rregullin 36 (1.c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në bazë të nenit 49 të Ligjit dhe Rregullit 36 (1.c) dhe 56 (2) të Rregullores më 18 qershor 2012, njëzëri,

VENDOS

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Mr. sc. Kadri Kryeziu Prof. Dr. Enver Hasani

KI 145/11 datë 12 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut P. nr. 2003/2006 të 9 nëntorit 2007 dhe aktgjykimeve të Gjykatës Supreme AP. nr. 190/2009 të 27 janarit 2010, API. nr. 1/2010 të 26 nëntorit 2010 dhe PKL-36/11 të 10 gushtit 2011.

Rasti KI 145/2011, vendimi i datës 8 maj 2012
Fjalët kyçe: kontest penal, kërkesa individuale, kërkesë qartazi e pabazuar

Parashtruesi e kishte dorëzuar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke pretenduar se me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe aktgjykimet e Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me : Nenin 21 [Parimet e përgjithshme], Nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], Neni 24 [Barazia para Ligjit], Nenin 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimi Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues], Nenin 29 [E drejta e Lirisë dhe Sigurisë], Nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], Nenin 32 [E drejta për mjete Juridike], dhe Nenin 33 [Parimi i legalitetit dhe Proporcionalitetit në rastet Penale].

Gjykata kishte konstatuar se, parashtruesi ka dështuar të provojë që shkeljet e supozuara të të drejtave kushtetuese, të përmendura në kërkesë, përbënin elemente të pakontestuara të shkeljes/shkeljeve të të drejtave të tij. Andaj, kishte konsideruar që kërkesa e parashtruesit duhet të ishte qartazi e bazuar në mënyrë që gjykata të lëshohej në meritat e saj. Gjykata gjithashtu kishte theksuar se, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të vlerësojë ligjshmërinë dhe saktësinë e vendimeve të dhëna nga institucionet kompetente gjyqësore, përveç nëse ka prova bindëse se vendimet e tilla janë dhënë në një mënyrë dukshëm të padrejtë dhe të paqartë.

Gjykata konstatoi se parashtruesi nuk kishte ofruar prova se Gjykata e Qarkut në Prishtinë dhe Gjykata Supreme, kishin vlerësuar dhe analizuar provat të ofruara nga parashtruesi në mënyrë të pasaktë. Në të vërtetë, Parashtruesi i Kërkesës kishte dështuar që të arsyetojë kërkesën e tij se Gjykatat e rregullta kanë bërë shkelje të nenit 21, 22, 24, 27, 29, 31 dhe 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata në këtë raste kishte cituar rastin *KI 13/09, Sevdail Avdyli* kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. Nr. 533/2006 të datës 11 shtator 2006 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. Nr. 533/2006 të datës 2 dhjetor 2006, 17 qershor 2010. Si përfundim, Gjykata, kishte konsideruar se kërkesa nuk i kishte përmbushur kriteret procedurale të lejueshmërisë, siç kërkohen me nenin 46 të Ligjit, si dhe rregullin 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së punës, për faktin se parashtruesi ka dështuar të provojë që shkeljet e supozuara të të drejtave kushtetuese, përbëjnë arsyet e mjaftueshme në mënyre që Gjykata të lëshohet më tutje në meritat e rastit.

Prishtinë, më 02 korrik 2012

Nr. ref.: RK263/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 145/11

Parashtruesi

Shkumbin Mehmeti

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut P. nr. 2003/2006 të 9 nëntorit 2007 dhe aktgjykimeve të Gjykatës Supreme AP. nr. 190/2009 të 27 janarit 2010, API. nr. 1/2010 të 26 nëntorit 2010 dhe PKL-36/11 të 10 gushtit 2011.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almira Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Shkumbin Mehmeti me vendbanim në Podujevë, i përfaqësuar nga z. Teki Bokshi avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut P. nr. 2003/2006 të 9 nëntorit 2007 dhe aktgjykimet e Gjykatës Supreme AP. nr. 190/2009 të 27 janarit 2010, API. nr. 1/2010 të 26 nëntorit 2010 dhe PKL-36/11 të 10 gushtit 2011.

Objekti i çështjes

3. Kërkesa e parashtruesit ka të bëjë me shkeljet e supozuara të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtës së të akuzuarit, si dhe të drejtës për mjete efektive juridike të Kushtetutës, lidhur me veprën penale sipas aktakuzës së ngarkuar - vrasje e rëndë dhe vrasje e rëndë në tentativë.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në gjykatë

5. Më 10 nëntor 2011, parashtruesi e dorëzoi Kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (me tutje: Gjykata).

6. Më 17 janar 2012, Kryetari, me vendimin Nr. GJR. 145/11, caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar Raportues. Po të njëjtën ditë, Kryetari, me vendimin Nr. KSH. 145/11, caktoi Kolegjin Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: 1. Ivan Čukalović (kryesues), 2. Dr. Gjyljeta Mushkolaj (anëtare) dhe 3. Dr. Iliriana Islami (anëtare).

7. Më 18 janar 2012, Gjykata, përmes Sekretares së Përgjithshme njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës dhe nga i njëjti kërkoi dokumentacion shtesë, po të njëjtën datë është njoftuar Gjykata Supreme dhe Gjykata e Qarkut në Prishtinë.

8. Më 30 janar 2012, përfaqësuesi ligjor në emër të parashtruesit dorëzoi dokumentacionin e kërkuar nga gjykata.

9. Më 8 maj 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

10. Më 9 nëntor 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, nxori Aktgjykimin P. nr. 203/2005 me të cilin shpalli fajtor parashtruesin për veprat penale të ngarkuara: "Vrasje e rëndë", e kryer në bashkëpunim me të tjerët, "Vrasje në tentativë" dhe "Armëmbajtje pa leje". Parashtruesi për veprat penale të ngarkuara u dënua me 30 vjet burg, duke iu llogaritur koha e mbajtjes në paraburgim nga 7 prilli 2004 deri sa aktgjykimi të bëhej i formës së prerë. Kundër këtij aktgjykimi babai i

parashtruesit z. Gani Mehmeti ushtroi të drejtën e ankesës në Gjykatën Supreme të Kosovës.

11. Më 27 janar 2010, Gjykata Supreme, nxori aktgjykimin AP. nr. 190/2009, dhe hodhi poshtë ankesën e babait të parashtruesit z. Gani Mehmeti, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit, si dhe pranoi pjesërisht ankesën e avokatëve të parashtruesit, ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. nr. 203/2005 të 9 nëntorit 2007, gjegjësisht akuzat (a) dhe (b) në diapozitivin e këtij aktgjykimi janë kualifikuar si një (1) akuzë e *vrasjes së rëndë* dhe *vrasje e rëndë në tentativë* sipas nenit 30 par. 2 pika (6) të Ligjit Penal të Kosovës (LPK) në lidhje me nenin 19 dhe 22 të Kodit Penal të RSFJ-së (KP RSFJ), dënimi i shqiptuar për të dyja akuzat është tridhjetë (30) vjet, ndërsa dënimi unik i shqiptuar për të gjitha akuzat është tridhjetë (30) vjet burgim. Gjykata Supreme, më 30 mars 2006, dënimin me dymbëdhjetë (12) vjet burgim, të shqiptuar me aktgjykimin P. nr. 126/2005 të 3 gushtit 2005 nga Gjykata e Qarkut në Pejë, e shndërroi në dënim unik prej tridhjetë (30) vjetësh burgim, paraburgimi i parashtruesit është vërtetuar nga kjo gjykatë derisa aktgjykimi të bëhej i formës së prerë me një aktvendim të veçantë. Kundër këtij aktgjykimi ishte lejuar të ushtrohet e drejta e ankesës.

12. Kundër aktgjykimit AP. nr. 190/2009 mbrojtja e parashtruesit të kërkesës, më 8 mars 2010 parashtroi ankesë, më pas babai i parashtruesit më 18 mars 2010, si dhe vet parashtruesi më 12 prill 2010.

13. Më 26 nëntor 2010, Gjykata Supreme, nxori Aktgjykimin API. 1/2010, refuzoi si të pa bazë ankesën e 8 marsit 2010, parashtruar nga avokati i parashtruesit, hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e 18 marsit 2010 të ushtruar nga babai i parashtruesit z. Gani Mehmeti dhe refuzoi gjithashtu ankesën e parashtruesit, ushtruar më 12 prillit 2010. Kjo gjykatë e vërtetoi aktgjykimin AP. nr. 190/2009, si të drejtë dhe në përputhje me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

14. Më 21 shkurt 2011, mbrojtja e parashtruesit kishte paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër: aktgjykimit P. nr.

203/2005 të Gjykatës së Qarkut në Prishtine të 9 nëntorit 2007, aktgjykimit AP. nr. 190/2009 të 27 janarit 2010 dhe API. nr. 01/2011 të 26 nëntorit 2010 të Gjykatës Supreme të Kosovës.

15. Më 5 korrik 2011, Gjykata Supreme, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga mbrojtja e parashtruesit të kërkesës e hodhi poshtë si të pabazuar dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Supreme, në përputhje me nenin 456 të KPPK. Kjo gjykatë i hodhi poshtë të gjitha pretendimet e mbrojtjes për shkelje të dispozitave esenciale të procedurës penale, duke i analizuar ato veç e veç, e njëjta erdhi në përfundim se, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe aktgjykimet e Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me : Nenin 21 [Parimet e përgjithshme], Nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], Neni 24 [Barazia para Ligjit], Nenin 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimi Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues], Nenin 29 [E drejta e Lirisë dhe Sigurisë], Nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], Nenin 32 [E drejta për mjete Juridike], dhe Nenin 33 [Parimi i legalitetit dhe Proporcionalitetit në rastet Penale].

17. Ndër të tjera, parashtruesi pretendon se, gjykatat e rregullta kanë bërë shkelje të dispozitave esenciale të procedurave penale, ankohet se gjykimi ka qenë i padrejtë dhe i anshëm, ankohet se i është shkelura e drejta për mjete efektive juridike, pohon se, gjykatat nuk kanë pasur prova të drejtpërdrejta që ai i përkiste grupit të sulmuesve.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

18. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregullore të punës të Gjykatës.

19. Gjykata së pari duhet të përcaktojë nëse Parashtruesi është palë e autorizuar që të parashtrojë kërkesë në Gjykatë, në pajtim me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës dhe 47.2 te Ligjit. Parashtruesi, ndodhet në vuajtje të dënimit dhe në emër të tij ka autorizuar përfaqësuesin e tij (avokatin) që ta përfaqësojë atë në Gjykatë. Përfaqësuesi i parashtruesit ka dorëzuar autorizimin në Gjykatë dhe ka provuar se i njëjti është palë e autorizuar në përputhje me nenin 21 të Ligjit dhe kërkesat e nenit 113.7 (Kërkesat Individuale) të Kushtetutës.

20. Gjykata, po ashtu përcakton nëse parashtruesi ka provuar t'i ketë përmbushur kërkesat e nenit 47.2 të Ligjit. Duke qenë se parashtruesi ka dorëzuar në gjykatë prova të mjaftueshme për përmbushjen e kriterit të shterimit të mjeteve efektive juridike, Gjykata, konsideron që parashtruesi i kërkesës ka përmbushur po ashtu kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47.2 të Ligjit dhe rregullit 36.1 (a) të Rregullores së Punës.

21. Gjithashtu, parashtruesi duhet të provojë që ka përmbushur kërkesat e nenit 49 të Ligjit, sa i përket dorëzimit të kërkesës brenda afatit ligjor. Nga shkresat e lëndës vërehet qartë se vendimi i fundi për rastin e parashtruesit është aktgjykimi i Gjykatës Supreme PKL-36/11 i 5 gushtit 2011, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 10 gusht 2011, ndërsa parashtruesi kërkesën në Gjykatë e dorëzoi më 10 nëntor 2011, që nënkupton se kërkesa është parashtruar brenda afatit 4 mujor të paraparë me ligj.

22. Gjykata, gjithashtu, përcakton nëse parashtruesi në kërkesën e tij ka saktësuar dhe qartësuar se cilat të drejta dhe liri pretendon se i jenë shkelur, më cilin akt dhe nga cila gjykatë a autoritet publik. Parashtruesi në kërkesën e tij ka përmendur shkeljet e supozuara të dispozitave Kushtetuese. Mirëpo, i njëjti duhet të argumentojë bindshëm që faktet të cilat pretendon se

kanë sjellë deri te shkelja e të drejtave dhe lirive të tij të garantuara më Kushtetutë në mënyrë të pa kontestuar në thelbin e tyre përbëjnë elemente të shkeljes së ndonjë të drejte.

23. Lidhur me këtë, Gjykata, i referohet Rregullit 36.1 pikës (c) të Rregullores së Punës, që qartazi përcakton se:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

c) kërkesa është qartazi e bazuar."

24. Në rastin konkret, parashtruesi ka dështuar të provojë që shkeljet e supozuara të të drejtave kushtetuese, të përmendura në kërkesë, përbëjnë elemente të pakontestuara të shkeljes/shkeljeve të të drejtave të tij. Andaj, njeri prej kritereve të pranueshmërisë është që kërkesa e parashtruesit duhet të jetë qartazi e bazuar në mënyrë që gjykata të lëshohet në meritat e saj.

25. Gjykata, lëshohet në themelësinë e kërkesës vetëm atëherë kur konsideron që pala ka plotësuar kriteret formale dhe procedurale për procedim të mëtejmë të kërkesës, prandaj nisur nga ky fakte gjykata nuk mund të lëshohet në meritat e rastit, nga shkaku se, pretendimet e shkeljeve Kushtetuese dhe të Konventës për të Drejtat të Njeriut nuk përmbushin kërkesat për pranueshmërinë e kërkesë sipas nenit 46 të Ligjit dhe rregullit 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së Punës të Gjykatës.

26. Andaj, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të vlerësojë ligjshmërinë dhe saktësinë e vendimeve të dhëna nga institucionet kompetente gjyqësore, përveç nëse ka prova bindëse se vendimet e tilla janë dhënë në një mënyrë dukshëm të padrejtë dhe të paqartë.

27. Detyrë e Gjykatës, lidhur me shkeljet e supozuara të të drejtave Kushtetuese është që të analizoje dhe vlerësojë nëse procedurat, në tërësinë e tyre kanë qenë të drejta dhe në pajtueshmëri me mbrojtjen shprehimisht të përcaktuar me Kushtetutë, pra, Gjykata Kushtetuese nuk është shkallë e katërt e apelit, nuk ka juridiksion

për të përsëritur procedurat gjyqësore ose t'i zëvendësojë vendimet e gjykatave të rregullta me konstatimet e veta.

28. Nuk ka prova se Gjykata e Qarkut në Prishtinë dhe Gjykata Supreme, kanë vlerësuar dhe analizuar provat të ofruara nga parashtruesi në mënyrë të pasaktë. Në të vërtetë, Parashtruesi i Kërkesës ka dështuar që të arsyetojë kërkesën e tij se Gjykatat e rregullta kanë bërë shkelje të nenit 21, 22, 24, 27, 29, 31 dhe 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

29. Për shkaqet e lartcekura, Gjykata gjen se Kërkesa e Parashtruesit është haptazi e pabazuar, prandaj hidhet poshtë si e papranueshme (*shih Vendim për Papranueshmëri Lënda nr. KI 13/09, Sevdail Avdyli kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. Nr. 533/2006 të datës 11 shtator 2006 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. Nr. 533/2006 të datës 2 dhjetor 2006, 17 qershor 2010*).

30. Nga sa më lartë, del se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbushë kriteret procedurale të lejueshmërisë, siç kërkohen me nenin 46 të Ligjit, si dhe rregullin 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së punës, për faktin se parashtruesi ka dështuar të provojë që shkeljet e supozuara të të drejtave kushtetuese, përbëjnë arsyet e mjaftueshme në mënyre që Gjykata të lëshohet më tutje në meritat e rastit.

31. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit të kërkesës konsiderohet e papranueshme në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, Rregullin 56 (2) të Rregullores së Punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 46 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, rregullin 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 8 maj 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar Raportues	**Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 51/11 datë 10 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Ac. nr. 359/10, të 14 dhjetorit 2010

Rasti KI 51/11, Aktgjykimi i 19 qershorit 2012
Fjalët kyçe: përmbarim, kërkesë individuale, mbrojtja e pronës, res judicata, e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, shkelje e të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi i kërkesës, z. Rexhep Rahimaj, e dorëzoi kërkesën bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke e kontestuar Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Ac. nr. 359/10, me pretendim se u mor në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-008 për Procedurën Përmbarimore dhe të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ, pasi që Gjykata e Qarkut e shtyu përmbarimin e vendimit *res judicata* të Gjykatës Komunale në Kamenicë, C. nr. 74/2007.

Lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, Gjykata vendosi që, bazuar në gjuhën e thjeshtë të nenit 113.7, kjo kërkesë ishte e pranueshme sepse në kërkesën e tanishme z. Rexhep Rahimaj e konteston kushtetutshmërinë e Vendimit Ac. Nr359/10 të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, të 14 dhjetorit 2010. Prandaj, parashtruesi i kërkesës duhet të konsiderohet palë e autorizuar, me të drejtën e adresimit të kësaj çështjeje në Gjykatë dhe se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, siç parashikohen me ligj, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës. Sa i përket kërkesës së nenit 49 të Ligjit se parashtruesi është dashur ta dorëzojë kërkesën brenda një periudhe prej katër (4) muajsh Gjykata përcaktoi se nga parashtresat e parashtruesit, parashtruesit i ishte dorëzuar vendimi i lartpërmendur i Gjykatës së Qarkut më 6 janar 2011, përderisa parashtruesi e kishte dorëzuar kërkesën në Gjykatë më 15 prill 2011, dmth. brenda afatit katër mujor, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit. Pastaj, parashtruesi i përcaktoi saktë cilat të drejta sipas Kushtetutës dhe KEDNJ pretendohen të jenë shkelur dhe nga

cili autoritet publik. Prandaj, Gjykata gjithashtu gjen se parashtruesi e ka plotësuar kushtin e nenit 48 të Ligjit.

Për meritat e kërkesës, Gjykata vëren se Gjykata e Qarkut në Gjilan ka vepruar në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës duke shtyrë vendimin për ekzekutimin e vendimit *res judicata* të Gjykatës Komunale. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se të drejtat e parashtruesit për një gjykim të drejtë dhe efektiv, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës janë shkelur dhe se vendimi *res judicata* i Gjykatës Komunale të Kamenicës, Vendimi C. nr. 74/2007 i datës 28 shtator 2007, duhet të ekzekutohet. Në arritjen e vendimin e saj, Gjykata gjithashtu u mbështet në vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që adresojnë çështjen e njëjtë ose të ngjashme. Gjykata deklaroi të pavlefshëm vendimin e Gjykatës së Qarkut dhe e ktheu në rivendosje në Gjykatën e Qarkut, në pajtim me aktgjykimin e kësaj gjykate.

Prishtinë, më 02 korrik 2012

Nr. ref: AGJ264/12

AKTGJYKIM

në

Rastin Nr. KI 51/11

Parashtruesi

Rexhep Rahimaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan,

Ac. nr. 359/10, të 14 dhjetorit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almira Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Cukalovic, gjyqtar

Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Rexhep Rahimaj, me vendbanim në Kamenicë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Ac. nr. 359/10, të 14 dhjetorit 2010, i cili i ishte dorëzuar më 6 janar 2011.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pohon që vendimi i kontestuar i Gjykatës së Qarkut në Gjilan shkel Ligjin Nr. 03/L-008 për procedurën përmbarimore, pasi e shtyu përmbarimin e vendimit *res judicata* të Gjykatës Komunale në Kamenicë, C. nr. 74/2007, të 28 shtatorit 2007.

4. Në këtë drejtim, parashtruesi pohon që i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), dhe me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009, (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56.1 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 15 prill 2011.

7. Më 19 prill 2011, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. 51/11, e caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. 51/11, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Enver Hasani dhe Gjyljeta Mushkolaj.

8. Më 2 qershor 2011, parashtruesi e dorëzoi Vendimin e Gjykatës Komunale në Kamenicë, C. nr. 74/2007, të 28 shtatorit 2007, siç u kërkua nga Gjykata. Parashtruesi gjithashtu e njoftoi Gjykatën se padia për pushimin e servitutit ende ishte pezull në të njëjtën gjykatë.

9. Më 8 korrik 2011, Gjykata Komunale në Kamenicë e njoftoi Gjykatën se procedura përmbarimore ishte shtyrë pasi të padituri kishin parashtruar padi të re në Gjykatën Komunale në Kamenicë për pushimin e servitutit.

10. Më 11 prill 2011, Gjykata e Qarkut në Gjilan e njoftoi Gjykatën se *"sipas informatave që i kemi marrë nga Gjykata Komunale në Kamenicë, Aktgjykimi i saj E. nr. 245/10 për lejimin e ekzekutimit sipas lëndës C. nr. 74/2007, është ende pezull, ngase lënda është në pritje për rivendosje nga ajo gjykatë"*.

11. Më 19. qershor 2012, Gjykata shqyrtoi dhe votoi lidhur me rastin.

Përmbledhje e fakteve

12. Në vitin 2007, parashtruesi ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Kamenicë me të cilën pretendonte se fqinjët e kishin penguar atë në shfrytëzimin e servitutit të tij, pra për të hyrë dhe dalë nga prona e tij.

13. Më 28 shtator 2007, Gjykata Komunale në Kamenicë, me Vendimin C. nr. 74/2007, aprovoi padinë e parashtruesit dhe u urdhëroi fqinjëve t'i mundësonin parashtruesit hyrjen dhe daljen nga prona/shtëpia e tij. Gjykata Komunale vërtetoi se fqinjët *"[...] kanë penguar [...]"parashtruesin e kërkesës "[...] në posedim-bashkëposedim të së drejtës së servitutit real, domethënë të shfrytëzojë rrugën në këmbë dhe me veturë, traktor apo makina tjera [...]", dmth fqinjët "[...] kanë kryer ndaj [...]"* parashtruesit të kërkesës *"[...] akt pengimi në posedim."* Fqinjët ushtruan ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut në Gjilan.

14. Më 17 dhjetor 2007, Gjykata e Qarkut në Gjilan, me Vendimin AC. nr. 395/07, aprovoi ankesën e fqinjëve dhe ndryshoi vendimin e Gjykatës Komunale për shkak se kjo e fundit nuk i kishte vlerësuar në mënyrë adekuate situatën faktike dhe provat. Për këtë arsye, parashtruesi kërkoi nga prokurori publik të inicionte kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Prokurori publik e paraqiti kërkesën më 28 shkurt 2008, duke theksuar që aktvendimi i Gjykatës së Qarkut *"[...] përmbante shkelje esenciale të dispozitave të procedurës sepse paditësit [fqinjëve] me veprim të kundërligjshëm të gjykatës [Gjykatës Komunale], me mosdorëzim, nuk iu mundësua të deklarohet lidhur me provat [...]".*

15. Më 10 qershorit 2009, Gjykata Supreme me Vendimin Mlc. nr. 11/2008 e ndryshoi Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Ac. nr. 395, të 17 dhjetorit 2007, dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Kamenicë, C. nr. 74/2007, të 28 shtatorit 2007, me të cilin vërtetohej se fqinjët *"[...] kanë*

penguar [...]"parashtruesin e kërkesës "[...] në posedim-bashkëposedim të së drejtës së servitutit real, domethënë të shfrytëzojë rrugën në këmbë dhe me veturë, traktor apo makina tjera [...]", dmth fqinjët "[...] kanë kryer ndaj [...]" parashtruesit të kërkesës "[...] akt pengimi në posedim.". Gjykata Supreme vërtetoi se " *Duke pasur parasysh se prova në të cilën mbështetet aktvendimi i kundërshtuar janë prova jorandësishme dhe fare nuk janë administruar nga gjykata e shkallës së parë ndërsa gjykata e shkallës së dytë aktvendimin e vet e mbështetë në fotodokumentacion pa e hapur shqyrtimin pranë gjykatës së shkallës së dytë dhe e vlerësuar nga Gjykata Supreme e Kosovës si provë e cila nuk do të ndihmonte në ndryshimin e gjendjes faktike të vërtetuar me aktvendimin e gjykatës të shkallës së parë, Gjykata Supreme e pranoj kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si të bazuar dhe e ndryshojë aktvendimin e kundërshtuarë, ashtu që refuzoi ankesën e paraqitur kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe vërtetoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë me vlerësim se i njëjti nuk përmbanë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore."*

16. Me vërtetimin e Gjykatës Supreme të vendimit të Gjykatës Komunale në Kamenicë, C. nr. 74/2007, të 28 shtatorit 2007, ky vendim bëhet i përmbarueshëm dhe *res judicata*..

17. Më 14 shtator 2010, Gjykata Komunale me vendimin E. nr. 245/10, miratoi kërkesën e parashtruesit për ekzekutim të vendimit të Gjykatës Komunale në Kamenicë, të 28 shtatorit 2007, C. nr. 74/2007, i cili ishte bërë *res judicata*, por fqinjët menjëherë e kundërshtuan ekzekutimin e këtij vendimi.

18. Më 7 tetor 2010, Gjykata Komunale me vendimin E. nr. 245/10 e hodhi poshtë si të pabazuar kundërshtimin e fqinjëve. Gjykata Komunale theksoi se "*Në nenin 55 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), në mënyrë taksative janë numruar shkaqet për të cilat mund të ushtrohet prapësimi, por meqenëse në rastin konkret gjykata nuk ka gjetur asnjë nga shkaqet ligjore për të cilat mund të ushtrohet dhe aprovohet prapësimi, në kuptim të dispozitave nga neni 57 i LPP-së, i*

njëjti është dashur të refuzohet dhe vendoset si në dispozitiv të këtij aktvendimi". Fqinjët më pas paraqitën ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut në Gjilan.

19. Më 14 dhjetor 2010, Gjykata e Qarkut në Gjilan me vendimin E.nr.145/10, e miratoi ankesën e fqinjëve dhe shtyu përmbarimin e vendimit të dhe shtyu ekzekutimin e vendimit e 7 tetorit 2010, të Gjykatës Komunale, derisa ajo gjykatë të vendoste lidhur me kërkesat e fqinjëve të 25 gushtit dhe 17 shtatorit 2010 për **pushimin** e servitutit të parashtruesit. Gjykata e Qarkut arsyetoi që, pasi kërkesat e fqinjëve të 25 gushtit dhe 17 shtatorit 2010 për **pushimin** e servitutit të parashtruesit ishin vendosur në të njëjtën dosje, vendimi i Gjykatës Komunale për ta hedhur poshtë ankesën e fqinjëve kundër ekzekutimit të vendimit me të cilin konfirmohej servituti nuk ishte i drejtë dhe se parashtruesi dhe fqinjët duhej të pritnin përfundimin e procedurave lidhur me **pushimin** e servitutit. Gjykata e Qarkut iu referua nenit 68 të Ligjit për procedurën përmbarimore, i cili parasheh që gjykata, me kërkesën e debitorit, mund ta shtyjë ekzekutimin në raste të tilla kur ekzistojnë shkaqet veçanërisht të arsyeshme që debitori, nëse ofron fakte të besueshme, do të pësonte dëme të mëdha për shkak të zbatimit të ekzekutimit.

Pretendimet e parashtruesit

20. Parashtruesi pohon që Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Ac. nr. 359/10, i 14 dhjetorit 2010, ia privoi të drejtën e posedimit, e cila u njoh dhe vërtetua me vendimin gjyqësor të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Kamenicë, C. nr. 74/2007, të 28 shtatorit 2007, i cili ishte bërë *res judicata*. Parashtruesi thekson se mohimi i një të drejte të tillë është shkelje thelbësore e të drejtës në pronë, të garantuar me nenin 46 [E Drejta në Pronë] të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, i cili përcakton që "Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij".

21. Përveç kësaj, parashtruesi pohon që dështimi për të vepruar në përputhje me një vendim gjyqësor të formës së prerë e bën të cenueshëm sundimin e ligjit në Kosovë dhe parimin e sigurisë juridike të qytetarëve. Kështu që, kjo është në kundërshtim me nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

22. Në lidhje me këtë, parashtruesi i referohet Aktgjykimit të Gjykatës në Rastin KI 08/09, të 17 dhjetorit 2010, ku Gjykata gjeti që "Sundimi i ligjit është një prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike, presupozon respektimin e parimit të sigurisë juridike, sidomos në lidhje me vendimet gjyqësore që kanë marrë formën *res judicata*. Asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një aktgjykimi përfundimtar dhe të plotfuqishëm thjesht për qëllimin e fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të freskët të rastit [...] Po të mos ishte kështu, kthimi prapa i vendimeve përfundimtare do të çonte në një klimë të përgjithshme të pasigurisë juridike, duke zvogëluar kështu besimin publik në sistemin gjyqësor.

23. Autoritetet kompetente, pra, kanë obligimin pozitiv që të organizojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv edhe në kuptimin ligjor edhe në atë praktik, dhe i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme [...]." [...]. Ekzekutimi i një aktgjykimi të marrë nga një gjykatë duhet shikuar si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenet e lartpërmendura [nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së]. [...] parashtruesit nuk do të duheshin privuar nga përfitimi i vendimit, i cili kishte marrë formë *res judicata*, në favorin e tyre".

24. Së fundi, parashtruesi kërkon që Gjykata ta miratojë padinë e tij, duke e shpallur jokushtetues Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, AC. nr. 359, të 14 dhjetorit 2010, dhe duke urdhëruar ekzekutimin e Vendimit të Gjykatës Komunale, C. nr. 74/2007, të 28 shtatorit 2007.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

25. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.

26. Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi është palë e autorizuar në kuptimin e nenit 113.7 Kushtetutës, i cili përcakton se: "*Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj*". Në lidhje me këtë, kërkesa është parashtruar në Gjykatë nga individi. Prandaj, parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, me të drejtën t'i parashtrojë këtë rast Gjykatës sipas nenit 113.7 të Kushtetutës.

27. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës, në pajtim me nenin 49 të Ligjit, duhet të paraqesë kërkesës në afat prej 4 muajsh pas vendimit të fundit gjyqësor. Më 14 dhjetor 2010, Gjykata e Qarkut nxori Vendimin AC. nr. 359/10, përderisa parashtruesi e pranoi këtë Vendim më 6 janar 2011. Parashtruesi i paraqiti kërkesën Gjykatës më 15 prill 2011. Kështu që, parashtruesi i ka plotësuar kushtet e afateve për parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

28. Përveç kësaj, në përputhshmëri me nenet 12 dhe 14 të LPP, Gjykata e Qarkut në Gjilan konsiderohet "instanca e fundit për të gjykuar përmbarimin e çështjes në fjalë". Si rrjedhojë, parashtruesi i kërkesës i ka shterur të gjitha mjetet ligjore të parapara me ligjet e Kosovës. *Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI*

29. Përfundimisht, neni 48 i Ligjit përcakton: *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."* Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Gjykatës së Qarkut AC. nr. 359/10, ku pretendohet se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e pronës] të Kushtetutës, si dhe neni 1 i Protokollit 1 të KEDNJ, pasi që me atë Vendimin

përmbarimi i Vendimit *res judicata* C.nr. 74/2007 të Gjykatës Komunale në Kamenicë të 28 shtatorit 2007 ishte shtyrë. Prandaj, parashtruesi i kërkesës ka plotësuar edhe këtë kusht.

30. Pasi që parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka respektuar afatet për parashtrimin e kërkesë në Gjykatë, i ka shterur të gjitha mjetet juridike dhe i ka qartësuar saktësisht shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive, përfshirë vendimin të cilin e konteston, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë.

Vlerësimi kushtetues i kërkesës

31. Pasi që parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet procedurale të pranueshmërisë, Gjykata duhet të shqyrtojë themelësinë e ankesës së parashtruesit.

32. Lidhur me parashtresën e parashtruesit, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, AC. nr. 359/10, të 14 dhjetorit 2010, me të cilin,me të cilin, në përputhshmëri me nenin 68 të LPP, shtyhet përmbarimi i vendimit të Gjykatës Komunale të 7 tetorit 2010.

33. Sa i përket ankesës së parashtruesit, Gjykata vëren që, më 14 shtator 2010, Gjykata Komunale lejoi ekzekutimin e vendimit të vet *res judicata*, të 28 shtatorit 2007, siç u kërkua nga parashtruesi, por që, siç u cek më sipër, Gjykata e Qarkut në Gjilan e pezulloi ekzekutimin për shkak se më 25 gusht dhe 17 shtator 2010, fqinjët e parashtruesit/të padituri kishin iniciuar procedurë të re në Gjykatën Komunale në Kamenicë, duke kërkuar kësaj radhe pushimin e servitutit të parashtruesit.

34. Kjo u vërtetua nga Kryetari i Gjykatës Komunale në Kamenicë në shkresën e tij, të 8 korrikut 2011, drejtuar kësaj Gjykate, në të cilën thuhej që procedura përmbarimore lidhur me vendimin

res judicata ishte shtyrë pasi të padituri [fqinjët e parashtruesit] kishin parashtruar padi të re për pushimin e servitutit të parashtruesit.

35. Lidhur me këtë,, parashtruesi pretendon se janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e pronës] e Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ sepse vendimi r*es judicata* i Gjykatës Komunale në Kamenicë, Vendimi C. nr. 74/2007 i datës 28 shtator 2007, nuk ishte ekzekutuar.

36. Prandaj, Gjykata gjithashtu duhet të gjykojë nëse Gjykata e Qarkut, me rastin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit *res judicata* të Gjykatës Komunale ka mundur ta bëjë atë pasi fqinjët/kundërshtarët e parashtruesit kishin parashtruar padi të re për pushimin e servitutit të parashtruesit.

37. Në këtë drejtim, Gjykata dëshiron të ritheksojë se gjetjet e saj në Rastin KI 08/09, të 17 shtatorit 2010, në të cilin përcaktoi që "Sundimi i ligjit është një prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike, presupozon respektimin e parimit të sigurisë juridike, sidomos në lidhje me vendimet gjyqësore që kanë marrë formën *res judicata*. Asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një aktgjykimi përfundimtar dhe të plotfuqishëm thjesht për qëllimin e fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të freskët të rastit (shih, *mutatis mutandis*, Sovtransavto Holding kundër Ukrainës, nr. 48553/99, GJEDNJ 2002-VII) [...]. Po të mos ishte kështu, kthimi prapa i vendimeve përfundimtare do të çonte në një klimë të përgjithshme të pasigurisë juridike, duke zvogëluar kështu besimin publik në sistemin gjyqësor".

38. Gjykata më tej konstatoi që: "Prandaj, autoritetet kompetente kanë obligimin pozitiv që të themelojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv edhe në kuptimin ligjor edhe në atë praktik, dhe i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme [...]." [...]. Ekzekutimi i një aktgjykimi të marrë nga një gjykatë duhet shikuar si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenet e lartpërmendura [nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së]. [...] parashtruesit nuk do të

duheshin privuar nga përfitimi i vendimit, i cili kishte marrë formë *res judicata*, në favorin e tyre".

39. Gjykata më tej vëren se në përputhshmëri me nenin 68 të LPP, shtyrja e përmbarimit mund të bëhet vetëm me kërkesën e kreditorit dhe jo me kërkesën e debitorit siç ka theksuar Gjykata e Qarkut në Gjilan, në vendimin e vet Ac. nr. 359/10 të 14 dhjetorit 2010. *Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI*

40. Sa i përket kërkesës në fjalë, Gjykata konsideron që Gjykata e Qarkut në Gjilan ka vepruar në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës duke shtyrë vendimin për ekzekutimin e vendimit *res judicata* të Gjykatës Komunale.

41. Në këto rrethana, Gjykata konstaton që janë shkelur të drejtat e parashtruesit për gjykim të drejtë dhe efektiv, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe se vendimi *res judicata* i Gjykatës Komunale në Kamenicë, Vendimi C.nr.74/2007, i datës 28. Shtator 2007, duhet përmbaruar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56 (1) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 19 qershor 2012,

VENDOSI

I. Njëzëri, TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;

II. Me shumicë votash, TA SHPALLË të pavlefshëm Vendimin Ac. nr. 359/10, të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, të 14 dhjetorit 2010, i cili shkel nenin 31 të Kushtetutës;

III. TA KTHEJË Vendimin Ac. nr. 359/10, të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, të 14 dhjetorit 2010, për rishqyrtim në pajtueshmëri me aktgjykimin e kësaj Gjykate në bazë të rregullit 74 (1) të Rregullores së Punës;

IV. Në bazë të rregullit 63 (5) të Rregullores së Punës, Gjykata e Qarkut në Gjilan duhet t'i dorëzojë informacione Gjykatës Kushtetuese për masat e ndërmarra në zbatimin e këtij aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese;

V. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

VI. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Prof. Dr. Enver Hasani

SHTOJCË

Dispozita të rëndësishme ligjore lidhur me vendimet gjyqësore:

Ligji 2008/03-L008 për Procedurën përmbarimore

Në Republikën e Kosovës, rregullat, procedurat e përmbarimit dhe sigurimi i vendimeve ligjore janë të rregulluara me Ligjin për Procedurën Përmbarimore (Ligji Nr. 2008/03-L008).

Neni 12 [Mjetet e goditjes së vendimeve]

"...

12.1 Në procedurën përmbarimore janë mjete të zakonshme goditjeje prapësimi dhe ankesa, poqëse nuk janë përjashtuar me këtë ligj.

12.2 Kundër aktvendimit të shkallës së parë mundë të paraqitet prapësimi, kurse ankesa vetëm në rastet e parapara me këtë ligj.

12.3 Prapësimi i paraqitet gjykatës që e ka dhënë aktvendimin brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit, po qe se me këtë ligj nuk është

paraparë ndryshe. Për prapësimin e paraqitur vendosë gjykata që e ka dhënë aktvendimin.

12.4 Kundër aktvendimit të dhënë lidhur me prapësimin mund të paraqitet ankesa brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit.

12.5 Për ankesën e paraqitur është kompetente të vendos gjykata e shkallës së dytë.

12.6 Prapësimi dhe ankesa nuk e ndalin procedurën përmbarimore, por përmbushja e kërkesës së propozuesit të përmbarimit shtyhet deri sa mos të vendosë gjykata e shkallës së parë për prapësimin e paraqitur. Përjashtimisht kur me titullin ekzekutiv është caktuar detyrimi i ushqimit ligjor, apo kur përmbarimi kryhet duke u kaluar të hollat nga llogaria e transaksionit të personit juridik në llogarinë e llojit të njëjtë të propozuesit të përmbarimit, por edhe në rastet tjera të parapara me këtë ligj, mund të realizohet kredia edhe para se të vendoset për prapësimin e debitorit.

12.7 Kundër konkluzionit si lloj i vendimit në parim nuk lejohet mjeti i goditje.

…"

Neni 13 [Forma e prerë dhe përmbarueshmëria]

"...

13.1 Aktvendimi kundër të cilit nuk është paraqitur brenda afatit ligjor prapësimi, bëhet i formës së prerë dhe i përmbarueshëm.

13.2 Aktvendimi kundër të cilit është refuzuar prapësimi bëhet i përmbarueshëm, e po qe se kundër tij nuk është e lejueshme ankesa, ai bëhet edhe i formës së prerë.

13.3 Aktvendimi me të cilin është refuzuar prapësimi bëhet i formës së prerë po qe se kundër tij nuk paraqitet ankesë brenda afatit ligjor, ose në qoftë se ankesa e paraqitur refuzohet si e pathemeltë.

13.4 Po qe se me këtë ligj është paraparë se kundër aktvendimit të shkallës së parë mund të paraqitet ankesa në vend të prapësimit, atëherë aktvendimi i tillë bëhet përmbarimore, kurse i formës së prerë po qe se nuk paraqitet ankesa brenda afatit ligjor, ose kur ankesa e paraqitur refuzohet si e pabazë.
..."

Neni 14 [Mjetet e goditjes së jashtëzakonshme]

"...

14.1 Kundër aktvendimit të nxjerrë në formë të prerë në procedurën përmbarimore dhe të sigurimit nuk lejohet revizioni as përsëritja e procedurës.

14.2 Kthimi në gjendjen e mëparshme lejohet vetëm në rast të mosruajtjes së afatit për paraqitjen e prapësimit dhe të

ankesës kundër aktvendimit të përmbarueshëm për përmbarimin e detyrueshëm.

…”

KREU VII Shtyrja, Pezullimi dhe Përfundimi i Përmbarimit

Neni 68 [Shtyrja e përmbarimit sipas kërkesës së kreditorit]

“…

68.1 Po qe se me ligj nuk është paraparë ndryshe, përmbarimi mund të shtyhet pjesërisht apo tërësisht vetëm sipas kërkesës së propozuesit të përmbarimit, por vetëm në qoftë se ende nuk ka filluar të zbatohet aktvendimi për përmbarimin. Po qe se në procedurën e përmbarimit marrin pjesë më tepër propozues të përmbarimit e vetëm ndonjëri nga ta e kërkon shtyrjen, atëherë gjykata e shtyn përmbarimin vetëm për aq sa i përket propozuesit të tillë të përmbarimit.

68.2 Po qe se zbatimi i përmbarimit ka filluar, kurse debitori brenda afatit të caktuar nga gjykata është deklaruar kundër shtyrjes, atëherë gjykata do të vendosë për arsyeshmërinë e kërkesës për shtyrje.

68.3 Në qoftë se me ligj është paraparë se përmbarimi mund të propozohet vetëm brenda afatit të caktuar,

atëherë propozuesi i përmbarimit mund të paraqesë kërkesën për shtyrje të përmbarimit vetëm brenda afatit të tillë.

…"

Neni 69 [Koha për të cilën shtyhet përmbarimi]

"…

69.1 Gjykata e shtyn përmbarimin për kohën që e ka caktuar propozuesi i ekzekutimit, apo për kohën të cilën e quan të arsyeshme duke i marrë parasysh rrethanat e rastit konkret.

69.2 Në qoftë se me ligj është paraparë afati brenda të cilit mund të propozohet ekzekutimi, atëherë shtyrja e tij nuk mund të bëhet tej afatit të tillë.

…"

Neni 70 [Vazhdimi i procedurës së shtyrë]

"…

Përmbarimi i shtyre vazhdohet sipas kërkesës së propozuesit të përmbarimit edhe para se të skadojë koha për të cilën është shtyer. Po qe se propozuesi i përmbarimit nuk e kërkon vazhdimin e procedurës as pas 15 ditësh, nga dita e skadimit të afatit për të cilin është shtyre përmbarimi, atëherë gjykata do ta përfundojë procedurën e ekzekutimit të shtyre me aktvendim me të cilin supozohet se është tërheq propozimi për përmbarim.

...”

KI 37/10 datë 26 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme Nr. SCEL-06-0016 të datës 10 tetor 2006 dhe Aktvendimit Nr. SCEL 06-016 të datës 31 janar 2007

Rasti KI 37/10, vendimi i 19 qershorit 2012.

Fjalët kyçe: Kërkesa individuale, diskriminimi etnik, e drejta e përdorimit të gjuhës, pasafatshme, ratione temporis.

Parashtruesit e kërkesës kanë parashtruar një kërkesë në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar aktgjykimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme nr. SCEL-06-0016, të datës 10 tetor 2006, si dhe vendimin nr. SCEL 06-016 të datës 31 janar 2007, duke kërkuar që Gjykata Kushtetuese të prishë aktgjykimin dhe vendimin, sepse mënyra e shpalljes në gazetat ditore që botohen në gjuhën serbe nuk ka qenë në përputhje me nenin 5 të Kushtetutës. Duke theksuar që nuk kanë mundur të informohen në gjuhën serbe, pasi që gazetat ditore *Danas dhe Blic* që shpërndahen në Republikën e Kosovës, nuk ekzistojnë në territorin e Komunës së Kllokotit. Për shkak të këtyre arsyeve, nuk kanë arritur që më kohë të paraqiten dhe të regjistrojnë të drejtat e tyre nga marrëdhënia e punës si dhe të përfshihen në listën e punëtorëve përkatës që përmbushin kushtet për të fituar 20% të aksioneve nga të ardhurat e realizuara me privatizimin e këtyre ndërmarrjeve.

Parashtruesit kundërshtojnë aktgjykimin e e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme nr. SCEL-06-0016, të datës 10 tetor 2006, si dhe vendimin nr. SCEL 06-016 të datës 31 janar 2007. Gjykata ka ardhur tek përfundimi që kërkesa ka të bëjë me ngjarjet para 15 qershorit të vitit 2008, gjegjësisht datës kur ka hyrë në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Në bazë të kësaj, kërkesa është e pasafatshme, si dhe për këtë, nuk është në përputhje "*ratione temporis*" me dispozitat e Kushtetutës dhe Ligjit. Për këto arsye, Gjykata ka vendosur që kërkesa është e papranueshme në pajtim me Rregullin 36. (3h) të Rregullores së Punës.

Mendime mospajtuese ndaj këtij vendimi kanë paraqitur gjyqtarët Ivan Čukalović dhe Altay Suroyi, të cilët konsiderojnë që bëhet fjalë

për një shkelje të vazhdueshme të të drejtave për përdorim të gjuhës, për të cilën arsye parashtruesit e kërkesës nuk kanë pasur mundësi që të shfrytëzojnë mjetin juridik brenda afatit.

Gjyqtarët Kushtetues Ivan Čukalović dhe Altay Suroyi theksojnë që nuk qëndrojnë pretendimet që rasti është i papranueshëm si *ratione temporis*, për shkak se refuzimi që punëtorët të përfshihen në listë është bërë më 15 prill 2010, derisa vendimi i AKP-së ndaj ankesës së punëtorëve është marrë më 29 tetor 2010, derisa Kushtetuta ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008.

Gjithashtu, gjyqtarët paraqesin qëndrimin e tyre që parashtruesve të kërkesës iu janë shkelur të drejtat e përdorimit të gjuhës sipas nenit 5, paragrafi 1:
"1. Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe.

2. Gjuha Turke, Boshnjake dhe ajo Rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj."

Si dhe neni 58, paragrafi 2:

"Republika e Kosovës do të promovoj frymën e tolerancës, dialogut dhe do të mbështesë pajtimin ndërmjet komuniteteve dhe do të respektoj standardet e përcaktuara me Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe me Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave."

Në bazë të këtyre, rrjedh që parashtruesit e kërkesës, për shkak të shkeljes së vazhdueshme të së drejtës për përdorim të gjuhës, e kanë pasur të pamundur jo vetëm që të informohen për t'u paraqitur në konkursin për përfshirje në listë, por edhe që të informohen për të drejtat e shfrytëzimit të mjeteve juridike.

Në bazë të këtyre, gjyqtarët konsiderojnë që parashtruesve të kërkesës iu janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 5, si dhe neni 58, paragrafi 2, gjë që më tutje ka prodhuar shkeljen e neneve 24, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në bazë të argumenteve të parashtruara me të drejtë, gjyqtarët konsiderojnë që kërkesa e punëtorëve të Njësisë Punuese Stacionar (Qendra për Shërim dhe Rehabilitim) është e pranueshme.

Prishtinë, 05 korrik 2012

Nr.Ref.RK264/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 37/10

Nebojša Stanojević, Dragan Marinković dhe 118 ish të punësuarit „N.SH. Banja e Kllokotit“

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme Nr. SCEL-06-0016 të datës 10 tetor 2006 dhe Aktvendimit Nr. SCEL 06-016 të datës 31 janar 2007

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almira Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Cukalovic, gjyqtar

Gjylieta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës janë:

1. Stanojević Nebojša,
2. Marinković Dragan
3. Bukelić Miodrag
4. Bocić Aleksandar
5. Cvetković Petar,
6. Simić Ilija
7. Spasić M. Slobodan
8. Stoiljković Trajan
9. Perić Ljubiša,
10. Stojanović Zoran,
11. Raković Novica
12. Perić Đoka
13. Nedeljković Milan
14. Tomić Trajan
15. Tomić Vesna
16. Zdravković S. Zoran
17. Nojković Vlasta
18. Bojić Stanimir
19. Zdravković Miroslava
20. Zdravković Nenad
21. Trajković M. Zoran
22. Cvetković (Marković) Deska
23. Marinković Slobodan
24. Ivković Srđan
25. Zdravković Dobri
26. Stanković Dušica
27. Antić Dragan
28. Spasić Milić
29. Vesić Ilija
30. Svilanović Stanislav
31. Mirković Zoran
32. Vesić Nataša
33. Spasić Mića
34. Aksić Živojin
35. Stojković Ivan
36. Radić Tihomir
37. Vasić P. Srećko
38. Stolić Miodrag
39. Vlajković Milan
40. Zdravković Živko
41. Cvetković Dragoljub
42. Marković Rodobljub
43. Milkić (Spasić) Slađa
44. Vesić (Simić) Biserka
45. Vasić B. Srećko
46. Vasić Bocka
47. Tomić Svetlana
48. Cvetković Trajan
49. Bogdanović Srđan
50. Nisić Ljubomir
51. Spasić Jadran
52. Spasić Boban
53. Cvetković Momčilo
54. Spasić Zoran
55. Vlajković Staniša
56. Mirković Nikola
57. Bogdanović Zvonko
58. Kecić Bogoslav
59. Dimić Čedomir
60. Kecić (Arsić) Blagica
61. Dimić Dobrila
62. Mirković Dragan
63. Simić Zoran
64. Vesić Lj. Srđan
65. Radić Ivica
66. Stolić Vesna
67. Radić Nenad
68. Savić Petar
69. Jovanović Ivica
70. Cvetković Božidar
71. Nojkić Tomislav
72. Stoiljković Zoran
73. Zdravković V. Zoran
74. Svilanović Nenad
75. Marinković Trajko
76. Marinković Saša
77. Vesić Olga
78. Kojić Nenad
79. Spasić Dragan
80. Nisić Ivan
81. Marinković Srećko
82. Marinković Vesna
83. Marinković (Kojić) Radmila
84. Kojić Tomislav
85. Vesić M. Srđan
86. Trajković Nebojša
87. Ristić (Maksimović) Mileva
88. Spasić J. Slobodan
89. Stević Vesko
90. Jovanović Svetlana
91. Maksimović Dragan
92. Stanković Jelena
93. Stoiljković Ivica
94. Pavić Zoran
95. Pavić Jovan
96. Mitić (Pavić) Sunčica
97. Savić Leposava
98. Zafirović Slobodanka
99. Tomić Zoran
100. Spasić Bogdan
101. Mikilić (Dinčić) Vesna
102. Savić Olivera
103. Stojanović Svetomir
104. Đorđević Žarko
105. Dimić Jadran
106. Zafirović Miodrag
107. Zafirović Todor
108. Stanković Srebrena
109. Vesić Ljubiša
110. Vasić (Cvetković) Snežana
111. Perić Slobodan
112. Bogdanović Milivoja
113. Bogdanović (Spasić) Radica
114. Cvetković T. Slobodan
115. Stanković Vlasta
116. Đorić Jovica
117. Arsić Nenad
118. Jovanović Slavica
119. Stanković Nebojša
120. Mirković Milorad

1. Në këtë raport, për hir të raportimit më të lehtë parashtruesit e kërkesës janë të listuar dhe kolektivisht mund të quhen, si: Nebojša Stanojević, Dragan Marinković dhe 118 ish të punësuarit e Ndërmarrjes Shoqërore Banja e Kllokotit nga Kllokoti. Në procedurat para Gjykatës Kushtetuese ata përfaqësohen nga Nebojša Stanojević dhe Dragan Marinković.

Vendimet e kontestuara

2. Kontestohen dy vendime të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: AKM)

   a. Aktgjykimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet lidhur me AKM nr. SCEL-06-0016 të datës 10 tetor 2006 si dhe
   b. Aktvendimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet lidhur me AKM nr. SCEL 06-016 të datës 31 janar 2007.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit e kërkesës i kontestojnë vendimet e lartpërmendura të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme duke mos përmendur ndonjë nen konkret të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: "Kushtetuta"). Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se është bërë shkelje e të drejtës në fushën e marrëdhënieve të punës (e drejta në kompensim prej 20% në procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore).

Baza juridike

4. Nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të datës 16 dhjetor 2008 (në tekstin e mëtejmë: "Ligji") dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: "Rregullorja e Punës").

Procedura para Gjykatës Kushtetuese

5. Parashtruesit e kërkesës më 2 qershor 2010 e parashtruan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: "Gjykata").

6. Më 4 prill 2011, Gjykata Kushtetuese me shkresën Nr.ref:649/11/r.l. ka kërkuar nga AKM dokumentacion dhe sqarime shtesë lidhur me procedurat e zbatuara me rastin e publikimeve ne gjuhën serbe.

7. Më 25 maj 2011, AKM së bashku me përgjigjen Nr.10/1 ka dorëzuar edhe udhëzimin e dhënë më 2004 nga ana e zyrës ligjore të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (në tekstin e mëtejmë:PSSP), si dhe listën e plotë të punëtorëve që i plotësojnë kushtet për të drejtën në pjesën e mjeteve nga privatizimi i Ndërmarrjes Shoqërore Banja e Kllokotit nga Kllokoti.

8. Më 19 qershor 2012, pas shqyrtimit të Raportit paraprak të gjyqtares Iliriana Islami, Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Snezhana Botusharova (kryesuese), Prof. Dr. Ivan Ćukalović dhe Mr. sc. Kadri Kryeziu, i propozoi gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

9. Ndërmarrja Shoqërore Banja e Kllokotit (në tekstin e mëtejmë: NSH Banja e Kllokotit) përbëhet nga dy njësi punuese:

   a. njësia punuese Fabrika e Ujit Mineral në Kllokot, dhe
   b. njësia punuese Stacionari (Qendra për Shërim dhe Rehabilitim) gjithashtu në Kllokot.

10. Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe plotësimeve në Rregulloren e UNMIK-ut 2004/45 me rastin e privatizimit të pjesës së parë NSH Banja e Kllokotit njësia punuese Fabrika e Ujit Mineral që është kryer më 24 nëntor 2005 AKM e ka përcaktuar listën e punëtorëve që i plotësojnë kushtet të cilëve sipas Rregullores u takon pjesa e 20% të mjeteve nga privatizimi i NSH Banja e Kllokotit.

11. Lista e punëtorëve që i plotësojnë kushtet është publikuar në të përditshmet në gjuhën shqipe *Zëri dhe Koha Ditore* më 28 dhe 29 qershor dhe më 1 korrik 2006, përderisa në gjuhën serbe lista e punëtorëve që i plotësojnë kushtet është publikuar më 28 dhe 29 qershor e 1 korrik 2006 në të përditshmet *Danas dhe Blic*.

12. Së bashku me listën e punëtorëve që i plotësojnë kushtet, të cilëve ju takon pjesa e 20% të mjeteve nga privatizimi, është publikuar edhe udhëzimi lidhur me mjetet ligjore për punëtorët që nuk janë përfshirë në listën e publikuar, të cilët kanë pasur mundësinë t'i paraqesin ankesë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit të paraparë prej 20 ditësh i cili ka skaduar më 24 korrik 2006.

13. Një numër i madh i punëtorëve, të cilët nuk ishin përfshirë në listën e punëtorëve që i plotësojnë kushtet nga ana e AKM-së,

iniciuan procedurë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që kanë të bëjnë me AKM, në mënyrë që të përfshiheshin në listën e punëtorëve që i plotësojnë kushtet.

14. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me AKM-në, për të gjitha ankesat e parashkruara vendosi me Aktgjykimin nr. SCEL-06-0016 të datës 10 tetor 2006, me të cilin urdhëron që AKM të përfshijë 12 (dymbëdhjetë) punëtorë në listën e punëtorëve që i plotësojnë kushtet dhe me të njëjtin aktgjykim hedh poshtë kërkesat e 8 (tetë) punëtorëve si **të pabaza**, ngaqë nuk kishin plotësuar kushtet e parapara me Rregullore për përfshirje në listën e punëtorëve që i plotësojnë kushtet.

15. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me AKM-në për të gjitha ankesat e parashkruara vendosi me Aktvendimin nr. SCEL 06-016 të 31 janarit 2007, me të cilin Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme i hodhi poshtë ankesat e 135 (njëqind e tridhjetë e pesë) punëtorëve si **të parashkruara** për shkak se janë parashtruar pas 24 korrikut 2006, kur kishte kaluar afati i paraparë për parashtrimin e ankesave.

16. Me të njëjtin vendim Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme vëren se ekziston një numër i madh i ankesave të dorëzuara pas afatit të paraparë me ligj dhe sugjeron se lista punëtorëve që i plotësojnë kushtet ndoshta nuk është shpallur në mënyrë të efektshme dhe prandaj këshillon "*që **de jure condendo** të bëhet një qarkullim më efektiv dhe me përhapje më të gjerë të listës së punëtorëve që i plotësojnë kushtet në mesin e palëve mund të jenë potencialisht të dëmtuara*".

17. Më 13 prill 2010 është nënshkruar marrëveshja për privatizimin e pjesës së dytë të NSH Banja e Kllokotit - njësia punuese Stacionari (Qendra për Shërim dhe Rehabilitim), e shpërndarja e mjeteve të 20% është bërë sipas listës së punëtorëve që i plotësojnë kushtet të konfirmuar më parë nga ana e AKM-së

dhe miratuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme me Aktgjykimin Br.SCEL-06-0016 të 10 tetorit 2006.

18. Më 15 prill 2010 parashtruesit e kërkesës iu drejtuan me shkrim AKM-së me kërkesën që për pjesën e dytë të NSH Banja e Kllokotit njësia punuese Stacionari (Qendra për Shërim dhe Rehabilitim) duhet të përcaktohet lista e re e punëtorëve që i plotësojnë kushtet dhe kërkojnë që AKM t'i përfshijë parashtruesit e kërkesës në procesin e shpërndarjes së aksioneve të pjesës së dytë të ndërmarrjes.

19. Më 29 tetor 2010 në përgjigjen ndaj kërkesës për përfshirje në listën e punëtorëve që i plotësojnë kushtet, AKM-ja thekson se nuk mund t'i përfshijë parashtruesit e kërkesës në listën e punëtorëve që i plotësojnë kushtet ngase lista e punëtorëve që i plotësojnë kushtet është përcaktuar me rastin e privatizimit të pjesës së parë të NSH Banja e Kllokotit - njësia punuese Fabrika e Ujit Mineral.

20. Në vazhdim të përgjigjes së vet AKM pohon se me rastin e përcaktimit të listës së punëtorëve që i plotësojnë kushtet, AKM ka vepruar në pajtim me udhëzimin e dhënë në vitin 2004 nga ana e zyrës ligjore të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, në të cilin thuhet se "... nëse një ndërmarrje ka disa njësi organizative, atëherë lista e përbashkët bazohet në të gjitha njësitë organizative ndërsa data zyrtare e privatizimit konsiderohet data e privatizimit të pjesës së parë të asaj ndërmarrjeje."

21. Në fund AKM thekson se lista përfundimtare e punëtorëve që i plotësojnë kushtet përcaktohet sipas aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme Nr.SCEL-06-0016 të datës 10 tetor 2006, dhe se ai aktgjykim është i formës së prerë, detyrues dhe se kundër tij nuk mund të parashtrohet asnjë ankesë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me AKM-në nr. SCEL-06-0016 të datës 10 tetor 2006 dhe me Aktvendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me AKM-në nr. SCEL 06-016 të datës 31 janar 2007 i janë shkelur të drejtat në fushën e marrëdhënieve të punës.

23. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se janë dëbuar nga puna në periudhën Korrik-Gusht 1999 për shkak të diskriminimit etnik, se kurrë nuk i kanë marrë aktvendimet për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, se edhe pse i kanë plotësuar kushtet prej 3 e më shumë vjetësh përvojë pune, janë përjashtuar nga lista e punëtorëve që i plotësojnë kushtet për shkak të diskriminimit etnik.

24. Më tutje parashtruesit e kërkesës pohojnë se nuk kanë mundur të dorëzojnë brenda afatit të paraparë ankesat ndaj vendimit të AKM-së pasi që nuk kanë qenë të informuar në gjuhën serbe dhe si dëshmi e bashkëngjisin vërtetimin e "RADIO KLLOKOTIT" si të vetmin burim të informimit në gjuhën serbe në komunën e Kllokotit ku thuhet se ky radio stacion kurrë nuk kishte bërë një lajmërim të popullatës për privatizimin e NSH Banja e Kllokotit.

25. Njëkohësisht parashtruesit e kërkesës pohojnë se të përditshmet Danas dhe Blic nuk janë të përditshme që publikohen në Republikën e Kosovës, kështu që nuk ekzistojnë në territorin e komunës së Kllokotit.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë

26. Në mënyrë që kërkesa të jetë e pranueshme, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse Parashtruesi ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligjin dhe Rregulloren e Punës të Gjykatës Kushtetuese.

27. Sa i përket kërkesës së parashtruesve të kërkesës Gjykata i referohet rregullit 36. paragrafi 3 pika h) që parasheh:

> *„Një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese:*
>
> *h) kur kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën.“*

28. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesit e kanë dorëzuar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 2 qershor 2010, përderisa vendimi i fundit në lidhje me këtë rast, pra aktvendimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me AKM Nr. SCEL 06-016 është marrë më 31 janar 2007. Kjo do të thotë se kërkesa ka të bëjë me ngjarje para 15 qershorit 2008, respektivisht para hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

29. Në bazë të kësaj, kërkesa nuk është "*ratione temporis*" në pajtim me dispozitat e Kushtetutës dhe Ligjit (shih *mutatis mutandis* Blečić kundër Kroacisë, kërkesa nr. 59532/00, *Aktgjykimi* i GJEDNJ-së, 29 korrik 2004), prandaj përfundohet se kërkesa është e vjetruar.

30. Rrjedhimisht, kërkesa është e papranueshme sipas rregullit 36 (3h) të Rregullores së Punës i cili parasheh: „*Një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese: h) kur kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën.“*

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullin 36 (3h) të Rregullores

së Punës, në seancën e mbajtur më 19 qershor 2012, me shumicë votash

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar Raportues **Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**

Dr.Iliriana Islami Prof. Dr. Enver Hasani

KI 30/12 datë 12 korrik 2012- Kërkesa për vlerësimin e Kushtetutshmërisë të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.1496/2011 të datës 24 janar 2012

Rasti KI 30/12, vendimi i datës 3 korrik 2012

Fjalët kyçe; barazia para ligjit, kërkesë individuale, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. Nr. 1496/2011 të datës 24 janar 2012, në bazë të cilit parashtruesit të kërkesës i është refuzuar ankesa dhe është vërtetuar Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë E.nr 1168/10 , i datës 06.10.2011 e me të cilin "është konstatuar shitja e patundshmërisë së hipotekuar të hipotekëlënsit z.Murat Plakolli' kreditorit PRO CREDIT BANK me seli në Prishtinë, i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si në vijim: neni 21(parimet e përgjithshme),neni 24(barazia para ligjit)neni 54 (mbrojtja gjyqësore e të drejtave) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 8 i Deklaratës Universale për të Drejtat e njeriut.

Duke vendosur për kërkesën e parashtruesit, pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk gjeti elemente të arbitraritetit dhe as shkelje të supozuar të drejtave të njeriut sikur që parashtruesit e kërkesës kishin pretenduar.

Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se në perputhje me Rregullin 36 paragrafi 2 pika (c dhe d) të Rregullorës së Punës kërkesa është qartazi e pabazuar .

Prishtinë, më 06 korrik 2012

Nr. ref.: RK267/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 30/12

Parashtruesi

Afrim Kalaja

Kërkesa për vlerësimin e Kushtetutshmërisë të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.1496/2011 të datës 24 janar 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Z. Afrim Kalaja (më tutje: parashtruesi i kërkesës) nga f. Dabishefc, me banim në Prishtinë, rr. "Jakup Ferri", nr. 29.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik, me të cilin pretendohen shkeljet e të drejtave të garantuara me Kushtetutën e Kosovës, është Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.1496/2011 i 24 janarit 2012, për të cilin në formularin për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë pala nuk ka specifikuar datën e pranimit të tij

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) më 26 mars 2012 është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit

të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.1496/2011, në bazë të cilit parashtruesit të kërkesës i është refuzuar ankesa dhe është vërtetuar Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë E.nr 1168/10, i datës 6.10.2011 e me të cilin "është konstatuar shitja e patundshmërisë së hipotekuar të hipotekëlënsit z. Murat Plakolli' kreditorit PRO CREDIT BANK me seli në Prishtinë.

Baza ligjore

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2009, i hyrë në fuqi më 15 janar 2010 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe neni 54, 55 dhe 56 (2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 26 mars 2012, parashtruesi e dorëzoi Kërkesën në Gjykatë, dhe e njëjta u regjistrua në Gjykatë me nr KI30/12.

6. Më 27 mars 2012, me vendimin GJR KI30/12 Kryetari i Gjykatës caktoi Gjyqtar raportues, zëvendëskryetarin z. Kadri Kryeziu, ndërsa me vendimin KSH 30/12, Kolegjin shqyrtues në përbërje Robert Carolan, kryesues dhe Altay Suroy, gjyqtar, Prof. rr. Enver Hasani, gjyqtar si anëtarë të Kolegjit shqyrtues.

7. Më 5 qershor 2012, Gjykata Kushtetuese kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 5 qershor 2012 Gjykata njoftoi edhe Gjykatën e Qarkut në Prishtinë për regjistrimin e kërkesës duke kërkuar edhe përgjigje me shkrim lidhur me kërkesën, por nga kjo gjykatë

nuk kishte marrë asnjë koment me shkrim lidhur me këtë lëndë.

9. Më 20 qershor Gjykata Kushtetuese ka pranuar përgjigje nga Gjykata Komunale lidhur me rastin, ku shpjegohet kronologjia e lëndës dhe njëkohësisht bashkëngjiten vendimet gjyqësore të cilat Gjykata Kushtetuese tashmë i kishte në dosjen e lëndës të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës.

10. Më 3 korrik 2012, pas raportimit të Gjyqtarit raportues, zëvendëskryetarit z. Kadri Kryeziu Kolegji shqyrtues njëzëri i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 13 tetor 2008 ProCredit bank me seli pune në Prishtinë në cilësinë,e Kreditëdhënësit ka lidhur Kontratë Për Kredinë nr A-59246, me z. Afrim Kalaja-pronar i NTP ”Ideal” me seli pune në Prishtinë rr Drenica” nr 29,në cilësinë e kredimarrësit dhe z Murat Plakolli nga Prishtina me banim në rr.”Vëllezërit Fazliu” dhe znj. Hasime Kalaja nga Prishtina, rr ”Jakup Ferri” nr 29, në cilësinë e bashkëkredimarrësve në vlerë prej 100.000 (njëqindmijë)euro për një periudhë kohore prej 48 muajve.

12. Neni 8 i kësaj kontrate ka paraparë se me nënshkrimin e kësaj kontrate bashkëkredimarrësit marrin përgjegjësi të plotë në zbatimin e kontratës për kredinë në rast se kredimarrësi nuk përmbushë obligimet kontraktuale ndaj kredidhënësit.

13. Pjesë përbërëse e kësaj kontrate ishte edhe kontrata për Hipotekën e cila kishte objekt patundshmërinë e përshkruar si në fletën poseduese 4949- Komuna e Prishtinës, pronësi e z, Murat Plakolli e lidhur në mes të z. Murat Plakolli nga Prishtina si Hipotekëlënës, në emër të cilit me autorizim gjyqësor kishte nënshkruar z. Muhamet Plakolli dhe .dhe z. Afrim Kalaja

,pronar i NTP ”Ideal”në cilësinë e kredimarrësit ,me të cilën hipotekë sigurohej kredia. kryesore në të cilën

14. Më 20 maj 2010 pas konstatimit se kredia nuk po paguhej sipas kushteve të parapara me kontratën për kredinë ProCredit Bank në cilësinë e kreditëdhënësit në Gjykatën Komunale në Prishtinë paraqet **Propozimin për Ekzekutim në Paluejtshmëri-Hipotekë** e cila ishte objekt i kontratës mbi hipotekën**.**

15. Më 17 maj 2011 në Gjykatën Komunale në Prishtinë është mbajtur seanca publike sipas propozimit të kreditorit ProCredit Bank në të cilin ka marrë pjesë z. Kalaja në cilësinë e debitorit ndërsa z. Murat Plakolli dhe znj Hasime Kalaja edhe pse kishin marrë ftesat nuk ishin paraqitur në Gjykatë .Nga kopja e procesverbalit konstatohet se z,Afrim Kalaja kishte deklaruar se ai ka marrë kredinë në shumën e theksuar në kontratë për kredinë por pasi ka rënë në krizë financiare nuk ka mundësi ta paguaj atë,

16. Po të njëjtën ditë, pra 17 maj 2011 Gjykata Komunale ka nxjerrë konkluzion mbi shitjen dhe ka caktuar shitjen e parë publike me ankand publik në patundshmërinë e debitorit z. Murat Plakollit. Gjykata kishte theksuar se ”kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa”

17. Nga procesverbalet e Gjykatës Komunale në Prishtinë, të mbajtura me rastin e Ankandeve Publike për shitje, konstatohet se janë mbajtur tri ankande të tilla publike dhe atë me 21.07.2011, më 12.09.2011 dhe përfundimisht me 06 10.2011 ku u mbajt edhe seanca e shitjes së patundshmërisë. Gjykata kushtetuese gjithashtu konstaton se me rastin e mbajtjes së seancës së parë debitori-kredimarrësi z. Afrim Kalaja kishte deklaruar se garantuesi-hipoteklënësi z.Murat Plakolli kishte vdekur dhe për këtë ka deponuar certifikatën e vdekjes duke kërkuar njëkohësisht ndryshimin e objektit të hipotekës por kjo gjë nuk u pranua nga kreditori dhe Gjykata Komunale caktoj

një përfaqësues të përkohshëm ligjor –avokat z. Naser Peci të mbrojë interesat e z. Plakolli në këtë proces.

18. Në dy ankandet e para publike nuk kishte pasur asnjë ofertues për të blerë paluejtshmërinë e hipotekuar kështu që në secilin ankand pasues është ulur vlera e pasurisë së hipotekuar.

19. Më 06 tetor 2011 Gjykata Komunale në Prishtinë ka nxjerrë Aktvendimin E.nr.1168/10 me të cilin në pikën I –Konstatohet se i është Shitur kreditorit ProCreditbank si ofertues i vetëm - patundshmëria e hipotekëlënësit z. Murat Plakolli e identifikuar në mbi të drejtat e pronës nr UL-71914059-04949 e cila gjendet në ngastrën kadastrale 1994-0 me kulturë shtëpi oborr" në Prishtinë ZK Kolonia e Re në sipërfaqe prej 224 m² në shumën prej 30.000 (tridhjetëmijë euro). Gjithashtu në pikën II janë urdhëruar debitorët që paluejtshmërinë t`ia dorëzojnë në posedim Kreditorit në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi.

20. Kundër këtij Aktvendimi në afat ligjor ankesën Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kanë paraqitur z. Afrim kalaja –debitor në cilësinë e përfaqësuesit të NTP'Ideal" dhe z. Naser Peci Avokat në cilësinë e përfaqësuesit të përkohshëm të bashkëkredimarrësit –tani të ndjerit z. Murat Plakolli.

21. Më 24 janar 2012, Gjykata e qarkut ka nxjerrë Aktvendimin Ac.nr 1496/2011 me të cilin ka refuzuar si të pabazuara ankesat e parashtruesve njëkohësisht ka vërtetuar Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë E.nr.1168/2010 të datës 06.10 2011.

22. Në arsyetimin e këtij aktvendimi thuhet se Gjykata e Qarkut nuk ka gjetur fakte të jenë shkelur dispozitat e ligjit për Procedurën përmbarimore si dhe se çmimi përfundimtar i pronës së hipotekuar pas dy shitjeve të pasuksesshme është përcaktuar në kuptim të nenit 203.5 të Ligjit për Procedurës Përmbarimore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljet Kushtetuese

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin e kontestuar Vendimin, janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si në vijim: neni 21(parimet e përgjithshme),neni 24(barazia para ligjit)neni 54(mbrojtja gjyqësore e të drejtave) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 8 i Deklaratës Universale për të Drejtat e njeriut

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

24. Për të qenë në gjendje për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë,Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe rregulloren e punës së Gjykatës

25. Në lidhje me ketë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës që përcakton se:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë* ***shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale****,* ***të garantuara me Kushtetutë****, mirëpo* ***vetëm*** *pasi të* ***kenë shteruar të gjitha mjetet juridike*** *të përcaktuara me ligj".*

26. Gjykata me këtë rast merr parasysh edhe :

> Rregullin 36 të Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese ku përcaktohet:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

c) Kërkesa është qartas e bazuar.

27. Duke iu referuar kërkesës së parashtruesit dhe shkeljeve të pretenduara të drejtave Kushtetuese Gjykata kushtetuese thekson se:

28. Gjykata Kushtetuese nuk është Gjykatë e faktit, dhe me këtë rast dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike të drejtë dhe e të plotë është juridiksion i plotë i Gjykatave të rregullta si në rastin konkret që shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, ku në procedurë përmbarimore ishte kompetencë e Gjykatës Komunale dhe e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë që vendosën lidhur me pasurinë e hipotekuar sipas kontratës mbi Hipotekën, dhe se roli i sajë (i GJ. Kushtetuese) është vetëm qe ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veproje si "gjykate e shkalës se katërt", (shih, *mutatis mutandis,* i.a., Akdivar kunder Turqise, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65

29. Fakti i thjeshte se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund tu shërbejë atyre si e drejtë të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje te Nenit 31 te Kushtetutës (shih *mutatis mutandis* aktgjykim ECHR Appl. No. *5503/02,* Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykim i 26 korrikut 2005 ose , Tengerakis v. Qipro, nr. 35698/03, vendim i datës 9 nëntor 2006, § 74).

30. Në fakt, përpos pakënaqësisë me rezultatin përfundimtar të procesit gjyqësor, parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur argumente bindëse të cilat do të përkrahnin pretendimet e tij për shkeljen e të drejtës për barazi para ligjit, sepse në asnjë rast nuk ka paraqitur prova se është trajtuar i pabarabartë me

palën kundërshtare në proces gjyqësor dhe në asnjë mënyrë nuk kishte specifikuar se ku qëndron pabarazia e pretenduar.

31. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kishte qenë pjesë aktive e procesit gjyqësor në procedurë përmbarimore dhe nga shkresat që ka bashkangjitur me kërkesën nuk mund të konstatohet se ka dorëzuar prova që do të justifikonin shkeljen e nenit 54 të Kushtetutës së Kosovës (mbrojtja gjyqësore e të drejtave),

32. Për të deklaruar një Aktgjykim a Aktvendim të një autoriteti publik si jo kushtetues, parashtruesi i kërkesës do të duhej *prima facie* të tregojë se "Vendimi i autoritetit publik, si i tillë, do të jetë tregues i një shkeljeje të kërkesës për gjykim të drejtë, dhe nëse, paarsyeshmëria e atij vendimi është aq e dukshme sa që vendimi mund të konsiderohet si vendim ***tej mase arbitrar*** (shih GjEDNj, *Khamidov kundër Rusisë,* nr. 72118/01, aktgjykimi i datës 15 nëntor 2007, § 175.

33. Gjykata Kushtetuese në Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut Ac.nr 1496/2011 të datës 24. janar. 2012 nuk gjeti elemente të arbitraritetit dhe as shkelje të supozuar të drejtave të njeriut sikur që parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar.

34. Në këto rrethana parashtruesi i kërkesës nuk ka "argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij" dhe nuk mund të konstatohet se kërkesa ishte e bazuar andaj,Gjykata në përputhje me rregullin 36 paragrafi 2 pika c dhe d , gjen se kërkesën duhet ta refuzoj si qartas të pabazuar.,dhe rrjedhimisht

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e mbajtur me 3 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Mr.sc.Kadri Kryeziu Prof. Dr. Enver Hasani

KI 49/12 datë 12 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Pkl. nr. 135/09 të 22 shkurtit 2011

Rasti KI 49/2012, vendimi i datës 3 korrik 2012
Fjalët kyçe:Kontest administrativ, kërkesa individuale, kërkesa qartazi e pabazuar.

Parashtruesi e kishte dorëzuar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke pretenduar se me vendimet gjyqësorë atij i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me: Nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], Nenin 24.1, 2 [Barazia para Ligjit], Nenin 31.2 [E drejta për Gjykim të Drejte dhe të paanshëm]; dhe Nenin 102.3 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata në këtë rast kishte vlerësuar që parashtruesi në të vërtet kishte dështuar të provojë se nga rrethanat objektive, pa fajin e tij, është penguar që ta parashtrojë kërkesën e tij në kohë, prandaj, barra e të provuarit bie mbi palën/palët që parashtrojnë kërkesat e tyre në Gjykatë. Gjykata me tutje kishte theksuar se Pala nuk mund ta arsyetojë vonesën e parashtrimit të kërkesës vetëm për qëllime të përfitimit të rishqyrtimit të çështjes së tij, pa e mbështetur atë me prova, që vërtet do ta arsyetonin shkakun për humbjen e afatit që është paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës.

Prishtinë, më 06 korrik 2012

Nr. ref.: RK266/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 49/12

Parashtruesi

Muzafer Hetemi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Pkl. nr. 135/09 të 22 shkurtit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Muzafer Hetemi nga Ferizaj, me vendbanim të përkohshëm në Arlesheim të Zvicrës, i përfaqësuar nga z. Fatmir Bajraktari, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi gjyqësor i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Pkl. nr. 135/09 i 22 shkurtit 2011, të cilin përfaqësuesi i parashtruesit e pranoi më 3 mars 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: "Gjykata") i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl. nr. 135/09 i 22 shkurtit 2011, që ka të bëjë me shkeljen e supozuar të Nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenit 24.1, 2 [Barazia para Ligjit], nenit 31.2 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: "Kushtetuta").

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 28 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në gjykatë

5. Më 8 maj 2012, parashtruesi përmes postës elektronike e dorëzoi Kërkesën në Gjykatë.

6. Më 11 maj 2012, përfaqësuesi i parashtruesit ka dorëzuar dëshmi që provon se i njëjti është i autorizuar që ta përfaqësoi parashtruesin e kërkesës në këtë çështje juridike.

7. Më 22 maj 2012, Kryetari, me vendimin Nr. GJR. 49/12, caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar Raportues. Po të njëjtën ditë, Kryetari, me vendimin Nr. KSH. 49/12, caktoi Kolegjin Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: 1. Ivan Čukalović (kryesues) 2. Dr. Gjyljeta Mushkolaj (anëtare) dhe 3. Dr. Iliriana Islami (anëtare).

8. Më 19 maj 2012 Gjykata, përmes Sekretares së Përgjithshme njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës dhe kërkoi nga i njëjti dokumentacion shtesë. Të njëjtën datë për regjistrimin e kërkesës është njoftuar gjithashtu dhe Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.

9. Më 4 qershor 2012, përfaqësuesi i parashtruesit të Kërkesës dorëzoi dokumentacion shtesë lidhur me rastin.

10. Më 12 qershor 2012, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës dhe Gjykatën Supreme, për regjistrimin e kërkesës.

11. Më 2 korri 2012, Kryetari, me vendimin Nr. KSH. 49/12, riemëroj Kolegjin Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: 1. Ivan Čukalović (kryesues), ndërsa, gjyqtaret Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami u zëvendësuan me gjyqtaret 2. Robert Carolan (anëtar) dhe 3. Prof. Dr. Enver Hasani, (anëtar), sepse gjyqtareve në fjalë ju kishte përfunduar mandati si Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese më 26 qershor 2012.

12. Më 3 korrik 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e faktesh

13. Parashtruesi i kërkesës që nga viti 1987, kishte punuar si Gjyqtar në Gjykatën Komunale në Ferizaj, me pas ka emigruar në Zvicër dhe serish është kthyer në Kosovë, ku dhe ka filluar ushtrimin e profesionit të Gjyqtarit në Gjykatën Komunale të Ferizajt.

14. Më 23 prill 2009 Gjykata e Komunale në Prizren, me Aktgjykimin P. nr. 99/2009, shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës, në bazë të nenit 343 paragrafi 2 te KPK-së për vepër penale të ngarkuar marrje e ryshfetit dhe është dënuar me katër (4) muaj burgim. Kundër këtij aktgjykimi, përfaqësuesi i parashtruesit (mbrojtësi), ka ushtruar ankese në Gjykatën e Qarkut në Prizren, përmes kësaj gjykate për shkak te shkeljeve esenciale te dispozitave të procedurës penale.

15. Më 23 tetor 2009 Gjykata e Qarkut në Prizren, nxori Aktgjykimin Ap. nr. 97/2009, me ç'rast refuzoi si të pa bazë ankesën e përfaqësuesit të parashtruesit (mbrojtësit), gjithashtu dhe ankesën e Prokurorit Special të Republikës së Kosovës në Prishtinë, vërtetoj kështu Aktgjykimin e shkalles së parë P. nr. 99/2009 të 23 prillit 2009, ku sipas vlerësimit të kësaj gjykate,

shkalla e parë nuk kishte lëshuar aktgjykim me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, siç pretendonte mbrojtësi i parashtruesit në ankesën e tij.

16. Më 20 nëntor 2009, i pakënaqur me Aktgjykimin e shkallës së pare P. nr. 99/2009 të 23 prillit 20009 dhe aktgjykimin e shkallës së dytë Ap. nr. 97/2009 të 23 tetorit 2009, përfaqësuesi i parashtruesit kishte bërë "kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë" në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës.

17. Më 22 shkurt 2011 Gjykata Supreme e Kosovës, bazuar në kërkesën e përfaqësuesit të parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë, nxori Aktgjykimin Pkl nr. 135/2009, me ç'rast refuzoi si të pabazuar "kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë", duke vlerësuar që shkalla e parë dhe shkalla e dytë, kanë konstatuar drejt faktin.

18. Më 8 maj 2011, parashtruesi i pakënaqur me vendimet e instancave të rregullta gjyqësore, përfundimisht kishte vendosur që të dorëzojë, në Gjykatën Kushtetuese, kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PKl. nr. 135/09 të 22 shkurtit 2011.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet gjyqësorë të njëjtit i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me: Nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], Nenin 24.1, 2 [Barazia para Ligjit], Nenin 31.2 [E drejta për Gjykim të Drejte dhe të paanshëm]; dhe Nenin 102.3 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

20. Parashtruesi, ndër të tjera, ka kërkuar kthim në gjendjen e mëparshme bazuar në nenin 50 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret procedurale për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, e që specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregullore të punës të Gjykatës.

22. Nga shkresat e lëndës vërehet qartë se vendimi i fundi për rastin e parashtruesit është aktgjykimi i Gjykatës Supreme Pkl. nr. 135/2011 i 22 shkurtit 2011, të cilin parashtruesi e pranoi më 3 mars 2011, ndërsa parashtruesi kërkesën në Gjykatë e dorëzoi më 8 maj 2011, që nënkupton se kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit 4 mujor siç parashihet me Ligj dhe Rregullore të punesë.

23. Sa i përket parashtrimit të kërkesës brenda afatit kohorë, Gjykata i referohet Nenit 49 të Ligjit që nënvizon se:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht."*

24. Parashtruesi duke qenë i vetëdijshëm për parashtrimin e kërkesës pas afatit të paraparë me ligj, ndër të tjera nga Gjykata Kushtetuese ka kërkuar "kthim në gjendje të mëparshëm" bazuar në nenin 50 të Ligjit, që nënvizon se:

> *"Nëse parashtruesi pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, Gjykata Kushtetuese ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme. Parashtruesi ka për detyrë të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë*

(15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës dhe të arsyetojë kërkesën në fjalë[.. .].

25. Lidhur me këtë, Gjykata vlerëson që parashtruesi në të vërtet ka dështuar të provojë se nga rrethanat objektive, pa fajin e tij, është penguar që ta parashtrojë kërkesën e tij në kohë, prandaj, barra e të provuarit bie mbi palën/palët që parashtrojnë kërkesat e tyre në Gjykatë. Pala nuk mund ta arsyetojë vonesën e parashtrimit të kërkesës vetëm për qëllime të përfitimit të rishqyrtimit të çështjes së tij, pa e mbështetur atë me prova, që vërtet do ta arsyetonin shkakun për humbjen e afatit që është paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës.

26. Gjykata, do ta konsiderojë kërkesën e parashtruesit, si të jashtëafatshme, nga shkaku se parashtruesi ka dështuar të arsyetojë vonesën e parashtrimit të saj në kohë, siç kërkohet me nenin 50, që bën përjashtim nga kërkesat e nenit 49 të Ligjit.

27. Përfundimisht, nga arsyet e lartcekura, del se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret për pranueshmëri, siç kërkohen me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36.1 pika (b) të Rregullores së punës. Prandaj, kërkesa e parashtruesit konsiderohet e jashtëafatshme dhe hedhet poshtë si e papranueshme.

28. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit të kërkesës konsiderohet e papranueshme në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, Rregullin 52.2 të Rregullores së Punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, më 3 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues	**Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 34/12 datë 16 korrik 2012- Kërkesë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës A. nr. 29/2011 të 15 shkurtit 2011

Rasti KI 34/2012, vendimi i datës 3 korrik 2012
Fjalët kyçe:Kontest administrativ, E drejta për pension për personat me aftësi te kufizuara, kërkesa individuale, kërkesa e paafatshme.

Parashtruesja e kishte dorëzuar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke pretenduar se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme A. nr. 29/2011 të 15 shkurtit 2011, i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me: Nenin 51.2 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale], Kapitullin VII, [Sistemi i Drejtësisë], Nenin 102 paragrafi 3 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], Nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejte i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtarë]; dhe Nenin 13 [Kartës Sociale].

Gjykata, në këtë rast konstatoi se parashtruesja, nuk ka arsyetuar në asnjë mënyrës vonesën e parashtrimit të kërkesës, andaj, barra e të provuarit bie mbi palët që parashtrojnë kërkesat e tyre në Gjykatë, nga ky këndvështrim, Gjykata, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës kishte konsideruar se kërkesa është e paafatshme dhe si të tille e kishte hedhur poshtë si të papranueshme.

Prishtinë, më 06 korrik 2012

Nr. ref. RK265/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 34/12

Parashtruesja

Hala Krasniqi

Kërkesë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës A. nr. 29/2011 të 15 shkurtit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKES SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almira Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesja e Kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Hala Krasniqi nga fshati Martinaj/Plavë, Republika e Malit të Zi, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë.

Vendimi gjyqësor i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik me të cilin pretendohen shkeljet e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: "Kushtetuta) është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr. 29/2011 i 15 shkurtit 2011 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), të cilin parashtruesja e ka pranuar më 20 maj 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës së parashtruar më 28 mars 2012 në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: "Gjykata) është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. nr. 29/2011 të 15 shkurtit 2011**,** sa i përket shkeljes së të drejtës së parashtruesit për pension invalidor.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 16 dhjetorit 2008, i hyrë në fuqi më 15 janar 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe Rregulli 28 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Ankesa e parashtrueses

5. Parashtruesja e kërkesës ankohet se Komisionet mjekësore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejmë: MPMS) ia kanë refuzuar në mënyrë joligjore të "drejtën për pension të personave me aftësi të kufizuara" edhe pse parashtruesja pretendon se i plotësonte kushtet për një pension të tillë, ndërsa, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin A. nr. 29/2011 të 15 shkurtit 2011, duke refuzuar padinë e saj lidhur me këtë çështje pretendon se ka bërë shkelje të të drejtave të saja kushtetuese, sepse, siç pohon parashtruesja, ajo nuk posedon aftësi për punë dhe këtë e ka provuar me dokumentacion mjekësor.

Procedura në Gjykatë

6. Më 28 mars 2012 Gjykata Kushtuese pranoi kërkesën e znj. Hala Krasniqi dhe e regjistroi atë me nr. KI 34/12.

7. Më 26 2012 Kryetari, me vendimin GJR. 34/12 caktoi gjyqtar raportues, gjyqtaren Iliriana Islami. Po të njëjtën ditë, Kryetari, me vendimin KSH. 34/12 caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues në përbërje të gjyqtareve: 1. Almiro Rodrigues (kryesues), 2. Mr. sc. Kadri Kryeziu (anëtar) dhe 3. Prof. Dr. Enver Hasani (anëtar).

8. Më 17 maj 2012 Gjykata, njoftoi parashtruesen e kërkesës, gjithashtu dhe Gjykatën Supreme, për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 2 korrik 2012 Kryetari, me vendimin GJR. 34/12 caktoi gjyqtar raportues, gjyqtaren Snezhana Botusharova, e cila zëvendëson gjyqtaren Iliriana Islami, sepse mandati i saj si gjyqtare në Gjykatë përfundoi më 26 qershor 2012.

10. Më 3 korrik 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 20 nëntor 2004, MPMS, përkatësisht Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: DAPK), kishte lëshuar Vendimin me numër të dosjes 5014327, në bazë të së cilit parashtrueses së kërkesës, iu kishte miratuar kërkesa për pension për persona me aftësi të kufizuara.

12. Më 28 prill 2010, DAPK, duke vepruar në bazë të ankesës së parashtrueses së kërkesës, nxori Aktvendimin me nr. të dosjes 5014327, me të cilin refuzoi kërkesën e parashtrueses. DAPK ka pohuar se parashtruesja "nuk kishte dëshmi të mjaftueshme për të qenë shfrytëzuese e pensionit për persona me aftësi të kufizuar dhe njëherësh kishte konstatuar se vendimi i shkallës së parë ishte i drejtë dhe i bazuar në ligj".

13. Më 31 maj 2010, parashtruesja, kishte paraqitur Padi në Gjykatën Supreme, kundër Aktvendimit me nr. të dosjes 5014327 të DAPK-së.

14. Më 8 shtator 2010, Gjykata Supreme, duke vepruar sipas padisë së parashtruar nga parashtruesja e kërkesës për inicimin e Konfliktit Administrativ, nxori Aktgjykimin A.nr.516/2010. Më ketë rast aprovoi padinë parashtrueses dhe anuloi Aktvendimin e Këshillit të Ankesave të MPMS me nr të dosjes 5014327 të 28 prillit 2010, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të nenit 84.2 pika c dhe nenit 85.1 pika a, të Ligjit për Procedurës Administrative.

15. Më 24 nëntor 2010, MPMS, përkatësisht, Këshilli i Ankesave në kuadër të DAPK, për të dytën herë, nxori Aktvendim me numër të dosjes 5014327, me ç'rast refuzoi sërish ankesën e parashtrueses së kërkesës, duke e lënë në fuqi vendimin e komisionit mjekësor të shkallës së parë të 28 prillit 2010. Kundër këtij aktvendimi parashtruesja ka ushtruar padi për inicimin e konfliktit administrativ në Gjykatën Suprem.

16. Më 15 shkurt 2011, Gjykata Supreme, nxori Aktgjykimin A.nr.29/2011. Me këtë aktgjykim e njëjta refuzoi padinë e ushtruar nga parashtruesja, me arsyetimin se, komisionet mjekësore të autorizuara me ligj kishin vërtetuar se te parashtruesja (paditësja) nuk ekziston aftësia e kufizuar për punë, dhe se organet administrative drejt kanë zbatuar dispozitën e nenit 3 të Ligjit për Konfliktin Administrative.

Pretendimet e parashtrueses

17. Parashtruesja e kërkesës, pretendon se, me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme A. nr. 29/2011 të 15 shkurtit 2011, i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me: Nenin 51.2 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale], Kapitullin VII, [Sistemi i Drejtësisë], Nenin 102 paragrafi 3 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], Nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejte i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtarë]; dhe Nenin 13 [Kartës Sociale].

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

18. Në mënyrë që Gjykata, të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtrueses, duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kriteret procedurale për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregulloren e punës së Gjykatës.

19. Gjykata, nga shkresat e lëndës, vëren që vendimi i kontestuar nga parashtruesja, është Aktgjykimi A. nr.29/2011, i Gjykatës Supreme miratuar më 15 shkurt 2011, i cili i është dorëzuar parashtrueses më 20 maj 2010. Ndërsa, parashtruesja kërkesën në Gjykatë e dorëzoi më 28 mars 2012, që nënkupton se kërkesa është dorëzuar jashtë afatit katër (4) mujor, të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, sepse kërkesa është dashur që të dorëzohej në Gjykatën Kushtetuese, jo me vone së 20 shtatori i vitit 2011.

20. Lidhur me këtë , Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

Neni 49 [Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [.. .]"

21. Parashtruesja, nuk ka arsyetuar në asnjë mënyrës vonesën e parashtrimit të kërkesës, andaj, barra e të provuarit bie mbi palët që parashtrojnë kërkesat e tyre në Gjykatë, nga ky këndvështrim, Gjykata, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, konsideron se kërkesa është e jashtë afatshme dhe si e tille hedhet poshtë si e papranueshme.

22. Rrjedhimisht, Kërkesa, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, Rregullin 56. (2) të Rregullores së Punës është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, më 3 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues	**Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 113/11 datë 16 qershor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë të aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës KRJA nr. 3/2010 të 4 majit 2011

Rasti KI 113/11, vendimi i 11 korrikut 2012

Fjalët kyçe: person juridik, e drejta për mjet juridik, tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), tatim mbi fitimin dhe tatimi në burim, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës e ka parashtruar kërkesën në bazë të nenit 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës së Kosovës duke kontestuar aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës KRJA nr. 3/2010 të 4 majit 2011 dhe është hedhur poshtë si i palejueshëm propozimi i parashtruesit të kërkesës që në bazë të ligjit të ri Gjykata Supreme edhe një herë të vendos në mënyrë meritore për të drejtën e tij.

Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se Ligji për Gjykatat e Rregullta nuk është ende në zbatim dhe se e vetmja gjykatë kompetente për çështje administrative si në shkallën e parë ashtu edhe në shkallën e dytë është Gjykata Supreme e Kosovës. Pra Gjykata Supreme e Kosovës ka qenë e obliguar që të vendosë në mënyrë meritore në lidhje me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në bazë të dispozitave të Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative i cili është në fuqi që nga 5 nëntori 2010 duke konsideruar se ky ligj është më i favorshëm për palën në procedurë.

Duke vendosur në lidhje me kërkesën e parashtruesit "DELOITTE KOSOVA" SHPK, pas shqyrtimit të procedurës në tërësi Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur se procedurat përkatëse pranë gjykatave të rregullta kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare . Rrjedhimisht Gjykata konkludoi se Gjykata Supreme në lidhje me pretendimet e njëjta të parashtruesit të kërkesës tashmë ishte deklaruar në mënyrë meritore me aktgjykim. Prandaj kërkesa është qartazi e pabazuar pasi që faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese.

Prishtina, më 9 korrik 2012

Nr. ref.: RK/269/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 113/11

Parashtruesi

"DELOITTE KOSOVA" SHPK

Vlerësim i kushtetutshmërisë të aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës

KRJA nr. 3/2010 të 4 majit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është "DELOITTE KOSOVA" - SHPK nga Prishtina, të cilën e përfaqëson avokati Bejtush Isufi, nga Prishtina, rr. Andrea Gropa nr. 29 , 10000 Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Kontestohet aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës KRJA nr.3/2010 i 4 majit 2011, me të cilin është hedhur poshtë kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A.nr.1713/2007 të 14 prillit 2009 si e papranueshme.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës konteston aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës KRJA nr.3/2010 të 4 majit 2011, duke pretenduar se është shkelur neni 32 [E drejta për mjete juridike] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke theksuar:

> *„Ligji i ri për Konfliktet Administrative është me i favorshëm për palën. Kjo për faktin se me Ligjin e vjetër mbi Konfliktet Administrative nuk është lejuar ky mjet juridik, të paktën sipas interpretimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa me ligjin e ri shprehimisht lejohet ky*

mjet juridik. Res ipsa loquitur. Ne këtë rast Gjykata Supreme është dashur që të aplikojë dispozitat e ligjit të ri dhe të lejojë Kërkesën për Rishqyrtim te Jashtëzakonshëm të Vendimit gjyqësor duke vendosur në mënyre meritore dhe jo siç ka vepruar duke ia mohuar Paraqitësit të kërkesës të drejtën e tij të garantuar me Nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës -të drejtën në mjetin juridik."

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56 paragrafin 2 të Rregullores.

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) më 16 gusht 2011.

6. Më 12 tetor 2011, Gjykata Kushtetuese e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës se është iniciuar procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë të vendimeve në lidhje me lëndën KI 113/11.

7. Më 2 korrik 2012, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Altay Suroy, Kolegji Shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe prof. Dr. Ivan Čukalović i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Këshilli i Pavarur për Rishqyrtime (në tekstin e mëtejmë KPR) me aktvendimin A. nr. 125/2007-ATK të 6 qershorit 2007 e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës ndaj aktvendimit të Administratës Tatimore të Kosovës (në tekstin e mëtejmë ATK) nr. 73/2007 të 6 prillit 2007 në lidhje me obligimin e pagesës së tatimit shtesë në kategorinë e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH), tatimit në fitim dhe tatimit në burim në bazë të raporteve të rivlerësimit.

9. Më 1 korrik 2007, Deloitte Kosova sh.p.k. (parashtruesi i kërkesës), ushtroi padi Gjykatën Supreme të Kosovës duke kërkuar anulimin e aktvendimit të KPR-së A. nr. 125/2007-ATK të 6 qershorit 2007. Në këtë padi, parashtruesi i kërkesës e kontestoi aktvendimin e KPR-së i cili në arsyetimin e aktvendimit thotë se kontratat për shërbime të nënshkruara nga parashtruesi i kërkesës dhe kompanitë e tjera trajtohen si kontratë e punës dhe jo si kontratë komerciale.

10. *Me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 1713/2007 të 14 prillit 2009 u hodh poshtë padia e parashtruesit të kërkesës me të njëjtin arsyetim që e kishte dhënë KPR-ja.*

11. *Në arsyetim Gjykata Supreme nxori përfundimin se, me gjithë faktin se dy persona juridikë kishin lidhur kontratë për shërbime, puna ishte kryer nga ana e individëve, gjë që mund të vërtetohet në bazë të specifikimeve të llogarisë. Në vijim konkludohet se këta individë kishin vepruar personalisht dhe jo në emër të kompanisë, duke vlerësuar se parashtruesi i kërkesës ka qenë i obliguar të kryejë pagesën e tatimit në burim dhe tatimit në të ardhura personale.*

12. *I pakënaqur me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 1713/2007 të 14 prillit 2009, parashtruesi i kërkesës i paraqiti Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm.*

13. *Duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të Gjykatës Supreme të*

Kosovës A. nr. 1713/2007 të 14 prillit 2009, Gjykata Supreme e Kosovës me aktvendimin KRJA nr. 3/2010 të 4 majit 2011 e hedh poshtë kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm me arsyetimin ku thuhet:

> *"Nga shkresat e lëndës del se aktgjykimi kundër të cilit është paraqitur kërkesa për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, që është nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës e cila ka kompetencë në tërë territorin e saj, fakt ky që kërkesën e bën të palejueshme në kuptim të nenit 19 par. 2 të Ligjit për konflikte administrative."*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesi i kërkesës konteston aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës KRJA nr. 3/2010, të 4 majit 2011, parashtruesi i kërkesës konsideron se me këtë aktvendim është bërë shkelje e nenit 32 [E drejta për mjete juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ku thuhet:

> *„Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj"*

15. Më tej parashtruesi i kërkesës thekson se në bazë të ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës, në rastet kur palët paraqesin kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të një vendimi gjyqësor, kompetent për nxjerrjen e vendimit është gjykata e shkallës së parë që është kompetente për çështjet administrative. Neni 24 i Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative thotë:

> *„Kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë,*

pala mund të parashtrojë Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor.

16. Parashtruesi i kërkesës më tutje pohon se:

„Ligji për Gjykata e Rregullta ende nuk është i zbatueshëm, e vetmja gjykatë kompetente për çështjet administrative, si në shkallë të parë ashtu edhe në shkallë të dytë, është Gjykata Supreme e Kosovës. Prandaj, ajo ka qenë e obliguar të vendos lidhur me Kërkesën për Rishqyrtim të Jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, në mënyre meritore, sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative i cili është në fuqi që nga data 5 Nëntor 2010 (15 ditë pas publikimit në gazetën zyrtare). Kjo ngase Neni 70 i LKA thotë:

„Për paditë e paraqitura deri në ditën e hyrjes ne fuqi të këtij ligji, do të zbatohen procedurat sipas dispozitave të deritashme, përveç nëse ky ligj është më i favorshëm për palën.“

17. Në fund parashtruesi i kërkesës i propozon Gjykatës Kushtetuese që:

“- të shpallë kërkesën të pranueshme.

- të konfirmojë shkeljen e nenit 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; dhe

- të anulojë aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës KRJA br.3/2010 dhe ta kthejë lëndën në rishqyrtim.“

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se neni 32 [E drejta për mjete juridike] i Kushtetutës është baza për kërkesën e tij.

19. Kushtet e pranueshmërisë së kërkesës janë të përcaktuara me Kushtetutë, dhe specifikuar më detajisht me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e Punës.

Neni 48 i Ligjit parashikon:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë"*

20. Në bazë të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që të interpretojnë ligjin dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës materiale dhe procedurale (shih *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, paragrafi 28., Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

21. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë provë *prima facie* që tregon shkelje të të drejtave kushtetuese të parashtruesit të kërkesës (shih Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99 i 31 majit 2005). Parashtruesi i kërkesës nuk përmend se në çfarë mënyre neni 32 [E drejta për mjete juridike] i Kushtetutës e mbështet kërkesën e tij, siç parashihet në nenit 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 48 të Ligjit.

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë cenuar të drejtat me zbatimin e gabuar të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta, duke theksuar se Gjykata Supreme ka bërë shkelje të nenit 32 të Kushtetutës pasi që nuk ka vendosur në mënyrë meritore për objektin e çështjes sipas rishqyrtimit të jashtëzakonshëm, edhe

pse Gjykata Supreme, në bazë të pretendimeve të njëjta të parashtruesit të kërkesës, tashmë ishte deklaruar në mënyrë meritore në aktgjykim.

23. Në këtë rast parashtruesit të kërkesës i ishin ofruar mundësi të shumta për të paraqitur rastin e tij dhe për ta kontestuar interpretimin e ligjit për të cilin konsideron se është i padrejtë, pranë Administratës Tatimore të Kosovës, Këshillit të Pavarur për Rishqyrtime dhe pranë Gjykatës Supreme. Pas shqyrtimit të procedurave në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur se procedurat përkatëse kanë qenë në çfarëdo mënyre të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06 të 30. qershorit 2009).

24. Përfundimisht, kushtet e pranueshmërisë nuk janë përmbushur në këtë kërkesë. Ai nuk ka arritur të përmend dhe të mbështesë me fakte pretendimin se me aktvendimin e kontestuar i janë cenuar të drejtat dhe liritë kushtetuese.

25. Nga kjo del se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së Punës që parashikon *„Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.“*

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2b) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 2 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Altay Suroy Prof. Dr. Enver Hasani

KI 13/12 datë 16 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 443/2009, të datës 8 dhjetor 2011

Rasti KI 13/12, vendimi i 2 korrikut 2012

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, barazia para ligjit, e drejta për gjykim të drejtë, barazia para ligjit, qartazi i pabazuar

Parashtruesi i kërkesës ka parashtruar kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës duke kontestuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 443/2009 të 8 dhjetorit 2011, me të cilin gjykata e refuzoi si të pabazuar kërkesë padinë e parashtruesve të kërkesës, punëtorë të Shkollës Fillore „Faik Konica“, në fshatin Krojmir, që Ministria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Arsimit e Komunës së Lipjanit parashtruesve t'ua paguajë të ardhurat personale për muajin nëntor dhe për dhjetë (10) ditët e para të dhjetorit 2007 për punën që kanë kryer si punëtorë të arsimit gjatë aktiviteteve parazgjedhore dhe njëkohësisht kanë mbajtur orët e mësimit, duke konsideruar se u takojnë të ardhurat personale nga marrëdhënia e punës për periudhën kontestuese.

Parashtruesi i kërkesës konsideron se janë shkelur neni 24 (Barazia para Ligjit) i Kushtetutës së Kosovës dhe neni 6 i Protokollit 1 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Duke vendosur për kërkesën e parashtruesve Shqiprim Qeriqi dhe Rizah Qeriqi, Gjykata Kushtetuese pas shqyrtimit të procedurës në tërësi nuk ka gjetur se procedurat përkatëse pranë gjykatave të rregullta kanë qenë në çfarëdo mënyre të padrejta dhe arbitrare. Prandaj Gjykata konkludoi se kërkesa është qartazi e pabazuar pasi që faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese.

Prishtinë, më 9 korrik 2012

Nr. ref.: RK/268/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 13/12

Parashtruesi

Shqiprim Qeriqi dhe Rizah Qeriqi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev. Nr. 443/2009, të datës 8 dhjetor 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë Shqiprim Qeriqi dhe Rizah Qeriqi, të cilët i përfaqëson Kryetari i sindikatës së SBASHK-ut, zotëri Rrustem Bublica nga fshati Dobrajë e Madhe, Komuna e Lipjanit.

Kërkesa e parashtruesve të kërkesës

2. Kontestohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev nr. 443/2009, i datës 8 dhjetor 2011, me të cilin konfirmohet Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 263/09, i datës 25 qershor 2009, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Lipjan C. nr. 17/2008, i datës 19 qershor 2008, dhe refuzohet si e papranueshme kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës, punëtor të shkollës fillore „Faik Konica“, në fshatin Krojmir, që Ministria e Shërbimeve Publike - Drejtoria e Arsimit e Komunës së Lipjanit për punën e kryer t'u paguajë parashtruesve të kërkesës të ardhurat personale, me kamatë, duke filluar nga 1 shkurti 2008, deri në kohën e pagesës përfundimtare, si dhe njëkohësisht t'u kompensojë atyre shpenzimet procedurale, në afat prej 8 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij Aktvendimi, me kërcënimin e ekzekutimit me forcë.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes, kontesti nga marrëdhënia e punës mes parashtruesit të kërkesës dhe Ministrisë së Shërbimeve Publike – Drejtoria e Arsimit e Komunës së Lipjanit, është krijuar si pasojë e mospagesës së të ardhurave personale. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev nr. 443/2009, të datës 8 dhjetor 2011, duke theksuar se me këtë Aktgjykim parashtruesve të kërkesës u është shkelur e drejta themelore nga neni 24 (Barazia para

ligjit) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 154 LMD(Ligji për marrëdhëniet detyrimore) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Protokolli 1, neni 6 .

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56 paragrafi 2 të Rregullore së punës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 9 shkurt 2012, parashtruesit e kërkesës i paraqitën kërkesën Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 15 shkurt 2012, Gjykata Kushtetuese ka njoftuar parashtruesit e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës se ka filluar procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit për lëndën Nr. KI-13-12.

7. Më 2 korrik 2012, pas shqyrtimit të raportit paraprak të gjyqtares Snezhana Botusharova, Kolegji shqyrtues i përbërë nga: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Prof.Dr. Ivan Čukalović, i rekomanduan Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Parashtruesit e kërkesës kanë ushtruar padi në Gjykatën Komunale në Lipjan kundër të padituve: Drejtorisë së Arsimit

të Komunës së Lipjanit dhe Ministrisë së Shërbimeve Publike në Prishtinë, për kompensim të të ardhurave personale gjatë kampanjës parazgjedhore për KK të Lipjanit.

9. Në kërkesëpadi si dhe në seancat dëgjimore para Gjykatës Komunale në Lipjan, parashtruesit e kërkesës theksuan se punëtorët e arsimit në shkollën fillore „Faik Konica“ në fshatin Krojmir, kanë paraqitur kandidaturat për funksion të zgjedhur publik pranë KK të Lipjanit, dhe se kanë kryer aktivitete parazgjedhore në periudhën e muajit nëntor dhe dhjetë ditët e para të muajit dhjetor 2007, por se këtë aktivitet parazgjedhor e kanë kryer pa ndërprerë marrëdhënien e punës, ashtu që punët dhe përgjegjësitë e arsimtarëve gjatë kësaj kohe i kanë kryer pa humbur orët e mësimit.

10. Më pastaj, ata theksuan se askush nuk i ka njoftuar lidhur me obligimet ligjore se aktivitetin parazgjedhor duhet kryer duke marrë pushim pa pagesë, ngase po të kishin të tilla njohuri ata në asnjë mënyrë nuk do të vendosnin të paraqisnin kandidaturat për funksion të zgjedhur publik. Meqenëse gjatë aktivitetit parazgjedhor, njëkohësisht edhe kanë mbajtur orët mësimore, ata konsiderojnë se u takojnë të ardhurat personale të marrëdhënies së punës për periudhën e kontestuar, për çka edhe i kanë propozuar Gjykatës Komunale në Lipjan që gjykata të pranoj plotësisht kërkesëpadinë e tyre si të bazuar.

11. Duke vendosur lidhur me kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës, Gjykata Komunale në Lipjan përmes Aktgjykimit C.nr.17/2008, të datës 19 qershor 2008, ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës, me të cilën kanë kërkuar që të obligohen të paditurit për kompensim të të ardhurave personale për muajin nëntor dhe dhjetë ditët e para të muajit dhjetor 2007, për punën e kryer në cilësinë e punëtorëve të shkollës fillore „Faik Konica“ fshati Krojmir, me kamatë, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore me arsyetimin se:

> "...vihet në përfundim se paditësit kanë qenë në marrëdhënie pune pranë shkollës fillore „Faik Konica“, në

> Krojmir, dhe se kanë paraqitur kandidaturat për funksione të caktuara publike pranë KK të Lipjanit në zgjedhjet që janë mbajtur më 17 nëntor 2007, dhe se të njëjtit kanë zhvilluar aktivitet parazgjedhor gjatë muajit nëntor dhe 10 ditët e para të muajit dhjetor 2007, pa e ndërprerë marrëdhënien e punës dhe se në të njëjtën kohë kanë mbajtur edhe orët mësimore te shkolla fillore ku kanë qenë në marrëdhënie pune gjatë periudhës kontestimore. Te një gjendje e këtillë e fakteve, e vërtetuar mbi bazën e provave të administruara në gjykatë, e duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi, gjykata vjen në përfundim se paditësit nuk kanë pasur mundësi ligjore që të njëjtën kohë të jenë në marrëdhënie të punës, por ata prej momentit kur kanë paraqitur kandidaturat për ndonjë funksion të zgjedhur publik, e duke filluar nga data kur ata publikisht i kanë shpallur kandidaturat e tyre, domosdo kanë qenë detyruar të marrin pushim pa pagesë nga shërbimi civil, respektivisht organizata e tyre (neni 28.4 i Urdhëresës Administrative nr. 23/2 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 për Shërbimin Publik të Kosovës)".

12. Ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Lipjan C.nr.17/2008, të datës 19 qershor 2008, parashtruesit e kërkesës ushtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

13. Me Aktgjykimin e Gjykatës Qarkut në Prishtinë Ac.nr. 263/2009, të datës 25 qershor 2009, u refuzua si e pabazuar ankesa e parashtruesve të kërkesës dhe u konfirmua Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Lipjan C.nr.17/2008, të datës 19 qershor 2008.

14. Ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Qarkut në Prishtinë Ac.nr.263/2009, të datës 25 qershor 2009, parashtruesit e kërkesës ushtruan kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

15. Me Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr.443/2009, të datës 8 dhjetor 2011, u refuzua si e pabazë kërkesa për revizion e parashtruesve të kërkesës, e parashtruar

kundër Aktgjykimit të Gjykatës Qarkut në Prishtinë Ac.nr. 263/2009, të datës 25 qershor 2009.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

16. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se; *"me këto vendime të padrejta gjyqësore janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore nga neni 24 (Barazia para ligjit) i Kushtetutës ës Republikës së Kosovës dhe neni 154 LMD(Ligji për marrëdhëniet detyrimore) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Protokolli 1,neni 6".*

17. Këtyre pretendimeve parashtruesit e kërkesës u kanë bashkangjitur edhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri C.nr. 85/08, të datës 18 prill 2008, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Podujevë E.nr.943/2008, të datës 1 prill 2009, me të cilat punëtorëve të arsimit, të cilët poashtu kanë marrë pjesë në zgjedhje, u është njohur e drejta në të ardhura personale pa marrë parasysh se kishin marrë pjesë në zgjedhje.

18. Parashtruesit e kërkesës i drejtohen Gjykatës Kushtetuese me kërkesën;

> *"Të miratohet kërkesëpadia dhe të ndryshohen të gjitha aktgjykimet e gjykatave më të ulëta".*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se neni 24. (Barazia para ligjit) i Kushtetutës ës Republikës së Kosovës, dhe neni 6 (E drejta për një proces të rregullt) Protokolli 1 I KEDNJ, janë bazë për parashtresën e tyre.

20. Neni 48 Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*

21. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit, kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga ana e gjykatave të rregullta, çshtë detyrë e gjykatatve të rregullta që të interpretojnë ligjet dhe zbatojnë rregullat e duhura të të drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, [GJEDNJ ESLJP] 1999-I).

22. Parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur kurrfarë dëshmie *prima facie* që do të tregonte shkeljet e të drejtave të tyre kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës ës Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99, të datës 31 maj 2005). Parashtruesit e kërkesës nuk theksojnë se në çfarë mënyre neni 24 (Barazia para ligjit) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe neni 6 (E drejta për proces të rregullt) Protokolli 1 i KEDNJ, mbështesin kërkesën e tyre, siç parashihet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

23. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se u janë shkelur të drejtat (Barazia para ligjit) dhe (E drejta për proces të rregullt) me zbatimin e gabueshëm të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta, pa cekur qartë se në çfarë mënyre Aktgjykimi iu shkel të drejtat e tyre kushtetuese.

24. Në rastin konkret, parashtruesve të kërkesës u janë ofruar mundësi të shumta që të paraqesin rastin e tyre dhe të kontestojnë interpretimin e ligjit, që mendojnë se është i gabuar, para Gjykatës Komunale në Lipjan, Gjykatës së Qarkut në Prishtinë si dhe Gjykatës Supreme. Pas shqyrtimit të

procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat përkatëse në çfarëdo mënyre kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, të datës 30 qershor 2009).

25. Përfundimisht, kjo kërkesë nuk i plotëson kushtet e pranushmërisë. Parashtruesit e kërkesës nuk kanë arritur të tregojnë dhe mbështesin me dëshmi se, gjoja, me këtë Aktgjykim u janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese.

26. Nga kjo rrjedh se, kërkesa është qartazi e pabazuar, në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, i cili parasheh „Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese.“

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 2 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues	**Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 111/11 datë 16 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PKL. Nr. 117/09, të datës 12 tetor 2010

Rasti KI 111/11, vendimi i 20 marsit 2012

Fjalët kyçe: rasti penal, barazia para ligjit, zbulim i identitetit, kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtat e të akuzuarve, shkelja e të drejtave dhe lirive individuale, i paafatshëm

Parashtruesi parashtroi kërkesën bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke pohuar se janë shkelur të drejtat e tij nga nenet 24 [Barazia para Ligjit], 30 [Të drejtat e të akuzuarit] dhe 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës, me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, e cila e shpalli parashtruesin fajtor për kryerjen e veprës penale nga neni 142 në lidhje me nenet 22, 26 dhe 30 të Kodit Penal të Republikës Socialiste të Republikës së Jugosllavisë. Parashtruesi më tutje kërkoi nga Gjykata që mos ta zbulojë identitetin e tij. Gjykata konsideroi se Kërkesa ishte e papranueshme, sepse ai nuk e parashtroi kërkesën sipas afatit të paraparë në nenin 49 të Ligjit. Aktgjykimi i formës së prerë i Gjykatës Supreme, PKL. Nr. 117/09, u mor me 12 tetor 2010 dhe iu dorëzua parashtruesit në një datë të paspecifikuar, përderisa parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 11 gusht 2011. Pasi që parashtruesi nuk ofroi prova në Gjykatë kur iu dorëzua aktgjykimi i Gjykatës Supreme, kjo Gjykatë konsideron datën e shpalljes së vendimit si datë të dorëzimit, d.m.th. 12 tetor 2010, kur gjyqtarët e kishin nënshkruar aktgjykimin. Sa i përket kërkesës së parashtruesit që të mos i zbulohet identiteti, Gjykata e refuzon atë si të pabazë, sepse nuk është ofruar ndonjë dokumentacion mbështetës apo informacion lidhur me arsyet se pse nuk duhet zbuluar identiteti i parashtruesit te kërkesës.

Prishtinë, 12 korrik 2012

Nr. ref.: RK /270/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 111/11

Parashtruesi

Selim Krasniqi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PKL. Nr. 117/09, të datës 12 tetor 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtrues i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Selim Krasniqi, i përfaqësuar nga z. Mahmut Halimi, avokat nga Mitrovica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme PKL. Nr. 117/09, të 12 tetorit 2010, i cili nuk dihet se kur iu dorëzua parashtruesit të kërkesës.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) mbi kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PKL. Nr. 117/09, me të cilin pretendohet t'i jenë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), dhe atë nenet 24 [Barazia para Ligjit], 30 [Të Drejtat e të akuzuarit] dhe 31 [E Drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm].

4. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të mos i zbulohet identiteti.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 15 janarit 2009, (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

6. Më 11 gusht 2011, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 23 gusht 2011, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI 111/11, emëroi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj si Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI 111/11, emëroi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova.

8. Më 18 tetor 2011, Gjykata i njoftoi për kërkesën Gjykatën Supreme dhe Gjykatën e Qarkut në Prizren.

9. Më 24 janar 2012, Gjykata njoftoi për kërkesën edhe Prokurorin e Shtetit.

10. Më 24 janar 2012, Gjykata kërkoi nga Gjykata Supreme që të njoftoi këtë Gjykatë se kur i kishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës Aktgjykimin e Gjykatës Supreme PKL. Nr. 117/09, të 12 tetorit 2010. Deri më tani nuk është pranuar asnjë përgjigje.

11. Më 20 mars 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 10 gusht 2006, Gjykata e Qarkut në Prizren gjeti parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale sipas nenit 142 në lidhje me nenet 22, 26 dhe 30 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (në tekstin e mëtejmë: KP RSFJ), (Vendimi P. nr. 85/2005). Kundër këtij vendimi parashtruesi i kërkesës u ankua në Gjykatën Supreme.

13. Më 10 prill 2009, Gjykata Supreme miratoi ankesën e parashtruesit të kërkesës për sa i përket dënimit, i cili ishte ndryshuar nga Gjykata Supreme. Pjesa tjetër e kërkesës së parashtruesit të kërkesës ishte refuzuar si e pabazë dhe ishte konfirmuar pjesa e mbetur e Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut (Aktgjykimi Ap-Kz nr. 371/2008). Parashtruesi i kërkesës i paraqiti Gjykatës Supreme kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër këtij aktgjykimi.

14. Më 12 tetor 2010, Gjykata Supreme refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazë (Aktgjykimi Pkl-Kzz 117/09).

15. Më 19 tetor 2010, Gjykata Supreme lëshoi një vendim (Vendimi Pkl-Kzz 117/09) me të cilin u korrigjua Aktgjykimi i Gjykatës Supreme i 12 tetorit 2010, i cili përmbante gabime.

16. Për më tepër, nuk është ofruar ndonjë dokumentacion mbështetës apo informacion lidhur me arsyet se pse nuk duhet zbuluar identiteti i parashtruesit të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, nenet 24 [Barazia para Ligjit], 30 [Të Drejtat e të akuzuarit] dhe 31 [E Drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] i janë shkelur me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme PKL. Nr. 117/09, sepse deklaratat e dëshmitarëve janë kontradiktore dhe nuk korrespondojnë me shpjegimet e tyre për ngjarjet të cilat ata pretendojnë të kenë ndodhur.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon t'i jenë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, nenet 24 [Barazia para Ligjit], 30 [Të Drejtat e të akuzuarit] dhe 31 [E Drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm]. Gjykata rikujton se për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen me Kushtetutë, specifikohen me Ligj dhe Rregullore të punës.

19. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se mund të vendos lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, vetëm po qe se parashtruesi i kërkesës dëshmon se ai/ajo ka paraqitur kërkesën *"brenda afatit prej katër (4) muajve [...] nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.",* në pajtim me nenin 49 të Ligjit.

20. Aktgjykimi i fundit i Gjykatës Supreme, PKL. Nr. 117/09, ishte marrë më 12 tetor 2010, nuk dihet se kur i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës, përderisa parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesën në Gjykatë më 11 gusht 2011. Pasi që parashtruesi i kërkesës ka dështuar t'i paraqes kësaj Gjykate dëshmi se kur i është dorëzuar aktgjykimi i Gjykatës Supreme, kjo Gjykatë konsideron datën e shpalljes së vendimit si datë të dorëzimit, d.m.th. 12 tetor 2010, kur gjyqtarët kishin nënshkruar aktgjykimin.

21. Një konsiderim i tillë është i arsyeshëm, kur kemi parasysh se dorëzimi i vendimit mund të jetë bërë brenda afatit prej katër muajve, për shkak të natyrës së procedurës penale.

22. Andaj, Gjykata konkludon se, në pajtim me nenin 49 të Ligjit, kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme.

23. Sa i përket kërkesës së parashtruesit që të mos i zbulohet identiteti, Gjykata e refuzon atë si të pabazë, sepse nuk është ofruar ndonjë dokumentacion mbështetës apo informacion lidhur me arsyet se pse nuk duhet zbuluar identiteti i parashtruesit të kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 56 (2) të Procedurës së punës, më 20 mars 2012,

VENDOSI

I. Njëzëri, ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme;

II. Me shumicë votash, ta refuzojë kërkesën si të papranueshme për shkak se është paafatshme;

III. Njëzëri, ta hedhë poshtë kërkesën për mos zbulim të identitetit;

IV. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

V. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Gjyljeta Mushkolaj Prof. Dr. Enver Hasani

KI 133/11 datë 16 korrik 2012- Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Rasti KI 133/11, vendimi i 20 marsit 2012

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, masa të përkohshme, e drejta e pronës, shkelja e të drejtave dhe lirive individuale, qartazi i pabazuar, mos-shterimi

Parashtruesit parashtruan kërkesën bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke pohuar se janë shkelur të drejtat dhe liritë e tyre individuale të garantuara me Kushtetutë dhe të inkorporuara në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut Protokolli 1, neni 1 (Të Drejtat Pronësore) nga autoritetet publike që i privatizuan ato.

Përveç kësaj, parashtruesit kërkojnë që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës të vlerësojë nëse neni 5.3 i Ligjit për AKP-ne (Nr. 03/L-067) është jo-kushtetues. Për më tepër, parashtruesit kërkojnë që Gjykata të lëshojë masë të përkohshme

Gjykata konsideroi se kërkesa ishte e papranueshme sepse parashtruesit nuk i kishin shterë mjetet ligjore që i kishin në dispozicion sipas ligjit të aplikueshëm bë Kosovë, sepse Dhoma e Posaçme ende nuk mori një vendim në lidhje me padinë e parashtruar në Dhomën e Posaçme nga Sh.A "Metaliku", Holding Company "Ening" Sh.A, Holding Company "Industria" Sh.A, Aksionarët e Holding Company "Ereniku" Sh.A, Holding Company "Enea" Sh.A, Holding Company "Emin Duraku" Sh.A., Holding Company "Jatex" Sh.A., dhe Holding Company "Deva" Sh.A.. Për më tepër, Gjykata konkludoi se parashtruesit nuk kishin ofruar prova se procedurat relevante ishin në ndonë mënyrë të padrejta apo arbitrare. Prandaj, Gjykate konsideron se kërkesa është qartazi e pabazuar, sipas rregullit 36 (1.c) të Rregullores. Sa i përket pyetjes s[parashtruesve lidhur me përputhshmërinë e nenit 5.3 të Ligjit për AKP-në (Ligji Nr. 03/L-067) me Kushtetutën, Gjykata vëren që parashtruesit kanë mundur ta ngrinin çështjen e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutë në gjykata te rregullta, te cilat janë të

autorizuara sipas nenit 113.8 të Kushtetutës t'i referojnë këto çështje në Gjykatën Kushtetuese. Megjithatë, në bazë të dokumenteve të dorëzuara, Gjykata vëren që parashtruesit nuk e kanë ngritur çështjen e përputhshmërisë së nenit 5.3 të Ligjit për AKP-në (Ligji Nr. 03/L-067) me Kushtetutën në gjykata të rregullta, prandaj, duke marre parasysh parimin e subsidiaritetit, Gjykata nuk mund ta shqyrtojë ketë çështje. Megjithatë, duke marrë parasysh që kërkesa u shpall e papranueshme, parashtruesi nuk ka te drejte, sipas rregullit 54 (1) të Rregullores së punës, të kërkojë masë të përkohshme.

Prishtinë, më 12 korrik 2012

Nr. ref.: RK /271/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastet Nr. KI 133/11

Parashtrues

Holding Company "Deva" SH.A.

Holding Company "Enea" SH.A.

Holding Company "Tregtia" SH.A.

Holding Company "Industria" SH.A.

Holding Company "Ening" SH.A.

Holding Company "Virxhinia" SH.A.

SH.A. "Metaliku"

J.S.C. "Mulliri"

SH.A. "Mishi"

SH.A. "Modeli"

ED "Ediko"

Aksionarët e Holding Company "Emin Duraku" SH.A.

Aksionarët e Holding Company "Ereniku" SH.A.

Aksionarët e Holding Company "Jatex" SH.A.

kundër

Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë: Holding Company "Deva" SH.A., Holding Company "Enea" SH.A., Holding Company "Tregtia" SH.A., Holding Company "Industria" SH.A., Holding Company "Ening" SH.A., Holding Company "Virxhinia" SH.A., SH.A. "Metaliku", J.S.C. "Mulliri", SH.A. "Mishi", SH.A. "Modeli", ED "Ediko", Aksionarët e Holding Company "Emin Duraku" SH.A., Aksionarët e Holding Company "Ereniku" SH.A., Aksionarët e Holding Company "Jatex" SH.A., të përfaqësuar nga z. Linn Slattengren, avokat nga Prishtina.

Palët kundërshtare

2. Palë kundërshtare janë Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: AKM) dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP).

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit ankohen se janë duke vuajtur shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe të inkorporuara në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) Protokolli 1, neni 1 [Të Drejtat Pronësore].

4. Përveç kësaj, parashtruesit kërkojnë që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të vlerësojë nëse neni 5.3 i Ligjit për AKP-në (Nr. 03/L-067) është jokushtetues.

5. Për më tepër, parashtruesit kërkojnë që Gjykata të lëshojë masë të përkohshme *"drejtuar AKP-së që të përmbahen nga shitja e aseteve të parashtruesve [...]", "Në mënyrë që të ruhet status quo dhe për të siguruar përputhshmëri me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës"*.

Baza juridike

6. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 22 dhe 27 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregullat 54, 55 dhe 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Parashtruesit e parashtruan kërkesën në Gjykatë më 20 tetor 2011.

8. Më 12 janar 2012, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. 133/11, e caktoi gjyqtaren Iliriana Islami Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. 133/11, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Gjyljeta Mushkolaj.

9. Më 9 shkurt 2012, Gjykata Kushtetuese e njoftoi AKP-në për parashtrimin e kërkesës.

10. Më 9 shkurt 2012, Gjykata Kushtetuese kërkoi informacione nga Dhoma e Posaçme lidhur me statusin e lëndëve, e cila u përgjigj më 20 shkurt 2012.

11. AKP-ja ia dërgoi kësaj Gjykate një përgjigje më 21 shkurt 2012.

12. Më 20 mars 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

13. Më 20 gusht 1990, ish-Republika Socialiste e Jugosllavisë (në tekstin e mëtejmë: RSFJ), miratoi Ligjin për Kapitalin Shoqëror për ta filluar procesin e transformimit të ekonomisë socialiste të Jugosllavisë në kapitalizëm. Sipas këtij ligji, gjoja, disa ndërmarrje shoqërore (në tekstin e mëtejmë: NSH) që gjendeshin në Gjakovë u transformuan në shoqëri aksionare (në tekstin e mëtejmë: SH.A).

14. Në vitin 2005 dhe 2006, sipas kërkesës së Holding Company "Deva" SH.A., Holding Company "Enea" SH.A., Holding Company "Tregtia" SH.A., Holding Company "Industria" SH.A., Holding Company "Virxhinia" SH.A., Aksionarët e Holding Company "Emin Duraku" SH.A., Aksionarët e Holding Company "Ereniku" SH.A., Aksionarët e Holding Company "Jatex" SH.A., Gjykata Ekonomike në Prishtinë e urdhëroi Regjistrin e Bizneseve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë t'i

regjistronte ato si shoqëri aksionare. Gjykata Supreme e miratoi vendimin e Gjykatës Ekonomike në Prishtinë. Megjithatë, gjoja, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë kurrë nuk i respektoi plotësisht vendimet e gjykatave dhe i regjistroi ato "si ndërmarrje të tjera nën juridiksionin e AKM-së".

15. Sa u përket procedurave në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: Dhoma e Posaçme), faktet janë me sa vijon:

Holding Company "Deva" SH.A.

16. Më 10 dhjetor 2010, Holding Company "Deva" SH.A. ushtroi padi në Dhomën e Posaçme kundër AKP-së, me ç'rast kërkoi anulimin e vendimeve të AKP-së prej 29 prillit 2010 për shpalljen e kësaj kompanie 100% në pronësi shoqërore, verifikimin e statusit të saj si kompani private, anulimin e vendimit për privatizimin e kompanisë dhe një urdhër për masë të përkohshme për ta ndaluar privatizimin e kompanisë.

17. Më 14 shkurt 2011, trupi gjykues i Dhomës së Posaçme e refuzoi kërkesën për dhënien e masës së përkohshme.

18. Më 18 gusht 2011, Holding Company "Deva" SH.A. e parashtroi kërkesën e dytë për masë të përkohshme në këtë çështje.

19. Më 7 tetor 2011, Dhoma e Posaçme e refuzoi kërkesën për masë të përkohshme me arsyetimin se nuk janë përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 55 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6 për ndryshimin dhe zëvendësimin e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2006/17, zbatimin e Rregullores Nr. 2002/13 për themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: UA UNMIK 2008/6). Përveç kësaj, Dhoma e Posaçme theksoi se pasi ajo tashmë kishte vendosur për këtë çështje më 14 shkurt 2011 dhe pasi nuk ka prova të reja të parashtruara me kërkesën e dytë për masë të përkohshme, nuk ka arsye për lejimin e kërkesës për masë të përkohshme.

20. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren që padia e ushtruar në Dhomën e Posaçme më 10 dhjetor 2008 është në procedurë e sipër pranë saj.

Holding Company "Jatex" SH.A.

21. Holding Company "Jatex" SH.A. ushtroi padi në Dhomën e Posaçme për ta konfirmuar statusin e saj si SH.A., për ta detyruar AKP-në për ta njohur statusin e saj dhe për ta anuluar vendimin për privatizim të nisur nga AKP-ja në valën e 45-të, më 22 tetor 2010.

22. Më 21 tetor 2010, Dhoma e Posaçme e miratoi kërkesën për masë të përkohshme deri në vendimin përfundimtar të padisë nga Dhoma e Posaçme.

23. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren që padia e ushtruar në Dhomën e Posaçme është në procedurë e sipër pranë saj.

Holding Company "Emin Duraku" SH.A.

24. Më 22 korrik 2008, Holding Company "Emin Duraku" SH.A. ushtroi padi në Dhomën e Posaçme duke kërkuar që ajo t'ia njihte statusin e saj ligjor si shoqëri aksionare dhe ta lironte këtë kompani nga juridiksioni i AKM-së/AKP-së.

25. Më 2 nëntor 2010, Dhoma e Posaçme e miratoi kërkesën për masë të përkohshme deri në vendimin përfundimtar të padisë nga Dhoma e Posaçme.

26. Më 26 nëntor 2011, AKP ushtroi ankesë në Kolegjin për ankesa kundër vendimit të trupit gjykues për dhënien e masës së përkohshme.

27. Më 19 maj 2011, Kolegji për ankesa e anuloi vendimin e trupit gjykues dhe e urdhëroi atë për të rigjykuar kërkesën për masë të përkohshme.

28. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren që padia e ushtruar në Dhomën e Posaçme është në procedurë e sipër pranë saj.

Holding Company "Enea" SH.A.

29. Më 15 tetor 2008, Holding Company "Enea" SH.A. ushtroi padi në Dhomën e Posaçme duke kërkuar verifikimin e statusit të saj ligjor si shoqëri aksionare dhe lirimin e saj nga juridiksioni i AKM-së.

30. Më 19 shtator 2011, AKP njoftoi për privatizimin e kompanisë.

31. Më 26 gusht 2011, kompania ushtroi kërkesë në Dhomën e Posaçme për masë të përkohshme.

32. Më 23 shtator 2011, Dhoma e Posaçme e miratoi kërkesën për masë të përkohshme deri në vendimin përfundimtar të padisë nga Dhoma e Posaçme.

33. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren që padia e ushtruar në Dhomën e Posaçme është në procedurë e sipër pranë saj.

Aksionarët e Holding Company "Ereniku" SH.A.

34. Më 5 maj 2008, aksionarët e Holding Company "Ereniku" SH.A. ushtruan padi në Dhomën e Posaçme duke kërkuar verifikimin e statusit të saj ligjor si shoqëri aksionare dhe lirimin e saj nga juridiksioni i AKM-së.

35. Më 18 maj 2011, kompania ushtroi kërkesë në Dhomën e Posaçme për masë të përkohshme.

36. Më 4 korrik 2011, Dhoma e Posaçme e refuzoi kërkesën për masë të përkohshme.

37. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren që padia e ushtruar në Dhomën e Posaçme është në procedurë e sipër pranë saj.

Holding Company "Industria" SH.A.

38. Më 9 maj 2008, Holding Company "Industria" SH.A. ushtroi padi në Dhomën e Posaçme duke kërkuar verifikimin e statusit të saj ligjor si shoqëri aksionare dhe lirimin e saj nga juridiksioni i AKM-së.

39. Më 17 maj 2011, kompania ushtroi kërkesë në Dhomën e Posaçme për masë të përkohshme.

40. Më 9 qershor 2011, Dhoma e Posaçme e miratoi kërkesën për masë të përkohshme deri në vendimin përfundimtar të padisë nga Dhoma e Posaçme.

41. Më 18 korrik 2011, AKP-ja njoftoi për shitjen e pasurive të të njëjtës kompani dhe, më 2 gusht 2011, kompania ushtroi kërkesë në Dhomën e Posaçme për masë të përkohshme.

42. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren që padia e ushtruar në Dhomën e Posaçme është në procedurë e sipër pranë saj.

Holding Company "Ening" SH.A.

43. Më 19 maj 2011, Holding Company "Ening" SH.A. ushtroi padi në Dhomën e Posaçme duke kërkuar verifikimin e statusit të saj

ligjor si shoqëri aksionare dhe lirimin e saj nga juridiksioni i AKP-së.

44. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren që padia e ushtruar në Dhomën e Posaçme është në procedurë e sipër pranë saj.

SH.A. "Metaliku"

45. Më 26 shtator 2011, SH.A "Metaliku" ushtroi padi në Dhomën e Posaçme duke kërkuar verifikimin e statusit të saj ligjor si shoqëri aksionare dhe lirimin e saj nga juridiksioni i AKP-së.

46. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren që padia e ushtruar në Dhomën e Posaçme është në procedurë e sipër pranë saj.

Holding Company "Virxhinia" SH.A.

47. Më 21 prill 2008, Holding Company "Virxhinia" SH.A. ushtroi padi në Dhomën e Posaçme duke kërkuar verifikimin e statusit të saj ligjor si shoqëri aksionare dhe lirimin e saj nga juridiksioni i AKM-së. Dhoma e Posaçme e hodhi poshtë padinë si të papranueshme për shkak se avokati kishte dështuar t'i përgjigjej kërkesës për informacione (Vendimi SCC-08-0099, i 9 korrikut 2009). Parashtruesi ushtroi ankesë kundër këtij vendimi.

48. Më 4 shkurt 2010, Dhoma e Posaçme e hodhi poshtë ankesën si të papranueshme për shkak se ankesa ishte e pakohshme (Vendimi ASC-09-0050)

Holding Company "Tregtia" SH.A.

49. Më 9 maj 2008, Holding Company "Tregtia" SH.A. ushtroi padi në Dhomën e Posaçme duke kërkuar verifikimin e statusit të saj ligjor si shoqëri aksionare dhe lirimin e saj nga juridiksioni i

AKM-së. Dhoma e Posaçme e hodhi poshtë padinë si të papranueshme për shkak se avokati kishte dështuar t'i përgjigjej kërkesës për informacione.

50. Dhoma e Posaçme e hodhi poshtë padinë si të papranueshme për shkak se avokati kishte dështuar t'i përgjigjej kërkesës për informacione (Vendimi SCC-08-0129, i 14 janarit 2009). Nuk u ushtrua ankesë kundër këtij vendimi.

SH.A. "Mulliri", SH.A. "Mishi", SH.A. "Modeli", dhe ED "Ediko"

51. Kompanitë SH.A. "Mulliri", SH.A. "Mishi", SH.A. "Modeli", dhe ED "Ediko" janë privatizuar në një datë të pacaktuar.

Pretendimet e parashtruesit

52. Parashtruesit pretendojnë që:

"...

i. Janë disa Shoqëri Aksionare Private të cilat kanë pasur pasuritë e tyre të marrura dhe të shtura nga AKM/AKP. Të ardhurat janë mbajtur në besim-trust, mirëpo së shpejti do të rimbursohen nga Qeveria.

ii. Ka individë privat të cilët pronën private në formë të aksioneve e kanë pas vlerën e shpronësuar në dobi të Qeverisë.

iii. Janë disa Shoqëri Aksionare Private që rrezikojnë ti kënaqë pasuritë e tyre të marrura dhe të shitura nga AKM//AKP.

iv. Në fund, janë disa individë privat të cilëve prona private në formë të aksioneve janë në rrezik të kenë vlerën e shpronësuar në dobi të Qeverisë.
…"

53. Përveç kësaj, parashtruesit *"[…] kërkojnë që Gjykata Kushtetuese e Kosovës të vendosë që neni 5.3 i Ligjit për AKP-në (Ligji 03/L-067) shkel […]"* Neni 32 i *"[…] Kushtetutës së Kosovës si është aplikuar në atë që rezulton në marrjen e pronës private në shkelje të nenit 1 Protokollit 1."* Parashtruesit pohojnë që efekti i nenit 5.3 të Ligjit për AKP-në siç është zbatuar, i lejon shtetit ta marrë pronën private në mënyrë arbitrare dhe t'ua shesë atë blerësve privatë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

54. Gjykata vëren që parashtruesit ankohen se janë duke vuajtur shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë dhe Protokollin 1, nenin 1 [Të Drejtat Pronësore] të KEDNJ-së. Përveç kësaj, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata të vlerësojë nëse neni 5.3 i Ligjit për AKP-në (Ligji 03/L-067) është jokushtetues.

55. Megjithatë, për të gjykuar për kërkesën e parashtruesve, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

i. Çështja e shterimit të mjeteve juridike

56. Arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, Aktvendim për Papranueshmëri:

Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI-41/09, i 27 janarit 2010, dhe *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).

57. Sa i përket kësaj kërkese, Gjykata vëren që Dhoma e Posaçme ende nuk ka marrë vendim lidhur me padinë e ushtruar në Dhomën e Posaçme nga SH.A. "Metaliku", Holding Company "Ening" SH.A., Holding Company "Industria" SH.A., Aksionarët e Holding Company "Ereniku" SH.A., Holding Company "Enea" SH.A., Holding Company "Emin Duraku" SH.A., Holding Company "Jatex" SH.A. dhe Holding Company "Deva" SH.A.

58. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesit nuk i kanë shteruar mjetet juridike që i kanë në dispozicion sipas ligjeve në fuqi në Kosovë në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe menin 47.2 të Ligjit.

B. Çështja e mbështetjes së kërkesës me prova

59. Sa i përket kërkesës lidhur me Holding Company "Tregtia" SH.A., Holding Company "Virxhinia" SH.A., J.S.C "Mulliri", SH.A "Mishi", SH.A. "Modeli", dhe ED "Ediko" Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të merret me lajthitjet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) gjoja të kryera nga Dhoma e Posaçme, përveç nëse dhe për aq sa ajo mund t'i ketë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Prandaj, Gjykata nuk duhet të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt kur i shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta.

60. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).

61. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesit e kësaj kërkese të kenë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991).

62. Përveç kësaj, parashtruesit thjesht nuk pajtohen me gjetjet faktike të gjykatave lidhur me rastin e tyre.

63. Përveç kësaj, sa i përket parashtruesit Holding Company "Virxhinia" SH.A., Gjykata vëren që Dhoma e Posaçme konkludoi që parashtruesi nuk kishte ushtruar ankesë brenda afatit ligjor (Vendimi ASC-09-0050, i 4 shkurtit 2010).

64. Sa i përket parashtruesit Holding Company "Tregtia" SH.A., Gjykata vëren që parashtruesi ka mundur të ushtronte ankesë kundër vendimit të Dhomës së Posaçme (Vendimi SCC-08-0129, i 14 janarit 2009), por nuk kishte ushtruar ankesë.

65. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës t'i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedura të rregullta për ta parandaluar shkeljen e Kushtetutës, ose, nëse ka, për ta korrigjuar shkeljen e një të drejte themelore. Prandaj, parashtruesi i kërkesës që dështon të ndërmarrë ndonjë hap procedural në gjykata të rregullta brenda afateve të caktuara kohore, vetë bart përgjegjësinë nëse rasti i tij shpallet i papranueshëm, pasi kjo do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për kundërshtim të mëtejmë të shkeljes.

66. Në fakt, parashtruesit nuk e kanë mbështetur kërkesën në baza kushtetuese dhe nuk kanë ofruar prova që të drejtat dhe liritë e tyre janë shkelur nga ai organ publik. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konkludojë që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

67. Duke marrë parasysh këtë që u tha më lart, rezulton që kërkesa është qartazi e pabazuar në përputhje me rregullin 36 (2) të Rregullores së punës.

C. Çështja e përputhshmërisë së Ligjit për AKP-në me Kushtetutën

68. Sa i përket pyetjes së parashtruesve lidhur me përputhshmërinë e nenit 5.3 të Ligjit për AKP-në (Ligji Nr. 03/L-067) me Kushtetutën, Gjykata vëren që parashtruesit kanë mundur ta ngrinin çështjen e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutë në gjykata të rregullta, të cilat janë të autorizuara sipas nenit 113.8 të Kushtetutës t'i referojnë këto çështje në Gjykatën Kushtetuese. Megjithatë, në bazë të dokumenteve të dorëzuara, Gjykata vëren që parashtruesit nuk e kanë ngritur çështjen e përputhshmërisë së nenit 5.3 të Ligjit për AKP-në (Ligji Nr. 03/L-067) me Kushtetutën në gjykata të rregullta, prandaj, duke marrë parasysh parimin e subsidiaritetit, Gjykata nuk mund ta shqyrtojë këtë çështje.

69. Duke marrë parasysh këtë që u tha më lart, rezulton që kërkesa si tërësi duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme

70. Sa i përket kërkesës së parashtruesve drejtuar Gjykatës për masë të përkohshme, Gjykata i referohet nenit 27 të Ligjit dhe, në veçanti, rregullit 54 (1) të Rregullores së punës, i cili thotë që, në çfarëdo kohe përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës dhe meritat e kërkesës nuk janë vendosur nga Gjykata, pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme. Megjithatë, duke marrë parasysh që kërkesa u shpall e papranueshme, parashtruesi nuk ka të drejtë, sipas rregullit 54 (1) të Rregullores së punës, të kërkojë masë të përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit, rregullin 36 (2), rregullin 54 (1) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 20 mars 2012, Gjykata Kushtetuese:

VENDOSI

I. Njëzëri, ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme;

II. Me shumicë, ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike dhe si qartazi të pabazuar;

III. Njëzëri, ta hedhë poshtë kërkesën për masë të përkohshme;

IV. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe

V. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Iliriana Islami Prof. Dr. Enver Hasani

KI 140/11 datë 24 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. 383/2008, të 10 qershorit 2011

Rasti KI 140/11, vendim i 12 korrikut 2012

Fjalët kyçe: Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, qeverisja lokale, kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, liritë dhe të drejtat individuale, e drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat e tij kushtetuese janë cenuar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilin u vërtetuan vendimet e Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës Komunale në Gjilan. Parashtruesi pretendoi se Gjykata Supreme ka cenuar të drejtën e garantuar me nenin 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte e papranueshme bazuar në Rregullin 56.2 të Rregullores së Punës për shkak se parashtruesi nuk kishte dorëzuar ndonjë provë *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave kushtetuese. Gjykata vendimin e saj e arsyetoi duke përsëritur se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Duke cituar vendimin e GJEDNJ-së në rastin *Vanek kundër Republikës Sllovake,* Gjykata më tutje arsyetoi se pas shqyrtimit të procedurave në gjykatat e rregullta si tërësi, nuk vëren që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare, dhe se Gjykata Supreme kishte dhënë arsye të mjaftueshme se përse kishte mbështetur vendimin e Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës Komunale në Gjilan. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

Prishtinë, më 12 korrik 2012

Nr. ref.: RK /275/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 140/11

Parashtruesi

Habib Ymeri

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev. 383/2008, të 10 qershorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan Gjyqtar

Altay Suroy, Gjyqtar

Almiro Rodrigues, Gjyqtar

Snezhana Botusharova, Gjyqtare dhe

Ivan Čukalović, Gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi është Habib Ymeri banor i Gjilanit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 383/2008, të 10 qershorit 2011, që i është dorëzuar parashtruesit më 1 korrik 2011.

Objekti i çështjes

3. Më 27 tetor 2011 parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) me pretendim se i është shkelur e drejta e tij e garantuar me Nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, Neni 20 i Ligjit dhe, Rregulli 56 (2) i Rregullores.

Procedura në Gjykatë

5. Më 26 tetor Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

6. Më 12 janar 2012, Kryetari,me Vendimin nr. GJR. 133/11, e caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë Kryetari, me Vendimin nr. K.SH. 33/11, caktoi Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodriguez (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 24 janar 2012, kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme të Kosovës. Deri më tani nuk është marrë ndonjë përgjigje. Të njëjtën ditë Gjykatës Komunale të Gjilanit iu dërgua kërkesa për fletëkthesën, për të kuptuar datën e saktë kur parashtruesi e ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. 383/2008.

8. Më 8 shkurt 2012, Gjykata Komunale e Gjilanit dërgoi dokumentet e kërkuara, të cilat ofronin dëshmi se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i është dorëzuar parashtruesit më 1 korrik 2011.

9. Më 11 korrik 2012, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve në Procedurën Administrative

10. Në 2001 (nuk është dhënë data e saktë) Parashtruesi krijoi marrëdhënien e punës në Komunën e Gjilanit- Drejtorinë e Urbanizmit, Rindërtimit dhe Ambientit/Sektori i dhënies së lejeve të Komunës së Gjilanit në pozitën Urbanist.

11. Më 14 dhjetor 2004, Drejtori i Sektorit të dhënies së lejeve e bëri vlerësimin e performancës së Parashtruesit.

12. Përveç kësaj, Shefi ekzekutiv i Komunës bëri vlerësimin tjetër të performancës dhe si rrjedhojë e kësaj me Vendimin 02/164 të 28 shkurtit 2005 vendosi që parashtruesit të mos ia përtërijë kontratën e punës.

13. Më 14 mars 2005, Parashtruesi i parashtroi ankesë Komisionit të ankesave të autoritetit lokal kundër Vendimit 02/164 për mos-përtëritjen e kontratës së punës.

14. Më 13 qershor 2005, Komisioni i ankesave nxori vendimin i cili i hodhi poshtë ankesat e Parashtruesit dhe e miratoi vendimin e Shefit ekzekutiv për përfundimin e marrëdhënies së punës.

15. Më 9 prill 2005, Parashtruesi parashtroi ankesë në Bordin e Pavarur Mbikëqyrës – Ministria e Shërbimeve Publike me pohimin se janë bërë shkelje serioze të dispozitave procedurale.

16. Më 8 dhjetor 2006, Bordi i Pavarur Mbikëqyrës (në tekstin e mëtejmë: BPM) nxori vendimin Nr. 02/66/2005 dhe e hodhi poshtë si të pabazë ankesën e Parashtruesit dhe e miratoi Vendimin 02/164 të 28 shkurtit 2005.

Përmbledhja e fakteve në procedurën gjyqësore

17. Parashtruesi i kërkesës i pakënaqur me vendimin e BPM parashtroi padi në Gjykatën Komunale të Gjilanit duke kërkuar shfuqizimin e Vendimit 02/164 të Komunës së Gjilanit për mos-përtëritjen e kontratës, dhe të Vendimit Nr. 02/66/2005 të BPM.

18. Më 10 mars 2008, Gjykata Komunale e Gjilanit nxori Aktgjykimin C. no. 562/07 i cili e miratoi ankesën e parashtruesit dhe e shfuqizoi Vendimin 02/164 të Komunës së Gjilanit për mos-përtëritjen e kontratës dhe, Vendimin Nr. 02/66/2005 të BPM, duke obliguar Komunën e Gjilanit që ta kthejë parashtruesin e kërkesës në vendin e tij të mëparshëm të punës.

19. Komuna e Gjilanit parashtroi ankesë në Gjykatë e Qarkut në Gjilan kundër Aktgjykimit C. no. 562/07 të Gjykatës Komunale, duke kërkuar anulimin e tij.

20. Më 18 qershor 2008, Gjykata e Qarkut nxori Aktgjykimin AC. nr. 172/08, me të cilin vërtetoi Aktgjykimin C. no. 562/07 të Gjykatës Komunale dhe e hodhi poshtë ankesën e Komunës së Gjilanit.

21. Komuna e Gjilanit paraqiti kërkesë për Revizion, si mjet të jashtëzakonshëm, në Gjykatën Supreme të Kosovës.

22. Më 10 qershor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin e saj Rev. no. 383/2008, i cili i miratoi pretendimet e Komunës së Gjilanit dhe i ndryshoi aktgjykimet: C. no. 562/07 të Gjykatës Komunale në Gjilan dhe AC. no. 172/08 të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, me konstatimin se:

"*Gjykata Supreme e Kosovës e Kosovës vlerëson se meqë kontrata e punësimit të paditësit nuk është përtërirë, marrëdhënia e punësimit të paditësit, si shërbyes civil, është ndërprerë automatikisht në pajtim me Nenin 32.1 (b) të Udhëzimit Administrativ nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores 2001/36 për Shërbyesit Civil të Kosovës".*

Përveç kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës jep arsyetimin për ndryshimin e Aktgjykimit të Gjykatës së instancës së ulët:

"*Qëndrimi juridik i gjykatave të instancës më të ulë, se nuk është relevant vlerësimi i punës së paditësit, i bërë nga ana e Kryeshefit ekzekutiv të paditurës, sepse i njëjti nuk është menaxher i paditësit e sa mbikëqyrës i punës së tij, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme është i gabuar, pasi që me Udhëzimin Administrativ nr. MSHP/DASHC. 2003/2 për procedurat e kontratave, në pikën 5a- "mos-përtëritja e kontratave" është paraparë se Sekretari i përhershëm*

/Kryeshefi Ekzekutiv, do të rishqyrtojë dëshmitë dhe do të merr vendim përfundimtar për ndërprerje të kontratës respektivisht për mos- përtëritje të saj.

Pretendimet e parashtruesit

23. Parashtruesi pretendon se me Aktgjykimin Rev. no. 383/2008 Gjykata Supreme ia ka shkelur të drejtën e tij për të punuar të garantuar me Nenin 49 të Kushtetutës. Ai po ashtu pretendon se koha që i është dashur Gjykatës Supreme për të vendosur në rastin e tij ka qenë e paarsyeshme.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

24. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton, se:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me lig".

25. Nga dokumentacioni i dorëzuar mund të shihet se Parashtruesi i ka shtjerë të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

26. Paragrafi 1 Nenit 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese përcakton, se:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur

publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".

27. Vendimi më i fundit në lidhje me këtë rast është vendimi i datës 10 qershor 2011, që iu dorëzua parashtruesit më 1 qershor 2011. Parashtruesi paraqiti kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 27 tetor 2011, që do të thotë se ai paraqiti kërkesën në këtë Gjykatë në përputhje me afatin e përcaktuar në Nenin 49.

28. Edhepse parashtruesi ka shterur të gjitha mjetet juridike për të realizuar të drejtën e tij të supozuar për punë, të paraparë me Kushtetutë, ai nuk ka ofruar ndonjë provë- Fakt relevant për të mbështetur se "autoritetet administrative ose gjyqësore kanë bërë ndonjë shkelje të të drejtave të tij/saj të garantuara me Kushtetutë", (shih Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi i GJEDNJ për pranueshmërinë në rastin nr. 53363/99të datës 31 maj 2005).

29. Gjykata Kushtetuese përsërit që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis,* Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, § 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] e 1999-I).

30. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë, dhe nëse procedurat në përgjithësi të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa nr. 13071/87 e miratuar më 10 korrik 1991).

31. Megjithatë, pas shqyrtimit të dokumenteve të paraqitura nga parashtruesi Gjykata Kushtetuese nuk ka vëren që procedurat në Gjykatën Supreme ishin të padrejta apo të prekura nga

arbitrariteti (shih *mutatis mutandis* Kërkesa nr. 53363/99, Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi i GJEDNJ të 31 majit 2005).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 11 korrik 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim to ti komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në përputhje me nenin 20 (4) të Ligjit;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Prof. Dr. Enver Hasani

KI 39/12 datë 24 korrik 2012- Kërkesë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës A. nr. 693/2011 të 23 shtatorit 2011

Rasti KI 39/2012, vendimi i datës 10 korrik 2012
Fjalët kyçe:Kontest administrativ, E drejta për pension për personat me aftësi te kufizuara, kërkesa individuale, kërkesa e paafatshme.

Parashtruesi e kishte dorëzuar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke pretenduar se me Gjykatës Supreme, me Aktgjykimin A. nr. 29/2011 të 15 shkurtit 2011, duke ia refuzuar përfundimisht të drejtën për njohjen e statusit të personit me aftësi të kufizuar ka bëre shkelje kushtetuese të të drejtave te tij, të garantuara me: Nenin 51.2 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale], Kapitullin VII, [Sistemi i Drejtësisë], Nenin 102 paragrafi 3 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], Nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejte i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtarë]; dhe Nenin 13 [Kartës Sociale].

Gjykata, kishte vërejtur që vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës ishte Aktgjykimi A. nr.639/2011 i 23 shtatorit 2011, i është dorëzuar parashtruesit më 1 tetor 2011. Ndërsa, parashtruesi kërkesën në Gjykatë e kishte dorëzuar më 13 prill 2012, që nënkupton se kërkesa ishte dorëzuar jashtë afatit katër (4) mujor, të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, sepse kërkesa është dashur që të dorëzohej në Gjykatë, jo me vone së 1 shkurti 2012. Prandaj ne baze te nenin 49 të Ligjit kërkesa është konsideruar e paafatshme.

Prishtinë, më 12 korrik 2012

Nr.ref.:RK/273/12

AKTVENDIM PER PAPRANUESHMERI

në

Rastin Nr. KI 39/12

Parashtruesi

Selver Dërmaku

Kërkesë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës A. nr. 693/2011 të 23 shtatorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKES SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almira Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtrues i Kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Selver Dërmaku, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë.

Vendimi gjyqësor i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik me të cilin pretendohen shkeljet e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: "Kushtetuta) është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr. 693/2011 i 23 shtatorit 2011 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), të cilin parashtruesi e ka pranuar më 1 tetor 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së lëndës/kërkesës së parashtruar më 13 prill 2012 në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: "Gjykata) është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. nr. 693/2011 të 23 shtatorit 2011, qe ka të bëj me të drejtën për pension të personave me aftësi të kufizuara.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 16 dhjetorit 2008, i hyrë në fuqi më 15 janar 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe Rregulli 28 i Rregullores së Punës së Gjykatës

Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Ankesa e parashtruesit

5. Parashtruesi i kërkesës ankohet se Komisionet mjekësore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejmë: MPMS) ia kanë refuzuar në mënyrë joligjore të "drejtën për pension të personave me aftësi të kufizuara" edhe pse e njëjti pretendon se i kishte plotësuar kushtet për një pension të tillë, ndërsa Gjykata Supreme me Aktgjykimin A. nr. 693/2011 të 23 shtatorit 2011, duke refuzuar padinë e tij lidhur me këtë çështje pretendon se ka bërë shkelje të të drejtave të tij kushtetuese

Procedura në Gjykatë

6. Më 13 prill 2012 Gjykata Kushtuese pranoi kërkesën parashtruar nga z. Selver Dërmaku dhe e regjistroi atë me nr. KI 39/12.

7. Më 23 prill 2012, Kryetari, me vendimin GJR. 39/12 caktoi Gjyqtar raportues, gjyqtaren Dr. Gjyljeta Mushkolaj. Po të njëjtën ditë, Kryetari, me vendimin KSH. 39/12, caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues në përbërje të gjyqtareve: 1. Snezhana Botusharova (kryesuese), 2. Ivan Čukalović (anëtar) dhe 3. Dr. Iliriana Islami (anëtare).

8. Më 29 maj 2012 Gjykata, njoftoi parashtruesen e kërkesës, gjithashtu dhe Gjykatën Supreme, për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 2 korrik 2012, Kryetari, me vendimin GJR. 39/12 caktoi Gjyqtar raportues, gjyqtarin Robert Carolan, që e zëvendëson gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj, meqë ajo përfundoi mandatin e saj si gjyqtare në Gjykatë më 26 qershor 2012. Po të njëjtën ditë, Kryetari, me vendimin KSH. 39/12, caktoi anëtarët e

Kolegjit shqyrtues në përbërje të gjyqtareve: 1. Altay Soroy (kryesues) që e zëvendëson gjyqtaren Iliriana Islami, që po ashtu e përfundoi mandatin si gjyqtare në Gjykatë më 26 qershor 2012, 2. Snezhana Botusharova (anëtare) dhe 3. Ivan Čukalović (anëtar).

10. Më 10 korrik 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi i kërkesës nga 23 korriku i vitit 1983 ka qenë përfitues i pensionit invalidor, kategorizuar me shkallën e parë të invaliditetit. Këtë të drejte ia kishte njohur BVI e sigurimit pensional invalidor të Kosovës, përkatësisht bashkësia e SHERB-PROF-I. nr. 28043.

12. Më 1 janar 2004, MPMS, përkatësisht Departamenti i Administratës Pensionale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: DAPK) bazuar në dokumentacionin e dhe provat e ofruara nga parashtruesi, ia njohu të drejtën për përfitimin e pensionit invalidor për faktin që parashtruesi i kishte plotësuar kushte sipas Ligjit 2003/23 për Pensionet e personave me aftësi të kufizuara.

13. Më 13 prill 2007, DAPK, bazuar ne vlerësimin e Komisionit Mjekësorë, nxori Vendimin nr. 5001462, më ç'rast ia refuzoi kërkesën parashtruesit për vazhdimin e të drejtës së përfitimit të pensionit invalidor. Kundër këtij vendimi parashtruesi kishte ushtruar ankesë në Komisioni e Ankesave të DAPK.

14. Më 30 korrik 2007, DAPK, përkatësish Komisioni i Ankesave me Vendimin nr. 5001462, aprovoi ankesën e ushtruar nga parashtruesi dhe ia njohur serish të drejtën e përfitimit të pensionit të personave me aftësi të kufizuara.

15. Më 1 tetor 2008, DAPK, pasi qe Komisioni Mjekësor kishte vlerësuar se parashtruesi edhe me tutje i plotëson kushtet për

përfitimin e pensionit të personave me aftësi të kufizuara sipas nenit 3 të ligjit 2003/23, nxori vendimin nr. 5001462 dhe vendosi qe, parashtruesit serish t'i vazhdohej e drejta e përfitimit të pensionit invalidor edhe për tri (3) vite të ardhshme, duke e lënë të hapur mundësinë që pas kalimit të afatit tre vjeçar, parashtruesi, t'i nënshtrohej rishqyrtimit dhe rivlerësimit të gjendjes, që kishte të bënte me të drejtën e përfitimit të pensionit invalidor, duke filluar nga data e fitimit të kësaj të drejte.

16. Më 16 mars 2011, DAPK me Vendimin nr. 5001462, bazuar në vlerësimin e Komisionit Mjekësor, ia refuzoi parashtruesit kërkesën për vazhdimin edhe me tej të përfitimit të pensionit invalidor, me arsyetimin se, "te i njëjti nuk ekziston aftësia e kufizuar e plote dhe e përhershme". Kundër këtij vendimi parashtruesi kishte ushtruar ankesë në Komisionin e Ankesave qe vepron në kuadër të DAPK.

17. Më 6 maj 2011, DAPK, bazuar në rivlerësimin e Komisionit të Ankesave, nxori Aktvendimin nr. 5001462 dhe vendosi për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit Mjekësor, duke ia refuzuar kështu parashtruesit të drejtën e përfitimit të pensionit invalidor, për personat me aftësi të kufizuara. Komisioni i Ankesave vendimin e Komisionit Mjekësor e kishte konsideruar si plotësisht të bazuar dhe në përputhje me ligjin 2003/23 për Pensionet e personave me aftësi të kufizuara, për faktin që ky komision vlerësoi që parashtruesi nuk i plotëson edhe më tej kushtet për përfitimin e pensionit invalidor, siç parashihet me nenin 3 të ligjit nr. 2003/23. I pakënaqur me aktvendimin e organit administrativ të shkallës së dytë parashtruesi ushtroi padi për inicimin e Konfliktit Administrativ në Gjykatën Supreme.

18. Më 23 shtator 2011, Gjykata Supreme, duke vepruar sipas padisë së ushtruar nga parashtruesi i kërkesës për inicimin e Konfliktit Administrativ, nxori Aktgjykimin A.nr.639/2011, më ç'rast refuzoi padinë e ushtruar kundër MPMS, përkatësisht DAPK me nr. të dosjes 5001462 të 6 majit 2011. Gjykata Suprem, kishte konstatuar se organet e administrative drejt kishin zbatuar dispozitën e nenit 3 të ligjit 2003/23 për

Pensionet e personave me aftësi të kufizuara, për faktin që komisioni kishte vërtetuar që parashtruesi nuk i plotëson më tej kushtet ligjore për njohjen e të drejtës për pensionin e personave me aftësi të kufizuara.

Pretendimet e parashtrueses

19. Parashtruesi i kërkesës, pretendon se, Gjykatës Supreme, me Aktgjykimin A. nr. 29/2011 të 15 shkurtit 2011, duke ia refuzuar përfundimisht të drejtën për njohjen e statusit të personit me aftësi të kufizuar ka bëre shkelje kushtetuese të të drejtave te tij, të garantuara me: Nenin 51.2 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale], Kapitullin VII, [Sistemi i Drejtësisë], Nenin 102 paragrafi 3 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], Nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejte i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtarë]; dhe Nenin 13 [Kartës Sociale].

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Në mënyrë që Gjykata, të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtrueses, duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kriteret procedurale për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregulloren e punës së Gjykatës.

21. Gjykata, vëren që vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës është Aktgjykimi A. nr.639/2011 i 23 shtatorit 2011, i cili i është dorëzuar parashtruesit më 1 tetor 2011. Ndërsa, parashtruesi kërkesën në Gjykatë e dorëzoi më 13 prill 2012, që nënkupton se kërkesa është dorëzuar jashtë afatit katër (4) mujor, të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, sepse kërkesa është dashur që të dorëzohej në Gjykatë, jo me vone së 1 shkurti 2012.

22. Lidhur me këtë , Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton:

Neni 49 [Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [.. .]"

23. Parashtruesja, nuk ka arsyetuar në asnjë mënyrës vonesën e parashtrimit të kërkesës. Andaj, barra e të provuarit bie mbi palët qe parashtrojnë kërkesën e tyre në Gjykatë. Nga ky këndvështrim, Gjykata, duhet të konsiderojë se kërkesa është parashtruar jashtë afatit të paraparë me ligj. Prandaj, kërkesa është e papranueshme.

24. Rrjedhimisht, Kërkesa, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, Rregullin 56. (2) të Rregullores së Punës është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, më 3 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues **Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Prof. Dr. Enver Hasani

KI 44/12 datë 24 korrik 2012 - Vlerësim i kushtetutshmërisë të aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës P. z. D. 96/2011 të 23 dhjetorit 2011

Rasti KI 44/12, vendimi i 3 korrikut 2012

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, qartazi i pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës ka paraqitur parashtresën në pajtim me nenin 113.7. të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës P. z. D. 96/2011 i 23 dhjetorit 2011 me të cilin gjykata e ka refuzuar si të pabazuar mjetin e jashtëzakonshëm juridik – kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit.

Parashtruesi i kërkesës ka theksuar se me vendimin dhe aktgjykimin e kontestuar janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të parashikuara me nenin 31. (E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm), sepse gjatë gjykimit nuk u arrit të provohet me asnjë provë që parashtruesi i kërkesës ka kryer veprën me të cilën ngarkohet, detyrim, për të cilën u shpall fajtor dhe për të cilën ai u dënua me burgim prej 2 (dy) vjet dhe 6 (gjashtë) muaj për veprën penale të detyrimit nga neni 267, paragrafi 2 të KPPK.

Parashtruesi i kërkesës ka konsideruar që është shkelur neni 31 (E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm) të Kushtetueses, si dhe neni 6 i KEDNJ (E drejta për një proces të rregullt).

Duke vendosur në lidhje me kërkesën e parashtruesit Bali Dellova, Gjykata Kushtetuese, pas shqyrtimit të procesit, nuk ka konfirmuar se proceset relevante para gjykatave të rregullta në asnjë mënyrë janë të padrejta dhe arbitrare. Prandaj, Gjykata ka konstatuar së kërkesa është qartazi e pabazuar, ngase faktet e prezantuara në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin dhe shkeljen e së drejtës kushtetuese.

Prishtinë, më 12 korrik 2012

Nr. ref.: RK/274/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI 44/12

Parashtruesi

Bali Dellova

Vlerësim i kushtetutshmërisë të aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës

P. z. D. 96/2011 të 23 dhjetorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Bali Dellova nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit.

Vendimi i kontestuar

2. Kontestohet aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. P.z.d. 96/2011 i 23 dhjetorit 2011, dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 25 janar 2012, me këtë aktvendim është hedhur poshtë si e pabazuar kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit të parashtruesit të kërkesës i cili me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, P. nr. 36/2009 të 7 shtatorit 2009 është shpallur fajtor për veprën penale detyrim nga neni , 267 paragrafi 2 të KPPK -së dhe është dënuar me burgim prej dy (2) vitesh e gjashtë (6) muajsh, dënim ky që plotfuqishëm është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. nr. 422/2009 të 23 marsit 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është procedura penale që është iniciuar dhe zhvilluar ndaj parashtruesit të kërkesës për veprën penale detyrim nga neni 267 paragrafi 2 KPPK-së në të cilën parashtruesi i kërkesës është dënuar me burgim në kohëzgjatje

prej dy (2) vitesh e gjashtë (6) muajsh, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjatë procedurës është shkelur neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese vendosjen e masës së përkohshme dhe *"të pezullohet përmbarimi i aktgjykimeve deri në marrjen definitive të vendimit të Gjykatës Kushtetuese."*

Baza juridike

5. Kërkesa është e bazuar në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejmë Ligji) dhe rregullin 56 paragrafin 2 të Rregullore e Punës.

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) më 27 prill 2012.

7. Më 28 maj 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme se ka filluar procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit për rastin nr. KI–44-12.

8. Më 3 korrik 2012, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Ivan Čukalović, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botuasharova dhe Kadri Kryeziu, i rekomanduan Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

9. Njëkohësisht Kolegji shqyrtues i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë ta hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit për masa të përkohshme, me arsyetimin se i njëjti nuk ka paraqitur asnjë provë bindëse që do ta arsyetonte futjen e masave të përkoshshme si të domosdoshme që të shmanget ndonjë dëm i pariparueshëm, ose provë se një masë e tillë është në interes publik.

Përmbledhja e fakteve

10. Ndaj parashtruesit të kësaj kërkese z. Bali Dellova dhe katër personave të tjerë, Prokuroria Publike e Qarkut në Prizren ngriti aktakuzën P.P. nr. 305/2008 të 19 janarit 2009, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale detyrim nga neni 267 paragrafi 2 në lidhje me nenin 25 KPPK-së.

11. Aktakuza e ngritur P.P. nr. 305/2008 e datës 19 janar 2009 është vërtetuar me aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren K. A. nr. 9/2009, të 4 shkurtit 2009.

12. Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren P. nr. 36/2009, të 7 shtatorit 2009, parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor për veprën penale detyrim nga neni 267 paragrafi 2 i KPPK-së dhe u dënua me burgim prej dy (2) vjetësh e gjashtë (6) muajsh.

13. Ndaj këtij aktgjykimi të Gjykatës së Qarkut në Prizren P. nr. 36/2009, të 7 shtatorit 2009 në afatin e paraparë me ligj parashtruesi i kërkesës më 9 tetor 2009 ushtroi ankesë përmes avokatit mbrojtës Sylë Hoxha, duke e goditur aktgjykimin në të gjitha bazat ligjore.

14. Duke vendosur sipas ankesës, Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin A. P. nr. 422/2009 të 23 marsit 2011 e refuzoi si të pabazuar ankesën e ushtruar nga ana e parashtruesit të

kërkesës dhe e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren P. nr. 36/2009, të 7 shtatorit 2009.

15. Parashtruesi i kërkesës më 24 nëntor 2011 i paraqiti Gjykatës Supreme të Kosovës mjetin e jashtëzakonshëm juridik kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit.

16. Gjykata Supreme e Kosovës me aktvendimin P. z .d. 96/2011 të 23 dhjetorit 2011, e refuzoi si të pabazuar mjetin e jashtëzakonshëm juridik – kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit me arsyetimin:

> *"Me dispozitën e nenit 448 të KPPK, parashikohet se zbutja e dënimit të shqiptuar lejohet pasi që aktgjykimi të ketë marrë formën e prerë, ndërsa paraqiten rrethana të reja të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën kur janë marrë aktgjykimet ose gjykata nuk ka ditur për to, e kanë ekzistuar e të cilat qartazi do të çonin në shqiptimin e një dënimi më të butë."*
> *"Meqë në kërkesë nuk ceket ndonjë rrethanë e re që qartazi do të ndikonte në zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, kjo gjykatë vlerëson se nuk ka bazë ligjore për zbutjen e zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, prandaj konform dispozitës së nenit 450 par. 6 të KPPK, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi."*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës konsideron "*se me aktvendimet dhe aktgjykimet kontestuese ankuesit i janë shkelë të drejtat e garantuara kushtetuese me Kushtetutën e Republikës së Kosovës të parapara me nenin 31 (e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm) , ngase gjatë gjykimit nuk është provuar me as një dëshmi se ankuesi (parashtruesi i kërkesës) ka kryer veprën qe i është vënë në barrë detyrim për të cilën është shpall fajtor dhe i është shqiptuar dënimi."*

18. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës njëkohësisht *"... i janë shkelë edhe të drejtat e garantuara me konventën evropiane për mbrojtjen e lirive themelore dhe te drejtave të njeriut si dhe protokolleve të saja ,gjegjësisht neni 6 i saj , e cila konvente sipas nenit 22 kushtetutës së Republikës së Kosovës zbatohet drejtpërdrejte ne Kosovë."*

19. Sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës; "*është shkelë edhe neni 7 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, ngase nuk janë vërtetuar dhe saktësuar tërësisht faktet për marrje vendimi, dhe Gjykatat nuk kanë vërtetuar faktet kundër te pandehurit dhe atë në favor të tij."*

20. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykata Kushtetuese me kërkesën që:

> *"Dëshiroj që aktgjykimet dhe aktvendimet kontestuese te anulohen ngase në pajtim me ligjin në fuqi nuk është provuar me prova se kam kry veprën qe më është vënë në barrë ,dhe që gjykimi të behet i paanshëm , vendimi i cili merret të jetë i bazuar në prova të marra dhe të administruara në pajtim me kushtetutën konventat dhe ligjin në fuqi.*
>
> *Në pajtim me Ligjin mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nenin 27, duke pas parasysh se aktgjykimet janë të formës së prerë dhe të përmbarueshme dhe se ankuesi është duke u ftuar për mbajtje të dënimit deri në vendosje të Gjykatës kërkojmë që të caktohet masa e përkohshme dhe të pezullohet përmbarimi i aktgjykimeve deri në marrje definitive të vendimit të Gjykatës Kushtetuese."*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se bazë për kërkesën e tij janë neni 31 (E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm) i Kushtetutës si dhe neni 6 i KEDN-së (E drejta për një proces të rregullt).

22. Neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës parashikon:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*

23. Në bazë të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit, kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për te Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

24. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë provë *prima facie* që do të tregonte se i janë cenuar të drejtat kushtetuese (shih, Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi i GJENJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99 i 31 majit 2005). Parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar se në çfarë mënyre neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së e mbështesin kërkesën e tij ashtu siç parashihet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

25. Parashtruesi i kërkesës pohon se i është cenuar e drejta për (gjykim të drejtë dhe të paanshëm) me zbatimin e gabueshëm të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta duke mos cekur saktësisht se në çfarë mënyrë me këtë aktgjykim i janë cenuar të drejtat kushtetuese.

26. Në rastin konkret parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta për ta paraqitur rastin dhe për të kontestuar interpretimin e ligjit për të cilin konsideron se është i gabueshëm, pranë Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe pranë Gjykatës Supreme të Kosovës. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat përkatëse, në çfarëdo mënyre kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).

27. Përfundimisht, në këtë kërkesë nuk janë plotësuar kushtet për pranueshmëri. Parashtruesi i kërkesës ka dështuar të përmend dhe të mbështesë me prova pretendimin se me aktvendimin e kontestuar i janë cenuar të drejtat dhe liritë kushtetuese.

28. Nga kjo del se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së Punës që parashikon se *„Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.“*

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 3 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TA HEDHË POSHTË kërkesën për masa të përkohshme;

III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues **Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Prof. Dr. Enver Hasani

KI 22/12 datë 26 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Rev.I. br.58/2008 të 27 dhjetorit 2011

Rasti KI 22/12, vendimi i 3 korrikut 2012

Fjalët kyçe; kërkesa individuale, e drejta në proces të rregullt, mbrojtja e pronës, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës ka paraqitur parashtresë në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. I. nr. 58/2008 i 27 dhjetorit 2011 me të cilin është zgjidhur kontesti pronësor-juridik, si rrjedhojë e kërkesës për konfirmimin e pronësisë së patundshmërisë së kontestuar midis parashtruesit të kërkesës dhe palëve të treta.

Parashtruesi i kërkesës konsideron se në praktikën gjyqësore rrallë ndodh që gjykata duke vendosur në lidhje me revizionin, e ndryshon aktgjykimin e formës së prerë dhe vetë vendos në lidhje me çështjen, duke mos arsyetuar mirë aktgjykimin e nxjerrë, duke marrë parasysh se me këtë aktgjykim Gjykata Supreme i ka ndryshuar aktgjykimet e gjykatës së instancës së parë dhe të instancës së dytë. Për shkak të kësaj, parashtruesi i kërkesës ishte i mendimit se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev. I. nr. 58/2008 ishte i padrejtë dhe i njëanshëm, me të cilën paditësit i është bërë shkelja të drejtave të njeriut të parashikuara me Konventën Evropiane. Parashtruesi i kërkesës konsideron se janë shkelur neni 31. (E drejta për gjykim të drejt dhe të paanshëm), 46. (Mbrojtja e pronës) si dhe Protokollet nr. 1, 4, 6, 7, 12 i 13 KEDNJ, dhe neni 6. (E drejta për një proces të rregullt) dhe Protokolli 1 i KEDNJ.Duke vendosur sipas kërkesës së parashtruesit Brahim Krasniqi, Gjykata Kushtetuese pas shqyrtimit të procedurës, nuk ka konfirmuar se procedurat e duhura para gjykatave të rregullta në asnjë mënyre nuk kanë qenë të padrejta dhe arbitrare. Prandaj, Gjykata ka arritur në përfundim se kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse faktet e prezantuara në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin dhe shkeljen e të drejtave kushtetuese

Prishtinë, më 12 korrik 2012

Nr. ref.: RK/272/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 22/12

Parashtruesi

Brahim Krasniqi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Rev.I. br.58/2008 të 27 dhjetorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Brahim Krasniqi, të cilin e përfaqësojnë avokatët Fikri Shishko dhe Shaip Ramadani ng Prizreni, komuna Lipjan.

Kërkesa e parashtruesit të kërkesës

2. Kontestohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës I. Br. 58/2008 i 27 dhjetorit 2011, me të cilin Gjykata Supreme ka aprovuar revizionin e të akuzuarve dhe ka ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Malishevë C. Nr. 185/ 2006, të 29 janarit 2007 dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. Nr. 170/2007 i 6 dhjetorit 2007 dhe ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e parashtruesit.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes të kontestit pronësoro – juridik është krijuar pas kërkesës për përcaktimin e pronësisë kontestuese ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe personave të tretë, i cili është përfunduar me Aktgjykim të formës së prerë të Gjykatës Supreme të Kosovës rev. I .nr.58/2008 të 27 dhjetorit 2011, me të cilën sipas pohimeve të parashtruesit të kërkesës:

> *"Brahim Krasniqi nga Prizreni me aktgjykim të pa drejtë dhe të njëanshëm është privuar nga prona e vet. Me të*

njëjtën, poashtu, është bërë shkelje e së drejtës kushtetues në gjykim të drejtë dhe të paanshëm – neni 31. dhe 46 i Kushtetutës së Kosovës".

"Aktgjykimi i Gjykatës Supreme rev. I. Nr. 58/2008 është e padrejttë dhe e njëanëshme, me të cilën parashtruesit të kërkesës i është bërë shkelje e të drejtave themelore njerëzore të parapara me Konventë Europiane mbi mbrojtjen e të drejtave njerëzore dhe lirive themelore, në lidhje me Protokollin nr.1, 4, 6, 7, 12 dhe 13 , të nenit 6. në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës mbi mbrojtjen e të drejtave njerëzore dhe lirive themelore të vitit 1952".

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejmë: " Ligji ") dhe Rregullit 56 paragrafi 2 të Rregullores së Punës.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Parashtruesi i kërkesës, më 02 mars 2012 ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, (në tekstin e mëtejmë: "Gjykata").

6. Më 21 maj 2012, Gjykata Kushtetuese ka njoftuar parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për inicimin e procedurës së vlerësimit të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit në rastin nr. KI-22-12.

7. Më 3 korrik 2012, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Kadri Kryeziu, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Prof. Dr. Enver Hasani, i

rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Parashtruesi i kërkesës, më 3 maj 2002 ka ushtruar aktpadi në Gjykatën komunale të Malishevës, kundër H. K. dhe të tjerët nga fshati Drenoc, KK Malishevë. Lënda e padisë – vërtetimi i së drejtës së pronës në pronën e paluajtshme. Padia në këtë gjykatë është regjistrua nën numër C. nr.2 4/2002 .
9. Me Aktgjykimin e Gjykatës komunale në Malishevë C.nr. 24 / 2002, të 7 gushtit 2003 është refuzuar si e pabazë kërkesa e paditësit Brahim Krasniqi. Në këtë aktgjykim parashtruesi i kërkesës ka deklaruar ankesë.

10. Gjykata e Qarkut në Prizren, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ana e parashtruesit të kërkesës, kundër aktgjykimit të Gjykatës komunale në Malishevë C. nr. 24/2004 të 7 gushtit 2003, me aktvendimin e vet Ac . nr . 367 /2003 të datës 9 dhjetor 2004, e ka aprovuar ankesën e parashtruesit të kërkesës si të bazuar dhe e ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës komunale në Malishevë C. nr . 24 / 2002 të 7 gushtit 2003 dhe lëndën e ka rikthyer në gjykim.

11. Gjykata komunale në Malishevë, duke vendosur lidhur me procedurën e përsëritur nxjerr aktgjykimin C. nr. 45/ 2995 të datës 27 qershor 2005, me të cilin sërish e refuzon si të pabazuar kërkesën për kompensim të parashtruesit.

12. Parashtruesi i kërkesës paraqet ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës komunale në Malishevë , C. nr. 45/ 2005 të 27 qershorit 2005 .

13. Gjykata e Qarkut në Prizren, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruesit të kërkesës, për herë të dytë në lidhje me çështjen e njëjtë juridike, me aktvendimin e vet Ac. nr. 406/2005 të 27 qershor 2005.

14. Duke vendosur për herë të tretë për kërkesën e parashtruesit të kërkesës Gjykata komunale në Malishevë, me aktgjykimin C. nr

. 185/ 2006 i 29 janarit 2007 lejon kërkesat e paditësit në mënyrën vijuese:

> *"VËRTETOHET se paditësi Brahim Krasniqi është pronar i ngastrës kadastrale nr. 2410 dhe 2411 edhe për sipërfaqen prej 0.10.89 ha të cilën sipërfaqe pa te drejt të padiburit e kanë përvetësuar , ne vendin e quajtur "Rrahishte" me kulturë arë e kl.6 me sipërfaqe prej 0.59,18 ha si dhe pjesa tjetër pra me kulturë arë e kl.5 në sipërfaqe prej 0.48,28 ha ashtu qe sipërfaqja e përgjithshme është prej 1.08,08 ha fletposedimi nr. 258 ZK Drenoc , me dimenzionet e pjesës kontestuese dhe atë sipas kopjes se planit prej pikës A në gjatësi prej 88.66m deri te pika B1 , nga pika B1 deri te pika C1 me gjatësi prej 51,93m ndërsa gjerësi prej 4m , nga pika C1 deri te pika D1 me gjatësi prej 20.78 m kurse me gjerësi prej 8m , nga pika D1 deri te pika E1 me gjatësi prej 32.67m ndërsa me gjerësi prej 6m, nga pika E1 deri te pika F1 me gjatësi prej 47.42m dhe gjerësi prej 5m, dhe nga pika F1 deri te pika H me gjatësi prej 38.00m ndërsa me gjerësi prej 4 m, ashtu qe sipërfaqja kontestuese prej 0.10,89 ha është pjese e ngastrave kadastrale nr. 2410 dhe 2411 me dimenzionet e cekura si me lart , dhe për këtë DETYROHEN të paditurit H., Xh., M., H. dhe B. që të pranojnë këtë fakt, ndërsa të paditurit H. dhe B., detyrohen që ta pranojnë të drejtën e paditësit për sipërfaqen kontestuese prej 0.10,89 ha duke hequr dorë ndaj pretendimeve pronësore për këtë sipërfaqe kontestuese, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ndërsa obligohet Drejtoria për kadastër, gjeodezi dhe pronësi të KK Malishevë që të bartë palujtshmërinë në të gjithë librat kadastral në* pronësi të paditësit, në të kundërtën ekzekutimi do të bëhet me detyrim."

15. Gjykata e Qarkut në Prizren me aktgjykimin Ac. nr. 170/2007, të datës 6 dhjetor 2007, duke vendosur lidhur me ankesën e të akuzuarve H. K. dhe të tj. të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës komunale në Malishevë C. nr . 185/2006 të datës 29 janar 2007, refuzon ankesën e Hasë Krasniqit dhe të tj. si të pa bazuar, dhe e vërteton aktgjykimin e Gjykatës komunale në Malishevë C. nr. 185 / 2006 të datës 29 janar 2007.

16. Pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 170/2007 të 6 dhjetorit 2007, parashtruesi i kërkesës përmes përfaqësuesve të vet të autorizuar ka paraqitur propozim për ekzekutim të aktgjykimit më 25 janar 2008, i cili propozim është evidentuar në Gjykatë si lëndë E. Nr.78/2008. Ekzekutimi i Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 170/2007 të datës 6 dhjetor 2007 është lejuar më datën 31 janar 2008.

17. Më datën 1 Shkurt 2008, të padituri H. dhe B. K. kanë parashtruar kërkesë për revizion si mjet i jashtëzakonshëm juridik kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 170 / 2007 e datës 6 dhjetor 2007, ndërsa më datën 21 shkurt 2008, përfaqësuesi i autorizuar i të akuzuarve ka pashtruar kundërshtim në ekzekutimin e lejuar të Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 170/ 2007, datë 6 dhjetor 2007, ku ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit derisa të nxirret aktvendimi i Gjykatës Supreme sipas kërkesës për revizion.

18. Duke vendosur sipas kërkesës për revizion Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin rev. I. nr.58/2008, datë 27 dhjetor 2011, aprovon revizionin e të akuzuarve H. dhe B. K. dhe NDRYSHON Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. Nr.170/2007 i datës 6 dhjetor 2007, si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Malishevë C. nr. 185/2006 të datës 29 janar 2007. Po ashtu REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e parashtruesit me arsyetim:

> "*... Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e vërtetuar faktike, ka gjetur se një qëndrim i tillë juridik i gjykatës së instancës më të ultë nuk mund të aprovohet si i drejë dhe ligjor, sepse sipas vlerësimit të kësaj gjykate me rastin e vërtetimit të gjendjes së tillë faktitke, gabimisht është aplikuar e drejta materiale kur të dy gjykatat e instancës më të ultë kanë gjetur se kërkesa e paditësit është e bazuar*".
>
> *"Duke pasur parasysh faktet e pa kontestueshme se sipërfaqja kontestuese nga viti 1954 është punuar dhe*

shfrytëzuar nga ish pronari tani ndërhyrësi në procedurë A. K. pa u penguar nga paditësi deri në vitin 1981 kur i njejti ngastrën kad.nr.2408 dhe 2409 së bashku me sipërfaqen kontestuese si tërësi iu ka shitur paraardhësve te paditurve H.dhe B. K., te cilëve edhe iu ka dorëzuar në posedim dhe shfrytëzim sipas-·gjendjes faktike deri te megjet e vjetra qe kanë ekzistuar me ngastrat e paditësit të cilat i kanë punuar pa kurrfarë pengese nga paditësi deri ne vitin 2000 ,se paditësi pas ndarjes me vëIlezërit e tij nga viti 1954 nuk e ka ne posedim dhe shfrytëzim sipërfaqen kontestuese për të cilën pretendon se e ka të drejtën e pronësisë në bazë të Fletës poseduese nr.258 ZK. Drenoc ,meqë sipas ekspertizës së ekspertit gjyqësorë nga lëmi i Gjeodezisë Hysen Thaqi të dt. 05.01. 2007 është konstatuar se sipërfaqja kontestuese udhëhiqet sipas ng.kad.nr.2410 dhe 2411 në emër të paditësit në bazë të aerofotografimit i cili pas deshifrimit ka hyrë në fuqi më 01.01.1967."

"Sipas nenit 20 parag.1 dhe 2 Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore është paraparë se: E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit,në bazë të veprimit juridik, dhe me trashëgim ,ose në bazë të vendimit të organit shtetërore në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj".

"Në rastin konkretë paditësi në pjesën kontestuese nuk ka fituar të drejtën e pronësisë me bazë ligjore të parapara sipas dispozitës së lartcekur meqë në shkresa të lëndës nuk ka prova mbi bazën juridike ndërsa Fleta poseduese nuk paraqet prove për fitimin e pronësisë duke pasur parasysh edhe faktin e vërtetuar se paditësi në sipërfaqën kontestuese nuk është në posedim dhe shfrytëzim nga viti 1954".

"Nga arsyet e cekura si dhe të dhëna të cilat gjenden në shkresat e lëndës kjo Gjykatë, gjeti se gjykatat e instancës më të ulët gabimisht e kanë zbatuar të drejtën materiale, prandaj të dy aktgjykimet e gjykatave u deshtë të ndryshohen dhe kerkesëepadia si e tillë të refuzohet".

Pohimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës konsideron se:

> *"Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, i shoqëruar me shkelje të dispozitave të KPK nenit 225 dhe 224/2, Pasi që praktiken gjyqësore shumë rrallë ndodh që gjykata duke vendosur për revizionin, ta ndryshoj aktgjykimin me formë të prerë dhe vet ta vendos çështjen, pa e arsyetuar mirë aktgjykimin e marrë. Pra në rastin konkret, duke mbajtur parasysh ecurinë e procedurës dhe vendimet dhe vendimet e gjykatës se parë dhe të dytë, sipas padisë së paditësit, krijohet bindja e bazuar se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev.I.nr, 58/2008 është i padrejtë dhe i njëanshëm, me të cilin paditësit i janë shkelur të drejtat e njeriut të parapara me Konventën Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, shoqëruar nga Protokollet Nr. 1, 4, 6, 7, 12 e 13, nenit 6 lidhur me nenin 1 të Protokollit Nr.1 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të njeriut dhe lirive themelore viti 1952, sepse Brahim Kasniqi nga Prizreni, me aktgjykim të padrejtë dhe të njëanshëm është privuar nga prona e tij, Po ashtu Brahim Krasniqit iu është shkelur e drejta kushtetuese për një gjykim të drejte dhe të paanshëm -neni 31 dhe 46 i Kushtetutës së Kosovës".*

20. Sipas pohimeve të parashtruesit të kërkesës *"... po ashtu iu është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanëshëm, nga fakti se i njëjti ne gjysmën e dytë të vitit t 2009, ka parashtruar propozim pranë Gjykatës Komunale në Malishevë, për përmbarimin e aktgjykimit me formë të prerë, lënda e regjistruar – E.nr, 78/2008., mirëpo sipas kësaj kërkese gjykata nuk ka vendosur , me gjasë duke e pritur vendimin e gjykatës sipas mjetit të jashtëzakonshëm".*

21. Parashtruesit e kërkesave i drejtohen Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për:

> *"Anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.I.nr. 58/2008 datë 27.12.2011, me të cilin aplikantit iu është shkeluur e drejta e pronës dhe e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, neni 31 dhe 46 i Kushtetutës së Kosovës, po ashtu ndaj aplikantit janë shkelur të drejtat e njeriut të parapara me Konventën Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, shoqëruar nga Protokollet Nr.1, 4, 6, 7, 12 e 13, nenit 6 lidhur me nenin 1 të Protokollit Nr.1 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të njeriut dhe lirive themelore viti 1952" .*

Vlerësimi i aprovimit të kërkesës

22. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se nenet 31. dhe 46. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe protokolli nr. 1, 4, 6, 7, 12 dhe 13 të GJEDNJ, dhe neni 6 (E drejta në Gykim të DFrejtë) Protokoll 1. i GJEDNJ janë bazë e parashtresës së tij.

23. Neni 48 i Ligjit mbi Kushtetutën e Republikës së Kosovës parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës është i obliguar që të theksoj qartë cilat të drejta dhe liri i janë shkelë dhe cili është akti konkret i organit publik që parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

24. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit, kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë ligjin dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të procedurës dhe të drejtës materiale (shih , *mutatis mutandis,* Garcia Ruiz kundër Spanjës(GC). Nr.30544/96, paragrafi 28 , Gjykata Evropiane për të drejta njerëzore (GJEDNj) 1999-I).

25. Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur kurrfarë dëshmie *prima facie* që tregon shkelje të të drejtave kushtetuese (shih,

Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99 i datës 31 maj 2005.). Parashtruesi i kërkesës nuk thekson në cilën mënyrë nenet 31 dhe 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe neni 6 (E drejta në Gjykim të Drejtë) Protokolli 1 i GJEDNJ, përkrahin kërkesën e tij, sikurse është paraparë me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

26. Parashtruesi i kërkesës pohon se i janë shkelur të drejtat në (Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) dhe (Mbrojtja e Pronës) me aplikimin e gabuar të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta, duke mos theksuar qartë në cilën mënyrë Aktgjykimi ka shkelur të drejtat e tyre kushtetuese.

27. Në këtë rast parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta për të paraqitur rastin e tij dhe të kontestojë interpretimin e ligjit të cilat i konsideron të pasakta, para Gjykatës Komunale në Malishevë, Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe Gjykatës Supreme. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se procedurat përkatëse në çfarëdo mënyre kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis,* Shub kundër Lituanisë, Aktvendimi i GJEDNJ lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06 i datës 30 qershor 2009).

28. Përfundimisht, kushtet për aprovim nuk janë plotësuar në këtë kërkesë. Parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur t'a mbështesë me prova se me aktgjykimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.

29. Nga kjo del se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me Rregullin 36 (2b) të Rregullores së Punës i cili parasheh se„*Gjykata hedhë poshtë kërkesën si të pa bazuar kur konstaton b) se faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pohimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese*".

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 3 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues **Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**

Kadri Kryeziu Prof. Dr. Enver Hasani

KI 38/10 datë 26 korrik 2012- Kërkesa për vlerësimin e procedurës gjyqësore në Gjykatën Komunale në Prishtinë lidhur me lëndën E.nr 34/2001 të datës .19.04.2001 (tejzgjatje e procedurës)

Rasti KI 38/10, vendimi i datës 13 korrik 2012

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, tejzgjatje e procedurës gjyqësore, mosshterje e mjeteve juridike.

Parashtruesi paraqiti kërkesën në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke pretenduar që Aktvendimi E 54/2001 i datës 19.04.2001 i Gjykatës Komunale në Prishtinë me anë të së cilit kjo Gjykatë ka aplikuar masën e përkohshme,e më të cilin parashtruesit të kërkesës z. Milan Vasic ia ka ndaluar atij vënien në hipotekë apo shitjen e pronës së paluajtshme, të një banese në lagjen "Bregu i Diellit" në Prishtinë, të përshkruar si Zona Lindore, A-17, kati i parë, nr. 8, parashtruesit I jane shkel të drejtat e paspecifikuara të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut,dhe sidomos nenin 6 të KEDNJ(e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm), neni 24 i Kushtetutës së Kosovës(barazia para ligjit)dhe neni 31 e 32 i Kushtetutës së Kosovës (drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe e drejta në mjete juridike).

Parashtruesi i kërkesës më tej gjithashtu thekson se procedura para Gjykatës Komunale në Prishtinë ka zgjatur tej mase dhe sipas tij ka kaluar secili afat i arsyeshëm për tu marrë një vendim meritor,gjë e cila e ka dëmtuar atë Gjykata Kushtetuese ka konstatuar që kërkesa është e papranueshme, sepse parashtruesi i kërkesës nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike efektive

Prishtinë, më 13 korrik .2012

Nr. ref.:RK/276/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rasti Nr. KI 38/10

Parashtruesi

Milan Vasić

Dobratin, komuna Lipjanit

Kërkesa për vlerësimin e procedurës gjyqësore në Gjykatën Komunale në Prishtinë

lidhur me lëndën E.nr 34/2001 të datës .19.04.2001 (tejzgjatje e procedurës)

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan Gjyqtar

Altay Suroy, Gjyqtar

Almiro Rodrigues, Gjyqtar

Snezhana Botusharova, Gjyqtare dhe

Ivan Čukalović, Gjyqtar

Parashtruesi i Kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Milan Vasic nga f. Dobrotin komuna e Lipjanit të cilin me Autorizim e përfaqëson avokati z. Ndue Kurti nga Prishtina me banim lagjen Ulpiana A-3,nr.1/1

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes së kërkesës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese nga z. Vasic është Aktvendimi E 54/2001 i dt. 19.04.2001 i Gjykatës Komunale në Prishtinë me anë të së cilit kjo Gjykatë ka aplikuar masën e përkohshme,e më të cilin parashtruesit së kërkesës z. Milan Vasic ia ka ndaluar atij vënien në hipotekë apo shitjen e pronës së paluajtshme, të një banese në lagjen "Bregu i Diellit" në Prishtinë, të përshkruar si Zona Lindore, A-17, kati i parë, nr. 8.

Shkeljet e pretenduara të drejtave të garantuara me Kushtetutë

3. Parashtruesi pretendon që dështimi i Gjykatës Komunale për të ndërmarrë masa të mëtejme shkel të drejtat e paspecifikuara të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut,dhe sidomos nenin 6 të KEDNJ(e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm), neni 24 i Kushtetutës së Kosovës(barazia para ligjit)dhe neni 31 e 32 i Kushtetutës së Kosovës (drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe e drejta në mjete juridike)

Baza juridike

4. Neni 113.7 Kushtetutës së Republikës së Kosovës(në te tekstin e mëtejmë Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i dt. 16 Dhjetor 2009 i hyrë në fuqi me 15 janar 2010(në tekstin e mëtejmë referuar si Ligji), dhe neni 29 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë i referuar si rregullorja).

Ankesa e parashtruesit

5. Parashtruesi i kërkesës ka pohuar se Gjykata Komunale në Prishtinë duke nxjerrë Aktvendimin për masën e përkohshme E 54/2001 i dt.1 9.04.2001 e me të cilën atij i ka ndaluar vënien në hipotekë, shitjen apo tjetërsimin e paluejtshmërisë-banesë e cila gjendet në Prishtinë në lagjen " Kodra e Diellit" dhe ka sipërfaqe prej 56,56 m² ,e për të cilin ai pretendon se është pronar i ligjshëm i saj, pa të drejtë ia ka cenuar të drejtat e garantuara me Konventa Evropiane si dhe me Kushtetutën e Kosovës (neni 24,31 e 32).

6. Parashtruesi i kërkesës më tej gjithashtu thekson se procedura para Gjykatës Komunale në Prishtinë ka zgjatur tej mase dhe sipas tij ka kaluar secili afat i arsyeshëm për tu marrë një vendim meritor,gjë e cila e ka dëmtuar atë.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 10.06.2010 Gjykata Kushtuese pranoj kërkesën e z. Milan Vasic ku dhe e regjistroi atë me nr KI 38/10

8. Më 11.11.2010 me vendimin GJ.R 38/10 Kryetari i Gjykatës caktoj Gjyqtar raportues gjyqtarin Robert Carolan.

9. Të njëjtën ditë Kryetrari i Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje Altay Suroy (kryesues) dhe gjyqtarët Amiro Rodrigez e prof. Dr. Enver Hasani në cilësi të anëtarëve të kolegjit

10. Gjykata Kushtetuese kishte njoftuar Gjykatën Komunale në Prishtinë më 4 gusht 2011 të për regjistrimin e kërkesës duke kërkuar edhe përgjigjeje me shkrim lidhur me statusin momental të lëndës e cila shqyrtohet në atë gjykatë e që ka të bëjë me kërkesën e parashtruar në Gjykatën Kushtetuese, Një njoftim të tillë Gjykata i ka dërguar edhe përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës.

11. Më 22 .08.2011 Gjykata Kushtetuese ka pranuar përgjigjen me shkrim nga Gjykata Komunale në të cilën shpjegohet kronologjia e lëndës si dhe bashkëngjiten kopjet e vendimeve të marra deri në këtë kohë.

12. Më 27.09.2011 Gjykata Kushtetuese ka pranuar një përgjigjeje shtesë nga Gjykata Komunale në Prishtinë në të cilën Gjyqtari z. Zenel Leku, shpjegon se lidhur me padinë për vërtetimin e pronësisë të ushtruar nga z. Bekë Hasanaj se kjo gjykatë e ka pranuar padinë me 11.05.2001 dhe se gjyqtarja e ngarkuar për këtë lëndë ka mbajtur një seancë me 20.04.2004 dhe ka pezulluar lëndën deri sa të vendos UN-Habitati për të njëjtën çështje ,ndërsa i autorizuari i z. Vasic ka parashtruar përgjigjeje

në Padi më 09.02.2009, Gjyqtari leku gjithashtu ka potencuar se për shkak lëvizjeve të shpeshta në këtë gjykatë ai është ngarkuar me këtë lëndë m]ë 30.11.2010 dhe se është i vetëdijshëm për natyrën prioritare të lëndës.

13. Gjykata Kushtetuese ia kishte dërguar këto komente përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës me 27 shtator 2011.

14. Më 03 tetor 2011 Gjykata kushtetuese ka pranuar përgjigjen e përfaqësuesit të z. Vasic, avokatit z. Ndue Kurti lidhur me komentet e Gjykatës Komunale.

15. Më 30 04.2012 Gjykata Kushtetuese ka pranuar Aktvendimin C.nr 500/2001 të datës 16.04.2012 të Gjykatës Komunale në Prishtinë me të cilin kjo Gjykatë shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore për këtë lëndë.

16. Në pikën II të këtij Aktvendimi përcaktohet që sapo aktvendimi të bëhet i formës së prerë ai do ti dërgohet dhomës së posaçme të Gjykatës Supreme për vendosje ndërsa në këshillën juridike të këtij aktvendimi thuhet se kundër tij lejohet ankesa në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së tij.

17. Gjykata Kushtetuese nuk ka informacion nëse Aktvendimi është bërë i formës së prerë dhe i është dërguar dhomës së veçantë të Gjykatës Supreme ose nëse ndonjëra nga palët ka paraqitur ankesë kundër tij.

18. Në seancën e mbajtur me 12.korrik 2012 paneli shqyrtues i rekomandoj Gjykatës në përbërje të plotë njëzëri për papranueshmërinë e kërkesës,

Përmbledhja e fakteve

19. Parashtruesi i kërkesës z. Milan Vasic pretendon se ka pronësinë mbi banesën e cila gjendet e cila gjendet në Prishtinë në lagjen" Kodra e Diellit"-zona e lindjes A-17 kati i I-rë banesa nr 8 dhe që ka sipërfaqe prej 56.56 m² dhe këtë të pretendim të tij ai e mbështet në Kontratën mbi shitblerje të lidhur ne mes tij

dhe KXMK "Trepca" D.D të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë vr.nr. 2190/98 dt. 09.06.1998 dhe aneks kontratën vr.nr 413/99 të datës 26.03.1999(të cilat nuk ia ka bashkangjitur kërkesës) dhe të cilat sipas tij atë e deklarojnë si pronar të kësaj banese,sikur që edhe Vendimet e UN-Habitatit HPCC në Prishtinë DS 000111 dhe DS 000631 të dt. 12.12.2003 dhe vendimi i shkallëssë dytë HPCC DS 000111 dhe DS00031 të dt. 16.11.2006 ia japin të drejtën e posedimit të banesës së sipërpërmendur.

20. Më 19.04.2001 Gjykata Komunale në Prishtinë duke vepruar sipas propozimit të kreditorit z.. Bekë Hasanaj nga Prishtina i cili pretendon se ka qenë pronarë i ligjshëm i banesës së sipërpërmendur para se z,Vasic të hynte në te, kishte nxjerrë Aktvendimin E.nr.54/2001 me anë të së cilit ka shqiptuat masën e përkohshme dhe njëkohësisht debitorit z. Milan Vasic nga fshati Dobratin i komunës së Lypjanit i ka ndaluar ngarkimin (vuarjen në hipotekë), shitjen e patundshmërisë ,gjegjësisht legalizimin e kontratës mbi shitblerjen e banesës

21. Sipas fletkëkthesës së Gjykatës Komunale z. Milan Vasic këtë Aktvendim e kishte pranuar më 24.05.2007.

22. Më 29. 05 2007. Z.Vasic ka ushtruar kundërshtim në Gjykatën Komunale në Prishtinë, kundër Aktvendimit të kësaj Gjykate për caktimin e masës së përkohshme E.nr.54/01 të dt.15.04.2001.

23. Më 6.12.2007 Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktvendimin E.nr.54.2001 ka refuzuar kundërshtimin e z. Vasic dhe ka lënë në fuqi Aktvendimin për caktimin e masës së përkohshme me të njëjtin numër të dt. 19.04.2001.

24. Pas aprovimit të kërkesës së dhe caktimit të masës së përkohshme z.Bekë Hasanaj kishte paraqitur padinë kundër të padituës së parë "Miniera me Flotacion" Kishnicë dhe Novobërdë dhe të padituit të dytë z. Milan Vasic dhe atë "Për Vërtetimin e pronësisë dhe prishjen e vendimit mbi ndarjen e banesës dhe të kontratës mbi shitblerje" dhe kjo padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë udhëhiqet me shenjen C.nr 500/2001.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

25. Për te qene ne gjendje për te gjykuar mbi Kërkesën e Parashtruesit te kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht te vlerësojë nëse Parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë te cilat përcaktohen ne Kushtetutë.

26. Në lidhje me ketë, Gjykata i referohet nenit 113.7 te Kushtetutës qe përcakton se:

*"Individët janë te autorizuar te ngrenë **shkeljet nga autoritetet publike te drejtave dhe lirive te tyre individuale**, **te garantuara me Kushtetute**, mirëpo **vetëm** pasi te **kenë shteruar te gjitha mjetet juridike** te përcaktuara me ligj."*

Gjykata Gjithashtu merr parasysh:

Rregullin 36 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese ku përcaktohet:

"(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

c) Kërkesa është qartas e bazuar:

27. Duke analizuar dokumentacionin e paraqitur në lëndë nga ana e parashtruesit të kërkesës konstatohet se Aktvendimi i fundit i Gjykatës Komunale në Prishtinë me të cilin është refuzuar kundërshtimi i z. Vasic për caktimin e masës së përkohshme është nxjerrë me 6 dhjetor 2007 dhe se sipas shkresave të deponuara në lëndë së bashku me kërkesën Gjykata nuk gjen

fakt se ndaj këtij Aktvendimi të jetë ushtruar mjeti juridik i ankesës i cili palës i është dhënë në udhëzimin juridik si mundësi efektive juridike e cila do të duhej ti drejtohej Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit për procedurë përmbarimore.

28. Gjykata Gjithashtu konstaton se pas nxjerrjes së Aktvendimit C.nr 500/2001 nga ana e Gjykatës Komunale në Prishtinë të datës 16.04.2012 pavarësisht nga fakti nëse Aktvendimi është bërë i formës së prerë dhe lënda i është dërguar për vendim marrje dhomës së veçantë të Gjykatës Supreme ose faktit që ndonjëra nga palët mund të ketë paraqitur ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë .kemi të bëjmë me një rast në pritje të zgjedhjes dhe rrjedhimisht për pasojë ka prapë mos shterjen e mjeteve juridike.

29. Bazuar në këtë fakt Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk e ka përmbush kriterin e pranueshmërisë së shterjes të mjeteve juridike të paraparë me nenin 113.7 të Kushtetutës si dhe rregullit 36.1(a) të rregullores së Punës së Gjykatës kushtetuese.

30. Gjykata dëshiron te theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit te mjeteve juridike është qe t'ua ofrojë autoriteteve vendore, përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar te Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi ligjor i Kosovës, do te sigurojë mjet efikas ligjor për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni v. France nr. 25803/94, Vendim i 28 korrikut 1999

31. Gjykata një arsyetim të tillë e kishte aplikuar në gjatë shqyrtimit të mëparshëm të kërkesave e në rastet : KI 55/10 Hamide Osaj në kërkesën për Vlerësim i Kushtetutshmërisë te Aktgjykimit te Gjykatës Supreme te Kosovës, Pkl. nr. 43/2010, i datës 4 qershor 2010 ; Rastin nr. KI 20/10 Muhamet Bucaliu kundër Vendimit te Prokurorit te Shtetit KMLC.nr. 09/10 te 24 shkurtit 2010(vendimi i GJ,Kushtetuese i datës 15 Tetor 2010)

32. Gjykata vëren se sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për një tejzgjatje të ”paarsyeshme të procedurës” se “zgjatja e procedurës në shumicën e rasteve varet nga rrethanat specifike të rastit” (shih. Cerin v.Croatia,no 54727000.08.03.2001 par 2), dhe si pasojë të kësaj edhe shkeljes së nenit 6 të KEDNJ (e drejta në gjykim të drejtë dhe kohë të arsyeshme), dhe në rastin konkret z. Vasic si palë kërkuese nuk ka paraqitur ndonjë provë relevante që do të justifikonte pretendimin tij, përpos se ka cekur kohën brenda të cilës nuk është zgjedhë lënda.

33. Me këtë rast Gjykata përkujton se GJEDNJ lidhur me çështjen e tejzgjatjes së procedurës para autoriteteve vendore ka përcaktuar disa kritere siç janë: kompleksiteti i çështjes, sjellja e aplikuesit, sjellja e autoriteteve relevante, rreziku për aplikuesin në procedurë, gjendja(faza) e procedurës etj.

34. Sa i përket kriterit të sjelljes së kërkuesit Gjykata i referohet rastit të GJEDNJ (Darnell v.U.K. 15058/89, 10/04/91). ku është specifikuar” Megjithatë, edhe në qoftë se gjykata kombëtare vetë g është përgjegjëse për vonesat në procedurë, aplikanti duhet të ketë duhet ti ketë kundërshtuar a to në mënyrë që të provojë që për vonesat e panevojshme të mos mund të mbahet përgjegjës ai vetë”

35. Duke parë se z. Vasic nëpërmes përfaqësuesit të vet ligjor, përgjigjja në Padi për lëndën C.nr.500/2001 në të cilin ai kishte statusin e të padituri e kishte bërë tek më 09.02.2009,ndërsa urgjencën e parë dhe të vetme për përshpejtimin e procedurës lidhur me këtë lëndë e kishte bërë me 15.2009 edhe pse lënda ishte në procedurë nga 11.05.2001 Gjykata konstaton se edhe z. Vasic me mosveprimin e vet ka ndikuar në zgjatjen e procedurës.

36. Duke Gjykuar kriterin e “sjelljes së autoriteteve relevante” Gjykata Kushtetuese vlerëson se Gjykata Komunale në përgjigjen e vet të dt. 27.09.2011 kishte shpjeguar veprimet kronologjike ne këtë gjykatë lidhur me këtë lëndë duke potencuar edhe arsyet e vonesave nga të cilat nuk vërehet se procedura në këtë Gjykatë qëllimshëm është zvarritur.

37. Gjykata Kushtetuese megjithatë rikujton se është obligim i të gjitha autoriteteve publike vendore përfshi edhe Gjykatat e rregullta që të marrin vendime meritore lidhur me çështjet e ngritura para tyre dhe atë në përputhje me nenin 31.2 të Kushtetutës së Kosovës se "Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj."

38. Në këto rrethana parashtruesi ankesës nuk ka shterur kësaj here të gjitha mjetet juridike në dispozicion andaj kërkesa

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, më 12 korrik 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim to ti komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në përputhje me nenin 20 (4) të Ligjit;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Robert Carolan	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 55/11 datë 20 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 518/2010, të 26 nëntorit 2010

Rasti KI 55/11, Aktgjykimi i 9 korrikut 2012
Fjalët kyçe: përmbarim, vendim përfundimtar dhe i ekzekutueshëm, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, kërkesë individuale, e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mjete ligjore, e drejta për punë, shkelje e të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi i kërkesës, z. Fatmir Pireci, e dorëzoi kërkesën bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke e kontestuar vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 518/2010, me pretendimin se ishte marrë në kundërshtim me të drejtat e tij të garantuara nga neni 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe neni 49 [E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, pasi që Gjykata e Qarkut e refuzoi propozimin e parashtruesit për ekzekutimin e vendimit të Bordit të Pavarur Mbikëqyrës. Vendimi i KPM-së ishte një vendim i marrë nga një organ administrativ i cili kishte asgjë të bëjë me një pretendim monetar siç është paraparë me Ligjin për Procedurën Përmbarimore. Prandaj, vendimi i KPM-së nuk ishte një titull për ekzekutim të cilin Gjykata e Qarkut duhet ekzekutuar, por ajo ishte brenda kompetencave të KPM-së, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2008/12, për të ekzekutuar vendimet e veta.

Lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, Gjykata vendosi që, bazuar në gjuhën e thjeshtë të nenit 113.7, kjo kërkesë ishte e pranueshme sepse në kërkesën e tanishme z. Fatmir Pireci e konteston kushtetutshmërinë e Vendimit Ac. nr. 518/2010 të Gjykatës së Qarkut në Prizren, të 26 nëntorit 2010. Prandaj, parashtruesi i kërkesës duhet të konsiderohet palë e autorizuar, me të drejtën e adresimit të kësaj çështjeje në Gjykatë dhe se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, siç parashikohen me ligj, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës. Sa i përket kërkesës së nenit 49 të Ligjit se parashtruesi është dashur ta dorëzojë kërkesën brenda një periudhe prej katër (4) muajsh Gjykata përcaktoi se nga parashtresat e parashtruesit, parashtruesit i ishte dorëzuar vendimi i lartpërmendur i Gjykatës së Qarkut më 17 dhjetor 2010, përderisa parashtruesi e kishte dorëzuar kërkesën në Gjykatë më 22 prill 2011, dmth. brenda afatit katër

mujor, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit. Pastaj, parashtruesi i përcaktoi saktë cilat të drejta sipas Kushtetutës dhe KEDNJ pretendohen të jenë shkelur dhe nga cili autoritet publik. Prandaj, Gjykata gjithashtu gjen se parashtruesi e ka plotësuar kushtin e nenit 48 të Ligjit.

Për meritat e kërkesës, Gjykata vendosi se, pasi që KPM-ja kishte gjetur shkelje të së drejtës së parashtruesit për punë, vendimi i të cilit ishte bërë përfundimtar dhe i ekzekutueshëm, parashtruesi kishte të drejtë për mjet efektiv juridik, pasi që Komuna e Prizrenit refuzoi ta ekzekutonte vendimin e KPM-së. Megjithatë, siç u përmend më lart, në vend të ekzekutimit të vendimit të KPM-së, siç ishte detyra e tyre ligjore, të dyja, Gjykata Komunale dhe ajo e Qarkut refuzuan ta bëjnë këtë. Duke mos e zbatuar vendimin e KPM-së të 25 qershorit 2008, autoritetet përkatëse i kanë privuar dispozitat e nenit 54 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ nga të gjitha efektet e dobishme Në këto rrethana, Gjykata konsideron se e drejta për gjykim të drejtë dhe efektiv, siç garantohet me nenet e Kushtetutës dhe KEDNJ-së, është shkelur dhe se vendimi përfundimtar dhe i ekzekutueshëm i KPM-së i Nr. 49/08 i 25 qershorit 2008, duhet të ekzekutohet. Në arritjen e vendimit të saj, Gjykata gjithashtu u mbështet në vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që adresojnë çështjen e njëjtë ose të ngjashme. Gjykata e shpalli të pavlefshëm vendimin e Gjykatës së Qarkut dhe e ktheu vendimin në Gjykatën e Qarkut për rivendosje, në pajtim me aktgjykimin e kësaj gjykate.

Prishtinë, më 16 korrik 2012

Nr. ref.: RK/277/12

AKTGJYKIM

në

Rastin nr. KI 55/11

Parashtruesi

Fatmir Pireci

Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 518/2010, të 26 nëntorit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Fatmir Pireci, me vendbanim në Prizren.

Vendim i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 518/2010, të 26 nëntorit 2010, që i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 17 dhjetor 2010.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) më 22 prill 2011 me të cilën kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 518/2010.

4. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i janë cenuar të drejtat e garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe nenin 49 [E drejta e Punës dhe

Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 (1) të Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

6. Më 22 prill 2011, parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 28 prill 2011, Kryetari me Vendimin Nr. GJR. 55/11, e emëroi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare Raportuese. Të njëjtën datë, me Vendim Nr. KSH. 55/11, e emëroi Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (Kryesues), Almiro Rodrigues dhe Iliriana Islami. Më 2 korrik 2012, me Vendim nr. GJR. KI 55/11 Kryetari e zëvendësoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj me gjyqtarin Kadri Kryeziun si Gjyqtar Raportues pasi që mandati i gjyqtares Gjyljeta Mushkolaj si gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese kishte mbaruar më 26 qershor 2012. Të njëjtën ditë, Kryetari me Vendim nr. KSH 55/11 e zëvendësoi anëtaren e Kolegjit Shqyrtues gjyqtaren Iliriana Islami me gjyqtarin Altay Suroy pasi që mandati i gjyqtares Iliriana Islami si gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese kishte mbaruar më 26 qershor 2012.

8. Më 26 maj 2011, Gjykata ia komunikoi kërkesën Gjykatës së Qarkut në Prizren.

9. Më 21 qershor 2011, Gjykata ua dërgoi Qeverisë, Zyrës së Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit dhe Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës (në tekstin e mëtejmë: KPM) këto pyetje:

"...

a. A jeni njoftuar nga parashtruesi i kërkesës që vendimi i Këshillit Pavarur Mbikëqyrës, Nr. 49/08 i datës 25 qershor 2008 nuk është zbatuar nga Komuna e Prizrenit?

b. Çfarë veprime keni ndërmarr ju sipas Rregullores nr. 2008/12 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, pasi parashtruesi i kërkesës ju ka njoftuar që vendimi i Këshillit Pavarur Mbikëqyrës, Nr. 49/08 i datës 25 qershor 2008 nuk është zbatuar nga Komuna e Prizrenit?

c. Si ekzekutohen vendimet e Këshillit Pavarur Mbikëqyrës sipas Rregullores nr. 2008/12 për ndryshimin e rregullores se UNMIK-ut 2001/36 mbi shërbimin civil të Kosovës dhe sipas Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mënyre që parashtruesi i kërkesës ta fitojë të drejtën që i është dhënë atij me vendimin e Këshillit Pavarur Mbikëqyrës, Nr. 49/08 të datës 25 qershor 2008?

..."

10. Më 27 qershor 2011, KPM u përgjigj duke thënë se ata ishin njoftuar nga parashtruesi i kërkesës se vendimi i KPM-së nuk po zbatohej dhe se këtë informacion KPM ia kishte përcjellë Kuvendit. Më tej, KPM-ja theksoi se vendimet e KPM-së duhet të zbatohen, përndryshe vendimet e KPM-së i nënshtrohen procedurave përmbarimore pranë gjykatave kompetente. Një numër i madh i vendimeve të KPM-së janë përmbaruar përmes procedurës përmbarimore nga gjykata kompetente. Më tutje, KPM i dorëzoi Gjykatës një vendim të Gjykatës Komunale në Prishtinë (Vendimi E. nr. 1155/10 i 14 janarit 2011), ku Gjykata

Komunale kishte lejuar propozimin për përmbarim të vendimit të KPM-së në mbështetje të nenit 28.1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore dhe neneve 13, 14 dhe 15.4 të Ligjit për KPM-në.

11. Më 1 korrik 2011, Gjykata i kërkoi parashtruesit të kërkesës të dorëzonte dëftesën e pranimit të vendimit të Gjykatës së Qarkut. Ai bëri këtë më 13 korrik 2011.

12. Më 5 korrik 2011, Kuvendi iu përgjigj Gjykatës se i kishte dërguar një raport Zyrës së Kryeministrit për këtë çështje dhe konstatoi se vendimi i KPM-së nuk ishte përmbaruar.

13. Më 12 korrik 2011, Zyra e Kryeministrit iu përgjigj Gjykatës duke thënë se e kishin njoftuar parashtruesin e kërkesës dhe KPM-në se vendimi i KPM-së është dashur të përmbarohet.

14. Më 9 korrik 2012, Gjykata mbajti këshillime dhe votoi për rastin.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 31 janar 2008, me Vendim Nr. 01/118-374, Zyra e Personelit e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme e Komunës së Prizrenit ia ndërpreu kontratën e punës parashtruesit të kërkesës, pasi që pozita "Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv" nuk parashihej me Rregulloren e UNMIK-ut 2007/30 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e UNMIK-ut 2007/30). Ndaj këtij vendimi parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Bordin e Ankesave pranë Komunës së Prizrenit.

16. Më 15 shkurt 2008, ankesa e parashtruesit u refuzua nga Bordi i Ankesave dhe vendimi për ndërprerjen e kontratës së punësimit parashtruesit të kërkesës u vërtetua (Vendimi Nr.

01/118-496). Ndaj këtij vendimi, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në KPM.

17. Më 25 qershor 2008, KPM-ja e miratoi ankesën dhe urdhëroi punëdhënësin që ta kthente në punë parashtruesin e kërkesës (Vendimi Nr. 49/08). KPM-ja theksoi se Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2008/12 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: "Rregullorja e UNMIK-ut 2008/12") nuk e parasheh ndërprerjen e kontratës së punësimit në bazë shuarjes së vendit të punës, kur kontrata është ende vlefshme. KPM-ja dha arsyetimin se vetëm nëse ka skaduar kontrata e punësimit atëherë punëdhënësi mund të refuzojë vazhdimin e kontratës së punësimit në bazë të shuarjes së vendit të punës. Kështu nuk ka ndodhur me parashtruesin e kërkesës pasi që kontrata e tij punësimit ishte ende e vlefshme. Vendimi i KPM-së ishte i formës së prerë.

18. Më 2008, parashtruesi i kërkesës e njoftoi Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Kryeministrin e Republikës së Kosovës se vendimi i KPM-së ishte shpërfillur nga Komuna e Prizrenit.

19. Më 13 nëntor 2008, Kuvendi i Kosovës i rekomandoi parashtruesit të kërkesës që të paraqiste padi në Gjykatën Komunale të Prizrenit.

20. Më 30 prill 2010, me Vendim AC. nr. 518/2010, Gjykata Komunale në Prizren e hodhi poshtë propozimin e parashtruesit të kërkesës për përmbarim të vendimit të KPM-së. Gjykata Komunale theksoi se vendimi i KPM-së ishte vendim i nxjerrë nga një organ administrativ që nuk kishte asgjë të bënte me kërkesë në të holla siç parashihet me Ligjin për Procedurën Përmbarimore. Rrjedhimisht, vendimi i KPM-së nuk ishte titull përmbarimor të cilin Gjykata Komunale duhej përmbaruar, por ishte në kompetencat e KPM-së që, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2008/12, të përmbaronte vendimet e veta.

21. Më 26 nëntor 2010, Gjykata e Qarkut e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi vendimin e Gjykatës Komunale (AC. nr. 518/2010).

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

23. Gjykata duhet së pari të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës, ku thuhet se *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."* Në këtë kuptim, kërkesa është parashtruar në Gjykatë nga një individ. Prandaj, parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, që ka të drejtë ta ngrehë këtë rast në Gjykatë në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës.

24. Përveç kësaj, sa i përket kriterit për parashtrimin e kërkesës nga ana parashtruesit brenda afatit prej 4 muajsh nga data e marrjes së vendimit të fundit gjyqësor në këtë rast, Gjykata përcakton se Gjykata e Qarkut në Prizren e nxori vendimin Ac. nr. 518/2010 më 26 nëntor 2010, ndërsa parashtruesi i kërkesës e mori vendimin më 17 dhjetor 2010. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 22 prill 2011. Parashtruesi i kërkesës rrjedhimisht e ka respektuar afatin e përcaktuar me nenin 49 të Ligjit për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë.

25. Përveç kësaj, në bazë të nenit 12 dhe 14 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, Gjykata e Qarkut në Prizren konsiderohet "gjykatë e shkallës së fundit për gjykimin e çështjeve që ndërlidhen me përmbarimin". Rrjedhimisht, parashtruesi i

kërkesës i ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion në bazë të ligjeve të Kosovës. ..

26. Për më tepër, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e ka respektuar nenin 48 të Ligjit: *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."* Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur neni 24 [Titulli ekzekutiv] i Ligjit për Procedurën Përmbarimore i cili në pikën b) përcakton se:

Neni 24.1: *Titujt ekzekutiv janë:*

[...]

b) vendimi ekzekutiv i dhënë në procedurë administrative [...]. *Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI.*

27. Pasi që parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka respektuar afatet për parashtrimin e kërkesë në Gjykatë, i ka shterur të gjitha mjetet juridike dhe i ka qartësuar saktësisht shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive, përfshirë vendimin të cilin e konteston, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë.

Vlerësimi kushtetues i kërkesës

28. Pasi që parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet procedurale të pranueshmërisë, Gjykata duhet të shqyrtojë meritat e ankesës së parashtruesit.

29. Në lidhje me parashtresat e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e konteston vendimin Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 518/2010, të datës 26 nëntor 2010, me të cilin u vërtetua vendimi i Gjykatës Komunale për mospërmbarimin e vendimit të KPM-së.

30. Gjykata vëren se, më 25 qershor 2008, KPM-ja e miratoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e urdhëroi punëdhënësin që ta kthente në punë parashtruesin e kërkesës (Vendimi Nr. 49/08). KPM-ja theksoi se Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2008/12 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e UNMIK-ut 2008/12) nuk parasheh ndërprerjen e kontratës së punësimit në bazë të shuarjes së vendit të punës, kur kontrata e punësimit është ende e vlefshme. KPM-ja dha arsyetimin se vetëm nëse ka skaduar kontrata e punës atëherë punëdhënësi mund të refuzojë vazhdimin e kontratës së punës në bazë të shuarjes së vendit të punës. Kështu nuk ka ndodhur me parashtruesin e kërkesës pasi që kontrata e tij punësimit ishte ende e vlefshme. Vendimi i KPM-së ishte i formës së prerë.

31. KPM-ja u themelua në shtator 2004 në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës të 22 dhjetorit 2001. *Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI*.

32. Detyrat dhe përgjegjësit e KPM-së u riafirmuan më vonë me nenin 101.2 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës i cili parashikon: *Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil* [...]".

33. Ligji Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i miratuar nga Kuvendi më 15 korrik 2010 dhe në zbatim të nenit 101.2 të Kushtetutës, në nenin 3 parashikon: *"Këshilli është organ i pavarur që i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i cili zgjidh ankesat e nëpunësve si dhe siguron respektimin e të gjitha rregullave dhe parimeve që rregullojnë Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës." Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI*.

34. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se vendimet e KPM-së janë të formës së prerë dhe të zbatueshme në procedurën administrative dhe se ankesa ndaj vendimeve të KPM-së në bazë të nenit 14 [E drejta e ankesës] nuk e ndalon përmbarimin e këtyre vendimeve. Përveç kësaj, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2008/12, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK Nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, neni 11 [Ankesat] parasheh: *"Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë, që i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në përputhje me ligjin në fuqi". Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI.*

35. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se Komuna e Prizrenit nuk ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim gjyqësor në gjykatën kompetente, me ç'rast ka pranuar obligimin për përmbarimin e vendimit të KPM-së brenda afatit ligjor.

36. Po ashtu KPM-ja, në përgjigjën e saj drejtuar Gjykatës më 27 qershor 2011, theksoi se vendimet e tij duhet të përmbarohen, dhe nëse kjo nuk ndodh, ato i nënshtrohen procedurave përmbarimore pranë gjykatave kompetente. Më tutje, KPM i dorëzoi Gjykatës një vendim të Gjykatës Komunale në Prishtinë (Vendimi E. nr. 1155/10 i 14 janarit 2011), ku Gjykata Komunale kishte lejuar propozimin për përmbarim të vendimit të KPM-së në mbështetje të nenit 28.1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore dhe neneve 13, 14 dhe 15.4 të Ligjit për KPM-në. *Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI.*

37. Gjykata vëren se gjithashtu edhe Zyra e Kryeministrit në përgjigjën e dërguar në Gjykatë theksoi vendimi i KPM-së është dashur të përmbarohet dhe se Kuvendi në përgjigjen e tij të datës 13 nëntor 2008, i rekomandoi parashtruesit të kërkesës që të paraqiste kërkesë në Gjykatën Komunale në Prizren për përmbarimin e vendimit të KPM-së.

38. Pa marrë parasysh këtë situatë juridike, më 26 nëntor 2010, Gjykata e Qarkut në Prizren, Ac. nr. 518/2010, e vërtetoi vendimin e Gjykatës Komunale të 30 prillit 2010, me ç'rast kërkesa e parashtruesit për përmbarim të vendimit të KPM-së të 25 qershorit 2008 u refuzua dhe konkludoi që, në bazë nenit 23 [Titulli ekzekutiv] të Ligjit Nr. 03/L-008 për Procedurën

Përmbarimore, vendimi i KPM-së nuk ishte titull përmbarimor i vlefshëm për kthim në punë. *Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI*.

39. Në bazë të fakteve të lartpërmendura, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka bërë çdo përpjekje të mundshme për të shfrytëzuar të gjitha mjetet që i ka në dispozicion në bazë të ligjeve të Kosovës që të përmbarohet vendimi i KPM-së, por që, me gjithë përpjekjet e tij, vendimi i KPM-së nuk është zbatuar as nga organet përgjegjëse komunale, dhe as nga gjykatat kompetente, siç ka kërkuar parashtruesi i kërkesës.

40. Vendimi i KPM-së, që kishte marrë formë të prerë pasi që Komuna e Prizrenit nuk kishte paraqitur kërkesë për rishqyrtim gjyqësor pranë gjykatës kompetente, mbetet i papërmbaruar për arsye se Komuna e Prizrenit si dhe gjykatat kompetente, të cilat është dashur ta përmbarojnë vendimin e KPM-së me kërkesë të parashtruesit të kërkesës, e injoruan obligimin ligjor që e kishin në bazë ligjeve të aplikueshme në Kosovë, dhe kësisoj shkelën parimin e sundimit të ligjit që është bazament i rendit juridik të Kosovës.

41. Ky rast duhet të kuptohet se ngrit çështje jo vetëm në kuptim të nenit 24 [Titulli ekzekutiv] i Ligjit për Procedurën Përmbarimore, por edhe në kuptim të nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] në lidhje me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive], që garanton mbrojtje të barabartë të të drejtave në procedurat pranë gjykatave, organeve tjera shtetërore dhe bartësve të pushteteve publike. Është e qartë se autoritetet komunale dhe gjykatat kompetente kanë vepruar në kundërshtim me këto nene, duke mos zbatuar vendimin e KPM-së që në pajtim me Ligjin për KPM-në kishte marrë formë të prerë dhe ishte bërë i përmbarueshëm.

42. Sundimi i ligjit është një prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike, presupozon respektimin e parimit të sigurisë juridike sidomos në lidhje me vendimet gjyqësore që kanë marrë formën e prerë dhe janë të përmbarueshme. Asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një aktgjykimi

përfundimtar dhe të plotfuqishëm thjesht për qëllimin e fitimit të rishqyrtimit dhe zgjidhje të re të rastit (shih, *mutatis mutandis*, Sovtransavto Holding kundër Ukrainës, nr. 48553/99, § 72, GJEDNJ 2002-VII). Po të mos ishte kështu, kthimi prapa i vendimeve përfundimtare do të çonte në një klimë të përgjithshme të pasigurisë juridike, duke zvogëluar kështu besimin publik në sistemin gjyqësor, si dhe rrjedhimisht edhe në sundimin e ligjit. Autoritetet kompetente, pra, kanë obligimin pozitiv që të organizojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv edhe në kuptimin ligjor edhe në atë praktik, si dhe i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme. (shih, Pecevi kundër Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21839/03, 6 nëntor 2008 Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 22731/02, 25 shtator 2006).

43. Përveç kësaj, Gjykata po ashtu konsideron se rasti i tanishëm duhet kuptuar se ngrit çështje edhe në kuptim të nenit 54 të Kushtetutës, që parashikon se:

"*Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.*"

44. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se, pasi që KPM-ja kishte gjetur shkelje të të drejtës së parashtruesit të kërkesës për punë, vendim ky që kishte marrë formë të prerë dhe ishte bërë i përmbarueshëm, parashtruesi i kërkesës kishte të drejtë për mjete efektive juridike, pasi që Komuna e Prizrenit refuzoi të përmbarojë vendimin e KPM-së. Sidoqoftë, siç përmendet më lart, në vend të përmbarimit të vendimit të KPM-së, gjë që e kishin obligim ligjor, që të dyja Gjykata Komunale dhe ajo e Qarkut refuzuan ta bënin këtë.

45. Duke mos përmbaruar vendimin e KPM-së të 25 qershorit 2008, autoritetet përkatëse ua kanë privuar dispozitave të nenit 54 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së çdo efekt të dobishëm.

46. Neni 13 i KEDNJ-së parashikon:

"Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare."

47. Në këto rrethana, Gjykata gjen se është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe efektiv, siç garantohet me nenet e lartpërmendura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së dhe se Vendimi i formës së prerë dhe i përmbarueshëm i KPM-së, Vendimi nr. 49/08 i 25 qershorit 2008, duhet të përmbarohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56 (1) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 9 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;

II. TA SHPALLË të pavlefshëm Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 518/2010, të 26 nëntorit 2010, i cili shkel nenin 54 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së.

III. TA KTHEJË Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 518/2010, të 26 nëntorit 2010 në Gjykatën e Qarkut në Prizren për rishqyrtim në pajtueshmëri me aktgjykimin e kësaj Gjykate në bazë të rregullit 74 (1) të Rregullores së Punës;

IV. Në bazë të rregullit 63 (5) të Rregullores së Punës, Gjykata e Qarkut në Prizren duhet t'i dorëzojë informacione Gjykatës Kushtetuese për masat e ndërmarra në zbatimin e këtij aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese;

V. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

VI. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Kadri Kryeziu Prof. Dr. Enver Hasani

Shtojca

Dispozitat e aplikueshme ligjore në lidhje me procedurat e përmbarimit të vendimeve administrative dhe gjyqësore

Ligji (Nr. 03/L-008) për Procedurën Përmbarimore i 2 qershorit 2008

Rregullat ligjore, procedurat e përmbarimit dhe siguria e vendimeve rregullohen me Ligjin për Procedurën Përmbarimore.

Neni 1.

"...

1.1 Me këtë ligj caktohen rregullat për procedurën e gjykatës sipas të cilës realizohen kërkesat në bazë të titujve ekzekutiv (procedura e përmbarimit), po qe se me ligj të posaçëm nuk është paraparë diçka tjetër.

1.2 Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për përmbarimin e vendimit të dhënë në procedurë administrative dhe për kundërvajtje me të cilin është caktuar detyrimi në të holla, përveçse kur për përmbarimin e tillë është paraparë me ligj kompetenca e organit tjetër.

…”

Neni 24 [Titulli ekzekutiv]

“…

24.1 Tituj ekzekutiv janë:

a) vendimi ekzekutiv i gjykatës dhe ujdia gjyqësore ekzekutive ;

b) vendimi ekzekutiv i dhënë në procedurë administrative dhe ujdia administrative, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër ;

c) dokumenti noterial ekzekutiv;

d) dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument ekzekutiv.

…”

Neni 26 [Përmbarueshmëria e vendimit]

“…

26.3 Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimorë, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.

…"

Neni 294 [Shpërblimi i pagës në rast të kthimit të punëtorit në punë]

"…

294.1 Propozuesi i përmbarimit që e ka parashtruar propozimin për kthim në punë, ka të drejtë të kërkojë që gjykata të nxjerrë aktvendim me të cilin do të caktojë se, debitori ka për detyrë që atij t'ia paguajë në emër të pagës shumat mujore që janë bërë të kërkueshme, nga dita në të cilën ka marrë formë të prerë vendimi e deri në ditën e rikthimit në punë. Me të njëjtin aktvendim, gjykata e cakton përmbarimin për realizimin e shumave mujore të caktuara.

…"

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2008/12 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës e 27 shkurtit 2008

Neni 11 [Ankesat]

"...

11.6 Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë, që i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në përputhje me ligjin në fuqi.

..."

Ligji Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i datës 15 korrik 2010

Neni 13 [Vendimi i Këshillit]

"...

Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtarit të nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Ekzekutimi duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

..."

Neni 14 [E drejta e ankesës]

“…

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrative në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.

…”

Neni 15 [Procedura në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit]

“…

1. Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjigjes i institucionit paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.

2. Nëse personi përgjegjës i institucionit nuk ekzekuton vendimin e Këshillit në afatin e paraparë me nenin 13 të këtij ligji, Këshilli në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita kur ka kaluar afati për ekzekutim, duhet të njofton me shkrim kryeministrin, dhe eprorin e drejtpërdrejt të personit përgjegjës për ekzekutim.

3. Njoftimi nga paragrafi 2. i këtij neni konsiderohet kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore dhe materiale kundër personit përgjegjës për ekzekutim, e cila zhvillohet në pajtim me dispozitat e parapara Ligjin për shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

4. Brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e kalimit të afatit për ekzekutim, pala mund të filloj procedurën e ekzekutimit në gjykatën komunale sipas ligjit për procedurën përmbaruese kundër personit dhe institucionit përgjegjës për ekzekutim, për dëmet materiale dhe jo materiale që janë shkaktuar me këtë vendim. Nëse gjykata kompetente vendos që punëtori (personi), i cili e ka kontestuar këtë mosekzekutim (mosekzekutimin e vendimit), t'ia kompensoi shumën e pagave, shpenzimet procedurale dhe shpenzimet tjera të mundshme, personi përgjegjës i institucionit mban edhe përgjegjësi materiale për dëmin që ia ka shkaktuar institucionit sipas ligjit.

5. Këshilli duhet të njofton me shkrim Kuvendin e Republikës së Kosovës për vendimet që nuk janë ekzekutuar.

..."

KI 159/11 datë 20 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Pn. nr. 530/2011, të 13 tetorit 2011

Rasti KI 159/2011, vendimi i datës 13 korrik 2012
Fjalët kyçe: kontest penal, kërkesa individuale, kërkesë qartazi e pabazuar.

Parashtruesi e kishte dorëzuar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke pretenduar se i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me Nenin 31 [E Drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], Nenin 32 [E drejta për mjete juridike], Nenin 33 [Parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale]; dhe Nenin 53 [Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut] të Kushtetutës.

Gjykata konsideroi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte sqaruar si dhe pse aktgjykimi i Gjykatës Supreme ia ka cenuar të drejtat kushtetuese të garantuara me nenet 31, 32, 33 dhe 53. Thjesht mospajtimi me aktgjykimin së bashku me numërimin e disa dispozitave kushtetuese nuk kishte mjaftuar për të ngritur rast në Gjykatën Kushtetuese për shkelje e pretenduara kushtetuese.

Gjykata kishte konstatuar se Kërkesa e Parashtruesit nuk i përmbushte kërkesat për pranueshmëri të parapara në dispozitat e kombinuara të nenit 113.1 të Kushtetutës, nenit 48 të Ligjit dhe të rregullit 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së Punës, prandaj si e tille, kërkesa ishte konsideruar se është qartazi e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë si e papranueshme Gjykata në këtë raste kishte cituar rastin KI 13/09*, Sevdail Avdyli* kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. Nr. 533/2006 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. Nr. 533/2006.

Prishtinë, më 16 korrik 2012

Nr. ref.: RK/281/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 159/11

Parashtruesi

Baton Morina

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Pn. nr. 530/2011, të 13 tetorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Cukalovic, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Baton Morina me vendbanim në Gjakovë, i përfaqësuar nga z. Sokol Dobruna, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi gjyqësor i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Pn. nr. 530/2011, i 13 tetorit 2011, të cilin përfaqësuesi i parashtruesit e ka pranuar më 19 tetor 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pn. nr. 530/2011 të 13 tetorit 2011, që ka të bëjë me kryerjen e një vepre penale.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: "Kushtetuta"), nenin 47 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 28 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në gjykatë

5. Më 9 nëntor 2011, parashtruesi e dorëzoi Kërkesën në Gjykatë

6. Më 17 janar 2012, Kryetari caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare Raportuese dhe Kolegjin Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Iliriana Islami.

7. Më 19 janar 2012 Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës dhe kërkoi dokumentacion shtesë. Të njëjtën datë Gjykata gjithashtu e njoftoi Gjykatën Supreme dhe Gjykatën e Qarkut në Prishtinë për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 13 shkurt 2012, përfaqësuesi i parashtruesit të Kërkesës dorëzoi dokumentacionin e kërkuar nga Gjykata.

9. Më 2 korrik 2012, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues, që e zëvendëson gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj si dhe e caktoi Kolegjin e ri Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues) që e zëvendëson gjyqtaren Iliriana Islami, Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.

10. Më 13 korrik 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 23 qershor 2006 Gjykata e Qarkut në Pejë, (Aktgjykimi P. nr. 80/2006), shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës dhe e dënoi për veprën penale "vrasje e rëndë në ndihmë, e në tentativë".

12. Kundër këtij aktgjykimi, përfaqësuesi i parashtruesit (avokat mbrojtës) parashtroi ankesë duke argumentuar se kishte pasur shkelje esenciale të dispozitave penale, shkelje e ligjit penal, vërtetim i gabuar dhe jo i plotë të gjendjes faktike dhe vendimit për shqiptimit të masës së dënimit dhe gjithashtu kishte kërkuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar, si dhe kthimin e çështjes për rigjykim në shkallën e parë.

13. Me 23 janar 2007 Prokurori Publik i Qarkut në Pejë propozoi që ankesat të refuzoheshin si të pabazuara.

14. Më 19 prill 2007 Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin AP. nr. 582/2006, me ç'rast miratoi ankesën e Prokurorit të Qarkut në Pejë dhe ia rriti dënimin.

15. Parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Supreme, parashtroi *kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë* duke pretenduar se ishin bërë shkelje e të drejtave të mbrojtjes, sepse ai pretendon se kërkesat e tij të paraqitura në ankesë nuk u morën parasysh nga Gjykata Supreme.

16. Më 31 dhjetor 2007 Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Pkl nr. 78/2007) e refuzoi si të pabazuar "kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë", duke vlerësuar që shkalla e parë dhe shkalla e dytë kishin konstatuar drejt faktet. Për më tepër Gjykata Supreme konkludoi se nuk kishte pasur shkelje thelbësorë të procedurës penale dhe se dispozitat e ligjit penal ishin zbatuar drejt.

17. Më 29 janar 2011, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata e Qarkut në Pejë që çështjet objekt të kërkesës përfshirë rihapjen e procedurës penale duhet të vendosen nga ana e gjyqtarëve të EULEX-it.

18. Më 13 shtator 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë, hodhi poshtë kërkesën për rishikimin e procedurës penale të përfunduar me Aktgjykimin e formës së prerë (P.nr. 80/2006 të 23 qershorit 2006) me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur baza ligjore për rishikimin e procedurës penale dhe se nuk ishin prezantuar fakte dhe prova të reja.

19. Më 13 shtatorit 2011, kundër Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme, duke pretenduar se kishte pasur cenime të rënda të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të ligjit penal. Parashtruesi i kërkesës propozoi që Gjykata Supreme ta anulojë aktvendimin e atakuar dhe çështjen t'ia kthejë shkallës së parë për rishqyrtim dhe rivendosje. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkoi përjashtimin e Prokurorit të Qarkut në Pejë, për shkak të dyshimeve subjektive që prokurori kishte me disa nga dëshmitaret.

20. Më 13 tetor 2011 Gjykata Supreme (Pn. nr. 530/2011) refuzoi si të pa bazë ankesën në mungesë të paraqitjes së fakteve dhe

provave të reja dhe konkludoi se nuk kishte bazë të mjaftueshme ligjore për rishikimin e procedurës.

21. Përfundimisht, më 9 nëntor 2011, parashtruesi i kërkesës parashtroi këtë kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pn. nr. 530/2011 të 13 tetorit 2011.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me Nenin 31 [E Drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], Nenin 32 [E drejta për mjete juridike], Nenin 33 [Parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale]; dhe Nenin 53 [Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut] të Kushtetutës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

23. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret procedurale për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, e që specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregullore të punës së Gjykatës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 (1) të Kushtetutës që përcakton se

"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar."

25. Po ashtu neni 48 i Ligjit parashikon që:

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

26. Përfundimisht, Gjykata ende i referohet rregullit 36 të Rregullores së Punës që përcakton se:

"*Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
c) Kërkesa është qartazi e bazuar:

27. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka sqaruar se si dhe pse aktgjykimi i Gjykatës Supreme ia ka cenuar të drejtat kushtetuese të garantuara me nenet 31, 32, 33 dhe 53. Thjesht mospajtimi me aktgjykimin së bashku me numërimin e disa dispozitave kushtetuese nuk mjafton për të ngritur rast për shkelje kushtetuese.

28. Nuk është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese që të vlerësojë ligjshmërinë dhe saktësinë e provave të vendimeve të nxjerra nga gjykatat e rregullta përveç nëse ka argumente bindëse dhe prova që çojnë në konkludime bindëse se një aktgjykim i tillë është nxjerrë në mënyrë dukshëm të padrejtë dhe të arbitrare.

29. Në juridiksionin e Gjykatës është që të analizojë shkeljet e të drejtave kushtetuese dhe të vlerësojë nëse procedurat, në tërësinë

e tyre kanë qenë të drejta dhe në pajtueshmëri me Kushtetutën, Pra, Gjykata Kushtetuese nuk është shkallë e katërt e apelit, nuk ka juridiksion për të përsëritur procedurat gjyqësore apo në ndonjë mënyrë të zëvendësojë aktgjykimin e Gjykatës Supreme me konstatimet e veta.

30. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se Kërkesa e Parashtruesit nuk i përmbush kërkesat për pranueshmëri të parapara në dispozitat e kombinuara të nenit 113.1 të Kushtetutës, nenit 48 të Ligjit dhe të rregullit 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së Punës, prandaj si e tille, kërkesa konsiderohet është qartazi e pabazuar dhe duhet të hedhet poshtë si e papranueshme (*shih Aktvendim për Papranueshmëri Lënda nr. KI 13/09, Sevdail Avdyli kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. Nr. 533/2006 të datës 11 shtator 2006 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme A. Nr. 533/2006 të datës 2 dhjetor 2006, 17 qershor 2010*).

31. Rrjedhimisht, në pajtim ne nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56.2 të Rregullores së Punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës, nenin 46 të Ligjit, rregullin 36.2 (b) dhe (d), rregullin 56.2 të Rregullores së punës, më 13 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Prof. Dr. Enver Hasani

KI 47/12 datë 20 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev. Nr. 188/2009, të 7 dhjetorit 2011

Rasti KI 47/2012, vendimi i datës 11 korrik 2012
Fjalët kyçe:Kontest administrativ, Kontest pune, kërkesa individuale, kërkesa e pranueshme, moszbatimi i vendimeve gjyqësore, shkelje e nenit 31, 32, 54 të Kushtetutës, shkelje e nenit 6 në lidhje me nenin 13 te KEDNj.

Parashtruesi e kishte dorëzuar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke pretenduar se, si pasoje e moszbatimit të Vendimit nr.123/02 të KPMSHCK dhe refuzimit të vendosjes se çështjes se tij në baza meritore, të gjitha instancat gjyqësorë, kanë bërë shkeljen e të drejtave kushtetuese të garantuara me: Nenin 22.1 [Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut], Nenin 31.1 [E Drejta për Gjykim të Drejte dhe të Paanshëm], Nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], Nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] si dhe Nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata në këtë rast kishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës i kishte përfushur kriteret procedurale te kërkuara me nenin 113.7 të Kushtetutës ligj dhe rregullore te punës dhe ishte leshtuar ne meritat e kërkesës.

Ne këtë rast, Gjykata i eshte referuar nenit 54 të Kushtetutës që nënvizon faktin se:"*Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur*". Duke qene se parashtruesi kishte kërkuar si nga autoritetet e Komunës se Kamenicës, po ashtu edhe nga autoritetet gjyqësore zgjidhje të çështjes së tij, mirëpo edhe përkundër përpjekjeve të tij veprimet e tij ishin injoruar dhe si pasoje i njëjti nuk kishte realizuar të drejtën e fituar me një vendim administrativ të lëshuar nga KPMSHCK.
Gjykata kishte vërejtur se në këtë rast nuk qëndronte asnjë arsye e fortë dhe e qëndrueshme e autoriteteve të KK të Kamenicës për

zvarritjen e procedurës lidhur me zbatimin e vendimit të KPMSHCK. Autoritetet e KK të Kamenicës, duke mos i venë në lëvizje mekanizmat për zbatimin e vendimit në fjalë, kishin dështuar të provojnë se janë të gatshme t'i respektojnë vendimet e një organi të pavarur dhe kompetent për vendosjen e kësaj çështjeje, aq me tepër kur të gjitha instancat gjyqësore e kishin adresuar zgjidhjen e saj tek ky organ (KPMSHCK).

Gjykata Kushtetuese kishte vlerësuar që, Gjykata Supreme, duke e hedhur përgjegjësin për zgjidhjen e çështjes, tek KK në Kamenicës dhe KPMSHCK, kishte bërë që parashtruesi të mbetej pa ndonjë rezultat konkret nga Gjykata Supreme, sepse parashtruesi nuk ka realizuar të drejtën e tij, nga shkaku se ati nuk i është ofruar "mbrojte gjyqësore e të drejtave" siç parashihet me kërkesat e nenit 54 të Kushtetutës. Ndërsa, bartja e përgjegjësisë nga kjo instancë dhe adresimi i zgjidhjes së rastit në KPMSHCK, nuk mund të konsiderohej si arsyetim për refuzimin e shqyrtimit të ankesës së parashtruesit, pasi qe ky organ i pavarur kishte nxjerr vendim konform procedurave administrative, siç kishte konstatuar më pas edhe vete Gjykata Supreme me Aktvendimin Rev. nr.188/2009 të 7 dhjetorit 2011. Por që ky vendim i KPMSHCK nuk është zbatuar asnjëherë nga KK i Kamenicës. Dukej qartë se parashtruesit i është pamundësuar, shfrytëzimi i mjeteve efektive juridike, prandaj, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se, mos marrja parasysh e këtyre fakteve të rëndësishme ka qenë në kundërshtim të plotë me kërkesat e Nenit 32 të Kushtetutës.

Për ta bërë edhe me të qartë, konstatim e saj, Gjykata, i është referuar Nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, qe përcakton se: *" Çdo personi, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura nga kjo Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare dhe kur kjo shkelje është kryer nga persona që veprojnë brenda funksioneve të tyre zyrtare."* GJEDNj ka nënvizuar se, Neni 13 i Konventës garanton disponueshmërinë e një mjeti ligjor, në nivelin kombëtar, për të zbatuar thelbin e të drejtave dhe lirive të Konventës në çdo lloj forme që mund të jetë parashikuar në rendin e tyre të brendshëm juridik. Efekti i Nenit 13 në këtë mënyrë kërkon ofrimin e mjeteve të brendshme juridike për të trajtuar përmbajtjen e një "ankimi të argumentueshëm" sipas Konventës dhe për të dhënë kompensimin e duhur *(shih Kudła k. Polonisë [GC], nr. 30210/96, § 157, ECHR 2000 XI)*. gjithsesi, mjeti juridik i Nenit 13 duhet të jetë "efektiv" si në

praktikë dhe në ligj (shih, për shembull, İlhan k. Turqisë [GC], nr. 22277/93, § 97, ECHR 2000-VII). më lart, § 158).

Si përfundim, Gjykata Kushtetuese, kishte konstatuar se, moszbatimi i vendimit nr. 123/2008 të KPMSHCK dhe zvarritja e paarsyeshme e zgjidhjes së kësaj çështjeje juridike, nga autoritetet e KK të Kamenicës përbënte shkelje të Nenit 31 në lidhje me nenin 32 të Kushtetutës, si dhe Nenit 6 në lidhje me Nenin 13 të Konventës. Ndërsa, dështimi i autoriteteve gjyqësore dhe pamundësia e krijimit të rrethanave për "mjete efektive juridike" dhe "mbrojtje gjyqësore të të drejtave" ka bërë që gjykatat të lëshojnë vendime me shkelje të Nenit 32 në lidhje me Nenin 54 të Kushtetutës, Nenit 6 në lidhje me Nenin 13 të Konventës.

Prishtinë, më 16 korrik 2012

Nr.ref.:AGJ/278/12

AKTGJYKIM

në

Rastin Nr. KI 47/12

Parashtruesi

Islam Thaçi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev. Nr. 188/2009, të 7 dhjetorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKES SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almira Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Islam Thaçi, me vendbanim në Gjilan.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi gjyqësor i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës Supreme Rev. nr. 188/2009 i 7 dhjetorit 2011, që parashtruesit i është dorëzuar më 13 janar 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 188/2009 të 7 dhjetorit 2011, që ka të bëj me Vendimin 119/07 të Kuvendit Komunal në Kamenice, me të cilin parashtruesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 28 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 4 maj 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

6. Më 22 maj 2012, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. 47/12, caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën ditë, me Vendimin Nr. KSH. 47/12, caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: 1. Snezhana Botusharov (kryesuese), 2. Ivan Čukalović (anëtar) dhe 3. Dr. Iliriana Islami (anëtare).

7. Më 30 maj 2012, Gjykata, njoftoi parashtruesin e kërkesës, Gjykatën Supreme dhe Kuvendin Komunal në Kamenicë për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 2 korrik 2012, Kryetari, me vendimin GJR. 47/12 caktoi gjyqtar raportues, gjyqtarin Altay Suroy, që e zëvendëson gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj, meqë ajo përfundoi mandatin e saj si gjyqtare në Gjykatë më 26 qershor 2012. Po të njëjtën ditë, Kryetari, me vendimin KSH. 47/12, caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues në përbërje të gjyqtareve: 1. Snezhana Botusharova (kryesuese) 2. Ivan Čukalović (anëtar) dhe Prof. Dr. Enver Hasani (anëtare), që e zëvendëson gjyqtaren Iliriana Islami, që po ashtu e përfundoi mandatin e saj si gjyqtare në Gjykatë më 26 qershor 2012.

9. Më 11 korrik 2012, Gjykata shqyrtoj dhe votoi për rastin.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 6 qershor 2007 Kuvendi Komunal në Kamenicë, me Vendimin nr. 119, në cilësinë e punëdhënësit e kishte shkarkuar parashtruesin nga pozita e Kryeshefit Ekzekutiv. Parashtruesi kishte lidhur kontratë me nr.03/2007, me kohëzgjatje prej 31 janarit 2006 deri më 31 janar 2008. Kundër këtij Vendimi i njëjti ka parashtruar ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMSHCK), pasi që organi i punësimit nuk i ishte përgjigjur ankesës së tij të cilën e kishte parashtruar në afat ligjor.

11. Më 15 qershor 2007, paralelisht me ankesën parashtruar në KPMSHCK, parashtruesi kishte ushtruar padi edhe në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) për shkak të heshtjes administrative nga ana e KK në Kamenicë.

12. Më 25 qershor 2007, parashtruesi serish kishte kërkuar nga KK në Kamenicë, që ti kthehej përgjigja lidhur më ankesën që e kishte parashtruar më 15 qershor 2007.

13. Më 27 gusht 2007, KPMSHCK, nxori Vendimin nr. 123/08 dhe aprovoi pjesërisht Ankesën e parashtruesit nr. 1341 të 15 qershorit 2007, duke i rekomanduar KK në Kamenicë që brenda tridhjetë (30) ditësh të veproi në përputhje me rekomandimet e dhëna në vendim, ku ndër të tjera thuhej:

> "*Kuvendi Komunal në Kamenice gjate shkarkimit të Kryeshefit Ekzekutiv nuk ka zbatuar procedurat të cilat janë të parapara me aktet në fuqi. KK është dashtë të formoi një Komision i cili do te bënte vlerësimin e gjertanishëm të punës së Kryeshefit Ekzekutiv dhe i cili do t'i raportoi-propozoi kuvendit për të gjeturat nga vlerësimi dhe Kuvendi të vendose (për shkarkim, apo jo) në bazë të procedurave të Rreg. 2000/45 mbi vetëqeverisjen e Komunave në Kosove, neni 30.8, Rreg. të SHCK-2001136 neni 1, Urdh. Adm. 2003/2,UNMIK neni 2, Këshillën Ligjore të dhënë nga MPL, Nr. 2006/01 të dt. 25.04.2006, veçanërisht kapitulli IV pika 6, Këshilla Ligjore Nr. 2007/02 e dt. 13.02.2007 MPL kapitulli IV. Pika 5, si dhe interpretimi i OS BE se i dt. 09. Maj 2007 në lidhje me kontratat e Kryeshefave të Ekzekutivit dhe Drejtoreve në Drejtoritë në Komuna pika 9. po ashtu nuk është vepruar në bazë të nenit 52 pika 2 dhe 3 e Statutit Komunal.*
>
> *3. Afati i përmbushjes së këtij vendimi nga KK. Kamenice është 30 (tridhjete) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.*
>
> *4. Pas ndërmarrjes së masave sipas këtij vendimi të njoftohet Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës.*
>
> *5. Ne rast mosveprimi sipas këtij vendimi KPMK do të njoftoje PSSP dhe Kryeministrin e Kosovës, në përputhje*

me nenin 11.4 të Rregullores 2001/36 mbi SHCK për ndërmarrjen e masave të mëtejme."

14. Duke qenë se, KK në Kamenicë, po e zvarriste zbatimin e vendimit të KPMSHCK parashtruesi, më 10 tetor 2007 ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Kamenicë, me ç'rast kishte kërkuar anulimin e vendimit nr. 119 të Kryetarit të KK të Kamenicës lidhur me largimin e tij nga puna.

15. Më 28 janar 2008, Gjykata Komunale në Kamenicë, nxori Aktvendimin nr.vep.C. 112/07 më ç'rast vendosi t'i ndërpresë të gjitha procedurat lidhur me kontestin, gjersa KK në Kamenicë të vendoste sipas vendimit nr. 123/08 të KPMSHCK. Parashtruesi i pa kënaqur me këtë vendim, ushtroi të drejtën e ankesës në Gjykatën e Qarkut në Gjilan.

16. Më 14 shkurt 2008 Kryetari i Komunës së Kamenicës dhe Menaxheri i Personelit përmes Njoftimit nr. 94/2008 informuan KPMSHCK për rastin, duke pranuar faktin që Vendimi për shkarkimin e Kryeshefit Ekzekutiv ishte miratuar në kundërshtim me aktet ligjore. Por edhe përkundër këtij fakti KK në Kamenicë nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim lidhur me kthimin e parashtruesit në pozicionin e mëparshëm të Kryeshefit Ekzekutiv.

17. Më 6 mars 2008, pasi që Gjykata Komunale në Kamenicë me Aktvendimin nr.vep.C. 112/07 kishte ndërprerë të gjitha procedurat lidhur me çështjen, parashtruesi, përmes një parashtrese kërkoi nga e njëjta vazhdimin e proceduarave të pezulluara, pasi që KK në Kamenicë nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim dhe nuk kishte vendosur ende për çështjen sipas vendimit të KPMSHCK .

18. Më 13 qershor 2008, Gjykata Komunale në Kamenicë, nxori Aktvendimin nr.vep.C. 74/2008, përmes së cilit shpalli veten jo kompetente për vendosjen e çështjes. Kjo gjykate kishte konstatuar që vendimi nr. 119/08 i 6 qershorit 2007 i kryetarit të KK të Kamenicës lidhur me shkarkimin e Kryeshefit

Ekzekutiv është akt administrativ, dhe se për këtë çështje me vendimin nr. 123/08 kishte vendosur KPMSHCK si organ i shkallës së dytë, i cili vendosi t'ia kthente lëndën KK të Kamenicës për rishqyrtim që të vendoste sipas rekomandimit të KPMSHCK.

19. Më 12 nëntor 2008, Gjykata e Qarkut në Gjilan, nxori Aktvendimin Ac. nr 308/2008 dhe refuzoi si të pa bazë ankesën e ushtruar nga parashtruesi, duke vërtetuar kështu Aktvendimin C.nr.74/2008 të Gjykatës Komunale të Gjilanit të 13 qershorit 2008. Kundër këtij aktvendimi parashtruesi më 14 janar 2008, ushtroi revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

20. Më 8 janar 2009, Gjykata Supreme, nxori Aktgjykimin A. nr. 218/2007, aprovoi padinë e parashtruesit si të bazuar, më ç'rast kishte urdhëruar KPMSHCK që në afat prej tetë (8) ditësh të vendoste lidhur me ankesën e parashtruesit, pasi që me nenin 26 të Ligjit për Konfliktin Administrativ është parapare që organi i shkallës së dytë duhet të vendos lidhur me ankesën në afat prej 60 ditësh, nga dita e parashtrimit të saj, nëse edhe pas 7 ditësh organi i shkalles së dytë nuk bie aktvendim lidhur me çështjen pala ka të drejt të inicioi kontest gjyqësor sikurse ankesa/kërkesa e tij të ishte refuzuar.

21. Më 7 dhjetor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktvendimin Rev. nr.188/2009, me ç'rast refuzoi revizionin e ushtruar nga parashtruesi, duke u arsyetuar se në bazë të nenit 11 të Ligjit për Procedurën Administrative, Gjykata, është kompetente të vendosë për kërkesat e dorëzuara nga personat fizik dhe juridikë, mirëpo, duke qenë se KK në Kamenicë nuk ka vendosur ende për këtë çështje juridike, procedura administrative nga e njëjta është konsideruar si e pa përfunduar pasi që KK në Kamenicë nuk kishte vendosur ende sipas vendimit të KPMSHCK.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, si pasoje e moszbatimit të Vendimit nr.123/02 të KPMSHCK dhe refuzimit të vendosjes se çështjes se tij në baza meritore, të gjitha instancat gjyqësorë, kanë bërë shkeljen e të drejtave kushtetuese të garantuara me: Nenin 22.1 [Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut], Nenin 31.1 [E Drejta për Gjykim të Drejte dhe të Paanshëm], Nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], Nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] si dhe Nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

23. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata, duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregullore të punës së Gjykatës.

24. Gjykata, së pari duhet të përcaktojë nëse Parashtruesi i kërkesës, është palë e autorizuar për të parashtruar kërkesë në Gjykatë në pajtim me kërkesat e Nenit 113 dhe 113.7 të Kushtetutës. Parashtruesi, ka dorëzuar kërkesën e tij në pajtim me këto dispozita kushtetuese. Andaj, rezulton që i njëjti është palë e autorizuar për të parashtruar kërkesë në Gjykatë për mbrojtjen kushtetuese të të drejtave të tij.

25. Gjithashtu, parashtruesi, duhet të provoj që i ka përmbushur kërkesat e Nenit 49 të Ligjit, sa i përket dorëzimit të kërkesës brenda afatit ligjor. Nga shkresat e lëndës vërehet qartë se vendimi përfundimtar për rastin e parashtruesit është Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Rev. Nr. 188/2009 i 7 dhjetorit 2012, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 13 janar 2012. Parashtruesi, kërkesën në Gjykatë e dorëzoi më 4 maj 2012, që nënkupton se kërkesa është parashtruar brenda afatit 4 mujor të paraparë me Ligj dhe Rregullore të punës së Gjykatës.

26. Gjykata, po ashtu përcakton nëse parashtruesi ka provuar ti ketë përmbushur kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit. Parashtruesi, fillimisht ka shterur mjetet juridike brenda institucionit të punësimit, ka vazhduar me tej kërkesën për realizimin e të drejtës së tij në KPMSHCK, dhe më pas ka iniciuar kontest të punës sipas procedurës civile kontestimore në të gjitha instancat gjyqësorë deri te mjeti i fundit juridik, që në rastin konkret është Aktvendimi i Gjykatës Supreme Rev. Nr. 188/2009 i 7 dhjetorit 2012, Gjykata, konsideron që, parashtruesi ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjeve në fuqi në kërkim të zgjidhjes së çështjes.

27. Gjithashtu, Gjykata, përcakton nëse parashtruesi në kërkesën e tij ka saktësuar dhe qartësuar se cilat të drejta kushtetuese pretendon t'i jenë shkelur, më cilin akt dhe nga cili autoritet publik. Parashtruesi, ka përmbushur edhe ketë kriter duke përmendur saktësisht shkeljet e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë dhe po ashtu autoritetin publik që e konsideron shkelësin e këtyre të drejtave.

28. Pasi që parashtruesi është palë e autorizuar, ka përmbushur afatin e nevojshme për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë, ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion, dhe ka saktësuar me përpikëri dispozitat e shkeljes së të drejtave dhe lirive, përfshirë edhe autoritetin publik qa ka bërë shkelje, Gjykata, konstaton se, parashtruesi ka përmbushur të gjitha kriteret procedurale për pranueshmëri.

Vlerësimi kushtetues i kërkesës

29. Përderisa parashtruesi, ka plotësuar të gjitha kriteret procedurale për pranueshmëri, Gjykata, duhet të gjykojë themelësinë e kërkesës së parashtruar në baza meritore.

30. Gjykata, nga parashtresat e parashtruesit, vëren se parashtruesi konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme Rev. Nr. 188/2009 të 7 dhjetorit 2012, për shkak refuzimit të kërkesës së tij që

kishte të bënte me zgjidhjen e kësaj çështje juridike (kontestit të punës), mes tij dhe KK të Kamenicës.

31. Siç duket nga shkresat e lëndës, fillimisht Gjykata Komunale në Kamenicë me Aktvendimin nr. vep. C. 112/07 kishte ndërprerë të gjitha procedurat lidhur me rastin dhe më pas me Aktvendimin nr.vep.C. 74/2008 e kishte shpallur veten jo kompetente për zgjidhjen e çështjes së parashtruesit. Ky vendim u vërtetua gjithashtu edhe nga Gjykata e Qarkut në Gjilan. Këto instanca gjyqësore, kishin nënvizuar faktin që zgjidhja e rastit është kompetencë e KPMSHCK, dhe se kjo çështje nuk ishte vendosur ende nga KK në Kamenicës. Parashtruesi, duke qenë i pakënaqur me vendimet e këtyre instancave gjyqësore kishte ushtruar revizion në Gjykatën Supreme, e cila po ashtu kishte nënvizuar faktin që zgjidhja e kontestit është kompetencë e KPMSHCK.

32. Nga sa më lartë, duket qartë se, parashtruesi i kërkesës, ka konsumuar të gjitha rrugët ligjore dhe institucionale, në kërkim të mbrojtjes gjyqësore të të drejtave të tij në kuptim të zbatimit të vendimit nr. 123/08 të KPMSHCK, që ishte lëshuar në përputhje me procedurat e parapara administrative. Mirëpo, edhe përkundër përpjekjeve të shumta të parashtruesit, për realizimin e kësaj të drejte të fituar me vendimin e lartpërmendur, përpjekjet e tij nuk u morën seriozisht nga autoritetet e KK të Kamenicës dhe autoritetet gjyqësore.

33. Si pasojë e mos vendosjes së çështjes nga KK i Kamenicës dhe refuzimit të zgjidhjes së saj edhe nga të gjitha instancat gjyqësore, parashtruesi i kërkesës, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 42.7 të Ligjit, duke e pare si mundësi të fundit realizimin e të drejtës së tij, më 14 maj 2012 parashtroi Kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

34. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 54 të Kushtetutës që nënvizon faktin se:

"Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur".

35. Gjykata, vëren se, zgjidhja e kësaj çështjeje juridike, në rastin konkret, natyrisht që ka qenë kompetencë e KPMSHCKN, për faktin që pozita e Kryeshefit Ekzekutiv, sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, e cila ka filluar të zbatohet në vitin 2004 në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike i përkiste pikërisht këtij organi të pavarur.

36. Duke pas parasysh faktin që, natyra e punës, së parashtruesit, ka kërkuar zgjidhje të përshpejtuar nga një organ kompetent, për faktin që procedurat e zgjidhjes së këtyre kontesteve, kërkojnë ndërmarrjen e verimeve konkrete dhe efikase. Andaj, ky fakt është dashur të merrej parasysh, si nga KK i Kamenicës, po ashtu edhe nga gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës, sepse duket qartë se parashtruesit nga te gjitha këto autoritetete iu pamundësua realizimi i të drejtës që e kishte fituar me vendimin e KPMSHCK.

37. Komunat e Republikës së Kosovës, duhet ta shohin si obligim Kushtetues zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe të autoriteteve publike, e jo ti zvarrisin procedurat e përmbarimit të tyre. Aq me tepër, kur procedurat përkatëse administrative që rregullohen me Ligj të posaçëm (*lex specialis)*, dispozitat e të cilit në mënyrë të përshpejtuar parashohin zgjidhjen e këtyre çështjeve juridike, duke parapare edhe afatet kohore për zgjidhjen e tyre *(shih, paragrafin 13 të këtij aktgjykimi, rekomandimi i KPMSHCK, pika 3 e pjesës operative të vendimit nr. 123/08 i 27 gushtit 2007)*, për faktin që natyra e tyre kërkon ndërmarrjen e veprimeve të tilla, zgjidhje të shpejtë dhe para se gjithash është në interes të shtetit që nëpunëseve që kategorizohen si "shërbyes civilë" t'u siguroj dhe garantoje mbrojë gjyqësore të të drejtave ligjore dhe Kushtetuese, nga shkeljet e mundshme të të drejtave të tyre nga ana e autoriteteve publike ku ata ushtrojnë profesionin e tyre.

38. Gjykata, vëren se, në rastin e parashtruesit, nuk ka qëndruar asnjë arsye e fortë dhe e qëndrueshme e autoriteteve të KK të Kamenicës për zvarritjen e procedurës lidhur me zbatimin e vendimit të KPMSHCK. Autoritetet e KK të Kamenicës, duke mos i venë në lëvizje mekanizmat për zbatimin e vendimit në fjalë, kanë dështuar të provojnë se janë të gatshme t'i respektojnë vendimet e një organi të pavarur dhe kompetent për vendosjen e kësaj çështjeje, aq me tepër kur të gjitha instancat gjyqësore e kishin adresuar zgjidhjen e saj tek ky organ (KPMSHCK).

39. Për më tepër, Gjykata Supreme, me Aktvendimin Rev. nr.188/2009 të 7 dhjetorit 2011, kishte konstatuar që zgjidhja e kësaj çështjeje juridike është nën juridiksionin e plotë të KPMSHCK. Prandaj, duke qenë se KK në Kamenice nuk po e zbatonte vendimin e KPMSHCK, kur dihet që kjo gjykatë, kishte konstatuar që KPMSHCK duhej të vendoste për rastin në fjalë në afatin e parapare me ligj *(shih: Aktgjykimin A nr. 218/2007 të 8 janarit 2009 të Gjykatës Supreme, ku e njëjta i kishte rekomanduar KPMSHCK që brenda afatit prej tetë (8) ditësh të vendoste për çështjen).*

40. Lidhur me këtë, Gjykata Kushtetuese, thekson që, Gjykata Supreme, duke ditur që parashtruesi po kërkonte mbrojte gjyqësore të të drejtave ligjore dhe Kushtetuese, nga shkaku se KK në Kamenicë nuk po vepronte sipas vendimit të KPMSHCK, në këtë mënyrë e Gjykata Supreme anashkaloi ankesën/kërkesën e parashtruesit duke u mjaftuar me faktin që KK i Kamenicës ende nuk kishte vendosur për çështjen në procedurës administrative sipas rekomandimit të KPMSHCK.

41. Duke qenë se KPMSHCK, nxori vendim dhe i njëjti nuk po zbatohej nga KK i Kamenicës, ku ishte konstatuar që largimi nga puna i Kryeshefit Ekzekutiv të KK të Kamenicës ishte në kundërshtim me aktet ligjore, shtrohet pyetja, ku tjetër do duhej kërkuar mbrojtje gjyqësore të të drejtave për shkeljet që bëjnë autoritetet publike me veprimet ose mosveprimet e tyre.

42. Prandaj, Gjykata Supreme, duke e hedhur përgjegjësin për zgjidhjen e çështjes, tek KK në Kamenicës dhe KPMSHCK, ka bërë që parashtruesi të mbetet pa ndonjë rezultat konkrete nga

Gjykata Supreme, sepse parashtruesi nuk ka realizuar të drejtën e tij, nga shkaku se ati nuk i është ofruar "mbrojte gjyqësore e të drejtave" siç parashihet me kërkesat e nenit 54 të Kushtetutës. Ndërsa, bartja e përgjegjësisë nga kjo instancë dhe adresimi i zgjidhjes së rastit në KPMSHCK, nuk mund të konsiderohet si arsyetim për refuzimin e shqyrtimit të ankesës së parashtruesit, pasi qe ky organ i pavarur kishte nxjerr vendim konform procedurave administrative, siç kishte konstatuar më pas edhe vete Gjykata Supreme me Aktvendimin Rev. nr.188/2009 të 7 dhjetorit 2011. Por që ky vendim i KPMSHCK nuk është zbatuar asnjëherë nga KK i Kamenicës.

43. Në të vërtet, duket qartë se parashtruesit i është pamundësuar, shfrytëzimi i mjeteve efektive juridike, prandaj, Gjykata Kushtetuese, vlerëson që, mos marrja parasysh e këtyre fakteve të rëndësishme është në kundërshtim të plotë me kërkesat e Nenit 32 të Kushtetutës.

44. Për ta bërë edhe me të qartë, këtë konstatim, Gjykata Kushtetuese, i referohet Nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, qe përcakton se: *" Çdo personi, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura nga kjo Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare dhe kur kjo shkelje është kryer nga persona që veprojnë brenda funksioneve të tyre zyrtare."*

45. GJEDNj ka nënvizuar se, Neni 13 i Konventës garanton disponueshmërinë e një mjeti ligjor, në nivelin kombëtar, për të zbatuar thelbin e të drejtave dhe lirive të Konventës në çdo lloj forme që mund të jetë parashikuar në rendin e tyre të brendshëm juridik. Efekti i Nenit 13 në këtë mënyrë kërkon ofrimin e mjeteve të brendshme juridike për të trajtuar përmbajtjen e një "ankimi të argumentueshëm" sipas Konventës dhe për të dhënë kompensimin e duhur *(shih Kudła k. Polonisë [GC], nr. 30210/96, § 157, ECHR 2000 XI).* gjithsesi, mjeti juridik i Nenit 13 duhet të jetë "efektiv" si në praktikë dhe në ligj (shih, për shembull, İlhan k. Turqisë [GC], nr. 22277/93, § 97, ECHR 2000-VII). më lart, § 158).

46. Nga e gjithë kjo, Gjykata Kushtetuese, ka kuptuar që, vendimi i KPMSHCK nuk ka gjetur zbatim tek autoritetet e KK të

Kamenicës. Ankesat e parashtruesit që i ishin adresuar KK të Kamenicës që të përgjigjej lidhur me zvarritjen e procesit të vendimmarrjes, nuk u morën parasysh gjithashtu edhe nga instancat e rregullta gjyqësorë. Si rezultat i këtyre anashkalimeve ose neglizhencës së autoriteteve publike, parashtruesi në asnjë mënyrë nuk ka realizuar të drejtën për mjete efektive juridike dhe mbrojtje gjyqësorë të të drejtave.

47. Ndërsa, sa i përket qartësimit të pozicionit dhe juridiksionit të KPMSHCK Gjykata, konsideron që, KPMSHCK tani është institucion i pavarur i konstituuar me ligj, në pajtim më Kushtetutën (shih, nenin 101.2 të Kushtetutës). Prandaj, të gjitha obligimet që dalin nga ky institucion lidhur me çështjet që janë nën juridiksionin e këtij institucioni prodhojnë efekte juridike për institucionet tjera përkatëse ku statusi i të punësuarve është i rregulluar me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Vendimi i këtij institucioni paraqet vendim administrativ të formës së prerë dhe si i tille duhet të përmbarohet nga gjykata kompetente sipas propozimit për përmbarim nga kreditori në kuptim të realizimit të së drejtës së fituar në procedure administrative.

48. Neni 6 i Konventës zbatohet edhe për fazat administrative të procesit gjyqësor gjegjësisht është brenda kornizave "për të drejtën në Gjykim të drejte dhe të paanshëm" e drejtë kjo e garantuar edhe me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Nga kjo rrjedh se edhe moszbatimi i vendimeve të Këshillit është element i nenit 6 të Konventës dhe shkelje e saj.

49. Gjykata Kushtetuese thekson se, është e drejte e palës së pakënaqur që te inicioi procedurë gjyqësore në rast të dështimit të realizimit të së drejtës së fituar që parashihet me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenin 6 në lidhje me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Do të ishte e pakuptimtë, nëse sistemi ligjor i Republikës së Kosovës do të lejonte që një vendim gjyqësor përfundimtar, i formës së prerë, të mbetej i paefektshëm në dem të një pale. Interpretimi i neneve të lartpërmendura në mënyrë ekskluzive ka të bëjë me qasjen ndaj gjykatës. Prandaj, jo efektshmëria e procedurave dhe moszbatimi i vendimeve

prodhojnë efekte të cilat na sjellin para situatave që nuk janë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit, parim të cilin autoritetet e Kosovës janë të obliguara ta respektojnë *(shih: mutatis mutandis, vendimin e GJEDNJ-së në rastin Romashov kundër Ukrainës, Parashtresa nr. 67534/01, aktgjykimi i 25 korrikut 2004).*

50. Gjykata është e mendimit se, ekzekutimi i një vendimi të marre nga një gjykate duhet shikuar si pjese përbërëse e të drejtës për gjykim të drejt, e drejtë kjo e garantuar me nenet e lartpërmendura *(shih: mutatis mutandis, rastin Hornsby kundër Greqisë, aktgjykimi i 19 marsit 1997, raportet 1997-II, f 510, para. 40)*. Ne rastin konkret, parashtruesi nuk do te duhej privuar nga përfitimi i vendimit të formës së prerë, që është në favorin e tij. Asnjë autoritet nuk mund të arsyetoj mos zbatimin vendimeve për qëllim të fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të freskët të rastit *(shih: mutatis mutandis Sovtransavto Holding kundër Ukrainës, nr. 48553/99, § 72, ECHR 2002-VII, si dhe Ryabykh kundër Rusisë, nr. 52854/99, § 52, ECHR 2003-IX)*. Autoritetet kompetente, pra, kanë për obligimin që të organizojnë një sistem efikas për zbatimin e vendimeve, që janë efektivë në kuptimin ligjor dhe atë praktik, si dhe duhet të sigurojnë zbatimin e tyre në kohë të arsyeshme, pa vonesa të pa nevojshme *(shih: mutatis mutandis, Peceve kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21839/03, 6 nëntor 2008; Martinovska kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 22731/02, 25 shtator 2006)*.

51. Si përfundim, Gjykata Kushtetuese, konstaton se, moszbatimi i vendimit nr. 123/2008 të KPMSHCK dhe zvarritja e paarsyeshme e zgjidhjes së kësaj çështjeje juridike, nga autoritetet e KK të Kamenicës përbën shkelje të Nenit 31 në lidhje me nenin 32 të Kushtetutës, si dhe Nenit 6 në lidhje me Nenin 13 të Konventës. Ndërsa, dështimi i autoriteteve gjyqësore dhe pamundësia e krijimit të rrethanave për "mjete efektive juridike" dhe "mbrojtje gjyqësore të të drejtave" ka bërë që gjykatat të lëshojnë vendime me shkelje të Nenit 32 në lidhje me Nenin 54 të Kushtetutës, Nenit 6 në lidhje me Nenin 13 të Konventës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullit 56 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 11 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA SHPALLË Kërkesën të pranueshme;

II. TA SHPALLË të pavlefshëm Aktvendimin Rev. nr. 188/2009, të Gjykatës Supreme, të 7 dhjetorit 2011, që shkel nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës, nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së;

III. TA KTHEJË Aktvendimin Rev. nr. 188/2011 të Gjykatës Supreme, të 7 dhjetorit 2011 për shqyrtim në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës, sipas nenit 74 (1) të Rregullores së punës; dhe

IV. Në pajtim me rregullin 63 (5) të Rregullores së punës, Gjykata Supreme do ta informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për të zbatuar këtë Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese.

V. Ky Aktgjykim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

VI. Ky Aktgjykim do të ketë efekt të menjëhershëm.

Gjyqtari Raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Altay Suroy, Prof. Dr. Enver Hasani,

KI 50/12 datë Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 153/2011, të 4 tetorit 2011, dhe Vendimit Nr. 02 (207) 2010, të 4 tetorit 2010, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës nga komuna e Junikut

Rasti KI 50/12, Aktgjykimi i 9 korrikut 2012

Fjalët kyçe: përmbarim, vendim përfundimtar dhe i ekzekutueshëm, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, kërkesë individuale, e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mjete ligjore, e drejta për punë, shkelje e të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi i kërkesës, z. Agush Lolluni, e dorëzoi kërkesën bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke e kontestuar mos-ekzekutimin e Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPM), Nr. 02 (207) 2010, të 4 tetorit 2010, dhe të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Peje, Ac. nr. 153/2011, të 4 tetorit 2011, i cili i ishte dorëzuar më 4 tetor 2011. Parashtruesi pohon që mos-zbatimi i këtyre vendimeve nga organet publike ia ka shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] te Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, Gjykata vendosi që, bazuar në gjuhën e thjeshtë të nenit 113.7, se kërkesa ishte e pranueshme sepse në kërkesën e tanishme z. Agush Lolluni e konteston mos-ekzekutimin e Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (ne tekstin e mëtejmë: KPM), Nr. 02 (207) 2010, të 4 tetorit 2010, dhe të Vendimit të Gjykatës së Qarkut

në Peje, Ac. nr. 153/2011, të 4 tetorit 2011. Prandaj, parashtruesi i kërkesës duhet të konsiderohet palë e autorizuar, me të drejtën e adresimit të kësaj çështjeje në Gjykatë dhe se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, siç parashikohen me ligj, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës. Sa i përket kërkesës së nenit 49 të Ligjit se parashtruesi është dashur ta dorëzojë kërkesën brenda një periudhe prej katër (4) muajsh, Gjykata përcaktoi se nga parashtresat e parashtruesit, situata e mos-ekzekutimit të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 153/2011, të 4 tetorit 2011 dhe Vendimi Nr. 02 (207) 2010, i 4 tetorit 2010 i KPM-së nga Komuna e Junikut vazhdon edhe sot. (shih Rastin Nr. KI08/09, Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të Fabrikës së Çelikut IMK në Ferizaj, të përfaqësuar nga z. Ali Azem, kryetar i Sindikatës, Vlerësimi Kushtetues i Vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajt, Vendimi C Nr. 340/2001, të 11 janarit 2002, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2010).Pastaj, parashtruesi i përcaktoi saktë cilat të drejta sipas Kushtetutës dhe KEDNJ pretendohen të jenë shkelur dhe nga cili autoritet publik. Prandaj, Gjykata gjithashtu gjen se parashtruesi e ka plotësuar kushtin e nenit 48 të Ligjit

Për meritat e kërkesës, Gjykata vendosi se, mos-zbatimi i vendimeve gjyqësore nga autoritetet komunale dhe dështimi i autoriteteve kompetente të Republikës së Kosovës për të siguruar mekanizma efektivë për zbatimin e vendimeve të autoriteteve përkatëse dhe vendimeve gjyqësore përbën shkelje të neneve 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenit 6, si dhe nenit 13 të KEDNJ-së. Duke dështuar të zbatojë Vendimin e KPM-së të 4 tetorit 2010, autoritetet përkatëse kanë privuar dispozitat e nenit 54 të Kushtetutës dhe nenit 13 te KEDNJ nga të gjitha efektet e dobishme. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se e drejta në gjykim të drejtë dhe efektiv, që garantohet me nenet e përmendura të Kushtetutës dhe KEDNJ, është shkelur dhe se vendimi përfundimtar përmbarimor i KPM-së, Vendimi nr. 02 (207) 2010 i 4 tetorit 2010 dhe Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Peje, Ac. nr. 153/2011 i 4 tetorit, duhet të ekzekutohen. Në marrjen e vendimit të saj, Gjykata gjithashtu u mbështet në vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që adresojnë çështjen e njëjtë ose të ngjashme. Gjykata vendosi se vendimi përfundimtar dhe përmbarimor i KPM, Vendimi

nr. 02(207) 2010 i 4 tetorit 2010, dhe Vendimi Ac. Nr. 153/201 i Gjykatës së Qarkut në Peje, i 4 tetorit 2011, duhet të ekzekutohen nga organi kompetent, në veçanti, nga Komuna e Junikut;

Prishtinë, më 16 korrik 2012

Nr. ref.: AGJ/279/12

AKTGJYKIM

në

Rastin Nr. KI 50/12

Parashtruesi

Agush Lolluni

Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 153/2011, të 4 tetorit 2011, dhe Vendimit Nr. 02 (207) 2010, të 4 tetorit 2010, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës nga komuna e Junikut

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Agush Lolluni, me vendbanim në Junik.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston mos-ekzekutimin e Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPM), Nr. 02 (207) 2010, të 4 tetorit 2010, dhe të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 153/2011, të 4 tetorit 2011, i cili i ishte dorëzuar më 4 tetor 2011.

Objekti i çështjes

3. Më 11 maj 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), me të cilën kërkonte vlerësim të kushtetutshmërisë në lidhje me dështimin e organeve publike për ta zbatuar vendimin e KPM-së, dhe vendimin e Gjykatës së Qarkut në procedurën përmbarimore nga komuna e Junikut.

4. Parashtruesi pohon që mos-zbatimi i këtyre vendimeve nga organet publike ia ka shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56.1 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 11 maj 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 23 maj 2012, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI 50/12, e caktoi gjyqtaren Iliriana Islami Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI 50/12, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesues), Enver Hasani dhe Kadri Kryeziu. Më 2 korrik 2012, Kryetari, me Vendimin nr. GJR. KI 50/12, zëvendësoi gjyqtaren Iliriana Islami si Gjyqtare raportuese, me Gjyqtarin Ivan Čukalović pasiqë mandati i gjyqtares Iliriana Islami si Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese ka mbaruar më 26 qershor 2012.

8. Më 28 maj 2012, Gjykata ua komunikoi kërkesën Gjykatës së Qarkut në Pejë, komunës së Junikut, KPM-së dhe Zyrës së Kryeministrit.

9. Më 5 qershor 2012, Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit iu përgjigj Gjykatës duke njoftuar se Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit e ka njoftuar parashtruesin se Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit nuk është kompetente sipas nenit 4 të Kushtetutës për të dhënë opinione në çështjet që janë duke u shqyrtuar nga Gjykatat.

10. Më 14 qershor 2012, KPM iu përgjigj Gjykatës duke njoftuar që:

    a. E drejta për punë është e drejtë themelore e njeriut e garantuar me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 23, Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 49, Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (Nr. 03/L-149), Ligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (Nr. 03/L-192), dhe ligje të tjera dhe akte nënligjore që e rregullojnë shërbimin civil në Republikën e Kosovës.

    b. Sipas nenit 13 dhe 14 të Ligjit për KPM-në, vendimet e KPM-së paraqesin vendim administrativ të formës së prerë dhe do të

ekzekutohen nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues apo personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Ekzekutimi duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Pala e dëmtuar e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.

c. Gjithashtu, Ligji për KPM-në ka paraparë edhe procedurat në rast të moszbatimit të vendimeve të KPM-së, që në përputhje me nenin 15 të Ligjit për KPM-në, në rast të mosekzekutimit të vendimit të KPM-së, pala e dëmtuar, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e kalimit të afatit për ekzekutim, mund ta fillojë procedurën e ekzekutimit në gjykatën komunale sipas Ligjit për procedurën përmbarimore ndaj personit dhe institucionit përgjegjës për ekzekutim, për dëmet materiale dhe jomateriale që janë shkaktuar me atë vendim.

d. Më tej, në përputhje me nenin 28.1 të Ligjit për procedurën përmbarimore, (Nr. 03/L-008), dokumenti ekzekutiv është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori, debitori ekzekutiv, si dhe objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbushjes së detyrimit. Neni 292.1 i Ligjit për procedurën përmbarimore përcakton që: propozimi për përmbarim në bazë të dokumentit ekzekutiv, me të cilin punëdhënësi është urdhëruar që punëtorin ta kthejë në punë, mund të paraqitet brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita në të cilën propozuesi i përmbarimit e ka fituar të drejtën që ta paraqesë këtë propozim. Po ashtu neni 293.1 përcakton që: përmbarimi në bazë të dokumentit ekzekutiv sipas të cilit punëdhënësi është i detyruar që punëtorin ta kthejë në punë, apo që ta sistemojë në vendin përkatës të punës, zbatohet me anë të caktimit të gjobave në të holla kundër punëdhënësit dhe personit përgjegjës në të.

e. Rrjedhimisht, në lidhje me moszbatimin e vendimit të KPM-së A/02/207/2010, të 4 tetorit 2010, nga organi i punësimit i

komunës së Junikut, KPM konsideron që ai është në kundërshtim me të drejtat themelore dhe ligjet në fuqi.

11. Më 14 qershor 2012, kryetari i komunës ë Junikut iu përgjigj Gjykatës duke njoftuar që:

a. Më 1 qershor 2011, komuna e Junikut nxori një vendim sipas të cilit komuna e Junikut nuk mund ta kthejë parashtruesin në vendin e tij të mëparshëm të punës drejtor të Gjimnazit "Kuvendi i Junikut" sepse vendimi i KPM-së nuk mund të ketë efekt retroaktiv posaçërisht duke pasur parasysh faktin që kontrata e punësimit e parashtruesit vlente deri më 7 janar 2011 dhe tani ka skaduar dhe nuk mund të prodhojë asnjë efekt juridik. Sa i përket çështjes së kompensimit, komuna e Junikut ka pranuar ta kompensojë parashtruesin për periudhën kohore prej marrjes së vendimit për degradimin e parashtruesit e deri në skadimin e kontratës së tij të punës si drejtor i Gjimnazit "Kuvendi i Junikut".

12. Më 9 korrik 2012, Gjykata shqyrtoi dhe votoi për rastin.

Përmbledhje e fakteve

13. Më 5 korrik 2010, kryetari i komunës së Junikut (me Vendimin Nr. 01/1020) e degradoi parashtruesin nga posti i drejtorit të Gjimnazit "Kuvendi i Junikut" në postin e mësimdhënësit në të njëjtin gjimnaz pa dhënë asnjë arsye specifike.

14. Parashtruesi ushtroi ankesë në Komisionin për Ankesa, i cili nuk lëshoi vendim, por një përgjigje (Nr. 1/2263, të 3 shtatorit 2010) nga menaxheri i personelit, e cila e udhëzonte parashtruesin t'i drejtohej KPM-së.

15. Më 4 tetor 2010, KPM e aprovoi ankesën e parashtruesit (Nr. 02 (207) 2010), e anuloi vendimin për degradimin e

parashtruesit nga posti i drejtorit në postin e mësimdhënësit dhe kërkoi nga organi i punësimit që brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi ta kthente parashtruesin në postin e mëparshëm si drejtor të gjimnazit. KPM më tej konstatoi që kryetari i komunës së Junikut duhet ta zbatojë vendimin e KPM-së.

16. Pas vendimit të KPM-së, parashtruesi iu drejtua disa herë institucionit të punësimit të komunës së Junikut, pra kryetarit të komunës së Junikut, por asnjë veprim nuk ishte ndërmarrë për ta zbatuar vendimin e KPM-së.

17. Pasi i kishte shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion në procedurë administrative, parashtruesi paraqiti propozim për ekzekutimin e vendimit të KPM-së, në përputhje me procedurën përmbarimore në Gjykatën Komunale në Deçan.

18. Më 19 nëntor 2010, Gjykata Komunale në Deçan e aprovoi propozimin e parashtruesit për ekzekutimin e vendimit të KPM-së, dhe e detyroi debitorin, përkatësisht kryetarin e komunës së Junikut, t'i ndërmerrte të gjitha masat e nevojshme për ta kthyer parashtruesin në postin e tij të mëparshëm me të gjitha të drejtat që dalin nga marrëdhënia e punës (Vendimi E. nr. 647/2010).

19. Më 1 dhjetor 2010, parashtruesi iu drejtua Kryeministrit të Kosovës, me ç'rast e informoi për dështimin për zbatimin e vendimit të KPM-së.

20. Komuna e Junikut, në cilësinë e debitorit, ushtroi kundërshtim kundër Vendimit të Gjykatës Komunale në Deçan, Vendimi E. nr. 647/2010, i 19 nëntorit 2010.

21. Më 1 prill 2011, Gjykata Komunale në Deçan e refuzoi si të paafatshëm kundërshtimin e debitorit – komunës së Junikut (E. nr. 647/2010). Komuna e Junikut u ankua kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut në Pejë.

22. Më 4 tetor 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë e refuzoi si të pabazuar ankesën dhe e miratoi vendimin e Gjykatës Komunale në Deçan (Ac. nr. 153/2011).

Pretendimet e parashtruesit

23. Parashtruesi pohon që moszbatimi nga organi i punësimit i vendimit të KPM-së dhe i vendimit të gjykatës së rregullt, të cilët ia dhanë të drejtën për t'u kthyer në postin e mëparshëm si drejtor, ia ka shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

24. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe në Rregullore të punës.

25. Gjykata duhet të përcaktojë së pari nëse parashtruesi është palë e autorizuar sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë që "*Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*" Në këtë drejtim, kërkesa është dorëzuar në Gjykatë nga një individ. Prandaj, parashtruesi është palë e autorizuar, ka të drejtë ta ngrejë këtë rast në Gjykatë sipas nenit 113.7 të Kushtetutës.

26. Përveç kësaj, sa i përket kriterit që parashtruesi duhet ta ketë dorëzuar kërkesën brenda 4 muajve pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë lidhur me rastin, Gjykata përcakton

që situata e moszbatimit të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 153/2011, të 4 tetorit 2011, dhe Vendimit Nr. 02 (207) 2010, të 4 tetorit 2010, të KPM-së nga komuna e Junikut vazhdon edhe sot (shih Rastin Nr. KI 08/09, Sindikata e pavarur e punonjësve të Fabrikës së Çelikut IMK Ferizaj, e përfaqësuar nga z. Ali Azem, kryetar i Sindikatës – Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajt, C Nr. 340/2001, të 11 janarit 2002, Aktgjykim i 17 dhjetorit 2010).

27. Për më tepër, në pajtim me nenin 12 dhe 14 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, Gjykata e Qarkut e Pejës konsiderohet " si gjykata e shkallës instancës së fundit për të gjykuar çështjet në lidhje me përmbarimin". Si rrjedhojë i kësaj, parashtruesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në Kosovë.

28. Përveç kësaj, Gjykata përcakton që parashtruesi i ka përmbushur kriteret e nenit 48 të Ligjit: *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."* Në këtë drejtim, Gjykata vëren që parashtruesi pretendon për shkelje të nenit 24 [Titulli ekzekutiv] të Ligjit për procedurën përmbarimore, i cili në nënparagrafin b) thotë:

Neni 24.1: Tituj ekzekutiv janë:

[...]

b) vendimi ekzekutiv i dhënë në procedurë administrative [...].Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI.

29. Pasi parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka përmbushur afatet kohore për të parashtruar kërkesë në

Gjykatë, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, dhe e ka qartësuar saktësisht shkeljen e supozuar të të drejtave dhe lirive, duke përfshirë vendimin që e konteston, Gjykata konkludon që parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri.

Vlerësimi kushtetues i kërkesës

30. Gjykata duhet t'i shqyrtojë meritat e ankesës së parashtruesit, pasi ai i ka përmbushur kriteret procedurale për pranueshmëri.

31. Gjykata vëren që parashtruesi nuk e konteston asnjë vendim të organeve publike, sepse të gjitha vendimet janë në favor të tij, prej vendimit të KPM-së deri tek vendimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë. Objekti i çështjes së kërkesës së parashtruesit ka të bëjë me moszbatimin e vendimit të KPM-së dhe të vendimeve gjyqësore nga organet e komunës së Junikut.

32. Gjykata vëren që, më 4 tetor 2010, KPM e aprovoi ankesën e parashtruesit (Nr. 02 (207) 2010), e anuloi vendimin për degradimin e parashtruesit nga posti i drejtorit në postin e mësimdhënësit dhe kërkoi nga organi i punësimit që brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi ta kthente parashtruesin në postin e mëparshëm si drejtor të gjimnazit. KPM më tej konstatoi që kryetari i komunës së Junikut duhet ta zbatojë vendimin e KPM-së. Gjykata më tej vërejti që komuna e Junikut nuk paraqiti kërkesë për shqyrtim gjyqësor në gjykatën kompetente, duke pranuar kështu detyrimin për ta përmbaruar vendimin e KPM-së brenda afatit ligjor.

33. Përveç kësaj, Gjykata vëren që, më 19 nëntor 2010, Gjykata Komunale në Deçan e aprovoi propozimin e parashtruesit për ekzekutimin e vendimit të KPM-së, e detyroi debitorin, përkatësisht kryetarin e komunës së Junikut, t'i ndërmerrte të gjitha masat e nevojshme për ta kthyer parashtruesin në postin e tij të mëparshëm me të gjitha të drejtat që dalin nga

marrëdhënia e punës (Vendimi E. nr. 647/2010). Ky vendim u aprovua edhe nga Gjykata e Qarkut në Pejë (Ac. nr. 153/2011).

34. Në këtë drejtim, parashtruesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike dhe institucionale sa i përket zbatimit të vendimeve të nxjerra në procedura administrative dhe të rregullta gjyqësore. Megjithatë, përkundër disa përpjekjeve të parashtruesit që kërkonte ta realizonte të drejtën e tij të fituar me vendimet e sipërpërmendura, për t'u kthyer në postin e tij të mëparshëm, përpjekjet e tij nuk janë marrë seriozisht nga organet e komunës së Junikut.

35. Prandaj, dështimi për të ndërmarrë masa konkrete ligjore për zbatimin e vendimeve përfundimtare nënkupton që kjo komunë ka dështuar të dëshmojë se është e gatshme t'i respektojë vendimet gjyqësore. Moszbatimi i vendimeve gjyqësore nga komunat nuk është në përputhje me kriteret e nenit 124.6 të Kushtetutës, i cili thotë:

> *"Komunat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet, dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore."*

36. Prandaj, është detyrë kushtetuese e komunave të Republikës së Kosovës që t'i respektojnë dhe zbatojnë vendimet gjyqësore, e jo t'i shtyjnë procedurat për ekzekutimin e tyre pa arsye të qëndrueshme ligjore dhe pa baza ligjore.

37. Gjykata rikujton që KPM-ja është institucion i pavarur i themeluar me ligj, në përputhje me nenin 101.2 të Kushtetutës. Prandaj, të gjitha detyrimet që dalin nga ky institucion, lidhur me çështjet që janë nën juridiksionin e tij, prodhojnë efekte juridike për institucionet e tjera përkatëse, në të cilat statusi i të punësuarve rregullohet me Ligjin për shërbimin civil të Republikës së Kosovës. Vendimi i këtij institucioni është vendim përfundimtar administrativ dhe si i tillë duhet të përmbarohet nga gjykata kompetente siç propozohet për përmbarim nga një kreditor sa i përket realizimit të së drejtës së fituar në procedurë administrative.

38. Neni 6 i KEDNJ-së gjithashtu zbatohet për faza administrative të procesit gjyqësor, përkatësisht është brenda kornizës "për të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm", e drejtë e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës. Prandaj, rezulton që moszbatimi i vendimit të KPM-së është element i nenit 6 të Konventës Evropiane, dhe është shkelje e të drejtës për gjykim të drejtë.

39. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 54 të Kushtetutës, i cili thekson që:

> *"Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur".*

40. Gjykata vëren që është e drejtë e palës të iniciojë procedurë gjyqësore në rast se nuk e realizon të drejtën e fituar siç përcaktohet në nenet 31 dhe 32 të Kushtetutë dhe në nenin 6 në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së. Do të ishte e pakuptimtë sikur sistemi juridik i Republikës së Kosovës të lejonte që një vendim përfundimtar gjyqësor të mbetej i paefektshëm në dëm të njërës palë. Interpretimi i neneve të sipërpërmendura ka të bëjë vetëm me qasjen në gjykatë. Prandaj, mosefikasiteti i procedurave dhe moszbatimi i vendimeve prodhon efekte që sjellin në situata që nuk janë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit, një parim që autoritetet e Kosovës janë të detyruara ta respektojnë (shih Vendimin e KEDNJ-së në rastin Romashov kundër Ukrainës, Parashtresa Nr. 67534/01, Aktgjykim i 25 korrikut 2004).

41. Gjykata konsideron që përmbarimi i një vendimi të shqiptuar nga cilado gjykatë duhet të konsiderohet pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë, e drejtë kjo e garantuar me nenet e sipërpërmendura (shih rastin Hornsby kundër Greqisë, Aktgjykim i 19 marsit 1997, Raportet 1997-II, f. 510, paragrafi 40). Në këtë rast specifik, parashtruesi nuk do të duhej të

privohej nga përfitimi i një vendimi përfundimtar, që është në favor të tij. Asnjë organ nuk mund ta justifikojë moszbatimin me qëllim të fitimit të një rishikimi dhe rishqyrtimi të ri të rastit (shih Sovtranstvo Holding kundër Ukrainës, Nr. 48553/99, paragrafi 72, KEDNJ, 2002-VII, dhe Ryabykh kundër Rusisë, Nr. 52854/99, paragraf 52, KEDNJ, 2003-IX). Prandaj, organet kompetente kanë për obligim që ta themelojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv edhe në kuptimin ligjor edhe në atë praktik, dhe i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme (shih, Pecevi kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21839/03, 6 nëntor 2008; Martinovska kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 22731/02, 25 shtator 2006).

42. Në fund, Gjykatë Kushtetuese gjen që moszbatimi i vendimeve gjyqësore nga organi komunal dhe dështimi i organeve kompetente të Republikës së Kosovës për të siguruar mekanizma efikas në lidhje me zbatimin e vendimeve përkatëse të organeve dhe të gjykatave përbën shkelje të neneve 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe të nenit 6 në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së.

43. Duke dështuar të zbatojë Vendimin e KPM të 4 tetorit 2010, autoritetet përkatëse kanë deprivuar dispozitat e nenit 54 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ nga të gjitha efektet e dobishme.

44. Neni 13 i KEDNJ përcakton:

> "Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare."

45. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se e drejta në gjykim të drejtë dhe efektiv, që garantohet me nenet e përmendura të Kushtetutës dhe KEDNJ, është shkelur dhe se vendimi përfundimtar përmbarimor i KPM, Vendimi nr. 02 (207) 2010 i

4 tetorit 2010 dhe Gjykata e Qarkut në Pejë, Vendimi Ac. nr. 153/2011 i 4 tetorit, duhet të ekzekutohen.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 20 të Ligjit, dhe Rregullin 56 (1) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 9 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;

II. Se ka pasur shkelje të nenit 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenit 6 dhe 13 i KEDNJ;

III. Se vendimi përfundimtar dhe përmbarimor i KPM, Vendimi nr. 02(207) 2010 i 4 tetorit 2010, dhe Vendimi Ac. Nr. 153/201 i Gjykatës së Qarkut në Pejë, i 4 tetorit 2011, duhet të ekzekutohet nga organi kompetent, në veçanti, nga Komuna e Junikut;

IV. Në pajtim me Rregullin 63 (5) të Rregullores së Punës, Komuna e Junikut duhet t'i dorëzojë Gjykatës Kushtetuese informata lidhur me masat e ndërmarra për të zbatuar këtë Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese;

V. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

VI. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues **Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Prof. Dr. Enver Hasani

Shtojcë

Dispozitat përkatëse ligjore lidhur me procedurat për ekzekutimin e vendimeve administrative dhe gjyqësore

Ligji për procedurën përmbarimore (Nr. 03/L-008)

Rregullat ligjore, procedura zbatuese dhe siguria e vendimeve rregullohen me Ligjin për procedurën përmbarimore [Ligji Nr. 03/L-008].

Neni 1 [Përmbajtja e ligjit]

1.1 Me këtë ligj caktohen rregullat për procedurën e gjykatës sipas të cilës realizohen kërkesat në bazë të titujve ekzekutiv (procedura e përmbarimit), po qe se me ligj të posaçëm nuk është paraparë diçka tjetër.

1.2 Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për përmbarimin e vendimit të dhënë në procedure administrative dhe për kundërvajtje me të cilin është caktuar detyrimi në të holla, përveçse kur për përmbarimin e tillë është paraparë me ligj kompetenca e organit tjetër.

Neni 24 [Titulli ekzekutiv]

24.1 Tituj ekzekutiv janë:

a) vendimi ekzekutiv i gjykatës dhe ujdia gjyqësore ekzekutive;

b) vendimi ekzekutiv i dhënë në procedurë administrative dhe ujdia administrative, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër;

c) dokumenti noterial ekzekutiv;

d) dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument ekzekutiv.

Neni 26 [Përmbarueshmëria e vendimit]

1. Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimorë, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.

Neni 294 [Shpërblimi i pagës në rast të kthimit të punëtorit në punë]

2. Propozuesi i përmbarimit që e ka parashtruar propozimin për kthim në punë, ka të drejtë të kërkojë që gjykata të nxjerrë aktvendim me të cilin do të caktojë se, debitori ka për detyrë që atij t'ia paguajë në emër të pagës shumat mujore që janë bërë të kërkueshme, nga dita në të cilën ka marrë formë të prerë vendimi e deri në ditën e rikthimit në punë. Me të njëjtin aktvendim, gjykata e cakton përmbarimin për realizimin e shumave mujore të caktuara.

Ligji Nr. 03/L-192 për KPM-në

Neni 13 [Vendimet e Këshillit]

Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtarit të nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Ekzekutimi duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Neni 14 [E drejta e ankesës]

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrative në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.

Neni 15 [Procedura në rast mos zbatimi të vendimit të Këshillit]

1. Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjigjes i institucionit paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.

2. Nëse personi përgjegjës i institucionit nuk ekzekuton vendimin e Këshillit në afatin e paraparë me nenin 13 të këtij ligji, Këshilli në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita kur ka kaluar afati për ekzekutim, duhet të njofton me shkrim kryeministrin, dhe eprorin e drejtpërdrejt të personit përgjegjës për ekzekutim.

3. Njoftimi nga paragrafi 2. i këtij neni konsiderohet kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore dhe materiale kundër personit përgjegjës për ekzekutim, e cila zhvillohet në pajtim me dispozitat e parapara Ligjin për shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

4. Brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e kalimit të afatit për ekzekutim, pala mund të filloj procedurën e ekzekutimit në gjykatën komunale sipas ligjit për procedurën përmbaruese kundër personit dhe institucionit përgjegjës për ekzekutim, për dëmet materiale dhe jo materiale që janë shkaktuar me këtë vendim. Nëse gjykata kompetente vendos që punëtori (personi), i cili e ka kontestuar këtë mosekzekutim (mosekzekutimin e vendimit), t'ia kompensoi shumën e pagave, shpenzimet procedurale dhe shpenzimet tjera të mundshme, personi përgjegjës i institucionit mban edhe përgjegjësi materiale për dëmin që ia ka shkaktuar institucionit sipas ligjit.

KI 24/12 datë 24 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 1/2010, të 3 dhjetorit 2010

Rasti KI 24/12, vendimi i 10 qershorit 2012

Fjalët kyçe: barazia para ligjit,, kërkesë individuale, mbrojtje gjyqësore e të drejtave, qartazi e pabazuar, jashtë afatit kohor, të drejtat e të akuzuarit, e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, shkelje e të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke pohuar se të drejtat e tij sipas neneve 3 [Barazia para Ligjit], 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 24 [Barazia para Ligjit], 30 [Të Drejtat e Akuzuarit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe si Neni 6 [E drejta për gjykim të drejtë] i KEDNJ është shkelur nga Aktgjykimi i Gjykatës Supreme,i cili kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazë dhe rrjedhimisht vendimi i Gjykatës së Qarkut, ku parashtruesi u shpall fajtor për kryerjen e një vepre penale.Gjykata vendosi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesi dështoi të paraqesë prova se procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare. Prandaj, Gjykata vendosi se kërkesa ishte haptazi e pabazuar sipas rregullit 36 (1.c) të Rregullores së Punës. Më tej, Gjykata u shpreh se kërkesa e parashtruesit ishte jashtë afatit kohor sipas nenit 49 të Ligjit, sepse Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 1/2010, është marrë më 3 dhjetor 2010 dhe i është dorëzuar parashtruesit më 29 dhjetor 2010, ndërsa parashtruesi paraqiti kërkesën në Gjykatë më 7 mars 2012, dmth. më shumë se 4 muaj nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi i Gjykatës Supreme.

Prishtinë, më 16 korrik 2012

Nr. ref.: RK/280/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 24/12

Parashtruesi

Alban Kastrati

Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 1/2010, të 3 dhjetorit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është paraqitur nga z. Alban Kastrati (Parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga z. Nysret Mjeku, avokat nga Prishtina. Sidoqoftë, më 29 maj 2012, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi Gjykatës dokumente shtesë, me ç'rast autorizimi i z. Nysret Mjekut u anulua ndërsa z. Ibrahim Z. Dobruna, avokat nga Prishtina, u emërua për ta përfaqësuar parashtruesin e kërkesës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 1/2010, të 3 dhjetorit 2010, i cili i ishte dorëzuar më 29 dhjetor 2010.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i sipërpërmendur i shkel të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), domethënë të nenit 3 [Barazia para Ligjit], nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit

54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] si dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saj (në tekstin e mëtejmë: "KEDNJ").

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 22 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 7 mars 2012, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 8 mars 2012, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Enver Hasani dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 11 maj 2012, Gjykata kërkoi sqarime shtesë nga parashtruesi i kërkesës, për ta informuar nëse parashtruesi e kishte referuar kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese apo në Gjykatën Supreme dhe të sqarojë cilat janë dispozitat kushtetuese të cilat pretendohen të jenë shkelur nga Gjykata Supreme.

8. Më 22 maj 2012 parashtruesi i kërkesës u përgjigj duke e informuar se kërkesa i ishte referuar Gjykatës Kushtetuese dhe dispozita kushtetuese e cila pretendohet se është shkelur nga Gjykata Supreme është neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] i Kushtetutës .

9. Më 29 maj 2012, parashtruesi i kërkesës paraqiti dokumente shtesë në Gjykatë, në mes të cilave edhe anulimin e autorizimit për Z. Nysret Mjeku, avokat nga Prishtina, i cili fillimisht kishte paraqitur kërkesën.

10. Më 6 qershor 2012, Gjykata ia komunikoi kërkesën Gjykatës Supreme dhe Prokurorit Publik të Shtetit.

11. Më 13 qershor 2012, Gjykata kërkoi sqarime shtesë nga parashtruesi i kërkesës, për ta informuar nëse parashtruesi e kishte autorizuar të atin apo avokatin të paraqet kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

12. Më 14 qershor 2012, Gjykata kërkoi nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë vërtetimin se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Pkl. nr. 1/2010 i 3 dhjetorit 2010 i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës.

13. Më 18 qershor 2012, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin për Z. Ibrahim Dobruna të nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës.

14. Më 10 korrik 2012, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit Raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

15. Më 29 qershor 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Vendimi P. nr. 667/2006) e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale. Parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatën Supreme ankesë kundër këtij vendimi.

16. Më 11 qershor 2008, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Ap. nr. 488/07) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut. Parashtruesi i kërkesës paraqiti në një kolegj tjetër shqyrtues në Gjykatën Supreme ankesë kundër këtij vendimi

17. Më 11 qershor 2009, Gjykata Supreme (Aktgjykimi API. nr. 5/08) e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të 11 qershorit 2008. Parashtruesi i kërkesës e paraqiti në Gjykatën Supreme kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimeve të Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës Supreme .

18. Më 3 dhjetor 2010, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pkl. nr. 1/2010) e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Pretendimet e parashtruesit

19. Parashtruesi pretendon se me aktgjykimet e nxjerra janë bërë shkelje esenciale të dispozitave të ligjit të procedurës penale dhe të ligjit penal.

20. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimet "nuk përbëjnë fakte që do të vërtetonin veçoritë e veprës penale, në bazë të cilave fakte, gjykatat do të mbështesnin gjykimin e tyre."

21. Për më tepër, Gjykata e instancës së parë dhe Gjykata Supreme gjoja nuk e kishin bërë një analizë të veprës penale dhe aktgjykimet janë në kundërshtim me deklaratat e të pandehurve, dëshmitarëve dhe dokumenteve të tjera të dosjes së lëndës.

22. Prandaj, parashtruesi i kërkesës konsideron se Gjykata ka shkelur nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] e KEDNJ.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

23. Gjykata, vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet që së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret procedurale për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe në Rregulloren e punës të Gjykatës.

24. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se ajo mund të vendosë në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nëse parashtruesi i kërkesës tregon se ai/ajo e ka paraqitur kërkesën "brenda afatit prej katër (4) muajve [...] që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor", në pajtim me nenin 49 të Ligjit.

25. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 1/2010, është lëshuar më 3 dhjetor 2010 dhe i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 29 dhjetor 2010, ndërsa parashtruesi i kërkesës e paraqiti kërkesën në Gjykatë më 7 mars 2012, d.m.th. më tepër se 4 muaj nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi i Gjykatës Supreme.

26. Për më tepër, rregulli 36 1 (c) i Rregullores së punës përcakton se: *"Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar."*

27. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve apo ligjit (ligjshmëria) gjoja të bëra nga Gjykata Supreme, nëse dhe deri më tani ato mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria). Në këtë mënyrë, Gjykata kur i shqyrton vendimet e marra nga gjykatat e rregullta nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt. Është detyrë e gjykatave të rregullta për të interpretuar dhe zbatuar rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz v. Spain [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

28. Me pak fjalë, Gjykata mundet vetëm të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë tyre, janë kryer në atë

mënyrë që parashtruesi ka pasur një gjykim të drejtë (shih në mes autoriteteve të tjera, Raporti i Komisionit Evropian mbi të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards v. Mbretërisë së Bashkuar, App. Nr. 13071/87, i miratuar më 10 qershor 1991).

29. Parashtruesi gjithashtu thjesht kundërshton nëse Gjykata Supreme kishte zbatuar në tërësi ligjin në fuqi dhe nuk pajtohet me të gjeturat faktike të Gjykatës në lidhje me këtë rast.

30. Në fakt, parashtruesi nuk kishte argumentuar pohimin mbi bazën kushtetuese dhe nuk kishte ofruar prova, se të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga autoriteti publik. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të përfundojë se procedurat përkatëse kanë qenë të padrejta apo të prishura nga arbitrariteti (shih *mutatis mutandis*, Shub v. Lithuania, GJEDNJ Vendimi për pranueshmëri të kërkesës Nr. 17064/06 i 30 qershorit 2009).

31. Prandaj, parashtruesi nuk ka treguar pse dhe si Gjykata Supreme i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.

32. Përgjithësisht, pason se kërkesa është e papranueshme, për shkak se është e paafatshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe edhe nëse do të ishte brenda afatit është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (1.c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1c) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 10 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 129/11 datë 20 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. nr. 158/2011 të 5 korrikut 2011 dhe vendimit nr. 02/197/2010 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës nga ana e Komunës së Klinës

Rasti KI129/2011, vendimi i datës 11 korrik 2012
Fjalët kyçe:Kontest administrativ, Kontest pune, kërkesa individuale, kërkesa e pranueshme, moszbatimi i vendimeve gjyqësore,moszbatimi i vendimit te KPMSHCK, shkelje e nenit 31, 32, 54 të Kushtetutës, shkelje e nenit 6 në lidhje me nenin 13 të KEDNj.

Parashtruesi e kishte dorëzuar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke pretenduar se me moszbatimin e vendimeve gjyqësorë nga institucioni i punësimit, Komuna e Klinës, i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me: Nenin 3 paragrafi 2 [Barazia para Ligjit], Nenin 7 paragrafi 1 [Vlerat], Nenin 21 paragrafi 1 dhe 3 [Parimet e Përgjithshme], Nenin 22 paragrafi 1 [Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut], Nenin 22 paragrafi 2 [Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut], Nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], Nenin 24.2 [Barazia para Ligjit] dhe Nenin 49 paragrafi 1 [E Drejta e Punës dhe ushtrimit të Profesionit].

Gjykata në këtë rast kishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës i kishte përfushur kriteret procedurale te kërkuara me nenin 113.7 të Kushtetutës ligj dhe rregullore te punës dhe ishte leshtuar ne meritat e kërkesës.

Ne këtë rast Gjykata kishte vërejtur se behej fjalë për moszbatimin e vendimit të KPMSHCK dhe vendimeve të gjykatave përmbaruese nga ana e autoriteteve te Komunës së Klinës. Gjykata në këtë rast ua ka rikujtuar Komunave te Republikës së Kosovës se te njëjtat janë te obliguara që t'i respektojnë dhe zbatojnë vendimet gjyqësore, e jo t'i zvarrisin procedurat e përmbarimit të tyre me arsyetime të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara ligjërisht duke përmendur nenin

124.6 të Kushtetutës, që thotë: "*Komunat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet, dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore"*.

Gjykata ka përmendur se neni 6 i Konventës, zbatohet edhe për fazat administrative të procesit gjyqësor gjegjësisht është brenda kornizave "për të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm" e drejtë kjo e garantuar edhe me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Nga kjo rrjedh se edhe moszbatimi i vendimeve të Këshillit është element i nenit 6 të Konventës dhe shkelje e saj.

Gjykata, ka theksuar se, është e drejtë e palës së pakënaqur që të iniciojë procedurë gjyqësore në rast të dështimit të realizimit të së drejtës së fituar që parashihet me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenin 6 në lidhje me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Dhe ka nënvizuar se do të ishte e pakuptimtë, nëse sistemi ligjor i Republikës së Kosovës do të lejonte që një vendim gjyqësor përfundimtar, i formës së prerë, të mbetej i paefektshëm në dëm të një pale. Interpretimi i neneve të lartpërmendura në mënyrë ekskluzive ka të bëjë me qasjen ndaj gjykatës. Prandaj, joefektshmëria e procedurave dhe moszbatimi i vendimeve prodhojnë efekte të cilat na sjellin para situatave që nuk janë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit, parim të cilin autoritetet e Kosovës janë të obliguara ta respektojnë, në këtë kontekst ka përmendur vendimin e GJEDNJ-së në rastin *Romashov kundër Ukrainës,* Parashtresa nr. 67534/01, aktgjykimi i 25 korrikut 2004.

Gjykata pasi qe kishte analizuar themelësinë e kërkesës ka konstatuar se parashtruesit i është shkelur e drejta në gjykim të drejtë dhe efektiv, që garantohet me nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe Nenit 6 në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së dhe se Vendimi përfundimtar përmbarimor i KPMSHCK, Vendimi nr. 02/197/2010 i 8 tetorit 2010 dhe Vendimi Ac. nr. 158/2011 i Gjykatës së Qarkut në Pejë, i 5 korrikut 2011 duhet të ekzekutohen.

Prishtinë, më 17 korrik 2012

Nr. ref.: AGJ/282/12

AKTGJYKIM

në

Rastin Nr. KI 129/11

Parashtruesi

Viktor Marku

Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. nr. 158/2011 të 5 korrikut 2011 dhe vendimit nr. 02/197/2010 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës nga ana e Komunës së Klinës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almira Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Viktor Marku, me vendbanim në Fshatin Videjë, Komuna e Klinës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston mosekzekutimin e Vendimit Administrativ nr. 02/197/2010 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (më tutje: KPMSHCK) dhe Aktvendimit Ac. nr. 158/2011 të Gjykatës së Qarkut në Pejë, të 5 korrikut 2011, nga ana e autoriteteve të Komunës së Klinës.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së Kërkesës, është vlerësimi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë:

"Gjykata"), i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Vendimit administrativ nr. 02/197/2010 të KPMSHCK dhe Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 158/2011 të 5 korrikut 2011, qe kanë të bëjnë me kthimin e parashtruesit në vendin e punës, pasi që të gjitha vendimet janë në favorin e tij.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: "Ligji") dhe rregulli 28 i Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: "Rregullorja").

Procedura në gjykatë

5. Më 10 tetor 2011 parashtruesi e dorëzoi Kërkesën në Gjykatë.

6. Më 15 tetor 2011, Kryetari, me vendimin Nr. GJR. 129/11, caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar Raportues. Po të njëjtën ditë, me vendimin Nr. KSH. 127/11, caktoi Kolegjin Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Snezhana Botusharova (kryesuese), Prof. Dr. Enver Hasani (anëtar) dhe 3. Dr. Iliriana Islami (anëtare).

7. Më 18 janar 2012, Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese ka njoftuar parashtruesin e kërkesës, Komunën e Klinës dhe palët e përfshira në procedurë.

8. Më 2 korrik 2012, Kryetari Nr. KSH. 129/11, caktoi Kolegjin e ri Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: 1. Snezhana Botusharova (kryesuese) 2. Mr. sc. Kadri Kryeziu (anëtar) që e zëvendëson gjyqtaren Ilirian Islami, meqë mandati i saj si gjyqtare në

Gjykatë i përfundoi më 26 qershor 2012, dhe Prof. Dr. Enver Hasani (anëtar).

9. Më 11 korrik 2012, Gjykata shqyrtoi dhe votoi për rastin.

Përmbledhja e fakteve të procedurës administrative

10. Parashtruesi e kërkesës, nga 2 maj 2000 ka punuar si punëtor social në Qendrën për Punë Sociale në Klinë (me tutje: QPS në Klinë) në cilësinë e shërbyesit civil me nr. id MPMS 122 deri në ndërprerjen e kontratës së punës. Sipas vërtetimit Nr. 0634/09 te 19 majit 2009, të QPS në Klinë, parashtruesi ka pas kontrate pune deri më 31 dhjetor 2009, me mundësi vazhdimi.

11. Më 16 dhjetor 2009, Drejtoria për Administratë dhe personel përmes shkresës nr. 02- 118-1767/09 njoftoi parashtruesin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, siç thuhet për shkak të skadimit të kontratës së punës dhe vlerësimit negativ të detyrave të punës dhe se parashtruesi nga 31 dhjetori 2009 nuk është i obliguar të lajmërohet në vendin e punës.

12. Më 28 dhjetor 2009, Drejtoria për Administratë dhe personel, nxori aktvendimin me nr. 02-118-4833/09 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të skadimit të kontratës së punës dhe vlerësimit negativ të detyrave të punës. Kundër këtij aktvendimi parashtruesi në afat ligjor ka parashtruar ankesë në Komisionin Komunal për Ankesa.

13. Më 5 janar 2010, Drejtoria e Administratës përmes konkluzionit Nr. 112-141/2010, shfuqizoi në tërësi Aktvendimin 02 nr. 118-4833/09 dhe mori vendim që parashtruesit t'i vazhdohet punësimi sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e punës. Më pas, Drejtoria e Administratës dhe Personelit lëshoi vendim për vazhdimin e kontratës së punës (nr. i kontratës 02/112-291/10, posti 184) për parashtruesin e kërkesës në kohëzgjatje prej 6 muajsh, duke filluar nga 1 janari 2010 deri më 30 qershor 2010.

14. Më 14 maj 2010, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (me tutje: DDSHMS), përmes shkresës 02 nr. 118-1641/10 njoftoi parashtruesin për ndërprerjen e kontratës së punës për shkak të skadimit të kontratës së punës dhe vërejtjeve me shkrim të shqiptuara më parë. Kundër këtij njoftimi parashtruesi parashtroi ankesë në Komisionin Komunal për Ankesa në Klinë. DDSHMS, më 30 qershor 2010 nxori aktvendimin 02 nr. 118-2196/10 për përfundimin e punësimit në shërbimin civil për shkak të skadimit të kontratës së punës dhe vlerësimit negativ të detyrave të punës. Kundër këtij aktvendimi parashtruesi serish në afat ligjor parashtroi ankesë në Komisionin Komunal për Ankesa në Klinë.

15. Më 28 korrik 2010, Komisioni Komunal për Ankesa në Klinë, nxori vendimin nr. 01 nr. 118-2815/2010 dhe refuzoi në tërësi ankesën e parashtruesit si të pa bazë, vërtetoi vendimin e Zyrës së Personelit 02 nr. 118-2196/10 të 30 qershorit 2010, me arsyetimin se parashtruesi nuk i është përmbajtur orarit të punës gjë të cilën e ka vërtetuar vërejtja disiplinore që i është shqiptuar atij me vendimin 02 nr. 132-1553/10, të 5 majit 2010, lëshur nga DSHMS në Klinë.

16. Me 12 gusht 2010, parashtruesi ka parashtruar ankesë në KPMSHCK kundër vendimit të Komisionit Komunal për Ankesa në Klinë duke kërkuar nga KPMSHCK që ta obligojë organin e punësimit që të rishqyrtojë rastin dhe t'ia vazhdojë kontratën e punës dhe ta kthejë në marrëdhënie pune në pajtim me kontratën e punës si Nëpunës për Asistencë Sociale në QPS në Klinë dhe kompensimin e të ardhurave personale të humbura nga 1 korriku 2010, për shkak të ndërprerjes së kontratës së punës.

17. Kundër ankesës së parashtruesit, Zyra e personelit e KK në Klinë, më 31 gusht 2010 ka bërë kundërshtim në KPMSHCK dhe ka kërkuar mbetjen në fuqi të vendimit 02 nr. 118-2196/10 të 30 qershorit 2010, si dhe vendimit 01 nr. 118-2815/2010 të 28 korrikut 2010 të Komisioni Komunal për Ankesa në Klinë.

18. Më 8 tetor 2010, KPMSHCK, bazuar në shkresat e lëndës dhe aktet ligjore në fuqi, nxori Vendimin me nr. 02/197/2010 dhe

aprovoi si të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës nr. 1637/2010, anuloi: aktvendimin 02 nr. 118-2196/10 të 30 qershorit 2010, për përfundimin e punësimit në shërbimin civil, njoftimin e drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale 02 nr. 118-1641/10 të 14 majit 2010 për ndërprerjen e kontratës së punës dhe vendimin e Komisionit Komunal për Ankesa në Klinë 01 nr. 118-2815/2010 të 28 korrikut 2010. Me këtë vendim KPMSHCK ka obliguar organin e punësimit që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit ta kthejë parashtruesin në vendin e punës Nëpunës i Asistencës Sociale dhe t'ia lëshojë kontratën e punës në pajtim me nenin 4 të Udhëzimit Administrativ nr. MSH/DASHC 2003/02 dhe t'ia bëjë kompensimin e të ardhurave personale sipas pagës së caktuar me kontratë (paga e caktuar bruto 196.90 euro) në mënyrë retroaktive, që nga dita kur parashtruesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës deri në ditën e ekzekutimit të këtij vendimi. Këshilla juridike e KPMSHCK citon: "Vendimi i Këshillit paraqet vendim administrativ të formës se prerë, që i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në përputhje me ligjin, ndërsa ankuesi në kuptim të realizimit të drejtave të veta mund t'i drejtohet gjykatës kompetente".

19. Pas vendimit të KPMSHCK, parashtruesi i është drejtuar disa herë institucionit të punësimit Komunës së Klinës, Kryetarit të kësaj Komune dhe DDSHMS në Klinë. Mirëpo, siç duket, Komuna e Klinës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ta zbatuar vendimin në fjalë.

20. Më 29 tetor 2010, parashtruesi njoftoi KPMSHCK se vendimi 02/197/2010 i 8 tetorit 2010 i aprovuar nga ky organ nuk po zbatohet nga personat përgjegjës të Komunës dhe kërkoi nga KPMSHCK që lidhur me këtë çështje të njoftohet Kryeministri dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës, siç parashihet me ligj.

21. Më 3 nëntor 2010, KPMSHCK me kërkesën e parashtruesit dhe në pajtim me nenin 101.2 të Kushtetutës, si dhe nenin 15 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr 03/L-192 për KPMSHCK i është drejtuar Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe e ka njoftuar lidhur me moszbatimin e vendimeve të këtij organi. KPMSHCK duke u bazuar në nenin 15.1 të Ligjit Nr 03/L-192

citon: "*moszbatimi vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit paraqet shkelje të rendë të detyrave të punës*", më tej paragrafi 2 i nenit 15 përcakton: "*nëse personi përgjegjës nuk e ekzekuton vendimin e Këshillit në afat prej 15 ditësh, atëherë, Këshilli 15 ditë pas kalimit të këtij afati për ekzekutim, në pajtim me nenin 13 të Ligjit Nr 03/L-192 njoftohet Kryeministri i Republikës së Kosovës"*. Njoftimi nga paragrafi 2 i këtij neni *"konsiderohet kërkese për fillimin e procedurës disiplinore dhe materiale kundër personit përgjegjës për ekzekutim e cila zhvillohet në pajtim me dispozitat e parapara me ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës"*.

22. Më 10 maj 2011, parashtruesi i është drejtuar Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës z. Jakup Krasniqi dhe ka kërkuar nga ai që ta shtrijë autoritetin e tij brenda kompetencave të ngarkuara si Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës që të respektohet dhe zbatohet vendimi i KPMSHCK nga përgjegjësit e institucionit të punësimit për kthimin e tij në vendin e punës.

Përmbledhja e fakteve në procedurë gjyqësore

23. Parashtruesi i kërkesës pasi që kishte shterur të gjitha mjetet juridike në procedurë administrative kishte bërë propozim për ekzekutimin e vendimit të KPMSHCK, sipas procedurës përmbarimore në Gjykatën Komunale në Klinë.

24. Më 18 nëntor 2010, Gjykata Komunale në Klinë, aprovoi propozimin e parashtruesit dhe nxori aktvendimin E. nr. 635/2010, për përmbarimin e vendimit të KPMSHCK, obligoi debitorin, përkatësisht organet kompetente të Kuvendit Komunal të Klinës, Kryetarin e Komunës, drejtorin e DAP-it për SHMS të KK Klinë që të ndërmarrin të gjitha veprimet për kthimin e parashtruesit në vendin e punës me të gjitha të drejtat e plota që dalin nga marrëdhënia e punës. Kjo gjykatë thekson se vendimi i KPMSHCK është vendim administrativ i formës së prerë dhe përmbarimor dhe nisur nga ky fakt është dashur që vendimi të ekzekutohet nga zyrtarët ose personat

përgjegjës të KK-Klinë, në pajtim me kërkesat e nenit 14 të Ligjit Nr 03/L-192 për KPMSHCK.

25. Me 7 shkurt 2011, Komuna e Klinës, në cilësinë e debitorit, ushtroi kundërshtim kundër aktvendimit E. nr. 635/2010 të 18 nëntorit 2010 të Gjykatës Komunale në Klinë dhe propozoi që të anulohet ky vendim.

26. Më 7 prill 2011, Gjykata Komunale në Klinë, refuzoi si të pabazuar kundërshtimin e ushtruar nga debitori Komuna e Klinës, ndaj aktvendimit E. nr. 635/2010, për lejimin e përmbarimit. Komuna e Klinës e pa kënaqur me vendimin e lartpërmendur ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Pejë.

27. Më 5 korrik 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë, sipas ankesës së ushtruar nga debitori Komuna e Klinës nxori aktvendimin me Nr. Ac. nr. 158/2011 dhe hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e së njëjtës, duke vërtetuar kështu aktvendimin e shkallës së parë E. nr. 635/2010 të 7 prillit 2011. Arsyetimin e vetë gjykata e kishte mbështetur në faktin se: "*vendimi KPMSHCK paraqet vendim administrativ të formës së prerë dhe si i tillë përben titull ekzekutiv dhe është në pajtim me nenin 24.1 (b) dhe 26.3 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore dhe se inicimi i konfliktit administrativ në Gjykatën Supreme nga Komuna e Klinës nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, me moszbatimin e vendimeve gjyqësorë nga institucioni i punësimit, Komuna e Klinës, i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me: Nenin 3 paragrafi 2 [Barazia para Ligjit], Nenin 7 paragrafi 1 [Vlerat], Nenin 21 paragrafi 1 dhe 3 [Parimet e Përgjithshme], Nenin 22 paragrafi 1 [Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut], Nenin 22 paragrafi 2 [Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut], Nenin 23 [Dinjiteti i Njeriut], Nenin 24.2 [Barazia para Ligjit] dhe Nenin 49 paragrafi 1 [E Drejta e Punës dhe ushtrimit të Profesionit].

29. Parashtruesi shpreh shqetësimin e tij lidhur me faktin që Komuna e Klinës nuk e zbatoi fillimisht vendimin e Këshillit, më pas vendimin e Gjykatës Komunale të Klinës dhe se fundmi vendimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë. Mirëpo edhe Qeveria (ekzekutivi), që është kompetente për të siguruar mekanizma për zbatimin e ligjit dhe vendimeve gjyqësore, sipas parashtruesit nuk ndërmori asnjë veprim lidhur me këtë çështje.

Dispozitat relevante ligjore lidhur me procedurat e ekzekutimit të vendimeve administrative dhe gjyqësore

Ligji për Procedurën Përmbarimore (Nr. 03/L-008)

30. Në Republikën e Kosovës, rregullat ligjore, procedurat e ekzekutimit dhe siguria e vendimeve rregullohen me Ligjin për Procedurën Përmbarimore [Ligji Nr. 03/L-008].

Neni 1 [Përmbajtja e ligjit]

1.1 Me këtë ligj caktohen rregullat për procedurën e gjykatës sipas të cilës realizohen kërkesat në bazë të titujve ekzekutiv (procedura e përmbarimit), po qe se me ligj të posaçëm nuk është paraparë diçka tjetër.

1.2 Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për përmbarimin e vendimit të dhënë në procedurën administrative dhe për kundërvajtje me të cilin është caktuar detyrimi në të holla, përveçse kur për përmbarimin e tillë është paraparë me ligj kompetenca e organit tjetër.

Neni 24 [Titujt Ekzekutiv]

24.1 Titujt ekzekutiv janë:

a) vendimi ekzekutiv i gjykatës dhe ujdia gjyqësore ekzekutive;

b) vendimi ekzekutiv i dhëne në procedure administrative dhe ujdia administrative, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është parapare diçka tjetër;
c) dokument noterial ekzekutiv;
d) dokument tjetër që me ligj është quajtur dokument ekzekutiv.

Neni 26 [Përmbarueshmëria e vendimit]

1. Vendimi i dhënë në procedure administrative është përmbarimorë, po që se i tille është bërë sipas rregullave me te cilat është rregulluar procedura e tillë.

Neni 294 [Shpërblimi i pagës në rast të kthimit të punëtorit në punë]

2. *Propozuesi i përmbarimit që e ka parashtruar propozimin për kthim në punë, ka të drejtë të kërkojë që gjykata të nxjerrë aktvendim me të cilin do të caktojë se, debitori ka për detyrë që atij t'ia paguajë në emër të pagës shumat mujore që janë bërë të kërkueshme, nga dita në të cilën ka marrë formë të prerë vendimi e deri në ditën e rikthimit në punë. Me të njëjtin aktvendim, gjykata e cakton përmbarimin për realizimin e shumave mujore të caktuara.*

Ligji Nr. 03/L-192 KPMSHCK

Neni 13 [Vendimi i Këshillit]

Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtaret të nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Ekzekutimi duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Neni 14 [E drejta e ankesës]

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrative në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.

Neni 15 [Procedura në rast mos zbatimi të vendimit të këshillit]

1. *Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjigjes i institucionit paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.*

2. *Nëse personi përgjegjës i institucionit nuk e ekzekuton vendimin e Këshillit në afatin e paraparë me nenin 13 të këtij ligji, Këshilli në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita kur ka kaluar afati për ekzekutim, duhet të njoftoj me shkrim kryeministrin, dhe eprorin e drejtpërdrejt të personit përgjegjës për ekzekutim.*

3. *Njoftimi nga paragrafi 2. i këtij neni konsiderohet kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore dhe materiale kundër personit përgjegjës për ekzekutim, e cila zhvillohet në pajtim me dispozitat e parapara Ligjin për shërbimin civil të Republikës së Kosovës.*

4. *Brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e kalimit të afatit për ekzekutim, pala mund të filloj procedurën e ekzekutimit në gjykatën komunale sipas ligjit për procedurën përmbaruese kundër personit dhe institucionit përgjegjës për ekzekutim, për dëmet materiale dhe jo materiale që janë shkaktuar me këtë vendim. Nëse gjykata kompetente vendos që punëtori (personi), i cili e ka kontestuar këtë mosekzekutim (mosekzekutimin e vendimit), t'ia kompensoi shumën e pagave, shpenzimet procedurale dhe shpenzimet tjera të mundshme, personi*

përgjegjës i institucionit mban edhe përgjegjësi materiale për dëmin që ia ka shkaktuar institucionit sipas ligjit.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

31. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregullore të punës të Gjykatës.

32. Gjykata, së pari duhet të përcaktojë nëse Parashtruesi është palë e autorizuar, që në pajtim me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës të parashtrojë kërkesë në Gjykatë. Parashtruesi, është person fizik dhe është palë e autorizuar në përputhje me kërkesat e nenin 113.7 (Kërkesat Individuale) të Kushtetutës.

33. Gjithashtu, parashtruesi duhet të provojë që i ka përmbushur kërkesat e nenit 49 të Ligjit, sa i përket dorëzimit të kërkesës brenda afatit ligjor. Nga shkresat e lëndës vërehet qartë se vendimi përfundimtar për rastin e parashtruesit është Aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë nr. Ac. nr. 158/2011 i 5 korrikut 2011, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 20 gusht 2011. Parashtruesi kërkesën e tij në Gjykatë e dorëzoi më 10 tetor 2011, që nënkupton se kërkesa është parashtruar brenda afatit 4 mujor të paraparë me ligj.

34. Gjykata, po ashtu, përcakton nëse parashtruesi ka provuar t'i ketë përmbushur kërkesat e nenit 47.2 të Ligjit. Duke qenë se parashtruesi fillimisht ka shterur mjetet juridike brenda institucionit të punësimit, ka vazhduar më tej kërkesën për realizimin e të drejtës në KPMSHCK, vendimi i të cilit është i formës së prerë në procedurë administrative, parashtruesi gjithnjë në kërkim të zbatimit të vendimit të KPMSHCK. ka shfrytëzuar edhe mjetin e fundit juridik në procedurën

përmbarimore, që në rastin konkret është aktvendimi Ac. nr. 158/2011 i Gjykatës së Qarkut në Pejë, ndaj të cilit nuk lejohet ushtrimi i të drejtës për ankesë. Si rezultat, sipas ligjeve në fuqi parashtruesi ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion.

35. Gjithashtu, Gjykata përcakton nëse parashtruesi në kërkesën e tij ka saktësuar dhe qartësuar se cilat të drejta dhe liri pretendon t'i jenë shkelur, më cilin akt dhe nga cili autoritet publik. Parashtruesi, ka përmbushur edhe këtë kriter duke përmendur shkeljet e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë dhe gjithashtu autoritetin publik që e konsideron shkelësin e këtyre të drejtave.

36. Gjykata konstaton se parashtruesi ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri, pasi që ai është palë e autorizuar, ka përmbushur afatin e nevojshëm për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë, ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion, dhe ka saktësuar me përpikëri pohimet e shkeljes së të drejtave dhe lirive, përfshirë edhe autoritetin publik qa ka bërë shkelje.

Vlerësimi kushtetues i kërkesës

37. Përderisa parashtruesi, ka plotësuar kriteret procedurale për pranueshmëri, Gjykata duhet ta shqyrtojë themelësinë e kërkesës së parashtruar në baza meritore.

38. Gjykata Kushtetuese, nga parashtresat e parashtruesit, vëren se parashtruesi i kërkesës nuk konteston asnjë vendim të autoriteteve publike a të gjykatave, sepse të gjitha vendimet janë në favorin e tij, duke filluar nga vendimi i KPMSHCK, aktvendimet e Gjykatës komunale në Klinë E. nr. 635/2010 i 18 nëntorit 2010 dhe E.nr.635/2010, i 7 prillit 2011, si dhe aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. nr. 158/2011 i 5 korrikut 2011, që konsiderohet mjet i fundit juridik në procedurën përmbarimore. Kërkesa e parashtruesit ka të bëjë me moszbatimin e vendimit të KPMSHCK dhe të vendimeve gjyqësore nga ana e autoriteteve të Komunës së Klinës.

39. Duket qartë se, parashtruesi i kërkesës i ka konsumuar të gjitha rrugët ligjore dhe institucionale në kuptim të zbatimit të vendimeve të zhvilluara në procedurën administrative dhe në procedurën e rregullt gjyqësore. Mirëpo, edhe përkundër përpjekjeve të shumta të parashtruesit në kërkim të realizimit të së drejtës së fituar me vendimet e lartpërmendura për kthim në punë, përpjekjet e tij nuk janë marrë seriozisht nga autoritetet e Komunës në Klinë.

40. Prandaj, mosndërmarrja e veprimeve konkrete ligjore për zbatimin e një vendimi përfundimtar, të formës së prerë, lë për të kuptuar që kjo Komunë ka dështuar të provojë se është e gatshme t'i respektojë vendimet gjyqësore. Moszbatimi i vendimeve gjyqësore nga Komunat është në kundërshtim të plotë me kërkesat e nenit 124.6 të Kushtetutës, që qartazi citon se:

> "*Komunat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet, dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore".*

41. Është obligim Kushtetues, që Komunat e Republikës së Kosovës, t'i respektojnë dhe zbatojnë vendimet gjyqësore, e jo t'i zvarrisin procedurat e përmbarimit të tyre me arsyetime të pa qëndrueshme dhe të pa bazuara ligjërisht. Arsyetimi i autoriteteve të Komunës për inicimin e konfliktit administrativ nuk duhet të ishte pretekst për moszbatimin e vendimit përfundimtar të KPMSHCK të zhvilluar në procedurë të rregullt administrative, në pajtim me ligjin përkatës që i parasheh dhe rregullon në mënyrë të qartë procedurat e tilla *(shih:nenin 14 të Ligjit Nr. 03/L-192 për KPMSHCK, [.. .] "Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit").*

42. Gjykata Kushtetuese, sa i përket qartësimit të pozicionit dhe juridiksionit të KPMSHCK, konsideron që, KPMSHCK është institucion i pavarur i konstituuar me ligj, në pajtim më Kushtetutën (shih, nenin 101.2 të Kushtetutës). Prandaj, të

gjitha obligimet që dalin nga ky institucion lidhur me çështjet që janë nën juridiksionin e këtij institucioni prodhojnë efekte juridike për institucionet e tjera përkatëse, ku statusi i të punësuarve është i rregulluar me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Vendimi i këtij institucioni paraqet vendim administrativ të formës së prerë dhe si i tillë duhet të përmbarohet nga gjykata kompetente sipas propozimit për përmbarim nga kreditori në kuptim të realizimit të së drejtës së fituar në procedurë administrative.

43. Neni 6 i Konventës, zbatohet edhe për fazat administrative të procesit gjyqësor gjegjësisht është brenda kornizave "për të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm" e drejtë kjo e garantuar edhe me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Nga kjo rrjedh se edhe moszbatimi i vendimeve të Këshillit është element i nenit 6 të Konventës dhe shkelje e saj.

44. Për më tepër, Gjykata i referohet nenit 54 të Kushtetutës që nënvizon faktin se, "*Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur".*

45. Gjykata, thekson se, është e drejtë e palës së pakënaqur që të iniciojë procedurë gjyqësore në rast të dështimit të realizimit të së drejtës së fituar që parashihet me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenin 6 në lidhje me nenin 13 të Konventës Evropiane për te Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Do të ishte e pakuptimtë, nëse sistemi ligjor i Republikës së Kosovës do të lejonte që një vendim gjyqësor përfundimtar, i formës së prerë, të mbetej i paefektshëm në dëm të një pale. Interpretimi i neneve të lartpërmendura në mënyrë ekskluzive ka të bëjë me qasjen ndaj gjykatës. Prandaj, joefektshmëria e procedurave dhe moszbatimi i vendimeve prodhojnë efekte të cilat na sjellin para situatave që nuk janë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit, parim të cilin autoritetet e Kosovës janë të obliguara ta respektojnë *(shih: vendimin e GJEDNJ-së në rastin Romashov kundër Ukrainës, Parashtresa nr. 67534/01, aktgjykimi i 25 korrikut 2004).*

46. Gjykata është e mendimit se, ekzekutimi i një vendimi të marrë nga një gjykatë duhet shikuar si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë, e drejtë kjo e garantuar me nenet e lartpërmendura *(shih: rastin Hornsby kundër Greqisë, aktgjykimi i 19 marsit 1997, raportet 1997-II, f 510, para. 40)*. Në rastin konkret, parashtruesi nuk do të duhej privuar nga përfitimi i vendimit të formës së prerë, që është në favorin e tij. Asnjë autoritet nuk mund të arsyetojë moszbatimin e vendimeve për qëllim të fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të freskët të rastit *(shih: Sovtransavto Holding kundër Ukrainës, nr. 48553/99, § 72, ECHR 2002-VII, si dhe Ryabykh kundër Rusisë, nr. 52854/99, § 52, ECHR 2003-IX)*. Autoritetet kompetente, pra, kanë për obligim që të organizojnë një sistem efikas për zbatimin e vendimeve, që janë efektivë në kuptimin ligjor dhe atë praktik, si dhe duhet të sigurojnë zbatimin e tyre në kohë të arsyeshme, pa vonesa të panevojshme *(shih: Pecevi kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21839/03, 6 nëntor 2008; Martinovska kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 22731/02, 25 shtator 2006)*.

47. Si përfundim, Gjykatë Kushtetuese konstaton se, moszbatimi i vendimeve gjyqësore nga autoritetet e Komunës dhe dështimi i autoriteteve kompetente të Republikës së Kosovës për të siguruar mekanizma efikas në kuptim të zbatimit të vendimeve të autoriteteve përkatëse dhe vendimeve gjyqësore përbenë shkelje të Nenit 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe Nenit 6 në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së.

48. Duke dështuar të zbatojë Vendimin e KPMSHCK të 8 tetorit 2010, autoritetet përkatëse kanë privuar dispozitat e nenit 54 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ nga të gjitha efektet e dobishme.

49. Neni 13 i KEDNJ përcakton:

> "Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja

është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare."

50. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se është shkelur e drejta në gjykim të drejtë dhe efektiv, që garantohet me nenet e përmendura të Kushtetutës dhe KEDNJ, dhe se Vendimi përfundimtar përmbarimor i KPMSHCK, Vendimi nr. 02/197/2010 i 8 tetorit 2010 dhe Vendimi Ac. nr. 158/2011 i Gjykatës së Qarkut në Pejë, i 5 korrikut 2011 duhet të ekzekutohen.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 20 të Ligjit, dhe Rregullin 56 (1) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 11 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;

II. Se ka pasur shkelje të nenit 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenit 6 dhe 13 të KEDNJ;

III. Se vendimi përfundimtar dhe përmbarimor i KPM, Vendimi nr. 02/197/2010 i 8 tetorit 2010, dhe Vendimi Ac. Nr. 158/2011 i Gjykatës së Qarkut në Pejë, i 5 korrikut 2011, duhet të ekzekutohen nga organi kompetent, në veçanti, nga Komuna e Klinës;

IV. Në pajtim me Rregullin 63 (5) të Rregullores së Punës, Komuna e Klinës duhet t'i dorëzojë Gjykatës Kushtetuese informata lidhur me masat e ndërmarra për të zbatuar këtë Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese;

V. Ky Aktgjykim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

VI. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues **Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**

Altay Suroy Prof. Dr. Enver Hasani

KI 117/11 datë 24 korrik 2012 - Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit Komunal në Prizren nr. 01/011-4539 të 18 qershorit 2009

Rasti KI 117/11, Vendimi i 11 korrikut 2012

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, barazia para ligjit, mbrojtja e pronës, përgjegjësia për mjedisin jetësor, palë e autorizuar, actio popularis.

Parashtruesi i kërkesës e ka parashtruar kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar vendimin e Kuvendit Komunal të Prizrenit nr. 01/011-4539 të 18 qershorit 2009 me të cilin është dhënë prona komunale në shfrytëzim – pa kompensim të tokës bujqësore në sipërfaqe prej 5 – 6 hektarësh, e cila gjendet në rrugën lokale për fshatin Nashec, e evidentuar si pronë shoqërore e KK Prizren, për ndërtimin e kompleksit shkollor nga ana e qendrës edukativo-arsimore "Gulistan". Si dhe vlerësimin e kushtetutshmërisë të kontratave që kanë rezultuar si pasojë e këtij vendimi duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese anulimin e këtij vendimi të paligjshëm dhe kontratave të lidhura në bazë të këtij vendimi.

Parashtruesi i kërkesës konsideron se janë shkelur neni 3 (Barazia para Ligjit), neni 24 (Barazia para Ligjit), neni 46 (Mbrojtja e Pronës) dhe neni 52 (Përgjegjësia për mjedisin jetësor) të Kushtetutës së Kosovës.

Duke vendosur në lidhje me kërkesën e parashtruesit Ridvan Hoxha, Gjykata Kushtetuese pas shqyrtimit të procedurës në tërësi konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur argumente me të cilat do të provonte se ai është viktimë e drejtpërdrejtë e miratimit të këtij vendimit dhe kontratave të lidhura në bazë të këtij vendimi. Sistemi juridiko-kushtetues i Kosovës nuk parasheh *actio popularis* që është modalitet i ankesave individuale i cili i mundëson çdo individi i cili kërkon të mbrojë interesin publik dhe rendin juridik që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me rastin e shkeljeve të tilla pa pasur statusin e viktimës.

Nga sa u tha më lart, Gjykata konkludoi se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar për të kontestuar në abstrakt kushtetutshmërinë e vendimit të Kuvendit Komunal dhe të kontratave të lidhura në bazë të këtij vendimi dhe rrjedhimisht kjo kërkesë duhet të shpallet e papranueshme duke mos hyrë në përmbajtjen e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës.

Prishtinë, më 18 korrik 2012

Nr.ref.: RK/283/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI 117/11

Parashtrues

Ridvan Hoxha

Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit Komunal në Prizren nr. 01/011-4539 të 18 qershorit 2009

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Ridvan Hoxha, këshilltar në Kuvendin Komunal të Prizrenit (në tekstin e mëtejmë: KK Prizren).

Vendimi i kontestuar

2. Kontestohet vendimi i KK-së Prizren nr. 01/011-4539 të 18 qershorit 2009, me të cilin lejohet *„...dhënia e pronës së komunës për shfrytëzim- pa kompensim, toka bujqësore me sipërfaqe prej 5-6 hektarësh, e cila gjindet në rrugën lokale për në fshatin Nashec, e evidentuar si pronë shoqërore e KK Prizren, për ndërtimin e kompleksit shkollor nga ana e qendrës edukative-arsimore "Gulistan"*.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vendimi i KK Prizren nr. 01/011-4539 të 18 qershorit 2009, me të cilin toka e komunës i është dhënë në shfrytëzim pa kompensim, e me te cilën sipas pohimeve të parashtruesit janë shkelur nenet 3, 24, 46 dhe 52 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejmë:Ligji) dhe Rregullin 56 paragrafi 2 i Rregullores së Punës.

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi i kërkesës më 18 gusht 2011 ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tesktin e mëtejmë: Gjykata).

6. Me Vendimin (nr. GJR.117/11 të 23 gushtit 2011) e Kryetarit, gjyqtarja Iliriana Islami është caktuar Gjyqtare raportuese. Të

njëjtën ditë, me Vendimin nr. KSH.117/11 të Kryetarit, është caktuar Kolegji Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodriguez dhe Ivan Čukalović.

7. Me Vendim të Kryetarit (nr. GJR. 117/11 të 2 korrikut 2012), gjyqtari Altay Suroy u emërua gjyqtar raportues në vend të gjyqtares Iliriana Islami së cilës më 26 qershor 2012 i përfundoi mandati në pozitën gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.

8. Më 11 korrik 2012, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Altay Suroy, Kolegji Shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović i paraqiti Gjykatës në përbërje të plotë rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. KK Prizren, pas shqyrtimit të kërkesës për dhënie të pronës komunale në shfrytëzim, të parashtruar nga ana e qendrës edukative-arsimore „Gulistan“, për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, në seancën e mbajtur më 18 qershor 2009, ka miratuar VENDIMIN nr. 01/011-4539 të 18 qershorit 2009 për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim të përhershëm me të cilin:

I. LEJOHET *dhënia në shfrytëzim – pa kompensim e pronës komunale, të tokës bujqësore me sipërfaqe prej 5-6 hektarësh, që gjendet në rrugën lokale për në fshatin Nashec, e evidentuar si pronë shoqërore e KK Prizren, për ndërtimin e kompleksit shkollor nga ana e qendrës edukative-arsimore „Gulistan“.*

II. AUTORIZOHET *Kryetarin e Komunës së Prizrenit që përmes organeve komunale (Drejtorisë së Administratës - Sektori për çështje pronësore-juridike dhe Avokaturës*

Publike-Komunale) që në procedurë të veçantë, pas bisedimeve me Institucionin që specifikohen në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi, që në pajtim me ligjet në fuqi, sa ipërket kohëygjatjes, mënyrës së shfrytëzimit dhe kushtet e tjera, të marrë aktvendimin për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit pa kompenzim të pjesës së pronës sëpaluajtshme nga KK Prizren në dobi të qendrës edukative-arsimore „Gulistan" për periudhën kohore që lejohet me ligjet në fuqi të cilat rregullojnë këtë cështje, me qëllim të ndërtimit të kompleksit të ri shkollor me infrasrukturën përcjellëse.

10. Për zbatimin e këtij vendimi të Kuvendit te Komunës së Prizrenit 01/011-4539 të 18 qershorit 2009, për dhënien e pronës komunale për shfrytëzim të përhershëm, kryetari i komunës, sipas detyrës zyrtare (ex officio) në procedurën e marrjes së tokës ndërtimore nga ana e shfrytëzuesit të tanishëm, në përputhje me nenin 17 dhe 25 të Ligjit për tokën ndërtimore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"nr. 44/80), njësia 128.2 (d) dhe neni 82 i Ligjit për Procedurën Administrative nxori **AKTVENDIMIN** Nr**.**01-370 të 24 nëntorit 2010, me të cilin:

*I. **MERRET** toka e regjistruar në emër të Organizatës Punuese të pyjeve „Sharri"- **OPB** Ekonomia e Pyjeve, dhe bartet në pronësi të Komunës së Prizrenit, ku sipërfaqja e asaj pjese të pronës së paluajtshme **50300 m2** e regjistruar si ngastër kadastrale në vendin e quajtur „Boka-Boka" me një sipërfaqe të përgjithshme prej **474434 m2**, sipërfaqe e regjistruar në certifikatën për të drejtat e paluajtshme **nr. 553,** ZK Korishx".*

11. Më 9 shkurt 2011, në Prizren është lidhur marrëveshje për kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme mes kryetarit të komunës së Prizrenit z. Ramadan Muja dhe shfrytëzuesit QEA „Gulistan" ku në nenin 1 të kontratës vërtetohet si në vijim:

"Ngastra kadastrale me nr. 800/2 prej 50300m2 e ZK Korishë, pronë e KK Prizren, i jepet në shfrytëzim QEA „Gulistan", në

përputhje me vendimin e KK Prizrennr. 01/011-4539 të 18 qershorit 2009 në periudhë kohore prej 40 vjetësh, duke u bazuar në Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës nr.03/L-226 të 28.10.201, ndërsa Komuna e Prizrenit ruan të drejtën e pronësisë, deri në ndonjë ndryshim eventual në ligjet dhe në aktet tjera juridike të Republikës së Kosovës, që rregullojnë këtë lëmi".

12. Përveq kontratës së lartëpërmendur, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor – KK Prizren si (qiradhënës) i N.T.P. „Kamila"–SH.P.K. –(nr. Fiskal -600108741)-si (qiramarrës) për 10 vjet (10+ 10) me mundësi vazhdimi)" , në Prizren më 15 prill 2011, kanë lidhur kontratën nr. 04-353 për shfrytëzimin e tokës komunale dhe përcaktimin e qirasë për ndërtimin e objektit – të fabrikës së çokolladës.

13. Parashtruesi i kërkesës cështjen e ligjshmërisë të këtyrë vendimeve, aktvendimeve dhe kontratave të lartëpërmendura është përpjekur ta vejë në rendin e ditës të seancës së XIII të KK-së së Prizrenit e cila është mbajtur më 16 qershor 2011, mirëpo këtë kryesuesi i Kuvendit nuk ia ka lejuar sepse rendi i ditës për seancën e XIII-të të KK Prizren ishte caktuar paraprakisht.

14. Më 1 korrik 2011, parashtruesi i kërkesës ka parashtrar një ankesë në Ministrinë e Administrrimit të Pushtetit Lokal duke paraqitur Ministrinë si organ përgjegjës për mbikëqyrje administrative të punës së pushtetit lokal, për parregullsitë me rastin e nxjerrjes së vendimeve, aktvendimeve dhe kontratave të lartëpërmendura.

15. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në përgjigjen ndaj ankesës nr. 463-576 të 13 korrikut 2011 në bazë të nenit 81.4 të Ligjit për Pushtetin Lokal nr. 03/L-040, Ligji për dhënjen në shfrytëzim dhe zëvendësim të pronës së paluajtshme të Komunës nr. 03/L-040, dhe pas shqyrtimit të pretendimeve në ankesë dhe të dëshmive të paraqitura, është konstatuar si në vijim:

"Dhënja e pronës së komunës në shfrytëzim D.T.P. „Kamila d.o.o." dhe kompanisë QEA „Gulistan" është në kundërshtim me dispozitat e nenit 5 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit nr. 03/L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, të cilët përcaktojnë se, Kuvendi i Komunës ka të drejtë për të dhënë në shfrytëzim pronën e paluajtshme të Komunës në periudhë prej dhjetë (10) vjetësh, në pajtim me kriteret e përcaktuara në Ligjin për prokurim publik, dhe në periudhë më të gjatë se dhjetë (10) vjetë, por jo më shumë se katërdhjetë (40) vjetë pas përmbushjes së kriterit të përcaktuar me Ligj për prokurim dhe pas dhënjes së aprovimit nga ana e Ministrisë së Financave dhe aprovimit paraprak nga ana e Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor dhe të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë".

"Në bazë të asaj që është përmendur më lartë dhe me qëllim të zbatimit të Ligjit për Pushtet Lokal, Ministria për Administratë të Pushtetit Lokal kërkon nga organet komunale, përkatësisht nga Kryetari i Kuvendit të komunës së Prizrenit, të ndërmarrë hapa konkretë në mënyrë që dhënia e pronës së paluajtshme të Komunës nga ana e Kuvendit të Komunës, të bëhet më respektimin e dispozitave të Ligjit nr. 03/L-226 për dhënien në shfytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës."

Pretendimet e parashtruesit

16. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Kuvendi i Komunës në Prizren me marrjen e vendimeve, aktvendimeve dhe kontratave të lartëpërmendura ka shkelur nenin 3 (Barazia para Ligjit), 24 (Barazia para Ligjit), 46 (Mbrojtja e Pronës), dhe 52 (Përgjegjësia për Mjedisin jetësor) të Kushetetutës së Republikës së Kosovës.

17. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për:

"Vërtetimin e shkeljes së dispozitave ligjore me vendimet arbitrare të Kryetarit të KK Prizren, Ramadan Muja, si përgjegjës

kryesor në Kuvendin e Komunës së Prizrenit dhe Kryesuesit Nijazi Kryeziu dhe PRISHJEN e këtyre vendimeve joligjore dhe kontratave të lidhura në bazë të këtyre vendimeve, me të cilat do të arrihej qëllimi kryesor, që veprimi i Kuvendit të Komunës në Prizren të bazohet në Kushtetutë dhe në ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës thekson se nenet 3 (Barazia para Ligjit), 24 (Barazia para Ligjit), 46 (Mbrojtja e Pronës) dhe 52 (Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës janë bazë për kërkesën e tij.

19. Kushtet e pranueshmërisë janë të parapara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e Punës.

20. Nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës në kornizën juridike të kritereve të pranueshmërisë së kërkesës nga individët, parashohin

„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

21. Në këtë rast konkret, parashtruesi ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese vlerësimin e kushtetutshmërisë së „ vendimit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-4539 të 18 qershorit 2009, me të cilin lejohet „...dhënia e pronës së

komunës në shfrytëzim-pa kompenzim , të tokës bujqësore me sipërfaqe prej 5-6 hektarësh, e cila gjindet në rrugën lokale për në fshatin Nashec, e regjistruar si pronë shoqërore e KK Prizren, për ndërtimin e kompleksit shkollor nga ana e qendrës edukative-arsimore „Gulistan". Gjithashtu edhe vlerësimin e kushtetutshmërisë së kontratës që është lidhur si rrjedhojë e këtij vendimi, duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese; „ANULIMIN e këtij vendimi joligjor dhe kontrates së lidhur në bazë të këtij vendimi".

22. Kërkesa e tillë për anulimin e vendimit të Kuvendit të Komunës në Prizren nr. 01/011-4539 të 18 qershorit 2009 dhe të kontratës së lidhur në bazë të këtij vendimit për të mbrojtur interesat e të gjithë qytetarëve të Komunës së Prizrenit tregon se parashtruesi e konteston në abstrakt vendimin e cekur dhe kontratat. Nëse ky është qëllimi i parashtruesi të kërkesës, si individ, ai nuk mund të konsiderohet si palë e autorizuar.

23. Në fakt, parashtruesi i kërkesës i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës si baze juridike për parashtrimin e kërkesës së tij. Përveq kësaj, parashtruesi nuk ka paraqitur argumente me të cilat do të dëshmonte se ai është viktimë e drejtëpërdrejtë nga miratimi i këtij vendimi dhe të kontratave të lidhura në bazë të këtij vendimi.

24. Vetëm individët, ashtu siç parashikohet në mënyrë eksplicite në nenin 113.2 deri 113.6 të Kushtetutës, janë palë e autorizuar që t'i drejtohen Gjykatës për çështjet e vlerësimit abstrakt të kushtetutshmërisë.

25. Përveq kësaj, sistemi kushtetues-juridik i Kosovës nuk parasheh „actio popularis", i cili është modalitet i ankesave individuale që mundëson çdo individi, i cili përpiqet të mbrojë interesin publik dhe rendin kushtetues, që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me rastin e shkeljeve të tilla edhe pse nuk ka statusin e viktimës.

26. Sipas kësaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar që të kontestojë kushtetutshmërinë e vendimeve të Kuvendit të Komunës dhe kontratës së lidhur në bazë të këtij vendimi në abstrakt dhe prandaj kjo kërkesë duhet të shpallet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 46, 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1a) dhe (3c) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese e Kosovës në seancën e mbajtur më 11 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Prof. Dr. Enver Hasani

K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12 datë 20 korrik 2012- Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012

Rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12, vendim i 20 korrikut 2012.

Fjalët kyçe: amandamentet e propozuara kushtetuese, deputetët e kuvendit, ex-post, ex-ante, funksionimi demokratik i institucioneve, kapitulli II i Kushtetutës, kërkesë e kryetarit të kuvendit, kërkesë e pranueshme, kriteri i proporcionalitetit, kushtetushmëria, ndërprerje e parakohshme e mandatit, pakësim i të drejtave dhe lirive kushtetuese, palë e autorizuar, parimi i ndarjes së pushteteve, subjektet politike, siguria e rendit juridik dhe kushtetuese, të drejtat civile dhe politike, zgjedhjet presidenciale.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.9 dhe Nenin 144.3 të Kushtetutës me ç'rast dorëzoi një grup të amendamenteve të propozuara për të vlerësuar paraprakisht nëse ato pakësojnë të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës. Nga pakoja e amandamenteve kushtetuese, Gjykata veçoi dhe konstatoi se nenet e reja të propozuara 85.2, 86.3, 90.5 (2), 90.5 (3), 90.5 (5), 104.1, 114.2, 162.1 pakësojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Nenin i ri i propozuar 85.2 lidhur me kufizimin e të drejtës për të qenë kandidat për President vetëm për qytetarët që kanë qenë banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës për pesë vjet, Gjykata arsyetoi *mes tjerash* se amendamenti i propozuar paraqet kufizim të së drejtës së cilitdo qytetar të Republikës së Kosovës që nuk ka pasur banim të përhershëm në Kosovë për pesë vjet të plota para kandidimit për post, dhe se pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Neni i ri i propozuar 86.3 lidhur me propozimet për postin e Presidentit të Kosovës -sepse ka të bëjë vetëm me subjektet politike parlamentare qe e kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit, Gjykata arsyetoi *mes tjerash* pasiqë neni i ri i propozuar nuk lejon propozimin nga të gjitha subjektet politike të regjistruara, pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.Neni i ri i propozuar 90.5 (2) lidhur me

kufizimin e kompetencave të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, Gjykata arsyetoi *mes tjerash* se nëse paraqiten rrethana të cilat kerkojnë që shteti të sigurohet dhe Ushtruesi i Detyrës se Presidentit i ka duart e lidhura, atëherë mund të paraqitet krizë kushtetuese të drejtat dhe liritë e njeriut të të gjithë qytetarëve në shtet mund të jenë në rrezik në një situatë të tillë, dhe se kufizimi i mundësisë së Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për të shpallur gjendje të jashtëzakonshme pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.Neni i ri i propozuar 90.5 (3) lidhur me kufizimin e kompetencave të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, Gjykata *mes tjerash* arsyetoi se drejtësia nuk mund të administrohet nëse gjyqtarët dhe prokurorët nuk janë në detyrë. Pengesa për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve mund të konsiderohet pengesë për administrimin e drejtësisë dhe pakësim i të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.Neni i ri i propozuar 90.5 (5) lidhur me kufizimin e kompetencave të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për shpalljen e faljeve, Gjykata *mes tjerash* arsyetoi se me nenin e ri propozohet që kur një person meriton të falet, në pajtim me ligjin, falja e tillë mund të mos lejohet, dhe se kjo përbën pakësim të të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës. Neni i ri i propozuar 104.1 lidhur me veton pezulluese të Presidentit për emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të rregullta, Gjykata *mes tjerash* arsyetoi se me rastin e shqyrtimit të nenit 90.5 (3), Gjykata theksoi se kufizimi i kompetencës së Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për të emëruar gjyqtarë pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës. Gjykata më tutje theksoi se i njëjti arsyetim vlen edhe për veton pezulluese të propozuar për Presidentin për t'i kthyer prapa emrat e gjyqtarëve të propozuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës per t'u emëruar. Neni i ri i propozuar 114.2 lidhur me veton pezulluese të Presidentit për emërimin e gjyqtarëve të Gjykates Kushtetuese, Gjykata *mes tjerash* arsyetoi se qëndrimi në lidhje me emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese është qëndrim që mund të shkaktojë vonesa të paarsyeshme nga Presidenti nëse ai ose ajo e kthen prapa gjyqtarin e propozuar të Gjykatës Kushtetuese, dhe se neni i ri i propozuar përbën pakësim i të drejtave dhe lirive të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Neni i ri i propozuar 162.1 lidhur me ndërprerjen e parakohshme të mandatit të Presidentit të Republikës së Kosovës, Gjykata *mes tjerash* arsyetoi se ndërprerja e parakohshme e mandatit te Presidentit, siç parashihet me amendamentin e propozuar, ndikon në parimet themelore

kushtetuese, në veçanti, parimin e ndalimit të shkurtimit të mandatit të fituar ligjërisht të postit kushtetues, si dhe parimin e mbrojtjes së besimit të arsyetuar të qytetarëve në ligjet e Kosovës dhe të zgjedhjes dhe mandatit të Presidentit të tyre duke u bazuar në ato ligje. Gjykata më tutje theksoi se mandati i Presidentit është i bazuar në Kushtetutë dhe si i tillë është i panecueshëm për të siguruar respektim të parimit të ndarjes së pushteteve dhe për ta ruajtur sigurinë në rendin juridik dhe kushtetues. Gjykata konstatoi se ndërpreja e parakoshme e mandatit të Presidentit të Republikës së Kosovës përbën pakësim të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës.

Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata konkludoi se Amendamentet e lartpërmendura 1) pakësojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës, 2) Aktgjykimi do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 te Ligjit; dhe 3) Aktgjykimi hyn në fuqi menjëherë.

Prishtinë, më 20 korrik 2012

Nr. Ref.:AGJ 284/12

AKTGJYKIM

në

Rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12

Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Duke u mbështetur në nenin 144.1 të Kushtetutës, 31 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës propozuan një sërë amendamentesh kushtetuese. Më 23 mars 2012, sipas kompetencave të veta të përcaktuara në nenin 144.3 të Kushtetutës, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kryetari i Kuvendit) dorëzoi një grup të amendamenteve të propozuara për të vlerësuar paraprakisht nëse ato pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

2. Kryetari i Kuvendit e dorëzoi edhe një grup tjetër të amendamenteve në Gjykatë më 4 maj 2012. Ky grup i dytë i amendamenteve dallonte në disa aspekte nga grupi i parë i amendamenteve.

3. Kryetari i Kuvendit është parashtrues i kërkesave në Gjykatën Kushtetuese.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.9 dhe në nenin 144.3 të Kushtetutës, në nenin 20 dhe në nenin 54 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 23 mars 2012, Kryetari i Kuvendit e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese duke kërkuar që Gjykata të vlerësonte nëse amendamentet e propozuara nga 31 deputetë pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës. Këto amendamente të propozuara janë të paraqitura në Aneksin A.

6. Më 26 mars 2012, Kryetari e caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Snezhana Botusharova.

7. Më 27 mars 2012, Gjykata kërkoi nga parashtruesi të dorëzonte informata dhe dokumente mbështetëse lidhur me procedurën e ndërmarrë në përputhje me nenin 144 të Kushtetutës.

8. Më 29 mars 2012, kërkesa iu komunikua Shkëlqesisë së saj, znj. Atifete Jahjaga, Presidente e Republikës së Kosovës dhe z. Sami Kurteshi, Avokat i Popullit,.

9. Më 30 mars 2012, Gjykata mori informatat shtesë dhe dokumentet mbështetëse që i kishte kërkuar nga parashtruesi.

10. Më 24 prill 2012, Avokati i Popullit iu përgjigj Gjykatës dhe ofroi vërejtjet e veta për amendamentet e propozuara. Përgjigja e Avokatit të Popullit është e paraqitur më poshtë.

11. Presidentja e Republikës i dorëzoi vërejtjet e veta në lidhje me amendamentet e propozuara më 3 maj 2012, të paraqitura më poshtë.

12. Kryetari i Kuvendit e dorëzoi edhe një grup tjetër të amendamenteve të propozuara të Kushtetutës në Gjykatë më 4 maj 2012. Ky grup i dytë i amendamenteve dallon në disa aspekte nga grupi i amendamenteve të dorëzuara më 23 mars 2012. Grupi i dytë i amendamenteve u mbështet nga gjysma e deputetëve që i bashkëngjitën emrat e tyre në amendamentet e para, kurse gjysma tjetër e deputetëve janë deputetë të tjerë. Grupi i dytë i amendamenteve u regjistrua nën numrin K.O. 48-12. Këto amendamente të propozuara janë të paraqitura në Aneksin B.

13. Më 7 maj 2012, Kryetari i Gjykatës kërkoi nga Kryetari i Kuvendit të tregonte cili grup i amendamenteve duhet të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese.

14. Kryetari i Kuvendit u përgjigj më 10 maj 2012 duke thënë se grupi i dytë i amendamenteve duhet të shqyrtohet nga Gjykata.

15. Më 10 maj 2012, Gjykata vendosi t'i bashkojë këto dy kërkesa për shkak të lidhjes me njëra-tjetrën sa i përket objektit të çështjes dhe personave që i parashtrojnë kërkesat.

16. I njëjti Gjyqtar raportues dhe Kolegj shqyrtues u caktuan edhe për grupin e dytë të amendamenteve.

17. Me anë të shkresës së 22 qershorit 2012, Avokati i Popullit ofroi komentet e veta lidhur me grupin e dytë të amendamenteve të propozuara.

Përmbledhje e fakteve

18. Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi tekstin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ajo hyri në fuqi më 15 qershor 2008. Në Kapitullin XIII [Dispozitat Përfundimtare], neni 144 [Amendamentimi] i Kushtetutës e autorizon Qeverinë, Presidentin apo një të katërtën (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, siç përcaktohet në Rregulloren e punës së Kuvendit, të propozojnë ndryshime dhe amendamentime të kësaj Kushtetute.

19. Udhëheqësit e Aleancës Kosova e Re (AKR), të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), z. Behgjet Pacolli, z. Isa Mustafa dhe z. Hashim Thaçi, nënshkruan një Memorandum të Marrëveshjes më 6 prill 2011.

20. Sipas kësaj Marrëveshjeje, Shkëlqesia e saj, znj. Atifete Jahjaga, u nominua si kandidate për Presidente të Republikës së Kosovës dhe palët përkatëse ofruan mbështetjen e tyre të plotë për kandidaturën e saj.

21. Në Marrëveshje më tej thuhet që udhëheqësit pajtohen që menjëherë ta formojnë një "Komision për Reformën e Zgjedhjeve Presidenciale" që do t'i hartojë amendamentet kushtetuese dhe legjislacionin e ndërlidhur, të nevojshëm për të siguruar që Presidenti i Kosovës zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli, dhe që zgjedhjet e drejtpërdrejta presidenciale në Kosovë do të mbahen jo më vonë se gjashtë muaj nga data në të cilën këto ndryshime dhe amendamentime të nevojshme të Kushtetutës dhe legjislacioni hyjnë në fuqi.

22. Sipas Marrëveshjes, udhëheqësit më tej pajtohen që Ligji i reformuar për zgjedhjet e përgjithshme do të përfshijë një dispozitë që thotë se zgjedhjet e para të përgjithshme sipas ligjit të amendamentuar do të mbahen jo më vonë se 18 muaj nga data në të cilën ligji i reformuar dhe amendamentimet e ndërlidhura kushtetuese hyjnë në fuqi.

23. Në Marrëveshje në fund thuhet që udhëheqësit do t'i paraqesin ndryshimet e përmendura në Marrëveshje në mbledhjen e Kuvendit në të cilën zgjidhet Presidenti i Kosovës.

24. Më 7 prill 2011, Kuvendi me 75 vota për, 2 abstenime dhe asnjë votë kundër, e miratoi Rezolutën Nr. 04-R-2, me të cilën e mbështeti Memorandumin e Marrëveshjes së sipërpërmendur.

25. Të njëjtën ditë, Kuvendi me 80 vota për, 10 të pavlefshme dhe 10 për kandidaten tjetër, e miratoi Vendimin Nr. 04-V-11, me të cilin Shkëlqesia e saj, znj. Atifete Jahjaga, u zgjodh Presidente e Republikës së Kosovës dhe se mandati i Presidentit është pesë (5) vjet.

26. Më 15 prill 2011, shefat e grupeve parlamentare: PDK, LDK, AAK, SLS, AKR dhe 6+, dorëzuan një propozim në Kuvend

për formimin e dy komisioneve: një Komision për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe një Komision për amendamentimin e ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

27. Më 22 prill 2011, Kuvendi me 76 vota për, 4 abstenime dhe 6 vota kundër, e miratoi Vendimin Nr. 04-V-12, për formimin e Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Komisioni).

28. Më 6 maj 2011, Kryetari i Kuvendit e njoftoi Komisionin në hollësi lidhur me statusin dhe kompetencat e Komisionit.

29. Më 23 dhjetor 2011, Komisioni kërkoi zgjatjen e mandatit të vet.

30. Më 20 janar 2012, Kuvendi me 62 vota për, 1 abstenim dhe 2 vota kundër, e miratoi Vendimin Nr. 04-V-227, me të cilin u miratua kërkesa për zgjatjen e mandatit të Komisionit edhe për dy muaj.

31. Më 20 mars 2012, kryesuesi i Komisionit ia dorëzoi Kuvendit amendamentimet e propozuara të Kushtetutës, të shoqëruar me listën e nënshkrimeve të 31 deputetëve të Kuvendit.

32. Më 23 mars 2012, Kryetari i Kuvendit ia dërgoi amendamentimet e propozuara Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar që Gjykata të vlerësojë nëse amendamentet e propozuara pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

33. Shkresa e sipërpërmendur përmbante shtojcën e 19 marsit 2012, nga kryesuesi i Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, drejtuar Kryetarit të Kuvendit, në të cilën thuhet “Në përputhje me nenin 144 të

Kushtetutës së Republikës së Kosovës, po ua dërgoj pakon e amendamenteve kushtetuese për procedim të mëtutjeshëm".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

34. Gjykata tani do të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

35. Gjykata duhet së pari duhet të përcaktojë nëse parashtruesi mund të konsiderohet palë e autorizuar sipas nenit 113.9 të Kushtetutës, i cili përcakton: *"Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës"*.

36. Kryetari i Kuvendit, Dr. Jakup Krasniqi, e dorëzoi kërkesën në këtë Gjykatë për vlerësim paraprak të amendamenteve të propozuara të Kushtetutës. Prandaj, sipas nenit 113.9 të Kushtetutës, parashtruesi është palë e autorizuar, dhe ka të drejtë ta parashtrojë këtë rast në Gjykatë.

37. Prandaj, Gjykata konkludon që parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri dhe kërkesa është e pranueshme.

Përgjigja e Avokatit të Popullit

38. Sa i përket amendamentit 1, nenit 84.10 të Kushtetutës, Avokati i Popullit ka kërkuar që fjala "bashkëpunim" të përcaktohet në mënyrë më të qartë për t'i evituar dallimet e mundshme të interpretimit.

39. Sa i përket amendamentit 1, nenit 84.21 të Kushtetutës, Avokati i Popullit ka kërkuar që shprehja "së bashku" të përcaktohet në mënyrë më të qartë.

40. Sa i përket amendamentit 1, nenit 84.22 të Kushtetutës, Avokati i Popullit konsideron që Kryeministri duhet të jetë më i përfshirë në vendimin për të shpallur gjendje të jashtëzakonshme.

41. Sa i përket amendamentit 1, nenit 84.30 të Kushtetutës, Avokati i Popullit mendon që Presidenti nuk mund të jetë përgjegjës për raportin për gjendjen në Republikën e Kosovës.

42. Sa i përket amendamentit 1, nenit 84.31 të Kushtetutës, Avokati i Popullit konsideron që Avokati i Popullit duhet të emërohet nga Kuvendi.

43. Sa i përket amendamentit 3, nenit 86.1 të Kushtetutës, Avokati i Popullit konsideron që fjalia *"ashtu siç përcaktohet me ligj"* duhet të shtohet në fund të paragrafit.

44. Sa i përket amendamentit 4, nenit 87.2 të Kushtetutës, Avokati i Popullit konsideron që Presidenti duhet të betohet para Kuvendit.

45. Sa i përket amendamentit 7, nenit 90 të Kushtetutës, Avokati i Popullit konsideron që pjesa më e madhe e nenit të propozuar duhet të përfshihet në Ligjin për Presidentin. Avokati i Popullit gjithashtu është i mendimit që kompetencat si faljet individuale apo emërimi i gjyqtarëve duhet të vazhdojnë të ushtrohen nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit. Ai thekoi se mungesa dhe/ose pamundësia e Presidentit nuk duhet të ndikojë në mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, nëse kjo zgjat shumë kohë.

46. Sa i përket amendamentit 8, nenit 91.1 të Kushtetutës, Avokati i Popullit konsideron që dorëheqja duhet t'i dorëzohet Kryetarit të Kuvendit, i cili me automatizëm do të fillojë ta ushtrojë detyrën e Presidentit.

47. Sa i përket amendamentit 8, nenit 91.6 të Kushtetutës, Avokati i Popullit konsideron që në rast të pamundësisë së Kryetarit të Kuvendit për ta ushtruar detyrën, ajo i kalon nënkryetarit më të vjetër, e kështu me radhë.

48. Me anë të shkresës së 22 qershorit 2012, Avokati i Popullit i ofroi komentet e veta lidhur me grupin e dytë të amendamenteve të propozuara, duke theksuar që neni 84.31 duhet të fshihet dhe që neni 134.1 duhet të mbetet me shtesën: *"Me të drejtën e rizgjedhjes së Ombudspersonit*".

Përgjigja e Presidentes së Republikës

49. Presidentja e Republikës u përgjigj më 3 maj 2012, por vetëm në lidhje me amendamentin 10, lidhur me shpalljen e zgjedhjeve të para presidenciale, i cili e zëvendëson nenin ekzistues 162 të Kushtetutës.

50. Presidentja konsideron që amendamenti i propozuar parasheh shkarkimin, përkatësisht ndërprerjen e mandatit kushtetues të Presidentit. Presidentja pohon që kjo bëhet përmes një veprimi retroaktiv të amendamentit të propozuar kushtetues dhe pa dyshim do të shpjerë në "shkarkim", edhe pse kjo fjalë nuk është përdorur.

51. Shkarkimi, sipas propozimit, do ta ndërpresë mandatin e Presidentit në një mënyrë që nuk është paraparë me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës duke shkelur kështu të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. E drejta për t'u zgjedhur gjithashtu parashikon kohëzgjatjen e mandatit. Rrjedhimisht, ky element i të

drejtës për t'u zgjedhur nuk mund të ndryshohet sapo një individ të jetë zgjedhur në funksion publik. Kushtetuta nuk parasheh asnjë rezervim apo kufizim të këtij elementi të së drejtës, pasi të jetë zgjedhur.

52. Presidentja theksoi se neni 91 [Shkarkimi i Presidentit] i Kushtetutës parashikon raste specifike kur Presidenti mund të shkarkohet nga posti, duke treguar kështu që Presidenti nuk mund të shkarkohet nëpërmjet një amendamenti kushtetues.

53. Presidentja pohon që amendamenti i propozuar është në kundërshtim me parimin e përgjithshëm të drejtësisë për moszbatimin e dispozitave kushtetuese dhe ligjore, apo ndryshimeve të tyre, në mënyrë retroaktive.

54. Amendamenti i propozuar shkel parimin e mosdiskriminimit, siç parashihet në nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

55. Presidentja gjithashtu thotë që amendamenti i propozuar shkel parimin e ndarjes së pushteteve.

Kushtetutshmëria e amendamenteve të propozuara

Shtrirja e juridiksionit kushtetues

56. Siç u tha më lart në pjesën Procedura në Gjykatë, grupi i dytë i amendamenteve të propozuara u dorëzua në Gjykatë nga Kryetari i Kuvendit. Ky grup i dytë i amendamenteve dallon në disa aspekte nga grupi i parë i amendamenteve të dorëzuara.

57. Gjykata rikujton që Kryetari i Kuvendit e njoftoi Gjykatën se vetëm grupi i dytë i amendamenteve duhet të shqyrtohet.

58. Gjykata është e vetëdijshme për nevojën e sigurisë juridike në lidhje me këtë çështje. Prandaj, Gjykata konsideron që grupi i dytë i amendamenteve e ka përfshirë dhe zëvendësuar grupin e parë të amendamenteve të propozuara dhe vlerësimi që përfshihet në këtë Aktgjykim ka të bëjë vetëm grupin e dytë të amendamenteve.

59. Prandaj, Gjykata do ta bëjë atë vlerësim duke u bazuar në kompetencën e vet juridiksionale sipas nenit 113.9 të Kushtetutës, që do të thotë konfirmimin se amendamentet e propozuara nuk i pakësojnë të drejtat dhe liritë e garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

60. Gjykata gjithashtu thekson që në përputhje me nenin 112 [Parimet e Përgjithshme] të Kapitullit VIII [Gjykata Kushtetuese] të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

61. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron që, sa i përket vlerësimit të kushtetutshmërisë së cilitdo amendament të propozuar të Kushtetutës, sipas nenit 144.3, amendamenti i tillë duhet të konsiderohet në dritën e Kapitullit II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës, i cili sipas nenit të vet 21 [Parimet e Përgjithshme], përbëhet nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të cilat janë baza e rendit juridik të Republikës së Kosovës.

62. Përveç kësaj, Gjykata konsideron që Kapitulli III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] dhe të drejta të tjera mund të jenë të zbatueshme në këtë proces, pasi të drejtat specifike të përcaktuara janë zgjerim i të drejtave dhe lirive të njeriut të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës, në veçanti, i atyre të drejtave të përcaktuara në nenin 24 [Barazia para Ligjit].

63. Kjo është veçanërisht kështu edhe nga pikëpamja e dispozitave të nenit 21.2 të Kushtetutës, i cili përcakton që Republika e Kosovës do t'i mbrojë dhe garantojë të drejtat

dhe liritë themelore të njeriut, siç parashihet me Kushtetutë, jo doemos ato të përfshira vetëm në Kapitullin II.

64. Prandaj, me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara, kjo Gjykatë nuk do t'i marrë parasysh vetëm të drejtat dhe liritë e njeriut të përfshira në Kapitullin II, por edhe të gjitha të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe të parashikuara me shkronjën dhe frymën e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës.

65. Është me rëndësi të theksohet që Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Ky është një juridiksion *ex-post* i Gjykatës si garantues i Kushtetutës për ta siguruar përputhjen e legjislacionit me aktin më të lartë të shtetit, pra me Kushtetutën.

66. Përveç këtij juridiksioni, Gjykata gjithashtu ka juridiksionin e ashtuquajtur *ex-ante* për vlerësim paraprak të kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar. Ky juridiksion i jepet Gjykatës, si mbrojtëse e Kushtetutës, për të siguruar që amendamenti i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

67. Gjykata konsideron që Kushtetuta është e qartë në atë drejtim. Amendamentet kushtetuese mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi Kryetari i Kuvendit të Kosovës ta ketë parashtruar amendamentin e propozuar në Gjykatë Kushtetuese për konfirmim paraprak që amendamenti i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

68. Gjykata gjithashtu konsideron që neni 21 i Kushtetutës duhet të lexohet në lidhje me nenin 7.1 të Kushtetutës, i cili i përcakton vlerat e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës që bazohet *"në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe*

sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut."

69. Sipas nenit 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme] të Kushtetutës, shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore që mbrohen me Kushtetutë mund të bëhet vetëm pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, sipas kësaj Kushtetute dhe vetëm deri në masën sa është e domosdoshme nën rrethanat e dhëna. Përveç kësaj, shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore që garantohen me nenet 23, 24, 25, 27, 28, 29, 31, 33, 34, 37 dhe 38 të kësaj Kushtetutës nuk do të lejohet në asnjë rrethanë.

70. Prandaj, është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të sigurojë mbrojtjen e këtyre vlerave themelore të rendit kushtetues. Në këtë drejtim, vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës, siç përcaktohet në paragrafin 1 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës."

71. Neni 116 i Kushtetutës zbatohet për të gjitha vendimet e Gjykatës, duke përfshirë Aktgjykimin e saj për kushtetutshmërinë e amendamenteve të propozuara.

72. Gjykata tani do ta shqyrtojë me radhë secilin prej amendamenteve të propozuara të grupit të dytë, të paraqitura në Aneksin B.

I. Amendamenti 1 i propozuar: Neni 84 [Kompetencat e Presidentit]

73. Amendamenti 1 propozon të ndryshohen paragrafët 1, 9, 10, 20, 21, 22, 23, 24, 26 dhe 30 të nenit 84, dhe t'i shtohen dy paragrafë të ri 31 dhe 32.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 84.1 të Kushtetutës

74. Sipas nenit aktual 84.1, Presidenti i Republikës së Kosovës:

> *"përfaqëson Republikën e Kosovës brenda dhe jashtë;"*

75. Sipas amendamentit të propozuar, neni 84.1 thotë me sa vijon:

> *"[Presidenti i Republikës së Kosovës] përfaqëson Republikën e Kosovës;"*

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 84.1 të Kushtetutës

76. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 84.1. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 84.1

nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 84.9 të Kushtetutës

77. Sipas nenit aktual 84.9, [Presidenti i Republikës së Kosovës]:

"mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;"

78. Sipas amendamentit të propozuar, neni 84.9 thotë me sa vijon:

"[Presidenti i Republikës së Kosovës] ngre çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me këtë Kushtetutë".

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 84.9 të Kushtetutës

79. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 84.9. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 84.9 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 84.10 të Kushtetutës

80. Sipas nenit aktual 84.10, [Presidenti i Republikës së Kosovës]:

"udhëheq politikën e jashtme të vendit;"

81. Sipas amendamentit të propozuar, neni 84.10 thotë me sa vijon:

"bashkëpunon me Qeverinë në lidhje me politikën e jashtme të vendit;"

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 84.10 të Kushtetutës

82. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 84.10. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 84.10 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 84.20 të Kushtetutës

83. Sipas nenit aktual 84.20, [Presidenti i Republikës së Kosovës]:

> *"emëron Komandantin e Forcave të Sigurisë të Kosovës, pas rekomandimit të Kryeministrit;"*

84. Sipas amendamentit të propozuar, neni 84.20 thotë me sa vijon:

> *"emëron Komandantin e Forcave të Sigurisë të Kosovës, pas rekomandimit të Kryeministrit;"*

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 84.20 të Kushtetutës

85. Gjykata konsideron që kompetenca e rekomandimit në lidhje me emërimin e Komandantit të Forcave të Sigurisë të Kosovës është bartur prej Qeverisë tek Kryeministri. Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 84.20 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 84.21 të Kushtetutës

86. Sipas nenit aktual 84.21, [Presidenti i Republikës së Kosovës]:

> *"së bashku me Kryeministrin, emëron Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Intelegjencë;"*

87. Sipas amendamentit të propozuar, neni 84.21 thotë me sa vijon:

> *"emëron Drejtorin e Agjencisë së Kosovës për Intelegjencë;"*

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 84.21 të Kushtetutës

88. Gjykata vëren që Presidenti do ta emërojë Drejtorin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë pa Kryeministrin. Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 84.21 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 84.22 të Kushtetutës

89. Sipas nenit aktual 84.22, [Presidenti i Republikës së Kosovës]:

> *"vendos për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, në konsultim me Kryeministrin;"*

90. Sipas amendamentit të propozuar, neni 84.22 thotë me sa vijon:

> *"shpall Gjendjen e Jashtëzakonshme, pasi ta njoftojë Kryeministrin."*

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 84.22 të Kushtetutës

91. Gjykata vëren që Presidenti mund ta shpallë gjendjen e jashtëzakonshme pa u konsultuar me Kryeministrin. Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 84.22 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 84.23 të Kushtetutës

92. Sipas nenit aktual 84.23, [Presidenti i Republikës së Kosovës]:

> *"mund të kërkojë mbledhje të Këshillit të Sigurisë të Kosovës dhe i kryeson ato në kohën e Gjendjes së Jashtëzakonshme;"*

93. Sipas amendamentit të propozuar, neni 84.23 thotë me sa vijon:

"kryeson Këshillin e Sigurisë të Kosovës;"

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 84.23 të Kushtetutës

94. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 84.23. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 84.23 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 84.24 të Kushtetutës

95. Sipas nenit aktual 84.24, [Presidenti i Republikës së Kosovës]:

"vendos për formimin e misioneve diplomatike e konsullare të Republikës së Kosovës, në bazë të konsultimit me Kryeministrin;"

96. Sipas amendamentit të propozuar, neni 84.24 thotë me sa vijon:

"themelon misionet diplomatike e konsullore të Republikës së Kosovës, me propozim të Qeverisë;"

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 84.24 të Kushtetutës

97. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 84.24. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 84.24 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 84.26 të Kushtetutës

98. Sipas nenit aktual 84.26, [Presidenti i Republikës së Kosovës]:

> *"emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;"*

99. Sipas amendamentit të propozuar, neni 84.26 thotë me sa vijon:

> *"emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në pajtim me këtë Kushtetutë;"*

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 84.26 të Kushtetutës

100. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 84.26. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej

kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 84.26 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 84.30 të Kushtetutës

101. Sipas nenit aktual 84.30, [Presidenti i Republikës së Kosovës]:

"së paku një herë në vit i drejtohet Kuvendit të Kosovës përkitazi me fushëveprimtarinë e tij/saj;"

102. Sipas amendamentit të propozuar, neni 84.30 thotë me sa vijon:

"së paku një herë në vit i drejtohet Kuvendit të Kosovës përkitazi me gjendjen në Republikën e Kosovës;"

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 84.30 të Kushtetutës

103. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 84.30. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 84.30 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket nenit shtesë të propozuar 84.31 të Kushtetutës

104. Sipas amendamentit të propozuar, neni i ri 84.31 thotë me sa vijon:

"emëron Ombudspersonin, me propozim të Kuvendit;"

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 84.31 të Kushtetutës

105. Në përgjigjet e veta në këto kërkesa, Avokati i Popullit theksoi se Ombudspersoni duhet të emërohet nga Kuvendi për shkak të marrëdhënies së ngushtë ndërmjet Ombudspersonit dhe Kuvendit. Ai theksoi që ai institucion ka fuqi rekomanduese dhe Kuvendi mund t'u përgjigjet rekomandimeve të tij me iniciativa legjislative dhe/ose interpelanca për agjencitë ekzekutive që i shkelin të drejtat e njeriut.

106. Gjykata vëren që propozimi është që Avokati i Popullit, një post kushtetues, roli i të cilit përcaktohet në nenet 132 deri në 135 të Kushtetutës, të emërohet nga Presidenti me propozim të Kuvendit. Në Kushtetutë nuk janë të përcaktuara rrethanat në të cilat Presidenti mund ta refuzojë emërimin e Avokatit të Popullit të propozuar nga Kuvendi. Ndonëse kjo çështje nuk del drejtpërdrejt në kontekst të kërkesës në fjalë, ka të ngjarë që nëse Presidenti refuzon ta bëjë një emërim të tillë, ai është objekt i shqyrtimit përveç nëse Presidenti ofron baza të arsyeshme.

107. Duke pasur parasysh këtë që u tha më lart, Gjykata konsideron që neni i ri i propozuar 84.31 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket nenit shtesë të propozuar 84.32 të Kushtetutës

108. Sipas amendamentit të propozuar, neni i ri 84.32 thotë me sa vijon:

> *"kryen edhe detyra të tjera, të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj."*

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 84.32 të Kushtetutës

109. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 84, përveç që i jep kompetenca shtesë, siç parashihet me Kushtetutë dhe ligj. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e nenit të ri të propozuar 84.32. Prandaj, Gjykata konkludon që neni i ri i propozuar 84.32 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

II. Amendamenti 2 i propozuar: neni 85 [Kualifikimet për Zgjedhjen e Presidentit]

110. Amendamenti 2 propozon që neni 85 të fshihet dhe të zëvendësohet me një nen të ri 85.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 85 të Kushtetutës

111. Neni aktual 85 thotë me sa vijon:

"President i Republikës së Kosovës mund të zgjedhet çdo shtetas i Republikës së Kosovës, i cili e ka mbushur moshën tridhjetë e pesë (35) vjeçare".

112. Sipas amendamentit të propozuar, neni 85 thotë me sa vijon:

"1. President i Republikës së Kosovës mund të jetë secili shtetas i Republikës së Kosovës, i ciIi në momentin e kandidimit e ka mbushur moshën 35 (tridhjetë e pesë) vjeçare.

2. Për t'u kualifikuar si kandidat për President, secili shtetas i Republikës së Kosovës duhet të ketë qenë banor i përhershëm i Republikës së Kosovës gjatë pesë viteve të fundit para kandidimit për President.

3. Para dhënies së betimit si President i Republikës së Kosovës, kandidati i zgjedhur President duhet të japë dorëheqje nga çdo post publik.

4. Përveç kushteve të përcaktuara në këtë nen, kandidatët për President duhet të përmbushin edhe kushtet e tjera të përcaktuara me ligj."

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 85.1 të Kushtetutës

113. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 85 lidhur me kriterin e moshës

për të pasur të drejtë për t'u kandiduar për postin e Presidentit të Republikës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që neni i ri i propozuar 85.1 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 85.2 të Kushtetutës

114. Propozimi për ta kufizuar të drejtën e kandidatëve për President, të cilët gjatë pesë vjetëve të fundit para kandidimit për President kanë qenë banorë të përhershëm në Republikën e Kosovës, shkakton ca vështirësi. Në shikim të parë, mund të duket e arsyeshme të kufizohet mbajtësi i postit me këtë kriter të banimit për të siguruar që Presidenti është i lidhur ngushtë me popullin dhe shtetin para se të hyjë në postin më të lartë politik në vend.

115. Megjithatë, neni 45.1 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] i Kushtetutës përcakton që:

"Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor."

116. E drejta për të marrë pjesë në procesin zgjedhor është e drejtë e pandarë e njeriut në një shoqëri demokratike. Kjo Gjykatë e ka theksuar rëndësinë e kësaj të drejte, jo vetëm për të zgjedhur, pra të votojë në zgjedhje të rregullta të lira e të drejta, por edhe të drejtën për t'u zgjedhur (shih Aktvendimin për Papranueshmëri në Rastin Nr. KI 73/09, Mimoza Kusari-Lila kundër Komisionit Qendror të

Zgjedhjeve, të 23 marsit 2010). Gjykata e theksoi rëndësinë e zgjedhjeve në paragrafin 24 të atij Aktvendimi me sa vijon:

"[Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut] GJEDNJ ka shprehur vazhdimisht rëndësinë e zgjedhjeve të lira dhe të demokracisë në Aktgjykimet e saj. Në të njëjtin Aktgjykim, Gjykata shprehu mendimin e saj për si vijon: 'Demokracia paraqitet si modeli i vetëm politik i parashikuar nga Konventa dhe, për pasojë, i vetmi që pajtohet me të'. GJEDNJ, në të njëjtin Aktgjykim citoi me miratim Kodin e Praktikës së Mirë, i aprovuar nga Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) në seancat e 51 (Udhëzimet) dhe 52 (Raporti) me 5-6 korrik dhe 18-19 tetor 2002 (Opinioni nr. 190/2002, CDL-AD(2002) 23 rev). Komisioni i Venecias me këtë rast deklaroi:

Pesë parimet mbi të cilat mbështetet trashëgimia zgjedhore e *Evropës janë* se *zgjedhjet duhet të jenë: universale, të barabarta, të lira, të fshehta dhe përmes një votimi të drejtpërdrejt. Përveç kësaj, zgjedhjet duhet të mbahen ne intervale të rregullta."*

117. Përveç kësaj, Kushtetuta e Kosovës bazohet në parimin e barazisë së qytetarëve të vet në ushtrimin e të drejtave të tyre. Kjo shihet qartë nga neni 24 [Barazia para Ligjit], i cili parasheh që çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore pa diskriminim dhe se askush nuk mund të diskriminohet në asnjë bazë, duke përfshirë "statusin personal". Neni i propozuar ua ndalon personave që nuk kanë qenë banorë të shtetit të Kosovës të jenë kandidatë për postin e Presidentit të Republikës së Kosovës.

118. Neni 155 [Shtetësia] i Kushtetutës parashikon që të gjithë banorët e ligjshëm të Kosovës në datën e miratimit të kësaj Kushtetute, 15 qershor 2008, dhe të gjithë personat që kanë banuar në Kosovë më 1 janar 1998 dhe pasardhësit e tyre të drejtpërdrejtë gëzojnë të drejtën e shtetësisë së Kosovës pavarësisht nga vendbanimi i tyre i tanishëm apo shtetësia që kanë. Këto ishin kategori të gjera të personave që gëzonin dhe akoma gëzojnë të drejtën e shtetësisë.

119. Historia e kohëve të fundit e Kosovës tregon se ekziston një numër i madh i personave të tillë që ishin të pranishëm në Kosovë më 1 janar 1998. Një numër i madh i mërgatës u largua nga Kosova për arsye të ndryshme, njëra prej tyre ishte arsyeja ekonomike. Këta persona që kanë shtetësinë e Kosovës apo që kanë të drejtë ta marrin shtetësinë e Kosovës nuk mund të diskriminohen në bazë të statusit të tyre aktual personal si emigrantë për shkaqe ekonomike ose të tjera. Amendamenti i propozuar i vë këta persona në pozitë të pabarabartë përballë qytetarëve të tjerë që kanë jetuar këtu gjatë pesë vjetëve të fundit.

120. Amendamenti i propozuar paraqet kufizim të së drejtës së cilitdo qytetar të Republikës së Kosovës që nuk ka pasur banim të përhershëm në Kosovë për pesë vjet të plota para kandidimit për post. Prandaj, Gjykata konkludon që mund të ketë pakësim të së drejtës për t'u zgjedhur të atyre qytetarëve që nuk e përmbushin kriterin e banimit dhe për këtë arsye propozimi për ta ndryshuar Kushtetutën me shtimin e këtij neni të ri 85.2 pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 85.3 të Kushtetutës

121. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar është në përputhje me nenin ekzistues 88 të Kushtetutës që Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër publik

apo ndonjë funksion tjetër në parti politike. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që neni i ri i propozuar 85.3 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 85.4 të Kushtetutës

122. Neni i ri i propozuar thotë me sa vijon:

"4. Përveç kushteve të përcaktuara në këtë nen, kandidatët për President duhet të përmbushin edhe kushtet e tjera të përcaktuara me ligj."

123. Gjykata vëren që dispozita e cila kërkon që kandidatët për President t'i përmbushin kushtet e tjera të përcaktuara me Ligj nuk mund të veprojë si mekanizëm për t'i modifikuar kriteret për qasje në postin e Presidentit të Republikës apo për ushtrimin e postit të Presidentit të Republikës, përveç nëse kufizimet e tilla janë të parapara me Kushtetutë

124. Gjykata konsideron që kjo dispozitë nuk mund të përdoret për nxjerrjen e një ligji që do t'i ndryshonte kriteret për qasje në postin e Presidentit të Republikës apo për ushtrimin e postit të Presidentit të Republikës në një mënyrë që është në kundërshtim me Kushtetutën. Modifikimet e tilla mund të bëhen vetëm me amendament kushtetues. Prandaj, Gjykata përcakton që nëse propozohet një ndryshim kushtetues, Gjykata duhet të konfirmojë nëse modifikimi i tillë i propozuar pakëson apo nuk pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

III. Amendamenti 3 i propozuar: neni 86 [Zgjedhja e Presidentit]

125. Amendamenti 3 propozon që neni 86 të fshihet dhe të zëvendësohet me një nen të ri 86.

126. Neni aktual 86 thotë me sa vijon:

> *"1. Presidenti i Republikës së Kosovës zgjedhet nga Kuvendi, me votim të fshehtë.*
>
> *2. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës duhet të bëhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual.*
>
> *3. Secili shtetas i Republikës së Kosovës mund të nominohet si kandidatë për President të Republikës së Kosovës, nëse ajo/ai siguron nënshkrimet e të paktën tridhjetë (30) deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Deputetët e Kuvendit mund të nënshkruajnë vetëm për një kandidatë për President të Republikës së Kosovës.*
>
> *4. Zgjedhja e Presidentit bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.*
>
> *5. Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe kandidati që*

merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve, zgjedhet President i Republikës së Kosovës.

6. Nëse në votimin e tretë, asnjëri kandidat nuk zgjidhet President i Republikës së Kosovës, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda dyzet e pesë (45) ditësh."

127. Sipas amendamentit të propozuar, neni 86 thotë me sa vijon:

"1. Presidenti i Republikës së Kosovës zgjedhet drejtpërdrejt nga qytetarët me të drejtë vote.

2. Zgjedhjet Presidenciale shpallen nga Kryetari i Kuvendit, jo më vonë se gjashtë muaj para përfundimit të mandatit të rregullt të Presidentit të Republikës së Kosovës.

3. Secili shtetas i Republikës së Kosovës, që i plotëson kushtet e përcaktuara në këtë Kushtetutë, mund të kandidohet për President: (a) nga subjektet politike parlamentare, që, në pajtim me ligjin, kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit; (b) nga subjektet politike që mbajnë ulëse të garantuara në Kuvend dhe (c) përmes peticionit të dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me nënshkrimet e së paku 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) votuesve të kualifikuar në Republikën e Kosovës. Një subjekt politik parlamentar mund të kandidojë vetëm një kandidat. Procesi i kandidimit bëhet sipas afateve kohore dhe procedurave të përcaktuara me ligj.

4. Nëse kandidati për President merr shumicën absolute (më shumë se 50%) të votave të vlefshme në rrethin e parë, atëherë zgjedhet President i Republikës së Kosovës. Nëse asnjë kandidat nuk merr shumicën absolute të votave në rrethin e parë, mbahet rrethi i dytë i zgjedhjeve në mes të dy kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave në rrethin e parë. Rrethi i dytë i zgjedhjeve mbahet jo më vonë se 30 ditë nga rrethi i parë. Kandidati, i cili merr shumicën e votave në rrethin e dytë të zgjedhjeve, zgjedhet President i Republikës së Kosovës."

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 86.1 të Kushtetutës

128. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar i Kushtetutës i cili parasheh zgjedhjen e Presidentit të Republikës nga qytetarët me të drejtë vote është përmirësim i të drejtës së qytetarëve. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që neni i ri i propozuar 86.1 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 86.2 të Kushtetutës

129. Gjykata konsideron që dispozita për shpalljen e zgjedhjeve për President të ri të Republikës gjashtë muaj para përfundimit të mandatit të rregullt të Presidentit nuk ndikon në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të parashikuara me Kushtetutë. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që

neni i ri i propozuar 86.2 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 86.3 të Kushtetutës

130. Paragrafi i ri në nenin 86.3 propozon kriteret për nominimin e kandidatëve për postin e Presidentit të Republikës kur Presidenti zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët. Aktualisht, pasi vetëm deputetët e Kuvendit mund ta zgjedhin Presidentin, kriteri për nominim është që ai/ajo mund të paraqesë nënshkrimet e së paku 30 deputetëve. Pasi secili deputet mund ta nominojë vetëm një kandidat, kjo do të thotë që më së shumti katër kandidatë mund të konkurrojnë sipas sistemit të tanishëm. Teorikisht, nuk ka arsye pse nuk mund të ketë numër më të madh të kandidatëve kur sistemi ndryshon në zgjedhje të drejtpërdrejtë nga qytetarët.

131. Tani propozohet që subjektet politike parlamentare të cilat e kanë kaluar pragun zgjedhor, sipas ligjit, mund të propozojnë kandidatë për postin e Presidentit, dhe subjektet politike që mbajnë ulëse të garantuara në Kuvend dhe, së paku 15.000 votues me të drejtë vote, përmes peticionit të dorëzuar me nënshkrime të veta. Afatet kohore dhe procedurat e tjera duhet të përcaktohen me ligj.

132. Duket të ketë arsyetim për të drejtën e subjekteve politike që mbajnë ulëse të garantuara në Kuvend për të pasur të drejtë për të propozuar kandidatë, posaçërisht duke pasur parasysh vlerat e diversitetit shumetnik dhe vlerat e tjera të mbrojtura me Kushtetutë, siç përcaktohet në nenin 3 [Barazia para Ligjit].

133. Ngjashëm, propozimi me peticion publik i numrit të propozuar prej 15.000 votuesve me të drejtë vote e përmbush kriterin që është i pranishëm në shumë shtete demokratike. Megjithatë, ky propozim ua mohon të drejtat subjekteve

politike që nuk e kanë kaluar pragun zgjedhor për ta propozuar kandidatin e tyre për postin e Presidentit.

134. Prandaj, një partie politike që është e regjistruar në mënyrë legjitime dhe ka të drejtë të marrë pjesë në zgjedhje si çdo parti tjetër politike, i mohohet e drejta për ta paraqitur kandidatin e zgjedhjes së tyre.

135. Gjykata konsideron që kufizimi i tillë i diskriminon subjektet e ligjshme të cilat pritet të kenë të drejtë të marrin pjesë në jetën publike. Kjo ua mohon anëtarëve dhe mbështetësve të subjekteve të tilla politike të drejtën për ta paraqitur kandidatin e tyre të propozuar për postin e Presidentit. Një ndalesë e tillë nuk e përmbush kriterin e proporcionalitetit, që pritet të përmbushet, për përjashtimin e tyre nga ky aspekt i pjesëmarrjes në jetën politike të shtetit.

136. Në të vërtetë, neni 24 i Kushtetutës ndalon diskriminimin e personave në shumë baza. Njëra prej tyre është *"mendimeve politike ose të tjera"*. Personat që dëshirojnë ta shprehin mendimin e vet politik kanë të drejtë të plotë ta bëjnë atë si anëtar i një partie politike të themeluar ligjërisht. Partitë politike kanë status special të mbrojtur me ligj. Partitë mund të formohen sipas kritereve të përcaktuara me ligje dhe, kur të themelohen, duhet të trajtohen në mënyrë jodiskriminuese.

137. Gjykata konsideron që mund të ketë diskriminim të pajustifikuar ndaj partive politike nëse ato nuk kanë të drejtë të propozojnë kandidatë për postin e Presidentit.

138. Prandaj, Gjykata konkludon që neni i ri i propozuar 86.3, pasi nuk lejon propozimin nga të gjitha subjektet politike të regjistruara, pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

139. Gjykata vëren që propozimi për President të Republikës mund të sigurohet vetëm me përfshirjen e partive politike ose me peticion dhe mbështetje të 15.000 qytetarëve. Askush nuk mund të parashikojë sa kandidatë mund të propozohen me peticion të qytetarëve. Kjo u mundëson partive politike të

kenë rol të madh lidhur me atë se kush mund të propozohet për postin e Presidentit.

140. Gjykata më tej vëren që neni 88 [Papajtueshmëria] i Kushtetutës, sa i përket formës aktuale dhe asaj që propozohet në amendament i nenit 88, ndalon ushtrimin e çdo funksioni në parti politike. Baraspesha që duhet të arrihet nga cilido President i ardhshëm në detyrë që ushtron postin e Presidentit dhe kërkon mbështetjen e partive politike duhet të kihet parasysh nëse ai President në detyrë dëshiron të rizgjidhet. Vështirësia e gjetjes së rrugës e cila siguron që neni 88 nuk cenohet, në ndërkohë që ka edhe angazhim në procesin politik të Presidentit në detyrë, kërkon shqyrtim dhe trajtim të kujdesshëm.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 86.4 të Kushtetutës

141. Gjykata konsideron që dispozita për mbajtjen e rrethit të dytë të votimit nëse asnjë kandidat nuk merr shumicën absolute të votave në rrethin e parë nuk ndikon në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të parashikuara me Kushtetutë. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që neni i ri i propozuar 86.4 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

IV. Amendamenti 4 i propozuar: neni 87 [Mandati dhe Betimi]

142. Amendamenti 4 propozon që neni 87 të fshihet dhe të zëvendësohet me një nen të ri 87.

143. Neni aktual 87 thotë me sa vijon:

"1. Presidenti i Republikës së Kosovës fillon mandatin pasi të ketë dhënë betimin para Kuvendit të Kosovës. Teksti i betimit rregullohet me ligjin.

2. Mandati i Presidentit është pesë (5) vjet.

3. Pas përfundimit të mandatit të parë, Presidenti mund të rizgjedhet vetëm edhe një herë."

144. Sipas amendamentit të propozuar, neni 87 thotë me sa vijon:

"1. Mandati i Presidentit të Republikës së Kosovës është pesë (5) vjet dhe fillon pasi që kandidati i zgjedhur të ketë dhënë betimin.

2. Presidenti betohet para Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese në një vend publik të përcaktuar me ligj. Teksti i betimit është:

"Betohem se me tërë qenien time do të ruaj dhe mbroj pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës, garantimin e të drejtave dhe lirive për të gjithë qytetarët, respektimin dhe mbrojtjen e Kushtetutës dhe ligjeve, ruajtjen e paqes dhe mirëqenies së të gjithë qytetarëve, do të jem lojal vetëm ndaj Republikës së Kosovës, duke heqë dorë nga të gjitha obligimet ndaj ndonjë shteti tjetër që janë në

kundërshtim me përgjegjësitë e mija në Republikën e Kosovës, dhe të përfaqësoj me tërë fuqinë time unitetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës."

3. Presidenti mund të rizgjedhet vetëm për një mandat tjetër.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 87 të Kushtetutës

145. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 87, përveç që parashikon futjen e tekstit të betimit në Kushtetutë. Asgjë në tekstin e betimit nuk ngrit çështje që mund të konsiderohen se ndikojnë në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të parapara me Kapitullin II. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 87 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

V. Amendamenti 5 i propozuar: neni 88 [Papajtueshmëria]

146. Amendamenti 5 propozon që neni 88 të fshihet dhe të zëvendësohet me një nen të ri 88.

147. Neni aktual 88 thotë me sa vijon:

"1. Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër publik.

2. Pas zgjedhjes, Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në parti politike."

148. Sipas amendamentit të propozuar, neni 88 thotë me sa vijon:

"1. Presidenti nuk mund të mbajë as të ushtrojë ndonjë funksion tjetër publik.

2. Presidenti nuk mund të mbajë as të ushtrojë ndonjë funksion në një subjekt politik dhe as të jetë anëtar i ndonjë subjekti politik."

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 88 të Kushtetutës

149. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 88. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 88 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

VI. Amendamenti 6 i propozuar: neni 89 [Imuniteti]

150. Amendamenti 6 propozon që neni 89 të fshihet dhe të zëvendësohet me një nen të ri 89.

151. Neni aktual 89 thotë me sa vijon:

> *"Presidenti i Republikës së Kosovës gëzon imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet brenda fushëveprimit të përgjegjësive të Presidentit të Republikës së Kosovës."*

152. Sipas amendamentit të propozuar, neni 89 thotë me sa vijon:

> *"Presidenti i Republikës së Kosovës gëzon imunitet nga ndjekja penale dhe paditë civile për veprimet dhe vendimet që janë brenda kompetencave të tij."*

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 89 të Kushtetutës

153. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 89. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 89 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

VII. Amendamenti 7 i propozuar: neni 90 [Mungesa e Përkohshme e Presidentit]

154. Amendamenti 7 propozon që neni 90 të fshihet dhe të zëvendësohet me një nen të ri 90.

155. Neni aktual 90 thotë me sa vijon:

> *"1. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës përkohësisht nuk është i aftë për të përmbushur përgjegjësitë e tij/saj, ajo/ai mund t'ia kalojë vullnetarisht detyrat e postit të tij/saj, Kryetarit të Kuvendit, i cili do të jetë Ushtrues i Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës. Urdhri i Presidentit për kalimin e përgjegjësive duhet të përmbajë veçanërisht arsyet dhe kohëzgjatjen e kalimit të përgjegjësive, nëse ka njohuri për to. Presidenti i Republikës së Kosovës do të rifillojë ushtrimin e përgjegjësive kur të jetë në gjendje t'i ushtrojë përgjegjësitë, dhe kështu Kryetarit të Kuvendit i pushon posti i Ushtruesit të Detyrës së Presidentit.*
>
> *2. Në rast se nuk ka ndodhur kalimi vullnetar i përgjegjësive, Kuvendi i Republikës së Kosovës, pas konsultimit me konsiliumin mjekësor, me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve vendos nëse Presidenti i Republikës së Kosovës është përkohësisht i paaftë për të ushtruar përgjegjësitë e veta. Kryetari i Kuvendit të Kosovës do të shërbejë si Ushtrues i Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës derisa ajo/ai të bëhet i aftë që të rifillojë ushtrimin e përgjegjësive të Presidentit.*
>
> *3. Posti i Ushtruesit të Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, nuk mund të ushtrohet për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj."*

156. Sipas amendamentit të propozuar, neni 90 thotë me sa vijon:

"1. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës përkohësisht nuk është në gjendje të ushtrojë kompetencat e tij, ai mund t'ia kalojë vullnetarisht ushtrimin e kompetencave të tij Kryetarit të Kuvendit, i cili bëhet Ushtrues i Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës. Vendimi me shkrim i Presidentit për kalimin e përgjegjësive përmban në veçanti arsyet dhe kohëzgjatjen e kalimit të përgjegjësive, nëse kohëzgjatja në fjalë mund të parashikohet. Presidenti i Republikës së Kosovës rifillon ushtrimin e kompetencave të tij kur të jetë në gjendje për të bërë këtë dhe, me këtë rast, Kryetarit të Kuvendit i përfundon posti i Ushtruesit të Detyrës së Presidentit.

2. Nëse Presidenti, për arsye shëndetësore, nuk është në gjendje të ushtrojë kompetencat e tij dhe nuk ka ndodhur kalimi vullnetar i përgjegjësive, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, mund të fillojë procedurën për të vlerësuar nëse gjendja shëndetësore nuk ia lejon Presidentit ushtrimin e kompetencave të tij. Kuvendi kërkon nga institucioni kompetent shëndetësor të themelojë Konsiliumin e Mjekëve, për të vlerësuar gjendjen shëndetësore të Presidentit, dhe për të dorëzuar raportin në Kuvend. Nëse në raportin e Konsiliumit konstatohet se Presidenti nuk është i aftë për të ushtruar kompetencat e tij, Kuvendi, me 2/3 (dy të tretat) e votave të të gjithë deputetëve, mund të vendosë për zëvendësimin e përkohshëm të Presidentit. Me këtë rast, Kryetari i Kuvendit të Kosovës ushtron detyrën e Presidentit. Presidenti i Republikës së Kosovës ne çdo kohë mund të kërkojë vlerësimin të ri të gjendjes shëndetësore dhe të kthehet në detyrë, nëse Konsiliumi i Mjekëve konstaton se Presidenti është i aftë që të rifillojë ushtrimin e kompetencave të tij.

3. Nëse për çfarëdo arsye tjetër, përveç asaj shëndetësore, Presidenti i Republikës së Kosovës nuk është në gjendje për të ushtruar kompetencat e tij dhe nuk ka ndodhur kalimi vullnetar i përgjegjësive, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, mund të fillojë procedurën për zëvendësimin e përkohshëm të Presidentit. Nëse Kuvendi vendos me 2/3 (dy të tretat) e votave të të gjithë deputetëve se Presidenti përkohësisht nuk është në gjendje të ushtrojë kompetencat e tij, Kryetari i Kuvendit do të ushtrojë detyrën e Presidentit, derisa Presidenti i Republikës së Kosovës të jetë i aftë të rifillojë ushtrimin e kompetencave.

4. Përveç nëse nuk përcaktohet ndryshe me këtë Kushtetutë, posti i Ushtruesit të Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës nuk mund të ushtrohet për një periudhë më të gjatë se 6 (gjashtë) muaj.

5. Ushtruesi i Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës ushtron të gjitha kompetencat e Presidentit me përjashtim të:

(1) propozimin e amendamenteve kushtetuese;

(2) shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, pa miratimin e Kryeministrit;

(3) emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve të Republikës së Kosovës, të kryeprokurorit dhe të prokurorëve të Republikës së Kosovës;

(4) emërimin dhe shkarkimin e shefave të misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës;

(5) dhënien e medaljeve, mirënjohjeve dhe të çmimeve, në pajtim me ligjin; dhe

(6) shpalljen e faljeve individuale.

6. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës nuk është në gjendje për të ushtruar kompetencat e tij për 6 (gjashtë) muaj, Ushtruesi i Detyrës së Presidentit menjëherë shpall vakant postin e Presidentit dhe shpall zgjedhjet e parakohshme për President, të cilat mbahen jo më vonë se 3 (tre) muaj pas mbetjes së postit të Presidentit vakant. Ushtruesi i Detyrës së Presidentit vazhdon ta ushtrojë kompetencat e Presidentit, derisa Presidenti i ri të zgjedhet dhe të bëjë betimin.

7. Nëse Konsiliumi i Mjekëve konstaton se Presidenti i Republikës së Kosovës nuk do të jetë në gjendje të ushtrojë kompetencat e tij për një periudhë më të gjatë se 6 (gjashtë) muaj, Kuvendi, me votën e 2/3 e të gjithë deputeteve, e shpall vakant postin e Presidentit. Ushtruesi i Detyrës së Presidentit menjëherë shpall zgjedhjet e parakohshme për President, të cilat mbahen jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita kur Kuvendi ka shpallur vakant postin e Presidentit. Ushtruesi i Detyrës së Presidentit vazhdon të ushtrojë kompetencat e Presidentit, derisa Presidenti i ri të zgjedhet dhe të bëjë betimin."

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 90.1, nenit 90.3 dhe nenit 90.4 të Kushtetutës

157. Gjykata konsideron që ndryshimet e parapara nga këto amendamente nuk ngrenë çështje që mund të konsiderohen se ndikojnë në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që neni i ri i propozuar 90.1, neni 90.3 dhe neni 90.4 nuk pakësojnë ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 90.5 të Kushtetutës

158. Neni ri i propozuar 90.5 kufizon mundësinë e Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për t'i ushtruar të gjitha kompetencat dhe funksionet e Presidentit. Kjo Gjykatë, në rastin Nr. KO 97/10, (*Në çështjen e kërkesës së parashtruar nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës Dr. Jakup Krasniqi, lidhur me mbajtjen e postit të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit dhe njëkohësisht të postit të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike të Kosovës*) të 22 dhjetorit 2010, vërejti me sa vijon,

> *"Ushtruesi i Detyrës së Presidentit nuk është President i zgjedhur dhe herë pas here mund të ngrihen pyetje lidhur me kompetencat e Ushtruesit të Detyrës së Presidentit. Asnjë çështje e tillë nuk është ngritur në këtë kërkesë. Çështjet e tilla janë çështje kushtetuese dhe Gjykata do t'i shqyrtojë këto çështje kur të ballafaqohet me kërkesën e duhur, duke marrë parasysh parimin e ndarjes së pushteteve, siç përcaktohet në Nenin 4.1 të Kushtetutës..."*

159. Tani ekziston një pyetje para Gjykatës lidhur me atë nëse kufizimi për t'i ushtruar disa kompetenca të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit sipas nenit 84 të Kushtetutës mund t'i

pakësojë të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës.

160. Neni i ri 90.5 në veçanti thekson që disa kompetenca të rëndësishme, siç janë përcaktuar në nenin 84, duhet të rrinë pezull derisa Presidenti nuk është në detyrë. Disa prej këtyre kufizimeve kanë të bëjnë me çështje të rëndësisë së madhe për sigurinë e shtetit në kohë të jashtëzakonshme. Të tjerat kanë të bëjnë me udhëheqjen e duhur dhe të rregullt të shtetit kur ekziston nevoja për emërimin e gjyqtarëve apo të prokurorëve.

161. Sa i përket kufizimit të mundësisë për të shpallur gjendje të jashtëzakonshme sipas nenit të propozuar 90.5 (2), qëndrimi aktual sipas nenit 84 është që Presidenti vendos të shpallë gjendje të jashtëzakonshme në konsultim me Kryeministrin dhe propozimi i ri është që kjo të ndryshohet në shpall gjendje të jashtëzakonshme pasi ta njoftojë Kryeministrin. Situata është e tillë sa që gjendja e jashtëzakonshme mund të shpallet vetëm me përfshirjen e Presidentit. Nuk ka mundësi që Kryeministri ta shpallë gjendjen e jashtëzakonshme me iniciativë të tij. Nëse paraqiten rrethana të cilat kërkojnë që shteti të sigurohet dhe Ushtruesi i Detyrës së Presidentit i ka duart e lidhura, atëherë mund të paraqitet krizë kushtetuese. Të drejtat dhe liritë e njeriut të të gjithë qytetarëve në shtet mund të jenë në rrezik në një situatë të tillë. Prandaj, Gjykata konsideron që kufizimi i mundësisë së Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për të shpallur gjendje të jashtëzakonshme pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 90.5 (3) të Kushtetutës

162. Një çështje tjetër ka të bëjë me kufizimin e mundësisë së Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së

Kosovës. Tani, Presidenti i emëron dhe shkarkon gjyqtarët në përputhje me nenin 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve] dhe nenin 84 (16), emëron dhe shkarkon Kryeprokurorin e Shtetit sipas nenit 84 (17), dhe emëron e shkarkon prokurorët e tjerë sipas nenit 84 (18) të Kushtetutës. Këto emërime dhe shkarkime bëhen me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Ka pak mundësi që Presidenti, sipas kritereve aktuale të Kushtetutës, të ndalojë ose refuzojë të bëjë emërimet apo shkarkimet pasi të bëhen propozimet. Megjithatë, administrimi i mirëfilltë i drejtësisë dhe besimi në administrimin e drejtësisë janë aspekte themelore të zbatimit të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë, në veçanti të atyre të drejtave dhe lirive të përfshira në Kapitullin II të Kushtetutës.

163. Përveç kësaj, drejtësia nuk mund të administrohet nëse gjyqtarët dhe prokurorët nuk janë në detyrë. Pengesa për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve mund të konsiderohet pengesë për administrimin e drejtësisë dhe pakësim i të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Kapitullin II. Avokati i Popullit shprehu po të njëjtën pikëpamje në përgjigjen e tij drejtuar Gjykatës, siç u cek më lart.

164. Me të vërtetë, kufizimi i kompetencave të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për të emëruar gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese, të cilëve potencialisht u ndalohet të emërohen sipas këtij amendamenti të propozuar, mund të shkaktojë që Gjykata, nganjëherë, të mos ketë kuorum por ta kryer punën e vet.

165. Kjo mundësi e bllokimit të një organi të rëndësishëm të shtetit ndikon shumë në zbatimin e të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë, pasi kjo do të mund të shkaktonte paralizim kushtetues që do ta pengonte Gjykatën për ta kryer punën e vet për shkak të mungesës së kompetencës së Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për emërimin e gjyqtarëve.

166. Duke pasur parasysh që Kuvendi i Republikës së Kosovës i zgjedh gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, kjo është arsye më tepër që Ushtruesi i Detyrës së Presidentit të ketë kompetenca të tilla që janë të nevojshme për emërimin e gjyqtarëve jo vetëm në Gjykatën Kushtetuese, por edhe për emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve siç është propozuar ligjërisht nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës të themeluar për atë qëllim.

167. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 90.5 (3) pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 90.5 (5) të Kushtetutës

168. Neni i ri i propozuar 90.5 (5) gjithashtu ia ndalon Ushtruesit të Detyrës së Presidentit shpalljen e faljeve individuale. Kompetenca fillestare sipas nenit 84 (29) është për Presidentin i cili *"shpall falje individuale, në pajtim me ligjin"*. Tani propozohet që kur një person meriton të falet, në pajtim me ligjin, falja e tillë mund të mos lejohet.

169. Për shembull, falja e tillë mund të mos lejohet në një rast ekstrem të një personi që është duke vuajtur dënimin dhe i cili mund të meritojë të lirohet në pajtim me kompetencën për të shpallur falje individuale, pasi këtij personi do t'i kufizohet liria e tij/saj derisa Presidenti i ri ta fillojë mandatin. Në një rast të tillë, nuk mund të ketë mjete të tjera juridike në dispozicion për ta siguruar lirinë e tij/saj.

170. Gjykata konsideron që një rast i tillë ka mundësi të madhe të ndikojë në një të drejtë dhe liri themelore, pra në të drejtën e lirisë, siç përcaktohet, ndër të tjera në nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës dhe nenin 5 të Konventës

Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

171. Prandaj, Gjykata konkludon që neni i ri i propozuar 90.5 (5) pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 90.5 (1), nenit 90.5 (4) dhe nenit 90.5 (6) të Kushtetutës

172. Neni i ri i propozuar 90.5 (1), neni 90.5 (4) dhe neni 90.5 (6) kanë të bëjnë me kufizimin e kompetencave të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për të propozuar amendamente kushtetuese, për të emëruar dhe shkarkuar shefa të misioneve diplomatike, dhe për të dhënë medalje, mirënjohje dhe çmime. Këto janë çështje që mund të shqyrtohen brenda kursit të rëndomtë të punës pa ndikuar në të drejtat dhe liritë ekzistuese të garantuara me Kushtetutë. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i ri i propozuar i nenit 90.5 (1), nenit 90.5 (4) dhe nenit 90.5 (6) nuk i pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

VIII. Amendamenti 8 i propozuar: neni 91 [Shkarkimi i Presidentit]

173. Amendamenti 8 propozon që neni 91 të fshihet dhe të zëvendësohet me një nen të ri 91.

174. Neni aktual 91 thotë me sa vijon:

"1. Presidenti i Republikës së Kosovës mund të shkarkohet nga Kuvendi nëse ai/ajo është dënuar për kryerjen e krimit të rëndë ose nëse ajo/ai nuk është i/e aftë për të

ushtruar përgjegjësitë e këtij posti për shkak të sëmundjes së rëndë ose nëse Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se ajo/ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës.

2. Procedura për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Kosovës mund të iniciohet nga një e treta (1/3) e deputetëve të Kuvendit, të cilët nënshkruajnë një peticion, i cili shpjegon arsyet për shkarkim. Në rast se peticioni supozon sëmundjen e rëndë, Kuvendi do të kërkojë mendimin e konsiliumit mjekësor për gjendjen shëndetësore të Presidentit. Në rast se peticioni supozon ndonjë shkelje të rëndë të Kushtetutës, peticioni duhet t'i dorëzohet menjëherë Gjykatës Kushtetuese, e cila vendosë për këtë çështje brenda shtatë (7) ditësh nga marrja e peticionit.

3. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës është dënuar për ndonjë krim të rëndë ose kur nëse Kuvendi, në pajtim me këtë nen, konstaton që Presidenti nuk është i aftë të ushtrojë përgjegjësitë e tij/saj për shkak të sëmundjes së rëndë ose nëse Gjykata Kushtetuese konstaton se ajo/ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës, Kuvendi mund të shkarkojë Presidentin me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij."

175. Sipas amendamentit të propozuar, neni 91 thotë me sa vijon:

"1. Presidenti i Republikës së Kosovës jep dorëheqje përmes dorëzimit të letër dorëheqjes te Kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Dorëheqja është e vlefshme në momentin e pranimit të letër dorëheqjes nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese dhe është e parevokueshme.

2. Presidenti i Republikës së Kosovës mund të shkarkohet nga detyra, nëse ai dënohet për kryerjen e krimit të rëndë gjatë ushtrimit të detyrës, ose nëse Gjykata Kushtetuese konstaton se ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës, ose nëse kryen akt të tradhtisë ndaj shtetit.

3. Procedura për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Kosovës, për rastet e specifikuara në paragrafin 2 të këtij neni, mund të fillohet nga 1/3 (një e treta) e deputetëve të Kuvendit ose nga 30.000 (tridhjetë mijë) qytetarë me të drejtë vote. Para se të dorëzohet në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtim, peticioni duhet të miratohet me 2/3 (dy të tretat) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

4. Nëse Gjykata Kushtetuese, me votat e së paku 7 (shtatë) gjyqtarëve, merr vendim se Presidenti i Republikës së Kosovës është përgjegjës për cilëndo nga arsyet e specifikuara në paragrafin 2 të këtij neni, Presidenti konsiderohet i shkarkuar nga detyra.

5. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës jep dorëheqje, shkarkohet në përputhje me dispozitat e këtij neni ose vdes, Kryetari i Kuvendit të Kosovës shërben si Ushtrues i Detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, në përputhje me kufizimet e përcaktuara në nenin 90, derisa të zgjedhet dhe të bëjë betimin Presidenti i ri. Kryetari i Kuvendit menjëherë shpall zgjedhjet e parakohshme për President të Republikës së Kosovës, të cilat mbahen jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita kur posti i Presidentit ka mbetur vakant.

6. Nëse Kryetari i Kuvendit, për ndonjë nga arsyet e përcaktuara në nenin 90 dhe 91, nuk është në gjendje të shërbejë si Ushtrues i Detyrës së Presidentit, kjo detyrë kalon te Nënkryetari i Kuvendit. Çështjet e tjera rreth bartjes së përgjegjësisë së ushtrimit të detyrës së Presidentit rregullohen me ligj."

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 91 të Kushtetutës

176. Gjykata konsideron që ndonëse ka disa ndryshime të praktikës të parapara nga amendamenti i propozuar, ai nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 91 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

IX. Amendamenti 9 i propozuar: nenet 18, 45, 65, 80, 82, 93, 94, 104, 109, 113, 114, 127, 131, 134 dhe 139

177. Amendamenti 9 propozon të ndryshohen nenet 18, 45, 65, 80, 82, 93, 94, 104, 109, 113, 114, 127, 131, 134 dhe 139 të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 18 të Kushtetutës

178. Neni aktual 18 thotë me sa vijon:

"1. Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje:

(1) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;

(2) të drejtat dhe liritë themelore;

(3) anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare;

(4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës.

2. Marrëveshjet ndërkombëtare me përjashtim të atyre në pikën 1, ratifikohen pas nënshkrimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

3. Presidenti i Republikës së Kosovës ose Kryeministri njoftojnë Kuvendin sa herë që të nënshkruhet një marrëveshje ndërkombëtare.

4. Amendamentimi ose tërheqja nga marrëveshjet ndërkombëtare do të kenë të njëjtën procedurë të vendim marrjes sikur ajo e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare.

5. Parimet dhe procedurat për ratifikimin dhe kontestimin e marrëveshjeve ndërkombëtare rregullohen me ligj."

179. Sipas amendamentit të propozuar, neni 18 thotë me sa vijon:

"1. Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje:

(1) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;

(2) të drejtat dhe liritë themelore;

(3) anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare;

(4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës, në pajtim me ligjin.

2. Marrëveshjet ndërkombëtare me përjashtim të atyre në pikën 1, konsiderohen të ratifikuara pas nënshkrimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me rekomandim të Qeverisë.

3. Presidenti i Republikës së Kosovës ose Qeveria njoftojnë Kuvendin sa herë që të nënshkruhet një marrëveshje ndërkombëtare.

4. Amendamentimi ose tërheqja nga marrëveshjet ndërkombëtare do të kenë të njëjtën procedurë të vendimmarrjes, sikur ajo e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare.

5. Parimet dhe procedurat për ratifikimin dhe kontestimin e marrëveshjeve ndërkombëtare rregullohen me ligj."

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 18 të Kushtetutës

180. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 18. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 18 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 45.1 të Kushtetutës

181. Neni aktual 45.1 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] thotë me sa vijon:

"1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor."

182. Sipas amendamentit të propozuar, neni 45.1 thotë me sa vijon:

> *"1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe në ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor ose me dispozitat e kësaj Kushtetute."*

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 45.1 të Kushtetutës

183. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar nuk e ndryshon substancën e nenit 45.1. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 45.1 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 65.7 të Kushtetutës

184. Neni aktual 65.7 thotë me sa vijon:

> *"Kuvendi i Republikës së Kosovës: ...*
>
> *(7) zgjedh dhe mund të shkarkojë Presidentin e Republikës së Kosovës në pajtim me këtë Kushtetutë; ..."*

185. Sipas amendamentit të propozuar, neni 65.7 thotë me sa vijon:

> *"(7) dorëzon në Gjykatën Kushtetuese peticionin për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 91 të Kushtetutës;"*

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 65.7 të Kushtetutës

186. Gjykata konsideron që ndonëse ka disa ndryshime të praktikës të parapara nga ky amendament i propozuar, në lidhje me amendamentin e propozuar të nenit 91 të Kushtetutës, ai nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 65.7 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 80 të Kushtetutës

187. Neni aktual 80 thotë me sa vijon:

> *"1. Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë.*

2. Ligji i miratuar nga Kuvendi nënshkruhet nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe shpallet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pasi ta ketë nënshkruar brenda tetë (8) ditësh pasi të ketë marrë ligjin.

3. Nëse Presidenti i Republikës e kthen ligjin në Kuvend, ai/ajo duhet të theksojë arsyet e kthimit të ligjit. Presidenti i Republikës së Kosovës të drejtën e kthimit të një ligji në Kuvend, mund ta ushtrojë vetëm një herë.

4. Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, vendos për miratimin e ligjit të rikthyer nga Presidenti i Republikës, dhe ligji përkatës konsiderohet i shpallur.

5. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda tetë (8) ditësh pas marrjes së ligjit, nuk merr asnjë vendim për shpalljen ose kthimin e tij, ligji konsiderohet i shpallur, pa nënshkrimin e saj/tij dhe publikohet në Gazetën Zyrtare.

6. Ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, përveç nëse, me vetë ligj nuk përcaktohet ndryshe."

188. Sipas amendamentit të propozuar, neni 80 do ta ketë një paragraf të ri të vendosur, i cili thotë me sa vijon:

"Kuvendi mund të mbivotojë (refuzojë) veton e Presidentit ndaj një ligji të miratuar me shumicën e votave të të gjithë

deputetëve plus dhjetë për qind vota të tjera shtesë dhe ai ligj konsiderohet i shpallur. Nëse Presidenti i Republikës ushtron të drejtën e vetos ndaj Ligjit për Buxhet, Kuvendi mund të votojë që të refuzojë (mbivotojë) veton me shumicën absolute të votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe Ligji konsiderohet i shpallur. Nëse Kuvendi pranon ndryshimet e propozuara nga Presidenti në ligjin ku ai/ajo ka përdorë veton, Kuvendi vendos për miratimin e atij ligji me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm e që votojnë dhe ligji përkatës konsiderohet i shpallur."

189. Ndonëse nuk është cekur ashtu në amendamentet e propozuara që janë dorëzuar në Gjykatë, supozohet që ky amendament është zëvendësim i nenit 80.4.

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 80.4 të Kushtetutës

190. Gjykata konsideron që ndonëse ka disa ndryshime të praktikës të parapara nga ky amendament i propozuar, ai nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 80.4 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 82 të Kushtetutës

191. Neni aktual 82 thotë me sa vijon:

"1. Kuvendi shpërndahet në këto raste:

(1) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e caktimit të mandatarit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nuk mund të formohet Qeveria;

(2) nëse për shpërndarjen e Kuvendit votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve, shpërndarja bëhet me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës;

(3) nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes, nuk zgjedhet Presidenti i Republikës së Kosovës.

2. Kuvendi mund të shpërndahet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas votimit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë.

192. Sipas amendamentit të propozuar, neni 82 do të ndryshohet me shfuqizimin e nenit 82.1 (3) në tërësi.

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 82 të Kushtetutës

193. Gjykata konsideron që ndonëse ka disa ndryshime të praktikës në lidhje me shpërbërjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve të parapara nga ky amendament i propozuar, ai nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 82 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 93 (10) dhe shtimin e nenit 93 (12) dhe nenit 93 (13) të Kushtetutës

194. Neni aktual 93 (10) thotë me sa vijon:

"Qeveria ka këto kompetenca: ...

(4) (10) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;..."

195. Sipas amendamentit të propozuar, neni 93 (10) thotë me sa vijon:

(5) "...(10) ngritë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese në pajtim me Kushtetutën;..."

196. Sipas amendamentit të propozuar, neni i ri 93 (12) dhe neni i ri 93 (13) thonë me sa vijon:

"(12) i propozon Presidentit themelimin e misioneve diplomatike e konsullore të Republikës së Kosovës;

(13) udhëheq politikën e jashtme të vendit."

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 93 të Kushtetutës

197. Gjykata konsideron që edhe pse në esencë nuk ka asnjë ndryshim në raport me amendamentin e propozuar të nenit 93 (10), megjithatë, theksi vihet në themelimin e misioneve diplomatike dhe konsullore dhe në sqarimin e asaj se kush e udhëheq politikën e jashtme të shtetit. Amendamenti i propozuar nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 93 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 94 (5) dhe nenit 94 (9) të Kushtetutës

198. Neni aktual 94 (5) dhe neni 94 (9) thonë me sa vijon:

"Kryeministri ka këto kompetenca: ...

... (5) kryeson Këshillin e Sigurisë të Kosovës;...

... (9) këshillohet me Presidentin për zbatimin e politikës së jashtme të vendit;...”

199. Sipas amendamentit të propozuar, neni 94 (5) thotë me sa vijon:

“... (5) është anëtar i Këshillit të Sigurisë të Kosovës;...”

200. Sipas amendamentit të propozuar, neni 94 (9) fshihet.

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 94 të Kushtetutës

201. Gjykata konsideron që ndonëse ka ndryshim në atë se kush do ta kryesojë Këshillin e Sigurisë të Kosovës dhe që Kryeministri më nuk do të konsultohet me Presidentin për zbatimin e politikës së jashtme të shtetit, këto nuk e ndryshojnë Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 94 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 104.1 të Kushtetutës

202. Neni aktual 104.1 thotë me sa vijon:

"1. Gjyqtarët i emëron, riemëron dhe shkarkon Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës."

203. Sipas amendamentit të propozuar, neni 104.1 thotë me sa vijon:

"Gjyqtarët i emëron, riemëron dhe shkarkon Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Presidenti mund të rikthejë kandidatin e propozuar për rishqyrtim në Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Këtë të drejtë mund ta ushtrojë vetëm një herë për një kandidat. Këshilli Gjyqësor i Kosovës mund të propozojë kandidatin e njëjtë nëse siguron mbështetjen e 2/3 (dy të tretat) të anëtarëve të Këshillit."

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 104.1 të Kushtetutës

204. Me rastin e shqyrtimit të nenit 90.5 (3) më sipër, Gjykata shqyrtoi si kufizimi i kompetencës së Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për të emëruar gjyqtarë pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II. I njëjti arsyetim vlen edhe për veton vezulluese të propozuar për Presidentin për t'i kthyer prapa emrat e gjyqtarëve të propozuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për t'u emëruar. Ai Këshill është zyrë e pavarur e themeluar në bazë të Kushtetutës dhe sipas nenit 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] është organ përgjegjës që siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor.

205. Ai është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të veta. Ka rrezik që administrimi i sigurt dhe i vazhdueshëm i drejtësisë, i garantuar me Kushtetutë, do të pengohet nëse me kohë nuk emërohet numër i mjaftueshëm i gjyqtarëve, siç parashihet me mekanizmat tashmë të themeluar me Kushtetutë. Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar; drejtësia administrohet në gjykata dhe nëse ka vonesë në emërimin e gjyqtarëve, siç parashihet me amendamentin e propozuar, atëherë vonesa në qasje në drejtësi pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II.

206. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, në veçanti ato në Kapitullin II, zbatohen nga gjykatat e themeluara me Kushtetutë dhe ligje. Neni 102.1 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] në mënyrë të qartë thekson se pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat. Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] përcakton që *"Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj"*. Këtu, Kushtetuta thekson të drejtën e qytetarëve për mjete juridike me qëllim të mbrojtjes juridike të të drejtave të tyre. Nuk mund të ketë qasje në mjete juridike pa emërimin me kohë të gjyqtarëve.

207. Gjithashtu, neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] përcakton që *"Çdokush gëzon të drejtën e* mbrojtjes *gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur"*. Kjo është një dispozitë themelore e cila siguron që personat kanë të drejtë në qasje në gjyqtarë për zgjidhjen e rasteve të tyre.

208. Ekziston rreziku i shkeljes së këtij neni të Kushtetutës me mosemërimin me kohë të gjyqtarëve. Të dy nenet, 32 dhe 54, përsërisin parimin e ndarjes së pushteteve deri në masën që ata përsërisin se ushtrimi i kompetencave gjyqësore dhe

qasja në mjete juridike janë gurë themele të njërës prej atyre shtyllave, pra i degës së gjyqësorit të shtetit.

209. Prandaj, çdo shkelje e mundshme e qasjes në gjykata dhe, rrjedhimisht, në gjyqtarë që marrin vendime në gjykata, pakëson të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 109.7 të Kushtetutës

210. Neni aktual 109.7 thotë me sa vijon:

"7. Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Mandati i Kryeprokurorit të Shtetit është shtatëvjeçarë, pa mundësi riemërimi."

211. Sipas amendamentit të propozuar, neni 109.7 thotë me sa vijon:

"7. Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Presidenti mund të rikthejë kandidatin e propozuar për rishqyrtim në Këshillin Prokurorial të Kosovës. Këtë të drejtë mund ta ushtrojë vetëm një herë për një kandidat. Këshilli Prokurorial i Kosovës mund të propozojë kandidatin e njëjtë nëse siguron mbështetjen e 2/3 (dy të tretave) të anëtarëve të Këshillit. Mandati i Kryeprokurorit të Shtetit është shtatë (7) vjet, pa mundësi riemërimi."

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 109.7 të Kushtetutës

212. Gjykata konsideron që ndonëse Presidentit do t'i jepet veto pezulluese në lidhje me emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit, kjo nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Posti i Prokurorit të Shtetit, i themeluar me nenin 109 [Prokurori i Shtetit] është një prej posteve të themeluara me Kushtetutë që mund të ushtrohet edhe nga zëvendësit deri në emërimin e Prokurorit të ri të Shtetit. Prandaj, natyra e postit të Prokurorit të Shtetit dallon nga ajo e gjyqtarëve të cilët duhet të ulen për të dëgjuar dhe gjykuar rastet që presin të zgjidhen në gjykatë. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 109 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 113.3 (5) të Kushtetutës

213. Neni aktual 113.3 (5) thotë me sa vijon:

"Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë çështjet në vijim:

"(5) nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit."

214. Sipas amendamentit të propozuar, neni 113.3 (5) thotë me sa vijon:

> *"(5) nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Presidentit dhe Kuvendit."*

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 113.3 (5) të Kushtetutës

215. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar i jep Gjykatës Kushtetuese kompetencë në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me zgjedhjen e Presidentit sipas sistemit të propozuar për zgjedhjen e tij/saj drejtpërdrejt nga populli, por kjo nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 113.3 (5) nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 113.3 (6) të Kushtetutës

216. Neni aktual 113.3 (6) thotë me sa vijon:

> *"6. Tridhjetë (30) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, janë të autorizuar të ngrenë çështjen nëse Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës."*

217. Sipas amendamentit të propozuar, neni 113.3 (6) thotë me sa vijon:

> *"6. Kuvendi i Kosovës është i autorizuar të dorëzojë peticionin, me të cilin kërkohet shkarkimi i Presidentit të Republikës së Kosovës në përputhje me nenin 91 të Kushtetutës."*

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 113.3 (6) të Kushtetutës

218. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar e ndryshon rolin e Gjykatës Kushtetuese kur ka të bëjë me shkarkimin e Presidentit, por kjo nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 113.3 (6) nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 114.2 të Kushtetutës

219. Neni aktual 114.2 thotë me sa vijon:

> *"2. Gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit, për një mandat nëntëvjeçar, pa mundësi vazhdimi."*

220. Sipas amendamentit të propozuar, neni 114.2 thotë me sa vijon:

> *"2. Gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit, për një mandat nëntëvjeçar pa mundësi vazhdimi. Presidenti mund të kthejë kandidatin e propozuar nga Kuvendi. Këtë të drejtë mund ta ushtrojë vetëm një herë për një kandidat. Kuvendi mund të propozojë kandidatin e njëjtë, vetëm nëse siguron mbështetjen e 2/3 (dy të tretave) të votave të të gjithë deputetëve."*

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 114.2 të Kushtetutës

221. Më herët, në një pjesë të këtij Aktgjykimi, Gjykata e shqyrtoi çështjen e mungesës së kompetencës së Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për të emëruar gjyqtarë dhe gjithashtu e shqyrtoi veton pezulluese të propozuar të Presidentit për t'ia kthyer prapa Këshillit Gjyqësor të Kosovës emërimet e gjyqtarëve.

222. I njëjti arsyetim në lidhje me rrezikun për administrimin e drejtësisë për shkak të mosemërimit me kohë të gjyqtarëve të gjykatave të rregullta vlen edhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Të gjitha arsyetimet që u përdorën për të ardhur në konkluzione zbatohen *mutatis mutandis* edhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

223. Përveç kësaj, sipas nenit 112 [Parimet e Përgjithshme], Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Kushtetuta përcakton që ajo duhet të jetë plotësisht e pavarur në ushtrimin e përgjegjësive të veta.

224. Tani, Kuvendi është organi përgjegjës për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Përveç dy gjyqtarëve, vendet e të cilëve janë të rezervuara apo të garantuara pasi i përfaqësojnë bashkësitë joshumicë në Kosovë, shumica e dy të tretave të deputetëve duhet të votojnë për emërimin e tyre.

225. Qëndrimi në lidhje me emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese është qëndrim që mund të shkaktojë vonesa të paarsyeshme nga Presidenti nëse ai/ajo e kthen prapa gjyqtarin e propozuar të Gjykatës Kushtetuese.

226. Kuorumin e Gjykatës, siç është përcaktuar me nenin 17 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, e përbëjnë shtatë gjyqtarë. Rreziku që Gjykata të mos jetë në gjendje ta zhvillojë punën e vet dhe t'i zgjidhë kërkesat për shkak të mungesës së kuorumit, qoftë edhe për një kohë të shkurtër, ndërhyn në të drejtat e parashtruesve në zgjidhjen e ankesave të tyre kushtetuese.

227. Ky është pakësim i të drejtave dhe lirive të garantuara me Kapitullin II. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 114.2 pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 127.2 të Kushtetutës

228. Neni aktual 127.2 thotë me sa vijon:

> *"2. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës kryesohet nga Kryeministri me mbështetje nga Qeveria, përveç gjatë periudhës së Gjendjes së Jashtëzakonshme, sikurse është parashikuar me këtë Kushtetutë."*

229. Sipas amendamentit të propozuar, neni 127.2 thotë me sa vijon:

> *"2. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës kryesohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me mbështetje nga Qeveria."*

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 127.2 të Kushtetutës

230. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar e ndryshon rolin e kryesuesit të Këshillit të Sigurisë, por kjo nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 127 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 129.3 të Kushtetutës

231. Neni aktual 129.3 thotë me sa vijon:

> *"3. Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri, pas konsultimit me Qeverinë, së bashku emërojnë Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Kualifikimi dhe mandati, rregullohen me ligj."*

232. Sipas amendamentit të propozuar, neni 129.3 thotë me sa vijon:

> *"3. Presidenti i Republikës së Kosovës emëron Drejtorin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Zëvendësdrejtori dhe Inspektori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë emërohen nga Kryeministri. Kualifikimi dhe mandati rregullohen me ligj."*

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 129.3 të Kushtetutës

233. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar është shtuar për ta bërë atë në përputhje me amendamentin e propozuar të nenit 84.21, të shqyrtuar më sipër, prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 129.3 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 131.8 të Kushtetutës

234. Neni aktual 131.8 thotë me sa vijon:

> *"8. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës, vetëm gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, ushtron funksione ekzekutive që kufizohen në funksionet që ndërlidhen në veçanti me Gjendjen e Jashtëzakonshme. Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës do të drejtohet nga Presidenti i Republikës së*

Kosovës, sikur rregullohet me ligj. Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës do të bashkëpunojë ngushtësisht me Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet ndërkombëtare."

235. Sipas amendamentit të propozuar, neni 131.8 thotë me sa vijon:

"8. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës, vetëm gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, ushtron funksione ekzekutive që kufizohen në funksionet që ndërlidhen në veçanti me Gjendjen e Jashtëzakonshme. Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës do të bashkëpunojë ngushtë me Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet ndërkombëtare."

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 131.8 të Kushtetutës

236. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar e ndryshon kryesinë e Këshillit të Sigurisë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, por nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 131 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 134.1 dhe nenit 134.5 të Kushtetutës

237. Neni aktual 134.1 thotë me sa vijon:

> *"1. Avokatin e Popullit e zgjedh Kuvendi i Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të tij, për një mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.*

238. Neni aktual 134.5 thotë me sa vijon:

> *"5. Avokati i Popullit mund të shkarkohet vetëm me kërkesën e më shumë se një të tretës (1/3) së të gjithë deputetëve, dhe në këtë rast Kuvendi vendos me shumicën e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të tij."*

239. Sipas amendamentit të propozuar, neni 134.1 thotë me sa vijon:

> *"1. Avokati i Popullit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti, me propozim të Kuvendit për një mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje. Presidenti mund të kthejë kandidatin e propozuar nga Kuvendi. Këtë të drejtë mund ta ushtrojë vetëm një herë për një kandidat. Kuvendi mund të propozojë kandidatin e njëjtë, vetëm nëse siguron mbështetjen e 2/3 (dy të tretave) të votave të të gjithë deputetëve."*

240. Sipas amendamentit të propozuar, neni 134.5 fshihet.

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 134.1 dhe nenit 134.5 të Kushtetutës

241. Gjykata konsideron që ndonëse Presidentit do t'i jepet veto pezulluese në lidhje me emërimin e Avokatit të Popullit dhe duhet të ketë ndryshime sa i përket mënyrës së shkarkimit të Avokatit të Popullit, këto nuk e ndryshojnë Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Gjykata gjithashtu përmend përgjigjen e Avokatit të Popullit, të shqyrtuar më herët në këtë Aktgjykim, si dhe propozimin e tij se Avokati i Popullit duhet të ketë të drejtë të rizgjidhet.

242. Siç u tha më sipër, me rastin e shqyrtimit të postit të Prokurorit të Shtetit, të themeluar me nenin 109 [Prokurori i Shtetit], posti i Avokatit të Popullit është njëri prej posteve të themeluara me Kushtetutë që mund të ushtrohet edhe nga zëvendësit deri në emërimin e Avokatit të ri të Popullit. Prandaj, natyra e këtij posti dallon nga ajo e gjyqtarëve të cilët duhet të ulen për të dëgjuar dhe gjykuar rastet që presin të zgjidhen në gjykata.

243. Përveç kësaj, mund të ketë arsye të mira për ta propozuar mundësinë për rizgjedhjen e Avokat të Popullit, por ky propozim nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 134 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Sa i përket amendamentit të propozuar të nenit 139.3 të Kushtetutës

244. Neni aktual 139.3 thotë me sa vijon:

> *"3. Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me jurisdiksion apeli."*

245. Sipas amendamentit të propozuar, neni 139.3 thotë me sa vijon:

> *"3. Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve e emëron dhe e shkarkon Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me juridiksion apeli."*

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 139.3 të Kushtetutës

246. Gjykata konsideron që ndonëse Presidentit do t'i jepet një rol në lidhje me shkarkimin e kryesuesit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kjo nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 139 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

X. Amendamenti 10 i propozuar: [Shpallja e Zgjedhjeve të para Presidenciale] e zëvendëson nenin 162

247. Amendamenti 10 propozon të futet një nen i ri, neni 162 [Shpallja e Zgjedhjeve të para të Presidenciale], i cili përcakton me sa vijon:

"Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Kushtetute:

(1) Zgjedhjet për Presidentin e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 86 të Kushtetutës, mbahen brenda 6 (gjashtë) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të amendamenteve Kushtetuese dhe ligjeve relevante.

(2) Mandati i Presidentit të Republikës së Kosovës, i zgjedhur nga Kuvendi, sipas dispozitave të mëhershme të Kushtetutës, vazhdon derisa Presidenti i ri të zgjedhet dhe të bëjë betimin.

(3) Presidentët që kanë shërbyer para hyrjes në fuqi të këtyre amendamenteve, kanë të drejtë të zgjedhen dhe rizgjedhen edhe një herë si President i Republikës së Kosovës."

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 162.1 të Kushtetutës

248. Gjykata konsideron që mbajtja e zgjedhjeve të para presidenciale sipas sistemit të ri zgjedhor, brenda gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të amendamenteve kushtetuese dhe ligjeve përkatëse, ia shkurton Presidentes aktuale mandatin prej pesë (5) vjetësh.

249. Me rastin e shqyrtimit të formulimit të nenit të ri të propozuar 86, të shqyrtuar më sipër, Gjykata konkludoi që zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës nga qytetarët

me të drejtë vote është përmirësim i të drejtave të tyre demokratike dhe nuk pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

250. Prandaj, çështja që duhet të shqyrtohet është nëse ndërprerja e parakohshme e mandatit të Presidentes aktuale prej pesë (5) vjetësh, të shkaktuar nga futja e sistemit të ri zgjedhor, pakëson apo nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

251. Neni 83 [Statusi i Presidentit] thotë me sa vijon:

> *"Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikë së Kosovës."*

252. Me Vendimin Nr. 04-V-227 për zgjedhjen e Presidentit të Republikës, të 7 prillit 2011, Kuvendi vendosi që (1) Shkëlqesia e saj, znj. Atifete Jahjaga zgjedhet Presidente e Republikës, dhe (2) Mandati i Presidentit është pesë (5) vjet.

253. Ky Vendim iu dërgua Kryesisë së Kosovës, Qeverisë së Kosovës dhe arkivit të Kuvendit. Më 7 prill 2011, Shkëlqesia e saj, znj. Atifete Jahjaga mori përsipër mandatin e saj si Presidente e Republikës, duke dhënë betimin para Kuvendit, në pajtim me nenin 87 të Kushtetutës.

254. Që nga data e zgjedhjes së Presidentit të Republikës nga Kuvendi, ajo u bë përfaqësuese legjitime e vendit, brenda dhe jashtë, si dhe garantuese e funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, siç parashihet me Kushtetutë.

255. Në rastin e Presidentes aktuale të Republikës, kjo do të thotë që i gjithë populli i Kosovës pret që ajo të jetë Presidentja e tyre gjatë pesë (5) vjetëve të ardhme. Kështu që, shkurtimi i

mandatit të saj, siç propozohet me amendamentin 10, e privon popullin e Kosovës nga përfaqësuesi i tyre legjitim dhe garantuesi në një kohë më të hershme se që besonin dhe shpresonin.

256. Autoriteti i Presidentit buron, para së gjithash, nga populli, të cilët përmes përfaqësuesve të tyre të zgjedhur në mënyrë demokratike në Kuvend e zgjedhin atë. Në rrathët e parë të votimit, Presidenti duhet t'i fitojë dy të tretat e shumicës së deputetëve të Kuvendit. Në rrethin e tretë, nëse është nevoja të mbahet, Presidenti mund të zgjidhet me shumicën e të gjithë deputetëve të Kuvendit. Presidentja aktuale u zgjodh me shumicën dërrmuese të të gjithë deputetëve të Kuvendit që në rrethin e parë.

257. Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] i Kushtetutës thotë që *"Presidenti i* Republikës *së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit ... [dhe] ... është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë."* Ky formulim sa i përket rolit të Presidentit është kryesor për njërin prej parimeve themelore të Kushtetutës së Kosovës, pra i doktrinës së ndarjes së pushtetit.

258. Kjo Gjykatë e theksoi këtë parim në Aktgjykimin e vet në Rastin Nr. KO 98/11, të 20 shtatorit 2011, lidhur me imunitetet e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në paragrafin 44, me ç'rast Gjykata tha:

"Republika e Kosovës definohet nga Kushtetuta e vet si Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre. Ndarja e pushteteve është njëra prej bazave që garanton funksionim demokratik të shtetit. Esenca e funksionimit të pavarur dhe

efektiv të këtyre degëve është imuniteti që u është dhënë njerëzve që i mishërojnë këto pushtete."

259. Pasi të zgjidhet, Presidenti mban mandatin deri në pesë vjet. Presidentja aktuale mban mandatin në mënyrë legjitime dhe është, në bazë të zgjedhjes së saj Presidente, garantuese e funksionimit demokratik të institucioneve në shtet. Mandati i Presidentit të Kosovës është përzierje e legjitimitetit të zgjedhjes së tij/saj, kohëzgjatjes së mandatit (pesë vjet) dhe kompetencave që i jepen Presidentit me Kushtetutë, jo vetëm kompetencat e dhëna sipas nenit 84 [Kompetencat e Presidentit].

260. Natyra e mandatit të Presidentit është edhe e natyrës politike që buron nga e drejta pasive e Presidentit për t'u zgjedhur, e garantuar me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], e posaçërisht me nenin 45.1, i cili thotë që të gjithë qytetarët gëzojnë të drejtën të zgjedhen. Instrumentet ndërkombëtare që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në Kosovë sipas nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] përfshijnë Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (në tekstin e mëtejmë: KNDCP), ku e drejta e njëjtë është theksuar në nenin 25, i cili përcakton:

"Çdo qytetar ka të drejtë dhe mundësi, që pa asnjë nga dallimet e përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme:

(a) Të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, qoftë drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht;

(b) Të votojë dhe të zgjedhet gjatë zgjedhjeve të vërteta të herëpashershme, me votim të përgjithshëm dhe të

barabartë dhe me vota të fshehta, të cilat sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve;

(c) Të pranohet, në kushte të përgjithshme barazie, për të ushtruar funksione publike në vendin e tij."

261. Gjykata vëren që shprehja "*të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike"* në nenin 25 (a) të KNDCP-së është kryesore për ushtrimin e mandatit të Presidentit të zgjedhur në mënyrë të drejtë e legjitime sipas Kushtetutës si pjesë e detyrave të tij/saj, siç parashihet me nenin 4, të cituar më lart.

262. Në të vërtetë, mund të thuhet që shprehja "*(c) Të pranohet, në kushte të përgjithshme barazie, për të ushtruar funksione publike në vendin e tij*" mund të zbatohet për postin e Presidentes së Republikës sipas kritereve aktuale të Kushtetutës, pasi barazia nënkupton të drejtën, krahas cilitdo person të trajtuar në mënyrë të padrejtë, për të pasur mjete efektive sipas ligjit për shkak të shkurtimit të mandatit. Sikur amendamenti i propozuar të miratohej, Presidentja aktuale nuk do të kishte qasje mjete të tilla.

263. Nëse Presidenti në detyrë nuk ka mbrojtje efektive juridike për shkak të shkurtimit të mandatit, atëherë rrezikohet mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. E drejta në mjet efektiv juridik është e mishëruar në nenin 54 të Kapitullit II të Kushtetutës, i cili përcakton:

"Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur."

264. Kjo e drejtë më tej mbrohet me nenin 13 të Konventës, i cili përcakton:

> *"Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare."*

265. Për më tepër, ushtrimi i këtyre të drejtave themelore është i garantuar me dispozitat e barazisë, të cilat gjithashtu i mbështesin normat e Kushtetutës, jo vetëm neni 24 [Barazia para Ligjit], i cili në paragrafin 1, ndër të tjera, thotë që "*Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim*". Kjo gjithashtu vlen, detyrimisht, për mbrojtjen e mandatit të Presidentit.

266. Kapitulli II i Kushtetutës përfshin shumë të drejta të tjera dhe liri themelore të njeriut në të cilat kjo Gjykatë, në këtë fazë, nuk duhet të thirret apo t'i shtjellojë tutje me rastin e marrjes së vendimit në lidhje me këtë amendament të propozuar, si ato të përcaktuara në nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] dhe në nenin 46 [Mbrojtja e Pronës].

267. Gjykata e shqyrtoi çështjen e mandatit të mbajtësve të posteve kushtetuese edhe në Aktgjykimin e sipërpërmendur në Rastin Nr. KO 98/11, në paragrafët 87 dhe 88:

> *"87. Në nenin 66 të Kushtetutës përdoret shprehja "mandat" për ta përshkruar kohëzgjatjen e legjislaturës përkatëse. Në të thuhet që mandati katërvjeçar fillon me seancën konstituive të mbajtur pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve dhe përfundon me shpërndarjen e Kuvendit.*

88. Kushtetuta gjithashtu përdor shprehjen "mandat" në lidhje me deputetët e Kuvendit me ç'rast ata, si përfaqësues të popullit, nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues. Secili deputet ka mandat individual, i cili fillon në ditën e certifikimit të rezultatit të zgjedhjes. Në ndërkohë që mandati i Kuvendit fillon me seancën konstituive të Kuvendit të sapozgjedhur, mandati i deputetit mund të fillojë më herët. Mandati i deputetit mbaron me shfaqjen e cilësdo prej rrethanave të cekura në nenin 70 (3) të Kushtetutës. Mandati i deputetit mishëron funksionin e tij/saj përfaqësues."

268. Vënia e theksit mbi rëndësinë dhe atributet e mandatit lidhej ngushtë me arsyetimin e Gjykatës në atë Aktgjykim se imuniteti ishte i pandashëm nga mandati. Mandati bazohej në Kushtetutë. Kështu është edhe me mandatin e Presidentit. Ai mandat është i panecueshëm për të siguruar respektim të parimit të ndarjes së pushteteve dhe për ta ruajtur sigurinë në rendin juridik dhe kushtetues.

269. Përveç kësaj, ndërprerja e parakohshme e mandatit të Presidentit të Republikës është ngjarje që është paraparë me nenin 91 të Kushtetutës [Shkarkimi i Presidentit] vetëm në rrethana të kufizuara, si dënimi për shkak të kryerjes së veprës së rëndë, për shkak të sëmundjes së rëndë apo për shkak të shkeljes së rëndë të Kushtetutës.

270. Megjithatë, ndërprerja e parakohshme e mandatit të Presidentit, siç parashihet me amendamentin e propozuar, ndikon në parimet themelore kushtetuese, në veçanti, parimin e ndalimit të shkurtimit të mandatit të fituar ligjërisht të postit kushtetues, si dhe parimin e mbrojtjes së besimit të arsyetuar të qytetarëve në ligjet e Kosovës dhe të zgjedhjes dhe mandatit të Presidentit të tyre duke u bazuar në ato ligje.

271. Për shkak të të gjitha arsyeve të përmendura më sipër, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar, me të cilin shkurtohet mandati i Presidentes aktuale të Republikës, pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 162.2 të Kushtetutës

272. Gjykata konsideron që amendamenti i propozuar ia vazhdon mandatin Presidentit të zgjedhur nga Kuvendi deri në betimin e Presidentit të ri sipas dispozitave të reja dhe kjo nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 162.2 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Kushtetutshmëria e nenit të ri të propozuar 162.3 të Kushtetutës

273. Gjykata konsideron që amendamenti propozon t'u lejohet Presidentëve të mëparshëm të zgjidhen dhe rizgjidhen dhe kjo nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 162.3 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

XI. Amendamenti 11 i propozuar: neni 162

Sa i përket amendamentit të propozuar që neni ekzistues 162 i Kushtetutës të bëhet neni 163:

274. Neni aktual 162 thotë me sa vijon:

> *"Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyn në fuqi më 15 qershor 2008."*

275. Sipas amendamentit të propozuar, neni me numër 163 thotë me sa vijon:

> *"Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyn në fuqi më 15 qershor 2008. Amendamentet 1-11 të kësaj Kushtetute hynë në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Kosovës. Pas hyrjes në fuqi të amendamenteve Kushtetuese bëhet harmonizimi i ligjeve dhe akteve të tjera të përgjithshme."*

Kushtetutshmëria e amendamentit të propozuar të nenit 162 të Kushtetutës

276. Gjykata konsideron që ndryshimeve të propozuara të Kushtetutës u jepet fuqi juridike pas miratimit në Kuvendin e Kosovës dhe që kjo nuk e ndryshon Kushtetutën në një mënyrë që ndikon në të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme ta vlerësojë më tej

kushtetutshmërinë e amendamentit të propozuar. Prandaj, Gjykata konkludon që amendamenti i propozuar i nenit 162 nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 113.9 dhe nenit 144.3 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 56.1 të Rregullores së punës,

GJYKATA NJËZËRI VENDOSI ME SA VIJON:

I. Kërkesat e dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit më 23 mars 2012 dhe më 4 maj 2012, me amendamentet e propozuara të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (të paraqitura në Anekset A dhe B) janë të pranueshme;

II. Amendamentet e propozuara të paraqitura në Aneksin B i kanë përfshirë ato në Aneksin A dhe ky Aktgjykim i referohet vetëm Aneksit B;

III. Amendamentet e propozuara në vijim pakësojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës :

1. Neni i ri i propozuar 85.2 (Në lidhje me kufizimin e të drejtës për të qenë kandidat për President vetëm për qytetarët që kanë qenë banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës për pesë vjet);

2. Neni i ri i propozuar 86.3 (Në lidhje me propozimet për postin e Presidentit të Kosovës – sepse ka të bëjë vetëm me subjektet politike parlamentare që e kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit);

3. Neni i ri i propozuar 90.5 (2) (Në lidhje me kufizimin e kompetencave të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme);

4. Neni i ri i propozuar 90.5 (3) (Në lidhje me kufizimin e kompetencave të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve);

5. Neni i ri i propozuar 90.5 (5) (Në lidhje me kufizimin e kompetencave të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit për shpalljen e faljeve);

6. Neni i ri i propozuar 104.1 (Në lidhje me veton pezulluese të Presidentit për emërimin e gjyqtarëve të gjykatave të rregullta);

7. Neni i ri i propozuar 114.2 (Në lidhje me veton pezulluese të Presidentit për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese);

8. Neni i ri i propozuar 162.1 (Në lidhje me ndërprerjen e parakohshme të mandatit Presidentit të Republikës së Kosovës);

IV. Ky Aktgjykim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

V. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Kadri Kryeziu Prof. Dr. Enver Hasani

KI 04/12 datë 24 korrik 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 647/2011, të 30 nëntorit 2011

Rasti KI 04/12, Aktgjykimi i 11 korrikut 2012

Fjalët kyçe: përmbarim, barazia para ligjit, vendime përfundimtare dhe të ekzekutueshme, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës, kërkesë individuale, e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mjete ligjore, e drejta për punë, shkelje e të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi i kërkesës, z. Esat Kelmendi, e dorëzoi kërkesën bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke e kontestuar vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 647/2011, me pretendimin se ishte marrë në kundërshtim me të drejtat e tij të garantuara nga neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, pasi që Gjykata e Qarkut e refuzoi propozimin e parashtruesit të kërkesës për ekzekutimin e vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës. Vendimi i KPM-së ishte një vendim i marrë nga organi administrativ që nuk ka asgjë të bëjë me kërkesën në të holla, siç parashihet me Ligjin e Procedurës Përmbarimore. Prandaj, vendimi i KPM-së nuk paraqiste titull përmbarimor, i cili do të duhej të ekzekutohej nga Gjykata e Qarkut, por ai ishte brenda kompetencave të KPM-së, sipas Rregullores së UNMIK-ut 2008/12 dhe Ligjit për KPM-në, për t'i ekzekutuar vendimet e veta.

Lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, Gjykata vendosi që, bazuar në gjuhën e thjeshtë të nenit 113.7, kjo kërkesë ishte e pranueshme sepse në kërkesën e tanishme z. Esat Kelmendi e konteston

kushtetutshmërinë e Vendimit Ac. nr. 647/2011 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të 30 nëntorit 2011. Prandaj, parashtruesi i kërkesës duhet të konsiderohet palë e autorizuar, me të drejtën e adresimit të kësaj çështjeje në Gjykatë dhe se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, siç parashikohen me ligj, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës. Sa i përket kërkesës së nenit 49 të Ligjit se parashtruesi është dashur ta dorëzojë kërkesën brenda një periudhe prej katër (4) muajsh Gjykata përcaktoi se nga parashtresat e parashtruesit, parashtruesit i ishte dorëzuar vendimi i lartpërmendur i Gjykatës së Qarkut më 16 dhjetor 2011, përderisa parashtruesi e kishte dorëzuar kërkesën në Gjykatë më 25 janar 2012, dmth. brenda afatit katër mujor, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit. Pastaj, parashtruesi i përcaktoi saktë cilat të drejta sipas Kushtetutës dhe KEDNJ pretendohen të jenë shkelur dhe nga cili autoritet publik. Prandaj, Gjykata gjithashtu gjen se parashtruesi e ka plotësuar kushtin e nenit 48 të Ligjit.

Për meritat e kërkesës, Gjykata vendosi se, pasi që KPM-ja kishte gjetur shkelje të së drejtës së parashtruesit për punë, vendimi i të cilit ishte bërë përfundimtar dhe i ekzekutueshëm, parashtruesi kishte të drejtë për mjet efektiv juridik, pasi që Rektorati i Universitetit të Prishtinës kishte refuzuar ta ekzekutojë vendimin e KPM-së. Megjithatë, siç u përmend më lart, në vend të ekzekutimit të vendimit të KPM-së, siç ishte detyra e tyre ligjore, të dyja, Rektorati i Universitetit të Prishtinës dhe Gjykata e Qarkut refuzuan ta bëjnë këtë. Duke mos e zbatuar vendimin e KPM-së të 18 marsit 2011, autoritetet përkatëse i kanë privuar nga të gjitha efektet e dobishme dispozitat e neneve 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe të nenit 6, si dhe nenit 13 të KEDNJ-së. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se e drejta për gjykim të drejtë dhe efektiv, siç garantohet me nenet e Kushtetutës dhe KEDNJ-së, është shkelur dhe se vendimi përfundimtar dhe i ekzekutueshëm i KPM-së i 18 marsit 2011, duhet të ekzekutohet. Për më tepër, Gjykata u shpreh se Gjykata e Qarkut nuk ka marrë parasysh vendimet e saj të mëparshme në mënyrë që ta kualifikojë dhe gjykojë rastin e parashtruesit në pajtim me vendimet e saj, të bazuara në parimin e së drejtës së trajtimit të barabartë, siç kishte vendosur më parë në rastet me rrethana plotësisht të ngjashme si në rastin e parashtruesit. Në këto rrethana, Gjykata, në përputhje

me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, thotë se kjo diferencë diskriminuese në trajtim përbën një shkelje të së drejtës për trajtim të barabartë përpara ligjit. Në arritjen e vendimit të saj, Gjykata gjithashtu u mbështet në vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që adresojnë çështjen e njëjtë ose të ngjashme. Gjykata e shpalli të pavlefshëm vendimin e Gjykatës së Qarkut dhe e ktheu vendimin në Gjykatën e Qarkut për rivendosje, në pajtim me aktgjykimin e kësaj gjykate.

Prishtinë, më 20 korrik 2012

Nr. Ref.:AGJ 285 /12

AKTGJYKIM

në

Rastin nr. KI 04/12

Parashtruesi

Esat Kelmendi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 647/2011, të 30 nëntorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Esat Kelmendi, me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar gjyqësor është Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 647/2011, i 30 nëntorit 2011, që parashtruesit i ishte dorëzuar më 16 dhjetor 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ]

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009, (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56 (1) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 25 janar 2012, Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë Gjykata).

6. Më 30 janar 2012, Kryetari, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues, dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 30 janar 2012, kërkesa iu komunikua Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës (në tekstin e mëtejmë: KPM).

8. Më 11 korrik 2012, Gjykata shqyrtoi dhe votoi për rastin.

Përmbledhje e fakteve

9. Më 20 janar 2011, Rektorati i Universitetit të Prishtinës (në tekstin e mëtejmë: Rektorati) i shqiptoi (Vendimi Nr. 178) parashtruesit masën disiplinore "ulje në pozitë" për shkak të shkeljes së Udhëzimit Administrativ 2003/2, d.m.th. të dispozitave lidhur me procedurën disiplinore dhe të kodit të mirësjelljes. Parashtruesi u ankua kundër këtij vendimi në KPM.

10. Më 18 mars 2011, KPM (Vendimi A 02/31/2011), miratoi ankesën e parashtruesit dhe i anuloi të gjitha masat procedurale lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës, përkatësisht "uljen në pozitë", dhe caktimin në vendin e punës "zyrtar i lartë për studime master dhe doktoratë në Fakultetin e Shkencave Sportive". Më tej, KPM e obligoi Rektoratin që ta kthente parashtruesin, në afat prej 15 ditësh, në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit të Prishtinës në përputhje me kontratën e tij të punës

11. Më 30 mars 2011, parashtruesi, e paralajmëroi Këshillin Drejtues të Universitetit të Prishtinës, dhe më 31 mars 2011, menaxherin e

personelit se moszbatimi i vendimit të KPM-së është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L – 192 për KPM (në tekstin e mëtejmë: Ligji për KPM).

12. Më 4 prill 2011, menaxheri i personelit, informoi parashtruesin se edhe Rektori i Universitetit të Prishtinës është informuar dhe se ata do ta njoftojnë parashtruesin për paralajmërimin e tij brenda afatit të paraparë ligjor.

13. Më 8 prill 2011, , parashtruesi e njoftoi KPM-në, se Rektorati në pajtim me nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-192nuk është duke e zbatuar vendimin e KPM-së.

14. Më 14 prill 2011, , parashtruesi ushtroi propozim në Gjykatën Komunale në Prishtinë, në pajtim me nenin 15 të Ligjit Nr. 03/L-192, për përmbarimin e vendimit të KPM-së.

15. Më 18 prill 2011, KPM në pajtim me nenin 15.2 të Ligjit Nr. 03/L-192, njoftoi Kryeministrin, Kryetarin e Kuvendit dhe Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë se Rektorati nuk është duke e zbatuar vendimin e KPM-së.

16. Më 7 korrik 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë (E. nr. 523/2011) refuzoi propozimin e parashtruesit për përmbarimin e vendimit të KPM-së. Gjykata Komunale në Prishtinë konkludoi se në përputhje me nenin 24 [Titulli ekzekutiv] të Ligjit Nr. 03/L-008 për procedurën përmbarimore (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Procedurën Përmbarimore) vendimi i KPM-së nuk është titull ekzekutiv sa i përket rikthimit në ven të punës, por në përputhje me nenin 13 të Ligjit për KPM. Vendimet e KPM-së do të ekzekutohen nga zyrtarët e nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës.

17. Më 13 korrik 2011, parashtruesi ushtroi kundërshtim kundër vendimit të Gjykatës Komunale.

18. Më 15 korrik 2011, parashtruesi bëri kërkesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit të Gjykatës Komunale në Prishtinë.

19. Më 27 korrik 2011, Këshilli Gjyqësor i Kosovës e njoftoi parashtruesin se hetimi disiplinor ndaj gjyqtarit kishte filluar.

20. Më 30 nëntor 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Ac. nr. 647/2011) refuzoi si të pathemeltë kundërshtimin e parashtruesit dhe e miratoi vendimin e Gjykatës Komunale

Pretendimet e parashtruesit

21. Parashtruesi pohon si në vijim:

    i. Neni 13 i Ligjit Nr. 03/L-192 saktëson se Vendimet e KPM-së janë përfundimtarë dhe të ekzekutueshëm në procedurë administrative dhe se ankesa e ushtruar kundër vendimit të KPM-së nuk e ndalon ekzekutimin. Në një vendim të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut konkludohet se vendimet e KPM-së në janë vendime administrative përfundimtare dhe se procedurat gjyqësore nuk e ndalojnë ekzekutimin e vendimit të KPM-së. Në këtë rast, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut urdhëroi kthimin e parashtruesit në vendin e tij të punës (shih Vendimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut nr. 2010 – 07, të 8 qershorit 2011 në rastin: Blerim Rudi kundër EULEX-it).

ii. Rektorati asnjëherë nuk më ka njoftuar, qoftë me shkrim apo gojarisht, për arsyet e moszbatimit të vendimit të KPM-së të 18 marsit 2011, edhe pse në përputhje me nenin 14 të Ligjit Nr. 03/L-192, fillimi i një procedure për konflikt administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimeve të KPM-së.

iii. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 03/L-192, moszbatimi i vendimit të KPM-së nga personi përgjegjës në institucion paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.

22. Për më tepër, Parashtruesi pretendon se Vendimi i Gjykatës Komunale (E.nr. 523/2011 i 7 korrikut 2011), është arbitrar, sepse nuk bazohet në ligj dhe është në kundërshtim me mënyrën se si Gjykata Komunale në Prishtinë dhe Gjykatat tjera Komunale në Kosovë e kanë shqyrtuar vendimet e KPM në raste të njëjta. Në mbështetje të pretendimit të tij, se gjykatat e rregullta e kanë shqyrtuar vendimin e KPM si titull përmbarimor, Parashtruesi i referohet vendimit në vijim:

ii. Më 29 dhjetor 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë e detyroi punëdhënësin ta kthente punëtorin në punë në përputhje me vendimin e KPM-së dhe nenin 28.1 të Ligjit Nr. 03/L-008 dhe nenin 15.4 të Ligjit Nr. 03/L-192 (E. nr. 2632/10). Gjykata Komunale e konsideroi vendimin e KPM-së përfundimtar dhe të ekzekutueshëm.

iii. Më 29 dhjetor 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë (Shënim: i njëjti gjyqtar që e refuzoi propozimin e parashtruesit për përmbarim) e detyroi

punëdhënësin ta kthente punëtorin në punë në përputhje me vendimin e KPM-së dhe nenin 28.1 të Ligjit Nr. 03/L-008 dhe nenet 13, 14 dhe 15.4 të Ligjit Nr. 03/L-192 (E. nr. 2633/10). Gjykata Komunale e konsideroi vendimin e KPM-së përfundimtar dhe të ekzekutueshëm.

iv. Më 29 dhjetor 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë e detyroi punëdhënësin ta kthente punëtorin në punë në përputhje me vendimin e KPM-së dhe nenin 28.1 të Ligjit Nr. 03/L-008 dhe nenet 13, 14 dhe 15.4 të Ligjit Nr. 03/L-192 (E. nr. 2634/10). Gjykata Komunale e konsideroi vendimin e KPM-së përfundimtar dhe të ekzekutueshëm.

v. Më 14 janar 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë (Shënim: i njëjti gjyqtar që e refuzoi propozimin e parashtruesit për përmbarim) e detyroi punëdhënësin ta kthente punëtorin në punë në përputhje me vendimin e KPM-së dhe nenin 28.1 të Ligjit Nr. 03/L-008 dhe nenet 13, 14 dhe 15.4 të Ligjit Nr. 03/L-192 (E. nr. 1155/10). Gjykata Komunale e konsideroi vendimin e KPM-së përfundimtar dhe të ekzekutueshëm.

vi. Më 21 janar 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë e detyroi punëdhënësin ta kthente punëtorin në punë në përputhje me vendimin e KPM-së dhe nenin 28.1 të Ligjit Nr. 03/L-008 dhe nenet 13, 14 dhe 15.4 të Ligjit Nr. 03/L-

192 (E. nr. 2778/10). Gjykata Komunale e konsideroi vendimin e KPM-së përfundimtar dhe të ekzekutueshëm.

vii. Më 20 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë e detyroi punëdhënësin ta kthente punëtorin në punë në përputhje me vendimin e KPM-së dhe nenin 28.1 të Ligjit Nr. 03/L-008 dhe nenet 13, 14 dhe 15.4 të Ligjit Nr. 03/L-192 (E. nr. 604/2011). Gjykata Komunale e konsideroi vendimin e KPM-së përfundimtar dhe të ekzekutueshëm.

viii. Më 20 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë e detyroi punëdhënësin ta kthente punëtorin në punë në përputhje me vendimin e KPM-së dhe nenin 28.1 të Ligjit Nr. 03/L-008 dhe nenet 13, 14 dhe 15.4 të Ligjit Nr. 03/L-192 (E. nr. 1070/2011). Gjykata Komunale e konsideroi vendimin e KPM-së përfundimtar dhe të ekzekutueshëm.

ix. Më 7 prill 2011, Gjykata Komunale në Klinë e detyroi punëdhënësin ta kthente punëtorin në punë. Gjykata Komunale konkludoi se vendimi i KPM-së është titull ekzekutiv dhe se ankesa ndaj vendimit të KPM-së nuk e ndalon përmbarimin (E. nr. 635/2010). Këtë vendim u miratoi edhe nga Gjykata e Qarkut në Pejë (Ac. nr. 158/2011, i 5 korrikut 2011).

23. Sipas mendimit të parashtruesit, "është e qartë që KPM i përgjigjet përkufizimit të një gjykate apo tribunali, siç përcaktohet me ligj, dhe bie nën fushëveprimin e nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së (shih sqarimin në udhëzimin e nenit 6 – Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Njeriut – i cili përcakton që neni 6 gjithashtu zbatohet për fazat administrative të procesit gjyqësor) dhe nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës".

24. Parashtruesi më tej pohon, që "KPM është i themeluar me ligj (Ligji Nr. 03/L-192) dhe nxjerr vendime të detyrueshme për palët (*shih*: rastin Sramek kundër Austrisë, 22 tetor 1984, ku GJEDNJ konstatoi se gjykata paraprake nuk ishte e pavarur me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit)".

25. Sipas parashtruesit, nga kjo rrjedh se "edhe moszbatimi i vendimeve të KPM-së bie nën fushëveprimin e nenit 6 të Konventës".

26. Përveç kësaj, gjoja, "vendimmarrja nga gjykatat e rregullta në çështje ligjore që janë tërësisht të njëjta dhe mos mundësia ose mos dëshira për ta krijuar një praktikë gjyqësore konsistente cenon rënd parimin e sigurisë juridike si një nga parimet bazë të sundimit të së drejtës, prandaj, nuk ka dyshim që vendimmarrja në këto rrethana përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenit 31 të Kushtetutës (*shih*: Rasti Beian kundër Rumanisë, 30658/05, 2007, GJEDNJ)".

27. Parashtruesi gjithashtu pohon, që me këto veprime, Gjykata Komunale dhe Gjykata e Qarkut padyshim kanë shkelur nenin 24 të Kushtetutës sepse, në situatë të njëjtë juridike, qytetarët nuk janë trajtuar njëjtë para ligjit dhe nuk kanë siguruar mbrojtje të barabartë ligjore pa diskriminim, siç kërkohet me nenin 24 të Kushtetutës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

28. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe në Rregullore të punës.

29. Gjykata përcakton së pari nëse parashtruesi është palë e autorizuar sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë që "*Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*" Në këtë drejtim, kërkesa është dorëzuar në Gjykatë nga një individ. Prandaj, parashtruesi është palë e autorizuar, ka të drejtë ta ngrejë këtë rast në Gjykatë sipas nenit 113.7 të Kushtetutës.

30. Përveç kësaj, Gjykata përcakton që Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxori Vendimin Ac. nr. 647/2011 më 30 nëntor 2011, kurse parashtruesi e mori atë vendim më 16 dhjetor 2011. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 25 janar 2012. Prandaj, parashtruesi e ka përmbushur afatin kohor për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.

31. Për më tepër, sipas nenit 12 dhe 14 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, pasi Gjykata e Qarkut në Prishtinë konsiderohet "si gjykatë e shkallës së fundit për të gjykuar për çështje që lidhen me përmbarimin". Si rrjedhojë, parashtruesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të Kosovës.

32. Përfundimisht, Gjykata përcakton që parashtruesi i ka përmbushur kriteret e nenit 48 të Ligjit: *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të*

drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj." Në këtë drejtim, Gjykata vëren që parashtruesi pretendon për shkelje të nenit 24 [Titulli ekzekutiv] të Ligjit për procedurën përmbarimore, i cili në nënparagrafin b) thotë:

Neni 24.1: Tituj ekzekutiv janë:

[...]

b) vendimi ekzekutiv i dhënë në procedurë administrative [...].Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI.

33. Pasi parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, pasi i ka përmbushur afatet kohore për të parashtruar kërkesë në Gjykatë, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, dhe pasi e ka qartësuar saktësisht shkeljen e supozuar të të drejtave dhe lirive, duke përfshirë aktgjykimin që e konteston, Gjykata konkludon që parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri.

Vlerësimi kushtetues i kërkesës

34. Gjykata duhet t'i shqyrtojë meritat e ankesës së parashtruesit, pasi ai i ka përmbushur kriteret procedurale për pranueshmëri.

35. Gjykata vëren që parashtruesi e konteston vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 647/2011, të 30 nëntorit 2011, me

të cilin u vërtetua vendimi i Gjykatës Komunale për të mos e përmbaruar vendimin e KPM-së.

36. Gjykata vëren që më 18 mars 2011, KPM miratoi ankesën e parashtruesit dhe e urdhëroi punëdhënësin që ta ripunësonte parashtruesin si Sekretar të Përgjithshëm të Universitetit të Prishtinës sipas kontratës së tij të punës (Vendimi A 02/31/2011). Vendimi i KPM-së ishte përfundimtar.

37. KPM u formua në shtator të vitit 2004 me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, të 22 shtatorit 2001. Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI.

38. Detyrat dhe përgjegjësitë e KPM-së u ripohuan më vonë me nenin 101.2 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës, i cili përcakton: *"Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, [...]"*.

39. Ligji Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i miratuar nga Kuvendi më 15 korrik 2010, dhe me të cilin zbatohet neni 101.2 i Kushtetutës, përcakton në nenin 3: *"Këshilli është organ i pavarur që i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i cili zgjidh ankesat e nëpunësve si dhe siguron respektimin e të gjitha rregullave dhe parimeve që rregullojnë Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës"*. Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI.

40. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që vendimet e KPM-së janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme në procedurë administrative dhe se ankesa e ushtruar kundër vendimit të KPM-së sipas nenit 13 të Ligjit për KPM-në nuk e ndalon ekzekutimin e vendimeve të tilla. Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI.

41. Pavarësisht këtyre dispozitave juridike, më 30 nëntor 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 647/2011, e vërtetoi vendimin e Gjykatës Komunale të 7 korrikut 2011, dhe ishte konkluduar se në përputhje me nenin 24 [Titulli ekzekutiv] të Ligjit për procedurën përmbarimore, vendimi i KPM-së nuk ishte titull ekzekutivi vlefshëm për ripunësim.

42. Në bazë të fakteve të mësipërme, Gjykata konsideron që parashtruesi ka shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion sipas ligjit të Kosovës për përmbarimin e vendimit të KPM-së. Sidoqoftë, përkundër përpjekjes së tij, vendimi i KPM-së nuk ishte zbatuar as nga Rektorati i Universitetit të Prishtinës, as nga gjykatat kompetente, siç u kërkua nga parashtruesi dhe siq parashihet me Ligj.

43. Sipas shënimeve të Gjykatës, në rastin në fjalë, vendimi i KPM-së, që ishte përfundimtar dhe i detyrueshëm, mbetet i papërmbaruar për shkak se Rektorati i Universitetit të Prishtinës dhe gjykatat kompetente, që është dashur ta përmbaronin vendimin e KPM-së sipas kërkesës së parashtruesit, e kanë injoruar detyrën e tyre ligjore sipas ligjeve të zbatueshme të Kosovës, duke shkelur kështu parimin e sundimit të së drejtës, që është baza e rendit juridik të Kosovës. Të gjitha obligimet që dalin nga vendimet e KPM-së, prodhojnë efekte juridike për institucionet e tjera përkatëse, ku statusi i punëtorit rregullohet me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Vendimi i këtij institucioni është vendim përfundimtar administrativ dhe, si i tillë, duhet të përmbarohet nga gjykatat kompetente siç propozohet për t'u përmbaruar nga kreditori lidhur me realizimin e të drejtave të tij të fituara në procedurën administrative.

44. Rasti në fjalë ngre çështjen sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 32 (e Drejta për Mjete Juridike) të Kushtetutës, sipas të cilit çdokujt i garantohet

mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike. Rektorati i Universitetit të Prishtinës dhe gjykatat kompetente duke mos zbatuar vendimin e KPM-së, kanë shkelur nenin 31 dhe 32 të Kushtetutës dhe nenin 6 dhe 13 të Konventës Evropiane.

45. Sundimi i ligjit është një prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike dhe presupozon respektimin e parimit të sigurisë juridike, sidomos në lidhje me vendimet gjyqësore që janë bërë përfundimtare dhe të përmbarueshme. Asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një aktgjykimi përfundimtar dhe detyrues vetëm për qëllim të fitimit të një rishqyrtimi dhe vendimi të ri të rastit (shih, *mutatis mutandis*, Sovtransavto Holding kundër Ukrainës, nr. 48553/99, paragrafi 72, GJEDNJ 2002-VII). Po të mos ishte kështu, anulimi i vendimeve përfundimtare do të rezultonte në një klimë të përgjithshme të pasigurisë juridike, duke zvogëluar kështu besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe, si rrjedhojë, edhe në sundimin e të drejtës. Prandaj, organet kompetente kanë për obligim pozitiv që ta organizojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv në kuptimin ligjor dhe atë praktik, dhe i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme (shih, Pecevi kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21839/03, 6 nëntor 2008; Martinovska kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 22731/02, 25 shtator 2006).

46. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu konsideron që rasti në fjalë duhet të kuptohet si rast që ngre çështje sipas nenit 54 të Kushtetutës, i cili thotë: *"Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur"*.

47. Gjykata vëren se është e drejtë e palës për të filluar procedura gjyqësore në rast të dështimit për të realizuar të drejtën e fituar, siç definohet në nenin 31 dhe nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 6 në lidhje me nenin 13 të KEDNJ. Do të ishte e pakuptimtë nëse sistemi juridik në Republikën e Kosovës do të lejonte që një vendim përfundimtar gjyqësor të mbetet i paefektshëm në dëm të një pale.

48. Prandaj, jo-efikasiteti i procedurave dhe mos-përmbarimi i vendimeve prodhon efekte që sjellin në situata që janë në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit, një parim që autoritetet e Kosovës janë të obliguara ta respektojnë (shih Vendimi i KEDNJ në rastin Romashov v. Ukraine, parashtresa nr. 67534/01 Aktgjykimi i 25 korrikut 2004).

49. Duke dështuar që ta zbatojnë vendimin e KPM-së të 18 marsit 2011, organet përkatëse ua kanë hequr të gjitha efektet e dobishme dispozitave të nenit 31 të Kushtetutës dhe të neneve 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

50. Në këto rrethana, Gjykata konstaton që është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe efektiv, siç garantohet me nenet e sipërpërmendura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së.

51. Përveç kësaj, parashtruesi ankohet se janë shkelur neni 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës, si dhe neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe neni 14 [Ndalimi i diskriminimit] i KEDNJ-së, pasi Gjykata e Qarkut në Prishtinë nuk e trajtoi parashtruesin në mënyrë të barabartë para ligjit me rastin e marrjes së vendimit në rastin e tij.

52. Në këtë drejtim, nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta në Kosovë i kanë konsideruar vendimet e KPM-së përfundimtare dhe të

ekzekutueshme dhe e kanë obliguar punëdhënësin që ta ripunësonte punëtorin në përputhje me vendimin e KPM-së dhe nenin 28.1 të Ligjit Nr. 03/L-008, dhe me nenet 13, 14 dhe 15.4 të Ligjit Nr. 03/L-192.

53. Megjithatë, në rastin e parashtruesit, i njëjti gjyqtar që e refuzoi propozimin e parashtruesit për ekzekutimin e vendimit të KPM-së më 29 dhjetor 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë e detyroi punëdhënësin ta kthente punëtorin në punë në përputhje me vendimin e KPM-së dhe nenin 28.1 të Ligjit Nr. 03/L-008, dhe nenet 13, 14 dhe 15.4 të Ligjit Nr. 03/L-192 (E. nr. 2633/10). Gjykata Komunale e konsideroi vendimin e KPM-së përfundimtar dhe të ekzekutueshëm.

54. Në këtë drejtim, GJEDNJ theksoi në rastin *Lithgov* se neni 14 i KEDNJ-së i mbron personat [...] që janë vënë në situata të ngjashme nga dallimet diskriminuese në trajtim (Lithgov dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Baashkuar, Aktgjykimi i 8 korrikut 1986, Seria A, nr. 102; (1986) 8 EHRR 329). Përveç kësaj, GJEDNJ theksoi në rastin *Fredrin* se, në mënyrë që kërkesa e parashtruesit të jetë e suksesshme, duhet të konstatohet, ndër të tjera, që situata në të cilën gjendet viktima e supozuar mund të konsiderohet e ngjashme me situatën e personave që kanë pasur trajtim më të mirë (shih Fredrin kundër Suedisë, Aktgjykimi i 18 shkurtit 1991, Seria A, nr. 192; (1991) 19 EHRR 784).

55. Përveç kësaj, GJEDNJ thekson se është obligim i gjykatave ose organeve lokale të tregojnë dhe dëshmojnë se trajtimi i një rasti ndryshe nga rastet e tjera me rrethana të ngjashme duhet të mbështetet me prova, të jetë bindës dhe i arsyetuar mirë. Në këtë drejtim, GJEDNJ theksoi në rastin Lithgov se: [...] për qëllime të nenit 14, dallimi diskriminues në trajtim është diskriminues nëse ky dallim nuk ka arsyetim objektiv ose të arsyeshëm, d.m.th. nëse nuk ndjek një synim legjitim.

56. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që, në bazë të parashtresës së parashtruesit, në të cilën i ka identifikuar disa vendime të gjykatave të rregullta që i kanë konsideruar vendimet e KPM-së përfundimtarë dhe të ekzekutueshëm në procedurë administrative (shih: Vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, E. nr. 2632/10, datë: 29.12.2010; Vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, E. nr. 2633/10, datë: 29.12.2010; Vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, E. nr. 2634/10, datë: 29.12.2010; Vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, E. nr. 1155/10, datë: 14.01.2011; Vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, E. nr. 2778/10, datë: 21.01.2011; Vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, E. nr. 604/2011, datë: 20.12.2011; Vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, E. nr. 1070/2011, datë: 20.12.2011; Vendimi i Gjykatës Komunale në Klinë, E. nr. 635/10, datë: 07.04.2011; dhe Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, AC. nr. 158/2011, datë: 05.07.2011).

57. Në lidhje me ekzekutimin e vendimit të KPM-së, në Vendimin E. nr. 2632/10, të 29 dhjetorit 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë thotë:

"...

I. Në bazë të propozimit të kreditorit Islam Krasniqi nga Prishtina, dhe dokumentit përmbarimorë – Vendimit të plotfuqishëm me shenjën A 02/128/10 i dt. 03.09.2010 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i cili është bërë i ekzekutueshëm me dt. 22.09.2010, PJESËRISHT LEJOHET PËRMBARIMI ndaj debitorit QKUK dhe e njëjta DETYROHET që kreditorin ta kthej në vendin e tij të mëparshëm të punës – Shef i Shërbimeve Teknike të QKUK-së në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.

II. Gjykata për lejimin e përmbarimit vendosi konform nenit 28.1 të LPP-së dhe neneve 13, 14 dhe 15 pika 4 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

…"

58. Kurse në rastin e parashtruesit, e njëjta Gjykatë vendosi ndryshe, duke thënë që:

"…

Gjykata pas analizimit të propozimit për përmbarim dhe shkresave të lëndës gjeti se: me nenin 24 të Ligjit për procedurën përmbarimore janë parapa titujt ekzekutiv në bazë të së cilëve gjykata e cakton përmbarimin kurse me pikën b të po këtij neni parashihet, citojmë "vendimi ekzekutiv i dhënë në procedurë administrative dhe ujdia administrative, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është parapa diçka tjetër" andaj gjykata konstatoi se vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës A 02/31/2001 1 datë 18.03.2011 nuk paraqet titull përmbarimor sa i përket kthimit në vendin e mëparshëm të punës kurse me nenin 13 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës (Ligji Nr. 03/L-192) parashihet se "Vendimi i Këshillit paraqet vendim administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtarë të nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës".

…"

59. Në rastin *Beian* (shih Beian kundër Rumanisë, 30658/05, të 6 dhjetorit 2007), GJEDNJ konstatoi që shkalla e lartë e pabarazisë së aktgjykimeve të Gjykatës së Kasacionit në Rumani për të njëjtat çështje ligjore vetvetiu është në kundërshtim me parimet e sigurisë juridike, që është implicite në të gjitha nenet e Konventës dhe është njëri prej elementeve themelore të sundimit të së drejtës. Kjo pabarazi është bërë burim i pasigurisë juridike, duke dëmtuar besimin e publikut në gjyqësor. GJEDNJ konstatoi se kjo pasiguri ka pasur efekt precedent të privimit të parashtruesit nga mundësia për t'i gëzuar të drejtat e parapara me ligj, ndërsa njerëzit e tjerë në situata të njëjta i kanë gëzuar këto të drejta. GJEDNJ gjeti që ka pasur shkelje të nenit 6.1 të Konventës.

60. Në këto rrethana, Gjykata konstaton që Gjykata e Qarkut nuk i ka marrë parasysh vendimet e veta të mëparshme për ta kualifikuar dhe gjykuar rastin e parashtruesit në përputhje me vendimet e veta duke u bazuar në parimin e të drejtës për trajtim të barabartë, siç kishte vendosur më parë në raste me rrethana plotësisht të ngjashme si të rastit të parashtruesit.

61. Në këto rrethana, Gjykata, në pajtim me nenin 24 (Barazia para Ligjit) të Kushtetutës, konstaton që ky dallim diskriminues në trajtim përbën shkelje të së drejtës për trajtim të barabartë para ligjit.

62. Në përgjithësi, Gjykata konstaton se të drejtat e garantuara, siq garantohen me nenet e lartpërmendura të Kushtetutës dhe të KEDNJ, janë shkelur dhe se vendimi përfundimtar përmbarimor i KPM, Vendimi A 02/31/2011 i 18 marsit 2011 duhet të përmbarohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim nenin 20 të Ligjit, dhe Rregullin 56 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 11 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA SHPALLË kërkesën si të pranueshme;

II. TA SHPALLË të pavlefshëm Vendimin Ac.nr. 647/2011 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të 30 nëntorit 2011, i cili shkelë nenet 24, 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenin 6 në lidhje me nenin 13 të KEDNJ;

III. TA KTHEJË Vendimin Ac. nr. 647/2011 të Gjykatës së Qarkut të 30 nëntorit 2011, në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate, në përputhje me Rregullin 74(1) të Rregullores së Punës;

IV. Në pajtim me Rregullin 63 (5) të Rregullores së Punës, Gjykata e Qarkut në Prishtinë duhet t'i dorëzojë Gjykatës Kushtetuese informata lidhur me masat e ndërmarra për të zbatuar këtë Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese;

V. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

VI. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues **Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Prof. Dr. Enver Hasani

SHTOJCA

Dispozitat përkatëse ligjore lidhur me procedurat për ekzekutimin e vendimeve administrative dhe gjyqësore

Ligji (Nr. 03/L-008) për procedurën përmbarimore

63. Në Republikën e Kosovës, rregullat ligjore, procedura zbatuese dhe siguria e vendimeve rregullohen me Ligjin për procedurën përmbarimore.

64. Neni 1 [Përmbajtja e ligjit]

"...

1.3 Me këtë ligj caktohen rregullat për procedurën e gjykatës sipas të cilës realizohen kërkesat në bazë të titujve ekzekutiv (procedura e përmbarimit), po qe se me ligj të posaçëm nuk është paraparë diçka tjetër.

1.4 Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për përmbarimin e vendimit të dhënë në procedure administrative dhe për kundërvajtje me të cilin është caktuar detyrimi në të holla, përveçse kur për përmbarimin e tillë është paraparë me ligj kompetenca e organit tjetër.

…"

65. Neni 24 [Titulli ekzekutiv]

"…

24.1 Tituj ekzekutiv janë:

a) vendimi ekzekutiv i gjykatës dhe ujdia gjyqësore ekzekutive;

b) vendimi ekzekutiv i dhënë në procedurë administrative dhe ujdia administrative, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër;

c) dokumenti noterial ekzekutiv;

d) dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument ekzekutiv.

…"

66. Neni 26 [Përmbarueshmëria e vendimit]

"…

26.3 Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimorë, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.

…"

67. Neni 294 [Shpërblimi i pagës në rast të kthimit të punëtorit në punë]

"…

294.1 Propozuesi i përmbarimit që e ka parashtruar propozimin për kthim në punë, ka të drejtë të kërkojë që gjykata të nxjerrë aktvendim me të cilin do të caktojë se, debitori ka për detyrë që atij t'ia paguajë në emër të pagës shumat mujore që janë bërë të kërkueshme, nga dita në të cilën ka marrë formë të prerë vendimi e deri në ditën e rikthimit në punë. Me të njëjtin aktvendim, gjykata e cakton përmbarimin për realizimin e shumave mujore të caktuara.

…"

Ligji Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

68. Neni 13 [Vendimet e Këshillit]

"...

Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtarit të nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Ekzekutimi duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

..."

69. Neni 14 [E drejta e ankesës]

"...

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrative në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.

..."

70. Neni 15 [Procedura në rast mos zbatimi të vendimit të Këshillit]

"...

1. *Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjigjes i institucionit paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.*
2. *Nëse personi përgjegjës i institucionit nuk ekzekuton vendimin e Këshillit në afatin e paraparë me nenin 13 të këtij ligji, Këshilli në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita kur ka kaluar afati për ekzekutim, duhet të njofton me shkrim kryeministrin, dhe eprorin e drejtpërdrejt të personit përgjegjës për ekzekutim.*
3. *Njoftimi nga paragrafi 2. i këtij neni konsiderohet kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore dhe materiale kundër personit përgjegjës për ekzekutim, e cila zhvillohet në pajtim me dispozitat e parapara Ligjin për shërbimin civil të Republikës së Kosovës.*
4. *Brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e kalimit të afatit për ekzekutim, pala mund të filloj procedurën e ekzekutimit në gjykatën komunale sipas ligjit për procedurën përmbaruese kundër personit dhe institucionit përgjegjës për ekzekutim, për dëmet materiale dhe jo materiale që janë shkaktuar me këtë vendim. Nëse gjykata kompetente vendos që punëtori (personi), i cili e ka kontestuar këtë mosekzekutim (mosekzekutimin e vendimit), t'ia kompensoi shumën e pagave, shpenzimet procedurale dhe shpenzimet tjera të mundshme, personi përgjegjës i institucionit mban edhe përgjegjësi materiale për dëmin që ia ka shkaktuar institucionit sipas ligjit.*
5. *Këshilli duhet të njofton me shkrim Kuvendin e Republikës së Kosovës për vendimet që nuk janë ekzekutuar.*

..."

71. Gjithashtu duhet të vihet në pah se në Republikën e Kosovës, ndonëse nuk parashihet me ligj, është praktikë e rëndomtë nga gjykatat që të përdoret Forca Policore e Kosovës si mjet për ta detyruar përmbarimin e vendimeve përfundimtare.

KI 63/11 datë 31 gusht 2012- Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. Br. 1239/2010 të 23 marsit 2011

Rasti KI 63/11, vendimi i 11 korrikut 2012

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, e drejta e pensionit, e drejta e pensionit invalidor, qartazi e pabazuar.

Parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 1239/2010 të 23 marsit 2011 me të cilin u hodh poshtë kërkesa për kompensimin e dëmit nga MPMS për shkak të ndërprerjes së pagesës së pensionit të parakohshëm të pleqërisë dhe pensionit invalidor në kohëzgjatje prej 11 vjetësh. Parashtruesi i kërkesës kërkon që përveç pranimit të së drejtës për pension invalidor Gjykata t'ia pranojë edhe pensionin e parakohshëm të pleqërisë të cilën e ka arritur për shkak të plagosjes në vitin 1981 kur ishte shpallur invalid ushtarak në kohë të paqes me shkallën e dëmtimit të shëndetit prej 40 %.

Duke vendosur në lidhje me kërkesën e parashtruesit të kërkesës Veli Kuqi, pas shqyrtimit të procedurës në tërësi Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur se procedurat përkatëse pranë gjykatave të rregullta kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare. Prandaj Gjykata konkludoi se kërkesa është qartazi e pabazuar pasi që faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese.

Prishtinë, më 23 korrik 2012

Nr. Ref.: RK 286/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 63/11

Parashtruesi

Veli Kuqi

Vlerësimi i Kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës

A. Br. 1239/2010 të 23 marsit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i Kërkesës është Veli Kuqi nga fshati Shirokë, Komuna Suharekës.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është aktgjykimi i Gjykatës Supreme te Kosovës A. Nr. 1239/2010 te 23marsit 2011 me të cilën refuzohet padia e parashtruesit të kërkesës për dëmshpërblimin e dëmit material dhe jomaterial, mbi kontestin kundër Ministrisë së Punës dhe Mbrojtjes Sociale (në tekstin e mëtejmë: MPMS) Departamenti i Administratës Qendrore (në tekstin e mëtejmë: DAQ) për ndërprerjen e pensionit

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës sfidon Gjykatën Supreme të Kosovës A. Nr. 1239/2010 të 23 marsit 2011 duke konsideruar se i është shkelur e drejta për pensionim të parakohshëm të pleqërisë të fituar në bazë të punës dhe pensionit invalidor të paraparë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa parashtrohet në bazë të neneve 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, neneve 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr.03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Kosovës të 16 dhjetorit 2008(në tekstin e mëtejmë: „Ligji“) dhe Rregullit 56 par. 2 i Rregullores së punës.

Procedura para Gjykatës

5. Parashtruesi i Kërkesës më datën 11 maj 2011 ka parashtruar kërkesë para Gjykatës kushtetuese të republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: „Gjykata“)

6. Më20 qershor 2011 Gjykata Kushtetuese ka njoftuar Gjykatën Supreme të Kosovës se është nisur procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të KosovësA.Nr.1239/2010 të 23 marsit 2011.

7. Me vendimin e Kryetarit (Nr. GJR.63/11 të 17 gushtit 2011), gjyqtarja Gjyljeta Mushkolaj emërohet për gjyqtare raportuese. Po të njëjtën ditë, me vendimin e kryetarit Nr. KSH.63/11 emërohet Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Prof. Dr. Iliriana Islami.

8. Me vendimin e kryetarit (Nr.GJR.117/11 dhe Nr.KSH/63/11 të 2 korrikut 20 2012), gjyqtari Ivan Čukalović u emërua si Gjyqtar raportues në vend të gjyqtares Gjyljeta Mushkolaj, ndërsa gjyqtari Altay Suroy si anëtar i Kolegjit Shqyrtues në vend të gjyqtares Iliriana Islami, të cilave më 26 qershor 2012 u përfundoi mandati si gjyqtare të Gjykatës Kushtetuese.

9. Më 11 korrik 2012, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Ivan Čukalović, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Altay Suroy, i

rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës

Përmbledhja e fakteve

10. Më 9 shtator 1973 parashtruesi i kërkesës ka lidhur marrëdhënie pune në Sekretariatin Krahinor të Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejmë: SKPB).

11. Parashtruesi i Kërkesës ka punuar në disa vende të punës në SKPB si zyrtar i autorizuar, ndërsa me rastin e kryerjes së detyrës zyrtare në SKPB më 1 prill 1981 parashtruesi i kërkesës është plagosur gjatë kohës së protestave në rrugë (demonstratave).
12. Më 9 qershor 1989 me shkresën nr. 04-118-36 parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga SKPB t'i lejohet dalja në pension të parakohshëm të pleqërisë, në të cilën në esencë konsideron *„...se për shkak të plagosjes së vitit 1981 është shpallur invalid ushtarak paqësor me 40% të dëmtimit të shëndetit trupor,...“*

13. Më 25 shtator 1989 me vendimin nr 7004035303 në bazë të ligjit të atëhershëm në fuqi parashtruesit të kërkesës i është pranuar e drejta për pension të parakohshëm të pleqërisë. Pensionin e parakohshëm të pleqërisë parashtruesi i kërkesës e ka gëzuar deri në vitin 1989kur qeveria e Serbisë ka ndaluar së paguari pensionet e personave me nacionalitet shqiptar.

Procedura për kërkesën e pensionit për persona me aftësi të kufizuara

14. Më 31 maj 2010 parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejmë: MPMS), Departamentit të Administratës së Pensioneve të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: DAPRK) që t'i pranohet e drejta për pension të parakohshëm për persona me aftësi të kufizuara.

15. Më 10 shkurt 2011 me vendimin e DAPRK, e në bazë të vendimit që ka përvetësuar këshilli për padi nr. 5097090 të 10 dhjetorit 2010, parashtruesit të kërkesës i është pranuar e drejta e pensionit për persona me aftësi të kufizuara.

Procedura për kërkesën për pension të parakohshëm të pleqërisë dhe pension invalidor

16. Megjithatë, në ndërkohë më 5 korrik 2010 parashtruesi i kërkesës i drejtohet MPMS me kërkesë të re në të cilën kërkon që përsëri t'i aktivizohet pensioni i parakohshëm i pleqërisë që kishte fituar dhe pensioni invalidor që kishte gëzuar para se të fillonte konflikti luftarak në Kosovë.

17. Më 21 korrik 2010 në përgjigjen e MPMS-DAPRKnr. 4920 për kërkesën e re në të cilën në esencë pohohet si në vijim;

> *„...se pensionin që ka gëzuar para luftës, nuk mund t'a gëzojë, për arsye se për pensionin në bazë të punës nevojitet të përmbushet kushti i pleqërisë 65 vjeçare.*
>
> *Që problemi i pensioneve të mbetura nuk është vetëm juaji, por është një problem i cili ekziston për rreth 50,000 penzionerë në Kosovë, të cilët kanë qenë penzionerë të fondit të ish Federatës Jugosllave, ose të atyre që kanë punuar në ndërmarrjet e Serbisë..."*

> *„...Që në bazë të listës së çështjeve që ka paraqitur ekziston alternativa në pikëpamje të pensioneve për persona me aftësi të kufizuara ose në pikëpamje të ndihmës sociale... dhe "(pensioni për persona me aftësi të kufizuara i cili i është aprovuar parashtruesit të kërkesës më 10 shkurt 2011 me vendimin e DAPRK dhe në bazë të vendimit që ka përvetësuar këshilli për padi nr. 5097090 të 10 dhjetorit 2010)".*

18. Në përgjigjen nr. 4920 të MPMS-DAPRK të 21 korrikut 2010 parashtruesi i kërkesës parashtron padi para Gjykatës Supreme të Kosovës më 22 dhjetor 2010 në të cilën kërkon kompensimin e dëmit nga MPMS për ndërprerjen e pagesës së pensionit të parakohshëm të pleqërisë dhe pensionit invalidor në kohëzgjatje prej 11 vjetësh.

19. Më 23 mars 2011 Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin A. Br. 1239/2010 refuzon padinë si të pabazë ku ndër të tjera pohohet si në vijim;

> *„ Gjykata Supreme e Kosovës ka konstatuar se padia është e pa bazuar, sepse ka vlerësuar, se organi i paditur, aktvendimi i te cilit kontestohet nuk është trashëgimtare e fondeve të ndryshme të pensioneve nga ·sistemi i shtetit të shpërberë të ish Jugosllavisë. Sipas rregullores 2001135, Administrata pensionale është themeluar ne kuadër të MPMS-se, dhe është e obliguar t'i rregullon pagesat e pensioneve bazë të personave që i plotësojnë kriteret sipas kësaj rregulloreje*
>
> .
>
> *Skema e bazës së pensioneve në Kosovë pas luftës, ka filluar më 1 korrik 2002, në kuadër të DAPRK, e cila rregullon pensionet e kontribut-dhënësve me stazh te sigurimit personal)sipas Rregullores Administrative nr.11/2007. Bazuar në gjendjen faktike, rezulton se institucionet e Republikës së Kosovës janë autoritete të reja të qeverisë, të cilat njëkohësisht nuk janë trashëgimtarë ligjor të organeve të qeverisë para vitit 1999.“*

Pretendimet e parashtruesit

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës A.Nr. 1239/2010 te 23 marsit 2001 janë

shkelur të drejtat për pensionim të parakohshëm të pleqërisë dhe pensionim invalidor duke theksuar se ka ardhur deri të shkelja e nenit 102 të Kushtetutës pika 3i cili parasheh *„Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe Ligjit.“*

21. Në fund parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur edhe neni 22 i Kushtetutës i cili parasheh zbatimin direkt të marrëveshjes dhe instrumenteve ndërkombëtare, e konkretisht edhe kartën sociale Evropiane të vitit 1996.

22. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës si vijon:

> *“Përmes parashtrimit të kësaj kërkese dëshirojë të arrijë që të vërtetohet se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës A nr.1239 dt. 22.12.2010 është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe me të cilin aktgjykim më është shkelur e drejta ime për të qenë shfrytëzues i pensionit invalidor të punës. Pra, unë jam privuar nga e drejta për të marrë pensionin invalidor të punës pasi që edhe i plotësoj të gjitha kushtet për një pension të tillë. Për shkak të aftësisë sime të kufizua unë jam i detyruar ta braktisë punën që e kam ushtruar për disa vite. Dhe për atë shkak që jam i paaftë edhe kam aplikuar për pension invalidor të punës. Për shkak të këtij aktgjykimi ende po vuaj nga mos realizimi i të drejtës sime.”*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës thekson se neni 22 (Zbatimi Direkt i Marrëveshjes dhe Instrumenteve Ndërkombëtare) dhe neni 102 (Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor) paragrafi 3 i Kushtetutës së Kosovës, janë bazë për kërkesën e tij

24. Neni 48 i ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës parasheh:

„Parashtruesi i kërkesës është i detyruar që qartazi të potencojë se cilat të drejta dhe liri i janë shkelur dhe cili është akti konkret i autoriteteve publike që parashtruesi dëshiron të sfidojë.“

25. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit, në rastet kur shqyrtohen rastet e sjella nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që të interpretojnë ligjin dhe zbatimin e rregullave të përshtatshme të procedurave dhe të drejtës materiale (shih *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [GC], br. 30544/96, paragrafi 28 Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut [GjEDNj],1999-I).
26. Parashtruesi i kërkesës nuk ka sjellë ndonjë dëshmi *prima facie që tregon shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese* (shih, Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi i GJEDNj në lidhje më pranueshmërinë e kërkesës, nr. 53363/99 të 31 majit 2005). Parashtruesi i kërkesës nuk thekson se në çfarë mënyre e mbështesin kërkesën e tij neni 22 dhe 102, ashtu siç parashihet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 48 të Ligjit.

27. Parashtruesi i kërkesës pohon se të drejtat e tij janë shkelur me përcaktimin e gabuar të fakteve dhe me zbatimin e gabuar të ligjit nga ana e gjykatave të rregullta, duke mos theksuar qartë se si ato vendime kanë shkelur të drejtat e tij kushtetuese.

28. Në këtë rast parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që të paraqesë rastin e tij para Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe para Gjykatës Supreme, dhe të kontestojë interpretimin e ligjit që mendonte se ishte i gabuar. Pas shqyrtimit të kërkesës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk gjen që procedurat përkatëse ishin të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNj-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr.17064/06 të 30 qershorit 2009).

29. Nga kjo del se kërkesa është e pabazuar në pajtim me Rregullin 36 (2b) të Rregullores së Punës që parasheh se „Gjykata hedh poshtë kërkesën qartazi si të pabazë kur përfundohet se b) faktet e nxjerra në asnjë mënyrë nuk arsyetojnë pretendimet dhe shkeljen e të drejtave kushtetuese,“.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 11 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues **Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Prof. Dr. Enver Hasani

KI 40/12 datë 07 shtator 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren P. nr. 208/09 të 15 qershorit 2011.

Rasti KI 40/12, vendimi i 11 korrikut 2012

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, shterimi i të gjithë mjeteve juridike efektive, padi konfesore, e drejta për një proces të rregullt.

Parashtruesi i kërkesës ka paraqitur parashtresën në pajtim me neni 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kërkuar nga Gjykata vlerësimin e kushtetutshmërisë të aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren P. nr. 208/09 i 15 qershorit 2011. Objekti i çështjes, kontesti juridiko pronësor, është rrjedhojë e kërkesës për konfirmimin e pronësisë mbi patundshmërinë e kontestuar ndërmjet parashtruesit së kërkesës dhe personave të tretë. Parashtruesi i kërkesës ka vlerësuar se vendimi i Gjykatës për ndarjen e rastit i cili po zhvillohet në lidhje me dy padi konfesore, paraqet shkelje të ligjit, sepse ligji nuk toleron që për paditë konfesore të vendoset ndaras. Nga sa u tha më lart, parashtruesi i kërkesës ka konsideruar se aktvendimi në procesverbalin, të cilin e ka nxjerr gjyqtari gjykues, është diskriminues, sepse e ka bllokuar rrjedhën e procesit, kundër të cilit nuk mund të parashtrohet mjeti juridik.

Parashtruesi i kërkesës ka konsideruar se janë bërë shkeljet e nenit 31. (E drejta për gjykim të drejt dhe të paanshëm) i Kushtetutës si dhe nenit 6 i KEDNJ (E drejta për një proces të rregullt).

Duke vendosur në lidhje më kërkesën e parashtruesit Pjeter Oroshi, Gjykata Kushtetuese, pas shqyrtimit të procesit, ka konfirmuar se individët mund të iniciojnë procedurë, nëse të drejtat dhe liritë e tyre, të garantuara me Kushtetutë, janë shkelur nga një organ publik, por vetëm pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Prishtinë, më 24 korrik 2012

Nr. Ref.: RK 287/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 40/12

Parashtruesi

Pjetër Oroshi

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Prizren P. nr. 208/09 të 15 qershorit 2011.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Z. Pjetër Oroshi, të cilin e përfaqësojnë avokatët Fikri Shishko dhe Shaip Ramadani nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës komunale në Prizren P. nr. 208/09 e 15 qershorit 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes pronësoro-juridike është krijuar shkaku i kërkesës për përcaktimin e pronësisë mbi patundshmërinë kontestuese ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe personave të tretë, që është në procedurë e sipër në Gjykatën komunale në Prizren.

4. Parashtruesi pohon si në vijim:

> *„Meqenëse në këtë rast kemi të bëjmë me dy padi konfesore (actio confesoria), ligji nuk toleron që për padi konfesore të*

vendoset ndarazi. Aktvendimi në procesverbal të cilin e ka nxjerrë gjyqtari shqyrtues është diskriminues, sepse me te e ka bllokuar rrjedhën e procesit, kundër të cilit nuk mund të parashtrohet mjeti juridik. Në këto rrethana gjyqtari i ka lënë hapësirë procesit shqyrtues të gjykon lidhur me padinë e paditësit Pashk Kol Oroshi. *Ndërsa është e pasigurt se çka do të ndodhë atëherë me padinë e paditësit* Pjetër Oroshi, *si parashtrues i kësaj kërkese".*

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejmë „Ligji") dhe rregulla 56 paragrafi 2 i Rregullores së punës

Procedura në gjykatë

6. Parashtruesi i kërkesës, më 17 prill 2012 ka parashtruar kërkesë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: „Gjykata").

7. Kryetari më 23 maj 2012 ka emëruar gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues të Kolegjit shqyrtues në përbërje : Robert Carolan (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Prof. Dr. Enver Hasani.

8. Më 6 qershor 2012, Gjykata e ka njoftuar parashtruesin e kërkesës, dhe Gjykatën e Qarkut në Prizren lidhur me dorëzimin e Kërkesës.

9. Më 11 korrik 2012, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Almiro Rodrigues, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues, Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani, i

rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

10. P. K. O. para Gjykatës komunale në Prizren ka parashtruar padi për vërtetim të pronësisë, kundër Komunës së Prizrenit dhe PIP „Progres – Export“ Prizren. P. K.O. si provë ka paraqitur një kontratë. Ajo kontratë është e vërtetuar nga gjykata, (Leg. nr. 1311, më 13 nëntor 1967), dhe ndërlidhet me ngastrën kadastrale nr. 4/321, arë, me sipërfaqe prej 1.02,00 ha, ZK Caparc.

11. Gjykata komunale e Prizrenit, me Aktgjykimin C. nr. 692/94 i 8 prillit 1996, aprovoi kërkesëpadinë dhe vërtetoi se paditësi P. K. O. është pronar i ngastrës së cekur kadastrale.
12. Komuna e Prizrenit dhe PIP „Progres – Export“ nga Prizreni ushtruan ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale.

13. Më 8 nëntor 1996, Gjykata e Qarkut në Prizren (Ac.nr.518/96) anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren dhe ktheu lëndën në rigjykim.

14. Më 12 maj 1998, Gjykata Komunale në Prizren, (Aktgjykimi C. nr. 836/96), përsëri aprovoi kërkesëpadinë dhe vërtetoi se P. K. O. është pronar i ngastrës së lartcekur.

15. Komuna e Prizrenit dhe PIP „Progres – Export“ nga Prizreni përsëri kanë parashtruar një ankesë kundër Aktgjykimit të ri të Gjykatës Komunale në Prizren.

16. Më 12 dhjetor 1998, Gjykata e Qarkut në Prizren (Ac. nr. 695/98), anuloi Aktgjykimin e ri të Gjykatës komunale në Prizren, dhe edhe njëherë lëndën e kthen në rigjykim.

17. Ndërkohë, parashtruesi ka kuptuar për kontestin ndërmjet P. K. O. nga njëra anë dhe Komunës së Prizrenit e PIP „Progres – Eksport“ nga Prizreni në anën tjetër.

18. Pastaj më 12 prill 2001, parashtruesi Pjetër Qun Oroshi ka parashtruar padinë nr. 40/99 pranë Gjykatës Komunale në Prizren për të vërtetuar të drejtën pronësore, në bazë të trashëgimisë për të njëjtën ngastër e cila është lëndë kontestuese.Meqenëse kërkesëpadia ndërmjet P. K. O. dhe Komunës së Prizrenit e PIP „Progres – Export“ nga Prizreni nuk ka përfunduar, tani në kontest ekzistojnë të parashtruara dy padi konfesore *(actio confesoria)* për të njëjtën ngastër kadastrale për të cilën që të dy edhe Pjetër Qun Oroshi dhe P. K. O. pohojnë së janë pronarë.

19. Për t' i ikur paragjykimit lidhur me kërkesëpaditë për vërtetimin e pronësisë, Gjykata Komunale në Prizren, vendos që t' i lidhë të dy lëndët dhe me Aktgjykimin C. nr. 198/01 të 14 janarit 2008, vendos për të dy kërkesëpaditë.

20. Në aktgjykimin e Gjykatës komunale në Prizren C. nr. 198/01 të 14 janarit 2008 të gjitha palët e pakënaqura parashtruan ankesë.

21. Duke vendosur sipas ankesave Gjykata e Qarkut në Prizren me Aktvendimin Ac. nr. 521/2008 të 16 marsit 2009, anulon Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prizren C. nr. 198/01 të 14 janarit 2008, dhe lëndën ia kthen në rigjykim Gjykatës komunale në Prizren.

22. Në procedurën e përsëritur Gjykata komunale në Prizren caktoi shqyrtimin kryesor për më shumë ditë pune me lëndë të bashkuara (dy), që kanë të njëjtën çështje shqyrtimi.

23. Më 15 qershor 2011, Gjykata Komunale në Priren nxjerr Aktvendimin P .nr. 208/09, me të cilin shqyrtimi kryesor, u shty për kohë të pacaktuar, dhe i njëjti do të caktohet pasi që

Gjykata të vendosë për bashkimin ose ndarjen e këtyre dy lëndëve. Kjo ishte seanca e fundit e mbajtur për këtë rast deri më tani.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *„i është shkelur e drejta kushtetuese për një proces të rregullt dhe të pa anshëm gjyqësor -neni 113/3 i Kushtetutës së Kosovës“.*

25. Ai gjithashtu pretendon se: *“i është shkelur e drejta për të përdorë mjete juridike kundër vendimit gjyqësor, sepse gjykata, në çështjen civile të përshkruar si më lartë ka konstatuar në procesverbal për shtyrjen e seancës për kohë të pacaktuar, duke aluduar në ndarjen e lëndëve me objekt të njëjtë shqyrtimi, të cilat më parë janë bashkuar dhe është vendosur me një Aktgjykim, ashtu që edhe përkundër këtij fakti , gjyqtari nuk nxjerrë Vendim për ndarjen e lëndëve, edhe pse të cilat me ligj nuk mund të ndahen, sepse njëherë veç janë bashkuar, ashtu që kundër vendimit të cilin do te duhej t ua dorëzonte palëve , me të drejtë ankese, një gjë e tillë nuk ka ndodhur, neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.”*

26. Prandaj, parashtruesi i kërkesës konsideron se *„lënda pa arsye zvarritet që nga viti 1994. Në rastin e lartë cekur, të elaboruar më lartë, parashtruesit të kërkesës, në bazë të nenit 6 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, i është shkelë e drejta për një proces të rregullt dhe të paanshëm gjyqësor, e po ashtu edhe brenda një afati të arsyeshëm“.*

27. Parashtruesi përfundon duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese *„ mbrojtje juridike, në mënyrë që të shmanget shkelja e të drejtave kushtetuese nga një autoriteti – si në rastin e procedurës kontestimore sipas lëndëve të cekura më lartë e që akoma janë në procedim pranë Gjykatës Komunale në Prizren. Që mosmarrëveshja civile e cila zvarritet me vite, të përfundoj ligjërisht dhe në mënyrë të paanshme”.*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pohon se neni 31. (E drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm) të Kushtetutës si dhe neni 6 GJEDNj (E drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm) janë bazë e kërkesës së tij.

29. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet ta shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë si dhe me Ligj dhe Rregullore.

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 paragrafi 7 të Kushtetutës i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

31. Në anën tjetër, neni 47 (2) i Ligjit po ashtu përcakton se:

> "*Individi mund të ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi të që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

32. Për më tepër, Rregulli 36 (1) parasheh se:

> *"Gjykata mund të shqyrtojë kërkesat vetëm nëse janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar.*

33. Në këtë rast del se Parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion , pasi që procedurat në Gjykatën Komunale në Prizren janë ende në pritje.

34. Në fakt Gjykata Komunale në Prizren (P.nr. 2008/09, e 15 qershorit 2011) deklaron:

> *"Shqyrtimi i sotëm shtyhet derisa të caktohet seanca e ardhshme pas vendimit të gjykatës lidhur me ndarjen dhe bashkimin e procedurave, si në lëndën e mëparshme nr. 40/99" (padia e parashtruesit e 12 prillit 2001).*

35. Gjykata konsideron se arsyetimi për kërkesën e shterimit është që tu ofrojë autoriteteve kompetente duke përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e supozuara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike për shkeljet e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis* GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94. Vendimi i 28 korrikut 1999).

36. Prandaj, Kërkesa sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 (2) të Ligjit dhe Rregullit 36 (1) a) të Rregullores së Punës, është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 11 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues	**Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 07/11 datë 07 shtator 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së moszbatimit të pretenduar të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Kamenicë C. nr 79/96, të datës 7 tetor 1997

Lënda KI 07/11, vendimi i 30 gushtit 2012
Fjalët kyçe; kërkesë individuale, e drejta në punë, vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit nr. 79-96 të Gjykatës Komunale në Kamenicë.

Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën në pajtim me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009.

Më 21 janar 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën e tij në Gjykatë.
Më 14 shkurt 2011, Kryetari caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj si Gjyqtare raportuese, dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Enver Hasani.

Parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Kamenicë, për kthimin e tij në marrëdhënie pune dhe për kompensimin e të ardhurave të tij personale prej 1 tetorit 1990.
Më 7 tetor 1997, Gjykata Komunale në Kamenicë vendosi CP. Nr. 79/96) të obligojë NSH "IMKOS" që t'i kompensojë parashtruesit të kërkesës për periudhën pas largimit të përkohshëm në shumën prej 78,20 dinarë me kamatë ligjore.

Aktgjykimi i Gjykatës Komunale ne Kamenicë nuk është zbatuar në mungesë të vërtetimit se aktgjykimi është i formës së prerë dhe detyrues, dhe si rrjedhojë, parashtruesi i kërkesës nuk e ka realizuar të drejtën në kompensim. Parashtruesi iu drejtua Gjykatës Komunale në Kamenicë, duke kërkuar vazhdimin e procedurave në mënyrë që aktgjykimi i lartpërmendur të ekzekutohet.

Me 6 maj 2005, Gjykata Komunale në Kamenicë informoi parashtruesin e kërkesës se "Aktgjykimi që ju [parashtruesi i kërkesës] keni kërkuar të bëhet i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm, për shkak të mungesës së dosjeve gjyqësore për momentin nuk mund të verifikohet dhe behet (...)'.
Nga shkurti 2001, deri ne korrik 2005, parashtruesi i kërkesës, përsëri, me qëllim të ekzekutimit të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Kamenicë, nisi procedura të ndryshme para Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Avokatit te Popullit, Dhomës se Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Përveç kësaj, me 1 korrik 2005, parashtruesi i kërkesës i pakënaqur me përgjigjen e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, parashtroi një kërkesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, për të ndikuar në Gjykatën Komunale në Kamenicë, në mënyrë që të lëshojë një vërtetim se aktgjykimi C. Nr. 79/96 i Gjykatës Komunale në Kamenicë, i 7 tetorit 1997 është i formës së prerë dhe detyrues.

Duke pasur parasysh këto dy dispozita ligjore, duhet konkluduar se juridiksioni i përkohshëm i Gjykatës Komunale për rastet paraprake fillon nga data e hyrjes në fuqi të Kushtetutës, e që është 15 qershori 2008, dhe përfundon me 15 maj 2009, qe do të thotë katër muaj (shih nenin 49 të Ligjit) pas hyrjes në fuqi të Ligjit, e që ishte 15 janari 2009· Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e kësaj kërkese, Gjykata Kushtetuese e Kosovës në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullave 36. (1a) dhe 36. (3c) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 17 janar 2012, njëzëri vendosi ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme.

Prishtinë, më 30 gusht 2012

Nr. ref.: RK291/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 07/11

Parashtruesi

Vebi Klaiqi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së moszbatimit të pretenduar të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Kamenicë C. nr 79/96, të datës 7 tetor 1997

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe

Ivan Čukalović, gjyqtar

Kërkesa

1. Kërkesa është parashtruar nga Vehbi Klaiqi (parashtrues i kërkesës), me vendbanim në fshatin Korretin, komuna e Kamenicës.

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin P.Nr.79/96, të Gjykatës Komunale në Kamenicë, të datës 7 tetor 1997.

3. Parashtruesi i kërkesës pohon se ka pasur shkelje të të drejtave të tij në punë, për shkak të mungesës së vërtetimit se aktgjykimi i kontestuar është i formës së prerë dhe i detyrueshëm.

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7, dhe nenin 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe Rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

5. Më 21 janar 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën e tij në Gjykatë.

6. Më 14 shkurt 2011, Kryetari caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj si Gjyqtare raportuese, dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Enver Hasani.

7. Më 11 gusht 2011, Gjykata Kushtetuese njoftoi Gjykatën Komunale në Kamenicë për kërkesën.

8. Më 2 korrik 2012, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues si Gjyqtar raportues, duke zëvendësuar gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj.

9. Më 10 korrik 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji Shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesi i kërkesës ka qenë i punësuar në NSH ”IMKOS” në Kamenicë, si Kryesues i Departamentit të Shërbimeve Ligjore.

11. Më 7 shtator 1990, Drejtori i Ndërmarrjes NSH ”IMKOS” në Kamenicë, me vendimin Nr. 544 ka larguar nga puna parashtruesin e kërkesës.

12. Parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Kamenicë, për kthimin e tij në marrëdhënie pune dhe për kompensimin e të ardhurave të tij personale prej 1 tetorit 1990.

13. Më 7 tetor 1997, Gjykata Komunale në Kamenicë vendosi (P. Nr. 79/96) të obligojë NSH ”IMKOS” që t’i kompensojë parashtruesit të kërkesës për periudhën pas largimit të përkohshëm në shumën prej 78,20 dinarë me kamatë ligjore.

14. Sipas parashtruesit të kërkesës, Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Kamenicë nuk është zbatuar në mungesë të vërtetimit se aktgjykimi është i formës së prerë dhe detyrues, dhe si rrjedhojë, parashtruesi i kërkesës nuk e ka realizuar të drejtën në kompensim.

15. Prandaj, duke filluar nga 15 shkurti 2001, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës së Qarkut në Gjilan, duke kërkuar vazhdimin e procedurës, në mënyrë që të ekzekutohej Aktgjykimi i lartpërmendur.

16. Më 6 maj 2005, Gjykata Komunale në Kamenicë informoi parashtruesin e kërkesës se "Aktgjykimi që ju [parashtruesi i kërkesës] keni kërkuar të bëhet i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm, për shkak të mungesës së dosjeve gjyqësore për momentin nuk mund të verifikohet dhe bëhet (...)".

17. Nga shkurti 2001, deri në korrik 2005, parashtruesi i kërkesës, përsëri, me qëllim të ekzekutimit të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Kamenicë, nisi procedura të ndryshme para Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Avokatit të Popullit, Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

18. Përveç kësaj, më 1 korrik 2005, parashtruesi i kërkesës i pakënaqur me përgjigjen e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, parashtroi një kërkesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, për të ndikuar në Gjykatën Komunale në Kamenicë, në mënyrë që të lëshojë një vërtetim se aktgjykimi C. Nr. 79/96 i Gjykatës Komunale në Kamenicë, i 7 tetorit 1997 është i formës së prerë dhe detyrues.

19. Duket se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të ekzekutojë Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Kamenicë.

Pretendimet e parashtruesit

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se është bërë shkelja e së drejtës së tij për kompensimin e të ardhurave personale nga marrëdhënia e punës, si një e drejtë e garantuar me Kushtetutë, pa iu referuar ndonjë neni të posaçëm të Kushtetutës.

21. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese që ta obligojë Gjykatën Komunale në Kamenicë që ta lëshojë vërtetimin se aktgjykimi C. Nr. 79/96 është i formës së prerë dhe detyrues.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës kanë të bëjnë me vërtetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Kamenicë (P. Nr. 79/96), të datës 7 tetor 1997, si të plotfuqishëm dhe të detyrueshëm, si kusht për ekzekutimin e tij.

23. Megjithatë, Gjykata Komunale në Kamenicë nuk ishte në gjendje të plotësonte kërkesën e parashtruesit të kërkesë, sepse dosja e rastit nuk ishte e disponueshme, meqë kishte humbur gjatë luftës.

24. Në anën tjetër, parashtruesi i kërkesës thekson se "rasti C. nr. 79/96 nuk u gjet në arkivin e Gjykatës Komunale në Kamenicë, por pothuajse të gjitha dokumentet e rastit janë në arkivin e palës së paditur".

25. Gjykata analizon nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, specifikuara në Ligj dhe Rregulloren e punës.

26. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari analizon nëse çështjet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës janë nën juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë mënyre, Gjykata duhet të marrë parasysh, edhe faktet për të cilat parashtruesi i kërkesës ankohet dhe fushën e së drejtës kushtetuese që pretendohet të jetë shkelur (Shih, Aktvendimin mbi papranueshmëri në rastin Nr. 69/10, Vehbi Halili, të 4 tetorit 2011 dhe gjithashtu *Gjykata Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut Aktgjykimi i Dhomës së Madhe në rastin e Blečić v. Croatia, Kërkesa nr. 59532/0, e 8 marsit 2006, para.* 82.).

27. Gjykata vëren se neni 56 (Rastet paraprake) i Ligjit parasheh:

> *"Afatet e përcaktuara në këtë ligj për fillimin e një procedure për çështjet për të cilat është kompetente Gjykata Kushtetuese dhe të cilat janë ngritur para hyrjes në fuqi të këtij ligji fillojnë të llogariten në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji".*

28. Në anën tjetër, neni 49 (Afatet) i Ligjit thotë se:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor".*

29. Duke pasur parasysh këto dy dispozita ligjore, duhet konkluduar se juridiksioni i përkohshëm i Gjykatës Komunale për rastet paraprake fillon nga data e hyrjes në fuqi të Kushtetutës, e që është 15 qershori 2008, dhe përfundon më 15 maj 2009, që do të thotë katër muaj (shih nenin 49 të Ligjit) pas hyrjes në fuqi të Ligjit, e që ishte 15 janar 2009.

30. Gjykata vëren se, në këtë rast, Aktgjykimi ishte dorëzuar më 7 tetor 1997 dhe se informata e fundit që kishte dhënë Gjykata Komunale në Kamenicë lidhur me disponueshmërinë e dosjes daton nga 6 maji 2005, që do të thotë, para hyrjes në fuqi të Kushtetutës më 15 qershor 2008. Parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese më 21 janar 2011.

31. Rrjedhimisht, Aktgjykimi ishte dorëzuar para 15 qershorit 2008, data e hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Gjykata nuk mund ta trajtojë kërkesën që ka të bëj me ngjarjet që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës. (Shih, Aktvendimin e Gjykatës mbi papranueshmëri në Rastin Nr. 18/10, *Denic et al* i 17 gushtit 2011*).*

32. Për më tepër, rregulli 36 (3h) i Rregullores së punës, parasheh se: „*Një kërkesë gjithashtu mund të konsiderohet e papranueshme në rastet vijuese kur: h) kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën*.“ Prandaj, konsiderohet se kërkesa është *ratione temporis* jashtë juridiksionit të Gjykatës.

33. Kështu që, duhet konkluduar se kërkesa nuk është *ratione temporis në pajtim me dispozitat e* Kushtetutën, dhe si e tillë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetues**
Almiro Rodrigues	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 158/11 datë 07 shtator 2012- Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Serbisë, Tu. Nr 367/90, të datës 21.03.1991

Rasti KI 158/11, vendimi i datës 30 prill 2012

Fjalët kyçe; kontrolli incidental, palë e autorizuar, ratione materia.

Parashtruesi paraqiti kërkesën në përputhje me nenin 113.8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës duke kërkuar vlerësimi të kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Serbisë, Tu. Nr. 367/90, i datës 21.03.1991, me anë të cilit është shpallur jokushtetues Vendimi i Kuvendit Komunal të Ferizajt për aprovimin e Planit Detal Urbanistik të Vikend-Zonës në Sharr (i 24 janarit 1979), e i shpallur në Gazetën Zyrtare të KSAK nr. 6, të datës 23 shkurt 1979.

Gjykata Kushtetuese ka konstatuar që parashtruesi i kërkesës nuk ka ngritur një çështje kushtetuese brenda kompetencave të parapara me nenin 113.8, andaj në përputhje me nenin 36 par. 3 (f) i Rregullores së Punës kërkesa duhet të vendoset si e papranueshme për shkak të papajtueshmërisë "ratione materiae" me Kushtetutën".

Prishtinë, më 30 gusht 2012

Nr. ref.: RK 290/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 158/11

Parashtruesi

Gjykata Komunale në Ferizaj-Dega në Shtërpcë

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Serbisë, Tu. Nr 367/90, të datës 21.03.1991

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Cukalovic, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Gjykata Komunale në Ferizaj-dega në Shtërpcë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik, vlerësimi i kushtetutshmërisë i të cilit kërkohet nga Gjykata Kushtetuese, është Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Serbisë, Tu. Nr. 367/90, i datës 21.03.1991.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së referuar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më 7 dhjetor 2011, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Serbisë, Tu. Nr. 367/90, i datës 21.03.1991, me anë të cilit është shpallur jokushtetues Vendimi i Kuvendit Komunal të Ferizajt për aprovimin e Planit Detal Urbanistik të Vikend-Zonës në Sharr (i 24 janarit 1979), e i shpallur në Gazetën Zyrtare të KSAK nr. 6, të datës 23 shkurt 1979.

Baza juridike

4. Neni 113.8 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 51 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2009, i hyrë në fuqi më 15 janar 2010 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe neni 29 i Rregullores së punës së Gjykatës

Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 7 dhjetor 2011, Gjykata Kushtuese pranoi kërkesën e parashtruar nga Gjykata Komunale në Ferizaj –dega në Shtërpcë, në emër të së cilës e kishte nënshkruar gjyqtari Musa Konxheli e me të cilën kërkohej vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar të përshkruar sikur në paragrafin 2 të këtij aktvendimi.

6. Më 30 janar, Gjykata Kushtetuese i dërgoi një njoftim Gjykatës Komunale në Ferizaj –dega në Shtërpcë se kërkesa e tyre është regjistruar në Gjykatën Kushtetuese me nr. KI-158/11..

7. Më 17 janar 2012, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Gjr. KI 158/11, caktoi Zëvendëskryetarin e Gjykatës, z. Kadri Kryeziu, për ta përpiluar raportin paraprak lidhur me kërkesën. Dhe të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin KSH-KI 158/11, caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje: Altay Suroy (kryesues) dhe gjyqtarët Robert Carolan e Prof. Dr. Enver Hasani, anëtarë të kolegjit.

8. Më 19 prill 2012 në seancën për shqyrtimin e kësaj kërkese,kolegji shqyrtues njëzëri i propozoj gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

9. Më 24 janar 1979, Kuvendi i Komunës së Ferizajt kishte nxjerrë Vendimin 01 nr. 03-1645 për aprovimin e Planit Detal Urbanistik të Vikend-Zonës Sharr dhe ky vendim ka hyrë në fuqi pas publikimit në Gazetën Zyrtare të ish-Krahinës së Kosovës (shih gazeta nr. 6 e datës 23 shkurt 1979, faqe 176).

10. Plani detal urbanistik ka përfshirë prona të paluajtshme në komunën kadastrale Vërbishticë dhe komunën kadastrale Shtërpcë, të renditura në parcelat kadastrale në nenin 1 të vendimit të sipërpërmendur.

11. Pronat e paluajtshme, të specifikuara në vendimin e datës 24 janar të vitit 1979 të Komunës së Ferizajt për qëllimin e zbatimit të atij vendimi, janë eksproprijuar sipas legjislacionit në fuqi të asaj kohe.

12. Në vitin 1988 (data e palexueshme) Gjykata Kushtetuese e Kosovës (KSAK) ka nxjerrë Vendimin U. 77/88 1988, me të cilin kishte refuzuar kërkesën e Bashkësisë Lokale të Shtërpcës për të shpallur të papajtueshëm me Kushtetutën vendimin e Kuvendit të Komunës së Ferizajt lidhur me planin detal Urbanistik të Vikend-Zonës SHARR, dhe rrjedhimisht me këtë, edhe të ekspropriimit të pronave të paluajtshme që përfshihen në këtë plan urbanistik (ky fakt konstatohet nga kopja e Vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Serbisë, Tu. Nr. 367/90, të datës 21.03.1991).

13. Më 13 maj 2011, znj. Milica Petkovic nëpërmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, avokatit z. Sadri Godanci, kishte paraqitur padi për vërtetimin e pronësisë në Gjykatën komunale në Ferizaj-dega në Shtërpcë, nga e cila kërkonte që ky institucion të vërtetojë të drejtën e pronësisë mbi parcelat në sipërfaqe prej 1444 m², përkatësisht 725², e të cilat ishin eksproprijuar me vendimin e Kuvendit Komunal në Ferizaj të vitit 1979. Kjo lëndë ishte regjistruar në këtë Gjykatë me numër C. nr. 17/11.

14. Përfaqësuesi i paditëses si provë që mbështet kërkesën e klientit të tij kishte paraqitur edhe Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Serbisë, Tu. Nr. 367/90, të datës 21.03.1991, e i cili kishte shpallë jokushtetues vendimin e KK të Ferizajt për Vikend-Zonën "Sharr".

15. Më 10 tetor 2011, gjatë seancës gjyqësore pala e paditur, Komuna e Ferizajt, kishte kontestuar këtë provë dhe mes tjerash kishte propozuar që të ndërpritet procesi dhe që Gjykata

Kushtetuese e Kosovës të deklarohet lidhur me kushtetutshmërinë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Serbisë.

16. Më 30 nëntor gjyqtari i çështjes, z. Musa Konxheli, kishte nxjerrë aktvendim me të cilin miratohet propozimi i palës së paditur dhe e kishte referuar çështjen në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës nga e cila kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar të GJ. Kushtetuese të Serbisë.

17. Më 7 dhjetor 2011, në Gjykatë Kushtetuese ka arritur kërkesa formale lidhur me këtë çështje.

Shkeljet e pretenduara drejtave të garantuara kushtetuese

18. Parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar se cilat shkelje kushtetuese mund të jenë bërë me vendimin e kontestuar, por ka kërkuar vlerësimin e pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën në përgjithësi.

19. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu ka kërkuar që Gjykata Kushtetuese e Kosovës të jap interpretim meritor nëse vendimi i kontestuar është nxjerrë nga një organ i autorizuar duke marrë parasysh kohën dhe vendin e nxjerrjes (viti 1991 pas suprimimit të Autonomisë së Kosovës, në Beograd)), nëse vendimi është diskriminues dhe nëse Gjykata Komunale e Ferizajt –dega në Shtërpcë duhet ta marrë parasysh si fakt relevant këtë vendim gjatë shqyrtimit të lëndëve –padive për vërtetimin e pronësisë, pasi që ky fakt është kontestuar nga njëra palë në procedurë dhe Gjykata Komunale e Ferizajt-dega në Shtërpcë e ka ndërprerë deri në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit të saj, Gjykata duhet paraprakisht të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen në Kushtetutë, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës së Gjykatës.

21. Në lidhje me ketë, Gjykata i referohet nenit 113.8 të Kushtetutës që përcakton se:

"Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë.",

dhe

Nenit 51 par. 1 e 2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ku shprehimisht përcaktohet se:

1. Kërkesa e ngritura në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës do të parashtrohet nga gjykata vetëm nëse ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti në çështjen që është pjesë e lëndës në shqyrtim dhe vetëm nëse ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit nga ana e gjykatës.

2. Kërkesa do të specifikojë cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën.

Gjykata gjithashtu merr parasysh:

Rregullin 36 par. 3 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, ku përcaktohet:

" (3) Po ashtu një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur:

f) kërkesa nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.

22. Duke iu referuar kërkesës së Gjykatës Komunale në Ferizaj lidhur me çështjen e shtruar për shqyrtim, Gjykata konstaton:

Sa i përket çështjes kushtetuese dhe palës së autorizuar:

23. Sikur u theksua në paragrafin 21 të këtij aktvendimi, gjykatat janë palë të autorizuara të ngritin çështje kushtetuese brenda kornizave të parapara me nenin 113.8 të Kushtetutës dhe nenit 51 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe çështja për të cilën i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese duhet gjithmonë të jetë e mbuluar me dispozita kushtetuese sa i përket materies kushtetuese (shih mutatis mutandis X vs Germany, Aplikacioni nr ° **7462/7 6 Vendimi për Papranueshmëri – *ratione materiae* 7 mars 1977).**

24. Në fakt, përkufizimi kushtetues dhe ai ligjor lidhur me kompetencat e gjykatave për t`iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese përcakton qartë se ato janë të autorizuara të kërkojnë vlerësimin e përputhshmërisë së LIGJEVE me Kushtetutën dhe jo edhe të ndonjë akti tjetër juridik (kontrolli incidental i kushtetutshmërisë).

25. Nga kërkesa e parashtruar nga Gjykata Komunale e Ferizajt-dega në Shtërpcë, padyshim konstatohet se kjo gjykatë nuk kishte kërkuar vlerësimin e përputhshmërisë së ndonjë ligji me Kushtetutën por të një vendimi të Gjykatës, e që nuk përkon me kompetencën kushtetuese të gjykatave sipas nenit 113.8 për të ngritur çështje në Gjykatën Kushtetuese.

26. Gjykata Kushtetuese thekson se edhe pse çështja e ngritur nga Gjykata Komunale ka lidhshmëri të drejtpërdrejtë me procesin gjyqësor që shqyrtohet nga ajo, prapë se prapë çështja themelore e ngritur është RATIONE MATERIE e pajtueshme me Kushtetutën sepse nuk është akt juridik për të cilin mund të kërkohet vlerësimi i kushtetutshmërisë nga gjykatat.

Sa i përket çështjeve për të cilat kërkohet vlerësimi kushtetues:

27. Gjykata Kushtetuese thekson se për sa i përket çështjeve substanciale të ngritura në kërkesë, ajo nuk është gjykatë e verifikimit të fakteve dhe nuk mund të paragjykojë se cilat fakte do të merren në konsideratë nga gjykatat e rregullta gjatë shqyrtimit të rasteve që ato i kanë në shqyrtim.

28. Konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i sajë (i GJ. Kushtuese) është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkalës së katërt" (shih, *mutatis mutandis,* i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65)

29. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese vëren se në Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Serbisë, Tu. Nr. 367/90, të datës 21.03.1991, është theksuar fakti se Gjykata Kushtetuese e

Kosovës në vitin 1988, me Vendimin U nr. 77/88, është deklaruar si gjykatë kompetente kushtetuese në atë kohë dhe ky fakt do të duhej të merrej parasysh edhe nga gjykatat e rregullta.

30. Në këto rrethana, parashtruesi i ankesës nuk ka ngritur një çështje kushtetuese brenda kompetencave të parapara me nenin 113.8, andaj në përputhje me nenin 36 par. 3 (f) kërkesa duhet të vendoset si e papranueshme për shkak të papajtueshmërisë "ratione materiae" me Kushtetutën".

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e 19 prillit 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Mr.Sc.Kadri Kryeziu	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 13/11 datë 07 shtator 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, P.nr. 211/06 të 1 nëntor 2007, të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.nr. 48/2008, të datës 14 maj 2008 dhe të Akgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Pzd. nr. 118/2010

Rasti KI 13/11, vendim i 31 gushtit 2012.

Fjalët kyçe: cenim i të drejtave dhe lirive kushtetuese, kodi i përkohshëm i procedures penale të Kosovës, kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar.

Parashtruesit paraqitën kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat dhe liritë e tyre kushtetuese janë cenuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, me ç'rast u vërtetua aktgjykimi dënues i Gjykatës së Qarkut lidhur me akuzat ndaj parashtruesve për vrasje dhe dëmtime trupore. Parashtruesit pohuan se Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme kanë cenuar të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara me nenet 24, 30 dhe 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Liritë e Njeriut.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesve ishte e papranueshme bazuar në Rregullin 56.2 të Rregullores së Punës për shkak se parashtruesit nuk i kanë mbështetur pretendimet e tyre ashtu siç kërkohet me Ligj dhe me Rregullore. Gjykata arsyetoi vendimin e saj duke theksuar se Gjykata Supreme kishte konstatuar se provat e ekspertëve mbështesnin dëshmitë e dëshmitarëve. Duke cituar praktikën e saj gjyqësore në rastin *nr. Kl 06/09, parashtruesi X kundër Aktgjykimit nr. 215/2006 të Gjykatës Supreme, Aktgjykimit nr. 741/2005 të Gjykatës së Qarkut, Aktgjykimit nr. 217/2004 të Gjykatës Komunale,* Gjykata më tutje arsyetoi se fakti se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të të drejtave dhe lirive kushtetuese. Për shkak të arsyeve

të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesve si të papranueshme.

Prishtinë, më 31 gusht 2012

Nr. ref.: 292/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 13/11

Parashtrues

Jeton Salihu dhe Mentor Salihu

Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, P.nr. 211/06 të 1 nëntor 2007, të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.nr. 48/2008, të datës 14 maj 2008 dhe të Akgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Pzd. nr. 118/2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Cukalovic, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare.

Parashtruesit

1. Parashtruesit janë Jeton Salihu dhe Mentor Salihu nga fshati Durar i komunës së Vushtrrisë, të përfaqësuar nga avokati i tyre Mahmut Halimi nga Mitrovica. Parashtruesit janë vëllezër.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës, P.nr. 211/06, të datës 1 nëntor 2007 dhe

Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Ap.nr. 48/2008, të datës 14 maj 2008.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës ka të bëjë me dënimin e parashtruesve për vrasje të Nexhat Mehollit të 31 dhjetorit 2005 dhe dëmtime të lehta trupore ndaj Berat Mehollit në po të njëjtën datë. Dënimi i parashtruesve kishte datën 1 nëntor 2007. Në të njëjtën datë babai I parashtruesve, Salih Salihu, ishte dënuar për dëmtime të lehta trupore ndaj Nexhat Meholli dhe Berat Meholli.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; nenin 20 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe Rregulli 56 (2) të Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 7 shkurt 2011, parashtruesit paraqitën një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

6. Më 15 shkurt 2011 Salih Salihu, babai i parashtruesve, përcjelli në Gjykatë dokumentet në lidhje me dënimin e tij.

7. Më 2 mars 2011, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese caktoi gjyqtaren Ilirana Islami gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodriguez dhe Kadri Kryeziu.

8. Me letrën e datës 11 korrik 2011, Gjykata kërkoi nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë informata që kanë të bëjnë me kërkesën. Gjykata e Qarkut në Mitrovicë u përgjigj më 19 korrik 2011, e cila përgjigje u pranua në Gjykatë më 22 korrik 2011.

9. Më 19 qershor 2012 Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit Raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përshkrimi i fakteve të rastit të evidentuara prej dokumenteve të ofruara nga parashtruesi

10. Më 1 nëntor 2007 Gjykata e Qarkut në Mitrovicë P.nr. 211/06 gjeti parashtruesin fajtor për vrasje sipas nenit 146 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe fajtor për sulm sipas nenit 153, par. 2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës. Gjykata dënoi parashtruesin Mentor Salihu me dënim të përgjithshëm prej dhjetë vjetësh e tre muajsh. Gjykata dënoi parashtruesin Jeton Salihu me një burgim të rëndë prej tetë vjetësh dhe dy muajsh. Babai i tyre gjithashtu ishte paraburgosur të njëjtën ditë për sulm.

11. Parashtruesit paraqitën ankesa të ndara për atë dënim në Gjykatën Supreme. Në ankesat e tyre parashtruesit pretendonin shkelje themelore të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe dënime tepër të rënda.

12. Më 14 prill 2008 Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Ap.nr. 48/2008 hodhi poshtë të dy ankesat si të pabazuara.

13. Më 10 nëntor 2008, një nga parashtruesit, Mentor Salihu, parashtroi një kërkesë për shqyrtim të procedurave penale në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë dhe propozoi që të mblidhen dhe të shqyrtohen fakte të reja. Parashtruesi bazoi këtë kërkesë fillimisht në pretendimin se Gjykata e Qarkut në Mitrovicë ka

bazuar aktgjykimin e vet në vendosjen e gabuar dhe jo të plotë të situatës faktike.

14. Më 27 dhjetor 2008 parashtruesit dorëzuan një kërkesë të bashkuar për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Kërkesa pretendonte shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurave penale, shkelje të ligjit penal dhe shkelje të nenit 157.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.
15. Më 3 shkurt 2009, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë në aktgjykimin Kp. Nr. 175/08 hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën e Mentor Salihut për shqyrtim të procedurës penale.

16. Më 20 maj 2010 Gjykata Supreme në aktgjykimin Pkl. Nr. 40/90 hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën e përbashkët për mbrojtjen e ligjshmërisë.

17. Më 14 dhjetor 2010 Gjykata Supreme në aktgjykimin Pzd. Nr. 118/2010 hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën e përbashkët të parashtruesve për zbutjen e jashtëzakonshme të ndëshkimit.

Shkeljet e pretenduara kushtetuese

18. Parashtruesit pretendojnë shkelje të nenit 24[Barazia para Ligjit], neni 30 [e Drejta e të Akuzuarit], neni 31 [e Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 6- e Drejta për Gjykim të Drejtë- të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut.

Argumentet ligjore të paraqitura nga parashtruesi

19. Parashtruesit pretendojnë se Gjykata e Qarkut në Mitrovicë ka shkelur Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, është përfshirë në vendosjen e gabuar dhe jo të plotë të situatës faktike, ka shkelur ligjin penal dhe ka shqiptuar dënime tepër të

rënda. Si rezultat parashtruesit pretendojnë se të drejtat e tyre Kushtetuese të garantuara me nenin 24, 30, dhe 31 të Kushtetutës ishin shkelur nga Gjykata e Qarkut e cila konfirmoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut. Fokusi i argumentit ligjor të parashtruesit është neni 157.1 i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës.

20. Në esencë, ata deklarojnë se dënimi i tyre ishte bazuar vetëm në dëshminë e Berat Mehollit dhe ata pohojnë se një gjykatë nuk mund të deklarojë një të akuzuar fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës

22. Neni 113 pika 1 dhe 7 i Kushtetutës vendos /rregullon kornizën ligjore të nevojshme për pranueshmëri. Përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *(...)*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi ti kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

23. Për më tepër, neni 48 i Ligjit thekson:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë."

24. Përfundimisht, Rregulli 36 i Rregullores së Punës thekson:

"1. Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

c)Kërkesa është qartazi e bazuar.

2. Gjykata mund të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:

a) Kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose
b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

c) kur Gjykata gjen se parashtruesi nuk është subjekt I ndonjë shkeljeje të së drejtave të garantuara me Kushtetutë, ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij;"

25. Siç u diskutua më sipër, parashtruesit pretendojnë se Gjykata e Qarkut në Mitrovicë ka bërë shkelje të ndryshme të procedurës penale dhe ligjit penal, dhe në veçanti fokusohet në nenin 157.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

26. I tërë neni 157 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës thotë si në vijim:

Neni 157

(1) Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie a një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale

(2) Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklarimit të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit publik (neni 156, paragrafi 1 i këtij Kodi).

(3) Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor vetëm ose duke i dhënë rëndësi vendimtare dëshmisë së dhënë nga një dëshmitar, identiteti i të cilit është i panjohur për mbrojtësin dhe të akuzuarin.

(4) Gjykata nuk e shpall personin fajtor vetëm mbi bazën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues (nenet 298 deri te 303 i këtij kodi)

27. Parashtruesit pretendojnë se ishin dënuar duke u bazuar vetëm në dëshminë e Berat Mehollit. Ata nuk ofrojnë ndonjë provë në kërkesën e tyre se ata ose avokatët e tyre nuk ishin në gjendje të marrin në pyetje Berat Mehollin ose në ndonjë mënyrë tjetër të kontestojnë dëshminë e tij gjatë rrjedhës së procedurës penale.

28. Në fakt, procesverbali nga gjykimi në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë të datës 4 qershor 2007, veçanërisht avokatit publik të palës mbrojtëse i është dhënë mundësia të marrë në pyetje Berat Mehollin dhe më tej është regjistruar marrja në pyetje e Berat Mehollit nga avokati mbrojtës.

29. Gjithashtu, në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Gjykata veçanërisht thekson se "Gjykata gjithashtu mori parasysh mbrojtjen e të akuzuarit" (në këtë rast deklaratat e

bëra nga parashtruesit e po ashtu edhe nga babai i tyre, për të cilat Gjykata konstaton se nuk ishin në përputhje).

30. Për më tepër, Gjykata Supreme në aktgjykimin e vet Pkl. Nr. 40/09, të datës 20 maj 2010, shqyrtoi këtë ankesë të veçantë të parashtruesve. Gjykata Supreme vërejti në veçanti se provat e shqyrtuara nga gjykata përfshinin provat e ekspertëve të dhëna në gjykim në lidhje me dëmtimet e shkaktuara ndaj të vdekurve. Gjykata Supreme konsideroi se këto prova mbështesnin dëshmitë e dëshmitarëve dhe prandaj nuk kishte shkelje të nenit 157 të Kodit Penal të Kosovës.

31. Parashtruesit nuk i kanë mbështetur pretendimet e tyre ashtu siç kërkohet me Ligj dhe me Rregullore.

32. Siç theksohet nga Gjykata Kushtetuese në rastin nr. KI 06/09, parashtruesi X kundër Aktgjykimit nr. 215/2006 të Gjykatës Supreme, Aktgjykimit nr. 741/2005 të Gjykatës së Qarkut, Aktgjykimit nr. 217/2004 të Gjykatës komunale:

> *". . . Gjykata dëshiron të theksojë se nuk është gjykatë e apelit për gjykatat tjera në Kosovë dhe nuk mund të intervenojë duke u bazuar në atë se gjykatat e tilla kanë dhënë vendime të gabuara ose kanë vlerësuar gabimisht faktet. Roli i Gjykatës është vetëm të sigurojë përputhjen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe instrumenteve tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si gjykatë e "shkallës së katërt" (shih mutatis mutandis, i.a., Akdivar v. Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D. 1996, R.J.D. 1996-IV, paragrafi 65)".*

33. Siç theksohet më tej në rastin nr. KI 06/09, parashtruesi X kundër Aktgjykimit nr. 215/2006 të Gjykatës Supreme, Aktgjykimit nr. 741/2005 të Gjykatës së Qarkut, Aktgjykimit nr. 217/2004 të Gjykatës komunale:

> *"Fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih mutatis mutandis aktgjykimi*

GJEDNJ apel. Nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

34. Prandaj kërkesa duhet të hidhet poshtë si e pabazuar sepse është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, Gjykata pas seancës së këshillimeve më 19 qershor 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'i komunikohet parashtruesit të kërkesës, dhe

III. Ky Vendim do të publikohet në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Prof. Dr. Enver Hasani

KI 125/10 datë 24 shtator 2012- Vlerësim kushtetues i vendimeve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, AC. Nr. 440/07, i 17 dhjetorit 2008, dhe të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. I. nr. 41/2008, i 13 gushtit 2010

Rasti KI 125/10, vendim i 31 gushtit 2012
Fjajët kyçe: largim nga puna, kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, shkelje e të drejtave dhe lirive individuale.

Parashtruesja paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat e saj ishin cenuar me vendimet e gjykatave të rregullta, me ç'rast parashtruesja pretendonte shkeljen e të drejatve të garantuara me Kushtetutë pa saktësuar ndonjë dispozitë kushtetuese në veçanti.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtrueses ishte qrtazi e pabazuar, sepse parashtruesja nuk kishte mbështetur me prova pohimet e saj, pra si dhe pse është kryer shkelja e pretenduar. Gjykata po ashtu theksoi se nuk vëren që procedurat përkatëse të zhvilluara në gjykatat e rregullta ishin arbitrare ose të padrejta. Duke cituar rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar* nga praktika e GJEDNJ-së, Gjykata më tutje arsyetoi se, si rregull i përgjthshëm, vlerësimi i fakteve është detyrë e gjykatave të rregullta. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtrueses si të papranueshme.

Prishtinë, më 31 gusht 2012

Nr. ref.: RK288/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rasti nr. KI 125/10

Parashtruesi

Sofije Grabovci

Vlerësim kushtetues i vendimeve

të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, AC. Nr. 440/07, i 17 dhjetorit 2008,

dhe

të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. I. nr. 41/2008, i 13 gushtit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është Sofije Grabovci nga Gjilani.

Vendimi i kontestuar dhe objekti i çështjes

2. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, AC. Nr. 440/07, i 17 dhjetorit 2008, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. I. nr. 41/2008, i 13 gushtit 2010.

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

4. Parashtruesja e parashtroi kërkesën në Sekretariatin e Gjykatës Kushtetuese më 13 dhjetor 2010.

5. Me urdhrin e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, të 16 dhjetorit 2010, gjyqtari Altay Suroy u caktua Gjyqtar raportues. Kryetari e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami.

Përmbledhja e fakteve siç pohohen nga parashtruesi

6. Parashtruesja filloi të punonte në atë që tani quhet Raiffeisen Bank më 14 tetor 2002. Ajo tha që banka kishte kërkuar që ajo të jepte dorëheqje për shkak të parregullsive që u dolën nga një auditim i kryer nga banka më 20 maj 2005. Ajo pohon që nënshkroi dorëheqjen gjersa vuante nga një gjendje mjekësore që mund të ketë shkaktuar që ajo të lëngonte nga "çrregullimi i kujtesës dhe tkurrja e vetëdijes". Parashtruesja ishte në pushim mjekësor dhe ishte e hospitalizuar prej 17 janarit 2005 deri më 28 janar 2005. Bashkëshorti i saj e dorëzoi dorëheqjen e saj me shkrim në bankë më 21 maj 2005.

7. Më pas, parashtruesja konkurroi në bankë që të lejohej të kthehej në punë. Banka iu përgjigj me një letër më 31 gusht 2006, se kërkesa e saj për t'u kthyer në punë nuk ishte pranuar. Banka theksoi se një çështje, që ishte zbuluar dhe hetuar nga auditorët e brendshëm të bankës, konsiderohej shpërdorim i rëndë i detyrës zyrtare dhe që qëndronte prapa konkluzioneve të auditorëve.

8. Parashtruesja inicioi procedurë kundër Raiffeisen Bankës pranë Gjykatës Komunale në Gjilan në vitin 2006, e cila vendosi në favor të saj më 3 shtator 2007. Gjykata Komunale konstatoi që asaj i ishte kërkuar të jepte dorëheqje dhe se ajo dha dorëheqje gjersa ishte në gjendje të rëndë shëndetësore si rrjedhojë e të cilës ajo nuk mund ta kontrollonte sjelljen e vet. Gjykata "pjesërisht i besoi" deklaratës së përfaqësuesit të bankës, i cili tha se asnjë procedurë disiplinore nuk ishte iniciuar kundër parashtrueses për shkak se ajo e kishte ofruar dorëheqjen e vet. Gjykata në mënyrë implicite pranoi që asaj i ishte kërkuar të jepte dorëheqje.

9. Sipas ankesës, Gjykata e Qarkut në Gjilan e anuloi Vendimin e Gjykatës Komunale dhe konstatoi se parashtruesja kishte dhënë dorëheqje vullnetarisht. Ky arsyetim u pranua më pas nga Gjykata Supreme në vendimin e saj të 13 gushtit 2010, në favor të bankës.

10. Parashtruesja e parashtroi një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese më 13 dhjetor 2010 dhe i bashkëngjiti kopjet e të gjitha

vendimeve të gjykatave të përmendura bashkë me një sërë dokumentesh dhe raportesh mjekësore. Kërkesa, pa e cekur në mënyrë specifike, duket të jetë kërkesë për anulimin e vendimit përfundimtar të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 13 gushtit 2010.

11. Në kërkesë nuk ceket se si janë shkelur të drejtat e saj kushtetuese me vendimin e Gjykatës Supreme, të 13 gushtit 2010. As parashtruesja nuk tregon si ajo gjykatë ka vepruar në mënyrë arbitrare, si nuk i ka marrë parasysh faktet përkatëse, dhe si ka vepruar jashtë kompetencave të veta. Ajo nuk tregon si i ishte mohuar gjykimi i drejtë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

12. Për të gjykuar për kërkesën e parashtrueses, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

13. Njëri prej kritereve është se parashtruesi nuk mund të ankohet që gjykatat e rregullta kanë bërë lajthim të fakteve ose të ligjit, vetëm dhe nëse ato mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.

14. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese thekson se nuk duhet të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt kur i shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Gjykatat e rregullta kanë për detyrë t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese në Rastin Nr. KI 13/09, Sevdail Avdyli, të 17 qershorit 2010, dhe *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës (GC), nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut 1999-I).

15. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse dëshmitë janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi nuk ka pasur gjykim të drejtë (shih, p.sh., Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, App. Nr. 13071/87, të miratuar më 10 korrik 1991). Prandaj, Gjykata konkludon që kërkesa duhet të hidhet poshtë si, qartazi, e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregullit 56 (2) të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Altay Suroy Prof. Dr. Enver Hasani

KI 151/11 datë 24 shtator 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjilan, C. nr. 494/06, të 11 prillit 2007; Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Ac. nr. 219/07, të 11 shtatorit 2009; dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr. 1120/83, të 19 janarit 1984

Rasti KI 151/11, vendim i 31 gushtit 2012
Fjalët kyçe: e drejta në prone, kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, shkelje e të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat e tij kushtetuese ishin cenuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, me ç'rast parashtruesit nuk i ishte njohur e drejtat e pronësisë në bazë të shtimit dhe mbajtjes. Parashtruesi pohoi se Gjykata Supreme kishte shkelur nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk kishte mbështetur me prova pohimet e tij, pra si dhe pse është kryer shkelja e pretenduar. Gjykata po ashtu theksoi se nuk vëren që procedurat përkatëse të zhvilluara në gjykatat e rregullta ishin arbitrare ose të padrejta. Duke cituar rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar* nga praktika e GJEDNJ-së, Gjykata më tutje arsyetoi se, si rregull i përgjthshëm, vlerësimi i fakteve është detyrë e gjykatave të rregullta. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit.

Prishtinë, më 31 gusht 2012

Nr. ref.: RK289/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 151/11

Parashtruesi

Sahit Emini

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjilan, C. nr. 494/06, të 11 prillit 2007; Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Ac. nr. 219/07, të 11 shtatorit 2009; dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr. 1120/83, të 19 janarit 1984

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar,

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Sahit Emini, nga Gjilani. Atë e përfaqëson avokati Avdullah Ismajli, rr. S. Brestovci nr. 15, Gjilan.

Objekti i çështjes

2. Objekti i çështjes së kërkesës ka të bëjë me pronësinë e një ngastre kadastrale në Qeremindane, Gjilan, që del nga ndryshimi i rrjedhës së një lumi në vitin 1962. Gjykata Supreme e Kosovës në fund vendosi kundër parashtruesit në aktgjykimin e vet të 5 shtatorit 2011.

3. Parashtruesi pohon që i janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 14 nëntor 2011, avokati i dërgoi një shkresë Gjykatës, në emër të parashtruesit, lidhur me një kërkesë të propozuar. Më 14 nëntor 2011, Gjykata kërkoi nga parashtruesi që ta plotësonte formularin e kërkesës.

6. Më 23 nëntor 2011, parashtruesi e dorëzoi kërkesën e plotësuar në Gjykatën Kushtetuese.

7. Më 17 janar 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Iliriana Islami.

8. Më 18 qershor 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e përgatitur nga Gjyqtarja raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri. Gjykata në përbërje të plotë e shqyrtoi kërkesën të njëjtën datë.

Përmbledhje e fakteve të rastit të evidentuara nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi

9. Në vitin 1962, lumi që lidh pronën e parashtruesit dhe të babait të tij në Qeremindane, Gjilan, e ndërroi rrjedhën dhe "mori" pronën e parashtruesit. Parashtruesi pohon që shtrati i vjetër i lumit ishte mbushur dhe shndërruar në pronë të tyre.

10. Parashtruesi filloi procedurën në Gjykatën Komunale në Gjilan duke kërkuar që t'i njihet e drejta e pronësisë në bazë të shtimit dhe mbajtjes së patundshmërisë. Komuna e Gjilanit ishte e paditura në këtë procedurë. Një shqyrtim u mbajt më 11 tetor 2005 dhe më 24 janar 2006. Gjykata mori parasysh raportet e ekspertëve të gjeodezisë. U bë edhe vëzhgimi i vendit të ngjarjes. Dëshmitarët u dëgjuan gjatë këtij shqyrtimi.

11. Në Aktgjykimin e vet C. nr. 76/04, të 24 janarit 2006, gjykata konkludoi që padia ishte e pabazuar sepse parashtruesi dështoi të ofronte prova përkatëse që e dëshmonin të drejtën e tij për njohje të pronës shoqërore. Gjykata gjeti që Ligji përkatës mbi

Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike nuk lejonte që e drejta e pronësisë të fitohej në pronësinë shoqërore në bazë të parashkrimit fitues.

12. Parashtruesi ushtroi ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, e cila, me Aktgjykimin e vet V. nr. 494/06, e anuloi vendimin e Gjykatës Komunale dhe e ktheu rastin për rigjykim. Ai shtoi edhe të paditur të tjerë në procedurë.

13. Në rishqyrtimin e mbajtur më 11 prill 2007, Gjykata Komunale në Gjilan me Aktgjykimin C. nr. 494/06 përsëri e refuzoi ankesën e parashtruesit. Në këtë shqyrtim u dëgjuan prova gjithëpërfshirëse nga dëshmitarët dhe ekspertët e gjeodezisë, të cilët kishin përgatitur raporte të reja.

14. Parashtruesi u ankua në Gjykatën e Qarkut, e cila, me Aktgjykimin Ac. nr. 218/07, të 11 shtatorit 2007, e refuzoi ankesën e parashtruesit.

15. Parashtruesi ushtroi ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme të Kosovës. Më 5 shtator 2011, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Rev. nr. 42/2008 me të cilin e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit.

Pretendimet e parashtruesit

16. Parashtruesi pohon, ndër të tjera, që Gjykata Komunale në shqyrtimin e dytë nuk e kishte bërë vëzhgimin e vendit të ngjarjes, që gjykatat nuk kishin dhënë arsye të plota për aktgjykimet e veta dhe që kishte pasur vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

17. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.

18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

19. Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është Gjykatë e faktit, Gjykata Kushtetuese dëshiron të theksojë se vërtetimi i drejtë dhe i plotë gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt", (*shih, mutatis mutandis, ndër të tjera, Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R. J. D, 1996-IV, para. 65; shih, gjithashtu, Aktvendimin për Papranueshmëri në Rastin Nr. KI-86/11 – Parashtrues i kërkesës Milaim Berisha – Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 20/09, të 1 marsit 2011 – të nxjerrë nga Gjykata më 5 prill 2012*).

20. Nga faktet e paraqitura së bashku me kërkesën shihet që parashtruesi i kërkesës i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe që gjykatat e rregullta i kanë marrë parasysh të gjitha provat e paraqitura nga parashtruesi dhe i kanë dëgjuar dëshmitarët e propozuar nga të gjitha palët në procedurë. Arsyet ishin dhënë për vendimet e marra. Në të vërtetë, Gjykata Komunale në aktgjykimin e vet të 11 prillit 2007 i dha arsyet e veta për mospranimin e provave të një dëshmitari të thirrur në emër të parashtruesit

21. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk e ka mbështetur me prova pohimin e tij për të sqaruar si dhe pse është bërë shkelja, dhe nuk ka ofruar prova për të dëshmuar se është shkelur e drejta e garantuar me Kushtetutë.

22. Përveç kësaj, kërkesa nuk tregon që Gjykatat kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave që t'i vlerësojnë provat që i kanë përpara. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (*shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, Kërkesa Nr. 13071/87, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, para. 34, e 10 korrikut 1991*).

23. Fakti që parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës (*shih, mutatis mutandis, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, Kërkesa Nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005*).

24. Në këto rrethana, parashtruesi nuk e ka mbështetur me prova pretendimin e tij për shkeljen e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës], sepse faktet e paraqitura nga ai nuk tregojnë në asnjë mënyrë që gjykatat e rregullta, të të tri shkallëve, ia kanë mohuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 18 qershor 2012, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 81/10 datë 24 shtator 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. I. Nr. 363/09 të datës 6 maj 2010

Rasti KI 81/10, vendim i 5 shtatorit 2012
Fjalët kyçe: e drejta në punë, kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, shkelje e të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat e tij ishin cenuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, me ç'rast ishte vërtetuar vendimi i komunës së Kaçanikut për mos përtëritjen e kontratës së parashtruesit si teknik dhëmbësh.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte qartazi e pabazuar, sepse nuk kishte ndonjë provë që tregonte se procedurat e zhvilluara para gjykatave të rregullta ishin të padrejta ose të njollosura nga arbitrariteti. Duke cituar rastin *Vanek kundër Sllovakisë*, nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, Gjykata theksoi se parashtruesi nuk kishte ofruar ndonjë provë *prima facie* që tregon shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Gjykata më tutje arsyetoi se, si rregull i përgjithshëm, vlerësimi i fakteve është detyrë e gjykatave të rregullta. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme.

Prishtinë, 05 shtator 2012

Nr. Ref.: RK293/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rasti nr. KI 81/10

Parashtruesi

Nazif Reka

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. I. Nr. 363/09 të datës 6 maj 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi

1. Parashtrues është Ramadan Rrahmani nga Fushë Kosova, Prishtinë. Parashtruesi nuk është i përfaqësuar.

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes së kërkesës është padia e parashtruesit se Vendimi i Gjykatës Supreme të 6 majit 2010 ka shkelur të drejtën e tij kushtetuese për punë. Ai pretendon se është emëruar që të punojë si teknik dhëmbësh në Komunën e Kaçanikut.

Vendimi i Kontestuar

3. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. I. nr. 363/09, të datës 6 maj 2010.

Baza juridike

4. Kërkesa është parashtruar në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit Nr. 03/ L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës se Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës)

Procedura në Gjykatë

5. Më 3 shtator 2010, parashtruesi dorëzoi një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

6. Më pas, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese emëroi Gjyqtar raportues gjyqtaren Iliriana Islami, dhe Kolegjin Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Snezhana Botusharova.

7. Më 10 korrik 2012, Kryetari zëvendësoi gjyqtaren Iliriana Islami, mandati i së cilës si gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese ka mbaruar, me gjyqtarin Ivan Ćukalović si Gjyqtar Raportues.

8. Më 11 korrik 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi Raportin Paraprak të Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve të rastit

9. Parashtruesi ka qenë i punësuar si teknik dhëmbësh në Komunën e e Kaçanikut në bazë të një kontrate të punësimit. Me Vendimin e Komunës të datës 20 shkurt 2007, punësimi i tij si teknik dhëmbësh u ndërpre dhe atij iu ofruan tri pozita alternative; asistent dentar, nëpunës në sistemin operativ të informimit dhe vozitës. Pozicioni fillestar si teknik dhëmbësh ishte hapur si pjesë e një vendimi për të mbyllur 27 vende pune në Komunën e Kaçanikut. Parashtruesi refuzoi pozitat alternative sepse ai konsideronte se nuk i përgjigjeshin kualifikimeve të tij profesionale.

10. Kontrata e parashtruesit si teknik dhëmbësh kishte mbarua më 31 dhjetor 2006 dhe nuk ishte përtërirë. Komuna megjithatë e mbajti të punësuarin e vet dhe e pagoi për tre muaj të vitit 2007 derisa ai përfundimisht u hoq nga lista e pagave në prill të vitit 2007.

11. Parashtruesi u ankua në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës (KPM) dhe pjesërisht pati sukses në kuptimin që KPM-ja vendosi më 9 tetor 2007 që Komisioni i Ankesave brenda Komunës së Kaçanikut nuk ishte i kompletuar.

12. Më 9 tetor 2007 Komisioni i Ankesave në Komunë konstatoi se Parashtruesi duhet të mbahet në punë si teknik dhëmbësh. Ky Vendim nuk ishte zbatuar nga Komuna.

13. Më pas Parashtruesi inicioi procedurë në Gjykatën Komunale në Kaçanik ku ai kërkoi që të kthehej në vendin e punës. Ai ishte i suksesshëm në Gjykatën Komunale si dhe në Gjykatën e Qarkut dhe të Apelit në Prishtinë. Megjithatë, Komuna paraqiti ankesë në Gjykatën Supreme e cila vendosi në favor të Komunës.

14. Gjykata Supreme gjeti se Gjykata Komunale dhe Gjykata e Qarkut gabimisht kishin vendosur në favor të parashtruesit të kërkesës. Gjykata Supreme theksoi se Parashtruesi i kërkesës kishte kontratë pune vetëm deri më 31 dhjetor 2006, megjithëse Komuna e kishte vazhduar kontratën edhe për tre muaj shtesë në shenjë të vullnetit të mirë. Neni 35(1) (b) i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2003/02, NË ZBATIM TË RREGULLORES SË UNMIK-UT NR. 2001/36 PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS, parashihte që "punësimi në shërbimin civil përfundon automatikisht pas skadimit të kontratës së punësimit të nëpunësit civil".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

15. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

16. Gjykata Kushtetuese rithekson se rithekson se në bazë të Kushtetutës nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës se katërt, lidhur me vendimet e nxjerra

nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave te rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për te Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

17. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe procedurat pranë gjykatave të rregullta në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).

18. Në rastin konkret , parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të mjaftueshme për ta paraqitur rastin dhe për ta kontestuar interpretimin e ligjit për të cilin ai konsideron se është i gabueshëm, pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe pranë Gjykatës Supreme. Pas shqyrtimit të që të dy procedurave administrative në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk gjen se procedurat relevante ishin në ndonjë mënyrë të padrejta ose të njollosura nga arbitrariteti (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06 të 30 qershorit 2009).

19. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar prova *prima facie* që do të tregonte për shkelje të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë (shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99 të 31 majit 2005).

20. Kërkesa rrjedhimisht duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, dhe në pajtim nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 11 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'i komunikohet parashtruesit; dhe

III. Ky Vendim do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Prof. Dr. Enver Hasani

KI 89/10 datë 24 shtator 2012- Vlerësimi kushtetues i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr. 68/2008, të datës 14 shtator 2010

Rasti KI 89/10, vendim i 5 shtator 2012
Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë haptazi e pabazuar, ndërprerje e marrëdhënies së punës, procedurë diciplinore, shkelje e të drejtave dhe lirive individuale.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat e tij ishin cenuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme, me ç'rast ishte vërtetuar vendimi i komisionit diciplinor të Korporatës Energjetike të Kosovës për largim të parashtruesit nga puna.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk kishte mbështetur me prova pohimet e tij, pra si dhe pse është kryer shkelja e pretenduar. Gjykata po ashtu theksoi se nuk vëren që procedurat përkatëse të zhvilluara në gjykatat e rregullta ishin arbitrare ose të padrejta. Duke cituar rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar* nga praktika e GJEDNJ-së, Gjykata më tutje arsyetoi se, si rregull i përgjthshëm, vlerësimi i fakteve është detyrë e gjykatave të rregullta. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

Prishtinë, më 05 shtator 2012

Nr. ref.: RK294/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rasti nr. KI 89/10

Parashtruesi

Mehdi Sopjani

Vlerësimi kushtetues i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr. 68/2008, të datës 14 shtator 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi

1. Parashtruesi është Mehdi Sopjani nga Prishtina dhe ai nuk është i përfaqësuar.

Objekti i çështjes

2. Objekti i çështjes së kërkesës ka të bëjë me kontestin për ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit të parashtruesit me Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK). Gjykata Supreme e Kosovës përfundimisht ka vendosur kundër parashtruesit në Aktgjykimin e vet të 14 shtatorit 2010.

Baza juridike

3. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe Rregulli 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në gjykatë

4. Më 27 shtator 2010 parashtruesi parashtroi një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

5. Me letrën e datës 9 nëntor 2010 Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme lidhur me kërkesën e paraqitur.

6. Më 14 dhjetor 2010, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese caktoi gjyqtaren Iliriana Islami, Gjyqtare raportuese, dhe Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodriguez (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Gjyljeta Mushkolaj.

7. Më 2 korrik 2012 Kryetari zëvendësoi gjyqtaren Iliriana Islami, mandati i së cilës si gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese ka mbaruar, me gjyqtarin Altay Suroy si gjyqtar Raportues.

8. Më 10 korrik 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi Raportin paraprak të Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve të rastit të evidentuara nga dokumentet e paraqitura nga parashtruesi

9. Më 9 mars 2002, parashtruesi pretendohet të jetë gjetur me një tel bakri të vjedhur në veturën e tij private derisa ishte i punësuar në KEK. Pasoi një procedurë disiplinore e cila çoi në suspendimin e tij dhe përfundimisht deri në vendimin, të datës 4 qershor 2002, për ta larguar nga KEK-u. Parashtruesi u ankua kundër këtij vendimi në Bordin Ekzekutiv të KEK-ut i cili me vendimin e datës 7 gusht 2002, nuk gjeti elemente për të anuluar vendimin për largimin e tij.

10. Pas largimit të tij janë iniciuar procedurat juridike nga parashtruesi. Kjo çoi përfundimisht në një numër të konsiderueshëm të Vendimeve gjyqësore. Ato të cilat bëjnë bazën e kërkesës së parashtruesit janë si në vijim: e para, nga Gjykata Komunale në Prishtinë, C1. nr. 179/2002, të datës 10 mars 2004 që vendosi në favor të parashtruesit; e dyta, KEKU-u u ankua në këtë vendim në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, e cila me anë të Vendimit AC.nr. 484/2004, po ashtu vendosi në favor të parashtruesit dhe përfundimisht Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr. 38/2008 i datës 9 korrik 2010.

11. Në vendimin e Gjykatës Supreme pretendimet e parashtruesit u hodhën poshtë, dhe Aktgjykimi u nxor në favor të KEK-ut. Gjykata Supreme deklaroi theksoi se qëndrimi i gjykatave më të ulëta paraqiste zbatimin e gabuar të ligjit material.

12. Punëdhënësi gjithnjë mbante qëndrim se ishte arsyetuar në ndërprerjen e punësimit të parashtruesit sepse ai ishte gjetur duke vjedhur pasurinë e KEK-ut. Ata mbështeten në nenin 11.3 (b) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/27 në Ligjin Themelor të Punës në Kosovë i cili në pjesën kryesore thekson si në vijim:

"Neni 11
Shkëputja e kontratës së punës

11.1 Kontrata e punës shkëputet:

(a) me rastin e vdekjes së punonjësit;
(b) me marrëveshje me shkrim ndërmjet punonjësit dhe punëdhënësit;
(c) në rastet e rënda të sjelljes së keqe nga punonjësi;
(d) për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës nga ana e punonjësit;
(e)me skadimin e kohëzgjatjes së punësimit, dhe
(f) sipas fuqisë ligjore..

11.2 Kontrata e punës mund të shkëputet nga punëdhënësi në rastet e rënda të sjelljes së keqe ose të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës nga punonjësi.

11.3 Raste të rënda të sjelljes së keqe paraqesin:
(a) kundërshtimi i paarsyetuar për kryerjen e detyrave të përcaktuara në kontratën e punës;
(b) vjedhja, shkatërrimi, dëmtimi ose shfrytëzimi i paautorizuar i pasurisë së punëdhënësit;
(c) zbulimi i fshehtësive afariste;
(d) përdorimi i drogave dhe i alkoolit në punë, dhe
(e) sjellja e natyrës tepër të rëndë pas së cilës do të ishte e paarsyeshme që të pritet vazhdimi i marrëdhënies së punës më tej.

13. Gjykata Supreme gjithashtu theksoi se Rregullorja e brendshme e KEK-ut parasheh vjedhjen si një rast serioz të sjelljes së keqe të punëtorëve. Ajo Gjykatë përcaktoi se vendimi i KEK-ut për të ndërprerë marrëdhënien e punës ishte i drejtë dhe ligjor në dritën e dispozitave ligjore të lartpërmendura.

Pretendimet e parashtruesit

14. Parashtruesi nuk specifikon në kërkesën e tij cilat dispozita konkrete të Kushtetutës së Kosovës ai pretendon të jenë shkelur. Parashtruesi në mënyrë të përgjithshme ankohet që Gjykata Supreme ka hedhur poshtë pretendimin e parashtruesit ndaj ankesës së punëdhënësit të tij, KEK-ut, dhe ofroi vetëm arsye sipërfaqësore dhe jo të bindshme. Pastaj ai konsideroi se Gjykata Kushtetuese duhet të vendosë në favorin e tij për shkak të shkeljes së ligjit të aplikueshëm.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

15. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

16. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton se:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruara të gjitha mjetet të përcaktuara me ligj".*

17. Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është gjykatë e verifikimit të fakteve, dhe me këtë rast dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (shih, *mutatis mutandi*s, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996,R. J, 1996–IV, paragrafi 65, poashtu shih

Aktvendimi për papranueshmëri në rastin nr. KI 86/11- parashtrues Milaim Berisha- kërkesa për vlerësimin kushtetues të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 20/09, të datës 1.3.2011- i nxjerrë nga Gjykata më 5 prill 2012).

18. Nga faktet e bashkëngjitura me kërkesën, parashtruesi ka përdorur të gjitha mjetet ligjore në dispozicion, dhe gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh të gjitha provat e paraqitura. Ishin dhënë arsyet për Vendimet që ishin marrë. Në të vërtetë, Gjykata Supreme në Aktgjykimin e vet të 9 korrikut 2010, ka dhënë arsyet e qarta pse nuk ka pranuar pretendimin e parashtruesit dhe ka cituar ligjin e aplikueshëm dhe duket se ka aplikuar atë ligj në një mënyrë që ka favorizuar punëdhënësin në vend se të favorizonte parashtruesin. Gjykata Kushtetuese nuk mund të gjejë ndonjë të metë në arsyetimin e Gjykatës Supreme në lidhje me këtë.

19. Në këtë drejtim parashtruesi nuk e ka mbështetur kërkesën e tij, për të sqaruar si dhe pse është bërë një shkelje, ose nuk ka ofruar prova për të dëshmuar se një e drejtë e garantuar me Kushtetutë është shkelur.

20. Për më tepër, kërkesa nuk tregon se Gjykatat kanë vepruar në ndonjë mënyrë arbitrare ose të padrejtë. Nuk është brenda kompetencave të Gjykatës Kushtetuese të zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta,dhe, si rregull e përgjithshme, është detyrë e këtyre gjykatave të vlerësojnë provat para tyre. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të konstatojë nëse procedurat e gjykatave të rregullta ishin të drejta në tërësinë e tyre duke përfshirë edhe mënyrën si janë marrë provat (shih, Aktgjykimi GJEDNJ Kërkesa nr. 13071/87 Eduards kundër Mbretërisë së Bashkuar, paragrafi 34, i 20 korrikut 19991).

21. Fakti se parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund t'i shërbejë si e drejtë për të ngritur një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih *mutatis mutandis* GJEDNJ kërkesa nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

22. Në këto rrethana, parashtruesi nuk e ka mbështetur pretendimin e tij sepse faktet e paraqitura prej tij nuk tregojnë në asnjë mënyrë se Gjykata Supreme i ka mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'i komunikohet parashtruesit; dhe

III. Ky Vendim do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Altay Suroy Prof. Dr. Enver Hasani

KI 131/10 datë 24 shtator 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatë Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, P. nr. 46/2001, të 8 tetorit 2001; Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. nr. 14/2002, të 27 qershorit 2002, dhe API. nr. 3/'07, të 23 nëntorit 2007; dhe Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pr. nr. 20/2010, të 11 marsit 2010

Rasti KI 131/10, vendim i 6 shtatorit 2012
Fjalët kyçe: kërkesë individuale, kërkesë e paaftshme, gjykim i drejtë dhe i paanshëm, shkelje e lirive dhe të drejtave individuale.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat e tij kushtetuese ishin cenuar me vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, me ç'rast parashtruesi pretendonte se gjykimi dhe dënimi i tij me burgim ishte i padrejtë dhe kundër kushtetues.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte e paaftshme sepse nuk ishte dorëzuar në pajtim me afatin ligjor të paraparë me Nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Gjykata theksoi se edhe nëse kërkesa do të ishte dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar me Nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ajo do të hedhej poshtë si e papranueshme për shkak se procedurat në gjykatat e rregullta nuk ishin të padrejta apo të karakterizuara nga arbitrariteti. Duke cituar rastin Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë nga praktika e GJEDNJ-së, Gjykata më tutje arsyetoi se fakti që parashtruesit janë të pakënaqur me rezultain përfundimtar të rastit të tyre nuk nënkupton shkeljen e të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë si të papranueshme kërkesën e parashtruesit.

Prishtinë, më 06 shtator 2012

Nr. ref.: RK295/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 131/10

Parashtruesi

Fatbardh Gabraj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, P. nr. 46/2001, të 8 tetorit 2001; Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. nr. 14/2002, të 27 qershorit 2002, dhe API. nr. 3/'07, të 23 nëntorit 2007; dhe Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pr. nr. 20/2010, të 11 marsit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Fatbardh Gabraj, nga Bajram Curri në Shqipëri, dhe tani është duke vuajtur dënimin në burgun e Dubravës në Istog.

Vendimet e kontestuara

2. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, P. nr. 46/2001, i 8 tetorit 2001; Aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. nr. 14/2002, i 27 qershorit 2002, dhe API. nr. 3/'07, i 23 nëntorit 2007; dhe Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pr. nr. 20/2010, i 11 marsit 2010.

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është pretendimi, nga parashtruesi, se gjykimi dhe dënimi i tij për vrasje ishte i padrejtë dhe i paligjshëm dhe se i ishin shkelur të drejtat kushtetuese.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) më 28 dhjetor 2010.

6. Më 28 janar 2011, parashtruesi u njoftua për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, kërkesa iu komunikua Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe Gjykatës Supreme të Kosovës.

7. Gjykata e Qarkut në Pejë u përgjigj më 2 shkurt 2011.

8. Më 14 shkurt 2011 Kryetari, me Urdhrin Nr. GJR. KI-131/10, e caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari, me Urdhrin Nr. KSH. KI-131/10, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Almiro Rodrigues.

9. Më 19 qershor 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përshkrim i fakteve të rastit të evidentuara nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi

10. Më ose rreth 10 nëntorit 2000, në rrugën Pejë-Istog, pranë fshatit Arbëresh të Vitomiricës, afër shkollës fillore "7 Shtatori", parashtruesi bashkë me dy bashkë-ekzekutorët e tjerë, Sh.B. dhe G.L., të armatosur me pushkë automatike dhe granata dore, vozitën pranë V.E. dhe G.E. dhe qëlluan me armë mbi ta, ndërsa këta të fundit ishin duke vozitur në drejtim të Istogut me

një veturë (Golf i kuq), duke plagosur për vdekje V.E., i cili vdiq më pas nga plagët e plumbave.

11. Më 2 maj 2001, prokurori publik i qarkut në Pejë ngriti Aktakuzën PP. nr. 184/2000 kundër parashtruesit dhe Sh.B. (G.L., që gjithashtu ishte i përfshirë në sulmin kundër palës së dëmtuar, kishte vdekur nga plagët e marra pas përplasjes së veturës).

12. Më 8 tetor 2001, pas aktakuzës dhe gjykimit pasues, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktgjykimin P. nr. 46/2001, i shpalli fajtorë parashtruesin dhe Sh.B. dhe i dënoi me nga shtatëmbëdhjetë (17) vjet burg. Parashtruesi u dënua për shkak të vrasjes së V.E. dhe tentim vrasjes së G.E., A.E. dhe I.E.

13. Më 27 qershor 2002, pas miratimit të ankesës së prokurorit publik të qarkut në Pejë dhe pjesërisht për shkak të ankesës së mbrojtësit të parashtruesit dhe Sh.B. (bashkëpunëtori), Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Ap. nr. 14/2002, e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, P. nr. 46/2001, të 8 tetorit 2001, sa i përket cilësimit juridik të veprave të të akuzuarve dhe vendimit për dënim.

14. Pas ndryshimeve të bëra në Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, P. nr. 46/2001, të 8 tetorit 2001, Gjykata Supreme e Kosovës i dënoi parashtruesin dhe Sh.B. me nga 22 (njëzetedy) vjet burg, duke llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim.

15. Më 23 nëntor 2007, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin API. nr. 3/07, e refuzoi ankesën e parashtruesit dhe të Sh.B. si të pabazuar, dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, P. nr. 46/2001, të 8 tetorit 2001, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, AP. nr. 14/2002, të 27 qershorit 2002.

16. Më 11 mars 2010, Gjykata Supreme e Kosovës, me Vendimin P. nr. 20/2010, e refuzoi si të pabazuar ankesën e përbashkët të të

dënuarve të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, P. nr. 46/2001, të 8 tetorit 2001.

Shkeljet e supozuara të Kushtetutës

17. Parashtruesi pohon për shkelje të nenit 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës.

Argumentet ligjore të paraqitura nga parashtruesi

18. Parashtruesi pohon që dispozitat e sipërpërmendura kushtetuese ishin shkelur në dëm të tij sepse gjoja ishte rrahur deri në alivanosje nga anëtarët e familjes së palës së dëmtuar. Ai më tej pohon që prokurori publik i qarkut në Pejë veproi në mënyrë jokushtetuese, sepse hetimet e zhvilluara kundër tij ishin gjoja tendencioze, të njëanshme dhe të motivuara politikisht, dhe se aktakuza kundër tij ishte e bazuar në prova jobindëse dhe deklarata të rrejshme të palës së dëmtuar. Ai gjithashtu pohon që Gjykata e Qarkut në Pejë dhe Gjykata Supreme e Kosovës gabimisht e shpallën fajtor për vrasje dhe tentim vrasje ndërsa ai është i pafajshëm.

19. Parashtruesi propozon që Gjykata ta nxjerrë një vendim me ç'rast Gjykata do të konstatonte shkelje të dispozitave kushtetuese nga Gjykata e Qarkut në Pejë dhe Gjykata Supreme e Kosovës dhe do t'i anulonte vendimet e sipërpërmendura dhe do t'ia kthente këtë rast penal gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe në Rregullore të punës.

21. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili thotë:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".*

22. Nga parashtresat shihet që kërkesa është parashtruar më 28 dhjetor 2010 dhe se parashtruesit i është dorëzuar vendimi i gjykatës së shkallës së fundit më 11 mars 2010, që do të thotë se kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit.

23. Rezulton që kërkesa është e paafatshme.

24. Edhe po të supozohet që kërkesa me të vërtetë ishte parashtruar brenda afatit kohor të paraparë me nenin 49 të Ligjit, Gjykata Kushtetuese dëshiron të theksojë se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i gjykatave të rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (shih*, mutatis mutandis,* ndër të tjera, Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R. J. D, 1996-IV, para. 65; shih, gjithashtu, Aktvendimin për Papranueshmëri në Rastin Nr. KI-86/11 – Parashtrues i kërkesës Milaim Berisha – Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 20/09, të 1 marsit 2011 – të nxjerrë nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës më 5 prill 2012).

25. Nga faktet e paraqitura së bashku me kërkesën shihet që parashtruesi i kërkesës i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe që gjykatat e rregullta i kanë marrë parasysh dhe iu kanë përgjigjur ankesave të tij në lidhje me procedurën paraprake dhe gjykimin kryesor, pranimin e provave dhe vërtetësinë e tyre, dhe vërtetimin e gjendjes faktike. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se gjykatave, gjatë dëgjimit të rastit, u mungonte paanshmëria apo që procedurat ishin të padrejta.

26. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk e ka mbështetur me prova pohimin e tij për të sqaruar si dhe pse është bërë shkelja, dhe nuk ka ofruar prova për të dëshmuar se është shkelur e drejta e garantuar me Kushtetutë.

27. Fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis,* Aktgjykimin e GJEDNJ-së, Kërkesa Nr. *5503/02,* Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

28. Për këto arsye, kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 19 qershor 2012, në pajtim me nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Robert Carolan	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 56/12 datë 28 shtator 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ka. nr. 417/11, të 23 marsit 2012

Rasti KI 56/12, Aktvendim për Papranueshmëri të 19 shtatorit 2012
Fjalët kyçe: kërkesë individuale, masë e përkohshme, qartazi e pabazuar, mos-shterja, prokurori publike, e drejta për të ballafaquar dëshmitarët, shkelje e parimit të supozimit të pafajësisë, shkelja e të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesit e kërkesës, z. Shkelqim Devolli, Blerim Devolli dhe Ismet Bojku, e parashtruan kërkesën e tyre bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke e kontestuar vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ka. nr. 417/11, të 23 marsit 2012, me pretendim se ishte marrë në kundërshtim me të drejtat e tyre të garantuara me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ, sepse parashtruesit nuk kanë mundur ta ballafaqojnë një nga dëshmitarët kyç të Prokurorisë, mbrojtja ka ofruar mjaft argumente që dëshmon pafajësinë e parashtruesve si dhe Zyra e Prokurorit i ka kontribuuar fushatës publike kundër parashtruesve. Për më tepër, parashtruesit kërkuan nga Gjykata që të caktojë masën e përkohshme

Sa i përket pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata vendosi se kërkesa ishte e pabazuar, sepse parashtruesit nuk kishin dorëzuar dëshmi se procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare. Prandaj, Gjykata vendosi se kërkesa ishte qartazi e pabazuar sipas rregullit 36 (1.c) të Rregullores së Punës. Për më tepër, gjykata vërejti se rasti ishe ende në pritje në gjykatat e rregullta, ku parashtruesit do të ishin ende në gjendje të ushtronin ankesa para gjyqtarit të rastit për shkeljet e pretenduara të të drejtave të tyre gjatë periudhës paraprake. Prandaj, Gjykata konsideron se ende nuk ka ndonjë vendim final i cili do të kontestohej në gjykatë. Për më tepër, sa i përket kërkesës për masë të përkohshme, Gjykata vendosi se duke e marrë parasysh se kërkesa ishte shpallur e

papranueshme, parashtruesit nuk kanë të drejtë të kërkojnë masa të përkohshme sipas nenit 54 (1) të Rregullores së punës.

Prishtinë, më 19 shtator 2012

Nr. ref.: RK298/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rasti Nr. KI 56/12

Parashtruesi

Shkelqim Devolli

Blerim Devolli

Ismet Bojku

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ka. nr. 417/11, të 23 marsit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe

Arta Rama, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Shkelqim Devolli, z. Blerim Devolli dhe z. Ismet Bojku (parashtrues të kërkesës). Z. Shkelqim Devolli përfaqësohet nga avokatët Gani Tigani dhe Andrew Friedman, z. Blerim Devolli përfaqësohet nga avokatët Virtyt Ibrahimaga dhe Benjamin Chew, kurse z. Ismet Bojku përfaqësohet nga avokatja Iliriana Osmani-Serreqi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ka. nr. 417/11, të 23 marsit 2012, që u është dorëzuar më 30 mars 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesit e kërkesës pohojnë që vendimi i sipërpërmendur ua shkeli të drejtat e tyre të garantuara me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), përkatësisht me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt).

4. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës kërkojnë që Gjykata të vendosë masë të përkohshme për shkak se *"Është e qartë që paditësit nuk mund të dënohen për ndonjë vepër penale të pretenduar në bazë të provave të paraqitura. Shqyrtimi kryesor do të ishte i paarsyeshëm dhe do të rezultonte në dëmtim të mëtejmë të reputacionit të paditësit dhe në pamundësi për ta vazhduar punën e suksesshme të biznesit. Ky dëmtim do të ishte i pariparueshëm për paditësit."*

Baza juridike

5. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 dhe 27 të Ligjit mbi Kushtetutën e Republikës së Kosovës së 15 janarit 2009 (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: "Rregulloja e punës").

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesit e parashtruan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) më 23 maj 2012.

7. Më 5 korrik 2012, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga

gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Enver Hasani dhe Kadri Kryeziu.

8. Më 17 korrik 2012, Gjykata kërkoi nga parashtruesit që ta dorëzonin Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ka. nr. 417/11, të 22 marsit 2012.

9. Më 19 korrik 2012, Gjykata i njoftoi Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe Prokurorinë Speciale për parashtrimin e kërkesës.

10. Më 20 korrik 2012, parashtruesi e dorëzoi në Gjykatë Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ka. nr. 417/11, të 22 marsit 2012.

11. Më 19 shtator 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit Raportues dhe i paraqiti rekomandimin Gjykatës për papranueshmërinë e Kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 8 qershor 2011, prokurori special ngriti aktakuzën (PPS nr. 376109) në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

13. Më 5 nëntor 2011, gjyqtari konfirmues pjesërisht e konfirmoi aktakuzën ndaj parashtruesve (Ka. nr. 417/11). Parashtruesit ushtruan ankesë ndaj vendimit për pranueshmërinë e provave dhe vendimit për konfirmimin e aktakuzës të kolegjit prej tre gjyqtarëve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

14. Më 22 mars 2012, kolegji prej tre gjyqtarëve i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë e hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e parashtruesve (Ka. nr. 417/11). Gjykata e Qarkut në Prishtinë konstatoi që *"në shqyrtimin kryesor do të vlerësohen implikimet e mundshme të nenit 157.1 të KPPK-së dhe do të sigurohet që procedurat janë të drejta"*.

Pretendimet e parashtruesit

15. Parashtruesi pohon me sa vijon.

1. Shkelja e të drejtës për t'u ballafaquar me dëshmitarë, neni 6.3 (d) i KEDNJ-së

- Parashtruesi pohon që *"Prokuroria e ka bazuar vendimin e vet për ngritjen e aktakuzës (dhe gjykata e ka bazuar vendimin e vet për konfirmim po ashtu, pjesërisht) në bazë të letrave të dërguara nga përfaqësuesi ligjor i z. Adrian Shatku, ose në një rast, nga vetë z. Shatku. Prokuroria nuk e ka përfshirë z. Shatku në listën e dëshmitarëve të mundshëm për shqyrtimin kryesor, edhe pse letrat e tij të pretenduara janë dëshmitë kryesore mbi të cilat Zyra e Prokurorit e ka bazuar aktakuzën. Kërkesa e Prokurorisë që ta obligojë z. Shatku për t'iu përgjigjur ftesës për integrim nga ana e autoriteteve është refuzuar nga Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kështu që nuk ekziston mundësia që z. Shatku të marrë pjesë në shqyrtimin kryesor si dëshmitar. Prokuroria nuk ka prova të tjera të besimeve apo pikëpamjeve të z. Shatku përveç letrave në fjalë. Vendimi për të ngritur aktakuzë pa argumente, duke e ditur që z. Shatku nuk do të jetë dëshmitar në shqyrtimin kryesor dhe që mbrojtja nuk do të ketë mundësi për ta sfiduar z. Shatku gjatë shqyrtimit, është shkelje e qartë e nenit 6, paragrafit 3, pikës d".*

2. Shkelja kundër parimit të supozimit të pafajësisë, neni 6.2 i KEDNJ-së

- Parashtruesi pohon që *"Paditësi i ka ofruar prokurorisë prova që z. Shatku nuk ka asnjë pretendim ndaj paditësit. Përveç kësaj, paditësi i ka ofruar prokurorisë prova që 50.000,00 euro janë paguar nga paditësi, prandaj, nuk është i vërtetë*

pretendimi që kompania Dardafon SHPK është dëmtuar. Prokuroria nuk i ka vlerësuar ato prova. Përveç kësaj, ajo nuk i ka përfshirë provat kryesore të paraqitura nga të pandehurit në dosjen e prokurorisë për ta mashtruar gjyqtarin e procedurës paraprake për të besuar që aktakuza është e bazuar".

3. Ndjekje publike

- Parashtruesi pohon që *"Mediet e kanë ndjekur nga afër procedurën. Prokuroria i ka kontribuar fushatës publike kundër paditësit. Emri i respektuar i Kompanisë "Devolli" Group Shpk (një kompani prodhuese dhe tregtare) në të cilën paditësi është aksionari që ishte i përfshirë në këtë rast, edhe pse kjo kompani nuk ka të bëjë asgjë me këtë rast. Kjo përfshirje masive e publicitetit të rastit ka krijuar bazën që drejtësia publike do të pengohet dhe paragjykohet seriozisht".*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

16. Gjykata thekson se mund të vendosë vetëm për pranueshmërinë e kërkesës, nëse parashtruesi tregon se i ka shteruar të gjitha mjetet efektive juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi.

17. Neni 113.7 i Kushtetutës thotë që *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

18. Në anën tjetër, neni 47.2 i Ligjit përcakton që *"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

19. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi i kërkesës t'i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedura të rregullta për ta parandaluar shkeljen e Kushtetutës, ose, nëse ka, për ta korrigjuar shkeljen e një të drejte themelore.

20. Arsyetimi për rregullin e shterimit është që t'u ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të Kushtetutës (shih, Aktvendim për Papranueshmëri: Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI-41/09, i 21 janarit 2010, dhe shih, *mutatis mutandis,* GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).

21. Në të vërtetë, si rregull i përgjithshëm, Gjykata Kushtetuese do të ndërhyjë vetëm nëse ka shkelje të interpretimit të Kushtetutës apo nëse ligjet nuk janë në pajtim me Kushtetutën, por vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

22. Në këtë drejtim, parashtruesit pohojnë që ka pasur shkelje gjatë hetimit penal, fazës paraprake të procedurës penale, që ende janë në shqyrtim e sipër.

23. Siç u tha më lart, parashtruesi pretendon: (1) shkelje të së drejtës për t'u ballafaquar me dëshmitarë, neni 6.3 (d) i KEDNJ-së, (2) shkelje të parimit të supozimit të pafajësisë, neni 6.2 i KEDNJ-së, dhe (3) prokuroria publike.

    (1) Shkelja e së drejtës për t'u ballafaquar me dëshmitarë, neni 6 (3) d) i KEDNJ-së

24. Neni 6.3 (d) i KEDNJ-së përcakton:

    "Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme: d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në

pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës."

25. Gjykata Kushtetuese konsideron që pretendimi i parashtruesit për shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së është i pavend dhe i parakohshëm.

26. Në të vërtetë, neni 6 i KEDNJ-së ka të bëjë me të drejtën për një proces të rregullt. Procedura penale ende është në fazën paraprake, ku diskutimi mbi dyshimin e bazuar për kryerje të veprës penale është i përqendruar në nenin 5 të KEDNJ-së, i cili ka të bëjë me të drejtën e personit për liri dhe siguri.
27. Prandaj, pretendimi mbi bazën e nenit 6 duhet të lidhet me shqyrtimin, i cili pritet të mbahet, dhe të bëhet gjatë shqyrtimit dhe me rastin e parashtrimit të ankesës kundër aktgjykimit.

(2) Shkelja e parimit të supozimit të pafajësisë, neni 6.2 i KEDNJ-së

28. Parashtruesi pohon që prokuroria *"nuk i ka përfshirë provat kryesore të paraqitura nga të pandehurit [parashtruesi] në dosjen e prokurorisë për ta mashtruar gjyqtarin e procedurës paraprake për të besuar që aktakuza është e bazuar"*.

29. Prandaj, parashtruesi konkludon që ka pasur shkelje të nenit 6.2 të KEDNJ-së, i cili thotë:

"Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht".

30. Është detyrë e trupit gjykues që t'i vlerësojë jo vetëm provat mbi të cilat bazohet dyshimi i bazuar, por edhe dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë dhe provat materiale të paraqitura nga palët gjatë gjykimit.

31. Prandaj, argumenti që disa prova të paraqitura nga parashtruesi nuk ishin vlerësuar në mënyrë të drejtë ose ishin dorëzuar nga prokurori tani për tani është i parakohshëm.

32. Në këtë rast, Gjykata vëren që lënda ende është në procedurë e sipër në gjykata të rregullta, ku parashtruesi ende ka mundësi t'i ankohet gjyqtarit hetues lidhur me shkeljen e supozuar të të drejtave të tij gjatë periudhës paraprake. Prandaj, Gjykata konsideron që ende nuk ka vendim të formës së prerë i cili mund të kontestohet në këtë Gjykatë (shih Lutfi Dervishi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimeve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë: Kp. nr. 196/2009, i 8 qershorit 2009, PPS. nr. 02/2009, P. nr. 309/10, P. nr. 340/10, KA. nr. 278/10 dhe KA. nr. 309/10, të 1 marsit 2011, P. nr. 309/10, P. nr. 340/10, KA. nr. 278/10 dhe KA. nr. 309/10, të 27 prillit 2011, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 dhjetorit 2011).

33. Prandaj, parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit në fuqi, duke përfshirë shkallën e fundit, siç kërkohet ne nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47.2 të Ligjit.

> (3) Prokuroria publike

34. Parashtruesi pohon që *"Mediet e kanë ndjekur nga afër procedurën. (...) Kjo përfshirje masive e publicitetit të rastit ka krijuar bazën që drejtësia publike do të pengohet dhe paragjykohet seriozisht"*.

35. Gjykata thirret në nenin 48 të Ligjit, i cili përcakton që *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*

36. Përveç kësaj, rregulli 36.2 (d) përcakton që *"Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij"*.

37. Në këtë rast, parashtruesi nuk sqaron si dhe pse, dhe cilat të drejta janë shkelur.

38. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe si e tillë, duhet të hidhet poshtë.

Vlerësimi i kërkesës për Masë të përkohshme

39. Parashtruesit gjithashtu kërkuan vendosjen e masës së përkohshme, sepse *"shqyrtimi kryesor do të ishte i paarsyeshëm dhe do të rezultonte në dëmtim të mëtejmë të reputacionit të paditësit dhe në pamundësi për ta vazhduar punën e suksesshme të biznesit. Ky dëmtim do të ishte i pariparueshëm për paditësit."*

40. Ligji përcakton që *"Gjykata Kushtetuese (...) mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës (...)".*

41. Në anën tjetër, rregulli 54.1 i Rregullores së punës përcakton që *"Në çfarëdo kohe përderisa kërkesa është e pazgjidhur para Gjykatës (...), pala mund të kërkojë vendosjen e masës së përkohshme".*

42. Gjykata konkludon që kërkesa është e papranueshme dhe, si rrjedhojë, kërkesa për masë të përkohshme është pa objekt dhe duhet të hidhet poshtë.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 47.2 të Ligjit dhe rregullave 36(2), 54(1) dhe 56(2) të Rregullores së punës më 19 shtator 2012 Gjykata Kushtetuese njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TA HEDHË POSHTË kërkesën për masë të përkohshme*;*

III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit; dhe

IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. Dr. Enver Hasani

KO 57/12 datë 22 tetor 2012- Kërkesa e Presidentes së Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Saj, Atifete Jahjaga, me të cilën konteston votimin për miratimin e Ligjit nr. 04/l-084 "Për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës"

Lënda KO 57/12 nga data 13 korrik 2012.
Fjalët kyçe; kërkesë individuale, e konteston kushtetutshmërinë e votimit për miratim të Ligjit.

Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; nenin 46, 47, 48 dhe 49. të Ligjit nr.03/L-121 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin vijues:Ligji) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin vijues:Rregullorja e punës).
Më 31 maj 2012, kryetarja e Republikës së Kosovës, nëpërmjet përfaqësuesve të saj juridik i ka paraqitur kërkesë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.
Kryetari i gjykatës, më 6 qeshor 2012, e ka emëruar gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe kolegjin për shqyrtim në përbërje të gjyqtarëve: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Çukaloviq dhe Enver Hasani.
Kryetarja e Republikës së Kosovës "e konteston kushtetutshmërinë e votimit për miratimin e Ligjit nr.04/l-084 për pensionet e pjesëtarëve të Forcave të Sigurisë" i cili me vendimin e kryetares së Republikës së Kosovës i është kthyer për rishqyrtim Kuvendit të Kosovës.
Më 15 mars 2012, ligji nr.04/L-084 për "Pensionet e pjesëtarëve të Forcave të Sigurisë së Republikës së Kosovës" është miratuar në mbledhjen plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
Kryetarja e Republikës ka propozuar paragraf të ri të nenit 27 të Ligjit për Pensionet e Pjesëtarëve të FSK-së, si vijon:
"Në rast të mungesës së mjeteve publike, Qeveria mund ti zvogëlojë benificionet nga ligji, në mënyrë që të mos rrezikohet siguria financiare e Kosovës".

Komisioni funksional për punë të brendshme, siguri dhe mbikëqyrje, i Forcës së Sigurisë së Kosovës, nuk ka qenë për miratimin e ndryshimeve që i ka propozuar kryetarja e Republikës.

Më 3 maj 2012 kryetari i Kuvendit ka marrë Vendim duke pranuar se: "1. Kuvendi nuk i ka miratuar amendamentet e Ligjit nr.04/L-84 për Pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, që e ka propozuar kryetarja e Kosovës".Pastaj është theksuar se:"Ligji nr.04/L-84 për Pensionet për pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, mbetet ashtu siç është miratuar në Kuvendin e Kosovës, më 15 mars 2012 dhe konsiderohet i promulguar.

Gjykata Kushtetuese vëren se Kryetarja e Republikës i ka iniciuar dy çështje, si:
1. A është shkelur kompetenca e kryetares për ta kthyer ligjin për rishqyrtim e përshkruar në nenin 84. paragrafin 6. të Republikës së Kosovës?
2. A është bërë shkelja e nenit 80. paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës gjatë votimit/miratimit të ligjit për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë?
Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata njëzëri ka vendosur se kërkesa është e pranueshme.
Kompetencat e kryetarit të Republikës për ta kthyer ligjin në rishqyrtim, siç është paraparë në nenin 84.6 të Kushtetutës, në bazë të fakteve të paraqitura në këtë aktvendim, nuk janë shkelur; Prandaj, neni 80.4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës nuk është shkelur gjatë votimit/miratimit të Ligjit nr.04/L-084 për "Pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës".

Prishtinë, më 20 shtator 2012

Nr. ref.: AGJ297/12

AKTGJYKIM

në

Rastin nr. KO 57/12

Kërkesa e Presidentes së Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Saj, Atifete Jahjaga, me të cilën konteston votimin për miratimin e Ligjit nr. 04/l-084 "Për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës"

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Presidenti Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Presidentja e Republikës), Shkëlqesia e

Saj, Atifete Jahjaga, përmes përfaqësuesve të autorizuar z. Xhafer Tahiri dhe znj. Arisan Qosaj Mustafa.

Baza juridike

2. Kërkesa është bazuar në nenin 84.9 dhe 113.2.1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), dhe Rregullin 56(1) të Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e Punës).

Procedura në Gjykatë

3. Më 31 maj 2012, Presidentja e Republikës së Kosovës, përmes përfaqësuesve të saj ligjorë e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

4. Më 4 qershor 2012, Sekretariati i Gjykatës, në pajtim me Rregulloren e Punës, ia komunikoi kërkesën z. Jakup Krasniqi, Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Ministrit Agim Çeku, Ministër i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës.

5. Më 6 qershor 2012, Kryetari i Gjykatës e emëroi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar Raportues dhe Kolegjin Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

6. Më tutje, më 7 qershor 2012, Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës e dorëzoi përgjigjen në lidhje me kërkesën. Gjykata e mori përgjigjën nga Kryetari i Kuvendit më 18 qershor 2012.

7. Më 13 korrik 2012, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për

pranueshmërinë e kërkesës. Gjykata mbajti këshillime dhe votoi për kërkesën në seancë të mbyllur, në të njëjtën datë.

Objekti i çështjes

8. Presidentja e Republikës së Kosovës "konteston kushtetutshmërinë e votimit për miratimin e Ligjit nr. 04/L-0B4 për "Pensionet e Pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës" dhe ktheu për shqyrtim në Kuvendin e Kosovës me Vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës.

9. Rrjedhimisht, Presidentja e Republikës së Kosovës i drejtohet Gjykatës për të shqyrtuar nëse ka pasur shkelje të Kushtetutës, respektivisht të nenit 80.4, gjatë votimit në Kuvend lidhur me Vendimin e Presidentes për Kthimin e ligjit për shqyrtim.

10. Sipas Presidentes së Republikës, çështjet për shqyrtim para Gjykatës Kushtetuese janë:

> *"A është cenuar Neni 80, paragrafi (4), i Kushtetutës së Republikës së Kosovës gjatë votimit/aprovimit të Ligjit Nr. 04/L084 "Për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës" të rikthyer për rishqyrtim Kuvendit të Kosovës me Vendim të Presidentes së Republikës se Kosovës dhe rrjedhimisht a është cenuar kompetenca e Presidentit për kthim të ligjit ne rishqyrtim e parapare me nenin 84 paragrafi 6 te Kushtetutës së Republikës së Kosovës? "*

Përmbledhje e fakteve në lidhje me pyetjet në fjalë

11. Më 15 mars 2012, Ligji Nr. 04/L-084 për "Pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës" (në tekstin e mëtejmë: Ligji për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së) u miratua në seancë plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës. 69 deputetë votuan për ligjin, përderisa nuk kishte vota kundër dhe/apo abstenime.

12. Më 26 mars 2012, teksti i aprovuar i Ligjit iu dorëzua Zyrës së Presidentit të Republikës për shpallje nga ana e Presidentit.

13. Më 3 prill 2012, Presidentja e Republikës së Kosovës solli Vendimin për të kthyer Ligjin në rishqyrtim (në tekstin e mëtejmë: Vendimi për kthimin e ligjit të miratuar)..

14. Bazë juridike që përmendet në Vendimin për Kthimin e Ligjit në Shqyrtim të 3 prillit 2012 ishte neni 84.6 i Kushtetutës.

15. Në pjesën operative të Vendimit, thuhej se "Presidentja e Republikës së Kosovës sjellë këtë Vendim për kthimin në shqyrtim dhe me propozimin e një neni të ri për miratim, Kuvendit të Republikës së Kosovës.

16. Në të vërtetë, Presidentja e Republikës i propozoi Kuvendit një paragraf të ri për nenin 27 të Ligjit për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së, si vijon:

> *"Në rast të mungesës së fondeve publike, Qeveria mund të bëjë shkurtime sa i përket përfitimeve nga ligji, për të mos rrezikuar sigurinë financiare të Kosovës."*

17. Presidentja e Republikës konkludon në Vendimin për kthimin në shqyrtim të Ligjit të miratuar të 3 prillit 2012 se " Pa përfshirjen e këtij neni, do të rrezikohej funksioni demokratik i Institucioneve të Republikës së Kosovës në përmbushjen e obligimeve dhe detyrave të marra përsipër me marrëveshjet ndërkombëtare, zbatimi i të cilave është sanksionuar me Kushtetutë".

18. Presidentja pastaj dha arsyet për Vendimin, duke argumentuar se, me nënshkrimin e Marrëveshjes për anëtarësim në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), Republika e Kosovës ka marrë

përsipër përmbushjen e obligimeve të caktuara ndërkombëtare që do të mundësonin Kosovës të përfitonte mbështetje financiare në formë të huave të buta si dhe përkrahje teknike. Pastaj ajo argumentoi pse mos nënshkrimi i marrëveshjes me FMN do të shkaktonte dëm të shumëfishtë Republikës së Kosovës.

19. Vendimi i 3 prillit 2012 për të kthyer Ligjin e miratuar, u shqyrtua më pas nga Komisioni funksional për çështje të brendshme, siguri dhe mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

20. Megjithatë Komisioni nuk ishte për aprovimin e amendamentit siç ishte propozuar nga ana Presidentes së Republikës.

21. Më 3 maj 2012, Kuvendi mbajti seancë plenare. Në bazë të transkriptim të asaj seance të 3 majit 2012, pika e fundit e rendit të ditës ishte " Shqyrtimi i Vendimit të sjellë nga Presidentja e Kosovës për të shqyrtuar Ligjin e Pensioneve për Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës".

22. Kjo mund të vërehet nga transkripti që, pasi që u bë e ditur se janë prezent 71 deputetë, Kryetari i Kuvendit deklaroi si në vijim: "në mënyrë që të miratohet Kërkesa e Presidentes është e domosdoshme që të bëhen 61 vota:. Përfundimisht, në trasnkript thuhet: "Ne konkludojmë se me 29 vota "për", 34 "kundër" dhe 2 "abstenime", Kuvendi nuk e miraton amendamentin e propozuar nga Presidentja".

23. Gjithashtu më 3 maj 2012, Kryetari i Kuvendit mori Vendim për t'a bërë të ditur se: "1. Kuvendi nuk ka miratuar amendamentin e propozuar nga Presidentja e Kosovës për Ligjin nr. 04/L-84 për Pensionet e Pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës". Më tej thuhet: "Ligji nr. 04/L-84 për Pensionet e Pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë, mbetet siç është miratuar në Kuvendin e Kosovës, më 15 mars 2012, dhe konsiderohet i shpallur".

Përgjigjet nga palët

24. Më 7 qershor 2012, Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës u përgjigj, duke shprehur përkrahjen e tij që Gjykata të vendosë

se a është shkelur neni 80 (4) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës gjatë procedurës së votimit/miratimit të Ligjit për FSK-së.

25. Më 18 qershor 2012, Kuvendi në përgjigjen e vet të, theksoi se shqyrtimi i vendimit të 3 prillit 2012, i dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit ishte në pajtim me nenin 80.4 të Kushtetutës.

26. Kuvendi po ashtu iu referua praktikës së mëparshme në situata të ngjashme si në vijim: *" nga 5 qershori 2008, kur ka hyrë në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kuvendi ka pasur raste kur me shumicën e votave te deputeteve të Kuvendit (pra me 61 vota "për") ka miratuar vërejtjet e presidentit në ligj dhe Ligji është konsideruar i shpallur me vërejtjet e presidentit, por ka pasur edhe raste kur Kuvendi nuk i ka miratuar vërejtjet e Presidentit (në mungesë të 61 votave "për") dhe ligji ka mbetur ashtu siç është miratuar më parë nga Kuvendi dhe është konsideruar i shpallur*."

27. Në fund në përgjigjen e Kuvendit me tutje theksohej se "*Me rastin e vendimmarrjes ne Kuvendin e Republikës se Kosovës, me asnjë dispozite të Kushtetutës se Republikës se Kosovës nuk është e paraparë që me rastin e miratimit te ndonjë akti në Kuvend të kërkohet për te votuar "Kundër" shumica e deputeteve te Kuvendit*."

Pranueshmëria e kërkesës

28. Në bazë të nenit 113 (1) të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese ka jurisdiksion për të vendosur vetëm për rastet të ngitura në mënyrë ligjore nga palë të autorizuara.

29. Neni 84.9 i Kushtetutës thotë si në vijim:

"Neni 84 [Kompetencat e Presidentit]

Presidenti i Republikës së Kosovës:

(9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese…"

30. Është e qartë se në bazë të nenit 84(9) të Kushtetutës, Presidenti i Republikës së Kosovës është i autorizuar për të referuar çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese.

31. Gjykata Kushtetuese vëren se Presidentja e Kosovës ka shtruar dy pyetje si në vijim:

1) *A është cenuar Neni 80, paragrafi (4), i Kushtetutës së Republikës së Kosovës gjatë votimit/aprovimit të Ligjit Nr. 04/L084 "Për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës" (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Pensionet e Pjesëtarëve të FSK-së)"?*
2) *A është cenuar kompetenca e Presidentit për kthim të ligjit ne rishqyrtim e parapare me nenin 84 paragrafi 6 te Kushtetutës së Republikës së Kosovës?*

32. Në mënyrë që Kërkesa të shpallet e pranueshme, Kushtetuta kërkon që çështjet e referuara në Gjykatë në mënyrë ligjore nga një palë e autorizuar, sipas nenit 113.3.1 të Kushtetutës. Gjykata konstaton se pyetjet e Presidentes së Republikës janë shtruar në mënyrë ligjore. Gjykata Kushtetuese, si autoriteti final për interpretimin e Kushtetutës, poashtu konsideron se këto pyetje janë të natyrës kushtetuese. Prandaj Presidentja e Republikës ka shtruar pyetje kushtetuese dhe është një palë e autorizuar.
33. Pyetjet e shtruara janë pyetje kushtetuese siq përcakton neni 84(9) i Kushtetutës. Prandaj nuk është e nevojshme të shqyrtohet Kërkesa në kontekst të nenit 113.1 të Kushtetutës.

34. Rrjedhimisht, kërkesa është e pranueshme.

Meritat

35. Qysh në fillim, Gjykata do të dëshironte t'i referohej fakteve të lartpërmendura të rastit siç janë përmbledhur në paragrafin 16 dhe 17. Siç u përmend në pjesën operative, Vendimi i 3 prillit 2012, i sjellë nga Presidenti thuhej si në vijim: "Presidentja e Republikës së Kosovës sjellë këtë Vendim për kthimin në shqyrtim dhe me propozim të një neni të ri për miratim, drejtuar Kuvendit të Republikës së Kosovës".

36. Rrjedhimisht, Presidentja e Republikës i propozoi Kuvendit një paragraf shtesë për nenin 27 të Ligjit për Pensionin e Pjesëtarëve të FSK-së.

Nëse kompetenca e Presidentes për të kthyer ligjin në rishqyrtim është shkelur?

37. Në mënyrë që të vlerësojë pyetjen e parë kushtetuese të parashtruar nga Presidentja, Gjykata duhet të vlerësojë nëse Presidentja e Republikës kur ka ushtruar kompetencat siç përshkruhen në nenin 84 (6) të Kushtetutës ka të drejtë propozojë amendamente të Ligjit të miratuar nga Kuvendi sipas nenit 80 (1) të Kushtetutës pa kontestuar ligjin e miratuar ose ndonjë nga dispozitat e tij të veçanta.

38. Gjykata vëren se Presidenti i Republikës nuk ka kthyer ndonjë dispozitë të veçantë të Ligjit të miratuar për Pensionet e pjesëtarëve të FSK-së që ajo i konsideronte si të dëmshme, qoftë për interesat legjitime të Republikës ose të një apo më shumë komuniteteve të saj. Në vend të kësaj, Presidentja, propozoi një paragraf shtesë për nenin 27 të Ligjit për Pensione të pjesëtarëve të FSK-së

39. Në adresimin e kësaj çështje Gjykata duhet së pari të vlerësojë kompetencat kushtetuese të Presidentes për të kthyer ligjin e

miratuar për shqyrtim siq përshkruhet me nenin 84.6 të Kushtetutës.

40. Neni 84.6 i Kushtetutës [Kompetencat e Presidentit] thotë:

> "Presidenti i Republikës së Kosovës ka të drejtën e kthimit për rishqyrtim të ligjeve të miratuara, nëse konsideron se janë të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj. Të drejtën e rikthimit të një ligji mund ta shfrytëzojë vetëm një herë".

41. Kjo dispozitë e Kushtetutës duhet të kuptohen në lidhje me nenin 80 paragrafët 3 dhe 5 të Kushtetutës që thotë:

> " Neni 80 [Miratimi i Ligjit]
>
> *3. Nëse Presidenti i Republikës e kthen ligjin në Kuvend, ai/ajo duhet të theksojë arsyet e kthimit të ligjit. Presidenti i Republikës së Kosovës të drejtën e kthimit të një ligji në Kuvend, mund ta ushtrojë vetëm një herë.*
>
> ...
>
> *5. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda tetë (8) ditësh pas marrjes së ligjit, nuk merr asnjë vendim për shpalljen ose kthimin e tij, ligji konsiderohet i shpallur, pa nënshkrimin e saj/tij dhe publikohet në Gazetën Zyrtare."*

42. Kushtetuta parasheh se Presidentja e Republikës ka të drejtën të ushtrojë të ashtuquajturën "veto suspensive" për të pezulluar shpalljen e ligjit.

43. Në këtë mënyrë, Presidentja e Republikës është kreu i shtetit që përfaqëson unitetin e popullit (siç përcakton neni 83 i Kushtetutës)dhe është garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, dhe ushtron funksion të caktuar shqyrtues legjislativ.

44. Kushtetuta vlerëson se ky funksion i Presidentes, siç parashihet me Kushtetutë, është më shume e natyrës së kufizuar, *inter alia,* për arsyet në vijim.

45. Së pari, Presidentja mund të ushtrojë të drejtën për të pezulluar shpalljen e ligjit në fazën kur ligji tashmë i miratuar në formën e duhur në Kuvend (në pajtim me nenin 80.1 të Kushtetutës), duhet vetëm të bëhet efektiv (shih nenin 80 paragrafët 2 dhe 3 të Kushtetutës). Vetëm atëherë, Presidentja mund të intervenojë.

46. Së dyti, Presidentja, duhet të intervenojë brenda tetë ditësh prej ditës së pranimit të ligjit të miratuar; përndryshe një ligj duhet të konsiderohet i shpallur në vijë me nenin 80.5 të Kushtetutës.

47. Së treti, Presidenti duhet të theksojë arsyet e kthimit të ligjit në fjalë.

48. Këto arsye vetëm mund të ndërlidhen me konsideratën e Presidentes se shpallja e ligjit është i dëmshëm qoftë për interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj (shih neni 80.3 dhe 84.6 i Kushtetutës).

49. Së katërti, Presidentja mund të ushtrojë të drejtën e kthimit të një ligji vetëm një herë. (shih neni 80.3 i Kushtetutës).

50. Gjykata është në dijeni se e drejta e vetos së Presidentes për të kthyer nj lig në parlament mund të gjendet në një numër kushtetutash.

51. Për shembull, *në Francë*, neni 10 i Kushtetutës përcakton si në vijim:"*Presidenti i Republikës do të shpallë aktet e parlamentit brenda një periudhe prej 15 ditësh, pas miratimit dh transmetimit të tyre përfundimtar në qeveri. Para skadimit të këtij afati kohor, ai mundet, të kërkojë nga parlamenti që të rishqyrtojë aktin ose disa nene të tij. Ky rishqyrtim nuk mund të refuzohet".*

52. Në anën tjetër, neni 42 *i Kushtetutës Greke* përcakton si në vijim:

> *"Neni 42 [Ratifikimi i ligjeve, Vetoja]*
>
> *(1) Presidenti i Republikës nxjerr dhe publikon ligjet e miratuara nga parlamenti brenda një muaji nga miratimi i tij. Presidenti i Republikës mundet, brenda afatit kohor të specifikuar në paragrafin e mësipërm, të dërgojë përsëri në Parlament një ligj të miratuar, duke theksuar arsyet për veton e tij.*
> *(2) Një ligj ose ligji i një anëtari privat i vënë në veto nga Presidenti i Republikës duhet të sillet para seancës plenare të Parlamentit, dhe duhet të jetë miratuar përsëri nga shumica absolute e numrit të përgjithshëm të deputetëve, sipas procedurës së parashikuar në nenin 76 (2), Presidenti i Republikës nxjerr dhe publikon ligjin e tillë brenda dhjetë ditësh nga miratimi i tyre."*

53. Për më tepër, *Kushtetuta e Bullgarisë* në nenin 101 definon Veton e Presidentit si në vijim:

> "Neni 101 *[Vetoja]*
>
> *(1) Brenda afatit të përcaktuar me nenin 88(3), Presidenti është i lirë të kthejë një ligj, së bashku me*

motivet e tij, në Asamblenë Kombëtare për diskutim të mëtejshëm, i cili nuk do të mohohet.
(2) Miratimi i ri i ligjit të tillë kërkon shumicën e më shumë së gjysmës së të gjithë anëtarëve të Asamblesë Kombëtare.
(3) Pas një miratimi të ri të ligjit nga Asambleja Kombëtare, Presidenti do të shpallë atë brenda shtatë ditësh pas marrjes së tij".

54. Për më tepër, neni 72 i Kushtetutës së Lituanisë përcakton procedurat në vijm:

" Seimat mund të shqyrtojnë dhe të miratojnë një ligj të ri të referuar përsëri nga Presidenti i Republikës.

Ligji i shqyrtuar nga Seimat do të konsiderohet i miratuar me kusht që amendamentet dhe shtesat e paraqitura nga Presidenti i Republikës të jenë të miratuara ose nëse më shumë se ½ e të gjithë Anëtarëve të Seimas të kenë votuar për ligjin, dhe nëse është një ligj kushtetues- nëse jo atëherë 3/5 e të gjithë Anëtarëve të Seimas do të votojnë për të.

Presidenti i republikës duhet që brenda tri ditësh të nënshkruajë dhe menjëherë zyrtarisht të shpallë ligjet e tilla."

55. Për më tepër, sipas nenit 1, paragrafi 7 i Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, *: Çdo Ligj i cili do të miratohet në Dhomën e Përfaqsuesve dhe Senatit, duhet, para së të bëhet Ligj, t'i paraqitet Presidentit të Shteteve të Bashkuara; nëse ai e miraton duhet ta nënshkruajë, por nëse jo ai duhet ta kthejë, me Vërejtjet e tij tek ajo Dhomë nga e cila e ka origjinën, e cila do të fusë Vërejtjet në Gazetën e tyre, dhe do të vazhdojë me rishqyrtimin. Nëse pas një Rishqyrtimit të tillë dy të tretat e asaj Dhome do të bien dakord për ta miratuar Ligjin, ai duhet të dërgohet, së bashku me Vërejtjet, në Dhomën tjetër, nga e cila gjithashtu duhet të rishqyrtohet, dhe nëse miratohet nga*

dz të tretat e asaj Dhome, do të bëhet Ligj. Por në të gjitha rastet e tila Vota e të dy Dhomave do të përcaktohen nga Po-të dhe Jo-të, dhe nga Emrat e Personave që votojnë për dhe kundër Ligjit duhet të hyjnë në Gazetën e secilës Dhomë përkatëse. Nëse ndonjë Ligj do të kthehet nga Presidenti brenda dhjetë ditësh (përjashtohen të dielat) pasi t;i jenë paraqitur atij, i njëjti do të bëhet Ligj, në të njëjtën mënyrë sikur ta kishte nënshkruar ai, përveç nëse Kongresi me Shtyrjet e tyre parandalon Kthimin e tij, në këtë rast nuk do të bëhet Ligj".

56. Përfundimisht, neni 136 (Fuqizimi dhe Veto) i Kushtetutës së Portugalisë përcakton se:

"1. Brenda njëzet ditësh nga marrja e çdo dekreti nga Kuvendi i Republikës për miratimin si ligj, ose nga publikimi i ndonjë vendimi të Gjykatës Kushtetuese që nuk shpallë ndonjë nga dispozitat e dekretit jokushtetuese, Presidenti i republikës duhet ose të fuqizojë dekretin ose të ushtrojë të drejtën e vetos. Në rastin e fundit, ai duhet të dërgojë mesazh dhe të përcaktojë arsyet për këtë dhe të kërkojë që të rishqyrtohet statuti.

2. Nëse Kuvendi i Republikës konfirmon votën e vet origjinale me shumice absolute të të gjithë anëtarëve në ushtrimin e plotë të detyrës së tyre, Presidenti i Republikës do të fuqizojë dekretin brenda tetë ditësh nga marrja e tij".

57. Duke iu kthyer rastit në fjalë, Gjykata vëren se Presidentja e Republikës, më r prill 2012, mori Vendimin për ta thyer ligjin e miratuar brenda afatit kohor të përcaktuar me Kushtetutë. Gjykata gjithashtu vëren se bazë juridike ishte neni 84.6

58. Gjykata më tej vëren se Kushtetuta e Kosovës, ngjashëm si Kushtetutat e lartpërmendura, obligon Presidentin që të theksojë arsyet specifike të kthimit të ligjit në Kuvend.

59. Në disa vende si Lituania, Kushtetuta në mënyrë explicite përcakton se Presidenti i Republikës mund të dorëzojë amendamentet dhe shtesat në ligjin e kthyer.

60. Ky rast nuk ndodhë në Republikën e Kosovës.

61. Në te vërtetë, Kushtetuta e Kosovës nuk përcakton se Presidenti i Republikës ka të drejtë të propozojë amendamentet e ligjit të kthyer për rishqyrtim.

62. Gjykata është e vetëdijshme se neni 79 i Kushtetutës përshkruan se Presidenti mund të marrë nismën për të propozuar ligje nga fushë veprimtaria e tij/saj.

63. Ajo dispozitë e Kushtetutës është elaboruar më tej në nenin 53.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës që thotë:

> *"Propozim të Projektligjit në Kuvend mund ta paraqesë Presidenti i Republikës së Kosovës, nga fusha e veprimtarisë së tij..."*

64. Rregullorja e punës së Kuvendit më tej elaboron në nenin 54 kushtet për të paraqitur një Projekt-Ligj, siç është notë sqarimi, deklarimi i implikimeve buxhetore, etj.

65. Sidoqoftë, Presidenti i Republikës në rastin konkret nuk ka ushtruar të drejtën sipas nenin 79 të Kushtetutës dhe siç elaborohet më tutje në nenin 53,1 dhe 54 të Rregullores së Punës së Kuvendit për të paraqitur Ligjin dhe /ose amendamentet në Kuvend.

66. Rrjedhimisht, në bazë të fakteve të përshkruara më sipër, Gjykata vlerëson se kompetenca e Presidentes së Republikës për kthimin e ligjit për rishqyrtim, sic përcakton neni 84(6) i Kushtetutës, nuk është shkelur.

Nëse neni 80 (4) i Kushtetutës së republikës së Kosovës është shkelur gjatë procedurës së votimit/miratimit

67. Gjykata tani dëshiron shqyrtojë pyetjen e dytë të shtruar nga Presidentja si në vijim: Nëse neni 80 (4) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës është shkelur gjatë procedurës së votimit/miratimit të Ligjit nr. 04/L-084, për Pensionet e Pjesëtarëve të FSK?

68. Gjykata është e vetëdijshme se elaborimi i pyetjes së dytë mund të konsiderohet e tepërt , vis-a-vis me gjetjet në pyetjen e parë kushtetuese.

69. Gjykata është e mendimit se është një obligim i qartë i Kuvendit të Kosovës përcaktuar në nenin 80.4 të Kushtetutës si në vijim

> *"Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, vendos për miratimin e ligjit..."*

70. Sidoqoftë, obligimi i tillë i Kuvendit të Kosovës nuk ekziston në rast së Presidentja e Republikës propozon amendamentet për ligjin e kthyer në shqyrtim.

71. Pavarësisht që Gjykata, si gardiani i Kushtetutës dhe interpretuesi përfundimtar i saj, konsideron se është e nevojshme të përgjigjet në të gjitha pyetjet kushtetuese të parashtruara në këtë kërkesë.

72. Sipas procedurave të miratimit të ligjit Neni 80 [Miratimi i Ligjeve] parasheh si më poshtë:

> *"1. Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë.*

2. Ligji i miratuar nga Kuvendi nënshkruhet nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe shpallet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pasi ta ketë nënshkruar brenda tetë (8) ditësh pasi të ketë marrë ligjin.

3. Nëse Presidenti i Republikës e kthen ligjin në Kuvend, ai/ajo duhet të theksojë arsyet e kthimit të ligjit. Presidenti i Republikës së Kosovës të drejtën e kthimit të një ligji në Kuvend, mund ta ushtrojë vetëm një herë.

4. Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, vendos për miratimin e ligjit të rikthyer nga Presidenti i Republikës, dhe ligji përkatës konsiderohet i shpallur.

5. Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda tetë (8) ditësh pas marrjes së ligjit, nuk merr asnjë vendim për shpalljen ose kthimin e tij, ligji konsiderohet i shpallur, pa nënshkrimin e saj/tij dhe publikohet në Gazetën Zyrtare.

6. Ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, përveç nëse, me vetë ligj nuk përcaktohet ndryshe."

73. Gjykata përkujton që Kushtetuta bënë dallim në mes termit "shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë" dhe "shumicën e votave të të gjithë deputetëve".

74. Gjykata Kushtetuese vë në dukje se Kushtetuta në shumë vende e përdor termin "të gjithë deputetët", sikur në Nenin 76, 86 (4), 86(5), 90 (2).

75. Gjykata Kushtetuese përkujton se Kuvendi i Republikës së Kosovës përbëhet prej 120 deputetëve. Rrjedhimisht, kur Kushtetuta i referohet "të gjithë deputetët", në të vërtetë i referohet "120 deputetët"

76. Rrjedhimisht, parashihet që Presidenti i Republikës të ushtrojë fuqinë e vetos siç është përshkruar në Nenin 80.3 të Kushtetutës, për ta përmbysur veton e Presidentit nevojiten që së paku 61 deputetë të votojnë në favor të ligjit të miratuar i cili është kthyer nga Presidenti i Republikës.
77. Prandaj, bazuar në faktet e përshkruara më sipër, Gjykata konsideron që gjatë procedurës së votimit/miratimit të Ligjit nr. 04/L-0B4 për "Pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës" nuk është shkelur Neni 80 (4) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës

PËR KËTO ARSYE GJYKATA, NJËZËRI, VENDOSI SI MË POSHTË:

I. Kërkesa është e pranueshme;

II. Kompetencat e Presidentit të Republikës për të kthyer për shqyrtim ligjet, siç parashihet me Nenin 84 (6) të Kushtetutës, bazuar në faktet e përshkruara në Aktgjykim, nuk janë shkelur.

III. Rrjedhimisht, gjatë procedurës së votimit/miratimit të Ligjit nr. 04/L-0B4 për "Pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës" nuk është shkelur Neni 80 (4) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës

IV. Ky Aktgjykim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

V. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë

Gjyqtar raportues	**Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 93/11 datë 28 shtator 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PPA 9/2008, të datës 29 prill 2011

Rasti KI 93/11 vendim i 20 shtatorit 2012

Fjalët kyçe: administrata tatimore, e drejta në pronë, kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, këshilli i pavarur shqyrtues, shkelje e lirive dhe të drejtave individuale.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke pohuar se të drejtat e tij kushtetuese ishin cenuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, me ç'rast miratoi vendimin e Këshillit të Pavarur Shqyrtues që më herët kishte hedhur poshtë ankesën e parashtruesit kundër lartësisë së tatimeve të caktuara nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës.Duke cituar vendimin e GJEDNJ-së në rastin *Shub kundër Lituanisë* , Gjykata arsyetoi se nuk vëren se procedurat përkatëse ishin të padrejta apo arbitrare, dhe se parashtruesit i ishin dhënë mundësi të shumta për të mbrojtur të drejtat e tij para organeve vendimmarrëse. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshm

Prishtinë, më 20 shtator 2012

Nr. ref.: RK296/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 93/11

Parashtruesi

N.T. AKUSTIKA

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PPA 9/2008, të datës 29 prill 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është ndërmarrja private e emëruar N.T. AKUSTIKA nga Peja, përfaqësuar nga Mustafë Kastrati, avokat nga Peja.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës PPA 9/2008, i datës 29 prill 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës ka të bëjë me kontestimin e vlerësimit të taksave për parashtruesin e kërkesës.

Baza juridike

4. Bazë juridike për kërkesën janë nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121 për

Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2008 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 7 korrik 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese emëroi gjyqtaren Iliriana Islami si Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Almiro Rodrigues (kryesues), Enver Hasani dhe Kadri Kryeziu.

7. Gjyqtari Raportues i raportoi Kolegjit shqyrtues më 29 nëntor 2011 dhe Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

8. Më 13 maj 2004, parashtruesi i kërkesës u ankua ndaj vendimit të Administratës Tatimore të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: ATK) lidhur me tatimin e vlerësuar si të pagueshëm nga parashtruesi i kërkesës. Ankesa bazohej në arsyet e mëposhtme:

   i. Shkelje të rënda të procedurave tatimore;
   ii. Përcaktim të gabuar të situatës faktike;
   iii. Zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale; dhe
   iv. Niveleve të larta të detyrimeve të vlerës së shtuar (në tekstin e mëtejmë: TVSH) të vlerësuar si të pagueshëm nga parashtruesi i kërkesës.

9. Më 2 korrik 2004, Administrata Tatimore informoi parashtruesin e kërkesës se kishte pranuar ankesën e tij për

shqyrtim dhe se parashtruesi i kërkesës, megjithatë, mbetej i detyruar për pagesën e tatimit. ATK vendosi se tatimi i shtuar ishte llogaritur nga parregullsitë e të dhënave të parashtruesit të kërkesës.

10. Më 12 korrik 2004, parashtruesi i parashtroi kërkesë Këshillit të Pavarur Shqyrtues lidhur me vendimet e ATK të cekura në shkresën e 2 korrikut 2004.

11. Më 30 prill 2005, Këshilli Pavarur Shqyrtues (A. nr. 130/2005) refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar.

12. Parashtruesi i kërkesës atëherë i parashtroi ankesë Gjykatës Supreme për të anuluar vendimin e Këshillit të Pavarur Shqyrtues.

13. Më 29 tetor 2007,Gjykata Supreme (A. nr. 429/2005) refuzoi ankesën e parashtruesit.

14. Më 24 prill 2011, Gjykata Supreme e refuzoi (PPA. nr. 9/2008) ankesën e parashtruesit për përsëritje të procedurës.

15. Parashtruesi i kërkesës i paraqiti mocion Prokurorit Publik për peticion për mbrojtje të ligjshmërisë, me arsyen se kishte përcaktim të gabuar të së drejtës materiale.

16. Më 22 qershor 2011, Prokurori i Shtetit refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak se nuk gjeti asnjë bazë juridike për parashtrim të një peticioni të tillë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me rastin e përcaktimit të tatimit të vlerësuar të parashtruesit të kërkesës ka pasur shkelje të paragrafit 9 të nenit 119 të Kushtetutës, duke e krahasuar atë

me tri biznese të tjera të ngjashme kundrejt përcaktimeve të bazuara në ligj, dokumentacion financiar dhe libra të biznesit.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

18. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen me Kushtetutë.

19. Neni 48 i Ligjit parasheh se:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*

20. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit kur shqyrtohen vendime të marra nga ana e gjykatave më të ulëta. Roli i gjykatave më të ulëta është të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat e duhura të procedurës dhe të drejtës materiale *(shih mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës* [GC], Nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

21. Parashtruesi pretendon se janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese nga shkelje të renda të procedurave tatimore, nga përcaktimi i gabuar i situatës faktike dhe nga zbatimi i gabuar i së drejtës materiale nga ana e organeve administrative dhe nga gjykatat më të ulëta pa theksuar në mënyrë specifike se si ndonjë vendim i veçantë ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese.

22. Sidoqoftë, parashtruesi i kërkesës nuk i ka ofruar Gjykatës ndonjë *prima facie dëshmi* që do të mbështeste pohimet se ka pasur shkelje të të drejtave të tij kushtetuese (*shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë,* Vendimi i GJEDNJ për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 53363/99, i majit 2005). Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk cekë se në çfarë mënyre paragrafi 9 i nenit 119 mbështet kërkesën e tij, siç edhe parashihet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.

23. *Parashtruesit të kërkesës i ishin ofruar mundësi të shumta për ta paraqitur rastin e tij dhe për të kontestuar interpretimin e ligjit (që parashtruesi i kërkesës pretendon të jetë i gabuar) para ATK-së, Këshillit të Pavarur Shqyrtues, Gjykatës Supreme dhe Prokurorit Publik.*
24. *Gjykata Kushtetuese nuk gjeti se procedurat përkatëse ishin në çfarëdo mënyre të padrejta apo arbitrare* (shih mutatis mutandis Shub kundër Lituanisë, Vendimi GJEDNJ për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, datë 30 qershor 2009).

25. Prandaj, në këtë parashtresë nuk janë plotësuar kushtet për pranueshmëri. Parashtruesi i kërkesës ka dështuar të mbështesë pretendimet se vendimi i kontestuar shkelë të drejtat dhe liritë kushtetuese të parashtruesit të kërkesës.

26. *Prandaj, për këto arsye, kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës i cili parasheh se*: "Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave kushtetuese*"*.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, pas shqyrtimit të 29 nëntorit 2011, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

I. TË HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'i komunikohet palës; dhe

III. Ky Vendim do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Prof. Dr. Enver Hasani

KI 55/12 datë 17 tetor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 132/2009, të 17 janarit 2012

Rasti KI 55/12, Aktvendimi për papranueshmëri i 21 shtatorit 2012
Fjalët kyçe: mbrojtja gjyqësore e të drejtave, kërkesë individuale, qartazi e pabazuar, shkelje e të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi i kërkesës, z. Avni Shabani, e dorëzoi kërkesën bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke e kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 132/2009, të 17 janarit 2012, duke pretenduar se ai u mor në kundërshtim me të drejtat e tij të garantuara nga neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, sepse *ka "[...] raste të shumta kur Gjykata Supreme me kërkesën e palëve të dëmtuara rritë këto shuma, ndërsa nuk kemi raste që i ka zvogëluar dhe ky rast është i pari që ka gjykuar Gjykata Supreme e Kosovës kësisoj. Me këtë Aktgjykim, paditësit i ka vënë në pozitë të pabarabartë me paditësit e tjerë [...]."*

Në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, Gjykata vendosi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesi nuk kishte dorëzuar prova se procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare. Prandaj, Gjykata vendosi se kërkesa ishte qartazi e pabazuar sipas rregullit 36 (1.c) të Rregullores së punës.

Prishtinë, 21 shtator 2012

Nr. ref.: RK307/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 55/12

Parashtruesi

Avni Shabani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 132/2009, të 17 janarit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Kërkesa është dorëzuar nga Z. Avni Shabani (në tekstin e mëtejmë: Parashtruesi), i përfaqësuar nga Z. Nysret Mjeku, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 132/2009, të 17 janarit 2012, që i është dorëzuar atij më 12 mars 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon se vendimi i lartpërmendur ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), respektivisht neni 54 [Mbrojtja gjyqësore e të Drejtave].

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 22 maj 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 5 korrik 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese me Vendimin nr. GJR.KI-55/12, caktoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi si gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese me Vendimin nr. Kolegji Shqyrtues. KI-55/12, caktoi Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalovič dhe Kadri Kryeziu.

7. Më 25 korrik, kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme.

8. Më 21 shtator 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares Raportues dhe i paraqiti rekomandimin Gjykatës për papranueshmërinë e Kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

9. Në vitin 2007, i biri i parashtruesit ishte mbytur në një aksident me veturë. Rrjedhimisht, parashtruesi ushtroi padi kundër kompanisë së sigurimit për kompensimin e dëmeve materiale dhe jo-materiale në Gjykatën Komunale në Lipjan.

10. Më 17 shtator 2007, Gjykata Komunale në Lipjan (Aktgjykimi C. nr. 119.07) aprovoi padinë e parashtruesit për kompensimin e dëmeve materiale dhe jo-materiale. Kompania e sigurimit ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër këtij Aktgjykimi.

11. Më 11 mars 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (aktgjykimi Ac. nr. 897.2007) pjesërisht hodhi poshtë ankesën e kompanisë së sigurimit si të pabazuar dhe mbështeti Aktgjykimin e Gjykatës

Komunale. Në lidhje me normën e interesit, Gjykata e Qarkut në Prishtinë miratoi ankesën e kompanisë së sigurimit dhe ndërroi shumën e normës së interesit. Kompania e sigurimit ushtroi një revizion në Gjykatën Supreme kundër këtij Aktgjykimi të Gjykatës së Qarkut.

12. Më 17 janar 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 132/2009) pjesërisht aprovoi kërkesën për revizion dhe ndryshoi aktgjykimin e gjykatave më të ulëta sa i përket shumës së kompensimit të dëmeve materiale dhe jo-materiale. Gjykata Supreme konstatoi se gjykatat e ulëta në lidhje me shumën e caktuar për kompensim të dëmeve materiale dhe jo-materiale ishte shumë e lartë dhe nuk ishte në pajtim me nenin 200 paragrafi 2 në lidhje me nenin 201 të Ligjit për Detyrimet.

Pretendimet e parashtruesit

13. Parashtruesi pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme u mor në kundërshtim me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, sepse ka *"[...] raste të shumta kur Gjykata Supreme me kërkesën e palëve të dëmtuara rritë këto shuma, ndërsa nuk kemi raste që i ka zvogëluar dhe ky rast është i pari që ka gjykuar Gjykata Supreme e Kosovës kësisoj. Me këtë Aktgjykim, paditësit i ka vënë në pozitë të pabarabartë me paditësit e tjerë[...]."*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

14. Gjykata vëren se për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për papranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

15. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet rregullit 36 (1c) të Rregullores së Punës që përcakton se "Gjykata mund t'i

shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar".

16. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabime në fakte ose të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç nëse dhe për sa kohë të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara më Kushtetutë (kushtetutshmëri). Prandaj, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e gjykatave të rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat e së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

17. Në përgjithësi, Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991).

18. Për më tepër, parashtruesi vetëm konteston nëse Gjykata Supreme ka zbatuar në tërësi ligjin e zbatueshëm dhe nuk pajtohet me konstatimet e fakteve nga gjykata në lidhje me rastin e tij dhe me shumën e caktuar për kompensim për dëmet materiale dhe jo-materiale.

19. Faktikisht, parashtruesi nuk e ka mbështetur padinë në baza kushtetuese dhe nuk ka paraqitur prova se të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga ai autoritet publik. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konstatojë se procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

20. Prandaj, parashtruesi nuk ka treguar se si dhe pse Gjykata Supreme ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.

21. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e papranueshme sepse është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (1.c) të Rregullores së Punës.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të rregullit 36(1.c) dhe 56(2) të Rregullores së punës më 21 shtator 2012, Gjykata Kushtetuese njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Arta Rama-Hajrizi Prof. Dr. Enver Hasani

KI 88/11 datë 28 shtator 2012- Vlerësim i Vendimit të Gjykatës Supreme nr. AP 306/2011, të 6 prillit 2011

Lënda KI 88/11, vendimi i datës 19 mars 2012.
Fjalët kyçe; kërkesë individuale, vlerësimi i vendimit të Gjykatës Supreme.

Kërkesa është bazuar në nenin 113. paragrafin 7. të Kushtetutës, në nenin 46, 47, 48 dhe 49. të Ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin vijues:Ligji) dhe rregullin 56. paragrafin 2. të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Paraqitësi i kërkesës, më 29 qershor 2011, i ka paraqitur kërkesë Gjykatës.
Kryetari, më 17 gusht 2011 e ka emëruar gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe dhe kolegjin për shqyrtim në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesuer), Altay Suroy dhe Gjyljeta Mushkolaj.
Paraqitësi i kërkesës, më 30 janar 2011 i është ankuar Entit të Statistikave të Kosovës lidhur e regjistrimin e popullsisë, si pasojë e shqetësimit se anëtarët e paraqitësit të kërkesës nuk kanë mundësi që lirshëm ta shprehin përkatësinë e tyre fetare në regjistrim.
Paraqitësi i kërkesës pohon se ESK, kinse është përzier në çështjet fetare duke kërkuar nga qytetarët e vet që në regjistrim të deklarohen për përkatësinë e tyre fetare.Paraqitësi i kërkesës beson se kjo paraqet shkelje të nenit 8. të Kushtetutës në të cilin është përshkruar*:"Republika e Kosovës është shtet sekular dhe neutral lidhur me çështjen e besimeve fetare".*
Paraqitësi, më 22 shkurt 2011 dhe më 7 mars 2011, lidhur me këtë i është ankuar edhe ombudspersonit.
Ombudspersoni ka theksuar se :*"kërkesa për fillimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (...) e papranueshme".*
Paraqitësi i kërkesës, më 30 mars 2011 ka parashtruar padi pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës kundër ESK-së në bazë të heshtjes administrative për ankesën e paraqitësit të kërkesës, shkeljen e të drejtave të njeriut dhe injorimin e bashkësisë fetare ligjore në Kosovë.

Paraqitësi i kërkesës ka kërkuar nga Gjykata Supreme që ta pengoj ESK-në që ti shpallë rezultatet e regjistrimit lidhur me pyetjen nr.10 në formularin R3 dhe ka kërkuar komentim lidhur me Ligjin për Regjistrimin e Popullsisë.
Gjykata Supreme ka konkluduar se *"kërkesat janë të parakohshme"*, prandaj i ka refuzuar kërkesat.

Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se kërkesa konkrete duhet konsideruar e papranueshme pasi që nuk janë shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.Gjykata kushtetuese, në vështrim të nenit 113. paragrafi 7. të Kushtetutës, nenit 22. të Ligjit dhe rregullit 36. paragrafit 1. pikës a) të Rregullores, njëzëri ka vendosur që kërkesën ta refuzojë si të papranueshme.

Prishtinë, më 24 shtator 2012

Nr. ref.RK 299 /12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 88/11

Parashtrues

Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës

Vlerësim i Vendimit të Gjykatës Supreme nr. AP 306/2011, të 6 prillit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović, gjyqtar

Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe

Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesja e kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës, e përfaqësuar nga Pastori Femi Cakolli.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e konteston Vendimin e Gjykatës Supreme nr. 306/2011, të 6 prillit 2011, i cili iu dorëzua më 7 qershor 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes ka të bëjë me interpretimin e Kushtetutës lidhur me regjistrimin e popullsisë dhe aktet ligjore, zyrtare dhe teknike që e përcollën procesin e regjistrimit të vitit 2011.

4. Parashtruesja pohon që të kërkosh nga qytetarët ta deklarojnë përkatësinë e tyre fetare në regjistrimin e vitit 2011 është shkelje e nenit 8 të Kushtetutës, i cili përcakton: *Republika e Kosovës është shtet laik dhe neutral në çështje të besimeve fetare*.

Baza juridike

5. Kërkesa është e bazuar në nenin 113 (7) të Kushtetutës, nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesja e parashtroi kërkesën në Gjykatë më 29 qershor 2011.

7. Më 17 gusht 2011, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Gjyljeta Mushkolaj.

8. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues më 19 mars 2012 dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

9. Më 31 janar 2011, parashtruesja u ankua në Entin Statistikor të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: ESK) lidhur me regjistrimin e popullsisë për shkak të brengave se anëtarët e parashtrueses nuk ishin në gjendje ta shprehnin lirisht përcaktimin e tyre fetar në procesin e regjistrimit të përgjithshëm për shkak se ata ende jetojnë në familjet myslimane apo katolike dhe si rrjedhojë këta anëtarë *"statistikisht nuk do të ekzistojnë fare"*.

10. Parashtruesja iu ankua Avokatit të Popullit për të njëjtën çështje më 22 shkurt 2011 dhe 7 mars 2011.

11. Më 24 mars 2011, Avokati i Popullit iu përgjigj parashtrueses duke ia rikujtuar që "*neni 113, paragrafi 7, i Kushtetutës, i autorizon individët të ngrenë në Gjykatë Kushtetuese shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë"*. Përveç kësaj, Avokati i Popullit theksoi se *"kërkesa për të ngritur çështje në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (...) është e papranueshme, për shkak se jeni në shfrytëzim të mjeteve juridike"*.

12. Më 31 mars 2011, parashtruesja ushtroi padi në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër ESK-së për shkak të heshtjes administrative lidhur me ankesën e saj, shkeljen e të drejtave të njeriut dhe injorim ndaj një bashkësie fetare legale në Kosovë.

13. Duket që parashtruesja e ka ushtruar atë padi pa e respektuar nenin 29 të Ligjit Nr. 03-L-202 për konfliktet administrative (në tekstin e mëtejmë: LKA), që do të thotë pa e ushtruar kërkesën e dytë në ESK dhe pa pritur afatin prej shtatë ditësh,

si kriter i domosdoshëm ligjor për të ushtruar kërkesë në Gjykatën Supreme.

14. Megjithatë, parashtruesja kërkoi nga Gjykata Supreme që ta ndalonte ESK-në nga publikimi i rezultateve nga pyetja 10 e formularit R3 dhe kërkoi komente lidhur me Ligjin për regjistrimin e popullsisë.

15. Më 6 prill 2011, Gjykata Supreme nxori vendim në procedurën nr. 306/2011 lidhu me dy paditë e parashtruara nga parashtruesja (nr. 306/2011 dhe A. nr. 315/2011) për shkak se ESK-ja ende nuk kishte vendosur lidhur me kërkesën e saj.

16. Gjykata Supreme konkludoi që "kërkesat janë të parakohshme" dhe, si rrjedhojë, i refuzoi kërkesat. Gjykata Supreme arsyetoi se "sipas dispozitave të nenit 29, paragrafit 2, të LKA-së, pas skadimit të afatit prej 30 ditësh, paditësja është dashur ta përsërisë kërkesën e vet dhe të kërkojë nga ESK-ja të vendosë lidhur me kërkesën e saj dhe gjithashtu të presë edhe shtatë ditë të tjera nga paraqitja e kërkesës së përsëritur. Nëse pas kalimit të këtij afati ESK-ja nuk do të vendoste lidhur me kërkesën, paditësja do të mund të ushtronte kërkesë për fillim të konfliktit administrativ.

17. Së fundi, *"me që paditësja nuk i është drejtuar Entit të Statistikave të Kosovës me kërkesë të përsëritur, Gjykata Supreme, në përputhje me dispozitën e parashikuar nga neni 34 par. 1 pika 1 lidhur me nenin 29 par 2 të LKA, gjeti se në këtë çështje administrative nuk janë plotësuar kushtet për fillimin e konfliktit administrativ për shkak të heshtjes së administratës."*

18. Përveç kësaj, në kështillën juridike të vendimit të Gjykatës Supreme thuhet: *"Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, e tilla i paraqitet Gjykatës Supreme të Kosovës, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes së tij."*

19. Parashtruesja nuk tregon që ankesa është ushtruar kundër këtij aktvendimi brenda afatit të përcaktuar.

20. Më 10 qershor 2011, Avokati i Popullit e njoftoi Pastorin Femi Cakolli se hetimi lidhur me këtë ankesë ishte ndërprerë. Shkresës i ishte bashkëngjitur "vendimi mbi largimin e çështjes nga lista", ku shpreheshin shkurtimisht veprimet e ndërmarra lidhur me ankesën dhe arsyetimi i vendimit.

Argumentet ligjore të paraqitura nga parashtruesja

21. Parashtruesja pohon që miratimi nga ESK-ja i pyetjes 10 të formularit R3 të regjistrimit të vitit 2011, e cila kërkonte përgjigje në pyetjen "Cili është besimi juaj fetar?", e pasuar nga gjashtë mundësi: "(1) Islam, (2) Ortodoks, (3) Katolik, (4) Tjetër (shëno), (5) Asnjë besim fetar, apo (6) Preferoj të mos përgjigjem" (...) është "shkelje e Kushtetutës dhe Ligjit për liritë fetare dhe shkelje e të drejtave të njeriut dhe e ndërgjegjes së besimit të qytetarëve".

22. Parashtruesja pohon që ESK-ja gjoja ndërhyri në çështje fetare duke kërkuar që qytetarët ta deklarojnë përkatësinë e tyre fetare në procesin e regjistrimit. Parashtruesja beson që kjo është shkelje e nenit 8 të Kushtetutës, i cili thotë: *Republika e Kosovës është shtet laik dhe neutral në çështje të besimeve fetare*.

23. Parashtruesja vëren që Ligji Nr. 03/L-237 për regjistrimin e popullsisë hyri në fuqi në nëntor të vitit 2010 dhe regjistrimi u mbajt prej 1 deri më 15 prill 2011. Parashtruesja mendon që nuk është mbajtur asnjë debat publik për procesin e regjistrimit dhe ligjin për regjistrimin e popullsisë. Përveç kësaj, parashtruesja pohon që formularët e regjistrimit ishin shtypur para shpalljes së ligjit të zbatueshëm për regjistrimin e popullsisë.

24. Në përgjithësi, parashtruesja pretendon me sa vijon:

a. Së pari, ESK-ja shkeli nenin 8 të Kushtetutës duke kërkuar që qytetarët ta deklarojnë përkatësinë e tyre fetare;

b. Së dyti, ESK-ja shkeli nenin 5.4 të Ligjit Nr. 02/L-31 për liritë fetare, duke mos e paraqitur bashkësinë ungjillore në formularin F3;

c. Së treti, thuhet që regjistruesit e ESK-së i kanë mbushur në mënyrë të padrejtë formularët e regjistrimit duke shënuar apriori "islam" si përgjigje për përkatësi fetare pa e pyetur paraprakisht individin për këtë çështje;

d. Së katërti, pyetja 10 në formularin F3 nuk ishte neutrale. Qytetarëve është dashur t'u ofrohej mundësia të mos zgjedhin të përgjigjen në këtë pyetje; dhe

e. Së fundi, konkluzioni i Gjykatës Supreme është "i papranueshëm dhe jopraktik".

25. Në përfundim, parashtruesja kërkon që Gjykata:

1) Të vendosë nëse neni 8 i Kushtetutës është shkelur gjatë regjistrimit të popullsisë;

2) Të pengohet ESK-ja nga publikimi i rezultateve nga pyetja 10 në formularin F3 nëse konsiderohet e pavlefshme nga pikëpamja kushtetuese apo në kundërshtim me nenin 5.4 të Ligjit Nr. 02/L-31 për liritë fetare; dhe

3) Të përcaktojë nëse të drejtat e njeriut të protestantëve të Kosovës janë shkelur nga ESK-ja në kundërshtim me nenin 5.4 të Ligjit Nr. 02/L-31 për liritë fetare, duke mos e përfshirë fenë protestante si mundësi në regjistrim.

Pranueshmëria e kërkesës

26. Kriteret për pranueshmëri janë të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.

27. Paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës e përcaktojnë kornizën e përgjithshme ligjore që kërkohet për pranueshmëri. Ata përcaktojnë:

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. (...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

28. Rregulli i shterimit të të gjitha mjeteve juridike korrespondon me obligimin e gjykatave të rregullta për t'i korrigjuar shkeljet e të drejtave themelore që mund të kenë ndodhur në faza të ndryshme të ankesës. Në të vërtetë, sipas nenit 102 (3) të Kushtetutës, "*Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit*". Prandaj, çdo gjykatë është e obliguar të ofrojë mbrojtje ligjore në rast të shkeljes së Kushtetutës.

29. Në anën tjetër, parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi t'i shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedura të rregullta për ta penguar shkeljen e Kushtetutës, ose, nëse ka, për ta korrigjuar shkeljen e një të drejte themelore. Prandaj, palët që nuk ndërmarrin ndonjë hap procedural në gjykata të rregullta vetë bartin përgjegjësinë nëse rastet e tyre shpallen të papranueshme, pasi kjo do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për kundërshtim të mëtejmë të shkeljes.

30. Prandaj, parashtruesja duhet të tregojë se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Arsyetimi për rregullin e shterimit është që t'u ofrojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih *mutatis mutandis*, GJEDNJ,

Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).

31. Me pak fjalë, parashtruesja duhet t'i ndërmarrë të gjithë hapat që në mënyrë të arsyeshme mund të priten nga ajo për t'i shteruar mjetet juridike vendëse (*D.H. dhe të tjerët kundër Republikës së Çekisë [DHM, nr. 57325/00, GJEDNJ 2007-XII*).

32. Megjithatë, sa i përket kësaj kërkese, duket që parashtruesja nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike.

33. Në të vërtetë, më 6 prill 2011, Gjykata Supreme konkludoi (Vendimi nr. 306/2011) që padia ishte e parakohshme për shkak se parashtruesja nuk e kishte respektuar nenin 29 të Ligjit Nr. 03-L-202 për konfliktet administrative.

34. Neni 29 i LKA-së thotë:

a. Nëse organi i shkallës së dytë nuk e ka nxjerrë vendimin brenda tridhjetë (30) ditësh ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita të veçanta rreth ankimit të palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, ndërsa nuk e nxjerr as në afatin e mëtejmë prej shtatë (7) ditësh me kërkesë të përsëritur, pala mund të fillojë konfliktin administrativ sikur t'i është refuzuar ankesa.

b. Në mënyrën e parashikuar në paragrafin 1. të këtij neni mund të veprojë pala edhe kur sipas kërkesës së saj nuk është nxjerrë vendimi nga organi i shkallës së parë, kundër aktit të të cilit nuk mund të bëhet ankesa.

c. Nëse organi i shkallës së parë, kundër aktit të të cilit mund të bëhet ankesa, nuk ka nxjerrë asnjë vendim në bazë të kërkesës brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh ose në një afat më të shkurtër të paraparë me dispozita të veçanta, pala ka të drejtë t'i drejtohet me kërkesë organit të shkallës së dytë. Kundër vendimit të organit të shkallës së dytë, pala mund të fillojë konfliktin administrativ, por mundet, nën kushtet nga

paragrafi 1. i këtij neni, ta fillojë edhe nëse ky organ nuk ka nxjerrë vendim.

35. Përveç kësaj, parashtruesja nuk është ankuar brenda afatit prej 15 ditësh kundër Vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, nr. AP 306/2011, të 6 prillit 2011, pas marrjes së kështillës juridike të vendosur në të njëjtin vendim. Përkundër kështillës që parashtruesja mund t'i drejtohet Gjykatës Supreme të Kosovës me ankesë kundër vendimit të saj, ajo nuk e ka shfrytëzuar këtë të drejtë ligjore.

36. Gjykata gjithashtu vëren që dyshimi i thjeshtë për perspektivën e çështjes nuk mjafton për ta përjashtuar parashtruesin nga detyrimet e tij për t'u ankuar në organet kompetente (shih Whiteside kundër Mbretërisë së Bashkuar, Vendim i 7 marsit 1994, Kërkesa nr. 20357/92, DR 76, f. 80).

37. Në të vërtetë, rregulli i shterimit kërkon që kërkesa duhet të parashtrohet në gjykatat [e rregullta] përkatëse dhe se duhet të shfrytëzohen mjetet e parapara juridike për ta kontestuar vendimin që tashmë është nxjerrë. Kjo normalisht kërkon që ankesat (...) duhet të parashtrohen (...) në pajtim me kriteret zyrtare dhe afatet e përcaktuara në ligjin vendës (po aty, f. 25-27, paragrafët 71-72; shih gjithashtu vendimin e Komisionit të 11 janarit 1961 për pranueshmëri të kërkesës nr. 788/60, Austria kundër Italisë, Vjetari i Konventës, vëllimi 4, f. 170-172); dhe se është dashur të përdoreshin mjetet procedurale që do të mund ta pengonin shkeljen [e Kushtetutës] (shih Aktgjykimin Barberà, Messegué dhe Jabardo , të 6 dhjetorit 1988, Seria A nr. 146, f. 28-29, paragrafët 58-59, si dhe vendimin e Komisionit të cituar më lart, f. 166-170).

38. Prandaj, nga pikëpamja e gjetjeve të Gjykatës Supreme, kjo kërkesë duhet të konsiderohet e papranueshme pasi nuk janë shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) a) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Prof. Dr. Enver Hasani

KI 78/12 datë 25 shtator 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012

Rasti KI 78/12, Vendim për masë të përkohshme të 24 shtatorit 2012
Fjalët kyçe: kërkesë individuale, masë e përkohshme, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, shkelje e të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën e tij bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke e kontestuar aktgjykimin, Pkl. Nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012, sepse Gjykata Supreme pa ndonjë arsyetim të fortë, nuk i kishte shqyrtuar provat e propozuara nga mbrojtja. Për më tepër, mbrojtja kërkoi masë të përkohshme, sepse "Nëse një aktgjykim i favorshëm nga Gjykata Kushtetuese do të shkaktonte rigjykim të mundshëm të këtij rasti ku Parashtruesi do të mund të lirohej nga përgjegjësia, atëherë mungesa e kësaj mase të përkohshme do të linte Parashtruesin me një vuajtje të jashtëligjshme të një dënimi të pamerituar."

Lidhur me çështjen e masës së përkohshme, gjykata konkludoi se pa paragjykuar vendimin përfundimtar të kërkesës, parashtruesi i kërkesës ka ofruar argumente mjaft bindëse se zbatimi i vendimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 70/2012 të 22 qershorit 2012, dhe i urdhër dënimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 485/09 të 26 nëntorit 2010, si dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Ap. nr. 134/2011 të 8 marsit 2012 dhe privimi i tij nga liria mund të rezultonin me dëmtimin e pariparueshëm të parashtruesit të kërkesës. Prandaj, Gjykata lejoi masën e përkohshme në kohëzgjatje deri më 31 dhjetor 2012 duke filluar nga data e miratimit të këtij Vendimi.

Prishtinë, më 24 shtator 2012

Nr. ref.: MP-300/12

VENDIM PËR MASËN E PËRKOHSHME

në

Rastin Nr. KI 78/12

Parashtruesi

Bajrush Xhemajli

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Bajrush Xhemajli, i cili përfaqësohet nga Shoqëria e Avokatëve "Sejdiu & Qerkini", sh.p.k. nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012, që i është dorëzuar parashtruesit më 26 korrik 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pohon që aktgjykimi i sipërpërmendur ia shkeli të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), neni 6. (E drejta për një proces të rregullt) i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), dhe neni 10 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

4. Përveç kësaj, parashtruesi kërkon që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të vendosë masë të përkohshme.

Baza juridike

5. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 dhe 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, (Nr. 03/L-121) (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 54 dhe 56 (3) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

6. Më 23 gusht 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 4 shtator 2012, Kryetari, me vendimin Nr. GJR. KI 78/12, e caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues. Të njëjtën datë, Kryetari, me vendimin Nr. K. SH. KI78/12, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova.

8. Më 5 shator 2012, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme dhe Prokurorinë e Shtetit për kërkesën e parashtruar.

9. Më 21 shtator 2012, Gjykata shqyrtoi Raportin paraprak të Gjyqtarit Raportues lidhur me vënien e masës së përkohshme, deri në vendimin përfundimtar të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

10. Më 24 nëntor 2009, prokuroria publike e qarkut ngriti aktakuzën (PP. nr. 565-1/2009) në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër parashtruesit sepse ka kryer veprën penale të nenit 297 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1-3 [Rrezikimi i

trafikut publik] të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPK).

11. Më 1 mars 2010, gjyqtari për konfirmim të aktakuzës konfirmoi aktakuzën ndaj parashtruesit (Ka. nr. 438/2009).

12. Më 26 nëntor 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi P. nr. 485/09) gjeti parashtruesin fajtor për kryerjen e veprës penale sipas nenit 297 paragrafi 5 në lidhje me paragrafin 1-3 të KPPK-së. Gjykata e Qarkut në Prishtinë vendosi se deklarata e të dëmtuarve ishin pa kundërthënie, në pajtim me ekspertizën dhe deklaratën e ekspertit të komunikacionit, ekspertizat mjeko-ligjore për lëndimet të cilët i kanë pësuar të njëjtit dhe raportin e autopsisë për të ndjerin dhe prandaj iu fali besimin e plotë. Gjithashtu, Gjykata ia fali besimin e plotë raportit të obduksionit si dhe ekspertizës së ekspertit të komunikacionit. Sa i përket pretendimet e parashtruesit *"[...] së në asnjë fazë të procedurës nuk është vërtetuar gjendja teknike e veturës të akuzuarit edhe pse ka qenë obligim ligjor, sipas vlerësimit të gjykatës, është rrethanë irelevante sepse [...] aksidenti i komunikacionit është shkaktuar si pasojë e veprimeve të të akuzuarit pas goditjes së veturës e cila ka qarkulluar në shiritin e majtë të rrugës dhe nga lëndimet e pësuara në këtë aksident, sipas raportit i autopsisë, ka vdekur [...], të dëmtuarit [...] kanë pësuar lëndime të rënda trupore dhe [...], lëndime të lehta trupore, si vërtetohet nga mendimi i ekspertit mjeko-ligjor, ndërsa në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit është konstatuar se nuk ka lëshime të pjesëmarrësve tjerë në komunikacion të cilat kishin me qenë faktor kontribuues të këtij aksidenti. Prandaj, sipas vlerësimit të gjykatës kjo mbrojtje kishte për qëllim justifikimin e veprimeve inkriminuese të të akuzuarit si dhe shmangien e përgjegjësisë penale të tij."* Kundër këtij aktgjykimi parashtruesi u ankua në Gjykatën Supreme.

13. Më 8 mars 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Ap. nr. 134/2011) e hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e parashtruesit. Gjykata Supreme konstatoi se në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar vendi dhe koha e ndodhjes së aksidentit, pjesëmarrësit dhe pasojat e shkaktuara. Për me tepër:

"...

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, nuk ka pas indikacione se automjeti i të akuzuarit nuk ka qenë në gjendje të rregull, sepse ai asnjëherë nuk ka pohuar një fakt të këtillë, e në anën tjetër eksperti i komunikacionit ka gjetur se bartja e automjetit mund të shkaktohet për shkak të mosfunksionimit të sistemit të frenimit por në rastin konkret deri të bartja e automjetit nuk ka ardhur për atë shkasë por automjeti i të akuzuarit është bartur pasi e ka goditur/prekur automjetin të cilin ka tentuar ta tejkaloje. Gjykata e shkalles së parë drejt ka konkluduar se gjetja e ekspertit është e drejt sepse [...] kjo prove ka qenë në përputhje me provat tjera të administruara.

Sipas ankesës faktori tjetër - "faktori rrugë" ka ndikuar në shkaktimin e "aksidentit dhe gjendja faktike edhe për këtë fakt është vërtetuar në mënyrë të gabuar. Kështu, sipas ankesës shkaktar i aksidentit është edhe mungesa e mbrojtësit në mes dy drejtime. Mirëpo, ky fakt nga mbrojtja është potencuar edhe "gjatë procedurës së shkalles së parë dhe nga eksperti i komunikacionit është "kërkuar përgjigje dhe eksperti qartazi ka deklaruar se ekzistimi i mbrojtjes do të kishte ndikuar që të mos vinte deri të aksidenti në përmasa të këtilla por jo edhe se ky është faktor i shkaktimit të vet aksidentit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme janë të pabazuara thëniet ankimore se eksperti ka dhëne konstatim dhe mendim jo profesional, i cili nuk ka mbështetje në provat e administruara. Përkundrazi, në kohën e dhënëses se ekspertizës, eksperti, siç edhe vet ka deklaruar, ka pas në dispozicion të gjitha shkresat e lëndës dhe konstatimi dhe mendimi i tij janë në përputhje, pra nuk kanë asnjë paqartësi apo kundërthënie me provat tjera te administruara, siç janë skica dhe fotodokumentacioni i vendit të ngjarjes, në të cilat shihen gjurmët në rrugë, dëmtimet dhe pozita e fundit të automjeteve, si dhe deklaratat e dëshmitarëve të dëgjuar.

..."

Kundër këtij aktgjykimi parashtruesi dorëzoi në Gjykatën Supreme kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

14. Më 22 qershor 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pkl. nr. 70/2012) e hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruesit. Për me tepër Gjykata Supreme konstatoi se *"Mbrojtësit e të akuzuarit në të gjitha fazat e procedurës i kanë përsëritur pothuajse të njëjtat pretendimet, duke bërë këtë edhe tani në këtë mjet të jashtëzakonshëm juridike, përkatësisht duke pretenduar se gjendja faktike nuk është vërtetuar drejt, për faktin se sipas tyre gjykata nuk ka arritur të vërtetojë me saktësi se kush ishte ai që kontribuoi në shkaktimin e këtij aksidentit me pasoja fatale: faktori njeri, faktori rrugë apo faktori teknik (ndonjë defekt eventual në mjet, prandaj, sipas tyre, në rrethana të tilla, ka qenë e domosdoshme të urdhërohet kryerja e një superekspertizë. Të gjitha këto pretendime, për të cilat kanë marrë përgjigje të mjaftueshme nga kolegji i kësaj Gjykate, janë të pabazuara. Gjykata mund të caktojë një ekspert tjetër apo të caktojë edhe superekspertizen në rast se në mendimin e eksperteve ka kundërthënie, të meta apo shfaqet dyshim i arsyeshëm për saktësinë e mendimit të dhëne, nëse të dhënat në konstatimin e eksperteve, (kur kemi dy) ndryshojnë thellësisht ose kur konstatimet e tyre janë të paqarta, jo të plota e në kundërshtim me vetveten ose me rrethanat e shqyrtuara dhe kur të gjitha këto nuk mund të mënjanohen me marrjen e sërishme në pyetje të eksperteve. Në situatën konkrete, nuk qëndron asnjëra nga këto rrethana që do ta detyronin gjykatën të kërkojë kryerjen e një superekspertizë."*

15. Më 17 prill 2012, Gjykata Komunale në Ferizaj (Aktvendim ED. nr. 17/12) e aprovoi kërkesën e parashtruesit për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim për periudhën kohore 3 (tre) muaj.

16. Më 18 korrik 2012, Gjykata Komunale në Ferizaj (Aktvendim ED. nr. 17/12) prapë e aprovoi kërkesën e parashtruesit për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim për periudhën

kohore 2 (dy) muaj. Parashtruesi është i detyruar që më 19 shtator 2012 të paraqitet për mbajtjen e dënimit.

Pretendimet e parashtruesit

17. Parashtruesi pohon me sa vijon.

(i) Shkelja e parimit të barazisë së palëve në procedurë

- Parashtruesi pohon që *"[...] gjykata pa ndonjë arsyetim të qëndrueshëm, nuk ka shqyrtuar provat e propozuara nga mbrojtja. Provat e paadministruara nga kjo gjykatë janë shumë relevante dhe me ndikim për vërtetimin e fajësisë apo pafajësisë së tij. Në procedurën e zhvilluar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, mbrojtja e Parashtruesit kishte kërkuar që gjykata të administroje edhe provat të cilat kanë të bëjnë me pjesën e përgjegjësisë së aktorëve të tjerë në fatkeqësinë e komunikacionit, e sidomos shpejtësinë e automjetit me të cilin është ndeshur fillimisht automjeti i Parashtruesit, [...], si dhe ekzaminimin teknik të veture të cilën ishte duke e drejtuar Parashtruesi në ditën kritike. Një gjë e tillë u kërkua nga mbrojtja, duke u mbështetur në deklarimet e ekspertit të komunikacionit [...], sipas të cilit në aksidentet e komunikacionit kontribuojnë tre faktorë dhe atë: faktori njeri, faktori rrugë dhe faktori makine. Duke marre parasysh faktin se në çështjen penalo-juridike në fjalë për të vërtetuar faktet relevante është angazhuar eksperti i komunikacionit, ai është munduar të japë përgjigje në ekzistimin apo mosekzistimin e dy faktorëve të parë dhe kontributin e tyre në shkaktimin e aksidentit të komunikacionit. Për këtë arsye, e gjithnjë duke marrë parasysh se faktori makinë ka mund të jetë kontribuues në aksidentin në fjalë, gjykata është dashur që të administrojë edhe këtë provë, duke angazhuar ekspertin e lëmese së makinerisë, në mënyrë që të*

vërtetoj ndikimin apo mos-ndikimin e këtij faktori në shkaktimin e aksidentit. Ky mohim nga ana e Gjykatës është cenim i të drejtave të Parashtruesit."

(ii) Gjykata e Qarkut në Prishtinë mbështet vendimin në dëshminë e personit i cili nuk ka mund të japë informata për ngjarjen-aksidentin

- Parashtruesi pohon që *"z. [...] nuk ka qenë vrojtues i drejtpërdrejtë i ngjarjes së ndodhur dhe për këtë arsye nuk është dashur të dëgjohet në cilësinë e dëshmitarit."*

(iii) Vlerësimet e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, në lidhje me ekspertizën e ekspertit të komunikacionit

- Parashtruesi pohon që *"Në pjesën arsyetuese të Aktgjykimit (fq. 7), gjykata konstaton se "Gjykata ia ka falë besimin ekspertizës me arsyetimin se e njëjta në mënyrë të detajuar ka dhënë shpjegime për të dhënat e vërtetuara nga shkresat e lëndës, në të cilat e ka bazuar ekspertizën, por edhe për metodat shkencore të cilat i ka përdorë gjatë ekspertimit të bërë". Ky vlerësim i punës së ekspertit nga Gjykata është shumë sipërfaqësore dhe jo-kritik. Ekspertiza është provë sikurse edhe provat tjera në procedurën penale dhe rrjedhimisht gjykata duhet ta vlerësoj këtë provë duke arsyetuar rrjedhën logjike të saj. Gjykata nuk mund të konstatojë se ekspertiza është në përputhje me metodat shkencore, sepse po ti dinte metodat shkencore nuk do të kishte pasur nevojë të angazhojë ekspert. Ekzistojnë një mori rregullash shkencore në lidhje me përcaktimin e shpejtësisë së automjetit para shkaktimit të aksidentit. Prandaj konsiderojmë se kërkesa e mbrojtjes së të pandehurit (tani të gjykuarit) për përsëritjen e ekspertizës apo për ekspertizë nga një ekspert tjetër i komunikacionit ishte e arsyeshme dhe kishte për qëllim verifikimin e*

metodave shkencore të përdorura në këtë rast penalo-juridik."

(iv) Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Ap. nr. 134/2011

- Parashtruesi pohon që *"Gjykata Supreme e Kosovës, duke vepruar si gjykatë e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsye të qarta juridiko-kushtetuese në aspekt të të gjitha fakteve të cilat janë relevante për dhënien e një vendimi të ligjshëm, por në mënyrë eksplicite, pa ndonjë vlerësim, i ka vlerësuar si të pabazuara pretendimet ankimore të Parashtruesit të kësaj kërkesë."*

(v) Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Pkl. nr. 70/2012

- Parashtruesi pohon që *"Gjykata Supreme me këtë rast nuk çmon fare se për çfarë arsye e konsideron ekspertizën e ekspertit të komunikacionit si të drejte, por vetëm ja falë besimin vlerësimeve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë pa ndonjë vlerësim kritik të këtij pretendimi ankimore."*

18. Për me tepër parashtruesi i referohet Kraska kundër Zvicrës, ky *"Gjykata Evropiane ka thënë se efekti i Nenit 6.1 është që t'ia mundësojë gjykatës kompetente të kryeje ekzaminimin e duhur të parashtresave, të argumenteve dhe provave të sjella nga palët, pa cenuar vlerësimin nëse ata janë apo nuk janë të rëndësishme për vendimin e saj"* (*shih Kraska kundër Zvicrës, Parashtresa nr. 13942/88, Aktgjykimi i 19 prillit 1993).*

19. Gjithashtu, sipas parashtruesit, *"gjykata duhet të bëjë një ekzaminim të vërtetë të argumenteve dhe dëshmive të palëve, duke vlerësuar rendësin e tyre për vendimin që do të dorëzohet. "*(*shih Quadrelli kundër Italisë, Parashtresa nr. 28168/95, Aktgjykimi i 11 janarit 2000*).

20. Për me tepër parashtruesi i referohet Bonisch kundër Austrisë, ky *"Gjykata Evropiane ka gjetur shkelje të Nenit 6.1 të Konventës Evropiane kur mbrojtja ka qenë në vështirësi për të caktuar një ekspertizë të re – tjetër"* (*shih BÖNISCH v. AUSTRIA, Parashtresa nr. 8658/79, Aktgjykimi i 6 majit1985).*

21. Parashtruesi, gjithashtu, pohon se "Njëheri, po kjo gjykatë ka gjetur shkelje të Nenit 6.1 të Konventës Evropiane kur dëgjimi i ekspertëve të tjerë (duke përfshirë një ekspert privat i cili kishte ardhur në rezultate të ndryshme) ishte refuzuar nga gjykata pasi që ishte dëgjuar vetëm një ekspert i një instituti që kishte konkluduar në dëm të të pandehurit (*shih Brandstetter kundër Austrisë, Parashtresa nr. 13468/87, Aktgjykimi i 28 gushtit 1991, G.B. kundër Francës, Parashtresa nr. 44069/98, Aktgjykimi i 2 tetorit 2001* dhe *Benderskiy kundër Ukrainës, Parashtresa nr. 22750/02, Aktgjykimi i 15 nëntorit 2007).*

Kërkesa për masë përkohshme

22. Parashtruesi kërkon që Gjykata të vendosë masë të përkohshme për shkak se:

    a. *"[...] një zbatim i këtij aktgjykimi antikushtetues do të privonte Parashtruesin nga liria me muaj e ndoshta edhe me vite [...]"* dhe *"do të shkaktonte dëme të paripareshme për Parashtruesin pasi që ai do të privohej nga liria pa iu ofruar atij një procedurë në rastin penalo-juridik që i garantohet me Kushtetute."*

    b. "Nëse një aktgjykim i favorshëm nga Gjykata Kushtetuese do të shkaktonte rigjykim të mundshëm të këtij rasti ku Parashtruesi do të mund të lirohej nga përgjegjësia, atëherë mungesa e kësaj mase të përkohshme do të linte Parashtruesin me një vuajtje të jashtëligjshme të një dënimi të pameritуar."

    c. "[...] privimi nga liria nuk mund të zhbëhet pasi që [...] nuk do të kompensohet koha që Parashtruesi do ta

kalonte i privuar nga liria, dhe pasojat fiziko-psikike që një privim i tillë do të lente në Parashtruesin. Ky theksim qëndron edhe me shumë duke pasur parasysh gjendjen e mjere shëndetësore të Parashtruesit, të cilit nuk do të mund t'i ofrohej kujdesi i mjaftueshëm shëndetësor brenda institucionit korrektues."

Vlerësimi i kërkesës për masën e përkohshme

23. Pas dëgjimit të Gjyqtarit Raportues, Kadri Kryeziu, dhe diskutimit të këndvështrimeve të parashtruesit të kërkesës të paraqitura me shkrim, më 21 shtator 2012 Gjykata mbajti këshillim dhe shqyrtoi.

24. Gjykata konkludoi se, pa paragjykuar vendimin përfundimtar të kërkesës, parashtruesi i kërkesës ka ofruar argumente mjaft bindëse se zbatimi i Vendimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 70/2012 të 22 qershorit 2012, dhe i urdhër dënimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 485/09 të 26 nëntorit 2010, si dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Ap. nr. 134/2011 të 8 marsit 2012, dhe privimi i tij nga liria mund të rezultonin me dëmtimin e pandreqshëm të parashtruesit të kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në bazë të nenit 116(2) të Kushtetutës dhe nenit 27 të Ligjit, më 21 shtator 2012,

VENDOSI

I. TË LEJOJË, me gjashtë vota për dhe dy kundër, masën e përkohshme;

II. TË LEJOJË masën e përkohshme në kohëzgjatje deri më 31 dhjetor 2012, duke filluar nga data e miratimit të këtij Vendimi;

III. TË SUSPENDOJË MENJËHERË zbatimin e Vendimit të Gjykatës Supreme Pkl. nr. 70/2012 të 22 qershorit 2012, urdhër dënimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 485/09 të 26 nëntorit 2010 si dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Ap. nr. 134/2011 të 8 marsit 2012, për të njëjtën periudhë kohore;

IV. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve; dhe

V. Ky Vendim do të publikohet në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Mr.sc. Kadri Kryeziu Prof. Dr. Enver Hasani

KI 163/11 datë 28 shtator 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl-Kzz-91/10 të 23 gushtit 2011

Lënda KI 163/11, vendimi i datës 13 korrik 2010
Fjalët kyçe; kërkesë individuale,vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; nenin 46, 47, 48 dhe 49. të Ligjit nr.03/L-121 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin vijues:Ligji) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin vijues:Rregullorja e punës).
Më 20 dhjetor 2011, paraqitësi i kërkesës i ka paraqitur kërkesë Gjykatës Kushtetuese.

Kryetari i Gjykatës, më 17 janar 2011 e ka emëruar gjyqtarin Robert Carolan si gjyqtar raportues dhe Kolegjin për shqyrtim në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (Kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami.
Më 16 shkurt 2012 Gjykata, nga ana e përfaqësuesit të paraqitësit të kërkesës, ka pranuar dokumente shtesë lidhur me kërkesën.
Kryetari i Gjykatës, më 13 korrik 2012, e ka emëruar Kolegjin për shqyrtim në përbërje të gjyqtarëve: Snezhana Botusharova (kryesuese), Enver Hasani dhe Ivan Çukaloviq.

Më 19 nëntor 2009 Gjykata e Qarkut në Mitrovicë ka marrë aktvendim K.nr.134/2008 dhe e ka shpallur paraqitësin e kërkesës fajtor për këto vepra penale: (a) shkaktim i urrejtjes nacionale, racore fetare apo etnike, konfliktit, mos tolerancës në kundërshtim me nenin 115-3 lidhur me paragrafin 1. të Ligjit Penal të Kosovës (LPK), (b) përpjekja e vrasjes së rëndë në kundërshtim me nenin 146 dhe 147. lidhur me nenin 20 të LPK.Si rezultat i kësaj, paraqitësi i kërkesës është dënuar me 6 vjet e 6 muaj burgim, duke filluar nga 14 qershori 2008.
Paraqitësi i kërkesës thekson shkeljen e nenit 24 [Barazia para Ligjit] dhe të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.Në këtë vështrim paraqitësi i kërkesës thekson se aktgjykimi i Gjykatës Supreme duhet të anulohet.

Paraqitësi i kërkesës thekson se për shkak se Gjykata Supreme ka marrë atë që duket si aktgjykim i ndryshëm me rastin ku ai thekson se është i ngjashëm me rastin e tij, se atij i është mohuar e drejta për trajtim të barabartë në pajtim me nenin 24. të Kushtetutës dhe nenin 7. të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.Ai po ashtu thekson se i është mohuar për gjykim të drejtë në pajtim me nenin 31 (1) dhe (2) të Kushtetutës, nenin 6 (1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata vëren se paraqitësi i kërkesës nuk ka arritur të provojë se rasti i tij është identik nga pikëpamja e fakteve apo pikëpamja juridike me ndonjë rast tjetër në Gjykatën Supreme ku del se Gjykata Supreme ka marrë konkluzion tjetër juridik të të njëjtit ligj procedural është zbatuar në rastin e tij.Për ta dëshmuar shkeljen kushtetuese paraqitësi i kërkesës duhet të provojë më shumë nga kjo se një Gjykatë e rregullt ka marrë dy apo më shumë konkluzione juridike apo faktike kontradiktore.Paraqitësi i kërkesës nuk ka arritur që të dëshmojë se nuk ka pasur gjykim të drejtë.

Në këtë kërkesë paraqitësi i kërkesës, thjesht ka theksuar se Gjykata Supreme e Kosovës ka qenë në kundërshtim në interpretimin e saj juridik të ligjit të procedurës penale.Pohimet e këtilla, pa më shumë prova, këtë kërkesë e bëjnë qartazi të pabazuar.

Gjykata Supreme, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 48 dhe 56. të Ligjit dhe të rregullit 36. të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese, në seancën e vet të mbajtur më 13 korrik 2012, njëzëri vendosi që kërkesën ta shpallë të papranueshme.

Prishtinë, më 24 shtator 2012

Nr. ref.: RK302/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 163/11

Parashtruesi

Predrag Đorđević

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl-Kzz-91/10 të 23 gushtit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Predrag Đorđević, i lindur në Zemun, Republika e Serbisë, momentalisht duke vuajtur dënimin me burg në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë. Në procedurat në Gjykatën Kushtetuese ("Gjykata"), parashtruesi i kërkesës është i përfaqësuar nga Miodrag Brkljač dhe Ljubomir Pantović, avokatë nga Mitrovica.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi gjyqësor i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Pkl-Kzz-91/10, i 23 gushtit 2011, që i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 12 shtator 2011. Me këtë aktgjykim është hedhur poshtë kërkesa e parashtruesit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë si e papranueshme.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi nga Gjykata Kushtetuese i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pkl-Kzz-91/më 23 gusht 2011, me të cilin gjoja janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës ("Kushtetuta").

4. Parashtruesi i kërkesës në veçanti pretendon shkeljen e nenit 24 [Barazia para ligjit] dhe të nenit 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pohon se janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 7 [Barazia para ligjit] dhe me nenin 10 [E drejta në gjykim të drejtë] të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

5. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës pohon se janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 6.1. e Konventës Evropiane ("Konventa") për të Drejtat e Njeriut.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; në nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

7. Më 20 dhjetor 2011, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

8. Më 17 janar 2012, Kryetari caktoi gjyqtarin Robert Carolan si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesuese), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami.

9. Më 18 janar 2012, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

10. Më 2 shkurt 2012, Gjykata njoftoi Zyrën e Prokurorisë Speciale të Kosovës për regjistrimin e kërkesës.

11. Në ditën e njëjtë, Gjykata kërkoi nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës që t'i sigurojë kopjet e të gjitha aktgjykimeve të aprovuara në procedura penale kundër parashtruesit të kërkesës, si dhe dokumentet e tjera relevante siç janë akuzat penale dhe dokumentet e tjera të lëshuara nga Prokurori Special.

12. Më 16 shkurt 2012, Gjykata pranoi nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dokumente shtesë që kanë të bëjnë me kërkesën.

13. Më 13 korrik 2012, Kryetari i Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues në këtë përbërje të gjyqtarëve: Snezhana Botusharova (kryesuese), Enver Hasani dhe Ivan Čukalović.

Përmbledhja e fakteve

14. Faktet e këtij rasti mund të përmblidhen si në vijim.

15. Më 19 nëntor 2009, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, me aktgjykimin K. nr. 134/2008, e shpall fajtor parashtruesin e kërkesës për veprat vijuese penale: (a) nxitje e urrejtjes kombëtare, racore, fetare ose etnike, mosmarrëveshje dhe jotolerancë, në kundërshtim me nenin 115.3, në lidhje me paragrafin 1, të Kodit Penal të Kosovës (KPK); dhe, (b) Vrasje e rëndë në tentativë, në kundërshtim me nenin 146 dhe 147, në lidhje me nenin 20 të KPK-së. Si rezultat i kësaj, parashtruesi i kërkesës u dënua me 6 vjet dhe 6 muaj burgim, duke filluar nga 14 qershori 2008.

16. Gjatë procedurës në Gjykatën e Qarkut, pas shpalljes së aktgjykimit, Gjyqtari kryesues i ka udhëzuar palët përkitazi me obligimin e paralajmërimit të ankesës brenda intervalit kohor të përcaktuar me ligj brenda tetë ditësh nga shpallja e aktgjykimit.

17. Aktgjykimi i lartpërmendur përmban udhëzimin vijues për mjetin juridik. "Pala e autorizuar mund të paraqesë ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi, nëpërmjet Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda afatit 15-ditësh nga dita e pranimit të kopjes së aktgjykimit".

18. I pakënaqur me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut dhe me kohëzgjatjen e dënimit, parashtruesi i kërkesës paralajmëroi ankesë më 26 nëntor 2009 në Gjykatën Supreme të Kosovës. Ankesa u paraqit më 31 dhjetor 2009.

19. Më 27 janar 2010, palët e dëmtuara E. P. dhe A. H., paraqitën ankesë kundër aktgjykimit Gjykatës së Qarkut për shkak të kohëzgjatjes së dënimit.

20. Më 30 maj 2010, Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës paraqiti kërkesë në Gjykatën Supreme, me propozim që ankesat e parashtruesit të kërkesës dhe të palëve të dëmtuara të refuzohen dhe që Gjykata Supreme të vërtetojë aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, të 19 nëntorit 2009.

21. Pas kësaj, Gjykata Supreme caktoi seancën përkitazi me rastin e parashtruesit të kërkesës. Në atë seancë, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës theksoi se nuk ishte e qartë nëse palët e dëmtuara e kishin paralajmëruar ankesën e tyre në pajtim me nenin 400 të KPK-së Përfaqësuesi i parashtruesit pretendoi se lëshimi i tyre për ta paralajmëruar ankesën i privoi ata nga e drejta për të paraqitur ankesë. Rrjedhimisht, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës kërkoi nga Gjykata Supreme që ta hedhë poshtë ankesën e tyre.

22. Më 4 maj 2010, Gjykata Supreme e Kosovës e lëshoi aktgjykimin K.ž Nr. 24/2010 pas ankesave të parashtruesit të kërkesës dhe të palëve të dëmtuara në rastin e mësipërm. Gjykata Supreme vendosi që: (a) ankesa e parashtruesit të kërkesës të refuzohet; (b) ankesa e palës së dëmtuar A. H. është hedhur poshtë si e paafatshme; dhe (c) ankesa e palës së dëmtuar E. P. të aprovohet.

23. Gjykata Supreme vendosi që aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë duhet të ndryshohet pjesërisht për shkak të disa rrethanave rënduese, siç janë: plumbi i gjuajtur nga arma e sulmit, i cili është ende në trupin e viktimës dhe gjendja mendore e të akuzuarit. Prandaj, parashtruesi i kërkesës u dënua me 12 vjet burgim, duke rezultuar me një dënim unik 12 vjet dhe 3 muaj burgim.

24. Më 1 shtator 2010, pas aktgjykimit mbi ndryshimin e dënimit të tij, parashtruesi i kërkesës, nëpërmjet Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës, paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës. Mbrojtja e parashtruesit të kërkesës pretendoi se kishte paraqitur kërkesë për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale dhe të Ligjit Penal. Si e

tillë, ata i propozuan Gjykatës Supreme ta ndryshojë aktgjykimin Kz Nr. 24/2010, të 4 majit 2010, dhe ta hedhë poshtë ankesën e palës së dëmtuar E. P. si të papranueshme apo ta kthejë rastin në kolegjin e shkallës së dytë të Gjykatës Supreme të Kosovës.

25. Në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë, përfaqësuesit e parashtruesit të kërkesës kanë pretenduar se Gjykata e ka interpretuar gabimisht nenin 400 të KPK-së përkitazi me faktin nëse pala e dëmtuar E. P. ka mundur të ankohet për këtë rast. Ata, gjithashtu, pretenduan se në rastin e përfaqësuesit të kërkesës është cenuar parimi elementar I*n Dubio pro Reo*.

26. Më 5 korrik 2011, në parashtresën e tyre me shkrim shtesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, përfaqësuesit e parashtruesit të kërkesës gjithashtu pretenduan se "Gjykata Supreme në seancën e kolegjit të mbajtur më 28 qershor 2011 për rastin e të pandehurit R. V., AP-Kz Nr. 238/2010, jep dënimin ligjor se ankesa e palës së dëmtuar nuk ishte e pranueshme, sepse nuk ishte paralajmëruar më herët, për ç'arsye ankesa e palës së dëmtuar S. D. është refuzuar dhe nuk është shqyrtuar". Rrjedhimisht, përfaqësuesit e parashtruesit të ankesës përsëritën bindjen e tyre se kolegji duhet të vendosë për rastin e parashtruesit të kërkesës, duke ndjekur shembullin e kolegjit në rastin Ap. (Kzh) nr. 238/2010.

27. Pavarësisht nga ajo që u tha më lart, më 23 gusht 2011, Gjykata Supreme lëshoi aktgjykimin e kontestuar përkitazi me rastin e parashtruesit të kërkesës me nr. Pkl-K 91/10 dhe hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

28. Gjykata Supreme, në arsyetimin e saj, thekson në veçanti: "Kolegji pranon se dispozita e nenit 400 të KPPK-së mund t'i nënshtrohet sqarimit. Kjo është një brengë më tepër, sepse ka mospërputhje ndërmjet versionit të gjuhës angleze dhe gjuhës shqipe të nenit 400. Përderisa paragrafi 4 në versionin e gjuhës angleze thotë "nëse i akuzuari dënohet me burgim dhe paralajmëron ankesë", versioni në gjuhën shqipe thotë se "dhe i akuzuari nuk paralajmëron ankesë".

29. Gjykata Supreme më tutje përmend se "... versioni autentik i Ligjit, versioni në gjuhën angleze, do të mbizotërojë. Ky version nuk specifikon cili person ka të drejtë të paralajmërojë. Mungesa e specifikimit në ligj duhet të interpretohet në atë mënyrë që të sigurojë trajtim të drejtë të palëve në procedurë".

30. Për më tepër, Gjykata Supreme theksoi se "në lidhje me zbatimin e parimit *In Dubio pro Reo*, në këtë rast Gjykata Supreme dëshiron të qartësojë se neni 3, paragrafi 2 i KPPK-së zbatohet vetëm në rastin kur dyshimi në lidhje me ekzistencën e fakteve që janë relevante për këtë rast apo në lidhje me zbatimin e dispozitave të caktuara të Ligjit Penal. Ky nuk është rast i tillë, pasi që ka të bëjë me interpretimin e ligjit në procedurë".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

31. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e nenit 24 [Barazia para ligjit] dhe të nenit 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës pretendon se duhet të prishet aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme.

Ligji i aplikueshëm

Neni 400

(1) Personat me të drejtë ankese (neni 399 i këtij Kodi) detyrohen ta paralajmërojnë ankesën. Ata ankesën mund të paralajmërojnë menjëherë pas shpalljes së aktgjykimit ose pas udhëzimit mbi të drejtën në ankesë (neni 394, paragrafi 1 i këtij Kodi), por jo më vonë se tetë ditë nga dita e shpalljes së aktgjykimit.

(2) Kur personi me të drejtë ankese nuk e paralajmëron ankesën brenda afatit të paraparë ligjor, konsiderohet se ai ka hequr dorë nga e drejta në ankesë, përveç në rastin nga paragrafi 4 i këtij neni.

(3) Kur askush nga personat me të drejtë ankese (neni 399 i këtij Kodi) nuk paralajmëron ankesë, nuk është e nevojshme që aktgjykimi i përpiluar me shkrim të përfshijë arsyetimin. Në rastin e tillë nuk është i nevojshëm as përshkrimi i audioincizimit të shqyrtimit gjyqësor.

(4) Kur i akuzuari dënohet me burgim dhe nuk paralajmëron ankesë, aktgjykimi i shkruar duhet të përfshijë arsyetimin dhe duhet bërë transkribimin e audioincizimit.

(5) Derisa gjykata e shkallës së dytë të marrë vendim, ankuesi mund të tërheqë ankesën. Tërheqja e ankesës nuk mund të revokohet.

Neni 399 i KPPP-së thotë si në vijim:

(1) Ankesë mund të paraqesin palët, mbrojtësi, përfaqësuesi ligjor i të akuzuarit dhe i dëmtuari.

(2) Prokurori publik mund të paraqesë ankesë në dëm dhe në dobi të të akuzuarit.

(3) I dëmtuari mund të ushtrojë ankesë ndaj aktgjykimit vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionet penale për veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër

integritetit seksual, kundër sigurimit të trafikut publik dhe për shpenzimet e procedurës penale. Por, nëse prokurori publik ka ndërmarrë ndjekjen nga paditësi subsidiar (neni 65, paragrafi 2 i këtij Kodi), i dëmtuari mund të paraqesë ankesë për të gjitha arsyet për të cilat mund të ushtrohet ankesë ndaj aktgjykimit (neni 402 i këtij Kodi).

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

32. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë për pranueshmëri, siç specifikohen më tutje në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës.

33. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në rastin e tashëm është ankuar për shkeljen e të drejtës së tij për trajtim të barabartë dhe gjykim të drejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

34. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i ka shterur të gjitha mjetet në dispozicion dhe e ka paraqitur kërkesën e tij brenda afatit të paraparë me nenin 49 të Ligjit.

35. Gjykata gjen se kjo kërkesë është qartazi e pabazuar sipas rregullit 36 të Rregullores.

36. Parashtruesi i kërkesës pretendon që, për shkak se Gjykata Supreme e Kosovës ka nxjerrë atë që duket të jetë aktgjykim i ndryshëm në rastin që ai pretendonte se ishte i ngjashëm me rastin e tij, për shkak se ai ishte i privuar nga e drejta e trajtimit të barabartë, sipas nenit 24 të Kushtetutës dhe nenit 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut. Parashtruesi i ankesës, gjithashtu, pretendon se ishte i privuar nga e drejta për gjykim të drejtë sipas nenit 31 (1) dhe (2) të Kushtetutës, nenit 6(1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenit 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

37. Neni 24 (2) i Kushtetutës parasheh:

> 2. “Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal”.

38. Neni 24 (3) i Kushtetutës parasheh:

> 3. “Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë”.

39. Neni 31 (2) parasheh se çdokush ka të drejtë në “...një gjykim të drejtë dhe të paanshëm...”

40. Parashtruesi i kërkesës thjesht pretendon që, për shkak se Gjykata Supreme e ka interpretuar aplikimin e ligjit të procedurës në ndonjë rast tjetër ndryshe nga ajo në rastin e tij, i është cenuar e drejta e tij kushtetuese në trajtim për barabartë dhe se atij nuk i ishte ofruar gjykim i drejtë. Parashtruesi i kërkesës nuk kishte provuar se ai nuk ishte trajtuar barabar me qytetarët e tjerë për shkak të statusit të tij.

41. Parashtruesi i kërkesës ka dështuar të provojë se rasti i tij ishte faktikisht apo ligjërisht identik me një rast tjetër të Gjykatës Supreme, ku del se Gjykata Supreme ka arritur një përfundim të ndryshëm ligjor të ligjit të njëjtë të procedurës së aplikuar në rastin e tij.

42. Parashtruesi i kërkesës ka dështuar të provojë se ai nuk kishte pasur gjykim ose dëgjim të drejtë.

43. Për të konstatuar shkeljen kushtetuese, parashtruesi i kërkesës duhet të provojë se një gjykatë e rregullt kishte arritur dy a më shumë përfundime kontradiktore ligjore ose faktike.

44. Siç është theksuar nga Gjykata Kushtetuese në rastin nr. KI06/09, Parashtruesi X k. Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Nr. 215/2006, Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Nr. 741/2005, Aktgjykimit të Gjykatës Komunale Nr. 217/2004:

> *"... Gjykata dëshiron të theksojë se nuk është gjykatë e apelit për gjykatat e tjera në Kosovë dhe se nuk mund të ndërhyjë mbi bazën se gjykatat e tilla kanë marrë vendim të gabuar ose kanë bërë vlerësim të gabuar të fakteve. Roli i Gjykatës është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt", (shih: mutatis mutandis, ndër të tjera, Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R. J. D, 1996-IV, para. 65).*

45. Siç është theksuar nga Gjykata Kushtetuese në rastin nr. KI06/09, Parashtruesi X kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Nr. 215/2006, Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Nr. 741/2005, Aktgjykimit të Gjykatës Komunale Nr. 217/2004:

> *"Fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës është i pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mundet që vetvetiu të ngrejë pretendim të diskutueshëm të shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës (shih: mutatis mutandis Aktgjykimi KEDNJ Appl. Nr. 5503/02, Mezotur Tiszazugi Tarsulat k. Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005)".*

46. Në këtë kërkesë, parashtruesi thjesht ka sugjeruar që Gjykata Supreme e Kosovës ka qenë kontradiktore në interpretimin e saj ligjor të Ligjit të Procedurës Penale. Një pretendim i tillë, pa më shumë prova, e nxjerr këtë kërkesë si qartazi të pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 48, 56 të Ligjit dhe me rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në seancën e mbajtur më 13 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Prof. Dr. Enver Hasani

KI 20/12 datë 28 shtator 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr. 590/2011, të 23 shtatorit 2011

Rasti KI 20/2012, vendimi i datës 19 shtator 2012
Fjalët kyçe:Kontest administrativ, E drejta për pension për personat me aftësi te kufizuara, kërkesa individuale, kërkesa e paafatshme.

Parashtruesi e kishte dorëzuar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke pretenduar se Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, me Aktgjykimin A. nr. 590/2011, të 23 shtatorit 2011, duke ia refuzuar përfundimisht të drejtën për njohjen e statusit të personit me aftësi të kufizuar, ka bërë shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, shkelje të cilat parashtruesi i kërkesës nuk i ka specifikuar në kërkesën e tij. Parashtruesi i kërkesës ndër të tjera, kishte kërkuar që t'i bëhet kompensimi në të holla për lëndimin e pësuar, për shkak të fatkeqësisë që i kishte ndodhur atij në vendin e punës.

Gjykata, në këtë rast ka vërejtur se parashtruesi i kërkesës e kontestonte Aktgjykimin A. nr. 590/2011 të Gjykatës Supreme, të 23 shtatorit 2011, të cilin, sipas librit të evidencës së Gjykatës Supreme e kishte pranuar më 26 tetor 2011. Ndërsa, i njëjti kërkesën në Gjykatë e kishte parashtruar më 1 mars 2012, që nënkupton se kërkesa është parashtruar jashtë afatit katër (4) mujor, të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës dhe për këtë arsye kërkesa nga Gjykata është shpallur si e papranueshme.

Prishtinë, më 24 shtator 2012

Nr. ref.: RK301/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 20/12

Parashtruesi

Halim Hajredinaj

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. nr. 590/2011, të 23 shtatorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Halim Hajredinaj, nga fshati Stanovc i Epërm, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar gjyqësor është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), A. nr. 590/2011, i 23 shtatorit 2011, të cilin parashtruesi e ka pranuar më 26 tetor 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës/lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) është çështja e njohjes së të drejtës për pension invalidor.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 dhjetorit 2009, i hyrë në fuqi më 15 janar 2010 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregulli 28 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtuese

5. Më 1 mars 2012, Gjykata pranoi kërkesën e z. Halim Hajredinaj dhe e regjistroi atë me nr. KI 20/12.

6. Më 2 mars 2012, Kryetari, me vendimin GJR 20/12 caktoi gjyqtar raportues gjyqtarin Ivan Čukalović. Të njëjtën ditë, Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova (anëtare) dhe Kadri Kryeziu (anëtar).

7. Më 11 maj 2012, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 25 maj 2012, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga Gjykata Supreme dëshmi përkitazi me datën e pranimit të Aktgjykimit A. nr. 590/2011, të 23 shtatorit 2011, nga parashtruesi.

9. Më 7 qershor 2012, Gjykata Supreme dorëzoi përgjigjen në kërkesë dhe e informoi Gjykatën se parashtruesi e ka pranuar Aktgjykimin A. nr. 590/2011, të 23 shtatorit 2011, më 26 tetor 2011.

10. Më 19 shtator 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi Raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 6 nëntor 1989, Bashkësia Themelore e Sigurimit Pensional e Invalidor të Kosovës, në bazë të Aktvendimit nr. 7011636939, konstaton se te parashtruesi i kërkesës, për shkak të lëndimit në punë, ekziston invaliditeti i kategorisë së III-të. Organizata e Punës së Bashkuar ishte obliguar që parashtruesin e kërkesës ta sistemonte në ndonjë vend tjetër të punës që i përgjigjej aftësisë së tij për punë, të siguronte kompensim në të holla për lëndimin e pësuar në punë, dhe të siguronte mbrojtjen e të drejtave sipas kushteve dhe mënyrave që ishin të përcaktuara me aktivitetet e përgjithshme të kësaj organizate.

12. Më 6 nëntor 2007, ndërmarrja "Trepça", në bazë të Aktvendimit Nr-L 505, ia aprovon parashtruesit kërkesën për përfitimin e pensionit të parakohshëm**.**

13. Më 3 shkurt 2011, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejmë: MPMS, përkatësisht Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, DAPK), në bazë të Vendimit me numër të dosjes 5098514, ia refuzoi kërkesën për përfitimin e pensionit për persona me aftësi të kufizuar, me arsyetimin se te parashtruesi i kërkesës nuk ekziston aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme.

14. Më 28 prill 2011, MPMS, përkatësisht DAPK, me Aktvendimin me nr. të dosjes 5098514, vendosi për ankesën e parashtruesit, me ç'rast ia refuzoi kërkesën për njohjen e të drejtës për pensionim të parakohshëm, duke u pajtuar kështu me vlerësimin e komisionit mjekësor, si shkallë e parë, që kishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk i plotëson kriteret për pensionim të personave me aftësi të kufizuar.

15. Më 1 korrik 2011, parashtruesi inicioi procedurë për konflikt administrativ në Gjykatën Supreme, kundër Aktvendimit me nr. 5098514, të 3 shkurtit 2011, të DAPK-së.

16. Më 23 shtator 2011, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin A. nr. 590/2011, duke vendosur sipas padisë së parashtruesit për konflikt administrativ, refuzoi padinë e ushtruar nga parashtruesi më 1 korrik 2011, me arsyetimin që komisionet mjekësore të autorizuara me ligj vërtetuan se te parashtruesi nuk ekziston aftësia e kufizuar për punë, prandaj, siç pohon Gjykata Supreme, organet administrative kanë zbatuar drejt dispozitën e nenit 3 të Ligjit për konfliktin administrativ.

Pretendimet e parashtruesit

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, me Aktgjykimin A. nr. 590/2011, të 23 shtatorit 2011, duke ia refuzuar përfundimisht të drejtën për njohjen e statusit të personit me aftësi të kufizuar, ka bërë shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, shkelje të cilat parashtruesi i kërkesës nuk i ka specifikuar në kërkesën e tij.

18. Parashtruesi i kërkesës kërkon, ndër të tjera, që t'i bëhet kompensimi në të holla për lëndimin e pësuar, për shkak të fatkeqësisë që i kishte ndodhur atij në vendin e punës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit duhet që, së pari, të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret procedurale për pranueshmëri, të parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe në Rregulloren e punës së Gjykatës.

20. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin A. nr. 590/2011 të Gjykatës Supreme, të 23 shtatorit 2011, të cilin, sipas librit të evidencës së Gjykatës Supreme, e ka pranuar më 26 tetor 2011. Ndërsa, kërkesën në Gjykatë, parashtruesi e parashtroi më 1 mars 2012, që nënkupton se kërkesa është parashtruar jashtë afatit katër (4) mujor, të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës.

21. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që nënvizon:

Neni 49 [Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...]"

22. Nga ajo që u tha më lartë, del se parashtruesi e ka parashtruar kërkesën e tij jashtë afatit të paraparë me Ligj dhe Rregullore të punës së Gjykatës.

23. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit, me Rregullin 56. (2) të Rregullores së punës, kërkesa konsiderohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe me rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, më 19 shtator 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Prof. Dr. Enver Hasani

KI 75/10 datë 28 shtator 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 942/2009, të 24 marsit 2010

Lënda KI 75/10,
Fjalët kyçe; kërkesë individuale, vlerësim i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës

Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën në pajtim me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009.

Me 4 gusht 2010, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Me 21 tetor 2010, Kryetari e caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Snezhana Botusharova

Me 21 maj 2009, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për pension të aftësisë së kufizuar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Administratës Pensionale të Republikës së Kosovës (DAPK).
Me 1 shtator 2009, DAPK (Vendimi Nr. 5093399) e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për arsye se Komisioni mjekësor kishte konkluduar se "te parashtruesi nuk ekziston aftësia e kufizuar e plotë dhe përhershme."

Më 13 tetor 2009, parashtruesi ushtroi ankesë kundër vendimit të DAPK-së.
Më 23 tetor 2009, Këshilli i Ankesave i DAPK-së, me Vendimin Nr. 5093399 e refuzoi ankesën e parashtruesit.
Më 17 nëntor 2009 parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për korrigjimin e Vendimit nr. 5093399 të 23 tetorit 2009 në lidhje me datën e hartimit te të njëjtit që DAPK e mori me 20 nëntor 2009. Ai po ashtu bëri një pyetje për të shqyrtuar dhe fotokopjuar lëndën e cekur.

Më 1 dhjetor 2009 DAPK i dërgoi parashtruesit të kërkesës njoftim me numër të referencës 345/2009 me të cilin e njofton për të drejtën e ankesës.
Më 2 dhjetor 2010, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme ndaj vendimit të Këshillit të Ankesave të DAPK-së për arsyet e cekura me poshtë.

Më 21 dhe 30 prill 2010, Gjykata Supreme CAgj.nr. 217/2010) e informoi parashtruesin e kërkesës se kjo gjykatë (Gjykata Supreme) pas marrjes së vendimit i kishte kthyer shkresat e lëndës si dhe vendimin A. nr. 942/2009 Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale -Departamentit te Administratës Pensionale -Këshillit për Ankesa për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara me seli ne Prishtinë."
" Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Supreme: "të miratojë kërkesë padinë si të bazuar; të anulojë në tërësi Vendimin nr. 5093399 të 13 tetorit 2009 të Këshillit për Ankesa pranë Departamentit të Administratës Pensionale të Republikës së Kosovës si të paligjshëm dhe ta kthejë rastin për korrigjim apo që Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës të vendosë në mënyrë meritore për këtë çështje administrative."
Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka provuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij në baza kushtetuese duke treguar se pse dhe si Gjykata Supreme ka bërë shkelje të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetute dhe Konventën Evropiane, dhe nuk ka ofruar prova se i janë cenuar të drejtat dhe liritë nga ana e Gjykatës Supreme. Prandaj Gjykata Kushtetuese nuk mund të gjej se përse dhe në çfarë mënyrë procedurat përkatëse, kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo të njollosura nga arbitrariteti (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-se në lidhje me pranueshmerinë e kërkesës, nr. 17064/06, te 30 qershorit 2009).
Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e kësaj kërkese, Gjykata Kushtetuese e Kosovës në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullave 36. (1a) dhe 36. (3c) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 17 janar 2012, njëzëri vendosi ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme.

Prishtinë, më 26 shtator 2012

Nr. ref. RK305/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 75/10

Parashtruesi

Blerim Hoxha

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 942/2009, të 24 marsit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Ivan Čukalović gjyqtar,

Kërkesa

1. Kërkesën e ka parashtruar Blerim Hoxha (Parashtruesi i kërkesës) nga komuna e Pejës.

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 942/2009, të 24 marsit 2010, i cili i ishte dorëzuar më 13 prill 2010.

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr. 942/2009, të 24 marsit 2010 me të cilin parashtruesit të kërkesës iu hodh poshtë kërkesë padia për pranimin e të drejtës për pension për persona të aftësisë së kufizuar.

4. Parashtruesi pretendon për shkelje të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenit 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 26 [E Drejta e Integritetit Personal], nenit 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike], nenit 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale], dhe nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

5. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) më 4 gusht 2010.

7. Më 16 gusht 2010, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme se kërkesa ishte pranuar dhe regjistruar..

8. Më 21 tetor 2010, Kryetari e caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Snezhana Botusharova.

9. Më 20 qershor 2011, Gjykata i kërkoi DAPK-së sqarim nëse parashtruesi kishte qenë i ftuar në seanca në organe të shkallës së parë dhe të dytë të DAPK-së.

10. Më 4 korrik 2011, DPAK informoi se "përmes autoritetit përkatës të Zyrës së Komisionit Mjekësor, kishte përfunduar vlerësimin më 17 gusht 2009 me një komision të përbërë prej tre mjekëve të cilët me nënshkrimin e vet vërtetojnë se e kanë kryer "kontrollimin dhe vlerësimin" e parashtruesit" në përputhje me nenin 4, paragrafin 6, të Ligjit për Pensionet e personave me aftësi të kufizuar (Ligji Nr. 2003/23). DAPK po ashtu dorëzoi fotokopje të vlerësimit të sipërpërmendur. DAPK tha më tej se parashtruesi nuk ishte i pranishëm në seancën e shkallës së dytë dhe ku ceket në Vendimin nr. 5093399, të 23 tetorit 2009, se ishte i pranishëm, ky ishte një gabim administrativ.

11. Më 2 korrik 2012 Kryetari e emëroi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar Raportues në zëvendësim të gjyqtares Gjyljeta Mushkolaj.

12. Më 10 korrik 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit Raportues, Kolegji Shqyrtues i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 21 maj 2009 parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për pension të aftësisë së kufizuar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Administratës Pensionale të Republikës së Kosovës (DAPK).

14. Më 1 shtator 2009, DAPK (Vendimi Nr. 5093399) e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për arsye se Komisioni mjekësor kishte konkluduar se "tek parashtruesi nuk ekziston aftësia e kufizuar e plotë dhe përhershme".

15. Më 13 tetor 2009, parashtruesi u ankua kundër vendimit të DAPK-së. duke argumentuar se i njëjti është "plotësisht i pavlefshëm sepse vendimi ishte marrë në kundërshtim me procedurën e paraparë me dispozitat e Ligjit për Pensionet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë dhe Ligjit për procedurën administrative". Parashtruesi tha se Komisioni nuk e kishte dëgjuar atë.

16. Më 26 tetor 2009, 28 tetor 2009 dhe më 16 maj 2010, parashtruesi i kërkesës kërkoi të shqyrtonte, korrigjonte dhe fotokopjonte shkresat e lëndës (Nr. 5093399).

17. Më 23 tetor 2009, Këshilli i Ankesave i DAPK-së, me Vendimin Nr. 5093399 e refuzoi ankesën e parashtruesit të 13 tetorit 2009duke theksuar se "nuk ka prova të mjaftueshme ai të bëhej përfitues valid i pensionit për persona me aftësi të kufizuara". Gjithashtu u tha që "ekspertët e Komisionit mjekësor të shkallës së dytë në seancën mjekësore në prani të parashtruesit vlerësuan tërë dokumentacionin mjekësor". Këshilli i ankesave i DAPK-së më tej konkludoi se nuk kishte prova të mjaftueshme për t'u bërë përfitues valid i pensionit për persona me aftësi të kufizuar.

18. Të paktën më 29 tetor 2009, DAPK e informoi parashtruesin e kërkesës se "më 13.10.2009 e dërgoi ankesën se bashku me tërë shkresat e lëndës Këshillit të Ankesave për shqyrtimin e të gjitha pretendimeve të paraqitura në ankesë".

19. Më 17 nëntor 2009 parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për korrigjimin e Vendimit nr. 5093399 të 23 tetorit 2009 në lidhje me datën e hartimit të të njëjtit që DAPK e mori më 20 nëntor 2009. Ai po ashtu bëri një pyetje për të shqyrtuar dhe fotokopjuar lëndën e cekur.

20. Më 1 dhjetor 2009 DAPK i dërgoi parashtruesit të kërkesës njoftim me numër të referencës 345/2009 me të cilin e njofton për të drejtën e ankesës.

21. Të paktën më 21 dhe 30 prill 2010, si dhe më 12 maj 2010, parashtruesi paraqiti kërkesë në Gjykatën Supreme për rishikim dhe fotokopjim të lëndës A. nr. 942/2009. Parashtruesi i kërkesës e mbështeti kërkesën e tij në nenin 41 të Kushtetutës në lidhje me nenet 1, 3 dhe 60 të LKA-së në lidhje me nenin 122, paragrafin 1, të Ligjit për procedurën kontestimore të Republikës së Kosovës (2008/03-L006).

22. Më 2 dhjetor 2010, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme ndaj vendimit të Këshillit të Ankesave të DAPK-së për arsyet e cekura më poshtë.

23. Parashtruesi i kërkesës më tej kërkoi nga Gjykata Supreme "të caktojë seancën e kolegjit (...) për të qartësuar më mirë çështjen, sqarime shtesë duhet bërë në lidhje me dëgjimin e palëve për të shmangur kundërthëniet dhe në bazë të ligjit të merret një vendim i drejtë".

24. Më 24 mars 2010, Gjykata Supreme "gjeti se kërkesë padia është e pabazuar" dhe konkludoi që (...) parashtruesi i kërkesës nuk i përmbush kushtet ligjore për pranimin e të drejtës së kërkuar".

25. Më 21 dhe 30 prill 2010, Gjykata Supreme (Agj.nr. 217/2010) e informoi parashtruesin e kërkesës se kjo gjykatë (Gjykata Supreme) pas marrjes së vendimit i kishte kthyer shkresat e lëndës si dhe vendimin A. nr. 942/2009 Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamentit të Administratës Pensionale – Këshillit për Ankesa për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara me seli në Prishtinë".

Argumentet ligjore

26. Parashtruesi i kërkesës e mbështeti ankesën e tij drejtuar Gjykatës Supreme mbi këto baza: 1. E njëjta ka dështuar të zbatojë apo e ka zbatuar në mënyrë të gabuar dispozitat e të drejtës materiale apo dispozitat e rregulloreve materiale 2. Vendimi i kontestuar është nxjerrë nga ana e një institucioni të paautorizuar, 3 Procedurat që i paraprin nxjerrjes së vendimit nga institucioni i paditur nuk kanë zbatuar dispozitat procedurale apo nuk vepruan në pajtim me rregulloret procedurale, posaçërisht gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë apo është marrë vendim i gabuar nga vërtetimi i fakteve në raport me gjendjen faktike; 4. Shkelje esenciale të dispozitave të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

27. Parashtruesi i kërkesës i përmbylli pretendimet e tij duke pohuar se "Vendimi i kontestuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të nenit 10 paragrafi 1 pika 3 të Ligjit për

Procedurën Administrative në lidhje me nenin 2 paragrafi 2, me nenin 3 paragrafin 2 pikën a), b), c), d) të Ligjit për pensionet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë (...)".

28. Në fund parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Supreme: "të miratojë kërkesë padinë si të bazuar; të anulojë në tërësi Vendimin nr. 5093399 të 13 tetorit 2009 të Këshillit për Ankesa pranë Departamentit të Administratës Pensionale të Republikës së Kosovës si të paligjshëm dhe ta kthejë rastin për korrigjim apo që Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës të vendosë në mënyrë meritore për këtë çështje administrative".

29. Si përfundim, parashtruesi i kërkesës ngrit një numër pretendimesh të ndryshme:

a)në kërkesë, por jo në ankesën e ushtruar pranë Gjykatës Supreme;

b) në ankesën e ushtruar pranë Gjykatës Supreme por duke kontestuar ligjshmërinë e aktgjykimit;

c) në ankesën e ushtruar pranë Gjykatës Supreme duke kontestuar shkeljet e të drejtave të njeriut.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Në këtë moment, Gjykata konsideron se për vlerësimin e pretendimeve dhe argumenteve ligjore të paraqitura nga ana e parashtruesit të kërkesës si dhe për vlerësimin e pranueshmërisë është me vend që të sillen ndër mend disa dispozita relevante ligjore.

31. Neni 113 (1) dhe (7) i Kushtetutës përcakton që:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

32. Neni 47 (2) i Ligjit parashikon që:

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

33. Neni 48 i Ligjit po ashtu përcakton se:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

34. Përveç kësaj, rregulli 36 i Rregullores së Punës parashikon si në vijim.

(1) Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

a) janë shterur të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar.

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

35. Në fund, neni 48 i Ligjit përcakton që:

"Gjykata Kushtetuese pranon dhe procedon kërkesën (...) nëse konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore."

36. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës është i obliguar që ta ngrit kërkesën në Gjykatë "*në mënyrë ligjore*", në të vërtetë "*pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*. Në fund Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën "*nëse konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore"*.

a) Pretendimet e ngritura në kërkesë por që nuk janë ngritur në ankesën e ushtruar pranë Gjykatës Supreme

37. Parashtruesi i kërkesës e thekson në kërkesën e tij "Më janë shkelur të drejtat gjatë procedurës administrative të udhëhequr nga Departamenti i Administratës Pensionale (DAPK) në procedurën në shkallën e parë dhe të dytë si dhe në procedurën pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, si në vijim: a) E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, b) e drejta për qasje në

dokumentet publike c) e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, d) e drejta për ndalimin e torturës, trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues, e) e drejta për integritet personal, f) e drejta për mbrojtje të barabartë ligjore pa diskriminim, e drejta në dinjitetin e njeriut g) e drejta për zbatim të drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare dhe nën i) e drejta për parime të përgjithshme. Këto të drejta janë paraparë në paragrafin 3 të preambulës së Kushtetutës, në lidhje me nenin 21, 22, 23, 24, 26, 27, 31, 41, 51, 55 të Kushtetutës në lidhje me preambulën e Deklaratës Universale në lidhje me nenin 2.2,4 të pjesës së dytë të Deklaratës Universale në lidhje me nenin 9 të pjesës së tretë në lidhje me nenin 30 të pjesës së pestë të Deklaratës Universale në lidhje me preambulën e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (në tekstin e mëtejmë Konventa Ndërkombëtare) në lidhje me nenin 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

38. Siç mund të shihet nga citati i lartpërmendur, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur një numër të pretendimeve të përsëritura dhe të ndryshme të cilat nuk ishin ngritur në Gjykatën Supreme, përfshirë pretendimet për shkelje të nenit 21 [Parimet e përgjithshme], nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare], nenit 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 26 [E drejta për integritet personal], neni 27 [Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor dhe poshtërues] të Kushtetutës.

39. Megjithatë, duke marrë parasysh parimin e subsidiaritetit dhe rregullin e shterimit, Gjykata vetëm mund të marrë parasysh pretendimet e ngritura pranë Gjykatës Supreme që është autoriteti përfundimtar intervenues.

40. Gjykata konsideron se arsyetimi për kërkesën e shterimit është që t'iu ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (shih *mutatis*

mutandis, GJEDNJ Selmouni kundër Francës, nr. 25803194, vendim i datës 28 korrik 1999).

41. Pra parashtruesi i kërkesës duke dështuar që të ndërmarrë ndonjë hap procedural në gjykatat e rregullta, më saktësisht në Gjykatën Supreme, ka gjasa që rasti t'i shpallet i papranueshëm pasi që do të kuptohet si heqje dorë nga procedurat e mëtutjeshme në kundërshtimin e shkeljes. (Shih Aktvendimin për papranueshmëri, Rasti nr. KI16/12, paragrafi 25).

42. Kjo do të thotë se të gjitha pretendimet e ngritura jashtë ankesës së ushtruar në Gjykatën Supreme nuk do të merren parasysh pasi që parashtruesi i kërkesës ka hequr dorë nga e drejta për t'u ankuar në lidhje to.

b) Pretendimet në ankesën e ushtruar në Gjykatën Supreme me të cilat kontestohet ligjshmëria e aktgjykimit

43. Gjykata konsideron se bazat e ankesës së parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Supreme nën 1, 2 dhe 3 kanë të bëjnë ekskluzivisht me ligjshmërinë; asnjë nga këto baza nuk mbështet në shkelje të të drejtave të njeriut. Në fakt, parashtruesi i kërkesës pretendon aktgjykimi i Gjykatës Supreme "nuk i zbatoi apo i zbatoi në mënyrë të gabuar të dispozitat ligjore materiale apo dispozitat e rregulloreve materiale"; "ishte nxjerrë nga institucioni i paautorizuar", nuk i zbatoi dispozitat procedurale"; "gjendja faktike nuk ishte vërtetuar në mënyrë të drejtë".

44. Gjykata e rithekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabime të fakteve apo të ligjit (ligjshmëria) që pretendohet se janë kryer nga Gjykata Supreme, përderisa dhe për aq sa ato nuk i kenë cenuar të drejtat dhe liritë e garantuara me kushtetutë (kushtetutshmëria). Prandaj, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së tretë në këtë rast. Është detyrë

dhe obligim i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për te Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

45. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të tillë ashtu që procedurat pranë gjykatave të rregullta në përgjithësi, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete te tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa nr. 13071/87, të miratuar më 10 korrik 1991).

c) Pretendimet në ankesën e ushtruar në Gjykatën Supreme me të cilat kontestohen shkeljet e të drejtave të njeriut

46. Parashtruesi i kërkesës e mbështeti ankesën e ushtruar në Gjykatën Supreme në "shkeljet esenciale të dispozitave të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut" pa përmendur në ankesën e tij ndonjë dispozitë juridike qoftë të Kushtetutës qoftë të Konventës Evropiane. Për më tepër, asnjë argument nuk mbështet pretendimin. Ankesa e parashtruesit të kërkesës përveç përmendjes së thjeshtë mbetet e heshtur në raport me këtë bazë.

47. Megjithatë, siç u tha më lart, parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij ka theksuar "shkelje esenciale të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtës për qasje në dokumentet publike, të drejtës për ndalimin e torturës, trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues, të drejtës për integritet personal, të së drejtës për mbrojtje të barabartë ligjore pa diskriminim, të drejtës në dinjitetin e njeriut, të drejtës për zbatim të drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare dhe nën i) e drejta për parime të përgjithshme".

48. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës numëron shkelje të nenit 21, nenit 22 paragrafët 1, 2 dhe 3, nenit 23, nenit 24 paragrafët 1 dhe 2, nenit 26 paragrafët 2 dhe 3, nenit 27, nenit 31 paragrafët 1 dhe 2 nenit 41 paragrafët 1 dhe 2, dhe përfundimisht nenit 55 paragrafi 1". Siç duket këto nene janë të Kushtetutës.

49. Në pajtim me dispozitat ligjore të cituara më lart, pretendimi për „shkelje esenciale të dispozitave të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut" i ngritur në Gjykatën Supreme dhe, dhe tani për së dyti në Gjykatën Kushtetuese, duhet "të mbështetet në mënyrë të mjaftueshme me prova" në mënyrë që Gjykata të pranojë dhe procedojë kërkesën.

50. Sidoqoftë, vetëm përmendja e thjeshtë e të drejtave të cenuara dhe numërimi i dispozitave juridike kushtetuese nuk mjafton për të plotësuar kushtin e një kërkesë "të mbështetur në mënyrë të mjaftueshme me prova". Parashtruesi i kërkesës nuk i specifikon në ankesën e tij se cilat ishin faktet që po të analizoheshin në bazë të dispozitave të caktuara ligjore do të mund të çonin te konkluzioni se ka pasur shkelje.

51. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka provuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij në baza kushtetuese duke treguar se pse dhe si Gjykata Supreme ka bërë shkelje të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë dhe Konvetën Evropiane, dhe nuk ka ofruar prova se i janë cenuar të drejtat dhe liritë nga ana e Gjykatës Supreme. Prandaj Gjykata Kushtetuese nuk mund të gjej se përse dhe në çfarë mënyrë procedurat përkatëse, kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo të njollosura nga arbitrariteti (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).

52. Nga sa u tha më lart, Gjykata gjen se kërkesa nuk i plotëson kushtet nga neni 46 i Ligjit dhe rregulli 36.2 b) dhe d), si e tillë është qartazi e pabazuar, dhe në përputhje me nenin 48 të Ligjit, nuk mund të pranohet dhe procedohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së Punës, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Prof. Dr. Enver Hasani

KI 59/12 datë 17 tetor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 254/2009 të 16 janarit 2012

Rasti KI 59/2012, vendimi i datës 20 shtator 2012
Fjalët kyçe:Kontest pronësor, kërkesa individuale, kërkesa qartazi e pabazuar.

Parashtruesi e kishte dorëzuar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke pretenduar se Gjykata Supreme, duke miratuar revizionin e ushtruar nga Komuna e Kaçanikut, ka bërë shkelje të të drejtave kushtetuese të tij, të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës].
Gjykata në rastin konkret i është referuar nenit 48 te ligjit dhe rregullit 36.2 pika b) dhe d)të Rregullores së punës. Në këtë drejtim, Gjykata ka konstatuar se parashtruesi nuk kishte treguar pse dhe si Gjykata e Supreme, ia kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane dhe as që kishte ofruar prova për shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Në këtë drejtim, Gjykata konstatoi se parashtruesi nuk kishte treguar pse dhe si Gjykata e Supreme, ia kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane dhe as që kishte ofruar prova për shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.Gjykata, kishte theksuar se nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në këtë rast. Sepse eshtë detyrë dhe obligim i gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale, Gjykata në këtë rast ka përmendur rastin *García Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I). Gjykata në përfundim kishte konsideruar që kërkesa nuk i përmbushte kriteret e kërkuara në nenin 48 të Ligjit dhe të rregullit 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së punës, prandaj, si e tillë kërkesa është konsideruar si qartazi e pabazuar.

Prishtinë, më 26 shtator 2012

Nr. ref.: RK306/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rasti Nr. KI 59/12

Parashtruesi

Remzi Berisha

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 254/2009 të 16 janarit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKES SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i Kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Remzi Berisha (parashtruesi) me vendbanim në Kaçanik, i përfaqësuar nga Muhamet Beqiri, avokat nga Ferizaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), Rev. nr. 254/2009 të 16 janarit 2012, të cilin e ka pranuar me 7 shkurt 2012, me të cilin iu refuzua kërkesa për përsëritje të procedurës në gjykatën e shkallës së parë.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës ka të bëjë me shkeljet e pretenduara të të drejtave në pronë, të garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 28 i Rregullores

së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në gjykatë

5. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) më 6 qershor 2012.

6. Më 17 korrik 2012, Gjykata e njoftoi parashtruesin, Gjykatën Supreme dhe Kuvendin Komunal të Kaçanikut, për regjistrimin e kërkesës.

7. Më 5 korrik 2012, Kryetari, me Vendimin nr. GJR 59/12 caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë me Vendimin nr. KSH 59/12 caktoi gjithashtu Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues (anëtar) dhe Arta Rama-Hajrizi (anëtare).

8. Me 20 shtator 2012, Kolegji shqyrtuese e shqyrtoj raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoj Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

9. Më 3 nëntor 1987, Gjykata Komunale në Kaçanik (Aktvendim Nr. 121/1987) ia mori patundshmërinë Pk. nr. 1121 z. Hisni Berishes (toke ndërtimore e pa ndërtuar, në sipërfaqe prej 2351. m2, e evidencuar në fletën poseduese me nr. 92, në Kaçanik) dhe ia dha në posedim Komunës së Kaçanikut, gjegjësisht Lidhjes së Luftëtareve të LNÇ të kësaj Komune. Për patundshmërinë në fjalë vlera për kompensim ishte caktuar në bazë të çmimit të shitjes së tregut, sipas kategorizimit të patundshmërive. Por që z. Berisha nuk ishte pajtuar që kompensimi t'i behej në të holla të gatshme.

10. Më 3 korrik 2008, Gjykata Komunale në Kaçanik, (Aktgjykimi C. nr. 41/2002) miratoi kërkesën e parashtruesit dhe të tre bashkëpronareve tjerë, që të gjithë e kishin fituar të drejtën e shfrytëzimit nga ¼-ta e pjesë e patundshmërisë pk.nr.1121/2 (Vendi i quajtur "Oborr" me kulture, arë e kl. II-të), në sipërfaqe prej 0.25,08 hektarë dhe pjesën tjetër me kulturë jopjellore prej 0.03,09 hektarë, së bashku në sipërfaqe prej 0.28,17 hektarë, të evidentuara në fletën poseduese nr. 1177, zona kadastrale në Kaçanik. Më ketë aktgjykim është detyruar Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi në Kaçanik, që pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit t'i bëjë ndryshimet në librin e kadastrës. Arsyetimin e vet ajo gjykatë e mbështeti në faktin që Komuna e Kaçanikut e kishte shpronësuar pasurinë e cila është evidentuar në emër të Hisni Berishës, përderisa pasuria ishte e Rexhep Berishës. Komuna e Kaçanikut shpronësimin e kishte bërë në vitin 1987, gjersa ndryshimet kadastrale i kishte bërë në vitin 2002, dhe jo pasi që kishte përfunduar procedura e shpronësimit të patundshmërisë. Ajo gjykatë pohoi se nuk kishte gjetur asnjë evidencë që do të provonte se pagesa lidhur me këtë patundshmëri ishte përmbaruar nga autoritetet kompetente.

11. Kundër vendimit të Gjykatës Komunale në Kaçanik (Aktgjykimi C. nr. 41/2002 i 3 korrikut 2008) Komuna e Kaçanikut ushtroi ankese në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

12. Më 18 dhjetor 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, (Aktvendimi Ac. nr. 1030/2008) refuzoi si të pabazë ankesën e ushtruar nga Komuna e Kaçanikut dhe vërtetoi aktgjykimin e shkallës së parë C. nr. 41/2002 të 3 korrikut 2008.

13. Komuna e Kaçanikut e pakënaqur me vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë ushtroi revizion në Gjykatën Supreme.

14. Më 16 janar 2012, Gjykata Supreme, aprovoi si të bazuar revizionin e ushtruar nga Komuna e Kaçanikut dhe prishi vendimet (Aktgjykimin C. nr. 41/2002, të 3 korrikut 2008 dhe Aktvendimin Ac. nr. 1030/2008, të 18 dhjetorit 2008) e instancave me të ulëta dhe refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit më të cilën pretendohej se të njëjtit kanë fituar

të drejtën e shfrytëzimit të patundshmërisë, nga ¼-ta pjesë e parcelës kadastrale pk.nr.1121/2 (vendi e quajtur "Oborr" me kulture arë e kl. II-të, në sipërfaqe prej 0.25,08 hektarë dhe pjesën tjetër me kulturë jopjellore prej 0.03,09 hektarë, se bashku në sipërfaqe prej 0.28,17 hektarë, të evidentuara në fletën poseduese nr. 1177, zona kadastrale në Kaçanik). Gjykata Supreme arsyetohet se vendimet e instancave më të ulëta nuk mund të pranohen si të drejta dhe të ligjshme, nga se, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, sa i përket gjetjeve faktike të vërtetuara nga këto instanca, gabimisht është aplikuar e drejta materiale, kur ato kane gjetur se kërkesëpadia e paditëseve (ndër të cilët bënë pjesë edhe parashtruesi) është e pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon që, Gjykata Supreme, duke miratuar revizionin e ushtruar nga Komuna e Kaçanikut, ka bërë shkeljet e të drejtave kushtetuese të tij të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe Nenin 46 [Mbrojtja e Pronës].

Vlerësimi paraprak i pranueshmerisë së kërkesës

16. Së pari, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës. Gjykata konsideron që parashtruesi e ka arsyetuar kërkesën me një përmendje të qartë të shkeljeve të supozuara. Ai posaçërisht konteston vendimin e Gjykatës së Supreme, si aktin konkret të organit publik që është objekt i shqyrtimit. Ai qartazi tregon se çfarë dëshiron të arrijë dhe bashkëngjit vendime të ndryshme dhe informata e dokumente të tjera mbështetëse.

17. Neni 46.(3) i Kushtetutës përcakton në mënyrë specifike se:

> *"Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet" (Shih paragrafin 3 të nenit 46).*

18. "Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës, për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriim, do të zgjidhen nga gjykata kompetente" (*shih paragrafin 4 të nenit 46).*

19. Në këtë rast parashtruesi i kërkesës pretendon se, Gjykata Supreme, ka bërë gabime në aplikimin e ligjit dhe të fakteve në vendimin e saj, duke pretenduar se kompensimi që i është dhënë paraardhësit të tij nuk ka qenë adekuat dhe se arsyetimi juridik i Gjykatës Supreme kishte mangësi.

20. Megjithatë, me rastrin e shqyrtimit të mbështetjes me prova të kriterit të pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata, vëren që neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese përcakton që: *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar".*

21. Në anën tjetër, rregulli 36.2 i Rregullores së punës përcakton që

> *"Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:*
>
> *b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose*

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

22. Së fundi, neni 46 i Ligjit përcakton që "Gjykata Kushtetuese pranon dhe procedon kërkesën e ngritur sipas nenit 113 paragrafi 7 të Kushtetutës, nëse konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore".

23. Gjykata, rikujton që rasti duhet të ndërtohet në baza kushtetuese në mënyrë që kjo Gjykatë të ndërhyjë.

24. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk tregon pse dhe si Gjykata e Supreme ia ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane, as nuk ka ofruar prova për shkeljet e supozuara të të drejtave kushtetuese.

25. Gjykata, thekson se, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me lajthitjet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë) gjoja të kryera nga Gjykata e Supreme, përveç nëse dhe për aq sa ato mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Prandaj, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në këtë rast. Është detyrë dhe obligim i gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

26. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).

27. Në të vërtetë, parashtruesi nuk i ka mbështetur pretendimet e tij në baza kushtetuese, duke treguar pse dhe si Gjykata e Supreme ia ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane dhe nuk ka ofruar prova që të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga Gjykata Supreme. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të gjejë pse dhe si procedurat përkatëse në Gjykatën Supreme, ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

28. Nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata gjen që kërkesa nuk i përmbush kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe të rregullit 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së punës, prandaj, si e tillë, është qartazi e pabazuar dhe, në pajtim me nenin 46 të Ligjit, nuk mund të pranohet dhe procedohet.

29. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56.2 të Rregullores së Punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim nenin 46 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 20 shtator 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues	**Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**
Robert Carolan	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 62/12 datë 17 tetor 2012- Kërkesë për interpretimin e Kushtetutës

Lënda KI 62/12, vendimi i 20 shtatorit 2012.

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, actio popularis, personi i paautorizuar

Parashtruesi i kërkesës paraqiti një kërkesë në përputhje me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese interpretimin e një numri të madh të neneve të Kushtetutës, pavarësisht nga fakti se parashtruesi i kërkesës nuk specifikon saktë asnjë nen të Kushtetutës për të cilin kërkon interpretimin, por nga kërkesa mund të konkludohet se behët fjalë për një numër të madh të normave kushtetuese për të cilat parashtruesi i kërkesës kërkon interpretim.

Parashtruesi i kërkesës nuk i ka paraqitur Gjykatës faktet konkrete në lidhje me kërkesën lëndore, por e drejton Gjykatën në një numër të madh të faqeve të internetit dhe shpreh gatishmërinë për të ndihmuar Gjykatën në gjetjen e fakteve. Gjithashtu, parashtruesi në kërkesën kërkon mbrojtjen e identitetit personal.

Parashtruesi i kërkesës nuk i ka cekur nenet e Kushtetutës të cilat pretendon se janë shkelur dhe gjithashtu nuk ka ofruar prova të tjera që do të janë të relevante për vendimin e gjykatës.

Duke vendosur mbi kërkesën e parashtruesit Liridon Aliu, Gjykata Kushtetuese konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk është pale e autorizuar për të kontestuar kushtetutshmërinë e një numri të madh të normave kushtetuese në abstrakt dhe prandaj, këtë kërkesë e ka shpallur të papranueshme, sepse kërkesa është paraqitur nga personi i paautorizuar.

Prishtinë, 28 shtator 2012

Nr. ref.:RK308/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 62/12

Parashtruesi

Liridon Aliu

Kërkesë për interpretimin e Kushtetutës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović , Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almira Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Liridon Aliu, kryetar i organizatës joqeveritare (OJQ) "Ngrite zërin dhe ti" (NZT), nga fshati Hajvali, Komuna e Prishtinës.

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes është interpretimi i një numri të madh të neneve të Kushtetutës, edhe pse parashtruesi i kërkesës nuk cek qartë se për cilat nene të Kushtetutës ka kërkuar interpretim, nga kërkesa mund të konkludohet se parashtruesi kërkon interpretimin e shumicës së normave kushtetuese.

Baza juridike

3. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56 paragrafi 2 të Rregullores së punës.

Procedura në Gjykatë

4. Më 28 qershor 2012, parashtruesi i kërkesës i parashtroi kërkesën Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata). Njëkohësisht, parashtruesi kërkon edhe mbrojtjen e identitetit, pa cekur arsyet se pse e kërkon mbrojtjen e identitetit.

5. Më 10 korrik 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi parashtruesin e kërkesës se kërkesa e tij është regjistruar në Gjykatë me numër KI-62-12.

6. Më 20 shtator 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues Kadri Kryeziu, Kolegji Shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Prof.Dr. Enver Hasani, i rekomanduan gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmërinë e kërkesës. Gjithashtu Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës që të hedhë poshtë kërkesën për mbrojtje të identitetit si të pabazuar.

Përmbledhja e fakteve

7. Parashtruesi i kërkesës nuk i ka paraqitur Gjykatës fakte konkrete lidhur me kërkesën në fjalë, por udhëzon Gjykatën në një numër të madh ëeb faqesh, dhe shpreh gatishmërinë të ndihmojë Gjykatën në gjetjen e këtyre fakteve.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

8. Parashtruesi i kërkesës kërkon interpretimin e Kushtetutës lidhur me sa vijon;

a. Detyrimet për pensionimin e personave të moshës 70 e më shumë vjeç,
b. Detyrimet e zyrtarëve publik dhe privat, të cilët janë nën akuzë penale, për të dhënë dorëheqje,
c. Zgjatjes së tepërt të procedurave para gjykatave,
d. Amnistia e personave recividist nga ana e gjykatës dhe Presidentit të Kosovës,
e. Mos-mbajtja e web faqeve nga ana e institucioneve publike,
f. Personat që kanë shumë vende të punës, prej 2-4,

g. Papërgjegjësia e medieve sa u përket kërkesave të OJQ-ve,
h. Çështja e dorëheqjeve të një numri të madh të zyrtarëve të lartë të Kosovës, për shkak të vjedhjeve të dëshmive nga stacioni policor në Pejë,
i. Të drejtën e OJQ-ve që të regjistrohen si institucione financiare dhe keqpërdorimi i donacioneve nga ana e OJQ-ve,
j. Moszbatimi i ligjit, dhe jo transparenca me rastin e nxjerrjes së tyre,
k. Dhe një varg çështjesh tjera që nuk mund të specifikohen saktësisht.

9. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese të Kosovës si vijon:

> "Kërkojmë nga Gjykata Kushtetuese të analizojë mirë kërkesën tonë për interpretim kushtetues. Aty në linqe mund të gjeni raste të shumta si zotëri Mujë Rugova, i cili ka mbushur 70-71 vite - është dashtë të jetë në pension po ende punon – kësi rastesh në linqet që i kemi cekur në kërkesën tonë mund të gjeni mjaft, etj."

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

10. Kriteret e pranueshmërisë janë paraparë me Kushtetutë, në detaje të specifikuara me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës.

11. Nenet 113.1, 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës parashohin kornizën ligjore të kritereve për pranueshmërinë e kërkesës së individit dhe personit juridik, ku thuhet:

> *„113. 1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. (...)*

113.7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

21. 4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme."

12. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës ka kërkuar interpretimin e një numri të madh të normave kushtetuese për të mirën e të gjithë qytetarëve të Kosovës, gjë që tregon se parashtruesi i kërkesës kërkon interpretim abstrakt të Kushtetutës. Në qoftë se parashtruesi i kërkesës synonte një gjë të tillë, person juridik, atëherë ai nuk mund të konsiderohet si palë e autorizuar.

13. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës nuk konteston asnjë vendim të organeve publike, çfarë do t'i mundësonte të jetë palë e autorizuar në procedurën në Gjykatë, siç edhe parashihet me nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, si bazë juridike për parashtrimin e kërkesës së tij. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur argumente që do të provonin se ai është viktimë e drejtpërdrejtë e interpretimit të gabuar të dispozitave ligjore, interpretimin e të cilave e kërkon.

14. Vetëm individët, siç edhe parashihet shprehimisht me nenin 113.2 deri 113.6 të Kushtetutës, janë palë e autorizuar t'i parashtrojnë Gjykatës çështjet e vlerësimit abstrakt të kushtetutshmërisë.

15. Për më tepër, sistemi kushtetues-juridik i Kosovës nuk parasheh *„actio popularis"*, që është modalitet i ankesave individuale që i mundësojnë cilitdo individ, i cili tenton të mbrojë interesin publik dhe rendin kushtetues, që t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese lidhur me shkeljet e tilla, edhe pse nuk e ka statusin e viktimës.

16. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar për të kërkuar interpretimin e normave kushtetuese në abstrakt, shih për këtë, kjo kërkesë duhet shpallë e papranueshme. Gjithashtu Gjykata vlerëson se kërkesa për mbrojtjen e identitetit është e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenit 46, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1a) dhe 36 (3c), të rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 20 shtator 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit; dhe

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Kadri Kryeziu Prof. Dr. Enver Hasani

KI 132/10, KI 28/11, KI 82/11, KI 85/11, KI 89/11, KI 100/11, KI 104/11, KI 109/11, KI 118/11, KI 123/11, KI 142/11, KI 143/11, KI 144/11, KI 154/11, KI 01/12, KI 02/12, KI 14/12 datë 17 tetor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së 17 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

Rastet KI 132/10, KI 28/11, KI 82/11, KI 85/11, KI 89/11, KI 100/11, KI 104/11, KI 109/11, KI 118/11, KI 123/11, KI 142/11, KI 143/11, KI 144/11, KI 154/11, KI 01/12, KI 02/12, KI 14/12, vendimi i datës 1 tetor 2012

Fjalët kyçe: shkelje e vazhdueshme, kontesti për kontratë, pension i aftësisë së kufizuar, kërkesë individuale/ grupore, pension invalidor, pritje legjitime, pensionet, e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm

Parashtruesit, 17 ish-punëtorë të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), i kishin dorëzuar Kërkesat sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, duke pretenduar se me 17 aktgjykimet e nxjerra nga Gjykata Supreme ishin shkelur të drejtat e tyre në pronë dhe në gjykim të drejtë, të cilat Gjykata i interpretoj si referenca në nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Parashtruesit argumentuan se ata padrejtësisht ishin privuar nga interesat e fitimit dhe se nuk ishin në gjendje të korrigjonin shkeljen me mjete juridike, përmes gjykatave të rregullta. Gjykata Supreme i anuloi vendimet e gjykatave më të ulëta dhe e aprovoi anulimin e njëanshëm nga KEK-u të marrëveshjeve për kompensim ("Marrëveshjeve") pas përfundimit të parakohshëm të kontratave të punës të Parashtruesve, të cilat u kishin dhënë atyre të drejtën në kompensim derisa të krijohej dhe të funksionojë Fondi i Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor. Në njërën anë, Gjykata Supreme erdhi në përfundim se KEK-u kishte përmbushur obligimet

e veta sipas marrëveshjes për kompensim, sepse ishte krijuar Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor (FSPI), duke nxitur kështu ndërprerjen e marrëveshjes. Në anën tjetër, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) i kontestoi gjetjet e Gjykatës Supreme, duke pranuar se pensionet u takojnë personave me aftësi të kufizuara të përhershme dhe individëve mbi moshën 65 vjeçare, por duke shtuar se ende nuk ishte miratuar Ligji për Pensionet përmes të cilit krijohet FSPI.

Sa i përket pranueshmërisë, Gjykata konstatoi se 17 Parashtrues ishin palë të autorizuara në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, se ata e kishin plotësuar kushtin për shterjen mjeteve juridike sipas nenit 113.7 dhe nenit 47.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese ("Ligji") dhe se në këtë rast nuk zbatohej rregulli për afatin prej katër muajsh, të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit, pasi që shkelja e pretenduar e Kushtetutës kishte karakter vazhdues. Gjykata vendosi se 9 Kërkesat korresponduese ishin të pranueshme dhe se 8 Kërkesat e mbetura ishin vetëm pjesërisht të pranueshme, duke përjashtuar kërkesat për kompensim, pas ditëlindjes së 65-të të Parashtruesve, e duke përfshirë kërkesat për kompensim për periudhën deri në ditëlindjen e tyre të 65-të.

Sa i përket meritave, Gjykata nënvizoi të drejtat në pronë të përfshira në nenin 46 dhe nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNJ). Gjykata arsyetoi se pritja e Parashtruesve për kompensim të përkohshëm sipas Marrëveshjeve, derisa të fillon të funksionontе FSPI ishte legjitime dhe një e drejtë kjo që mbrohej me nenin 1 të Protokollit Nr. 1, duke cituar rastin *Ibrahimi*, *Prokshi, Mërlaku dhe Halili*. Gjykata konstatoi se ndërprerja e njëanshme e Marrëveshjeve nga KEK-u para zbatimit të FSPI cenonte interesat e tyre të fitimit nga prona dhe ishte shkelje e nenit 46 dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

Duke theksuar të drejtat për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31.1 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata tërhoqi vërejtjen se gjykatat e rregullta duhet të zgjidhin kontestet faktike, ato procedurale si dhe ato të së drejtës materiale,

duke cituar rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, ndërsa fokusi i saj është në atë se a ka pasur Parashtruesi gjykim të drejtë, duke cituar rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*. Gjykata theksoi se gjykatat janë të obliguara që të paraqesin arsyet për aktgjykimet e tyre, ndonëse niveli i detajeve të domosdoshme mund të ndryshojë, duke cituar nenin 6.1 të KEDNJ-së, rastin *Ibrahimi*, *Prokshi, Mërlaku e Halili*. Çka është me rëndësi, Gjykata theksoi se Parashtruesit kishin argumentuar se Ligji për Pensionet me të cilin themelohet FSPI akoma nuk ishte miratuar, pohim ky që ishte konfirmuar edhe nga MPMS. Gjykata konkludoi se Gjykata Supreme nuk kishte bërë përpjekje që të zgjidhur argumentin e Parashtruesve, duke sugjeruar se neni 74.3 i Ligjit për Kontratat dhe Detyrimet në lidhje me nenin 18 të Ligjit të vitit 1983 për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, mund të kenë mbështetur ketë argument. Rrjedhimisht, Gjykata erdhi në përfundim se Gjykata Supreme kishte shkelur nenin 31 dhe nenin 6 të (KEDNJ) kur kishte dështuar që të adresojë argumentet specifike, përkatëse dhe të rëndësishme të paraqitura nga Parashtruesit, duke cituar rastin "*Ibrahimi dhe të tjerët*", "*Prokshi dhe të tjerët*", "*Mërlaku dhe të tjerët*", dhe "Halili *dhe të tjerët*".

Për arsyet e cekura më lartë, Gjykata nxori Aktgjykimin për vendimet e saj për pranueshmëri, për shkeljet e nenit 46 në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së dhe nenit 31 në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Aktgjykimi po ashtu i shfuqizoi vendimet e Gjykatës Supreme, i kthej rastet në rishqyrtim në pajtim me vendimet dhe deklaroi se vazhdon të mbetet kompetente në ketë çështje, në pritje të zbatimit të këtij aktgjykimi.

Prishtinë, më 01 tetor 2012

Nr. ref.: AGJ 309/ 12

AKTGJYKIM

në

Rastin Nr.

KI 132/10, KI 28/11, KI 82/11, KI 85/11, KI 89/11, KI 100/11, KI 104/11, KI 109/11, KI 118/11, KI 123/11, KI 142/11, KI 143/11, KI 144/11, KI 154/11, KI 01/12, KI 02/12, KI 14/12

Parashtrues të kërkesës

Istref Halili dhe 16 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së 17 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe

Ivan Čukalović, gjyqtar

HYRJE

1. Ky aktgjykim ka të bëjë me kërkesat e paraqitura nga parashtruesit e shënuar më poshtë, të parashtruara në Gjykatën Kushtetuese nga shtatëmbëdhjetë (17) ish-punëtorë të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) ndërmjet dhjetorit 2010 dhe shkurtit 2012.

2. Rastet në fjalë janë të ngjashme me rastin KI Nr. 40/09, "Imer Ibrahimi dhe 48 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 49 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës", me rastin "Gani Prokshi dhe 15 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 16 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës" dhe me rastin "Isuf Mërlaku dhe 25 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 17 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës" dhe "Ilaz Halili dhe 19 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës. Gjykata Kushtetuese vërejti se në të gjitha këto aktgjykime ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Mbrojtja e Pronës) në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe që ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për disa prej parashtruesve. Si rrjedhojë, është marr vendim për t'i shpallur të pavlefshme aktgjykimet e nxjerra nga Gjykata Supreme në disa prej atyre rasteve dhe për t'ia kthyer këto raste Gjykatës Supreme për rishqyrtim në pajtim me aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese (shih aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese të 23 qershorit 2010, 18 tetorit 2010, 10 marsit 2011 dhe 27 dhjetor 2011).

Parashtrues të kërkesës në rastin në fjalë janë:

3. Në këtë aktgjykim, për referim më të lehtë, parashtruesit mund të referohen kolektivisht si "Istref Halili dhe shtatëmbëdhjetë (17) ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK)".

1) Istref Halili
2) Ahmet Bytyqi
3) Nazmi Kelmendi
4) Selim Krasniqi
5) Ramadan Duraku
6) Shefqet Shala
7) Habib Muja
8) Brahim Shabani
9) Nexhat Latifi
10) Enver Hashani
11) Sefe Isufi
12) Syla Shefiku
13) Lute Luta
14) Ahmet Krasniqi
15) Brahim Imeri
16) Tafil Miftari

Parashtruesit i kontestojnë aktgjykimet në vijim të Gjykatës Supreme të Kosovës të nxjerra në rastet e: të datës

1)	KI 132/10	Istref Halili, Rev. 60/2009 i 11 shkurtit 2009
2)	KI 28/11	Ahmet Bytyqi, Rev. 198/2009 i 15 korrikut 2009
3)	KI 82/11	Nazmi Kelmendi, Rev. 529/2008 i 11 shkurtit 2009

4) KI 85/11 Selim Krasniqi, Rev. 103/2008 i 27 janarit 2009
5) KI 89/11 Ramadan Duraku, Rev. 138/2008 i 27 janarit 2009
6) KI 100/11 Shefqet Shala, Rev. 339/2008 i 10 shkurtit 2009
7) KI 104/11 Habib Muja, Rev. 511/2008 i 11 shkurtit 2009
8) KI 109/11 Brahim Shabani, Rev. 261/2008 i 10 shkurtit 2009
9) KI 118/11 Nexhat Latifi, Rev. 88/2009 i 23 shkurtit 2009
10) KI 123/11 Enver Hashani, Rev. 123/2009 i 2 qershorit 2009
11) KI 142/11 Sefe Isufi, Rev. 456/2008 i 10 marsit 2009
12) KI 143/11 Syla Shefiku, Rev. 509/2008 i 23 shkurtit 2009
13) KI 144/11 Lute Luta, Rev. 496/2008 i 11 shkurtit 2009
14) KI 154/11 Ahmet Krasniqi, Rev. 85/2009 i 23 shkurtit 2009
15) KI 01/12 Brahim Imeri, Rev. 510/2008 i 10 marsit 2009
16) KI 02/12 Tafil Miftari, Rev. 451/2008 i 11 shkurtit 2009
17) KI 14/12 Nuhi Gerguri, Rev. 418/2009 i 10 marsit 2010

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kësaj kërkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve individuale të nxjerra nga Gjykata Supreme e Republikës se Kosovës në shtatëmbëdhjetë (17) rastet individuale të parashtruesve kundër KEK-ut, siç është cekur më lart.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe nenin 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Përmbledhje e fakteve siç pretendohen nga palët

6. Faktet e këtyre kërkesave janë të ngjashme me ato në rastin "Imer Ibrahimi dhe 48 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 49 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës", me rastin "Gani Prokshi dhe 15 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 16 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës" dhe me rastin "Isuf Mërlaku dhe 25 ish-punëtorë të tjerë të Korporatës Energjetike të Kosovës". Shih aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: rasti "Ibrahimi dhe të tjerët", i 23 qershorit 2010, rasti "Prokshi dhe të tjerët", i 18 tetorit 2010, rasti "Mërlaku dhe të tjerët" i 10 marsit 2011 dhe "rasti Halili dhe të tjerët", i 27 dhjetorit 2011).

7. Gjatë vitit 2001 dhe 2002, secili parashtrues në këtë kërkesë, si dhe parashtruesit në aktgjykimin e lartcekur, të 23 qershorit 2010, 18 tetorit 2010, 10 marsit 2011 dhe 27 dhjetorit 2011 nënshkruan marrëveshje për kompensim të përkohshëm të pagesës për shkëputje të kontratës së punës me punëdhënësin e tyre, KEK-un. Këto marrëveshje ishin, në thelb, të njëjta.

8. Neni 1 i kësaj Marrëveshjeje përcaktoi se, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës nr. 26/83, 26/86 dhe 11/88*)* dhe konstatimit të Komisionit Invalidor të KEK-ut, përfituesi (d.m.th. secili parashtrues) ka të drejtë për kompensim të përkohshëm për ndërprerje të marrëdhënies së punës, deri në themelimin dhe funksionimin e Fondit të Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor.

9. Neni 2 i kësaj Marrëveshjeje përcaktoi se shuma mujore që duhet t'i paguhet secilit parashtrues ishte 206 marka gjermane.

10. Neni 3 përcaktoi që "pagesa do të përfundojë në ditën e funksionimit të Fondit të Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor. Prej asaj dite e tutje, shfrytëzuesi mund t'i realizojë të drejtat e veta në Fondin e Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor (Fondi Pensional Invalidor i Kosovës), dhe KEK-ut do t'i hiqen obligimet ndaj shfrytëzuesit sipas kësaj Marrëveshjeje".

11. Më 1 nëntor 2002, Bordi Ekzekutiv i KEK-ut miratoi një vendim për themelimin e Fondit Pensional, në përputhje me kriteret e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/30 për Pensionet në Kosovë. Neni 3 i këtij vendimi thotë: "Fondi Pensional do të vazhdojë të ekzistojë për një periudhë të pacaktuar kohore, në pajtim me kriteret dhe përgjegjësitë e përcaktuara me ligjet për pensione, të miratuara nga Bordi i Fondit Pensional dhe KEK-u, në përputhje me këtë vendim, apo derisa kushtet ligjore për ekzistimin dhe funksionimin e Fondit të jenë në përputhje me rregulloret për pension ose rregullat për pension të miratuara nga ABPK-ja."

12. Më 25 korrik 2006, Bordi Ekzekutiv i KEK-ut e anuloi vendimin në fjalë për themelimin e Fondit Pensional Suplementar dhe ndërpreu financimin dhe punën e Fondit Pensional Suplementar, që nga 31 korriku 2006. Sipas vendimit të 25 korrikut 2006, të gjithë përfituesve u garantohej pagesa e plotë në përputhje me Statutin e Fondit. Për më tepër, obligimi i përgjithshëm ndaj përfituesve ishte 2.395.487 euro, depozitat bankare ishin 3.677.383 euro, dhe suficiti nga përgjegjësia ishte 1.281.896 euro. Vendimi thotë se punëtorët e KEK-ut të cilët Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale i pranon si persona me aftësi të kufizuar për punë do t'i gëzojnë të drejtat e parapara nga Ministria. Më 14 nëntor 2006, KEK-u e informoi Autoritetin Qendror Bankar se "vendimi për revokimin e Fondit Pensional të KEK-ut bazohet në vendimin e Bordit Ekzekutiv të KEK-ut dhe në vendimin e Bordit Menaxhues për Pensione ... <u>për shkak të rrezikut financiar që kjo skemë paraqet për KEK-un në të ardhmen</u>."

13. Sipas parashtruesve, KEK-u ndërpreu pagesën e paraparë me marrëveshjet e verës së vitit 2006 pa asnjë njoftim. Parashtruesit pohojnë që një veprim i tillë është në kundërshtim me marrëveshjet e nënshkruara.

    Parashtruesit gjithashtu theksojnë se dihet se Fondi Pensional dhe Invalidor në Kosovë nuk është themeluar ende.

Në anën tjetër, në rastin fillestar, KEK-u kontestoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke argumentuar se dihet botërisht se Fondi Pensional në Kosovë funksionon që nga 1 janari 2004.

14. Sipas KEK-ut, parashtruesit ishin mbuluar automatikisht nga skema kombëtare invalidore në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/40 për shpalljen e Ligjit për Pensionet Invalidore në Kosovë (Ligji Nr. 2003/23).

15. KEK-u më tutje pohoi që më 31 gusht 2006 lëshoi një njoftim sipas të cilit të gjithë përfituesit e Fondit Suplementar të KEK-ut ishin njoftuar se Fondi ishte mbyllur. I njëjti njoftim konfirmonte se të gjithë përfituesve u garantohej pagesa e plotë në përputhje me Statutin e FPS-së, që do të thotë 60 muaj pagesë ose derisa përfituesit ta arrijnë moshën 65-vjeçare, në përputhje me Vendimin e Bordit Menaxhues të Fondit Pensional të 29 gushtit 2006.

16. KEK-u më tutje tha që parashtruesit nuk i kishin kontestuar udhëzimet për pension invalidor dhe nënshkrimin për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës në përputhje me konkluzionet e Komisionit Invalidor.

17. Parashtruesit ngritën padi kundër KEK-ut në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me të cilën kërkonin që Gjykata ta urdhëronte KEK-un t'ua paguante pagesat e papaguara dhe të vazhdonte t'ua paguante nga 105 euro (që është e barabartë me 206 marka gjermane) deri në përmbushjen e kushteve për ndërprerjen e pagesës.

18. Gjykata Komunale në Prishtinë i miratoi paditë e parashtruesve dhe urdhëroi kompensim monetar. Gjykata Komunale në Prishtinë konstatoi (*p.sh. Aktgjykimi C. Nr. 1863/2007, i 23 prillit 2008, në rastin e parashtruesit të parë Istref Halili*) se kushtet e parapara në nenin 3 të Marrëveshjes nuk ishin përmbushur. Neni 3 i Marrëveshjes parashikon kompensimin e

pagës deri në realizimin e të drejtës së parashtruesve, "që do të thotë të drejtën për skemë të pensioneve."

19. KEK-u paraqiti ankesë kundër aktgjykimeve të Gjykatës Komunale pranë Gjykatës së Qarkut, duke thënë, ndër të tjera, se aktgjykimi i Gjykatës Komunale nuk ishte i drejtë sepse marrëveshjet ishin nënshkruar me parashtruesit për shkak të invaliditetit të tyre dhe se nuk mund të kërkojnë vazhdimin e marrëdhënies së tyre të punës për shkak të invaliditetit të tyre.

20. KEK-u ritheksoi se Gjykata ishte e detyruar të vendoste duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/40 për shpalljen e Ligjit për Pensionet Invalidore, sipas të cilës parashtruesit kishin të drejtë për pension invalidor.

21. Gjykata e Qarkut në Prishtinë i hodhi poshtë ankesat e KEK-ut dhe i konsideroi parashtresat e tyre të pabazuara.

22. KEK-u parashtroi revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljes së supozuar thelbësore të Ligjit për procedurën kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Aty përsëritej që parashtruesit kishin të drejtë për pension sipas Ligjit 2003/40 dhe që për shkak të arsyeve humanitare KEK-u kishte vazhduar t'i paguante kompensimet ujore edhe pas hyrjes së Ligjit në fuqi. KEK-u pohonte që nuk ishte në pyetje mosha e parashtruesit, por invaliditeti i tij.

23. Gjykata Supreme i miratoi revizionet e KEK-ut, i anuloi aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe të Gjykatës Komunale në Prishtinë, dhe i refuzoi si të pabaza paditë e parashtruesve.

24. Gjykata Supreme theksoi që mënyra e ndërprerjes së punësimit konsiderohej e ligjshme sipas nenit 11.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë.

25. Në aktgjykimin e vet në rastin e parashtruesit të parë, Istref Halili, Rev. Nr. 60/2009, të 11 shkurtit 2009, Gjykata Supreme theksoi: *"Duke marrë parasysh faktin e pakontestueshëm që pala e paditur e ka përmbushur obligimin ndaj paditësit, që është pagesa e kompensimit të pagave sipas periudhës së specifikuar, që është deri në themelimin dhe funksionimin e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Kosovë, në fuqi prej 1 janarit 2004, Gjykata vërejti që pala e paditur e ka kryer obligimin sipas marrëveshjes. Kështu, pohimet e paditësit që pala e paditur ka për obligim t'ia paguajë atij kompensimin e përkohshëm të pagave pas themelimit të Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Kosovë konsiderohen nga kjo Gjykatë si të pabazuara për shkak se palët kontraktuese, deri në shfaqjen e kushtit shfuqizues – themelimin e fondit të lartpërmendur, i kanë kryer obligimet e tyre kontraktuese..."*

26. Më 15 maj 2009, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e Kosovës lëshoi këtë njoftim: *"Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, në arsyetimin e vet të p.sh. Aktgjykimit Rev. Nr. 338/2008, që në Republikën e Kosovës ekziston Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor që është funksional që nga 1 janari 2004 nuk është i saktë dhe është i pabazuar. Në dhënien e kësaj deklarate, ne kemi parasysh faktin që Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/40 shpall Ligjin Nr. 2003/213 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, i cili i rregullon rastet e personave me paaftësi të përhershme, të cilët mund ta gëzojnë këtë skemë në pajtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë ligj. Prandaj, më lejoni të theksoj që dispozitat e këtij Ligji nuk parashikojnë themelimin e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të vendit. Themelimi i Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Republikën e Kosovës përcaktohet me Ligjin për Sigurim Pensional dhe Invalidor, i cili është në proces të hartimit dhe miratimit në Qeverinë e Kosovës."* Në të njëjtin njoftim shpjegohej që në kohën e shkrimit të atij njoftimi, pensioni ndër të tjera ekzistonte, *"pensioni invalidor në shumë prej 45 eurove, siç rregullohet me Ligjin për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar (përfitues të tyre janë të gjithë personat me aftësi të kufizuara të plotë dhe të përhershme)", si dhe "pensionet e kontributdhënësve prej 82 eurove, që rregullohen me vendim të Qeverisë (përfitues të të cilit janë të gjithë pensionistët që e kanë arritur moshën e*

pensionimit prej 65-vjetësh, si dhe të cilët kanë së paku 15 vjet përvojë pune).”

Ankesat

27. Parashtruesit ankohen që të drejtat e tyre janë shkelur për shkak se KEK-u në mënyrë të njëanshme i ka anuluar marrëveshjet e tyre, përkundër faktit se kushti i përcaktuar me nenin 3, themelimi i Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor, nuk ishte përmbushur. Parashtruesit theksuan më tutje se nuk kanë pasur mundësi ta kundërshtojnë një shkelje të tillë në gjykatat e rregullta. Ndërsa parashtruesit nuk ankohen shprehimisht për shkeljen e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), nga parashtresat e tyre duket se objekt i ankesave janë të drejtat e tyre pronësore (siç garantohet me nenin 1, Protokollin 1 të KEDNJ-së), si dhe e drejta e tyre për gjykim të drejtë (siç garantohet me nenin 6 të KEDNJ-së).

Përmbledhje e procedurave në Gjykatë

28. Ndërmjet shtatorit 2010 dhe shkurtit 2012, parashtruesit individualisht i kanë dorëzuar kërkesat në Gjykatën Kushtetuese. Kryetari i Gjykatës e caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues dhe e caktoi Kolegjin shqyrtues të Gjykatës të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Enver Hasani dhe Ivan Čukalović.

29. Më 3 korrik 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues Kadri Kryeziu, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga Altay Suroy, Enver Hasani dhe Ivan Čukalović, i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për pranueshmëri të kërkesës.

30. Të njëjtën ditë, Gjykata u këshillua dhe votoi për këtë rast.

Pranueshmëria

31. Siç është vendosur në rastet *"Ibrahimi dhe të tjerët", "Prokshi dhe të tjerët" "Mërlaku dhe të tjerët" dhe "Halili dhe të tjerët"* , të përmendura më lart, për të gjykuar për kërkesat e parashtruesve, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë.

32. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë:

> "*Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj*";

dhe nenit 47.2 të Ligjit, i cili thotë:

> "*Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj*."

33. Gjykata gjithashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesit i kanë parashtruar kërkesat e tyre brenda afatit prej katër muajve, siç përcaktohet me nenin 49 të Ligjit. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili thotë:

> "*Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është*

dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ..."

34. Gjykata rikujton që në rastin në fjalë, ngjashëm si në rastet *"Ibrahimi dhe të tjerët", "Prokshi dhe të tjerët"* ,*"Mërlaku dhe të tjerët" dhe "Halili dhe të tjerët"*, parashtruesit ende vuajnë nga ndërprerja e njëanshme e marrëveshjeve të tyre të nënshkruara nga KEK-u. Ata kanë ngritur të njëjtin argument ashtu si parashtruesit e mëhershëm, në kuptimin se dihet mirëfilli që Fondi Pensional dhe Invalidor nuk është themeluar deri më sot. Pra, ekziston një situatë e vazhdueshme. Pasi rrethanat për të cilat parashtruesit ankohen kanë vazhduar, afati prej katër muajve, siç përcaktohet me nenin 49 të Ligjit, nuk është i zbatueshëm për këto raste.

35. Gjykata Kushtetuese është e njoftuar që disa prej parashtruesve ishin më të vjetër se 65 vjeç në kohën e parashtrimit të kërkesës së tyre pranë kësaj Gjykate.

36. Këta parashtrues janë: Istref Halili (1943), Selim Krasniqi (1942), Ramadan Duraku (1945). Habib Muja (1945), Brahim Shabani (1942), Sefë Isufi (1943), Ahmet Krasniqi (1943) dhe Tafil Miftari (1943).

37. Gjykata Kushtetuese rikujton se, sipas njoftimit të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale më 15 maj 2009, personave që e kanë arritur moshën e pensionimit prej 65-vjetësh dhe që i kanë së paku 15 vjet përvojë pune u takon pensioni në shumë mujore prej 82 eurove. Thelbi i këtij njoftimi u konfirmua nga përfaqësuesi i Ministrisë në seancën publike që Gjykata Kushtetuese e mbajti më 30 prill 2010 në rastin "*Ibrahimi dhe të tjerët*".

Rrjedhimisht, duket që parashtruesit e lartpërmendur kanë të drejtë për pension që nga momenti kur i kanë mbushur 65 vjet.

Megjithatë, ankesa e tyre lidhur me kompensimin e papaguar për periudhën para atij momenti, për shkak të situatës së vazhdueshme, mbetet në shqyrtim.

38. Prandaj, kërkesat e parashtruesve: Istref Halili, Selim Krasniqi, Ramadan Duraku. Habib Muja, Brahim Shabani, Sefë Isufi, Ahmet Krasniqi dhe Tafil Miftari janë pjesërisht të pranueshme.

39. Sa u përket parashtruesve të tjerë, Gjykata Kushtetuese nuk gjen ndonjë arsye për papranueshmëri të kërkesës.

40. Gjykata më tej konsideron se është e përshtatshme të bëhet bashkimi i kërkesave në përputhje me rregullin 36 të Rregullores së punës.

Meritat

41. Gjykata rikujton aktgjykimet e veta të 27 dhjetor 2012, 18 tetor, dhe 10 mars 2011 dhe 27 dhjetor 2012, të miratuara në rastet e mëhershme të KEK-ut, në të cilat konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Mbrojtja e Pronës) në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për të njëjtit parashtrues. Si rrjedhojë, ishte marrë vendim për t'i shpallur të pavlefshme aktgjykimet e nxjerra nga Gjykata Supreme në rastet e parashtruesve dhe për t'ia kthyer ato aktgjykime Gjykatës Supreme për rishqyrtim në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

i. Sa i përket mbrojtjes së pronës

42. Parashtruesit ankohen se të drejtat e tyre janë shkelur për shkak se KEK-u i ka anuluar marrëveshjet e tyre në mënyrë të njëanshme, edhe pse kushti i përcaktuar me nenin 3 (pra themelimi i Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor) nuk ishte përmbushur. Në thelb, parashtruesit ankohen se ka pasur shkelje të të drejtave të tyre pronësore.

43. Që në fillim, duhet rikujtuar këto dispozita ligjore:

Neni 53 i Kushtetutës

"*Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*."

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës thotë me sa vijon:

1. E drejta e pronës është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj shpronësimin e pronës nëse ky shpronësim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilëve shpronësohet.

Neni 1 i Protokollit nr. 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton:

"*Secili person fizik apo juridik ka të drejtë të gëzojë posedimet e tij në mënyrë të qetë. Askush nuk mund të privohet nga posedimet e tij/saj përveç për interes publik si dhe duke iu nënshtruar kushteve të përcaktuara me ligj, si dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.*

Megjithatë, dispozitat paravajtëse nuk do të pengojnë në asnjë mënyrë të drejtën e Shtetit që të zbatojë ligje që i konsideron të domosdoshme për kontrollimin e shfrytëzimit të pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm, apo për të siguruar pagesën e tatimeve apo kontributeve e dënimeve tjera."

44. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një parashtrues mund të pretendojë shkeljen e nenit 1 të Protokollit Nr. 1 vetëm deri në përmasën që vendimet e kundërshtuara kanë të bëjnë me "posedimet" e tij brenda kuptimit të kësaj dispozite.

45. Për më tepër, "posedimet" mund të jenë ose "posedime ekzistuese" ose asete, duke përfshirë pohimet, në kuptimin e të cilave parashtruesi mund të argumentojë që ai apo ajo ka së paku "pritje legjitime" të fitimit dhe gëzimit efektiv të një të drejte pronësore. Në kundërshtim me këtë, shpresa e njohjes së një të drejte pronësore e cila ka qenë e pamundur të ushtrohet në mënyrë efektive nuk mund të konsiderohet "posedim" sipas kuptimit të nenit 1 të Protokollit Nr. 1, dhe as kërkesa me kusht, e cila mbaron si rezultat i mospërmbushjes së kushtit" (shih aktgjykimet në rastet *"Ibrahimi dhe të tjerët"*, "*Prokshi dhe të tjerët", "Mërlaku dhe të tjerët" dhe Halili dhe të tjerët).*

46. Çështja që duhet shqyrtuar në secilin rast është nëse rrethanat e rastit, të marra si tërësi, i japin parashtruesit pronësi ndaj një interesi thelbësor të garantuar me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNJ-së. (Shih aktgjykimet në rastet *"Ibrahimi dhe të tjerët"*, "*Prokshi dhe të tjerët"* dhe "*Mërlaku dhe të tjerët").*

47. Gjykata Kushtetuese vëren që në kohën e nënshkrimit të marrëveshjeve ndërmjet parashtruesve dhe KEK-ut, ky lloj i marrëveshjeve është rregulluar me Ligjin për Marrëdhëniet Detyrimore (Ligji për Obligimet), të shpallur në Gazetën Zyrtare të RSFJ-së 29/1978 dhe të ndryshuar në 39/1985, 45/1989, 57/1989.

    Neni 74(3) i Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore thotë me sa vijon:

    "Pas lidhjes sipas kushtit shfuqizues, kontrata pushon të jetë e vlefshme pasi ai kusht është i vlefshëm."

48. Prandaj, thelbi i çështjes është nëse është përmbushur kushti shfuqizues sipas të cilit marrëveshjet ishin nënshkruar. Përgjigja në këtë pyetje do t'i mundësojë Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë nëse rrethanat e kësaj kërkese, të shqyrtuara si tërësi, u japin parashtruesve të drejtën ndaj interesit thelbësor të mbrojtur me nenin 1, Protokollin Nr. 1 të KEDNJ-së.

49. Gjykata Kushtetuese vëren se nga dokumentet është e qartë, dhe e pakontestueshme ndërmjet palëve, se "kushti shfuqizues", sipas të cilit janë nënshkruar marrëveshjet, është themelimi dhe funksionimi i Fondit të Kosovës për Sigurim Pensional dhe Invalidor.

50. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese vëren që sipas Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, themelimi i Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor do të duhej të parashikohej me Ligjin për Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor. Ky ka qenë në proces të hartimit dhe miratimit në Qeverinë e Kosovës.

51. Gjykata Kushtetuese konsideron se parashtruesit, me rastin e nënshkrimit të marrëveshjeve me KEK-un, kanë pasur pritje legjitime që do të gëzonin dëmshpërblim mujor në shumë prej 105 eurove, deri në themelimin e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor.

52. Një pritje e tillë legjitime garantohet me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës. Natyra e saj është konkrete, dhe jo vetëm shpresë e thjeshtë, dhe bazohet në një dispozitë ligjore apo akt ligjor, d.m.th. në marrëveshjen me KEK-un (aktgjykimet në rastet *"Ibrahimi dhe të tjerët"*, "*Prokshi dhe të tjerët", "Mërlaku dhe të tjerët" dhe "Halili dhe të tjerët")*; po ashtu *mutatis mutandis* Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës së Çekisë (vendim), nr. 39794/98, paragrafi 73, ECHR 2002-VII).

53. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konsideron se parashtruesit kanë "pritje legjitime" që kërkesa e tyre do të trajtohet në pajtim me ligjet në fuqi, në veçanti në pajtim me dispozitat e lartpërmendura të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore dhe të Ligjit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Kosovë, dhe si rrjedhojë do të miratohen (shih aktgjykimet në rastet *"Ibrahimi dhe të tjerët"*, "*Prokshi dhe të tjerët" ", "Mërlaku dhe të tjerët" dhe "Halili dhe të tjerët").*

54. Megjithatë, ndërprerja e njëanshme e marrëveshjeve, para përmbushjes së kushtit shfuqizues, i ka shkelur interesat materiale të parashtrueseve që ishin të njohura me ligj dhe të mbrojtura me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (shih aktgjykimet në rastet *"Ibrahimi dhe të tjerët"*, "*Prokshi dhe të tjerët" ", "Mërlaku dhe të tjerët" dhe "Halili dhe të tjerët").*

55. Si rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese konstaton se ka shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

ii. Sa i përket të së drejtës për gjykim të drejtë

56. Parashtruesit më tej ankohen se nuk kanë qenë në gjendje të zhdëmtohen për shkeljen e të drejtave të tyre pronësore në gjykatat e rregullta.

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës thotë me sa vijon:

1. *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike*.

Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet ... nga [një] gjykatë ... e cila do të vendosë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile ..."

57. Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës të veprojë si gjykatë apeli, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta, duke përfshirë Gjykatën Supreme. Në përgjithësi, "gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit" (neni 102 i Kushtetutës). Më saktësisht, roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

58. Në anën tjetër, "Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe të pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetutën" (neni 112.1 i Kushtetutës). Pra, Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë përkatëse dhe nëse procedurat në përgjithësi, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të duhur saqë

parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, miratuar më 10 korrik 1991).

59. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së i obligon gjykatat që të japin arsyetime për aktgjykimet e tyre, por kjo nuk mund të kuptohet si kërkesë për përgjigje të hollësishme për secilin argument. Përmasa në të cilën zbatohet detyra e ofrimit të arsyetimeve mund të dallojë varësisht nga natyra e vendimit. Për më tepër, është e domosdoshme të merret parasysh, ndër të tjera, shumëllojshmëria e parashtresave që një palë mund të dorëzojë në gjykata dhe dallimet që ekzistojnë në shtetet kontraktuese lidhur me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, mendimet juridike dhe paraqitjen dhe hartimin e aktgjykimeve. Prandaj, çështja nëse gjykatat kanë dështuar në përmbushjen e obligimit të parashtrimit të arsyeve, që burojnë nga neni 6 i Konventës, mund të përcaktohet vetëm në bazë të rrethanave të rastit (shih aktgjykimet në rastet *"Ibrahimi dhe të tjerët"*, "*Prokshi dhe të tjerët" ",* "*Mërlaku dhe të tjerët" dhe* "*Halili dhe të tjerët")*;

60. Në rastin në fjalë, parashtruesit kanë kërkuar nga gjykatat e rregullta të vendosin për mosmarrëveshjen e tyre pronësore me KEK-un. Parashtruesit iu kanë referuar në veçanti dispozitës së nenit 3 të marrëveshjeve, duke theksuar se Ligji për Pensionet, që themelon Fondin për Sigurim Pensional dhe Invalidor, nuk është miratuar ende. Ky fakt është vërtetuar nga përfaqësuesi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

61. Megjithatë, Gjykata Supreme nuk ka bërë asnjë përpjekje për t'i analizuar paditë e parashtrueseve nga ky këndvështrim, përkundër referencës së qartë para çdo instance tjetër gjyqësore. Në vend të kësaj, pikëpamja e Gjykatës Supreme ka qenë se është fakt i pamohueshëm që pala kundërshtare (KEK) i ka përmbushur obligimet e veta ndaj paditësit, që ka qenë pagesa e kompensimit të pagave sipas afatit të përcaktuar deri në themelimin dhe funksionimin e Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor në Kosovë, në fuqi nga 1 janari 2004.

62. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të vendosë se cila do të ishte mënyra më e mirë që gjykatat e rregullta t'i trajtojnë argumentet e parashtrueseve, d.m.th., përmbushjen e kushtit shfuqizues të nenit 3 të marrëveshjeve, përmbushje kjo që përcaktohet po ashtu me nenin 74 (3) të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore i marrë në lidhje me nenin 18 të Ligjit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të vitit 1983.

63. Megjithatë sipas mendimit të kësaj Gjykate, Gjykata Supreme duke shpërfillur vlerësimin e kësaj pike në tërësi, edhe pse ishte specifike, përkatëse dhe e rëndësishme, ka dështuar në obligimin e saj sipas nenit 6 të paragrafit 1 të KEDNJ-së (shih rastet *"Ibrahimi dhe të tjerët"*, "*Prokshi dhe të tjerët", "Mërlaku dhe të tjerët" dhe* "*Halili dhe të tjerët")*;

64. Nga sa u tha më lart, Gjykata Kushtetuese konkludon se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

GJYKATA NJËZËRI VENDOSI ME SA VIJON:

I. T'I BASHKOJË KËRKESAT;

II. T'I SHPALLË SI:

a) Të pranueshme **kërkesat në lidhje me parashtruesit në vijim*:***

KI 28/11 Ahmet Bytyqi

KI 82/11 Nazmi Kelmendi

KI 100/11 Shefqet Shala

KI 118/11 Nexhat Latifi

KI 123/11 Enver Hashani

KI 143/11 Syla Shefiku

KI 144/11 Lute Luta

KI 01/12 Brahim Imeri

KI 14/12Nuhi Gerguri

b) Pjesërisht të pranueshme **kërkesat në lidhje me parashtruesit në vijim:**

KI 132/10	Istref Halili
KI 85/11	Selim Krasniqi
KI 89/11	Ramadan Duraku
KI 104/11	Habib Muja
KI 109/11	Brahim Shabani
KI 142/11	Sefë Isufi
KI 154/11	Ahmet Krasniqi
KI 02/12	Tafil Miftari

III. ***TË KONSTATOJË QË:***

a) Ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastet e të gjithë parashtruesve;

b) Ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sa u përket parashtruesve të njëjtë, që kanë pësuar shkelje të nenit 46 të Kushtetutës.

IV. ***T'i shpallë të pavlefshme aktgjykimet e Gjykatës Supreme*** në këto raste:

KI 132/10 Istref Halili, Rev. 60/2009 i 11 shkurtit 2009

KI 28/11 Ahmet Bytyqi, Rev. 198/2009 i 15 korrikut 2009

KI 82/11 Nazmi Kelmendi, Rev. 529/2008 i 11 shkurtit 2009

KI 85/11 Selim Krasniqi, Rev. 103/2008 i 27 janarit 2009

KI 89/11 Ramadan Duraku, Rev. 138/2008 i 27 janarit 2009

KI 100/11 Shefqet Shala, Rev. 339/2008 i 10 shkurtit 2009

KI 104/11 Habib Muja, Rev. 511/2008 i 11 shkurtit 2009

KI 109/11 Brahim Shabani, Rev. 261/2008 i 10 shkurtit 2009

KI 118/11 Nexhat Latifi, Rev. 88/2009 i 23 shkurtit 2009

KI 123/11 Enver Hashani, Rev. 123/2009 i 2 qershorit 2009

KI 142/11 Sefe Isufi, Rev. 456/2008 i 10 marsit 2009

KI 143/11 Syla Shefiku, Rev. 509/2008 i 23 shkurtit 2009

KI 144/11 Lute Luta, Rev. 496/2008 i 11 shkurtit 2009

KI 154/11 Ahmet Krasniqi, Rev. 85/2009 i 23 shkurtit 2009

KI 01/12 Brahim Imeri, Rev. 510/2008 i 10 marsit 2009

KI 02/12 Tafil Miftari, Rev. 451/2008 i 11 shkurtit 2009

KI 14/12 Nuhi Gerguri, Rev. 418/2009 i 10 marsit 2010

V. T'IA KTHEJË këto aktgjykime Gjykatës Supreme për rishqyrtim në pajtim me aktgjykimin e kësaj Gjykate.

VI. MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të zbatimit të këtij Urdhri.

Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë pasi t'u dorëzohet palëve.

Prishtinë, më 26 shtator 2012

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Kadri Kryeziu, Prof. Dr. Enver Hasani

KI 43/12 datë 18 tetor 2012- Kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë se Aktvendimit te Gjykatës Supreme P.P.A.nr.3/ 2008 te datës 03.05.2011

Rasti KI 43/12, vendimi i datës 3 majit 2011

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, barazia para Ligjit, E drejta për Gjykim te Drejte dhe te paanshëm, Mbrojtja Gjyqësore e te drejtave, Aktvendim për papranueshmëri

Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se me Aktvendimin e lartcekur i janë shkelur te drejtat e garantuara me Kushtetutën e Kosovës dhe atë: barazia para Ligjit (neni 24), E drejta për Gjykim te Drejte dhe te paanshëm (neni 31) dhe Mbrojtja Gjyqësore e te drejtave (neni 54).

Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se me Aktvendimin e Gjykatës supreme të Kosovës me të cilin nuk i është aprovuar padia për përsëritjen e procedurës atij si subjekt afarist i është cenuar e drejta e garantuar me kushtetutë për barazinë para ligjit si dhe mbrojtja gjyqësore e të drejtave (neni 24 dhe 54 i Kushtetutës).

Gjykatën Kushtetuese është paraqitur me 26 prill 2012 .i krijon bazë të qartë juridike Gjykatës që në përputhje me rregullin 36 par 1 pika (b) të konstatojë se kërkesa është e papranueshme sepse parashtruesi i sajë e ka paraqitur atë në Gjykatë pas afatit të përcaktuar me nenin 49 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Prishtinë, më 8 tetor 2012

Nr. ref.: RK310/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 43/12

SH. A "JATEX"

Kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë se Aktvendimit te Gjykatës Supreme P.P.A.nr.3/ 2008 te datës 03.05.2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Cukalovic, zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar

Arta Rama–Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i Kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Shoqëria Aksionare "Jatex" me seli punë në Gjakovë Rr. 'Nëna Terezë" nr.8

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik Aktvendimi i Gjykatës Supreme P.P.A.nr.3/ 2008 te datës 03.05.2011 për të cilin parashtruesi i kërkesës nuk specifikoj datën e pranimit të tij

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) me 26 prill 2012 është vlerësimi i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me te cilin u refuzua kërkesa për përsëritjen e procedurës se përfunduar me Aktgjykimin e po kësaj Gjykate A.nr.1771/2005 te datës 31.10.2007

Shkeljet e pretenduara të drejtave të garantuara Kushtetuese

4. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se me Aktvendimin e lartcekur i janë shkelur te drejtat e garantuara me Kushtetutën e Kosovës dhe atë: barazia para Ligjit (neni 24), E drejta për Gjykim te Drejte dhe te paanshëm (neni 31) dhe Mbrojtja Gjyqësore e te drejtave (neni 54).

Baza juridike

5. Neni 113.7 lidhur me nenin 21.4 i Kushtetutës, nenet 22 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, , dhe rregullat 54, 55 dhe 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatën Kushtuese

6. Më 26 prill 2012, parashtruesi i Kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë, dhe e njëjta u regjistrua në Gjykatë me nr KI 43/12.

7. Më 22 maj me vendimin GJ.R. KI 43/12 Kryetari i Gjykatës caktoj Gjyqtar raportues, gjyqtarin Robert Carolan,ndërsa me vendimin KSH 43/12,Kolegjin shqyrtues në përbërje Altay Suroy (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami në cilësi të anëtarëve të kolegjit.

8. Më 2 korrik 2012 VENDIM Kryetari i Gjykatës morri Vendimin për zëvendësimin e gjyqtarëve të kolegjit shqyrtues ,Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami(skadimi i

mandatit ,neni 8 pika 1,1 i ligjit për Gjykatën kushtetuese) dhe në vend të tyre emëroj prof .Dr. Enver Hasani, dhe Almiro Rodrigues, gjyqtar si anëtar të në Kolegjin Shqyrtues për lëndën KI 43/12

9. Me 29 maj 2012 Gjykata Kushtetuese kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës lidhur me regjistrimin e kërkesës dhe njëkohësisht ka kërkuar që të dërgojë komentet eventuale lidhur me kërkesën..

10. Me 29 maj 2012 Gjykata kishte njoftuar gjithashtu edhe Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës lidhur me Kërkesën e parashtruar dhe ka kërkuar përgjigjeje me shkrim.

11. Gjykata Kushtetuese nuk morri asnjë përgjigjeje dhe as një koment të shkruar nga asnjëra palë brenda aftit ligjor Me 16 mars 2012

12. me 19 shtator në seancën shqyrtuese për këtë lëndë .paneli shqyrtues i propozoj gjykatës në përbërje të plotë për pa pranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 28 shkurt 2005 ,Administrata Tatimore e Kosovës NJ/T.M –Prishtinë nëpërmes inspektorëve të autorizuar tatimor kishte përpiluar" Raportin e Kontrollit" për Subjektin Afarist H.C" Jatex" me seli pune në Gjakovë.

14. Kontrolli i referohej periudhës kohore 01.07.2001 deri më 31.12.2003 dhe pas përfundimit të tij me raportin e l sipërpërmendur Kompania "JATEX" kishte detyrim të paguaj në emër të obligimeve tatimore në formën e ndëshkimit dhe interesit shumën prej 73480.85 €.

15. Më 05 maj 2005 SH.A 'Jatex" kishte bërë ankesë në Departamentin e Ankesave të Administratës Tatimore , për shkak të: 1). Vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike;2).Aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe 3)vendimit mbi lartësinë e dënimit-përcaktimit zyrtar,duke kërkuar që ky departament të anuloj të gjeturat e raportit dhe ta lirojë nga obligimi financiar ndaj ATK-së.

16. Më 24. Qershor 2005 Departamenti i Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës morri vendim për Refuzimin e ankesës së SHA"Jatex" nga Gjakova me arsyetimin se Inspektorët e sajë kishin konstatuar drejt dhe të plotë gjendjen faktike dhe se ndëshkimet dhe interesi i caktuar për SH.A "Jatex" rrjedhin sipas nenit 5 të procedurave të parapara me rreg. e Unmik-ut nr 2000/20 mi Mbi Administratën dhe Procedurat tatimore.

17. Kundër këtij vendimi më 30. Gusht 2005 SH.A "Jatex" ka paraqitur ankesë në Bordin e pavarur për Shqyrtimin e

vendimeve të Administratës Tatimore për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim it të gabuar të së drejt[s materiale.

18. Më 01 dhjetor 2005 Bordi i pavarur për Rishqyrtime ka nxjerr Aktvendimin A.nr 389/2005 me të cilin ka refuzuar ankesën e SH.A."Jatex" nga Gjakova dhe ka lënë në fuqi vendimin e Administratës tatimore nr 213/205 të datës 06.07.2005.

19. Kundër këtij Aktvendimi më 23 dhjetor 2005 SH.A."Jatex" ka parashtruar Padi në Gjykatën Supreme duke kërkuar anulimin e tij.

20. Më 31 tetor 2007 Gjykata Supreme e Kosovës në procedurën e Konfliktit Administrativ nxori Aktgjykimin A.nr.1771/2005 dhe Refuzoi Padinë e SH.A "jatex" me arsyetimin se gjendja faktike ishte e konstatuar e drejtë dhe e plotë nga ana e organeve administrative si dhe përcaktimi i tatimeve,ndëshkimeve dhe interesave ishte bërë konform legjislacionit në fuqi.

21. Kundër këtij Aktgjykimi SH.A"Jatex" në afat ligjor parashtroi Padi për Përsëritjen e Procedurës.

22. Më 03 maj 2011 Gjykata Supreme e Kosovës mori Aktvendimin P.P.A nr 3/2008 me të cilin Hodhi Poshtë padinë për Përsëritjen e Procedurës me arsyetimin se përpos

përsëritjes së pohimit për jo profesionalizimin e inspektorëve tatimor të Administratës Tatimore të Kosovës ,paditësi nuk kishte ofruar prova tjera bindëse që do të arsyetonin përsëritjen e procedurës.

Pretendimet e parashtruesit për shkeljet kushtetuese

23. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se me Aktvendimin e Gjykatës supreme të Kosovës me të cilin nuk i është aprovuar padia për përsëritjen e procedurës atij si subjekt afarist i është cenuare drejta e garantuar me kushtetutë për barazinë para ligjit si dhe mbrojtja gjyqësore e të drejtave (neni 24 dhe 54 i Kushtetutës).

24, parashtruesi kërkesë më tej ka theksuar se këto të drejta janë shkelur si pasojë e mos konstatimit të drejtë e të plotë të gjendjes faktike ,nga ana e inspektorëve tatimor të Administratës tatimore dhe jo profesionalizmit të theksuar të tyre sepse e kanë ngarkuar Kompaninë e tyre me obligime financiare ne emër të tatimeve. interesave e ndëshkimeve për shitje të cilat sipas parashtruesit të ankesës lirohen nga tatimi dhe blerësi i kishte këto mjete si kontribute dhe donacion. Sipas parashtruesit të ankesës të notat gabime i kanë bëre edhe organet administrative edhe Gjykata Supreme kur nuk i ka marrë parasysh faktet e parashtruara nga 'Jatex"SH.A.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

25. Për te qene ne gjendje për te gjykuar mbi Kërkesën e Parashtruesit te kërkesës, Gjykata duhet paraprakisht te vlerësojë nëse Parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen ne Kushtetute,ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës së Gjykatës

26. Ne lidhje me ketë, Gjykata i referohet nenit 113.7 te Kushtetutës qe përcakton se:

> *"Individët janë te autorizuar te ngrenë **shkeljet nga autoritetet publike te drejtave dhe lirive te tyre individuale**, **te garantuara me Kushtetute**, mirëpo **vetëm** pasi te **kenë shteruar te gjitha mjetet juridike** te përcaktuara me ligj."*

Gjykata Gjithashtu merr parasysh:

Nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese ku shprehimisht përcaktohet se:

> "Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi."

27. Për të vërtetuar faktin nëse parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur kërkesën brenda aftit katër mujor Gjykata i referohet kohës së pranimit të vendimit të fundit nga ana e parashtruesit të kërkesës si dhe datës së paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

28. Nga kopja e formularit standard për paraqitjen e kërkesave në Gjykatën Kushtetuese

Konstatohet fakti se parashtruesi i kërkesës nuk kishte specifikuar datën e pranimit të Aktvendimit të fundit - Gjykatës Supreme por ne rubrikën ku detyrohet pa përcaktojë atë kishte vure pikëpyetje(?) duke dhënë indikacion se nuk e di kur e ka pranuar atë vendim.

29. Gjykata me këtë rast rikujton se sipas nenit 49 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese është obligim i paraqitësit të kërkesës ta saktësoj kërkesën dhe se ky obligim nënkupton edhe paraqitjen e dëshmive se kërkesa e tij-saj është brenda kornizave kohore të afatit 4 mujor të përcaktuar me ligj.

30. Në fakt edhe pse paraqitësi i kërkesës nuk kishte specifikuar datën e pranimit të Aktvendimit të Gjykatës Supreme nga kopja e këtij Aktvendimi që e ka bashkangjitur me kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, qartazi vërehet se në ballinën e Këtij Aktvendimi në anën e majtë vet paraqitësi i kërkesës(jatex korporata) i kishte vënë vulën zyrtare të protokollit të pranimit që mbanë titullin e organit pranues,nr e protokollit .191 dhe datën 15.06.2011.

31. Fakti që, Aktvendimi i Gjykatës Supreme P.P.A.nr.3/ 2008 i nxjerrë me 03.05.2011 dhe është pranuar më **15.06.2011**

,ndërsa kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është paraqitur me 26 prill 2012 .i krijon bazë të qartë juridike Gjykatës që në përputhje me rregullin 36 par 1 pika (b) të konstatojë se kërkesa është e papranueshme sepse parashtruesi i sajë e ka paraqitur atë në Gjykatë pas afatit të përcaktuar me nenin 49 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese,një arsyetim të tillë ne mes tjerash Gjykata e kishte përdorur edhe me rastin e vendosjes së kërkesës Komuna e Gjakovës - Vlerësimi i kushtetutshmërisë te aktgjykimit te Gjykatës Ekonomike te Qarkut ne Prishtine Nr. c. nr. 183/2009 te 17 qershorit 2009(Aktvendimi për papranueshmëri i Gjykatës Kushtetuese i dt. 21 maj 2012)

32 . Gjykata gjithmonë thekson se qëllimi i rregullit katër-mujor është për të promovuar sigurinë juridike,të sigurojë që rastet e ngritura për e çështjet Kushtetuese do të ë shqyrtohen brenda një kohe të arsyeshme dhe për të mbrojtur autoritetet dhe personat e tjerë të interesuar nga të qenit në një situatë të pasigurisë për një periudhë të gjatë kohore (shih mutais mutandis PM v Mbretëria e Bashkuar Aplikacioni no. 6638/03 , 19 korrik 2005)

33. Në këto rrethana parashtruesi i kërkesë nuk i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, andaj:

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e 19 shtatorit 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Robert Carolan Prof. Dr. Enver Hasani

KI 76/11 datë 17 tetor 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 25/2011, të 22 marsit 2011, dhe të Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Kp. nr. 255/2010, të 2 nëntorit 2010

Lënda KI 76/11.

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Kërkesa bazohet në nenin 113.7. të Kushtetutës; nenin 46, 47, 48 dhe 49. të Ligjit nr.03/L-121 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin vijues:Ligji) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin vijues:Rregullorja e punës).

Paraqitësi i kërkesës, më 8 qershor 2011 i ka paraqitur kërkesë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Kryetari i gjykatës, më 17 gusht 2011 e ka emëruar gjyqtarin Ivan Çukaloviq gjyqtar raportues, si dhe Kolegjin për shqyrtim në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Iliriana Islami.Më 2 korrik 2012, kryetari e ka emëruar gjyqtaren Snezhana Botusharova në vend të gjyqtares Iliriana Islami.
Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren P.nr.17/2007 të datës 9 korrik 2007, paraqitësi i kërkesës është shpallur fajtor për dy vepra penale, raste të rënda të vjedhjes grabitqare nga neni 256.1. të Ligjit të Përkohshëm Penal të Kosovës (LPPK).Rrjedhimisht, paraqitësit të kërkesës i është shqiptuar dënimi unik me burg në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) vjetësh.

I pakënaqur me rrjedhën e aktgjykimit, paraqitësi i kërkesës ka ushtruar ankesë në Gjykatën Supreme.

Më 27 shkurt 2008, Gjykata Supreme e Kosovës ka marrë aktvendim nën numrin Ap.nr424/2007 dhe e ka refuzuar si të pabazë ankesën e paraqitësit të kërkesës.
Pas kësaj, më 18 shkurt 2011 ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës, më 22 shkurt 2011, ka marrë aktgjykim Pkl.nr.25/2011 dhe e ka refuzuar si të pabazë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Kp.nr.255/2010 nga data 2 nëntor 2010.

Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, gjykata nuk ka konstatuar se veprimet përkatëse në çfarëdo mënyre kanë qenë të padrejta apo të njollosura me arbitraritet (shih mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, vendimi ESLJP lidhur me pranueshmërinë e kërkesës nr.17064/06 nga data 30 qershor 2009).Rrjedhimisht, në këtë kërkesë nuk janë plotësuar kushtet e pranueshmërisë.Paraqitësi i kërkesës nuk ka arritur ta vërtetoj se vendimi i kontestuar ia ka shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese paraqitësit të kërkesës.Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 48 dhe 56. të Ligjit dhe rregullit 36. të Rregullores së punës së Gjykatës, njëzëri ka vendosur që kërkesën ta shpallë të papranueshme.

Prishtinë, 11 tetor 2012
Nr.ref.:RK 311/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 76/11

Parashtruesi

Avni Aliaj

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 25/2011, të 22 marsit 2011, dhe të Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Kp. nr. 255/2010, të 2 nëntorit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Avni Aliaj, i cili është duke vuajtur dënimin me burg në Burgun e Dubravës, në Istog.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. Nr. 25/2011, të 22 marsit 2011, dhe të Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Kp. Nr. 255/2010, të 2 nëntorit 2010.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës konsideron se me aktgjykimet e kontestuara janë shkelur dispozitat e nenit 31, paragrafët 1 dhe 2, të Kushtetutës (e Drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm) dhe nenit 23 (Dinjiteti i njeriut).

4. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese të vërtetojë se aktgjykimet e kontestuara janë nxjerrë në kundërshtim me Kushtetutën dhe për këtë të mundësohet përsëritja e procedurës penale para gjykatave të rregullta.

Baza juridike

5. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 8 qershor 2011, parashtruesi ka dorëzuar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Kryetari i Gjykatës, më 17 gusht 2011, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović për Gjyqtar raportues, si dhe Kolegjin shqyrtues në

përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Iliriana Islami. Më 2 korrik 2012, Kryetari caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova zëvendësim për gjyqtaren Iliriana Islami.

8. Të njëjtën datë, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

9. Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, P. nr. 17/2007, të 9 korrikut 2007, parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor për dy vepra penale: rast i rëndë i vjedhjes grabitqare apo i grabitjes, sipas nenit 256.1 të KPPK-së (Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës). Pastaj, i është shqiptuar dënimi i përbashkët më kohëzgjatje 12 (dymbëdhjetë) vjet.

10. I pakënaqur me rezultatin e Aktgjykimit, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, duke pretenduar se Aktgjykimi i kontestuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sipas nenit 403, paragrafi 1, pika 12 dhe 8, të KPPK-së. Ai, më tutje, pretendon se Aktgjykimi është i pakuptimtë, jokonsistent, nuk përmban arsye për faktet vendimtare dhe nuk është i bazuar në prova të pranueshme.

11. Më 27 shkurt 2008, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin me numër Ap. nr. 424/2007 dhe hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës. Gjykata Supreme, në arsyetimin e vet, ndër të tjera thekson se dispozitivi i Aktgjykimit është qartazi i kuptueshëm dhe konkret. Përfundimisht, Gjykata Supreme thekson se, në bazë të vlerësimit dhe të arsyetimit që ka dhënë gjykata e shkallës së parë, shihet se është vendosur drejt dhe plotësisht situata faktike dhe se është zbatuar në mënyrë të drejtë ligji penal.

12. Më 20 tetor 2010, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për përsëritjen e procedurës penale, duke theksuar se Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren është bazuar në deklaratë të rreme të dëshmitarëve dhe ofroi prova të reja që shkojnë në favor të tij.

13. Më 2 nëntor 2010, Gjykata e Qarkut në Prizren, me aktvendimin Kp. Nr. 255/2010, ka hedhur poshtë si të pabazuar kërkesën për përsëritjen e procedurës. Në atë aktvendim, parashtruesi është ankuar më 11 nëntor 2010, duke theksuar ndër të tjera se është gjithashtu i pabazuar.

14. Më 23 nëntor 2010, Gjykata Supreme e Kosovës ka hedhur poshtë si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës.

15. Pas kësaj, më 18 shkurt 2011, parashtruesi ka parashtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

16. Gjykata Supreme e Kosovës, më 22.02.2011, nxori Aktgjykimin Pkl. Nr. 25/2011, duke hedhur poshtë si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Kp. nr. 255/2010, të 2 nëntorit 2010. Gjykata Supreme vërteton, ndër të tjera, se parashtruesi nuk ka paraqitur prova të reja. Në të vërtetë, sipas Gjykatës Supreme, të njëjtat prova ishin objekt i aktgjykimeve të nxjerra në procedurat e shkallës së parë dhe të dytë penale. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme arriti në përfundim se provat e paraqitura nga parashtruesi nuk janë nën kategorinë e provave të reja, siç parashihet me nenin 442, paragrafi 1 dhe 3, të KPPK-së dhe, si pasojë, nuk janë përmbushur kërkesat për rishqyrtim të procedurës penale.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

17. Për të gjykuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata, së pari, duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për papranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe

të specifikuara në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregullore të punës.

18. Gjykata vëren se parashtruesi ka shteruar të gjitha mjetet dhe ka dorëzuar kërkesën e tij brenda afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.

19. Gjykata më tutje vëren se parashtruesi, në rastin konkret, ankohet në Gjykatën Supreme për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë, e drejtë kjo e garantuar me nenin 31, paragrafët 1 dhe 2, të Kushtetutës, si për shkelje të së drejtës për dinjitet njerëzor, e drejtë kjo e garantuar me nenin 23 të Kushtetutës.

20. Neni 31 (e Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), në paragrafët 1 dhe 2, parasheh si në vijim:

> *"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
>
> *2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".*

21. Neni 23 (Dinjiteti i Njeriut) i Kushtetutës parasheh si në vijim:

> *"Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut".*

22. Parashtruesi pretendon që, për shkak se Gjykata Supreme e Kosovës nuk i ka marrë parasysh provat e paraqitura si prova të reja, atij i është mohuar e drejta për gjykim të drejtë, siç garantohet më Kushtetutë.

23. Gjykata rithekson se, për të përcaktuar një shkelje kushtetuese, një parashtrues duhet të dëshmojë që, më shumë se një gjykatë e rregullt, mund të ketë bërë dy ose më shumë se dy konkluzione kontradiktore ligjore ose faktike.

24. Ashtu siç theksohet nga Gjykata Kushtetuese në rastin nr. KI06/09, parashtruesi X kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme nr. 215/2006, Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut nr. 741/2005, Aktgjykimit të Gjykatës Komunale nr. 217/2004:

> *"...Gjykata dëshiron të theksojë se nuk është gjykatë apeli për gjykatat e tjera në Kosovë, dhe nuk mund të intervenojë mbi bazën e asaj se ato gjykata kanë marrë vendime të gabuara, apo kanë bërë vlerësim të gabuar të fakteve. Roli i Gjykatës është vetëm të sigurojë pajtueshmëri me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, dhe për këtë arsye ajo nuk mund të veprojë si gjykatë e "shkallës së katërt" (shih, mutatis mutandis, Akdicvar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).*

25. Siç theksohet më tutje nga Gjykata Kushtetuese në rastin nr. KI06/09, parashtruesi X kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme nr. 215/2006, Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut nr. 741/2005, Aktgjykimit të Gjykatës Komunale nr. 217/2004:

> *"Fakti i thjeshtë se parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih, mutatis mutandis, Aktgjykimi I ECHR Appl. Nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).*

26. Për më tepër, përkitazi me ankesat e parashtruesit se janë shkelur të drejtat për gjykim të drejtë dhe për dinjitet njerëzor, parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që të paraqesë rastin e vet para Gjykatës Qarkut në Prizren dhe para Gjykatës Supreme të Kosovës dhe të kontestojë interpretimin e ligjit për të cilin konsideron se është i pasaktë. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka vërtetuar se

procedurat e duhura, në çfarëdo mënyre, kanë qenë të padrejta dhe arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, të 30 qershorit 2009).

27. Rrjedhimisht, në këtë kërkesë nuk janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë. Parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të mbështesë me prova pretendimet e tij se vendimi i kontestuar ka shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese të parashtruesit të kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 dhe 56 të Ligjit, dhe me rregullin 36 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata Kushtetuese, njëzëri

VENDOSI

I. TA SHPALLË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Prof. Dr. Ivan Čukalović	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 21/11 datë 22 tetor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Ap. Nr. 329/09, të 3 qershorit 2010, si dhe i Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, P. Nr. 187/2008, të 30 qershorit 2009

Lënda KI 21/11, vendimi i datës 03.07.2012.

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme të Kosovës Ap.nr.239/09 i datës 03.06.2010, si dhe aktvendimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren A.nr.187/2008 i datës 30.06.2009.

Paraqitësja e kërkesës, më 18.02.2011 i ka paraqitur kërkesë Gjykatës Kushtetuese.

Paraqitësja e kërkesës e ka paraqitur parashtresën në pajtim me nenin 113. paragrafi 7. i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 49. i Ligjit, rregulli 36 paragrafi 1(b) i Rregullores së Punës.

Paraqitësja e kërkesës konsideron se me aktvendimet e kontestuara është shkelur e drejta e saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e veçanërisht e drejta për mbrojtje adekuate profesionale në procedurën penale të filluar kundër saj.
Kryetari i gjykatës, më 02.03.2011, me vendimin nr.GJR 21/11 e ka emëruar gjyqtaren Iliriana Islami gjyqtare raportuese.
Më 02.07.2012, kryetari e ka emëruar gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues në vend të gjyqtares Iliriana Islami.
Më 30.06.2009 me aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren A.nr.187/08, paraqitësja e kërkesës është shpallur fajtore dhe është dënuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 18 vjetësh, për veprën e kryer penale vrasje e rëndë nga neni 147. paragrafi 1. pika 4 dhe veprën penale posedim i paautorizuar, kontroll, posedim apo përdorim i armës nga neni 328, paragrafi 2. i Ligjit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

Paraqitësja e kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të konstatojë se aktvendimet e marra janë në kundërshtim me të drejtat e garantuara kushtetuese, prandaj, për këtë arsye të mundësohet përsëritja e procesit penal para gjykatave të rregullta.

Më 03.07.2012, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji i shqyrtimit i ka rekomanduar Gjykatës mospranimin e kërkesës.
Gjykata vëren se kërkesa e paraqitëses së kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese, më 18.02.2011 është paraqitur jashtë afatit kohor prej katër muajsh, të paraparë me nenin 49 të Ligjit.
Prandaj, në pajtim me nenin 113. paragrafi 7. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullit 36. të Rregullores së punës, kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme.

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. paragrafi 7. i Kushtetutës, nenin 48, 49 dhe 56. të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, njëzëri ka vendosur që kërkesën e paraqitëses ta refuzojë si të papranueshme.

Prishtinë, më 11 tetor 2012

Nr. ref.: RK312/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Rasti nr. KI 21/11

Parashtruesi

Valbona Zogaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Ap. Nr. 329/09, të 3 qershorit 2010, si dhe i Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, P. Nr. 187/2008, të 30 qershorit 2009

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe

Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Valbona Zogaj, e cila për momentin është në vuajtje të dënimit me burg në QKP në

Lipjan, të cilën në Gjykatën Kushtetuese e përfaqëson avokatja Nushe Kuka-Mekaj nga Peja.

Vendimet e kontestuara gjyqësore

2. Vendimet e kontestuara gjyqësore janë: Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. Nr. 329/09, i 3 qershorit 2010, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren, P. Nr. 187/2008, i 30 qershorit 2009**.**

Çështja e lëndës

3. Parashtruesi i kërkesës konsideron se, me vendimet e kontestuara gjyqësore, i është shkelur e drejta në gjykim të drejtë, e posaçërisht e drejta në mbrojtje përkatëse profesionale në procedurat penale të drejtuara kundër saj.

4. Parashtruesi i kërkesës pretendon që mbrojtësit e saj në procedurë penale e kishin këshilluar gabimisht që të mos e thotë të vërtetën në gjyq. Kështu që, e vërteta nuk është thënë fare në gjyq. Sipas parashtruesit, kjo ishte arsyeja që ajo është konstatuar gabimisht fajtore për veprën penale vrasje e rëndë.

5. Parashtruesi i kërkesës pretendon që në procedurë është dashur ta kishte mbrojtjen përkatëse, e posaçërisht në rastet e veprave të rënda penale, duke cekur, siç parashihet me dispozitën e nenit 75.4 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës. Ajo pohon që nuk ishte në gjendje të kuptonte rëndësinë e veprës penale, ndërsa fshehja e argumenteve të vërteta nga gjyqi ishte e dëmshme për të, si dhe pohon që gjykata ishte e obliguar t'i ofronte mbrojtje përkatëse profesionale në procedurë.

6. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese të konstatojë që aktgjykimet e kontestuara janë nxjerrë në kundërshtim me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe,

prandaj, t'ia mundësojë përsëritjen e procedurës penale para gjykatave të rregullta.

Baza ligjore

7. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 49 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, dhe rregulli 36.1 (b) i Rregullores së punës së Gjykatës.

Procedura në Gjykatë

8. Më 18 shkurt 2011, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

9. Më 2 mars 2011, Kryetari i Gjykatës, me vendimin Nr. GJR. 21/11, e caktoi gjyqtaren Iliriana Islami Gjyqtare raportuese.

10. Më 7 tetor 2011, Sekretariati i Gjykatës kërkoi nga avokatja e parashtruesit të kërkesës, Nushe Kuka-Mekaj nga Peja, që t'ia dorëzonte Gjykatës edhe kopjen e vendimit të fundit të pranuar gjyqësor, së bashku me fletëdërgesën e nënshkruar në mënyrë të duhur.

11. Më 21 maj 2012, Gjykata e Qarkut në Prizren ia dorëzoi Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës kopjen e nënshkruar në mënyrë të duhur të fletëdërgesës për pranimin e dorëzimit të aktgjykimit të pandehurës, nga e cila vërehet qartë se parashtruesi i kërkesës e ka pranuar personalisht Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, P. Nr. 187/08, të 30 qershorit 2009, si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Nr. Ap. 329/2009, të 3 qershorit 2010, e cila i është dorëzuar personalisht më 9 korrik 2010.

12. Po të njëjtën ditë, Gjykata e Qarkut në Prizren i dorëzoi Sekretariatit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës kopjet e fletëdërgesave, të nënshkruara nga mbrojtësja e parashtruesit të

kërkesës përkitazi me pranimin e aktgjykimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe të Gjykatës së Qarkut në Prizren. Mund të konkludohet që njëri mbrojtës kishte pranuar aktgjykimin e Gjykatës Supreme më 8 korrik 2010, ndërsa tjetri më 9 korrik 2010.

13. Më 2 korrik 2012, Kryetari caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar raportues, në vend të gjyqtares Iliriana Islami.

14. Më 3 korrik 2012, pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e shkurtër e fakteve

15. Më 30 qershor 2009, sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, P. nr. 187/08, parashtruesja është shpallur fajtore dhe është dënuar me 18 vjet heqje lirie për kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë sipas nenit 147.1 (4) dhe të veprës penale mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të armëve sipas nenit 328.2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

16. E pakënaqur më rezultatin e kësaj, parashtruesi i kërkesës, nëpërmjet avokatëve të saj, ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës penale dhe vlerësimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së Kodit Penal dhe të aktvendimit për dënim penal. Për më tepër, avokatët mbrojtës të parashtruesit të kërkesë, parashtruan një përgjigje ndaj ankesës së Zyrës së Prokurorit Publik.

17. Më 3 qershor 2010, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin Ap. Nr. 329/2010, me të cilin e konfirmoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren dhe hodhi poshtë ankesat e avokatëve mbrojtës të parashtruesit të kërkesës dhe të Prokurorit Publik të Qarkut si të pabazuara. Gjykata Supreme, në arsyetimin e aktgjykimit, deklaroi, ndër të tjera: “Kjo Gjykatë

konstatoi si të pabazuara pohimet ankimore se aktgjykimi i kontestuar ka shkelur Kodin Penal ndaj të pandehurit, sepse nga provat e evidencuara pa asnjë dyshim del se i pandehuri ka kryer vepër penale, për të cilën ajo u shpall fajtore në gjykatën e shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë ka zbatuar në mënyrë të duhur dispozitat e Kodit Penal kur ka sjellë veprimet e të pandehurës në normat ligjore te vrasjes së rëndë sipas nenit 147, paragrafi 1, pika 4, të GJKK...".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

16. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

17. Sa i përket kërkesës së parashtruesit të kërkesës, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, i cili thotë:

"Afatet

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi".

18. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e saj, ankohet në shkeljen e të drejtës në gjykim të drejtë, respektivisht se është kështilluar gabimisht gjatë procedurës në gjykatë nga mbrojtësi të cilin vetë e kishte përzgjedhur.

19. Sidoqoftë, Gjykata vëren se aktgjykimi final është nxjerrë më 3 qershor 2010, ndërsa parashtruesi i kërkesës dhe mbrojtësit e saj e kanë pranuar më 8 korrik 2010 dhe më 9 korrik 2010.

20. Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit është dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese më 18 shkurt 2011, që do të thotë se kërkesa i është parashtruar Gjykatës jashtë afatit të paraparë gjyqësor prej katër muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

21. Rrjedhimisht, në pajtim më nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe në pajtim me rregullin 26, paragrafi 1 (b), të Rregullores së punës, kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 48, 49 e 56 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës njëzëri:

VENDOSI

I. TA SHPALLË kërkesën të papranueshme;

II. Ky vendim do t'i komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Altay Suroy Prof. Dr. Enver Hasani

KI 70/12 datë 21 nëntor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2005/2005, të 13 tetorit 2008; të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 76/2007, të 22 tetorit 2008; dhe të Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 27/2009, të 14 majit 2012

Rasti KI 70/2012, vendimi i datës 20 shtator 2012
Fjalët kyçe:Kontest pronësor, kërkesa individuale, kërkesa qartazi e pabazuar.

Parashtruesit e kishin dorëzuar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke pretenduar se, të gjitha instancat gjyqësore me vendimet e tyre kanë shkelur të drejtat e tyre kushtetuese, parashtruesit nuk kishin specifikuar dispozitën kushtetuese me te cilën pretendonin se u ishin shkelur të drejtat e tyre.

Gjykata në rastin konkret i është referuar nenit 48 te ligjit dhe rregullit 36.2 pika b) dhe d) të Rregullores së punës. Në këtë drejtim, Gjykata ka konstatuar se parashtruesi nuk kishte treguar pse dhe si Gjykata e Supreme, ia kishte shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane dhe as që kishte ofruar prova për shkeljet e pretenduara të të drejtave te garantuara me Kushtetutë. Gjykata, nuk mundur të gjejë pse dhe si procedurat përkatëse në Gjykatën Supreme, ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare lidhur me këtë përmend rastin *Shub kundër Lituanisë*, Vendimi i GJEDNJ-së për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009. Gjykata ne përfundim kishte konsideruar që kërkesa nuk i përmbushte kriteret e kërkuara në nenin 48 të Ligjit dhe të rregullit 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së punës, prandaj, si e tillë kërkesa është konsideruar si qartazi e pabazuar.

Prishtinë, më 17 tetor 2012

Nr. ref.: RK316/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 70/12

Parashtruesit

Zahir dhe Hazir Sinani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2005/2005, të 13 tetorit 2008; të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 76/2007, të 22 tetorit 2008; dhe të Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 27/2009, të 14 majit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Zahir dhe Hazir Sinani, nga fshati Hajvali, komuna e Prishtinës, nëpërmjet përfaqësuesit të tyre, z. Xhevat Bici, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë këto vendime gjyqësore: Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2005/2005, të 13 tetorit 2008; Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 76/2007, të 22 tetorit 2008; dhe Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 27/2009, të 14 majit 2012, të cilin e kanë pranuar më 20 qershor 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës ka të bëjë me shkeljet e pretenduara të të drejtave në pronë, të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

4. Parashtruesit, në kërkesën e tyre, kanë specifikuar kërkesën për vlerësimin e ligjshmërisë së vendimeve të sipërshënuara gjyqësore.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesit e kërkesës, nëpërmjet përfaqësuesit të tyre, e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) më 31 korrik 2012.

7. Më 13 shtator 2012, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtrueseve, Gjykatën Supreme, Gjykatën e Qarkut në Prishtine dhe Gjykatën Komunale në Prishtinë, për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 4 shtator 2012, Kryetari, me Vendimin nr. GJR 70/12, caktoi gjyqtarin Mr. sc. Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, me Vendimin nr. KSH 70/12, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy (anëtar) dhe Prof. Dr. Enver Hasani (anëtar).

9. Më 17 tetor 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

10. Më 13 nëntor 2006, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi C. nr. 2057/2005), aprovoi si të bazuar padinë e z. Ramush Rrahmani (paditësi) dhe, me këtë rast, i detyroi parashtruesit (të padituri) që t'ia dorëzojnë në posedim paluajtshmërinë e evidencuar në fletën poseduese 809 ZK në Hajvali, ngastra nr. 875, me kulturë arë e klasit III, në sipërfaqe 0.66,02 hektarë. Kërkesëpadia e parashtruesve, të cilët kishin kërkuar që t'u njihet bashkëpronësia nga ½ pjesë e paluajtshmërisë në fjalë, ishte refuzuar si e pabazë.

11. Më 22 tetor 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktvendimi Ac. nr. 76/2007), refuzoi si të pabazuar ankesën e ushtruar nga parashtruesit dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2057/2005, e 13 tetorit 2006, që ka të bëjë me paluajtshmërinë kontestuese në fjalë.

12. Kundër Aktvendimit Ac. nr. 76/2007, të 22 tetorit 2008, parashtruesit, në afat ligjor, kanë shfrytëzuar mjetin e jashtëzakonshëm juridik, pra kanë ushtruar revizion në Gjykatën Supreme, siç pohojnë parashtruesit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

13. Më 14 maj 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 27/2009), e shqyrtoi revizionin e ushtruar nga parashtruesit e kërkesës, që ishte ushtruar kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtine, Ac. nr. 76/2007, të 22 tetorit 2008, me ç'rast refuzoi si të pabazë revizionin e ushtruar, me arsyetimin se shkalla e dytë, në mënyrë të plotë dhe të drejtë, ka verifikuar gjetjet faktike dhe, në mënyrë të drejtë, ka aplikuar të drejtën materiale, kur gjykoi se ankesa e parashtruesve ishte e pabazuar.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

14. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se, të gjitha instancat gjyqësore, me vendimet tyre, kanë bërë shkeljen e të drejtave

kushtetuese të tyre, por që nuk kanë saktësuar se për cilat të drejta kushtetuese bëhet fjalë.

Vlerësimi paraprak i pranueshmerisë së kërkesës

15. Së pari, Gjykata vlerëson nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës. Gjykata, nga parashtresat e parashtruesve, ka kuptuar se bëhet fjalë për kontest pronësor, që në Kushtetutë nënvizohet në nenin 46 [Mbrojtja e pronës].

16. Neni 46 i Kushtetutës përcakton në mënyrë specifike:

> *1. E drejta e pronës është e garantuar;*
> *2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik;*
> *3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriimi;*
> *4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetent.*

17. Megjithatë, me rastin e shqyrtimit të mbështetjes me prova të kriterit të pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata vëren se neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese përcakton që *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar"*.

18. Fakti që parashtruesit ndahen të pakënaqur me vendimet gjyqësore, nuk do të thotë që, të njëjtit, pakënaqësitë e tyre përkitazi me çështjen kontestuese duhet t'i paraqesin nëpërmjet ankimit kushtetues, duke parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata rikujton që rasti duhet të ndërtohet në baza kushtetuese, në mënyrë që kjo Gjykatë të ndërhyjë.

19. Në anën tjetër, rregulli 36.2 i Rregullores së punës, përcakton:

"Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

20. Së fundmi, neni 46 i Ligjit përcakton që "Gjykata Kushtetuese pranon dhe procedon kërkesën e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nëse konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore".

21. Në këtë drejtim, parashtruesit nuk tregojnë pse dhe si Gjykata e Supreme ua ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane, as nuk kanë ofruar prova për shkeljet e supozuara të të drejtave kushtetuese.

22. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me lajthitjet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), gjoja të kryera nga Gjykata e Supreme, përveç nëse dhe për aq sa ato mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Prandaj, në këtë rast, Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt. Është detyrë dhe obligim i gjykatave të rregullta që t'i interpretojnë dhe t'i

zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

23. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe para organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesit e kësaj kërkese të kenë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).

24. Në të vërtetë, parashtruesit nuk i kanë mbështetur pretendimet e tyre në baza kushtetuese, duke treguar pse dhe si Gjykata e Supreme ua ka shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë dhe me Konventën Evropiane dhe nuk kanë ofruar prova që të drejtat dhe liritë e tyre janë shkelur nga Gjykata Supreme dhe nga instancat e tjera gjyqësore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të gjejë pse dhe si procedurat përkatëse në Gjykatën Supreme ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmëri të kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

25. Nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata gjen që kërkesa nuk i përmbush kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe të rregullit 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së punës, prandaj, si e tillë, është qartazi e pabazuar dhe, në pajtim me nenin 46 të Ligjit, nuk mund të pranohet dhe të procedohet.

26. Rrjedhimisht, në pajtim ne nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 46 dhe 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe në pajtim me rregullin 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 17 tetor 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Mr. sc. Kadri Kryeziu	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 78/10 datë 21 nëntor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 137/2007, i 13 prillit 2010

Rasti KI 78/2010, vendimi i datës 20 shtator 2012
Fjalët kyçe: kontesti për të drejtën ne punë, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, kërkesa individuale, kërkesa qartazi e pabazuar.

Parashtruesit e kishin dorëzuar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke pretenduar se ka pasur shkelje të rëndë të të drejtave të tyre themelore kushtetuese për punësim. Kërkesa nuk përmbante detaje më të mëdha. Ministria në përgjigjen e saj kishte pohuar se parashtruesit nuk janë dhe kurrë nuk kanë qenë punëtorë të Ministrisë dhe se ministria nuk posedonte shënime, prova, dokumente apo fakte që provojnë se parashtruesit ishin punëtorë te Ministrisë në fjalë, ata as që kishte kontrata të punës me Ministrinë ne fjalë.

Gjykata, në këtë rast i është referuar nenit 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullit 36.2 pikës b) dhe d) te Rregullores së punës qe përcaktojnë se b) *faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*

Gjykata, erdhi në përfundim se parashtruesit nuk e kishin mbështetur me prova pretendimin e tyre në gjykata të rregullta se ishin punëtorë të Ministrisë, ata as që i kishin ofruar Gjykatës Kushtetuese prova të mjaftueshme apo ndonjë provë që do të tregonte se aktgjykimi i Gjykatës Supreme ishte i gabuar. Siç u tha nga Gjykata Kushtetuese në Rastin Nr. KI. 06/09, Parashtruesi X kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Nr. 215/2006; Aktgjykimit

të Gjykatës së Qarkut Nr. 741/2005, dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale Nr. 217/2004.

Prishtinë, më 17 tetor 2012

Nr. ref.: RK314/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Rasti Nr. KI 78/10

Parashtruesit

Qerim Azizi, Shaip Reçica, Bajram Troshupa, Idriz Retkoceri,

Rukije Kastrati, Rashid Sejdiu dhe Ramadan Sylejmani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 137/2007, i 13 prillit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtrues

1. Parashtrues të kërkesës janë: Qerim Azizi, Shaip Reçica, Bajram Troshupa, Idriz Retkoceri, Rukije Kastrati, Rashid Sejdiu dhe Ramadan Sylejmani. Ata përfaqësohen nga avokati i tyre, Halim A. Sylejmani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 137/2007, të 13 prillit 2010, që parashtruesve u ishte dorëzuar më 7 qershor 2010.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kësaj kërkese ka të bëjë me kërkesën e parashtruesve për t'u trajtuar si punëtorë të Ministrisë së Kulturës dhe Sporteve (në tekstin e mëtejmë: Ministria), kërkesa e të cilëve së fundi ishte refuzuar nga Gjykata Supreme.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesit e parashtruan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 18 gusht 2010.

6. Më 19 gusht 2010, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesve se kërkesa ishte pranuar dhe se ishte regjistruar me numër të referencës KI 78/10.

7. Më 20 shator 2010, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

8. Të njëjtën ditë, Gjykata kërkoi nga Ministria të përgjigjen në këtë kërkesë. Pas korrespondencës së mëtejme ndërmjet Ministrisë dhe Gjykatës, Ministria u përgjigj më 1 mars 2011 dhe më 22 qershor 2012. Përgjigja e Ministrisë trajtohet më poshtë.

9. Më 20 shtator 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Faktet e rastit siç pretendohen nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesit

10. Parashtruesit pohojnë që si ish-punëtorë të "Federatës së Sporteve të Kosovës" kanë të drejtë të trajtohen si punëtorë të Ministrisë. Ata fillimisht iniciuan procedurë kundër "Federatës së Sporteve të Kosovës" në Gjykatën Komunale në Prishtinë më 25 shtator 2001. Më pas, ata paraqitën kërkesën që edhe Ministria t'u bashkohej si e paditur dhe kjo kërkesë u miratua.

11. Aktgjykimi u nxor në favor të parashtruesve në Gjykatën Komunale në Prishtinë, CI. nr. 414/2001, i 28 shkurtit 2006, dhe atyre iu caktua kompensimi prej 150 euro në muaj duke filluar nga 1 shtatori 2000, me kamatë ligjore dhe shpenzime të procedurës. Gjykata Komunale duket ta ketë marrë këtë vendim, së paku pjesërisht, mbi bazën që Ministria i inkasonte qiratë nga objektet që i zotëronte. Ministria nuk iu përgjigj procedurës në Gjykatën Komunale dhe aktgjykimi u nxor kundër tyre, në mungesë të tyre dhe pa pjesëmarrjen e tyre.

12. Ky aktgjykim u miratua sipas ankesës nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, në Aktgjykimin e vet, Ac. nr. 737/2006, të 21 dhjetorit 2006.

13. Ministria ushtroi ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme të Kosovës dhe Gjykata Supreme, me Aktgjykimin Rev 138/2007, të 13 prillit 2010, e miratoi ankesën e Ministrisë dhe mori vendim kundër parashtruesve dhe në dobi të Ministrisë dhe e refuzoi padinë e parashtruesve.

14. Gjykata Supreme theksoi në Aktgjykimin e vet se gjykatat e shkallëve më të ulëta kishin marrë vendime duke zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe me këtë rast i ndryshoi të dy aktgjykimet. Në esencë, Gjykata Supreme u pajtua që Ministrisë i mungonte legjitimiteti pasiv për të qenë palë në procedurë dhe se nuk kishte pasur raport të krijuar materialo-juridik në mes të parashtruesve dhe Ministrisë.

Përgjigja e Ministrisë drejtuat Gjykatës Kushtetuese

15. Në përgjigjet e tyre, Ministria pohonte që parashtruesit nuk janë dhe kurrë nuk kanë qenë punëtorë të Ministrisë. Ata pohuan që

nuk kishte shënime, prova, dokumente apo fakte që provojnë se parashtruesit ishin punëtorë, as që kishte kontrata të punës për ndonjërin prej tyre, as që ata ishin në listën e pagës mujore të listës së të pranishmëve në punë dhe se asnjëri prej tyre kurrë nuk kishte konkurruar për punësim në Ministri.

16. Ministria pohoi se i mungonte legjitimiteti pasiv për të qenë palë në procedurë. Ministria i kishte bërë këto argumente edhe në gjykatat e rregullta.

Shkeljet e supozuara të Kushtetutës

17. Parashtruesit pohojnë në përgjithësi që ka pasur shkelje të rëndë të të drejtave themelore kushtetuese për punësim. Kërkesa nuk lëshohet në detaje më të mëdha.

18. Parashtruesit pohojnë në përgjithësi që gjykatat në çdo shkallë e kanë shkelur Ligjin për familjen të Kosovës, Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës dhe garancitë kushtetuese.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesve, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, të specifikuara më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës.

20. Neni 113, paragrafët 1 i Kushtetutës përcakton kornizën e përgjithshme juridike që kërkohet për pranueshmëri. Ai përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

21. Megjithatë, me rastrin e shqyrtimit të mbështetjes me prova të kriterit të pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata vëren se, neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese përcakton që:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar[...]".*

22. Në anën tjetër, rregulli 36.2 i Rregullores së punës, përcakton që:

> *"Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:*
>
> *b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose*
>
> *d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

23. Së fundi, neni 46 i Ligjit përcakton që "Gjykata Kushtetuese pranon dhe procedon kërkesën e ngritur sipas nenit 113, paragrafi 7, të Kushtetutës, nëse konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara ligjore".

24. Gjykata rikujton që rasti duhet të ndërtohet në baza kushtetuese, në mënyrë që të ndërhyjë kjo gjykatë.

25. Në aktgjykimin e 13 prillit 2010, Gjykata Supreme, nxori një vendim të arsyetuar pse Ministrisë i mungonte legjitimiteti pasiv për të qenë palë në procedurën e iniciuar nga parashtruesit. Provat në të cilat bazohej Gjykata Supreme e mbështetën atë konstatim, posaçërisht mungesa e plotë e provave për krijimin e

marrëdhënies së punësimit në mes të parashtruesve dhe Ministrisë.

26. Parashtruesit nuk e mbështetën me prova pretendimin e tyre në gjykata të rregullta se ishin punëtorë të Ministrisë. As që i ofruan Gjykatës Kushtetuese prova të mjaftueshme apo ndonjë provë që do të tregonte se aktgjykimi i Gjykatës Supreme ishte i gabuar.

27. Siç u tha nga Gjykata Kushtetuese në Rastin Nr. KI. 06/09, Parashtruesi X kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Nr. 215/2006; Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Nr. 741/2005, dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale Nr. 217/2004:

"... Gjykata dëshiron të theksojë se ajo nuk është gjykatë apeli për gjykatat e tjera në Kosovë, dhe nuk mund të intervenojë mbi bazën e asaj se ato gjykata kanë marrë vendime të gabuara, apo kanë bërë vlerësim të gabuar të fakteve. Roli i Gjykatës është vetëm të sigurojë pajtueshmëri me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, dhe për këtë arsye ajo nuk mund të veprojë si gjykatë e "shkallës së katërt" (shih, mutatis mutandis, Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65)."

28. Siç u tha më tej nga Gjykata Kushtetuese në Rastin Nr. KI. 06/09, Parashtruesi X kundër Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Nr. 215/2006; Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Nr. 741/2005, dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale Nr. 217/2004:

"Fakti se parashtruesja e kërkesës është e pakënaqur me rezultatin e lëndës në vetvete nuk mund të përbëjë bazë për argumentim të kërkesës për shkelje të Nenit 31 të Kushtetutës (shih, mutatis mutandis, aktgjykimin e GJEDNj Nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, aktgjykim i datës 26 korrik 2005)."

29. Nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata gjen që kërkesa nuk i përmbush kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe të rregullit 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së punës, prandaj, si e tillë, është qartazi e

pabazuar dhe, në pajtim me nenin 46 të Ligjit, nuk mund të pranohet dhe të procedohet.

30. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 46 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe me rregullin 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 20 shtator 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Snezhana Botusharova Prof. Dr. Enver Hasani

KI 74/11 datë 21 nëntor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së dështimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë për të nxjerrë aktgjykim në një padi

Rasti KI 74/2011, vendimi i datës 20 shtator 2012
Fjalët kyçe:Kontesti penal, kërkesa individuale, prima facie, mos shterje e mjeteve juridike, kërkesa qartazi e pabazuar.

Parashtruesi e kishte dorëzuar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke pretenduar se ka pasur shkelje të rëndë të të drejtave themelore të garantuara me nenet: 7 [Vlerat], 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], 53 [Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut] dhe 102 [Parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor] të Kushtetutës, si dhe me nenin 41 të KEDNj.

Gjykata konstatoi se parashtruesi nuk ka treguar e as nuk ka ofruar prova që ka ndërmarrë hapa për të kërkuar nga gjykatat e rregullta që ta përshpejtonin padinë e tij (përveç ankesës në Këshillin Gjyqësor të Kosovës). Padia e parë ishte në pritje e sipër për vendim në gjykata të rregulla. Pala, në asnjë mënyrë nuk kishte treguar se në padinë e parë, i kishte ngritur çështjet e lartcekura sa i përket shkeljeve të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me KEDNj. Prandaj, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenet 47.2, 46 dhe 48 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 36.2 (a, b, c dhe d) të Rregullores së punës, kërkesa është konsideruar si qartazi e pabazuar dhe ishte hedhur poshtë si e papranueshme, sepse nuk ishte *prima facie* e arsyetuar, apo e mbështetur me prova të mjaftueshme.

Prishtinë, më 17 tetor 2012

Nr. ref.: RK313/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Rasti Nr. KI 74/11

Parashtrues

Rasim Nikoqi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së dështimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë për të nxjerrë aktgjykim në një padi

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Rasim Nikoqi nga Gegehysenaj, Republika e Shqipërisë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston refuzimin e shqyrtimit të një padie nga Gjykata e Qarkut në Pejë.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është refuzimin shqyrtimit të e padisë së parashtruesit nga Gjykata e Qarkut në Pejë. Parashtruesi pretendon që është diskriminuar, për shkak se i njëjti është shtetas i Shqipërisë, pasi qe Gjykata e Qarkut në Pejë, ka dështuar të nxjerrë një vendim lidhur me padinë e ushtruar nga ai. Fillimisht padi të ushtruar në Gjykatën Komunale në Gjakovë në vitin 2003.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 10 maj 2011.

6. Më 27 qershor 2011, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga Gjykata Komunale në Gjakovë të dërgonte informata përkitazi me këtë kërkesë. Të njëjtën datë, Gjykata kërkoi nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës të ofronte përgjigje në këtë kërkesë.

7. Këshilli Gjyqësor i Kosovës iu përgjigj Gjykatës, nëpërmjet letrës së 29 korrikut 2011, duke theksuar se gjyqtari i çështjes në fjalë ishte nën hetime, pasi lënda nuk ishte caktuar për pesë vjet.

8. Gjykata Komunale në Gjakovë iu përgjigj Gjykatës Kushtetuese më 1 gusht 2011 dhe, më pas, më 23 shkurt 2012. Gjykata Komunale iu drejtua Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar informata të tjera përkitazi me këtë çështje nga Gjykata e Qarkut në Pejë.

9. Më 17 gusht 2011, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari e caktoi edhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesues), Prof.Dr. Enver Hasani (anëtar) dhe Iliriana Islami (anetare).

10. Më 19 shtator 2012, Kryetari, me vendimin KSH. 74/11, caktoi anëtarët e Kolegjit të ri shqyrtues në përbërje të gjyqtareve: Altay Suroy (kryesues) i cili e zëvendëson gjyqtaren Iliriana Islami, e cila e përfundoi mandatin si gjyqtare në Gjykatë më 26 qershor 2012, Almiro Rodrigues (anëtar) dhe Prof. Dr. Enver Hasani (anëtar).

11. Më 20 shtator 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Faktet e rastit siç pretendohen nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi

12. Më 26 prill 2002, parashtruesi u dënua nga Gjykata Komunale në Gjakovë me 30 ditë paraburgim, pas gjykimit nën akuzat për "tregti të paligjshme", sipas nenit 116.1 të KPK-së. U sekuestruan mallra (435 arka me birrë) me vlerë 5.972,50 euro. Më 16 maj 2002, parashtruesi u shpall fajtor, u lirua nga paraburgimi dhe u dënua me gjashtë muaj burg – që u pezullua.

13. Parashtruesi ushtroi ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut në Pejë dhe ajo gjykatë më pas ia ktheu rastin Gjykatës Komunale në Gjakovë, e cila më pas e rigjykoi këtë rast dhe, më 1 janar 2003, i hodhi poshtë akuzat penale, nxori një vendim për shpenzime dhe urdhëroi që mallrat t'i ktheheshin parashtruesit.

14. Më 24 mars 2003, nëpërmjet avokatëve të tij, parashtruesi ushtroi padi civile në Gjykatën Komunale në Gjakovë për shpenzime dhe për kompensim. Sipas dokumenteve të dorëzuara nga parashtruesi, gjykimi për padinë e parë ishte caktuar për 17 dhjetor 2010 dhe, më pas, ai u shty deri më 24 mars 2011, me ç'rast, gjyqtari i caktuar në këtë çështje kërkoi të përjashtohej nga ky rast, pasi ishte gjyqtar në rastin e parë penal.

Shkeljet e pretenduara të Kushtetutës

15. Parashtruesi pohon, në përgjithësi, që ka pasur shkelje të rëndë të të drejtave themelore të garantuara me nenet: 7 [Vlerat], 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], 53 [Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut] dhe 102 [Parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor] të Kushtetutës, si dhe me nenin 41 të KEDNj.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

16. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, të

specifikuara më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës.

17. Neni 113, paragrafët 1 dhe 7, i Kushtetutës përcakton kornizën e përgjithshme juridike që kërkohet për pranueshmëri. Ai përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *(...)*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

18. Edhe sikur parashtruesi t'i kishte shteruar të gjitha mjetet efektive juridike në dispozicion sipas ligjeve në fuqi, Gjykata thekson se, në mënyrë që një kërkesë të trajtohet në Gjykatën Kushtetuese, parashtruesi, para së gjithash, duhet t'i mbështesë me prova pretendimet e tij për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me KEDNj.

19. Përkitazi me këtë, neni 48 i Ligjit, thotë:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

20. Së fundi, rregulli 36 i Rregullores së punës, përcakton:

> *"1. Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
>
> *c) kërkesa është qartazi e bazuar.*
>
> *2. Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:*

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

c) Gjykata gjen se parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij"

21. Në procedurat që i kishte iniciuar në gjykatat vendëse, parashtruesi ishte i përfaqësuar nga një avokat. Megjithatë, parashtruesi fare nuk ka treguar apo ofruar prova për ta mbështetur pretendimin se vonesa rrjedh nga diskriminimi për shkak të shtetësisë së tij. Parashtruesi nuk ka bërë asnjë krahasim për të treguar se ai, si shtetas i Republikës së Shqipërisë, është trajtuar ndryshe nga personat e tjerë që paraqiten në gjykata të Republikës së Kosovës. Nga deklarata e tij e thatë nuk mund të konkludohet që ka pasur diskriminim të tillë.

22. Parashtruesi as nuk ka treguar e as nuk ka ofruar prova që ka ndërmarrë hapa për të kërkuar nga gjykatat e rregullta që ta përshpejtonin padinë e tij (përveç ankesës në Këshillin Gjyqësor të Kosovës). Padia e parë është në pritje e sipër për vendim në gjykata të rregulla. Pala, në asnjë mënyrë nuk tregon se, në padinë e parë, i kishte ngritur çështjet e lartcekura sa i përket shkeljeve të të drejtave të tij të garantuara me ligjet dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me KEDNj.

23. Prandaj, në pajtim me nenin 117.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenet 47.2, 46 dhe 48 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 36.2 (a, b, c dhe d) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe hedhet poshtë si e papranueshme, sepse nuk është *prima facie* e arsyetuar, apo e mbështetur me prova të mjaftueshme.

24. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 20 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 56.2 të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenet 47.2, 46 dhe 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe në pajtim me rregullin 36.2 (a, b,c dhe d) të Rregullores së punës, më 20 shtator 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Snezhana Botusharova Prof. Dr. Enver Hasani

KI 121/11 datë 21 nëntor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. 134/2010, të 17 majit 2011

Rasti KI 121/11, vendim i 18 tetorit 2012

Fjalët kyçe: Agjencia Kosovare e Pronës, Drejtoria për Çështje Pronësore- Banesore - HABITAT, kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, res judicata, liritë dhe të drejtat individuale, mbrojtja e pronës.

Parashtruesja paraqiti kërkesën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat e saj kushtetuese janë cenuar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilin e pranoi kërkesën për revizion me të cilin prishi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, duke theksuar se Gjykata Komunale në Prishtinë kishte zbatuar në mënyrë duhur të drejtën materiale duke u deklaruar jo-kompetente për shqyrtimin e vendimeve të Drejtorisë për Çështje Pronësore – Banesore – HABITAT. Parashtruesja pohoi se Gjykata Supreme ka cenuar të drejtën e e garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtrueses ishte e papranueshme bazuar në Rregullin 56.2 të Rregullores së Punës për shkak se parashtruesja nuk kishte dorëzuar ndonjë provë *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave kushtetuese. Gjykata vendimin e saj e arsyetoi duke përsëritur se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Duke cituar vendimin e GJEDNJ-së në rastin *Vanek kundër Republikës Sllovake,* Gjykata më tutje arsyetoi se pas shqyrtimit të procedurave në gjykatat e rregullta si tërësi, nuk vëren që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare, dhe se Gjykata Supreme kishte dhënë arsye të mjaftueshme se përse kishte prishur vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Për shkak të arsyeve të përmendura,

Gjykata vendosi të hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit si të papranueshme.

Prishtinë, më 18 tetor 2012

Nr.Ref.:RK315/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr.KI 121/11

Parashtruesi

Arjana Syla

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Gjykatës Supreme të Kosovës

Rev. 134/2010, të 17 majit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesja është Arjana Syla me vendbanim në fshatin Gllamnik, komuna e Podujevës, e cila përfaqësohet nga Avokati Sabri Kryeziu nga Lipjani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 134/2010, të 17 majit 2011, që i është dorëzuar parashtruesit më 24 qershor 2011.

Objekti i çështjes

3. Më 13 shtator 2011 parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) me pretendim se i është shkelur e drejta e tij e garantuar me Nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, Neni 20 i Ligjit dhe, Rregulli 56 (2) i Rregullores.

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi i kërkesës, përmes përfaqësuesit të saj, avokatit Sabri Kryeziu, dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 13 shtator 2011.

6. Më 7 shkurt 2012, Kryetari,me Vendimin nr. GJR. 121/11, e caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë Kryetari, me Vendimin nr. K.SH. 121/11, caktoi Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodriguez (kryesues), Enver Hasani dhe Gjyljeta Mushkolaj.

7. Më 30 janar 2012, Gjykata Kushtetuese njoftoi Gjykatën Supreme se parashtruesi ka parashtruar një kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr. 134/2010, të datës 17 maj 2011.

8. Më 20 qershor 2012, Gjykata Kushtetuese kërkoi dokumentacionin e kompletuar nga Agjencia Kosovare e Pronës, si trashëgimtare e një pjese të përgjegjësive të Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore – HABITAT, pasi që ky institucion ka trajtuar paraprakisht çështjen e ngritur në Gjykatë.

9. Më 25 qershor, Agjencia Kosovare e Pronës ka kthyer përgjigjen në kërkesën e Gjykatës duke i bashkangjitur vendimet e marra nga Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore – HABITAT.

10. Më 2 korrik 2012, Kryetari, me vendimin GJR. 121/11 riemëroi Kolegjin e ri Shqyrtues në përbërje te gjyqtarëve: Almiro Rodrigues (kryesues), Enver Hasani (gjyqtar) , dhe Ivan Čukalović , u caktua në vend të gjyqtares Gjyljeta Mushkolaj, se cilës i kishte përfunduar mandati me 26 qershor 2012.

11. Më 18 tetor 2012 Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi Raportin e Gjyqtarit Raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës

Përmbledhja e fakteve

12. Prona e kontestuar, banesa përdhesë me sipërfaqe 73.58 m², i është dhënë në shfrytëzim Xh. J. , atëbotë punëtor i Organizatës së Bashkuar të Punës "Televizioni Prishtina", përmes kontratës nr. 01-2218, të datës 10 prill 1979.

13. Më pas, më 8 tetor 1979, përmes kontratës nr. 1193/9287 Xh. J. kishte lidhur kontratë me BVI-në për banim dhe hapësirë afariste në Prishtinë, për shfrytëzim të përhershëm të banesës së bashku më bashkëshorten ë tij, e cila gjithashtu ishte punëtore e "Televizionit Prishtina", dhe pjesën tjetër të familjes.

14. Ne vitin 1994, pas dëbimit nga puna e Xh. J. dhe bashkëshortes së tij, ata dëbohen edhe nga banesa.

15. Më 15 shkurt 1994, Sekretariati për Urbanizëm dhe Punë Banesore i Kuvendit të Prishtinës, me aktvendimin nr. 360-389 i jep në shfrytëzim të përhershëm banesën e lartcekur N. V.

16. Më 14 maj 1997, N. V., e cila në atë kohë punonte në Gjykatën Komunale në Prishtine, lidh kontratën nr. 287/1 me Ndërmarrjen Publike Banesore në Prishtinë, për qiramarrje të banesës së lartcekur.

17. Më 26 mars 1999, N. V. lidh kontratën Vr.nr. 107/99 për shitblerjen e banesës se lartcekur, dhe që nga ajo kohë figuron si pronare e banesës.

18. Më 28 prill 2005, babai i Parashtrueses F.S. (tashmë i ndjerë) ka lidhur kontratë të shitblerjes me N. V. , duke paguar 50.000 € (pesëdhjetëmijë euro). Kjo kontratë është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë me shenjën Vr. nr. 4424/2005

19. Në ndërkohë, në Drejtorinë për Çështje Pronësore-Banesore – HABITAT, janë dorëzuar tri kërkesa për shqyrtim lidhur me banesën e kontestuar: Ajo e Xh. J. me nr. DS008127, N. V. me nr. DS 00419 dhe D. P. me nr. DS 603193.

20. Në përgjigjen e pranuar nga Agjencia Kosovare e Pronës mes tjerash thuhet:

Lidhur me pronën e përmendur, Drejtoria ka pranuar 3 kërkesa, si në vijim:

Me datën 1 janar 2000, ka pranuar kërkesën e kategorisë "C" DS000419, të parashtruar nga znj. N.V., ndërsa palë përgjegjëse në këtë rast ishte z. F.S. (person tjetër me iniciale F.S. , por qw nuk wshtw babai i Parashtruesit), *i cili nuk kishte shprehur interes ligjor mbi pronën por vetëm kishte nevojë për banim.*

Me datën 19 shtator 2002, Drejtoria ka pranuar kërkesën e kategorisë "C" DS603193, të parashtruar nga znj. D.P., ndërsa palë përgjegjëse në këtë rast ishte z. Rr. H., i cili

e përfaqësonte dhe kërkonte të drejtë ligjore mbi pronën, në emër të z. Xh. J.

Me datën 13 maj 2003, Drejtoria ka pranuar kërkesën e kategorisë "A" DS008127, të parashtruar nga z. Xh. J., të cilin e përfaqësonte z. Rr. H.

Fillimisht Komisioni ka shqyrtuar shkresat e kërkesës "C" DS000419, të parashtruar nga znj. N.V. dhe me vendimin HPCC/D/62/2002/C të datës 13 dhjetor 2002, vendosë që kërkesa DS000419 të refuzohet> Me vendimin e Komisionit janë njoftuar të dy palët në procedure dhe brenda afatit ligjor Drejtoria ka pranuar kërkesë për rishqyrtim të vendimit të Komisionit, të parashtruar nga N.V. Komisioni pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, me vendimin HPCC/REC/41/2004, të datës 9 dhjetor 2004 vendosi që kërkesa për rishqyrtim të refuzohet. Edhe me këtë vendim janë njoftuar të dy palët në procedure. Më pas znj. N.V. ka parashtruar kërkesë për mbylljen e kërkesës DS000419, me arsyen se pronën në fjalë e ka shitur.

Pastaj, Komisioni shqyrton shkresat e kërkesave DS008127 dhe DS6033193 dhe me vendimin HPCC/D/181/A&C, vendos që kërkesa e kategorisë "A" DS008127, e parashtruar nga Xh. J. të aprovohej dhe e drejta e posedimit të pronës ti kthehej z. Xh.J., ndërsa kërkesa e kategorisë "C" DS603193, e parashtruar nga znj. D.P., të refuzohej. Me vendimin e Komisionit janë njoftuar të dy palët dhe brenda afatit të paraparë ligjor z. F.S. (palë e interesuar) ka kërkuar rishqyrtim të vendimit të Komisionit sipas nenit 14.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, i cili parasheh se brenda një viti nga dita e nxjerrjes së vendimit të Komisionit, pala e interesuar ka të drejtë të parashtrojë kërkesë për rishqyrtimin e këtij vendimi. Z. F.S., së bashku me kërkesën për rishqyrtim, ka parashtruar edhe kontratën e shitblerjes për pronën e lartpërmendur, të lidhur ndërmjet

paraqitëses së kërkesës së kategorisë "C" DS00419, zn.j N.V., si shitëse dhe z. F.S. si blerës, (Kontrata Vr. nr. 4424/2005 e datës 22. 06. 2005, e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë).

Komisioni, pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, me vendimin HPCC/REC/76/2006, të datës 16 tetor 2006, vendosi që kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga z. F.S., të refuzohej dhe mbetet në fuqi vendimi i shkallës së parë HPCC/D/181/2005/A&C, i datës 30 prill 2005. Edhe me këtë vendim janë njoftuar të gjitha palët në procedurë.

21. Pas plotfuqishmërisë së vendimit të Komisionit, z. Xh. J. ka kërkuar kthimin e posedimit të pronës dhe zyrtarët e Drejtorisë për Çështje Pronësore-Banesore – HABITAT me datën 7 maj 2007, e kanë liruar pronën nga njerëzit dhe sendet, ndërsa me datë 8 maj 2007, çelësat e pronës i janë dorëzuar z. Xh. J. dhe pas kësaj Drejtoria për Çështje Pronësore-Banesore – HABITAT i ka mbyllur të tri kërkesat: DS000419, DS008127 dhe DS603193 me ç'rast përfundon juridiksioni i saj mbi këtë çështje.

Procedura para gjykatave të rregullta

22. Babai i Parashtrueses, F.S..më 29 tetor 2007 parashtroi kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, për lirimin dhe dorëzimin e banesës në posedim nga Xh J.

23. Më 28 maj 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë nxori Aktgjykimin C.nr. 1185/2007, me të cilin e refuzoi kërkesëpadinë si të pabazuar, duke theksuar *inter alia* se:

"*Gjykata nuk ka mundësi ligjore që këtë vendim të HABITAT-it, i cili është përfundimtar dhe si i tillë i detyrueshëm në pajtim me nenin 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23, ta ndryshojë. Në kësi raste nuk mund të ketë dualizëm, prandaj ky vendim nuk mund të jetë subjekt i*

rishqyrtimit nga asnjë organ tjetër as gjyqësor, as administrativ në Kosovë"

Duke theksuar më tej se:

"*Në rastin konkret, gjykata sikur edhe HABITAT-i përkrah parimin "i pari për nga koha – pari për nga e drejta" ngase i padituri me këtë banesë ka poseduar që nga viti 1979 në mënyrë të pandërprerë, e posedon edhe sot aktualisht në cilësinë e bartësit të së drejtës së banimit"*

24. Pasi që mori aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, babai i Parashtrueses ushtroi ankesë pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë brenda afatit ligjor.

25. Gjykata e Qarkut në Prishtinë më 4 mars 2010 nxori Aktgjykimin Ac.nr. 1412/2009 me të cilin vlerësoi se ankesa e paditësit është e bazuar dhe si e tillë është miratuar, ndërsa vlerësoi se Gjykata Komunale në Prishtinë ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale, dhe si të tillë e ndryshoi me arsyetimin se Parashtruesi mbi bazën e dispozitave të nenit 20.1 të Ligjit për Marrëdhëniet Pronësore-Juridike Bazë, e ka fituar të drejtën e pronësisë në banesës-podrum mbi bazën e kontratës për shitblerje.

26. Pasi që kishte pranuar kërkesën për revizion nga pala e pakënaqur, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Rev.nr.143/2010, të datës 17 maj 2012 pranoi kërkesën për revizion si te bazua dhe theksoi se:

"*Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejte dhe i bazuar në ligj, ngase vendimi i Këshillit të punëtorëve të OBPB "Televizioni i Prishtinës" i miratuar më datë 2. 10. 1973, mbi bazën e së cilës i padituri ka lidhur kontratën për shfrytëzimin e saj me BVI-në përkatëse, asnjëherë nuk është anuluar me asnjë akt eventual apo procedure eventuale, prandaj si i tillë mbetet me efekt të plotë juridik. Edhe HABITAT-i i ka pranuar të*

drejtën e shfrytëzimit të paditurit në banesën lëndore sipas kërkesës së tij."

Duke theksuar më tej se:

"*Në rastin konkret paditësi nuk ka provuar me prova të drejtën e pronësisë së patundshmërisë, dorëzimin e së cilës e kërkon, andaj aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është ndryshuar, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, ashtu që ka mbetur në fuqi aktgjykimi i gjykatës së shkallës së pare e cila në mënyrë të drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesa e paditësit është e pabazuar".*

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

27. Edhe pse parashtruesi ka shterur të gjitha mjetet juridike për të realizuar të drejtën e tij të supozuar për punë, të paraparë në nenin 113.7 të Kushtetutës, ajo nuk ka ofruar ndonjë provë apo fakt relevant për të mbështetur se "autoritetet administrative ose gjyqësore kanë bërë ndonjë shkelje të drejtave të saj të garantuara me Kushtetutë", (shih Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi i GJEDNJ për pranueshmërinë në rastin nr. 53363/99të datës 31 maj 2005).

28. Gjykata Kushtetuese përsërit që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis,* Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, § 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] e 1999-I).

29. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë, dhe nëse procedurat në përgjithësi të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkese të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa nr. 13071/87 e miratuar më 10 korrik 1991).

30. Megjithatë, pas shqyrtimit të dokumenteve të paraqitura nga parashtruesi Gjykata Kushtetuese nuk ka vëren që procedurat në Gjykatën Supreme ishin të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti (shih *mutatis mutandis* Kërkesa nr. 53363/99, Vanek kundër Republikës Sllovake, Vendimi i GJEDNJ të 31 majit 2005).

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 18 tetor 2012, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Prof. Dr. Enver Hasani

KO 63/12 datë 07 nëntor 2012- Kërkesa e Alma Lamës dhe e 10 deputetëve të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82

Rasti KO 63/12, vendim i 29 tetorit 2012

Fjalët kyçe: Kodi Penal i Republikës së Kosovës, kërkesë e deputetëve të kuvendit, liria e shprehjes, liria e medieve, prezumimi i kushtetutshmërisë së ligjeve, përgjegjësia e penale e medieve, mbrojtja e burimit të informatës

Parashtruesit paraqitën kërkesën bazuar në Nenin 113.5 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se nenet 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës janë në kundërshtim me Kushtetutën. Parashtruesit pohuan se nenet e kontestuara janë në kundërshtim në kundërshtim me dispozitat kushtetuese që garantojnë lirinë e medieve dhe lirinë e shprehjes, si dhe ne kundërshtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, respektivisht dispozitat që mbrojnë lirinë e shprehjes.

Neni 37 i Kodit Penal rregullon çështjen e përgjegjësisë penale të kryeredaktorëve, botuesve, shtypshkronjave apo prodhuesve të publikimit të informative me anë të të cilave është kryer vepra penale, neni 38 rregullon mbrojtjen e burimit të informatës dhe neni 39 rregullon zbatimin e dispozitave të përgjithshme për përgjegjësinë penale për veprat penale të kryera me anë të medieve. Parashtruesit pohojnë se formulimi i këtyre neneve është mjaft i gjerë pa specifikuar veprat penale që mund të kryhen përmes medieve, dhe si të tilla rrezikojnë seriozisht lirinë e gazetarëve gjatë kryerjes së profesionit të tyre që përbën një pjesë jetike të funksionimit të demokracisë në Kosovë.

Gjykata konstatoi se parashtruesit janë palë e autorizuar dhe kërkesa është parashtruar brenda afatit të paraparë kohor, ata i kanë

përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë dhe, si rrjedhojë, kërkesa e tyre është e pranueshme.

Lidhur me meritat e kërkesës, Gjykata theksoi se, megjithëse Kodi Penal është miratuar dhe publikuar në Gazetën Zyrtare duke përfshirë tre nenet e kontestuara, në ndërkohë është një nismë e re legjislative që trajton heqjen e këtyre neneve nga Kodi Penal. Duke theksuar se rezultati i këtij procesi legjislativ është i rëndësisë së veçantë për këtë rast, Gjykata konsideroi se është shume e parakohshme për të vendosur për meritat e kërkesës. Kësisoj, Gjykata vendosi për shpalljen e kërkesës të pranueshme, dhe vendosi ta shtyej vendimin për meritat deri më 15 dhjetor 2012.

Prishtinë, më 29 tetor 2012

Nr. ref.:VP318 /12

VENDIM PËR PRANUESHMËRI DHE SHTYRJE

në

Rastin KO 63/12

Kërkesa e Alma Lamës dhe e 10 deputetëve të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë deputetët e Kuvendit të Kosovës: Alma Lama, Visar Ymeri, Rexhep Selimi, Afrim Kasolli, Albulena Haxhiu, Albana Fetoshi, Albana Gashi, Glauk Konjufca, Albin Kurti, Florin Krasniqi dhe Afrim Hoti.

Objekti i çështjes

2. Kërkesa ka të bëjë me kushtetutshmërinë e neneve 37, 38 dhe 39 të **Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82** (në tekstin e mëtejmë: Kodi Penal), të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, më 20 prill 2012, dhe të shpallur me vendim të Kuvendit më 22 qershor 2012.

3. Më saktësisht, parashtruesit e kërkesës i shtrojnë këtë pyetje Gjykatës Kushtetuese: "*A cenojnë nenet 37, 38, 39 të Kodit Nr. 04-L-082 Penal të Republikës së Kosovës të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Nenet 40 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me Nenin 10 te Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj*".

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 20 dhe 43 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 29 qershor 2012, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

6. Më 4 korrik 2012, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues, si dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.

7. Më 11 korrik 2012, Sekretariati i Gjykatës ua komunikoi kërkesën palëve të interesuara, përfshirë Presidenten e

Republikës së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga; Kryetarin e Kuvendit të Republikës, z. Jakup Krasniqi; Kryeministrin e Qeverisë së Kosovës, z. Hashim Thaçi; dhe, Kryetarin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Ismet Kabashi.

8. Të gjitha palët e interesuara u ftuan të bënin komente përkitazi me kërkesën, nëse kishin ndonjë koment, dhe t'i dërgonin ato në afatin pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e marrjes së njoftimit. Deri më sot, Gjykata nuk ka marrë ndonjë koment nga palët e interesuara.

9. Më 28 shtator 2012, parashtruesit e kërkesës kërkuan nga Gjykata që t'i informonte për statusin e rastit.

10. Më 5 tetor 2012, Gjykata i informoi parashtruesit e kërkesës se "*rasti është në procedurë shqyrtimi dhe se, së shpejti, do të informoheni me rezultatin e kërkesës suaj*".

11. Më 18 tetor 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës rekomandimin për pranueshmërinë e kërkesës dhe për shtyrjen e vendimit për meritat e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Në bazë të procesverbalit nr. P-58 nga seanca plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 20 prillit 2012, Kuvendi i Kosovës, me 76 vota "për", 9 vota "kundër", dhe 1 "abstenim", e miratoi Kodin Penal të Kosovës në leximin e dytë.

13. Kodi i miratuar Penal i përmbante nenet e kontestuara 37, 38 dhe 39, që rregullojnë përgjegjësinë penale për veprat penale të kryera me anë të medieve.

14. Në këto dispozita thuhet:

"DISPOZITAT E POSAÇME MBI PËRGJEGJËSINË PENALE PËR VEPRAT PENALE TË KRYERA ME ANË TË MEDIAVE

Neni 37

Përgjegjësia penale e kryeredaktorëve, botuesve, shtyp shkronjësve ose prodhuesve

1. Autori i informacionit është penalisht përgjegjës nëse vepra penale është kryer perms publikimit të informatës në gazetë ose në lloj tjetër të shtypit periodik, radio, televizion, internet ose mjete tjera të komunikimit.

2. Kryeredaktori përgjegjës ose personi i cili e zëvendëson atë në kohën e publikimit të informatës është penalisht përgjegjës kur:

2.1. autori nuk mund të gjendet apo të gjykohet në gjykatën e Kosovës;

2.2. publikimi i informacionit është bërë pa dijeninë e autorit ose kundër vullnetit të tij; ose

2.3. nëse gjatë kohës së publikimit të informatës kanë ekzistuar pengesa faktike dhe juridike për fillimin e procedurës penale ndaj autorit dhe të cilat ende ekzistojnë.

3. Kryeredaktori ose personi i cili e zëvendëson atë në kohën e publikimit të informatës nuk është penalisht

përgjegjës nëse për shkaqe të arsyeshme nuk ka ditur për ndonjë rrethanë të paraparë në paragrafin 2. të këtij neni.

4. Botuesi i gazetës ose llojit tjetër të shtypit periodik është penalisht përgjegjës nëse kryeredaktori ose personi që e zëvendëson atë në kohën e publikimit të informatës në gazette ose llojin tjetër të shtypit periodik është penalisht përgjegjës sipas paragrafit 2. të këtij neni.

5. Kur botuesi është penalisht përgjegjës sipas paragrafit 4. të këtij neni dhe për shkak të pengesave juridike ose faktike nuk është e mundur të dënohet botuesi, atëherë personi i cili e ka shtypur informatën është penalisht përgjegjës nëse ai e ka ditur se pengesat e tilla ligjore ose faktike kanë ekzistuar.

6. Prodhuesi është penalisht përgjegjës kur kryeredaktori ose personi që e zëvendëson atë në kohën e publikimit të informatës me anë të shiritit manjetik, filmit, diapozitivave, fotografive ose pajisjeve tjera audio dhe video të dedikuara për mediat masive ose për prezantim publikut apo për një numër të madh të personave janë penalisht përgjegjës sipas paragrafit 2. të këtij neni.

7. Nëse botuesi, shtypshkronjësi ose prodhuesi i cili është penalisht përgjegjës sipas këtij neni është person juridik apo organ publik, personi përgjegjës për shtypjen ose aktivitetin prodhues është penalisht përgjegjës.

8. Personat e cekur në këtë nen nuk janë penalisht përgjegjës nëse publikimi i informatës është raport i saktë nga një mbledhje e organit publik ose nga deklarata e një personi zyrtar.

Neni 38

Mbrojtja e burimit të informatës

1. Personi i cili merr pjesë si profesionist në publikimin e informacionit ose si anëtar i bordit redaktues të mediave dhe ndihmësi i tij nuk janë penalisht përgjegjës nëse refuzojnë ta tregojnë autorin e publikimit ose burimin e informatës.

2. Personat e cekur në paragrafin 1. të këtij neni janë penalisht përgjegjës nëse gjykata konstaton se:

2.1. zbulimi i informatave është i domosdoshëm për të parandaluar sulmin që përbën kërcënim të pashmangshëm ndaj jetës apo integritetit trupor të ndonjë personi.

Neni 39

Zbatimi i dispozitave të përgjithshme për përgjegjësinë penale

Dispozitat për përgjegjësinë penale të personave të cekur në nenet 37 dhe 38 të këtij Kodi janë të zbatueshme vetëm nëse ata persona nuk janë penalisht përgjegjës sipas dispozitave të përgjithshme për përgjegjësinë penale të përcaktuar në këtë Kod."

15. Sipas ueb-faqes së Presidentit të Republikës, më 4 maj 2012, Presidentja e Republikës, znj. Atifete Jahjaga, mori vendim që t'ia kthejë Kuvendit të Kosovës Kodin e miratuar Penal. Në këtë

vendim thuhej: "*Bazuar në kompetencat e Presidentes së Republikës së Kosovës, sipas nenit 84 pika 6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendimi për rishqyrtimin e Kodit Penal u mor pasi u vlerësua se Neni 37 dhe Neni 38 i Kodit Penal janë në kundërshtim të plotë me Nenin 40 dhe Nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që rregullojnë lirinë e shprehjes dhe lirinë e medieve si dhe me Nenin 22, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës që obligon përmbushjen e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj*".

16. Mund të vërehet nga transkriptet e Kuvendit të Kosovës, të 22 qershorit 2012, se ishte diskutuar për shqyrtimin e "Vendimit të Presidentes së Republikës së Kosovës për ta kthyer Kodin Penal". Po ashtu, mund të vërehet se Komisioni funksional propozoi miratimin e amendamentit të propozuar në Kodin Penal në pajtim me Vendimin e Presidentes për ta kthyer Kodin e miratuar Penal.

17. Në të vërtetë, Komisioni funksional kërkoi "të hiqeshin nenet 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal" dhe, në bazë të transkriptit të 22 qershorit 2012, votimi në Kuvend ishte ky: "59 vota për, katër vota kundër dhe 5 abstenime".

18. Më tej, në transkriptin e 22 qershorit 2012, thuhej:"*Në bazë të Rregullores, del se nuk janë bërë 61 vota dhe se nuk është krijuar shumica që të kalojë kërkesa e Presidentes, e cila ka kaluar nëpërmjet komisioneve. Dhe, në bazë të kësaj, ky ligj konsiderohet i shpallur*".

19. Më 5 korrik 2012, Kuvendi mbajti leximin e parë të Projektligjit për Shfuqizimin e Neneve 37, 38 dhe 39 tw Kodit Penal. Pas debatit, Kuvendi i Kosovës e miratoi ndryshimin e Kodit Penal, duke hequr nenet e kontestuara 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Kosovës.

20. Rrjedhimisht, Kuvendi i caktoi detyrë Komisionit për Legjislacion, që t'ia përgatisë Kuvendit Projektligjin dhe raportin për lexim të dytë, në një periudhë kohore dymuajshe, do të thotë deri më 5 shtator 2012.

21. Në ndërkohë, më 19 tetor 2012 Kuvendi mbajti leximin e dytë për Projektligjin për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal dhe miratoi Projektligjin.

22. Kodi Penal i Kosovës duhet të hyjë në fuqi më 1 janar 2013, siç është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 20 prill 2012, dhe i shpallur me vendimin e Kuvendit të 22 qershorit 2012.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

23. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se, më 22 qershor 2012, Kuvendi i Republikës e ka miratuar Kodin Penal të Republikës së Kosovës, që përmban nenet 37, 38 dhe 39, të cilat janë në kundërshtim me nenin 40 dhe 42 të Kushtetutës së Kosovës, si dhe me nenin 10 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore (Konventa).

24. Në këto dispozita thuhet:

Neni 40 i Kushtetutës [Liria e Shprehjes]

1. Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush.

2. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.

Neni 42 i Kushtetutës [Liria e Medieve]

1. Garantohet liria dhe pluralizmi i medieve.

2. Censura është e ndaluar. Askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet medieve, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.

3. Çdokush ka të drejtë të korrigjojë informacionin e pavërtetë, jo të plotë ose të pasaktë të publikuar, nëse cenon të drejtat ose interesat e saj/tij, në pajtim me ligjin.

Neni 10 i Konventës [Liria e shprehjes]

1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë liçencimin e ndërmarrjeve të transmetimit audio, kinematografik ose televiziv.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

Argumentet e parashtruesve të kërkesës

25. Përkitazi me nenin 37 të Kodit Penal, parashtruesit e kërkesës paraqitën këto argumente:

> ***Së pari**, ky nen, i cili futet te dispozitat e përgjithshme në Kodin Penal, në tërësinë e tij nuk specifikon se çfarë veprash penale mund të kryhen nëpërmjet medies, duke lënë kështu një hapësirë aq të madhe interpretimi, sa gazetarët nuk do të ndjeheshin komodë në ushtrimin e profesionit të tyre, e as të mbrojtur pas publikimit të informacioneve. Ky nen mundëson ngritjen e akuzave ndaj gazetarëve, redaktorëve, kryeredaktorëve, botuesve dhe shtypshkronjave për vepra të ndryshme penale.*
>
> ***Së dyti**, neni 37 nuk e ka të përcaktuar çështjen e sanksionimit penal.*
>
> ***Së treti**, neni 147, pika 1, 2, 3 dhe 4 i Kodit Penal, e adreson çështjen e kufizimit të lirisë së shprehjes dhe të medieve, përkatësisht adreson ndëshkimin për konsumimin e veprës penale që ka të bëjë me nxitjen ose me përhapjen publikisht të urrejtjes, të përçarjes ose të mosdurimit ndërmjet grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike, apo grupeve të tjera të tilla që jetojnë në Republikës e Kosovës. Pra, neni 37 është dublim i panevojshëm brenda të njëjtit ligj.*
>
> ***Së katërti**, nenet 37, 38, dhe 39, parandalojnë publikimin e të gjitha informatave, përveç atyre që janë pozitive. Për këtë çështje, Gjykata Evropiane për të Drejta e Njeriut, e ka formuluar kështu qëndrimin e saj në vendimin "Hondyside vs Britanisë së Madhe": Liria e shprehjes është një nga shtyllat e shoqërisë demokratike, bazë për zhvillimin e saj dhe kusht për vetërealizimin e individit. Ajo nuk mund të*

përfshijë vetëm informacionet e perceptuara pozitivisht, ose të konsideruara si të padëmshme ose si indiferente, por edhe të tilla që fyejnë, turbullojnë, apo janë shqetësim për shtetin, apo për një grup të caktuar të shoqërisë. Të tilla janë kriteret e pluralizmit, të tolerancës dhe të hapjes, pa të cilat nuk mund të ekzistojë një shoqëri demokratike."

26. Përkitazi me nenin 38 të Kodit Penal, parashtruesit e kërkesës paraqitën këto argumente:

"Në pikën 2.1, të nenit 38, thuhet se zbulimi i informatave është i domosdoshëm për të parandaluar sulmin që përbën kërcënim të pashmangshëm ndaj jetës dhe ndaj integritetit trupor. Ky nen shkel nenin 40 dhe 42 të Kushtetutës së Kosovës, sepse nuk përcakton se ne çfarë momenti Gjykata mund ta detyrojë gazetarin të zbulojë informatën. Në fakt, ka vetëm një moment kur mund të ndodhë kjo, atëherë kur janë shteruar të gjitha mënyrat e tjera dhe ky është hap i domosdoshëm për të mbërritur tek ajo informatë dhe vetëm në raste shumë specifike.

Ruajtja e konfidencialitetit të burimit është esenciale për punën e gazetareve. Në rast se një instancë gjyqësore do t'i detyronte ata të tregonin burimin, sa herë që prokuroria apo policia nuk mbërrin vetë te kjo informatë apo burim, liria e medias do të cenohej rëndë dhe gazetarët nuk do të mund të kryenin misionin e tyre si observues të institucioneve demokratike, pasi vetë burimet nuk do t'iu besonin sepse ata do te ndiheshin të rrezikuar të zbuloheshin herët a vonë.

Pa një mbrojtje të tille, burimet do te përmbaheshin nga informimi i shtypit për çështje të cilat kanë interes të madh për publikun. Si rezultat roli vital mbikëqyrës që ka media do të nënvlerësohej dhe mundësia që shtypi të provojë informacione të sakta dhe te besueshme do te zvogëlohej.

Ky Kod Penal ne tërësi nuk garanton as mbrojtjen e materialeve me te cilat punojnë gazetarët, që shpesh janë objekt i konfiskimeve nga ana e policisë.

Ndërsa Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut çështjen e mbrojtjes së burimeve e ka trajtuar në rastin e "Godwin vs Britanise së Madhe," në vendim thuhet : Mbrojtja e burimeve nga te cilat gazetarët përfitojnë informacione është një instrument i rëndësishëm, i cili i jep mundësisë shtypit të luajë rolin e rëndësishëm të vëzhguesit të shoqërisë demokratike, nëse gazetaret do te detyroheshin te zbuloheshin burimet, do e kishin shumë të vështirë për të arritur tek faktet, dhe si rezultat të informonin shoqërinë për çështjet me rëndësi publike. E drejta e lirisë së shprehjes e mbrojtur nga nenin 10 dhe e drejta që rezulton prej tij, e transmetimit dhe e marrjes së informacionit kërkon që deklarimi i burimit të ndodhë vetëm në rrethana mjaft të veçanta, psh kur këtë e kërkon interesi publik ose interesi i individit.

Si i tillë neni 38, nuk ofron garanci të mjaftueshme për mbrojtjen e informatave të gazetarëve, të burimeve dhe të materialeve të gazetarisë".

27. Në fund, përkitazi me nenin 39, parashtruesit e kërkesës dhanë këtë arsyetim:

"Ky nen lidhet me nenin 37 dhe 38. Në rast se Gjykata do të konstatojë shkeljen e nenit 40 dhe 42 të Kushtetutës, bie automatikisht".

Pranueshmëria e kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

29. Neni 113.1 i Kushtetutës thotë: *"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".*

30. Përveç kësaj, neni 113.5 i Kushtetutës. parashikon që *Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur".*

31. Kërkesa është parashtruar në Gjykatë brenda afatit kohor tetë ditë nga dita e miratimit të ligjit në Kuvend.

32. Prandaj, kërkesa është e pranueshme, pasi parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar, e kanë parashtruar kërkesën brenda afatit të përcaktuar dhe kësisoj i kanë respektuar kriteret e pranueshmërisë.

Vlerësimi i meritave të kërkesës

33. Gjykata rikujton se, nenet e kontestuara 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal, u miratuan nga Kuvendi i Kosovës më 20 prill 2012 dhe u shpallën me vendim të Kuvendit më 22 qershor 2012.

34. Sidoqoftë, këto dispozita ishin objekt i një iniciative tjetër legjislative dhe i një debati në Kuvendin e Kosovës. Në të vërtetë, Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, i miratoi në lexim të parë projektamendamentet në Kodin Penal, Nr. 04/L-82, që parashikojnë heqjen e neneve 37, 38 dhe 39 nga Kodi i miratuar Penal.

35. Rregullorja e punës e Kuvendit të Kosovës e specifikon kështu miratimin e ligjeve:

"Neni 56

Shqyrtimi i parë i një projektligji

1. Shqyrtimi i parë i një projektligji nuk mund të bëhet pa kaluar dy javë pune dhe as më vonë se katër javë pune, nga dita e shpërndarjes së tij.

2. Para shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhje plenare, komisioni funksional - raportues, i ngarkuar nga Kryesia e Kuvendit, e shqyrton projektligjin në parim. Komisioni i paraqet Kuvendit raport me rekomandime për miratim ose për mosmiratim të projektligjit në parim.

3. Shqyrtimi i parë i projektligjit nënkupton diskutimin dhe votimin e tij në parim.

4. Shqyrtimi i parë fillon me paraqitje të përfaqësuesit të propozuesit të projektligjit, vazhdon me paraqitje të raportuesit të komisionit funksional, të përfaqësuesve të grupeve parlamentare dhe të deputetëve. Shqyrtimi mbyllet me votimin në parim.

5. Propozuesi mund ta tërheqë projektligjin gjatë shqyrtimit në Kuvend, deri para fillimit të votimit në shqyrtimin e dytë.

Neni 57

Shqyrtimi i projektligjit në komisione

1. Pas miratimit të projektligjit në shqyrtim të parë, Kuvendi i ngarkon për shqyrtim të mëtejshëm: Komisionin funksional, si komision raportues dhe komisionet: për Legjislacion dhe Gjyqësi, për Buxhet e Financa, për Integrime Evropiane, për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione dhe për të

Drejtat e Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, si komisione të përhershme.

2. Në rastin kur projektligji rregullon çështje nga fushëveprimi i dy komisioneve funksionale, Kuvendi e ngarkon njërin prej tyre, si komision raportues.

3. Amendamente në projektligj mund të parashtrojë deputeti, grupi parlamentar, komisioni parlamentar dhe Qeveria, në afat prej dy javësh pune nga miratimi në parim. Amendamentet i adresohen komisionit funksional - raportues.

4. Propozimi për amendamentin duhet të përmbajë: referimin ndaj dispozitës së projektligjit, formulimin e saktë të amendamentit dhe arsyetimin e ndryshimit të propozuar.

5. Propozimi i amendamenteve, që kanë implikime buxhetore, i dërgohet Komisionit për Buxhet dhe Financa, i cili duhet të deklarohet me raport, në afat prej pesë (5) ditëve pune, nga dita e pranimit

.

6. Komisioni funksional Kuvendit ia paraqet raportin me rekomandime për projektligjin brenda dy muajve, nga shqyrtimi i parë.

7. Në raste të veçanta, komisioni mund të kërkojë nga Kuvendi afat shtesë, deri në një muaj, për ta paraqitur raportin.

8. Komisionet e përhershme raportet e veta duhet t'ia paraqesin komisionit funksional, në afat prej dhjetë (10) ditë pune, nga dita e pranimit të amendamenteve nga komisioni funksional -raportues.

9. Komisioni funksional – raportues, pasi e përfundon shqyrtimin, Kuvendit i paraqet raport me rekomandime, së paku pesë (5) ditë pune para shqyrtimit të dytë në mbledhje plenare. Në raport përfshihet edhe mendimi i komisioneve të përhershme, si dhe deklarimi për amendamentet e propozuara nga deputeti, nga komisioni, nga grupi parlamentar apo nga Qeveria.

Neni 58

Shqyrtimi i dytë i projektligjit

1. Shqyrtimi i dytë i projektligjit fillon me paraqitjen e raportit të komisionit funksional nga raportuesi. Pas paraqitjes së raportit, të drejtën e diskutimit e kanë përfaqësuesit e komisioneve të përhershme, përfaqësuesit e grupeve parlamentare, përfaqësuesit e Qeverisë dhe deputetët.

2. Shqyrtimi i dytë i projektligjit vazhdon me shqyrtimin dhe me votimin e amendamenteve të propozuara nga komisioni funksional – raportues dhe të amendamenteve të propozuara nga komisionet e tjera, nga grupet parlamentare, nga Qeveria dhe nga deputetët.

3. Amendamentet shqyrtohen dhe votohen një nga një, sipas radhitjes së paraqitur, krahas tekstit të projektligjit.

4. Kur janë të propozuara dy amendamente për të njëjtin nen të projektligjit, që e përjashtojnë njëri-tjetrin, amendamenti i cili merr numrin më të madh të votave, konsiderohet i miratuar.

5. Pas shqyrtimit dhe miratimit të amendamenteve, të pasqyruara në tabelën krahasuese me tri kolona (teksti i projektligjit, i amendamenteve dhe teksti përfundimtar),votohet teksti i Projektligjit në tërësi me ndryshimet e miratuara.

Neni 59

Shqyrtimi i tretë i projektligjit

1. Kur projektligji në shqyrtimin e dytë nuk merr numrin e duhur të votave për miratim, me kërkesë të propozuesit të projektligjit ose të komisionit funksional, Kuvendi vendos që projektligjin ta paraqesë edhe në shqyrtimin e tretë, së bashku me amendamentet e miratuara.

2. Amendamentet që janë shqyrtuar dhe që janë refuzuar në shqyrtimin e dytë, ose që janë të ngjashme me amendamentet në shqyrtimin e dytë, nuk mund të propozohen për shqyrtimin e tretë.

3. Procedura e shqyrtimit të amendamenteve plotësuese dhe procedura e shqyrtimit të projektligjit të ndryshuar në leximin e tretë, duhet të jenë në pajtim me nenin 58 të kësaj Rregullore".

36. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se një proces legjislativ është në zhvillim e sipër në Kuvend për heqjen e neneve të kontestuara 37, 38 dhe 39 të Kodit të miratuar Penal.

37. Përmbyllja e këtij procesi legjislativ është relevante dhe ka ndikim në objektin e çështjes së ngritur nga parashtruesit në këtë kërkesë.

38. Në këtë fazë, edhe pse rishtazi është arritur progres, ende nuk është e mundur të parashikohet në mënyrë të arsyeshme se kur do të finalizohet përfundimisht ky proces.

39. Prandaj, duke marrë parasysh datën e lartpërmendur (1 janar 2013), Gjykata konsideron se është shumë e parakohshme të vlerësojë dhe të vendosë për meritat e kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës, në pajtim me nenet 20, 42 dhe 43 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata Kushtetuese, njëzëri:

VENDOSI

I. TË SHPALLË kërkesën të PRANUESHME;

II. TË SHTYJË vendimin për meritat e kërkesës deri më 15 dhjetor 2012 dhe të mbetet e përkushtuar ndaj këtij rasti;

III. TË KËRKOJË nga Kuvendi i Kosovës që ta informojë Gjykatën në afatin kohor pesëmbëdhjetë (15) ditë për statusin e procedurës legjislative përkitazi me heqjen e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82;

IV. T' UA KOMUNIKOJË këtë vendim palëve dhe ta botojë në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe,

V. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Prof. Dr. Enver Hasani

KI 60/12 datë 08 nëntor 2012 - Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 58/2007, të 15 marsit 2010

Rasti KI 60/12, Aktvendimi për papranueshmëri i 18 tetorit 2012

Fjalët kyçe: barazia para ligjit, zbulimi i identitetit, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, kërkesë individuale, jashtafatshëm, e drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër, shkelje e të drejtave dhe e lirive personale.

Parashtruesi i kërkesës, z. Muharrem Sulaj, parashtroi kërkesë në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 58/2007, e 15 marsit 2012, si i nxjerrë në shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 21 [Parimet e përgjithshme], me nenin 24 [Barazia para ligjit], me nenin 34 [E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër], me nenin 46 [Mbrojtja e pronës] dhe me nenin 54 [Mbrojtja gjyqësore e të drejtave], sepse parashtruesi i kërkesës ka një aktgjykim nga Gjykata Komunale në Gjilan, Aktgjykimi C. nr. 441/2003, i 29 shtatorit 2003, me të cilin miratohet kërkesa e parashtruesit të kërkesës për të drejtat pronësore dhe i cili mori formë të prerë më 8 tetor 2003. Pavarësisht nga ky aktgjykim i formës së prerë, Gjykata Supreme konkludoi se parashtruesi i kërkesës nuk është pronar i pronës. Përkitazi me çështjen e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata vendosi se kërkesa është e papranueshme, sepse Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 58/2007 i nxjerrë më 15 mars 2010, i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 19 prill 2010, ndërsa parashtruesi i kërkesës i parashtroi kërkesë Gjykatës më 18 qershor 2012, d.m.th., më shumë se 4 muaj nga dita kur parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar vendimi i Gjykatës Supreme. Prandaj, Gjykata vendosi se kërkesa ishte e jashtafatshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit.

Prishtinë, më 29 tetor 2012

Nr. ref.: RK317/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 60/12

Parashtruesi

Muharrem Sulaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 58/2007, të 15 marsit 2010

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare,

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga z. Muharrem Sulaj (në tekstin e mëtejmë: Parashtruesi), me vendbanim në Gjilan.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 58/2007, e 15 marsit 2010, të cilin e ka pranuar më 19 prill 2010.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e lartpërmendura i kanë shkelur të drejtat e tij, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), respektivisht me nenin 21 [Parimet e përgjithshme], me nenin 24 [Barazia para ligjit], me nenin 34 [E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër], me nenin 46 [Mbrojtja e pronës] dhe me nenin 54 [Mbrojtja gjyqësore e të drejtave].

4. Për më tepër, parashtruesi kërkon prej Gjykatës që të mos zbulohet identiteti i tij.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

6. Më 18 qershor 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 5 korrik 2012, Kryetari, me Vendimin nr. GJR. KI-60/12, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalovič gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, me Vendimin nr. KSH. KI-60/12, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.

8. Më 25 qershor 2012, Gjykata kërkoi nga Gjykata Komunale në Gjilan dosjen e lëndës, të cilën ajo ia ofroi Gjykatës më 17 gusht 2012.

9. Më 31 gusht 2012, kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme.

10. Më 18 tetor 2012, pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 29 shtator 2003, Gjykata Komunale në Gjilan (Aktgjykimi C. nr. 441/2003), miratoi padinë e të drejtës pronësore të parashtruesit të kërkesës. Gjykata Komunale konsideron se

"nga vlerësimi i provave te shtjelluara dhe fakteve te vërtetuara, Gjykata gjen se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ka asgjë kontestuese". Ky aktgjykim mori formë të prerë më 8 tetor 2003. Më 28 prill 2004, z. R. A. paraqiti ankesë në Gjykatën Komunale në Gjilan, duke kërkuar anulimin e aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale, të 29 shtatorit 2003, dhe të vërtetojë të drejtën e pronësisë. Për më tepër, ai kërkoi nga Gjykata Komunale lejimin e masave të përkohshme.

12. Më 29 prill 2004, Gjykata Komunale në Gjilan (Vendimi C. nr. 204/04), miratoi kërkesën e z. R. A. për masat e përkohshme.

13. Më 16 dhjetor 2004, Gjykata Komunale në Gjilan (Aktgjykimi C. nr. 204/04), miratoi ankesën e z. R. A. dhe vërtetoi se z. R. A. është pronar i pronës së kontestuar dhe jo parashtruesi i kërkesës. Më tej, Vendimi C. no. 204/04, i 29 prillit 2004, për masat e përkohshme mbetet në fuqi deri në zgjidhjen përfundimtare të këtij kontesti. Parashtruesi i kërkesës u ankua kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Gjilan.

14. Më 25 qershor 2005, Gjykata Komunale në Gjilan (Vendimi Ac. nr. 95/05), miratoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe prishi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan, të 16 dhjetorit 2004, dhe e ktheu atë në rigjykim. Gjykata e Qarkut në Gjilan
konsideron se aktgjykimit të Gjykatës Komunale, të 16 dhjetorit 2004, *"[...] i mungojnë arsyet mbi faktet vendimtare dhe se ato te cilat janë dhënë nuk janë të plota, nuk janë bindëse dhe nuk janë të mjaftueshme".*

15. Më 21 mars 2006, Gjykata Komunale në Gjilan (Aktgjykimi C. nr. 480/05), miratoi e padinë e z. R. A. dhe vërtetoi të drejtën e tij në pronë, që i ishte vërtetuar më parë parashtruesit të kërkesës me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan, të 29 shtatorit 2003 (Aktgjykimi C. nr. 441/2003). Gjykata Komunale, më tutje, konsideroi se Aktgjykimi C. nr. 204/04, i 29 prillit 2004, për caktimin e masës së përkohshme, mbetet në fuqi deri në zgjidhjen përfundimtare të këtij kontesti. Gjykata Komunale arsyetoi se:

"Pasi qe paditësi sipas kësaj çështje pretendon se ne ketë are e ka fituar te drejtën e pronësisë ne baze te blerjes e këtë e pretendon edhe i padituri Muharrem Sylaj, gjykata duke i vlerësuar provat veç e veç dhe si tersi përfundon se ne mesin e dy pretenduesve te barabartë te fitimit te pronësisë ne këtë are kontestuese, më i fort është paditësi sepse kërkesëpadinë e tij e provon me provat e shtjelluara nga te cilat shifet se ai këtë arë e bleu nga i padituri Shemsedin si pronar faktik por qe shumën e parave ia pagoi pasi e ka marr 16 pëlqimin prej trashëgimtarit të vetëm te pronarit juridik Servet Zeqirit dhe pasi e pagoi çmimin e shitblerjes është futur ne posedim, dhe te njëjtën e posedoi dhe e shfrytëzoi pa shqetësim deri në momentin kur i padituri Muharrem e njoftoi se arën e njëjtë e kishte bartur ne emër te tij, ndërsa i padituri Muharrem edhe pse disponon me aktgjykim te plotfuqishëm mbi fitimin e te drejtës te pronësisë ne këtë are ai këtë nuk e ka provuar ne asnjë mënyrë sepse dëshmia e tij është ne kundërshtim me dëshminë e te padiburit Veli Kamberit dhe Shemsedin Halimit e sidomos me dëshminë e të padiburit Servet Zeqirit i cili dëshmon se ne besueshmëri është vu në lajthim nga i padituri Muharrem dhe nga avokati i tij i cili ka nënshkruar deklaratë pa ditur përmbajtjen e saj e këtë duke menduar se i padituri Muharrem këtë arë e ka blerë prej paditësit me te cilin kishte biseduar ne Zvicër për bartjen e arës".

"Gjykata i ka vlerësuar edhe pohimet e përfaqësuesit te padiburit Muharrem Sylaj-avokatit Gazmend Sylaj të dhëna ne parashtresën e te padiburit dhe në përgjigjen ne padi se kjo çështje konsiderohet si çështje e gjykuar dhe një pohim të tillë e konsideron te pa justifikuar sepse për të qenë një çështje e gjykuar duhet të plotësohen tre kritere dhe atë identiteti i njëjte i palëve ne procedurë dhe roli i palëve, identiteti i kërkesave te palëve dhe identiteti i bazës faktike e që në këtë çështje nuk është ashtu sepse ne këtë çështje përveç te padiburve Muharrem, Veli dhe Servet të përfshirë në lëndën civile C. nr. 441/03, janë të përfshirë edhe paditësi Rifat Aliu dhe i padituri Shemsedin Halimi".

16. Më 28 tetor 2006, Gjykata e Qarkut në Gjilan (Aktgjykimi Ac. nr. 190/06), hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Gjilan, të 21 marsit 2006. Parashtruesi paraqiti revizion në Gjykatën Supreme kundër këtij aktgjykimi.

17. Më 15 mars 2010, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 58/2007), hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për revizion. Gjykata Supreme konsideron se *"Ne arsyetimin e aktgjykimit gjykata e shkallës së dytë ka shtuar se paditësi ne vitin 1994 ka fituar te drejtën e pronësisë në paluajtshmërinë kontestuese ne baze te shitblerjes nga i padituri Shemsedin Halimi, kur edhe menjëherë është futur ne posedim dhe shfrytëzim te lirë në këtë paluajtshmëri te cilën pa pengesa dhe shqetësime nga askush e ka shfrytëzuar lirshëm gjer ne vitin 2003 kur nga i padituri Muharrem Sylaj eshte njoftuar se i njëjti paluajtshmërinë kontestuese e ka bartur ne pronësi sipas një vendimi te plotfuqishëm gjyqësor. Gjykata e Qarkut ka vlerësuar se i padituri Muharrem Sylaj edhe pse disponon me aktgjykim te plotfuqishëm mbi fitimin e pronësisë ne paluajtshmërinë kontestuese, i njëjti nuk e ka fituar këtë te drejtë nga se nuk ka provuar pakontestueshëm se ne bazë të shitblerjes është bërë pronar i kësaj paluajtshmërie, në posedimin dhe shfrytëzimin e lirë të së çiles deri me tani fare nuk ka hyrë. Gjykata e Qarkut vlerëson se te gjitha provat e administruara përveç aktgjykimit të lartcekur dhe pjesërisht dëshmisë së të padituritVeli Kamberi, dhe dëshmisë së të padituritMuharrem Sylaj, vërtetojnë se paditësi ka fituar ligjshëm te drejtën e pronësisë në ketë paluajtshmëri kurse i padituri Muharrem Sylaj e Veli Kamberi, pa vend paditësit ia kontestojnë këtë të drejtë...*

Duke u nisur nga gjendja e tille e çështjes Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët, drejt kane zbatuar te drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Aktgjykimi i goditur dhe ai i shkalles së parë përmbajnë arsye te mjaftuara pre faktet relevante, te vlefshme për gjykimin e drejte te kësaj çështjeje juridike te cilat i pranon edhe kjo gjykate".

18. Për më tepër, asnjë dokumentacion mbështetës dhe asnjë informatë nuk është ofruar përkitazi me arsyet që identiteti i tij të mos zbulohet.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimi i Gjykatës Supreme është nxjerrë duke shkelur nenin 21 [Parimet e përgjithshme], nenin 24 [Barazia para ligjit], nenin 34 [E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër], nenin 46 [Mbrojtja e pronës] dhe nenin 54 [Mbrojtja gjyqësore e të drejtave] të Kushtetutës, sepse parashtruesi e ka një aktgjykim nga Gjykata Komunale në Gjilan, Aktgjykimi C. nr. 441/2003, i 29 shtatorit 2003, i cili miratoi padinë e parashtruesit të së drejtës pronësore dhe i cili mori formën e prerë më 8 tetor 2003. Pavarësisht nga ky aktgjykim i plotfuqishëm, Gjykata Supreme përfundoi se parashtruesi i kërkesës nuk është pronar i pronës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Gjykata vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë përkitazi me ankesën e parashtruesit të kërkesës, është e nevojshme që në fillim të vlerësohet se a i ka plotësuar ai kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se ajo mund të vendosë përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës, nëse parashtruesi dëshmon se ai/ajo e ka paraqitur kërkesën "brenda periudhës prej katër (4) muajsh [...] nga dita kur paditësit i është dorëzuar vendimi i gjykatës", në pajtim me nenin 49 të Ligjit.

22. Aktgjykimi i plotfuqishëm i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 58/2007, është nxjerrë më 15 mars 2010 dhe i është dorëzuar parashtruesit më 19 prill 2010, derisa parashtruesi e paraqiti

kërkesën në Gjykatë më 18 qershor 2012, respektivisht më tepër se 4 muaj nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi i Gjykatës Supreme.

23. Del se kërkesa është e papranueshme, për shkak se është e jashtafatshme sipas nenit 49 të Ligjit.

24. Sa i përket kërkesës së parashtruesit për moszbulimin e identitetit të tij, Gjykata e hedh poshtë si të pabazuar, sepse nuk është ofruar dokumentacion dhe informata shtesë përkitazi me arsyet që parashtruesit të mos i zbulohet identiteti.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 18 tetor 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TA HEDHË POSHTË kërkesën e tij për të mos zbuluar identitetin;

III. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Prof. Dr. Enver Hasani

KO 61/12 datë 21 nëntor 2012- Konfirmim i amendamenteve të propozuara kushtetuese, të paraqitura nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 22 qershor 2012, nëpërmjet shkresës Nr. 04-DO-1095

Lënda KO 61/12, vendimi i 20 shtatorit 2012.

Fjalët kyçe; Kryetari, Kuvendi, vlerësimi i kushtetutshmërisë, amendamentet kushtetuese, Qeveria e Republikës së Kosovës.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, me 22 qershor 2012 paraqiti një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me propozimin e Qeverisë për amendamentet kushtetuese, duke i kërkuar Gjykatës Kushtetuese që të bëjë vlerësimin nëse dy (2) amendamentet kushtetuese në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të cilat me 12 qershor 2012 janë miratuar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, pakësojnë të drejtat dhe liritë e garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata konstatoi se Kryetari i Kuvendit në bazë të nenit 113 paragrafi 9 është palë e dëmtuar e cila ka të drejt të paraqesë një kërkese në Gjykatës Kushtetuese.

Për të përcaktuar kushtetutshmërinë e amendamenteve të propozuara, Gjykata ka marrë parasysh jo vetëm të drejtat dhe liritë e njeriut të përfshira në Kapitullin II, por edhe gjithë shkronjën dhe frymën e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës në tërësi, si dhe praktikën e shumë vendeve evropiane.

Zyra e Avokatit të Popullit ka reaguar në lidhje me këtë çështje dhe qëndrimi i saj është që amendamentet e cekura nuk i pakësojnë të drejtat dhe liritë të njeriut të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës së Republike Kosovës.

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat në arsyetim, dhe në bazë të nenit 113.9 dhe nenit 144.3 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 56(1) të Rregullores së punës, në mbledhjen e mbajtur më 20 shtator 2012, Gjykata Kushtetuese vendos se kërkesa e paraqitur nga

Kryetari i Kuvendit më 22 qershor 2012 është e pranueshme për shqyrtim.

Amandameni i ri i propozuar 1.- Amnestia, paragrafi 1 i cili thotë

> *"Me amnisti, personat e cekur me emër do te lirohen pjesërisht ose plotësisht nga ndjekja penale, dënimet e tyre do te zëvendësohen me një dënim me te lehte, ose dënimi i këtyre personave do te hiqej nga evidencat e te dënuarve".*

Gjykata konstaton me shumicën e votave: që paragrafi 1 i amandamentit 1 në pjesën që lidhet me ***„personat të cilët janë të caktuar me emër"*** pakëson të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kapitullin II të Kushtetuës.

Sa i përket amandamantit të ri të propozuar 1- Amnestia paragrafët 2 dhe 3 të cilët theksojnë:

> "*Kuvendi i Republikës së Kosovës do të miratoje ligj përkatës për dhënien e Amnistisë. Ligji për Amnistinë do të miratohet me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputeteve të Kuvendit".*

Gjykata konstaton njëzëri se amendamenti i ri i propozuar 1- Amnistia, paragrafi i dytë dhe i tretë nuk pakësojnë të drejtat dhe liritë të njeriut të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Gjykata konstaton njëzëri që amandamneti i ri i propozuar 2- neni 108. (Këshilli Gjyqesor i Kosovës) nuk pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

** Mendimi konkurrues dhe mospajtues i gjyqtarit Robert Carolan*

Gjykatesi i Gjykatës Kushtetuese Robert Carolan, konkludon se të gjitha ndryshimet e propozuara të Kushtetutës janë në përputhje me Kapitullin II (neni 21 – 56) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe për këtë arsye ai konsideron se ato nuk do ti pakësojnë asnjë të drejtë dhe liri të mbrojtura nga këto nene të Kushtetutës.

Prishtinë, më 20 shtator 2012

Nr. ref.: AGJ/12

AKTGJYKIM

në

Rastin KO 61/12

Konfirmim i amendamenteve të propozuara kushtetuese, të paraqitura nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 22 qershor 2012, nëpërmjet shkresës Nr. 04-DO-1095

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 144.3 të Kushtetutës, i referoi Gjykatës Kushtetuese propozimin e Qeverisë për amendamentet kushtetuese.

Objekti i çështjes

2. Objekt i çështjes së kërkesës janë dy (2) amendamente kushtetuese të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të cilat ishin miratuar më 12 qershor 2012, me Vendimin Nr. 03/78 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

3. Kërkesa bazohet në nenin 113.9 dhe 144.3 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 54 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/ L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

4. Më 22 qershor 2012, Kryetari i Kuvendit të Kosovës i referoi Gjykatës Kushtetuese propozimin e Qeverisë për amendamentet kushtetuese, duke kërkuar vlerësim nëse amendamentet e

propozuara nga Qeveria do të pakësonin ndonjë nga të drejtat dhe liritë e parapara me Kapitullin II të Kushtetutës.

5. Më 26 qershor 2012, Kryetari caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar raportues dhe Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.

6. Më 9 korrik 2012, Kryetari i Kuvendit u informua se Gjykata kishte regjistruar kërkesën.

7. Po të njëjtën ditë, nga një kopje e kërkesës iu dërgua Presidentes së Republikës së Kosovës, Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Avokatit të Popullit.

8. Më 20 shtator 2012, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Altay Suroy, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përgjigjja e Avokatit të Popullit

9. Sa i përket **Amendamentit 1 – Amnistia,** Avokati i Popullit, në përgjigjen e tij, dha këtë mendim:

"Ky amendament nuk zvogëlon të drejtat dhe liritë e njeriut, të caktuara me Kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, por përkundrazi e pasuron punën e të drejtave dhe lirive të njeriut të personave të cilët në periudha të caktuara kohore rënë ndesh me ligjin penal të vendit.

Avokati i Popullit, bazuar në kompetencat e tij ligjore të caktuara me nenin 16 paragrafi 6 të Ligjit të Avokatit të

Popullit, në vazhdimësi inspekton vendet/burgjet ku mbahen personat me liri të kufizuar të lëvizjes.

Nga takimet me të ndaluarit/paraburgosurit, Avokati i Popullit ka punuar disa ankesa nga ta me kërkesën që amnistia, si një institut juridik, të përfshihet në ndryshimet kushtetuese dhe të nxirret ligj i veçantë për amnistinë.

Avokati i Popullit, e bazuar në mandatin e tij dhe përvojën e punës nga inspektimet e burgjeve, si dhe kontaktet dhe kërkesat e personave që gjinden në burgje, e mbështet këtë amendament që Qeverisë së Kosovës".

Përmbledhja e fakteve

10. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar tekstin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008. Në Kapitullin XIII [Dispozitat përfundimtare], neni 144 [Amendamentet], përcaktohet: "Qeveria, Presidenti ose një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, siç edhe parashihet me Rregulloren e Punës, mund të propozojë ndryshime dhe amendamentime të kësaj Kushtetute".

11. Më 12 qershor 2012, ministri i Drejtësisë, "në bazë të nenit 92, paragrafi 1, 2, dhe 4, neni 93, pika 9, dhe nenit 144, paragrafi 1, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës", i paraqiti Qeverisë dy "Propozime për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës".

12. Më 12 qershor 2012, Qeveria e Republikës së Kosovës, "në bazë të nenit 92, paragrafi 4, dhe nenit 93, paragrafi (4), i Kushtetutës së Republikës së Kosovës", miratoi Vendimin Nr.

03/78 për "miratimin e propozimit të Ministrisë së Drejtësisë për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës" (në tekstin e mëtejmë: Propozimet e Qeverisë për amendamentimin e Kushtetutës).

13. Më 22 qershor 2012, Kryetari i Kuvendit të Kosovës i dorëzoi Gjykatës "amendamentet e propozuara nga Qeveria e Kosovës në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (...) për të vlerësuar nëse ndryshimi i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

14. Gjykata shqyrton nëse janë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

15. Gjegjësisht, neni 113.9 i Kushtetutës, thotë:

"Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konstatohet nëse amendamenti i propozuar i zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës".

16. Kryetari i Kuvendit paraqiti kërkesë për vlerësim paraprak të amendamenteve të propozuara të Kushtetutës. Kështu që, në bazë të nenit 113.9 të Kushtetutës, Kryetari i Kuvendit është palë e autorizuar për ta referuar këtë rast në Gjykatë.

Shtrirja e konfirmimit kushtetues

17. Kryetari i Kuvendit i paraqiti dy (2) amendamentet e propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

18. Konfirmimi i kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara, nuk do të bëhet nga ana e kësaj Gjykate, duke marrë parasysh vetëm të drejtat dhe liritë e njeriut që përfshihen në Kapitullin II, por edhe gjithë shkronjën dhe frymën e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës, siç sqarohet më tepër në paragrafët 56 deri 71 të Aktgjykimit të nxjerrë në rastet KO29/12 dhe KO48/12 (amendamentet e propozuara të Kushtetutës nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe më 4 maj 2012), të datës 20 korrik 2012.

Kushtetutshmëria e amendamenteve të propozuara kushtetuese

I. Amendamenti 1 i propozuar: Amnistia

19. Amendamenti 1 propozon që t'i shtohet edhe një nen i ri Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili thotë:

> *"Me amnisti, personat e cekur me emër do të lirohen pjesërisht ose plotësisht nga ndjekja penale, dënimet e tyre do të zëvendësohen me një dënim më të lehtë, ose dënimi i këtyre personave do të hiqej nga evidencat e të dënuarve.*
> *Kuvendi i Republikës së Kosovës do të miratojë ligj përkatës për dhënien e Amnistisë.*
> *Ligji për Amnistinë do të miratohet me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit".*

20. Amendamenti i propozuar sugjeron futjen e një dispozite të re në Kushtetutën e tashme të Kosovës, duke ia shtuar një kompetencë të re kompetencave të Kuvendit, në mënyrë që të ketë autoritet për miratimin e një ligji për amnistinë.

21. Gjykata vëren se Kushtetuta nuk cek nocionin e "amnistisë" në asnjë nga nenet e saj. Sidoqoftë, neni 84 (29) përcakton se Presidenti i Republikës së Kosovës "shpall falje individuale në pajtim me ligjin".

22. Për më tepër, nga propozimi i paraqitur, nuk mund të konkludohet se ku do të përshtatej dispozita e re për amnistinë, pasi që kjo nuk është cekur në vetë amendamentin e propozuar.

23. Gjykata është e vetëdijshme se shumë kushtetuta evropiane i përcaktojnë që të dyja: edhe amnistinë, edhe faljet.

24. Në fakt, neni 16 i Kushtetutës së Shqipërisë, përcakton: "Kuvendi Popullor ka këto kompetenca kryesore: *6. Ai jep amnisti*". Për më tepër, neni 28 i Kushtetutës, përcakton: "Kompetencat kryesore të Presidentit të Republikës *janë si vijon: 14. Ai ushtron të drejtën e tij për falje".*

25. Neni 84 i Kushtetutës së Bullgarisë parasheh se një nga kompetencat e Kuvendit Popullor është dhënia e amnistisë. Sidoqoftë, neni 98 parasheh se një nga funksionet e Presidentit të Republikës është edhe e drejta për falje.

26. Ngjashëm, neni 80 i Kushtetutës së Kroacisë, parasheh kompetencën e Kuvendit të Kroacisë për dhënien e amnistisë për veprat penale. Përderisa, neni 97 i Kushtetutës kroate përcakton se Presidenti i Republikës do të japë falje.

27. Përkundër kushtetutave të lartpërmendura që nuk definojnë amnistinë, përveçse përshkruajnë se kjo bën pjesë në fushëveprimin e kompetencave ligjore të kuvendeve përkatëse, Kushtetuta e Greqisë i definon që të dyja: edhe amnistinë, edhe faljen, në nenin 47:

"Neni 47 [Falja dhe Amnistia]
(1) Presidenti i Republikës ka të drejtën, sipas propozimit të Ministrit të Drejtësisë dhe pasi të ketë konsultuar mendimin e këshillit i cili përbëhet nga shumica e gjyqtarëve, të falë, të zëvendësojë, ndryshojë, ose të zvogëlojë dëmet e shqiptuara nga gjykatat dhe të heqë pasojat e çfarëdo lloji të dala nga dënimet të cilat janë shqiptuar dhe mbajtur.

(2) Presidenti i Republikës ka të drejtën të falë një ministër të dënuar sipas nenit 86, por, vetëm me pëlqimin e Kuvendit.
(3) Amnistia mund të jepet vetëm në rastet e krimeve politike, me ligjin e votuar në Seancë Plenare të Kuvendit, me shumicën e tri të pestave të votave , të numrit të përgjithshëm të deputetëve.
(4) Amnistia në rastet e krimeve ordinere mund të mos jepet madje as edhe me ligj".

28. Për më tepër, neni 79 i Kushtetutës së Italisë, për amnistinë dhe faljen, thotë:

" *[Amnistia dhe falja]*
(1) Amnistitë dhe faljet mund të jepen me ligj i cili duhet miratuar nen pas neni dhe në tërësi nga dy të tretat e anëtarëve të secilës dhomë.
(2) Ligji për dhënien a amnistisë ose faljes duhet të përcaktojë afatet kohore për zbatimin e tij.
(3) Në asnjë rast, falja ose amnistia nuk mund të përfshijë vepra të kryera pas paraqitjes së projektligjit".

29. Neni 87 i Kushtetutës së Italisë më tej parasheh se një nga përgjegjësitë e Presidentit është " (*11) ... të japë falje dhe të zëvendësojë dënimet*".

30. Përfundimisht, neni 164 i Kushtetutës së Portugalisë, parasheh: *"Kuvendi i Republikës do të ketë kompetencat vijuese: g) të japë amnisti dhe falje të përgjithshme"*. Përderisa neni 137 i Kushtetutës së Portugalisë parasheh: "Presidenti i Republikës ka kompetencat në vijim*: ...f) Të japë falje dhe të zëvendësojë dënimet, pasi të ketë dëgjuar Qeverinë".*

31. Shembujt e lartpërmendur tregojnë se ekzistojnë dallime të qarta ndërmjet kompetencave të dhënies së amnistisë dhe të faljeve të ushtruara zakonisht me akt të përgjithshëm të

Kuvendit, d.m.th. me ligjet dhe me kompetencat për dhënien e faljeve individuale që ushtrohen nga krerët e shteteve.

32. Në të vërtetë, shumica e shteteve, në legjislacionin e tyre definojnë konceptet dhe aplikueshmërinë e amnistisë dhe të faljeve. Për shembull, Ligji i Përgjithshëm për Amnistinë në Kroaci (1996), *"jep amnisti të përgjithshme nga procedurat e ndjekjes penale për kryesit e veprave penale të kryera gjatë agresionit, rebelimit të armatosur ose konflikteve të armatosura dhe përkitazi [me atë] në Republikën e Kroacisë"*.

33. Sidoqoftë, Ligji parasheh se *"nga amnistia për veprat penale të cekura në ... përjashtohet ky ligj", kryesit e krimeve (sipas neneve 120–122 të Kodit Penal), gjenocidit (sipas nenit 119 të Kodit Penal) dhe çfarëdo akti tjetër i cili sipas Kodit Penal përbën shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës"."Me amnisti, personat e cekur me emër do të lirohen pjesërisht ose plotësisht nga ndjekja penale, dënimet e tyre do të zëvendësohen me një dënim më të lehtë, ose dënimi i këtyre personave do të hiqej nga evidencat e të dënuarve.*

35. Gjykata më tej vëren se, në përputhje me paragrafët 2 dhe 3 të Amendamentit 1, "*Kuvendi i Republikës së Kosovës do të miratojë ligj përkatës për dhënien e Amnistisë" dhe "Ligji për Amnistinë do të miratohet me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit"*.

36. Rrjedhimisht, duket se Amendamenti 1 ka për qëllim që të parashihet me ligj se cilët nga "*personat e cekur me emër"* kanë të drejtë të lirimit nga ndjekja penale; dënimet e tyre [individuale] do të zëvendësohen me një dënim më të lehtë; dhe dënimi i këtyre personave do të hiqej nga evidencat e të dënuarve.

37. Në mënyrë që të konfirmojë nëse amendamenti i propozuar pakëson të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës, Gjykata duhet të vlerësojë definicionin e propozuar më lartë për amnistinë.

38. Ndërkohë, Gjykata ka parasysh se, në bazë të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit], **"**Kuvendi i Republikës së Kosovës: (1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme".

39. Posaçërisht, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse Ligji për amnistinë mund të përcaktojë një listë të "*personave të cekur me emër",* që do të ishte objekt i Ligjit, i cili duhet të jetë i përgjithshëm dhe abstrakt nga natyra, për qëllimet e përmendura.

40. Përkitazi me këtë, Gjykata rikujton se Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në rastin Sunday Times kundër MB, të 29 marsit 1979, dy kërkesat rrjedhin nga shprehja "e përcaktuar me ligj".

41. "*Së pari, ligji duhet të jetë i disponueshëm në mënyrë adekuate: qytetari duhet të jetë në gjendje të ketë një tregues që është adekuat në rrethanat e rregullave ligjore të zbatueshme për një çështje të caktuar. Së dyti, një normë nuk mund të konsiderohet si "ligj" nëse ajo është formuluar me saktësi të mjaftueshme për t'ia mundësuar qytetarit që të rregullojë sjelljen e tij: ai duhet të jetë në gjendje – nëse është nevojshme me këshillën e duhur – të parashikojë deri në atë shkallë që është e arsyeshme, rrethanat dhe pasojat që mund të sjell një veprim i caktuar. Këto pasoja nuk duhet të jenë të parashikuara me siguri absolute: përvoja tregon se kjo është e paarritshme. Sërish, përderisa siguria është shumë e dëshirueshme, ajo mund të sjell një ngurtësi të tepruar dhe ligji duhet të jetë në gjendje të mbajë hapin me rrethanat e ndryshuara. Rrjedhimisht, shumë ligje pashmangshëm janë shkruar në kuptimin që, në një masë më të madhe ose më të vogël, janë të paqarta dhe interpretimi e zbatimi i tyre është çështje e praktikës".*

42. Gjykata konsideron se, nëse një listë e "*personave të cekur me emër"* është përcaktuar me ligj, një ligj i tillë nuk do të përmbushte standardin e lartpërmendur të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në të vërtetë, një ligj i tillë nuk do të ishte i parashikueshëm deri në një shkallë të arsyeshme, në rrethanat dhe në pasojat që do të mund të sillte një veprim i tillë.

43. Për më tepër, një listë e "*personave të cekur me emër",* që do të ishin objekt i amnistisë, do të mundësonte ngritjen e një çështje sipas nenit 24 [Barazia para ligjit] të Kushtetutës dhe nenit 14 [Ndalimi i diskriminimit] të Konventës Evropiane, pasi do të kishte dallime në trajtimin e tyre dhe të personave të tjerë në situata analoge apo të ngjashme, e që nuk janë në listë (shih, p.sh., *D. H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* [GC], nr. 57325/00, § 175, KEDNJ 2007).

44. Dallimet e tilla në trajtim do të ishin diskriminuese, pasi kjo nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Me fjalë të tjera, nëse nuk kanë një qëllim legjitim, ose nëse nuk ka raport të arsyeshëm të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve dhe qëllimit që duhet realizuar (shih, p.sh., *Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], nr. 13378/05, KEDNJ 2008).

45. Përkitazi me këtë, Gjykata rikujton nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, i cili thotë: *"1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal".*

46. Gjykata konsideron se një listë e "*personat e cekur me emër"* është në përputhshmëri me nenin 84 (29), ku Presidenti i Republikës së Kosovës "shpall falje individuale në pajtim me ligjin"; por nuk është në përputhshmëri me miratimin e ligjit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, i cili përkufizohet si akt i përgjithshëm.

47. Prandaj, Gjykata konfirmon se paragrafi 1 i Amendamentit 1 – Amnistia, pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut të parapara me Kapitullin II të Kushtetutës.

48. Sidoqoftë, Gjykata më tej konfirmon se paragrafët 2 dhe 3 të Amendamentit 1, që thonë se "*Kuvendi i Republikës së Kosovës*

do të miratojë ligj përkatës për dhënien e amnistisë" dhe "Ligji për Amnistinë do të miratohet me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit" nuk pakësojnë të drejtat dhe liritë e parapara me Kapitullin II të Kushtetutës.

II. Amendamenti 2 i propozuar: Amendamentimi i nenit 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës]

49. Amendamenti 2 i propozuar thotë: *"Neni 108, paragrafi 6, nënparagrafët 1 dhe 2, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ndryshohet si në vijim: (1) Shtatë (7) anëtarë do të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga anëtarët e gjyqësorit. (2) Dy (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar".*

50. Kështu, *Amendamenti 2 propozon largimin e nenit 108.6 (1) dhe 108.6 (2) dhe zëvendësimin e tij me nenin 108.6 (1) dhe 108.6 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.*

51. Teksti i nenit të tanishëm 108.6 (1) dhe 108.6 (2) është si në vijim:

"(1) Pesë (5) anëtarë do të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga anëtarët e gjyqësorit; (2) Katër (4) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve. Të paktën dy (2) nga katër (4) anëtarët duhet të jenë gjyqtarë, dhe një (1) do të jetë anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës".

52. Sipas amendamentit të propozuar, neni 108.6 (1) dhe 108.6 (2) do të formulohej si më poshtë:

"(1) shtatë (7) anëtarë do të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga anëtarët e gjyqësorit; (2) dy (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve dhe së paku një (1) nga dy do të jetë gjyqtar".

53. Gjykata rikujton se neni 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës], nën (1) dhe (2), thotë se "*Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor*" dhe është "*institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij"*. Përveç kësaj, Këshilli Gjyqësor i Kosovës *"siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale e të paanshme"*.

54. Gjykata konsideron se, ndryshimet e propozuara për përbërjen e Këshillit Gjyqësor, nuk ndikojnë në karakterin e një institucioni të pavarur dhe kështu nuk duket i nevojshëm vlerësimi i mëtejmë i kushtetutshmërisë së amendamentit të propozuar.

55. Prandaj, Gjykata konfirmon se Amendamenti 2 i propozuar - Amendamentimi i nenit 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] nuk pakëson të drejtat dhe liritë e përcaktuara me Kapitullin II të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113.9 dhe nenit 144.3 Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 56.1 të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 20 shtator 2012,

VENDOSI SI VIJON

- Njëzëri

I. Kërkesa e parashtruar nga Kryetari i Kuvendit, më 22 qershor 2012, me amendamentet e propozuara të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është e pranueshme;

- Me shumicë

II. Amendamenti 1 i propozuar– Amnistia, paragrafi i parë, përkitazi me ***"personat e cekur me emër",*** pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut, të parapara me Kapitullin II të Kushtetutës;

- Njëzëri

III. Amendamenti 1 i propozuar – Amnistia, paragrafët e dytë dhe të tretë, nuk pakësojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, të parapara me Kapitullin II të Kushtetutës;

IV. Amendamenti 2 i propozuar – Neni 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] nuk pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut, të parapara me Kapitullin II të Kushtetutës.

V. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe,

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Altay Suroy Prof. Dr. Enver Hasani

KI 03/12 datë 29 nëntor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PKL. Nr. 88/2011, të 21 shtatorit 2011

Rasti KI 03/12, vendim i 31 tetorit 2012

Fjalët kyçe: kodi i procedurës penale të Kosovës, kërkesë individuale, kërkesë qartazi e pabazuar, përbërja e trupit gjykues.

Parashtruesi paraqiti kërkesën bazuar në Nein 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat e tij kushtetuese janë cenuar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl.nr.88/2011, të 21 shtatorit 2011. Parashtruesi pohoi se gjykimi dhe dënimi i tij, në Gjykatën Komunale në Prishtinë, për vjedhje të rëndë, shkel të drejtat e tij kushtetuese sepse për rastin e tij trupi gjykues ishte formuar gabimisht.

Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit ishte e papranueshme bazuar në nenet 48 dhe 56 të Ligjit dhe rregullit 36.2 (a dhe d) të Rregullores së punës, sepse kërkesa nuk ishte arsyetuar *prima facie* , dhe mbështetur sa duhet. Gjykata më tutje arsyetoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte ofruar dëshmi, se kur ai apo përfaqësuesi i tij, kishin kundërshtuar për here të parë përbërjen e trupit gjykues. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit si qartazi të pabazuar.

Prishtinë, më 31 tetor 2012

Nr. ref.:RK319/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 03/12

Parashtrues

Kastriot Gerbeshi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,

PKL. Nr. 88/2011, të 21 shtatorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Kastriot Gerbeshi nga Prishtina, Kosovë.

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesi i kërkesës pohon se, gjykimi dhe dënimi i tij në Gjykatën Komunale në Prishtinë, për vjedhje të rëndë, shkel të drejtat e tij mbi bazën se trupi gjykues, për rastin e tij, ishte formuar gabimisht, se për ankesën e tij ishte marrë vendim i gabuar dhe se kërkesa e fundit për mbrojtje të ligjshmërisë, e cila ishte refuzuar nga Gjykata Supreme, përbën shkelje të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (neni 452, paragrafi 3).

Baza juridike

3. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

4. Më 20 janar 2012, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

5. Më 7 shkurt 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues. Po të njëjtën ditën,

Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami.

6. Më 17 prill 2012, Gjykata i shkroi parashtruesit të kërkesës dhe kërkoi sqarim përkitazi me datën e parashtrimit të ankesës për dënimin e tij dhe nëse ai, apo përfaqësuesi i tij ligjor, kontestonin përbërjen e trupit gjykues para dënimit të tij në Gjykatën Komunale.

7. Më 22 maj 2012, Gjykata përsëri i shkroi parashtruesit të kërkesës, duke e këshilluar atë për numrin e referencës së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

8. Më 19 shtator 2012, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH.03/12, caktoi Kolegjin e ri shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Enver Hasani, pas përfundimit të mandatit të gjyqtareve Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami si gjyqtare të Gjykatës.

9. Më 17 tetor 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Faktet e rastit, siç pretendohet në dokumentet e ofruara nga parashtruesi i kërkesës

10. Parashtruesi i kërkesës ishte dënuar nga një kolegj për të mitur në Gjykatën Komunale në Prishtinë, për veprën vjedhje e rëndë, P. nr. 660/2008, të 30 majit 2008. Në kohën e kryerjes së veprës, për të cilën ai u dënua në fund, parashtruesi i kërkesës ishte i mitur, meqenëse kishte lindur më 12 shkurt 1990. Megjithatë, në kohën e gjykimit ai ishte i moshës madhore. Ai ishte gjykuar me të bashkëpandehurit e tjerë, që të gjithë të mitur sipas Kodit të drejtësisë për të mitur. Ai u dënua me një vit e gjashtë muaj burgim. Koha e kaluar në paraburgim do t'i llogaritej.

11. Ankesa kryesore e parashtruesit të kërkesës ishte se trupi gjykues në Gjykatën Komunale nuk përbëhej nga gjyqtarë të

gjinive të ndryshme, siç e kërkohet me ligj, dhe se aktgjykimi nuk ishte i mbështetur me dëshmi, apo i arsyetuar mirë.

12. Ai u ankua kundër dënimit të Gjykatën së Qarkut në Prishtinë, Ap. Nr. 416/2008, të 9 prillit 2011, i cili gjeti se koha për ankesë kishte kaluar. Nga dosja e lëndës, Gjykata e Qarkut konstatoi se ankesa është dashur të paraqitej më 26 qershor 2008, ndërsa është parashtruar më 27 qershor 2008. Gjykata e Qarkut gjithashtu deklaroi se, edhe në qoftë se do të parashtrohej me kohë, ankesa nuk do të ishte e lejueshme për shkak se nuk arsyetonte bazën mbi të cilën mund të kontestohej aktgjykimi.

13. Kundër kësaj, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, e cila ishte refuzuar nga Gjykata Supreme e Kosovës. Pkl. nr. 88/2011, e 21 shtatorit 2011, e cila i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 4 tetor 2011. Gjykata Supreme refuzoi si të pabazë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë.

Shkeljet e pretenduara të Kushtetutës

14. Parashtruesi i kërkesës, përveç shkeljeve të pretenduara të Kodit të Procedurës Penale, pretendon se janë shkelur edhe neni 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore – E drejta për gjykim të drejtë – dhe Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (pa saktësuar ndonjë nen të veçantë).

Ligji

15. Neni 49 i Kodit për të mitur të Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më 20 prill 2004, përkitazi me përbërjen e trupave gjykues për rastet ku të pandehurit janë të mitur, parasheh si vijon:

Kapitulli XI

Përbërja e trupave gjykues për të mitur

Neni49

(1) Trupi gjykues për të mitur në gjykatën e shkallës së parë dhe trupi gjykues për të mitur në gjykatën e shkallës së dytë, me përjashtim të kolegjeve në Gjykatën Supreme të Kosovës, përbëhet nga një gjyqtar për të mitur dhe dy gjyqtarë laikë. Gjyqtari për të mitur është kryetari i trupit gjykues.

(2) Kolegji për të mitur në Gjykatën Supreme të Kosovës përbëhet nga tre gjyqtarë

duke përfshirë së paku një gjyqtar për të mitur. Kur trupi gjykues për të mitur gjykon në shqyrtimin gjyqësor, do të përbëhet nga dy gjyqtarë për të mitur dhe tre gjyqtarë laikë.

(3) Gjyqtarët laikë në trupin gjykues për të mitur zgjedhen nga mesi i profesorëve,

arsimtarëve, edukatorëve, punëtorëve socialë, psikologëve dhe personave të tjerë që kanë përvojë në edukimin e të miturve.

(4) Gjyqtarët laikë që marrin pjesë në trupin gjykues për të mitur janë të gjinive të

ndryshme.

16. Për më tepër, edhe pse parashtruesi i kërkesës ishte në moshën madhore në kohën e gjykimit dhe të dënimit, më 22 maj 2008, neni 3 i Kodit për të mitur parasheh:

Neni 3

(1) Dispozitat e këtij Ligji zbatohen ndaj cilitdo personi të akuzuar për vepër penale

të kryer si i mitur, pavarësisht nga mosha e tij në kohën e fillimit të procedurës.

(2) Kur ky Ligj e parasheh, dispozitat e këtij Ligji zbatohen ndaj cilitdo personi të

akuzuar për vepër penale të kryer si madhor i ri.

(3) Kur madhori akuzohet për vepër penale të kryer si i mitur, nenet 41 dhe 45 të këtij

Ligji nuk zbatohen.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

17. Për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren punës.

18. Neni 113, paragrafi 1 dhe paragrafi 7, i Kushtetutës krijon kornizën e përgjithshme ligjore për pranueshmëri. Ai parasheh:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

19. Për më tepër, neni 48 i Ligjit, thotë:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

20. Përfundimisht, rregulli 36 i Rregullores së punës, parasheh:

"1. Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
c) kërkesa është qartazi e bazuar.

2. Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:

a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

c) Gjykata gjen se parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të së drejtave të

garantuara me Kushtetutë, ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

21. Ankesa e parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Komunale u gjykua nga Gjykata e Qarkut si e paafatshme. Gjykata Kushtetuese kërkoi nga parashtruesi i kërkesës të ofrojë dëshmi se kërkesa ishte parashtruar me kohë dhe i mundësoi parashtruesit të kërkesës të cekë se si kishte gabuar Gjykata Komunale në konstatimet e veta. Parashtruesi i kërkesës nuk dha kurrfarë përgjigje.

22. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka dështuar t'i përgjigjet konkludimit të gjykatës vendëse, ngase ai

nuk arriti të parashtrojë ankesë në kohën e duhur. Prandaj, kjo nënkupton se ai ka hequr dorë nga e drejta e tij për ankesë. Kështu, ai ka dështuar të shterojë të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjeve të zbatueshme në Kosovë.

23. Veç kësaj, nga parashtruesi i kërkesës ishin kërkuar informata se kur ai, apo përfaqësuesi i tij ligjor, së pari kishin kundërshtuar përbërjen e kolegjit të Gjykatës Komunale, që e shqyrtoi rastin e tij. As për këtë çështje nuk pati përgjigje.

24. Andaj, duket se ka mungesë të dëshmive mbi të cilat Gjykata Kushtetuese mund të konstatoj ndonjë shkelje të të drejtave kushtetuese të parashtruesit të kërkesës. Në bazë të kësaj, duket se parashtruesi i kërkesës ka dështuar të mbështesë kërkesën e tij në këtë Gjykatë.

25. Prandaj, Gjykata konkludon se, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, në bazë të nenit 48 dhe të nenit 56 të Ligjit, dhe në bazë të rregullit 36.2 (a dhe d) të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme si qartazi e pabazuar, sepse nuk është arsyetuar *prima facie,* apo mbështetur sa duhet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, pas këshillimit më 17 tetor 2012, në përputhshmëri me Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 20 të Ligjit dhe Rregullin 56.2 të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

IV. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

V. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Robert Carolan	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 53/12 datë 21 nëntor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, të 23 shkurtit 2011, me të cilin parashtruesit i mohohet pensioni i invalidit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)

Rasti KI 53/2012, vendimi i datës 19 shtator 2012
Fjalët kyçe:Kontest penal, kërkesa individuale, kërkesa e paafatshme.

Parashtruesi e kishte dorëzuar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke pretenduar se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duke mos ia njohur statusin e invalidit të UÇK-së ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese.
Në këtë rast, Gjykata ka konstatuar se nuk ka prova që provojnë se parashtruesi ka bërë përpjekje për të ushtruar ankesë kundër vendimit të kontestuar, prandaj Gjykata konsideroi se parashtruesi nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Gjykata, siç kishte theksuar edhe në rastin KI 41/11 Universiteti AAB-RIINVEST kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës edhe në këtë rast ka ritheksuar se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike, siç interpretohet nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut sipas nenit 53 të Kushtetutës është që t'ua lejojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose për ta korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efikase juridike përkitazi me shkeljen e të drejtave kushtetuese, më ç'rast ka përmendur rastin e GJEDNj *Selmouni kundër Francës,* Nr. 25803/94, vendimi i 28 korrikut 1999Kërkesa ehte refuzuar si e papranueshme për faktin se parashtruesi nuk i kishte shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion, në përputhje me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47.2 të Ligjit dhe të rregullit 36.1 b) të Rregullores së punës.

Prishtinë, më 01 nëntor 2012
Nr. ref.: RK320/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 53/12

Parashtrues

Aziz Amrushi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, të 23 shkurtit 2011, me të cilin parashtruesit i mohohet pensioni i invalidit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtrues i kërkesës është Aziz Amrushi nga Pjetershtica, komuna e Shtimes. Parashtruesi është i papërfaqësuar.

Objekti i çështjes

2. Objekti i çështjes së kësaj kërkese është pretendimi i parashtruesit se vendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, i 23 shkurtit 2011, përkitazi me kërkesën e tij për të drejtën në pension invalidor të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte nxjerrë në mënyrë të gabuar.

Vendimi i kontestuar

3. Vendimi që kontestohet është vendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, i 23 shkurtit 2011, me të cilin parashtruesit i mohohet pensioni invalidor i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 28 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 21 maj 2012.

6. Më 4 korrik 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović (anëtarë).

7. Më 3 gusht 2012, Gjykata njoftoi parashtruesin për pranimin e kërkesës.

8. Më 22 gusht 2012, kërkesa iu komunikua Ministrisë së Punës dhe Mirëqenie Sociale.

9. Më 19 shtator 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve të rastit, siç janë paraqitur nga parashtruesi

10. Parashtruesi ishte pjesëtar i UÇK-së gjatë trazirave në Kosovë në vitet e 90-ta dhe ishte i plagosur gjatë konfliktit. Për këtë ofroi prova nga Shoqata e Invalidëve të Luftës e UÇK-së. Ai paraqiti kërkesë për pension invalidor të UÇK-së në Departamentin për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile, në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

11. Vendimi i Ministrisë, i 23 shkurtit 2011, ia mohoi të drejtën në pension, si invalid i UÇK-së. Në vendim thuhej që parashtruesi kishte të drejtë të ushtronte ankesë kundër këtij vendimi në afatin kohor 15 ditë nga dita e pranimit. Ankesa duhej t'i drejtohej Sektorit për ankesa të Departamentit për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile.

12. Parashtruesi nuk ka ofruar prova që ka ushtruar ankesë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

13. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, të specifikuara më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës.

14. Neni 113, paragrafi 1 dhe paragrafi 7, i Kushtetutës përcakton kornizën e përgjithshme juridike që kërkohet për pranueshmëri. Ai përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *(...)*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

15. Në këtë rast, nuk ka prova që parashtruesi ka bërë përpjekje për të ushtruar ankesë kundër vendimit të kontestuar dhe prandaj nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.

16. Siç u tha në Rastin Nr. KI.41/09, Universiteti AAB-RIINVEST kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës (Aktvendimi Nr. RK04/10 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 27 janarit 2010), Gjykata dëshiron të theksojë se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike, siç interpretohet nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (shih nenin 53 të Kushtetutës), është që t'ua lejojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose për ta korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjet efikas juridik për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, *GJEDNJ*, *Selmouni kundër Francës, Nr. 25803/94, vendimi i 28 korrikut 1999*). Megjithatë, nuk është e nevojshme që të drejtat kushtetuese të ceken në mënyrë eksplicite në procedurën në fjalë. Nëse çështja ishte ngritur në mënyrë implicite, ose në substancë, rregulli i shterimit të mjeteve juridike është plotësuar (shih, *mutatis mutandis, GJEDNJ, Azinas kundër Qipros, Nr. 56679/00, vendimi i 28 prillit 2004*).

17. Prandaj, kërkesa duhet të refuzohet si e papranueshme mbi bazën se parashtruesi ka dështuar t'i shterojë të gjitha mjetet juridike në dispozicion, në përputhje me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 47.2 të Ligjit dhe të rregullit 36.1 b) të Rregullores së punës.

18. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 20 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 56.2 të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 47.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe në pajtim me rregullin 36.1 (a) të Rregullores së punës, më 19 shtator 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Snezhana Botusharova Prof. Dr. Enver Hasani

KI 12/12 datë 08 nëntor 2012- Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Mitrovicë, E. nr. 709/2006, të 10 dhjetorit 2007

Rasti KI 12/12, vendimi i datës 10 dhjetor 2007

Fjalët kyçe; kërkesë individuale, ratione temporis , Aktvendim për papranueshmëri

Parashtruesi i kërkesës vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Mitrovicë, E. nr. 709/2006, të 10 dhjetorit 2007.

Parashtruesi i kërkesës pretendon se, me mosekzekutimin e këtij aktvendimi, atij i janë shkelur të drejtat, pa specifikuar me saktësi ndonjë të drejtë të veçantë kushtetuese, dhe nga Gjykata Kushtetuese kërkon ekzekutimin e vendimit të kontestuar.

Gjykata konstaton që kërkesa është e papranueshme, shkaku i papajtueshmërisë *ratione temporis* me Kushtetutën.

Prishtinë, më 02 nëntor 2012

Nr. ref.: RK321/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 12/12

Parashtruesi

Reshat Murati

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Mitrovicë, E. nr. 709/2006, të 10 dhjetorit 2007

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Reshat Murati, me banim në Mitrovicë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendime të kontestuara të autoritetit publik janë: Aktvendimi për ekzekutim i Gjykatës Komunale në Mitrovicë, E. nr. 2185/98, i 14 gushtit 1998, si dhe Aktvendimi E. nr. 709/2006, i 10 dhjetorit 2007, me të cilin Gjykata Komunale në Mitrovicë ka lejuar përtëritjen e shkresave të lëndës sipas shkresave të ish-lëndës E. nr. 2185, për të cilin aktvendim parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar datën kur e ka pranuar.

Objekti i çështjes

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), më 15 shkurt 2012, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit E. rr. 2185/98, të 14 gushtit 1998, si dhe Aktvendimit E. nr. 709/2006, të 10 dhjetorit 2007, e që kanë të bëjnë me mosekzekutimin e aktvendimit, sipas të cilit, Komuna e Mitrovicës, në cilësi të debitorit obligohej që kreditorit, z. Reshat Murati, t'ia paguante shumën 25.220,48 dinarë të atëhershëm, si dhe shumën 5.000.00 dinarë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë

4. Parashtruesi i kërkesës nuk ka potencuar në kërkesë shkelje specifike të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 22 dhe 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregullat 54, 55 dhe 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 28 shkurt 2012, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë dhe ajo u regjistrua me nr. KI12/12.

7. Më 7 shkurt 2012, me Vendimin GJ.R. KI12/12, Kryetari i Gjykatës caktoi Gjyqtar raportues gjyqtarin Ivan Čukalović. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues, në përbërje: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu (në cilësi të anëtarëve të Kolegjit).

8. Më 30 mars 2012, Gjykata njoftoi Gjykatën Komunale në Mitrovicë për regjistrimin e kërkesës së parashtruar nga parashtruesi, si dhe kërkoi nga Gjykata Komunale në Mitrovicë që ta njoftojë Gjykatën përkitazi me statusin e lëndës E. nr. 2185/98.

9. Më 11 prill 2012, Gjykata Komunale e Mitrovicës dërgoi në Gjykatë përgjigjen përkitazi me kërkesën në të cilën thekson se, pasi shkresat e lëndës kanë mbetur në ndërtesën e Gjykatës në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës në të cilën nuk kanë qasje, Gjykata Komunale e Mitrovicës nuk ka mundësi të informojë se në çfarë faze të përmbarimit gjendet lënda E. nr. 2185/98.

10. Më 10 maj 2012, parashtruesi i kërkesës, nëpërmjet postës elektronike, njoftoi Gjykatën Kushtetuese se, në fakt, atë, para kësaj Gjykate, nuk e përfaqëson avokati z. Adem Vokshi dhe, për këtë arsye, së bashku me kërkesën nuk ka bashkangjitur as autorizimin për përfaqësim.

11. Më 19 shtator 2012, në Seancën shqyrtuese për këtë lëndë, paneli shqyrtues i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 4 dhjetor 1997, z. Reshat Murati, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, me autorizim të avokatit z. Dejan R. Milic nga Mitrovica, kishte paraqitur në Gjykatën Komunale në Mitrovicë propozimin për ekzekutim, me të cilin kërkonte që kjo gjykatë të lejojë ekzekutimin dhe të obligojë Komunën e Mitrovicës që, si debitor, t'i paguajë shumën e parave të cekur në paragrafin 3 të këtij raporti.

13. Më 14 gusht 1998, Gjykata Komunale në Mitrovicë, kishte nxjerrë Vendimin E. nr. 2158/98, për ekzekutim të Aktgjykimit P. 787/97, të marrë me 20 shkurt 1998 nga Gjykata Komunale në Mitrovicë, në bazë të cilit Komuna e Mitrovicës detyrohet që parashtruesit të kërkesës t'ia paguajë kompensimin në vlerë 25.220,48 dinarë të atëhershëm.

14. Sipas pohimit të parashtruesit të kërkesës, ky aktvendim asnjëherë nuk është ekzekutuar.

15. Më 10 dhjetor 2007, Gjykata Komunale në Mitrovicë, pas kërkesës së parashtruar nga parashtruesi, nxjerr Aktvendimin E. nr. 709/2006, ku bën përtëritjen e shkresave të lëndës E. nr. 2158/98.

16. Më 14 maj 2010, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar nga ekipi i gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, që të përshpejtojnë ekzekutimin e Aktvendimit të Gjykatës Komunale të Mitrovicës, E. nr. 706/06.

17. Më 3 gusht 2010, ekipi i gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, i ishte përgjigjur kërkesës së parashtruesit të kërkesës, ku ata theksonin që, "për shkak se nuk ka lëndë të re ose të pazgjidhur civile që ka të bëjë me pronën para

gjyqësorit vendor, gjyqtarët e EULEX-it nuk kanë kompetenca në këtë rast të veçantë".

Pretendimet e parashtruesit

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, me mosekzekutimin e këtij aktvendimi, atij i janë shkelur të drejtat, pa specifikuar me saktësi ndonjë të drejtë të veçantë kushtetuese, dhe nga Gjykata Kushtetuese kërkon ekzekutimin e vendimit të kontestuar.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

19. Për të qenë në gjendje për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë, me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës së Gjykatës dhe, në këtë drejtim, i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, ku thuhet:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë **shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë**, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

20. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh:.

> Rregullin 36 të Rregullores së punës të Gjykatës ku, në paragrafin 3, përcaktohet:
> "*po ashtu një kërkesë mund të konsiderohet e papranueshme në rastet kur":*
>
> (h) kërkesa nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën.

21. Duke analizuar dokumentacionin e paraqitur në lëndë nga ana e parashtruesit të kërkesës, konstatohet se Aktvendimi, i cili është objekt i vlerësimit të kushtetutshmërisë, i Gjykatës Komunale në Mitrovicë, E. nr. 2185/98, është i 14 gushtit 1998, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Mitrovicë, E. nr. 709/2006, me të cilin lejohet ripërtëritja e lëndës, është i 10 dhjetorit 2007.

22. Gjithmonë duke marrë parasysh afatet kohore, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së akteve të autoriteteve, që datojnë nga një periudhë kohore para se të hynte në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës (15 qershor 2008), prandaj Gjykata Kushtetuese nuk mund të vlerësojë kushtetutshmërinë e akteve juridike me anë të të cilave supozohet shkelja e ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë, sepse, në atë kohë, ato as nuk janë përcaktuar, e as nuk janë garantuar me Kushtetutë, nga shkaku se vetë Kushtetuta nuk ka ekzistuar, prandaj kërkesa është *ratione temporis* e papranueshme në raport me Kushtetutën (shih, Blecic v. Kroaci, kërkesa nr. 59532/00, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, 29 korrik 2004, ku GJEDNJ e kishte shpallë të papranueshme atë kërkesë, sepse dispozitat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk i obligojnë palët kontraktuese përkitazi me asnjë akt që është nxjerrë, apo situatë juridike që ka përfunduar së ekzistuari para se konventa të hyjë në fuqi.)

23. Një arsyetim të tillë, Gjykata Evropiane e kishte përdorur edhe kur e ka shpallur të papranueshme **Jasiuniene kundër Lituanisë** (shih, *mutatis mutandis Jasiuniene kundër Lituanisë, kërkesa nr. 41510/98, aktgjykimet* e *GJEDNJ-së, 6 mars 2003 dhe* 6 *qershor 2003).*

24. Në këto rrethana, Gjykata konstaton që kërkesa është e papranueshme, shkaku i papajtueshmërisë *ratione temporis* me Kushtetutën;

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 36.3 (h) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 20 shtator 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Prof. Dr. Enver Hasani

KI 36/12 datë 27 nëntor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Ac. Nr. 116/2011, të 17 janarit 2012

Lënda Kl36/12, vendimi i 17 tetorit 2012
Fjalët kyçe; kërkesë individuale, e drejta e familjes, vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,

Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë në pajtim me nenin 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009.

Më 3 prill 2012, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.
Më 23 maj 2012, Kryetari e caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
Më 11 tetor 2010,Qendra për Punë Sociale në Rahovec ka nxjerrë vendimin nr. 02313/2010 me të cilin i ka dhënë parashtruesit të kërkesës në kujdestari të përkohshme fëmijën e mitur, që është nip i parashtruesit të kërkesës.
Më 29 mars 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxori vendimin N.Nj. C 2/2011 dhe ka urdhëruar parashtruesin e kërkesës t'ia kthejë fëmijën e mitur nënës së vet. Gjithashtu, ishte vendosur se, në rast të mosrespektimit të urdhrit të Gjykatës, parashtruesi do të gjobitej me gjobë 10,000 euro.
I pakënaqur me vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës.
Pas ankesës së parashtruesit, më 10 qershor 2011, Gjykata Supreme nxori vendimin AC nr. 40/2011 me të cilin është refuzuar ankesa e parashtruesit si e pabazuar dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, N.nj. 2/2011 i 29 marsit 2011.
I pakënaqur me rezultatin e procedurës në Gjykatën Supreme, parashtruesi i kërkesës i kërkoi Gjykatës Supreme që të përsëritë procedurën.
Gjykata Supreme e Kosovës e ka refuzuar propozimin e parashtruesit të kërkesës për përsëritjen e procedurës, me vendimin PPC nr. 62/11 të 29 shtatorit 2011.

Më 26 shtator 2011, Qendra për Punë Sociale në Rahovec nxori një vendim të ri në rastin nr. 02-313/2010 dhe prishi vendimin e saj të mëhershëm të 11 tetorit 2010, me të cilin parashtruesit i është dhënë kujdestaria e përkohshme.

Parashtruesi pastaj kontestoi vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (PPC nr. 62/11 të 29 shtatorit 2011).

Parashtruesi në kërkesë të Gjykatës Kushtetuese thekson se Gjykata Supreme e Kosovës, kur bëhet fjalë për rastin e tij, ka bërë shkelje të nenit 3 pika 1.1. të Ligjit nr. 03/L-238 për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës.
Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konkludoi se parashtruesi i kërkesës, as nuk e ka ndërtuar rastin mbi shkeljen e ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë dhe as që ka ofruar ndonjë provë *prima facie* për atë shkelje (shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, ECHR, Vendimi sa i përket pranueshmerisë së kërkesës, nr. 53363/99 i 31 majit 2005).

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e kërkesës së paraqitur, Gjykata Kushtetuese e Kosovës në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 46, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullave 36. (1a) dhe 36. (3c) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 17 tetor 2012, njëzëri vendosi ta hedhë poshtë kërkesën si të papranueshme.

Prishtinë, më 06 nëntor 2012

Nr.Ref.:RK322/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 36/12

Parashtruesi

Bajram Luta

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,

Ac. Nr. 116/2011, të 17 janarit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është Bajram Luta, me vendbanim në fshatin Radoste, komuna e Rahovecit.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Ac. Nr. 116/2011, i 17 janarit 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese i aktgjykimit të nxjerrë nga Gjykata Supreme e Republikës se Kosovës, më 17 janar 2012, që ka të bëjë me rrëmbimin ndërkombëtar të fëmijëve, me të cilin aktgjykim është refuzuar ankesa e parashtruesit kundër vendimit të Gjykatës Supreme, PPC nr. 62/11, të 29 shtatorit 2011, si e pabazuar dhe është konfirmuar vendimi i mëparshëm i Gjykatës Supreme, PPC nr. 62/11.

4. Me këtë kërkesë, parashtruesi i ka propozuar Gjykatës Kushtetuese që "ta mbrojë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë" e vendimit të kontestuar.

5. Parashtruesi pohon se janë shkelur të drejtat e tij, të garantuara me nenin 113 të Kushtetutës dhe me nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113 të Kushtetutës; në nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit; dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së

punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 3 prill 2012, parashtruesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

8. Më 23 maj 2012, Kryetari e caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu (anëtarë).

9. Më 1 qershor 2012, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme përkitazi me kërkesën.

10. Më 17 tetor 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 11 tetor 2010, Qendra për Punë Sociale në Rahovec ka nxjerrë vendimin Nr. 02-313/2010, me të cilin i ka dhënë parashtruesit të kërkesës në kujdestari të përkohshme një fëmijë të mitur, që është nip i parashtruesit të kërkesës.

12. Më 29 mars 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë ka nxjerrë vendimin N. Nj. C 2/2011 dhe ka urdhëruar parashtruesin e kërkesës t'ia kthejë fëmijën e mitur nënës së vet. Gjithashtu, ishte vendosur se, në rast të mosrespektimit të urdhrit të Gjykatës, parashtruesi do të gjobitej me gjobë 10,000 euro.

13. Gjykata e Qarkut në Prishtinë theksoi në arsyetimin e vendimit të lartpërmendur se fëmija i mitur jeton me parashtruesin pa

lejen e nënës së fëmijës. Gjithashtu, ishte theksuar se Ministria e Drejtësisë së Republikës së Kosovës edhe Ministria e Drejtësisë së Republikës së Austrisë kishin kërkuar nga parashtruesi t'ia kthejë fëmijën nënës së vet. Gjykata e Qarkut në Prishtinë argumentoi më tej se sjellja e parashtruesit është në kundërshtim me Ligjin për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës, Nr 03/L- 238, dhe me Konventën e Hagës për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës.

14. I pakënaqur me vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

15. Pas ankesës së parashtruesit, më 10 qershor 2011, Gjykata Supreme nxori vendimin AC Nr. 40/2011, me të cilin është refuzuar ankesa e parashtruesit si e pabazuar dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, N. nj. 2/2011, i 29 marsit 2011. Gjykata Supreme theksoi se "pretendimet ankimore të kundërpropozimit nuk janë relevante në rastin konkret dhe nuk janë dëshmuar me asnjë provë, e cila do të mund të vinte në pyetje bazat e vendimit".

16. I pakënaqur me rezultatin e procedurave në Gjykatën Supreme, parashtruesi i kërkesës i kërkoi Gjykatës Supreme që të përsërisë procedurën.

17. Gjykata Supreme e Kosovës ka refuzuar propozimin e parashtruesit të kërkesës për përsëritjen e procedurës, me vendimin PPC nr. 62/11, të 29 shatorit 2011.

18. Në arsyetimin e Gjykatës Supreme thuhet se "Gjykata Supreme gjen se nuk është e nevojshme të mbahet seancë gjyqësore në lidhje me shqyrtimin e kërkesës për rrëmbim ndërkombëtar të fëmijës në pajtim me dispozitat e Ligjit për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës (Ligji nr. 03/L-238)... dhe të Ligjit për procedurën jokontestimore dhe dispozitat e Konventës Evropiane (25.10.1980) për aspektet civile të rrëmbimit të fëmijës, prandaj Gjykata Supreme gjen se mospjesëmarrja e palëve në procedurë në seanca nuk paraqet shkelje thelbësore të procedurës jokontestimore, në të cilën është bazuar vendimi i gjykatës së shkallës së parë".

19. Më 26 shtator 2011, Qendra për Punë Sociale në Rahovec nxori një vendim të ri në rastin Nr. 02-313/2010 dhe prishi vendimin e saj të mëhershëm të 11 tetorit 2010, me të cilin parashtruesit i është dhënë kujdestaria e përkohshme. Qendra njoftoi se arsyeja për këtë vendim ishte bashkimi i fëmijës së mitur me nënën e tij.

20. Parashtruesi pastaj kontestoi vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (PPC nr. 62/11, i 29 shtatorit 2011) në panelin e Gjykatës Supreme. Ai argumentoi, ndër të tjera, se "Gjykata nuk i dha mundësi kundërpropozuesit (d.m.th., parashtruesit) të marrë pjesë në shqyrtim në mënyrë Gjykata që të nxjerr vendim të duhur në lidhje me këtë çështje familjare".

21. Më 17 janar 2012, Gjykata Supreme hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazë dhe vërtetoi vendimin e Gjykatës Supreme PPC nr. 62/11, të 29 shtatorit 2011. Gjykata Supreme, ndër të tjera, vlerësoi se "provat e reja nuk kanë ndikim në nxjerrjen e vendimit tjetër nga ai ku është vendosur që fëmija t'i kthehet nënës. Në pajtim me Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe në pajtim me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, gjykatat gjithmonë veprojnë në interes të fëmijës së mitur.

Ligji i aplikueshëm

22. Neni 11 i Ligjit për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës, Nr 03/L- 238, i 9 nëntorit 2010, thotë:

Urdhri për kthim

1. Gjykata do të urdhërojë kthimin e menjëhershëm të fëmijës nga Kosova në shtetin kërkues nëse:

1.1. fëmija është larguar apo mbajtur pa të drejtë në Kosovë; dhe

1.2. nga data kur është pranuar kërkesa në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, ka kaluar një periudhe me pak se një (1) vit nga data e largimit apo mbajtjes së padrejtë të fëmijës në Kosovë.

2. Gjykata do të urdhërojë kthimin e fëmijës së larguar apo mbajtur pa të drejtë edhe kur kërkesa është pranuar pas mbarimit të periudhës së një (1) viti, siç referohet në paragrafin 1. të këtij neni, për sa kohë që nuk është provuar se fëmija tashmë është përshtatur në një mjedis të ri të tij.

Pretendimet e parashtruesit

23. Siç është përmendur më herët, parashtruesi i kërkesës, pa precizuar më hollësisht, pohon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 113 të Kushtetutës dhe me nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji).

24. Për më tepër, parashtruesi thekson se Gjykata Supreme e Kosovës, kur është marrë me këtë rast, e ka shkelur nenin 3, pika 1.1., të Ligjit për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës, Nr. 03/L- 238.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

25. Siç është përmendur më herët, argumenti kryesor i parashtruesit është se, kur Gjykata Supreme e Kosovës është marrë me këtë rast, e ka shkelur nenin 3, pika 1.1., të Ligjit për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës, Nr. 03/L-238, i cili thotë:

"1.1 Largimi apo mbajtja e një fëmije konsiderohet i padrejtë në rastet kur:

1.2. konsiston në shkeljen e të drejtave të kujdestarisë dhënë një personi, një institucioni apo organi tjetër, qoftë bashkërisht apo individualisht, sipas ligjit të shtetit në të cilin fëmija ka qenë banor i përhershëm para largimit apo mbajtjes…"

26. Gjykata Kushtetuese do të përkujtojë se, sipas Kushtetutës, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Konventa (kushtetutshmëria). Gjykata Kushtetuese nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt, përkitazi me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis, Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], Nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I; shih gjithashtu Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI70/11, të parashtruesve Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. Nr. 983/08, të 7 shkurtit 2011).

27. Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese vëren nga faktet e paraqitura në këtë kërkesë se parashtruesi i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore në dispozicion dhe se gjykatat e rregullta i kanë marrë parasysh ato dhe se, në të vërtetë, i janë përgjigjur ankesave të tij në pikat ligjore.

28. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se rastit i ka munguar paanshmëria, ose që procedurat kanë qenë të padrejta (shih, *mutatis mutandis*, Shub vs. Lituania, ECHR, Vendimi për pranueshmërinë e kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).

29. Si përfundim, parashtruesi as nuk e ka ndërtuar rastin mbi shkeljen e ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë dhe as që ka ofruar ndonjë provë *prima facie* për atë shkelje (shih

Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, ECHR, Vendimi sa i përket pranueshmërisë së kërkesës, Nr. 53363/99, i 31 majit 2005).

30. Nga kjo del se kërkesa është qartazi e pabazuar sipas rregullit 36 1. (c) të Rregullores së punës që parasheh se "Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar".

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me rregullin 36 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe,

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Prof. Dr. Enver Hasani

KI 08/09 datë 06 dhjetor 2012- Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Fabrikës së Çelikut, IMK, në Ferizaj, e përfaqësuar nga z. Ali Azemi, kryetar i Sindikatës – Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit C. Nr. 340/2001, të 11 janarit 2002

Rasti KI 08/09, Vendimi për moszbatim, i datës 18 tetor 2012

Fjalët kyçe: dështimi në zbatimin e vendimit, shkelje të të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi, Z. Mr. Ali Azemi, në pajtim me Rregullin 63 (6) të Rregullores së Punës, ka parashtruar një kërkesë për nxjerrje të një vendimi mbi dështimin e zbatimit të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI 08/09 të datës 17 dhjetor 2010.

Gjykata vërejti që Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI 08/09, të datës 17 dhjetor 2010, kishte marrë formën e plotfuqishme që nga data 17 dhjetor 2010, që është edhe data e fillimit të afatit kohor prej gjashtë muajsh që i ishte dhënë Autoriteteve Zbatuese për zbatimin e Aktgjykimit. Mëtej, Gjykata Kushtetuese vërejti që afati kohor që i ishte dhënë Autoriteteve Zbatuese për zbatimin e Aktgjykimit në rastin KI 08/09 kishte skaduar gati dy vjet më parë. Gjykata vërejti që në pajtim me nenin 116.1 [Efekti juridik i vendimeve] të Kushtetutës, "Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës." Për më tepër, Gjykata përkujton që, në pajtim me Rregullin 63 (2) të Rregullores së Punës, "Të gjitha organet kushtetuese, si dhe gjykatat e autoritetet, janë të obliguara të respektojnë, të jenë në përputhje dhe të zbatojnë vendimet e Gjykatës, brenda kornizës së kompetencave të tyre të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj." Siç mund të vërehet nga pikat si më lart, Autoritetet Zbatuese ende nuk kanë zbatuar Aktgjykimin e prerë dhe të plotfuqishëm të kësaj Gjykate në rastin nr. KI 08/09, të datës 17 dhjetor 2010, në kundërshtim me nenin 116.1 të Kushtetutës, në lidhje me Rregullin 63 të Rregullores së Punës. Gjykata vendosi në Aktgjykimin e saj që Qeveria dhe AKP-ja ishin përgjegjëse për zbatimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, duke korrigjuar kështu shkeljen e të drejtave të njeriut të Parashtruesit. Pra, duke mos marrë masat e nevojshme për gati dy vjet për të zbatuar

Aktgjykimin e prerë dhe të plotfuqishëm të Gjykatës Kushtetuese në këtë rast, është bërë shkelje nga Autoritetet Zbatuese në kuptimin e obligimit të tyre kushtetues për të zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, si dhe shkelje e mëtutjeshme e të drejtave të Parashtruesve.

Prishtinë, më 14 nëntor 2012

Nr. ref.: VMSP323/12

VENDIM PËR MOSPËRMBARIM

në

AKTGJYKIMIN e Gjykatës Kushtetuese, të 17 dhjetorit 2010

në

Rastin nr. KI 08/09

Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Fabrikës së Çelikut, IMK, në Ferizaj, e përfaqësuar nga z. Ali Azemi, kryetar i Sindikatës – Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit C. Nr. 340/2001, të 11 janarit 2002

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, Gjyqtar

Altay Suroy, Gjyqtar

Almiro Rodrigues, Gjyqtar

Snezhana Botusharova, Gjyqtare

Kadri Kryeziu, Gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, Gjyqtare

Parashtrues

1. Parashtrues është Sindikata e Pavarur e punonjësve të Fabrikës së Çelikut, IMK, nga Ferizaj. Në procedurën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) është e përfaqësuar nga kryetar i Sindikatës, z. Ali Azemi, me banim në Ferizaj.

Autoritetet zbatuese

2. Gjykata, në Aktgjykimin e saj të 17 dhjetorit 2010, vendosi: "[…] Vendimi i formës së prerë dhe i obligueshëm i Gjykatës Komunale në Ferizaj duhet përmbaruar nga ana e organeve kompetente, posaçërisht nga Qeveria dhe nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, si pasardhëse ligjore e AKM-së". Gjykata, më tej, vendosi se Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit janë autoritetet zbatuese.

Baza juridike

3. Neni 116 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), rregulli 56 dhe rregulli 63 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

4. Më 17 qershor 2011, Agjencia Kosovare e Privatizimit e informoi Gjykatën se "sipas nenit 9.5 të Ligjit për AKP nr. 03/L-067, Komisioni i Likuidimit i NSH IMK Ferizaj është pjesë integrale e AKP-së. Rrjedhimisht, Komisioni përkatës i likuidimit, në përputhje me dispozitat e Rregullores 2005/48

për likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore, ka filluar me trajtimin e kërkesave kreditore sipas radhës prioritare të përcaktuar me nenin 44 të Rregullores nr. 2005/48 për Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve dhe Aseteve të tyre nën Autoritetin Administrativ të AKP-së".

5. Më 4 tetor 2011, Gjykata Kushtetuese i dërgoi kërkesë Qeverisë së Republikës së Kosovës që të njoftonte Gjykatën Kushtetuese se çfarë veprimesh kishte ndërmarrë për të përmbaruar Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, në rastin KI08/09, të 17 dhjetorit 2010. Qeveria e Republikës së Kosovës nuk i është përgjigjur deri më tani kësaj kërkese të Gjykatës.

6. Më 16 dhjetor 2011, Agjencia Kosovare e Privatizimit, të cilës i ishte dërguar një kopje e kërkesës për Qeverinë, komentoi përkitazi me këtë, si në vijim:

"...

Komisionet e likuidimit, të themeluara pranë Agjencisë sipas ligjit të mëhershëm për Agjencinë Kosovare të privatizimit nr. 03/L-067, përfshirë edhe komisionin e Likuidimit të NSH IMK Ferizaj kanë pushuar së vepruari me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr. 04-L-034, në shtator të vitit 2011.

Rrjedhimisht, duke iu përgjigjur kushteve të reja ligjore të parapara me nenin 12 të Shtojcës së Ligjit nr. 04-L-034,

Agjencia ka nisur procedurat e parapara ligjore për themelimin e Autoritetit përkatës të Likuidimit. Themelimi dhe emërimi i anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit bëhet në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik, prandaj duhet ndjekur procedurat lidhur me publikimin dhe njoftimet e nevojshme. Në momentin e themelimit të këtij autoriteti, puna do të fillojë në shqyrtimin e kërkesave të kreditorëve të NSH IMK Ferizaj.

Agjencia do të ju informojë me kohë me të gjitha veprimet që shkojnë në dobi të përmbushjes së Aktgjykimit KI08/09.

...”

7. Më 19 dhjetor 2011, parashtruesi i kërkesës, z. Ali Azemi, kërkoi që Gjykata Kushtetuese të lëshonte një vendim në pajtim me rregullin 63 (6) të Rregullores së punës, që përcakton:

“Në rast të moszbatimit të një vendimi, ose të vonesës në dhënien e informacioneve për Gjykatën Kushtetuese për masat e ndërmarra, Gjykata Kushtetuese mund të lëshojë një vendim në të cilin do të theksohet që vendimi nuk është zbatuar dhe të vendosë për botimin e atij vendimi në Gazetën Zyrtare”.

8. Më 18 dhjetor 2012, Gjykata shqyrtoi dhe votoi Vendimin për mospërmbarim të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, të 17 dhjetorit 2010.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 3 mars 2009, parashtruesi parashtroi një kërkesë në Gjykatë, duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së shkeljes së supozuar të parimit *res judicata* të përfshirë në nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë e të paanshëm] të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës pohon se Gjykata Komunale e Ferizajt, e cila, me Aktgjykimin e 11 janarit 2002, ka miratuar kërkesën për kompensim të rrogave të papaguara të 572 punonjësve në ndërmarrjen shoqërore Fabrika për prodhimin e tubave të çelikut, IMK (në tekstin e mëtutjeshëm: IMK) në shumën 25.649.250,00 €. Ky Aktgjykim është bërë i plotfuqishëm (*res judicata)* më 11 mars 2002. Më 22 dhjetor 2005, e njëjta Gjykatë Komunale lejoi përmbarimin e Aktgjykimit. Megjithatë, përmbarimi deri më tani nuk është kryer.

10. Më 13 tetor 2010, është mbajtur një Seancë publike, ku përfaqësuesi i parashtruesve ishte i pranishëm, sikur edhe përfaqësuesit e AKP-së dhe IMK New CO. Gjithashtu, edhe Gjykata Komunale në Ferizaj, ishte e ftuar në Seancën publike, por ajo nuk i është përgjigjur ftesës. Të njëjtën datë, ishte dorëzuar dokumentacioni shtesë nga parashtruesi dhe nga AKP-ja.

11. Më 17 dhjetor 2010, Gjykata shqyrtoi dhe votoi për kërkesën.

12. Gjykata, në Aktgjykimin e saj të 17 janarit 2010, vendosi që, edhe përderisa mjetet juridike në dispozicion, sipas ligjit të zbatueshëm, janë shteruar nga punonjësit, këto mjete nuk kanë qenë efektive, në kuptimin që ato nuk i kanë sjellë rezultatet e pritura, sepse punonjësit ende janë duke pritur ekzekutimin e Vendimit të Gjykatës Komunale, të datës 11 janar 2002.

13. Përkitazi me këtë, Gjykata thekson që e drejta e inicimit të procedurës gjyqësore në raste civile, siç parashihet me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës, si dhe me nenin 6 në lidhje me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), do të ishte iluzore, nëse sistemi ligjor i Kosovës do të lejonte një vendim gjyqësor përfundimtar dhe të plotfuqishëm që të mbetej i paefektshëm në dëm të një pale. Do të ishte e pakuptueshme që këto nene t'i përshkruajnë në hollësi garancitë procedurale që i ofrohen palëve në procedurë – procedura që janë të drejta, publike dhe ekspeditive – pa mbrojtjen e zbatimit të vendimeve gjyqësore. Interpretimi i neneve të lartpërmendura, si ekskluzivisht të lidhura me qasjen ndaj gjykatës, dhe administrimi e efektshmëria e procedurave, do të kishte mundësi të çonte në situata që nuk janë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit, të cilin autoritetet e Kosovës janë të obliguara ta respektojnë (shih, *mutatis mutandis, aktgjykimin e ECRtHR-së në rastin Romashov kundër Ukrainës, Parashtresa nr. 67534/01, aktgjykimi i 25 korrikut 2004*).

14. Më tej, Gjykata vendosi, në Aktgjykimin e 17 dhjetorit 2010, se sundimi i ligjit, që është një prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike, presupozon respektimin e parimit të

sigurisë juridike, sidomos përkitazi me vendimet gjyqësore që kanë marrë formën *res judicata*. Asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një aktgjykimi përfundimtar dhe të plotfuqishëm, thjesht për qëllimin e fitimit të rishikimit dhe të rishqyrtimit të freskët të rastit (shih, për shembull, *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës, nr. 48553/99, § 72, ECHR 2002-VII, si dhe Ryabykh kundër Rusisë, nr. 52854/99, § 52, ECHR 2003-IX*). Po të mos ishte kështu, kthimi prapa i vendimeve përfundimtare do të çonte në një klimë të përgjithshme të pasigurisë juridike, duke zvogëluar kështu besimin publik në sistemin gjyqësor, si dhe rrjedhimisht edhe në sundimin e ligjit. Autoritetet kompetente, pra, kanë obligimin pozitiv që të organizojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv edhe në kuptimin ligjor e edhe në atë praktik, si dhe i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme (shih, *Pecevi kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21839/03, 6 nëntor 2008; Martinovska kundër Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 22731/02, 25 shtator 2006*).

15. Në rastin konkret, parashtruesit nuk do të duhej të privoheshin nga përftimi i vendimit, i cili kishte marrë formën *res judikata* në favor të tyre.

16. Gjykata konkludoi se është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe efektiv, e garantuar me Kushtetutë dhe me GJEDNJ, sepse autoritetet përkatëse kanë dështuar që, për një periudhë kaq të gjatë kohore, të përmbarojnë Aktgjykimin e 11 janarit 2002.

17. Më 17 dhjetor 2010, Gjykata publikoi Aktgjykimin.

Përmbarimi i Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese

18. Gjykata Kushtetuese (me Aktgjykimin në rastin KI08/09, të 17 dhjetorit 2010) pranoi kërkesën e parashtruesit për vlerësim të kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj, Vendimi C. nr. 340/2001, të 11 janarit 2001.

19. Më tej, Gjykata ka vendosur se *"[...] ka pasur shkelje të Nenit 31* [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenet 6 [E drejta për gjykim të drejtë] dhe 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

20. Sa i përket zbatimit të Aktgjykimit të saj, Gjykata ka vendosur *"[...]* që vendimi i formës së prerë dhe i detyrueshëm i Gjykatës Komunale në Ferizaj duhet të përmbarohet nga autoritetet kompetente, në veçanti nga Qeveria dhe nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, si pasardhës ligjor i AKM-së". Prandaj, siç theksohet në paragrafin 2 më lart, është e qartë se autoritetet zbatuese janë Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit.

21. Gjithashtu, Gjykata ka vendosur se *"[...]* Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit duhet të dorëzojnë në Gjykatë, brenda një periudhe gjashtëmujore, informata lidhur me masat e ndërmarra për ekzekutimin e këtij Aktgjykimi".

22. Aktgjykimi i Gjykatës, KI08/09, i 17 dhjetorit 2010, ka hyrë në fuqi menjëherë nga data 17 dhjetor 2010, që është gjithashtu datë e fillimit të afatit prej gjashtë muajsh që i është dhënë autoriteteve zbatuese për përmbarimin e Aktgjykimit.

23. Gjykata Kushtetuese tani gjen se afati që i është dhënë autoriteteve zbatuese për përmbarimin e Aktgjykimit të saj, në rastin KI08/09, ka skaduar pothuajse qe dy vjet.

24. Sipas nenit 116.1 [Efekti juridik i vendimeve] të Kushtetutës, "Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës".

25. Për më tepër, Gjykata rikujton se, në pajtim me rregullin 63 (2) të Rregullores së punës, "Të gjitha organet kushtetuese, si dhe gjykatat e autoritetet, janë të obliguara të respektojnë, të jenë në përputhje dhe të zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese, brenda kornizës së kompetencave të tyre të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj".

26. Nga sa u tha më sipër, del se autoriteti zbatues nuk ka zbatuar ende Aktgjykimin final dhe të detyrueshëm të kësaj Gjykate, në rastin KI08/09, të 17 dhjetorit 2010, përkundër nenit 116.1 të Kushtetutës, në lidhje me rregullin 63 të Rregullores së punës.

27. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata vlerësoi se Qeveria dhe AKP-ja janë përgjegjës për përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese dhe kështu korrigjoi shkeljen e të drejtave të

njeriut të parashtruesit të kërkesës. Prandaj, duke u përmbajtur për gati dy vjet nga marrja e masave të nevojshme për t'iu përmbajtur Aktgjykimit final të detyrueshëm të Gjykatës Kushtetuese, në rastin konkret, ka pasur kështu shkelje nga autoriteti zbatues sa i përket obligimit të tyre kushtetues për të zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, si dhe ka pasur shkelje të të drejtave të parashtruesve.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 116 të Kushtetutës, në pajtim me rregullin 56 dhe në pajtim me rregullin 63 të Rregullores së punës, më 18 tetor 2012, njëzëri

VENDOSI

I. Të publikojë Vendimin për mospërmbarim, për shkak se Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit në Kosovë ende nuk kanë përmbaruar Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, KI08/09, të 17 dhjetorit 2010;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve, Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Qeverisë;

III. Në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit dhe për qëllime të rregullit 63 (6) të Rregullores së punës, ky vendim do të publikohet në Gazetën Zyrtare.

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

KI 96/12 datë 13 dhjetor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev. 311/2009 të 15 korrikut 2009, Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 393/08, të 18 shkurtit 2009 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale C.nr.749/07 të 4 korrikut 2008

Rasti KI 96/2012, vendimi i datës 23 nëntor 2012
Fjalët kyçe: kontest civil, kontest pronësor, kërkesa individuale, kërkesa e paafatshme.

Parashtruesi e kishte dorëzuar Kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke pretenduar se me vendimet gjyqësore të gjykatave të rregullta i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës. Parashtruesi, tregon se qëllimi i tij dhe i anëtareve tjerë të familjes është kthimi i patundshmërisë së kontestuar që ua kishte lënë nëna e tyre, pasuri të cilën pretendon se iu është marrë atyre në mënyrë të paligjshme nga bashkëfshatari i tij.

Në këtë rast, Gjykata, ka vërejtur që vendimi gjyqësor përfundimtar për parashtruesin ishte Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Rev.nr.311/2009 të cilin parashtruesi e kishte pranuar më 23 tetor 2010, përderisa, parashtruesi kërkesën në Gjykatë e kishte dorëzuar më 8 tetor 2012, që nënkupton se kërkesa ishte dorëzuar jashtë afatit katër (4) mujor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës.

Prishtinë, më 23 nëntor 2012

Nr. ref.: RK324/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 96/12

Parashtrues

Ramiz Asllani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev. 311/2009 të 15 korrikut 2009, Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 393/08, të 18 shkurtit 2009 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale C.nr.749/07 të 4 korrikut 2008

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Remzi Asllani (parashtruesi) me vendbanim në fshatin Reçan, komuna e Prizrenit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston: Aktvendimin e Gjykatës Supreme Rev. 311/2009 të 15 korrikut 2009, Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 393/08 të 18 shkurtit 2009 dhe Aktgjykimit e Gjykatës Komunale C.nr.749/07 të 4 korrikut 2008.

Objekti i çështjes

3. Çështjes bazë e kërkesës, ka të bëjë me të drejtën në pronë, dhe kërkesën për kthimin e pronës kontestuese për të cilin parashtruesi pretendon se i është marre në mënyrë të paligjshme nga bashkëfshatari i tij.

4. Parashtruesi ndër të tjera ka kërkuar edhe mos zbulimin e identitetit të tij.

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregullit 28 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në gjykatë

6. Më 8 tetor 2012. parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 8 tetor 2012, Gjykata, nga parashtruesi i kërkesës kërkoi plotësimin e kërkesës me dokumentacion të nevojshëm.

8. Më 18 tetor 2012, parashtruesi e dorëzoi kërkesën e kompletuar së bashku me dokumentacionin e nevojshëm.

9. Më 30 tetor 2012, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe palët e përfshira në procedurë, për regjistrimin e kërkesës KI 96/12.

10. Më 1 nëntor 2012, Kryetari me vendimin GJR. 96/12, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë me vendimin KSH. 96/12, Kryetari, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Cukalovic (anëtar) dhe Arta Rama-Hajrizi (anëtare).

11. Më 13 nëntor 2012, Gjykata, kërkoi nga Gjykata Komunale në Prizren, dëshmi përkitazi me datën e pranimit të Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev.nr. 311/2009 të 15 korrikut 2009, nga parashtruesi i kërkesës.

12. Me 13 nëntor 2012, Gjykata Komunale në Prizren dorëzoi dëshmitë e kërkuara nga Gjykata, ku vërehet se parashtruesi e kishte pranuar Aktvendimin Rev.nr.311/2009 të 15 korrikut 2009 më 23 tetor 2010.

13. Më 23 nentor 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

14. Më 4 korrik 2008, Gjykata Komunale në Prizren, sipas padisë së ngritur nga z. Arun Limani (paditësi), nga fshati Reçan, komuna e Prizrenit, kishte marr vendim (Aktgjykimi C.nr.749/07 i 04.07.2008) lidhur me përcaktimin e të drejtës në pronë. Gjykata Komunale e Prizrenit të drejtën e pronës ia njohu z. Limani.

15. Parashtruesi, kundër Aktgjykimi, C.nr.749/07 të 4 korrikut 2008 të Gjykatës Komunale të Prizrenit, përmes të autorizuarit të tij (avokatit) ushtroi të drejtën e ankesës, duke e kundërshtuar vendimin në fjale për shkak të shkeljeve qenësore të procedurës, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që i njëjti të anulohet dhe që lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

16. Më 18 shkurt 2009, Gjykata e Qarkut në Prizren, me Aktgjykimin Ac.nr.392/2008 të 18 shkurtit 2009, refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar për shkak se Aktgjykimi i kontestuar C.nr.749/07 i 4 korrikut 2008 nuk ishte lëshuar me shkelje të thelbësore të procedurës kontestimore siç kishte pretenduar avokati i parashtruesit dhe as arsyet e ankesës nuk paraqesin bazë për anulimin ose ndryshimi i aktgjykimit të kontestuar.

17. Më 15 korrik 2009, parashtruesi i pa kënaqur me vendimin e Gjykatës së Qarkut, ushtroi revizion në Gjykatën Supreme (Aktvendimin Rev.nr.311/2009 i 15 korrikut 2009), e cila hodhi poshtë si të palejueshëm revizionin e ushtruar nga parashtruesi, me arsyetimin se vlera e objektit të kontestit në aktgjykimin e formës së prerë nuk e kalon shumën e parapare me dispozitën e nenit 382 par. 3 të LPK, ku sipas kësaj dispozite revizioni në këtë çështje juridike nuk është i lejuar dhe si i tille duhet të hidhet poshtë.

18. Më 19 qershor 2010, parashtruesi i kërkesës ushtroi padi në Gjykatën Evropiane për të Drejta të Njeriut në Strasburg (GJEDNj).

19. Më 24 qershor 2010, GJEDNj konfirmoj pranimin e parashtrues së parashtruar nga parashtruesi. GJEDNj i është përgjigjur se: "Kosova nuk është nënshkruese e Konventës për të Drejtat e Njeriut, kështu që nuk mund të ushtroni parashtresë kundër të njëjtës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet gjyqësore të gjykatave të rregullta i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

21. Parashtruesi, tregon se qëllimi i tij dhe i anëtareve tjerë të familjes është kthimi i patundshmërisë së kontestuar që ua kishte lënë nëna e tyre, pasuri të cilën pretendon se iu është marrë atyre në mënyrë të paligjshme nga bashkëfshatari i tij.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

22. Së pari, Gjykata vlerëson nëse kërkesa parashtruesit i përmbushë kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

23. Përkitazi me këtë , Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, që përcakton: *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht [...]"*

24. Në këtë rast, Gjykata, vëren që vendimi gjyqësor përfundimtar për parashtruesin është Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Rev.nr.311/2009 i 15 korrikut 2009 të cilin parashtruesi e ka pranuar më 23 tetor 2010. Parashtruesi,

kërkesën në Gjykatë e dorëzoi më 8 tetor 2012, që nënkupton se kërkesa është dorëzuar jashtë afatit katër (4) mujor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës.

25. Për më tepër, kërkesa e parashtruesit të kërkesës për moszbulimin e identitetit të tij duhet refuzuar si e pabazë, për faktin qe i njëjti nuk ka ofruar prova pse dhe si mund të ndikoj negativisht zbulimi i identitetit të tij në këtë çështjen juridike.

26. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe me rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, më 23 nëntor 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Altay Suroy	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 120/11 datë 13 dhjetor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. Nr. 551, të 20 qershorit 2011

Rasti KI 120/2011, vendimi i datës 4 dhjetor 2012
Fjalët kyçe: kërkesa individuale, kontest administrativ, parimi i barazisë së armëve, mos shterje e mjeteve juridike

Parashtruesi e kishte dorëzuar kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, duke pretenduar se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, A. Nr. 551 i datës 20 qershor 2011, me të cilin refuzohet padia e tij kundër vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës (A. 02/63/2011, të 17 majit 2011), kishte shkelur të drejtat e Parashtruesit, të garantuara me nenin 113.8 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës dhe nenin 6.1 [E Drejta për Gjykim të Drejtë] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut.

Gjykata konsideroi se Parashtruesi i kërkesës është dashur, së pari, të ankohej në Gjykatën Supreme. Fakti se Parashtruesi i kërkesës nuk është ankuar në Gjykatën Supreme kundër shkeljes së pretenduar të të drejtave të tij për një gjykim të drejtë, tregon se nuk janë shteruar të gjitha mjetet e ofruara nga sistemi i rregullt ligjor.

Gjykata kishte konstatuar se kërkesa e Parashtruesit nuk i përmbushte kërkesat për pranueshmëri të parapara në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 (2) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe rregullit 36 (1) të Rregullores së punës.

Prishtinë, më 04 Dhjetor 2012

Nr. Ref.:RK326/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 120/11

Parashtruesi

Ministria e Shëndetësisë

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. Nr. 551, të 20 qershorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa ishte paraqitur nga Ministria e Shëndetësisë, e përfaqësuar nga Sekretari i saj i Përgjithshëm.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Gjykatës Supreme, A. Nr. 551, të 20 qershorit 2011.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon se ai aktgjykim, me të cilin refuzohet padia e tij kundër vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës (A. 02/63/2011, të 17 majit 2011), ka shkelur të drejtat e Ministrisë së Shëndetësisë, të garantuara me Kushtetutë, më saktë ka shkelur nenin 113.8 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të Konventës Evropiane për të Dejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë, KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 21.4 dhe në nenin 113.7 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedurat në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 5 gusht 2011, parashtruesi i paraqiti kërkesë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë, Gjykata).

6. Më 5 gusht 2011, Gjykata Kushtetuese informoi Ministrinë e Shëndetësisë, Gjykatën Supreme dhe Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës (KPM) përkitazi me kërkesën.

7. Më 1 shtator 2011, Kryetari emëroi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe emëroi Kolegjin shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

8. Më 9 korrik 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, mbajti këshillime për rastin, dhe i paraqiti një rekomandim Gjykatës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 1 dhjetor 2010, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë vendosi (vendimi ZSP 115-XII-2010) t'ia ndërpresë kontratën e marrëdhënies së punës të punësuarit Alban Pozhegu. Vendimi arsyeton se pozita e z. Pozhegu do të shuhet dhe se kontrata tij e punësimit nuk do të përtëritet.

Alban Pozhegu u ankua në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.

10. Më 8 shkurt 2011, Komisioni hodhi poshtë ankesën e z. Alban Pozhegu (Vendimi Nr. 05-5784/4) dhe la në fuqi Vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm. Alban Pozhegu i parashtroi ankesë KPM-së kundër këtij vendimi.

11. Më 17 maj 2011, KPM-ja mbështeti ankesën e z. Alban Pozhegu (Vendimi A 02-63-2011) dhe anuloi Vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë. Njëkohësisht, obligoi Ministrinë "që të rikthejë parashtruesin e kërkesës në vendin e tij të punës, ta sistemojë atë në ndonjë pozitë të ngjashme në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, duke ia vazhduar punësimin me të gjitha të drejtat e marrëdhënies së punës".

12. Më 15 qershor 2011, parashtruesi parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme, duke kërkuar që "të **ANULOHET** vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës (...) si i paligjshëm dhe i pabazuar" dhe "të **MBËSHTETET** padia e Ministrisë së Shëndetësisë (...) si e bazuar". Parashtruesi i kërkesës i propozoi Gjykatës Supreme të Kosovës që "të referojë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës kërkesë për interpretimin e përputhshmërisë së Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Nr. 036/L-192, (nenet 13 dhe 14) me Kushtetutën".

13. Më 20 qershor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi (Aktgjykimi A. nr. 551/2011) "të refuzojë padinë" dhe se "kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës (...) është e pabazuar".

14. Në fakt, Gjykata Supreme gjeti se padia ishte e pabazuar, "sepse i padituri [KPM] ka respektuar Rregulloren e punës dhe ka vërtetuar në mënyrë të drejtë e të plotë gjendjen faktike, pa cënuar ligjin në dëm të paditësit" [Ministria e Shëndetësisë]. Në anën tjetër, Gjykata Supreme, po ashtu, "vlerësoi edhe kontestimet e tjera të padisë se duhej të merrej vendim tjetër lidhur me kërkesën e paditëses dhe konstatoi se ato nuk do të

ndikonin në këtë çështje administrative". Përfundimisht, Gjykata Supreme konstatoi se "për shkak të vendimit të marrë (...), kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit është jolëndore".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ai aktgjykim, me të cilin refuzohet padia e tij kundër vendimit të KPM-së, ka shkelur të drejtat e Ministrisë së Shëndetësisë, të garantuara me nenin 113.8 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, dhe nenin 6.1 [E Drejta për Gjykim të Drejtë] të KEDNJ-së.

16. Parashtruesi i kërkesës argumenton se, në ankesën e vet pranë Gjykatës Supreme, "ka paraqitur të gjitha faktet përkitazi me rastin, ku, ndër të tjera, është propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës të referojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, Nr. 036/L-192, konkretisht nenet 13 dhe 14 të këtij ligji".

17. Parashtruesi i kërkesës më tej argumenton se "Vendimi i Këshillit është i bazuar në këtë ligj, për të cilin konsiderojmë se disa nga nenet e tij nuk janë në përputhshmëri me Kushtetutën, duke marrë parasysh kërkesën eksplicite të Gjykatës Supreme për ta dërguar këtë ligj në Gjykatën Kushtetuese, konsiderojmë se Gjykata Supreme, bazuar në nenin 113.8 të Kushtetutës, ka qenë e obliguar që në rastin konkret ta ndërpresë procedurën dhe të ngrejë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë të dispozitave të kontestuara të ligjit në fjalë".

18. Parashtruesi i kërkesës konsideron se Gjykata Supreme "ka shkelur nenin 113.8 të Kushtetutës, duke mos aprovuar propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë për të dërguar rastin në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për KPM-në (Nr. 03/L-192) përkitazi me nenin 31 të Kushtetutës, sepse duke mos aprovuar propozimin e Ministrisë

së Shëndetësisë dhe duke mos ekzaminuar dëshmitë e paraqitura nga Ministria e Shëndetësisë, ka bërë trajtim jo të barabartë të palëve në procedurë (barazia e armëve)".

19. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu, i referohet shkeljes së nenit 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (E drejta për një proces të rregullt), (...) sepse "Gjykata Supreme, ndër të tjera, ka pasur obligim të bëjë shqyrtim të mirëfilltë të parashtresës, të argumenteve dhe të provave të paraqitura nga palët, dhe të vlerësojë, pa paragjykim, nëse ato janë relevante për vendimin e saj" (S*hih Vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në rastin Kraska kundër Zvicrës, të 19 prillit 1993).*

20. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu, thekson se "parimi i barazisë së armëve është një kriter i rëndësishëm i gjykimit të drejtë" dhe thirret në disa vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. "Është tërësisht e qartë se, Gjykata Supreme, duke mos marrë parasysh argumentet e paraqitura nga Ministria e Shëndetësisë, ka bërë shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së (...)".

21. Parashtruesi i kërkesës përmbyll ankesën, duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese "anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A.nr. 551/11, të 20 qershorit 2011, dhe anulimin e Vendimit të KPM-së, A 02/63/11, të 17 majit 2011, duke i shpallur ato si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe duke shprehur mendimin se Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës (Ligji Nr.03/L-192) të Republikës së Kosovës, në shumë dispozita të tij, është i papajtueshëm me Kushtetutën e Kosovës".

22. Argumentet ligjore dhe kërkesat e bëra nga parashtruesi i kërkesës mund të ishin përmbledhur në mënyrë të drejtë në një pyetje kryesore: nëse Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, si vendim përfundimtar (i cili përfshin edhe vendimin e KPM-së), ka shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, më saktësisht të drejtën për gjykim të drejtë (marrë si kompozim të të drejtave përkitazi me procedurën e drejtë gjyqësore, përfshirë edhe

mungesën e arsyetimit për jokushtetutshmërinë e propozuar të Ligjit për KPM-në).

Pranueshmëria e kërkesës

23. Para së gjithash, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë së kërkesës.

24. Neni 113. (1 dhe 7) i Kushtetutës përbën kornizën e përgjithshme të kërkesave ligjore që një kërkesë të jetë e pranueshme. Ai parasheh:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

25. Neni 47 (2) i Ligjit për Gjykatën, po ashtu, parasheh:

"Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

26. Për më tepër, rregulli 36 (1. a) i Rregullores parasheh:

"Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me ligj kundër vendimit ose aktgjykimit të kundërshtuar".

27. Ato kushte të pranueshmërisë më tej janë zhvilluar në Ligj dhe në Rregullore të punës, ku specifikohet, ndër të tjera, përputhshmëria me afatin e paraparë, duke përfshirë edhe justifikimin procedural dhe substancial të kërkesës, me një deklarim të shkurtër të fakteve dhe të sqarimit të saktë të të drejtave që janë shkelur, duke cekur aktin konkret të autoritetit publik që është objekt i kontestimit, si dhe ndihmën e kërkuar; dhe, duke bashkëngjitur informatat dhe dokumentet e nevojshme mbështetëse.

28. Parashtruesi i kërkesës nuk vepron si individ, por si përfaqësues i personit juridik, i Ministrisë së Shëndetësisë. Neni 21 (4) i Kushtetutës parasheh:

"Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme".

Andaj, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese. (*Shih, Aktvendimi në rastin KI. 41/09, Universiteti AAB-RIINVEST Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, paragrafi 14).*

29. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës i është përmbajtur afatit të paraparë prej katër muajsh, llogaritur nga dita kur Ministrisë i është dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës Supreme; ka justifikuar kërkesën me fakte relevante dhe me referime të qarta të shkeljeve të supozuara; shprehimisht konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme që është akti konkret i autoriteteve dhe objekt shqyrtimi; qartë tregon ndihmën e kërkuar, qartazi thekson ndihmën që kërkon; dhe bashkëngjit vendime të ndryshme si dhe informata e dokumente mbështetëse.

30. Sidoqoftë, parashtruesi i kërkesës është i obliguar të shterë të gjitha mjetet ligjore të parapara me ligj, siç parashihet për

individët me nenin 113.(7) të Kushtetutës dhe me dispozitat e tjera ligjore, siç ceket më lart.

31. Qëllimi i rregullit të shterimit është që, në këtë rast, t'i ofrohet Gjykatës Supreme mundësia e rregullimit të shkeljeve të pretenduara të Kushtetutës. Rregulli i shterimit është operativisht i ndërthurur me karakterin e subsidiaritetit të drejtësisë kushtetuese të kornizës procedurale. (Shih*, Selmouni kundër Francës [GC], § 74; Kudła kundër Polonisë [GC], § 152; Andráshik dhe të tjerët kundër Sllovakisë [dec.]).*

32. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, apo administrative ose gjyqësore, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka, të rregullohet shkelja e tillë e të drejtave themelore. Andaj, parashtruesi i kërkesës është përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, nëse dështon të shfrytëzojë procedurat e rregullta, apo dështon të raportojë shkeljet e Kushtetutës në procedurë të rregullt. Ai dështim do të kuptohet si mosshfrytëzim i të drejtës për të kundërshtuar më tej shkeljen dhe për t'u ankuar. (Shih*, Aktvendimi në rastin KI07/09, Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj, Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl.nr. 61/07, të 24 nëntorit 2008, paragrafi 18*).

33. Një e drejtë e njeriut është shkelur, nëse vendimi gjyqësor do të ishte bazuar në një qëndrim të cilin Gjykata Kushtetuese do ta anulonte për shkak të papajtueshmërisë me Kushtetutën. Megjithatë, kur ndodh, parashtruesit e kërkesës janë të obliguar të shterojnë të gjitha mjetet ligjore të parapara me ligj, në mënyrë që t'ua ofrojnë organit publik, përfshirë edhe gjykatat e rregullta, mundësinë e korrigjimit të shkeljeve të pretenduara të Kushtetutës.

34. Mosshterimi i mjeteve ligjore mund të nënkuptojë situata të ndryshme: kërkesa është e parakohshme, sepse vendimi për të njëjtën çështje është ende në pritje; kërkesa ishte parashtruar në mungesë të disa ankesave; ose ankesa parashtrohet në instancën e fundit, pa iu dhënë mundësia asaj gjykate të instancës së fundit që të korrigjojë shkeljen e pretenduar.

35. Kurdo që kontestohet një vendim në bazë të një qëndrimi juridik nga pikëvështrimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, po të njëjtit organ, përfshirë edhe gjykatat e rregullta që sollën vendimin, duhet ofruar mundësia e rishqyrtimit të vendimit të kontestuar. Kjo do të thotë se, çdoherë, kur pretendohet shkelja e të drejtave të njeriut, nuk është e thënë që ky pretendim të arrijë në Gjykatën Kushtetuese para se të shqyrtohet paraprakisht nga organet publike, përfshirë këtu edhe Gjykatën Supreme.

36. Parashtruesi i kërkesës, në këtë rast, do të duhej të ishte ankuar para Gjykatës Supreme kundër shkeljes së pretenduar të së drejtës së tij për gjykim të drejtë, pasi që "duhet gjykuar në bazë të Kushtetutës dhe ligjit" (neni 102 (3) i Kushtetutës).

37. Në praktikë, asgjë nuk e ndaloi parashtruesin e kërkesës që të ankohej para Gjykatës Supreme për shkeljen e pretenduar të së drejtës së tij për gjykim të drejtë. Nëse Gjykata Supreme do ta konsideronte shkeljen dhe do ta rregullonte atë, kjo do të përfundonte; nëse Gjykata Supreme nuk do ta rregullonte shkeljen, apo nuk do ta shqyrtonte atë, parashtruesi i kërkesës do të kishte plotësuar kushtet e pranueshmërisë për shterimin e mjeteve, në kuptimin që Gjykatës Supreme i është ofruar mundësia e rregullimit të shkeljes së pretenduar.

38. Në fakt, kjo analizë është në përputhshmëri me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane, e cila parasheh që parashtruesit vetëm duhet shteruar mjetet vendore që i kanë në dispozicion në teori dhe në praktikë në kohën përkatëse, që do të thotë se janë të arritshme, në gjendje të sigurojnë dëmshpërblim lidhur me ankesat e tyre dhe për të ofruar mundësi të arsyeshme për sukses (Shih, *Sejdović kundër Italisë [GC], nr. 56581/00, ECHR 2006-II § 46*). Duhet vlerësuar, në të gjitha rrethanat e rastit, nëse parashtruesi i kërkesës ka bërë gjithçka që me arsye pritet prej tij ose prej saj për të shteruar mjetet vendore (Shih, *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke [GC], §§ 116-22).*

39. Andaj, parashtruesi i kërkesës nuk mund të ankohet drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese për shkelje të të drejtave

dhe të lirive themelore të njeriut. Parashtruesi i kërkesës është dashur, së pari, të ankohej në Gjykatën Supreme. Fakti se parashtruesi i kërkesës nuk është ankuar në Gjykatën Supreme kundër shkeljes së pretenduar të të drejtave të tij për një gjykim të drejtë, tregon se nuk janë shteruar të gjitha mjetet e ofruara nga sistemi i rregullt ligjor.

40. Kështu që, Gjykata Kushtetuese nuk mund të vlerësojë shkeljet e pretenduara kushtetuese, pa iu dhënë mundësia Gjykatës Supreme për të rregulluar të njëjtat shkelje. Duke pasur parasysh gjithë atë që u tha më lart, në bazë të nenit 47 (2) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe në bazë të rregullit 36 (1) të Rregullores së punës, Gjykata mund të konkludojë se kërkesa duhet refuzuar si e papranueshme.

41. Rrjedhimisht, në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës, në përputhshmëri me nenin 20 të Ligjit, dhe në përputhshmëri me rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhshmëri me nenin 47 (2) të Ligjit dhe në përputhshmëri me rregullin 36.1 të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe,

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 72/12 datë 17 dhjetor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr. 1053/2008, të 31 majit 2012

Rasti KI 72/12, vendim i 7 dhjetorit 2012
Fjalët kyçe: e drejta në gjykim të drejtë, e drejta në pronë, kërkesë individuale, kërkesë e pranueshme, masa të përkohshme

Parashtruesit kërkesën e paraqitën bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se të drejtat e tyre në pronë dhe në gjykim të drejtë ishin shkelur nga Inspektorati i Komunës së Prishtinës, Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe se në fund, këto shkelje, ishin konfirmuar me aktgjykim të Gjykatës Supreme.

Bazë e kërkesës së parashtruesve ishte pretendimi i tyre se Inspektorati i Komunës së Prishtinës kishte marrë vendim për rrënimin e dy shupave që ishin pronësi e parashtruesve, dhe se provat e ofruara nga parashtruesit tek Insepktorati i Komunës së Prishtinës ishin shpërfillur. Për më tepër, provat e parashtruesve ishin shpërfilur dhe nga Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe Gjykata Supreme e Kosovës.

Gjykata së pari vlerësoi nëse parashtruesit përmbushnin kriteret procedurale për pranueshmëri të kërkesës. Pas konstatimit se parashtruesit i përmbushin të gjitha kriteret procedurale të pranueshmërisë, Gjykata e shqyrtoi kërkesën e tyre në përmbajtje.

Gjykata kishte vërejtur se Sektori i Inspeksionit Komunal kishte vendosur të rrënonte shupat e parashtruesve, në mënyrë që të mbrojë hapësirën publike dhe të ndalojë keqpërdorimin e tyre. Sidoqoftë, vendimi i Sektorit të Inspeksionit Komunal ishte marrë pa vërtetuar në fillim nëse ka pasur ndonjë çështje pronësore që ka të bëj me shupat.

Gjykata theksoi se parashtruesit kishin ofruar prova të pronësisë përkitazi me shupat që ishin objekt i kontestit në Gjykatën Supreme porse gjykata në fjalë kishte shpërfillur ato prova, nuk kishte dhënë përgjigje shprehimore ndaj provave të ofruara, dhe kishte dhënë një vendim të paarsyetuar. Duke shqyrtuar kërkesën në përmbajtje të saj, Gjykata konstatoi se të drejtat e parashtruesve për t'u dëgjuar, dhe të

drejtat për vendim të arsyetuar, si komponentë të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanashëm ishin cenuar. Për shkak të arsyeve të përmendura, Gjykata vendosi: i) se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ii) shpall të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, A. no. 1053/2008, të 31 majit 2012; iii) kthen Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për rivendosje, në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese; dhe iv) lejon kërkesën për masë të përkohshme deri në rivendosjen e cështjes nga Gjykata Supreme e Kosoves sipas *ratio decidendi* të dhënë nga Gjykata Kushtetuese.

Prishtinë, më 07 dhjetor 2012

Nr. ref.:AGJ329/12

AKTGJYKIM

në

Rastin nr. KI 72/12

Parashtruesit

Veton Berisha dhe Ilfete Haziri

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,

A. nr. 1053/2008, të 31 majit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare,

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë Veton Berisha dhe Ilfete Haziri, me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, A. nr. 1053/2008, të 31 majit 2012, të cilin e kanë pranuar më 25 korrik 2012.

Baza juridike

3. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 dhe në nenin 27 të Ligjit, për Gjykatën Kushtetuese së Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 54 dhe 56.1 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Parashtruesit e kërkesës ankohen kundër rrënimit të shupave, që pretendohet të jenë në pronësi të parashtruesve të kërkesës, nëpërmjet vendimeve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës Civile në Komunën e Prishtinës, dhe të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, të cilat u konfirmuan nga Aktgjykimi i Gjykatës Supreme.

5. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të vendosë masë të përkohshme në pajtim me nenin 27 të Ligjit, në mënyrë që t'i mbrojë shupat prej rrënimit nga Inspektorati Komunal i Prishtinës.

Procedura në Gjykatë

6. Më 30 korrik 2012, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatë Kushtetuese.

7. Më 4 shtator 2012, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.

8. Më 1 tetor 2012, kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme dhe Kryetarit të Komunës së Prishtinës.

9. Më 5 tetor 2012, parashtruesit e kërkesës u njoftuan për regjistrimin e kërkesës.

10. Më 30 tetor 2012, parashtruesve iu kërkuan dokumente shtesë, për të plotësuar kërkesën e tyre, d.m.th. iu kërkuan dokumente shtesë për statusin e tanishëm të shupave.

11. Më 5 dhjetor 2012, Kolegji shqyrtues mbajti këshillime përkitazi me raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës dhe vendosjen e masës së përkohshme.

Përmbledhja e fakteve që kanë të bëjnë me Veton Berishën

12. Më 6 korrik 1990, Komuna e Prishtinës (Vendimi nr. 08-360-247) i dha parashtruesit të kërkesës, Veton Berisha, në përdorim banesën "që gjendet në Prishtinë XXX, Blloku banesor III, Ndërtesa 4, Nr. 1, hyrja në kat". Banesa ka "gjithsej sipërfaqe të banueshme 43.90 metra katrorë, ka 2 dhoma: 1 dhomë, 1 kuzhinë, 1 banjo, 1 WC, 1 paradhomë, korridor, ballkon, 1 tarracë, shpajz, 1 bodrum, shupë dhe garazh".
13. Më 16 korrik 1990, BVI për banim dhe lokale afariste nga Prishtina dhe parashtruesi i kërkesës nënshkruan kontratën nr. 1193/3127 për shfrytëzimin e banesës. Kontrata *inter alia* përcaktonte:

> *"Në bazë të aktvendimit të dhënësit të banesës, Kuvendi Komunal (KK) Prishtinë, nga Prishtina, 08 nr. 360-247, të datës 06.07.1990, organizata e dorëzon, kurse bartësi e pranon në shfrytëzim në kohë të pacaktuar banesën e cila gjendet në Prishtinë rr. XXX, Blloku III banesor, nr. 3/1, në katin 4, Hyrja në katin. Banesa ka gjithsej sipërfaqe banesore prej 43, 90 m² e përbëhet prej 2 dhomave: 1 dhomë, 1 kuzhinë, 1 banjo, 1 Wc, 1 paradhomë, 1 korridor, shpajz, ballkon, ter., _____ballk. të brendshëm, podrum, shupë dhe garazhë".*

"Bartësi do ta shfrytëzojë banesën– që është lëndë e kësaj kontrate së bashku me anëtarët e familjes. Bartësi obligohet *t'ia paguajë qiranë organizatës në shumën prej 40,00 dinarë. Ai ngarkohet prej 01.08.1990 dinarë* në muaj, më se voni deri më 5 të çdo muaji*".*

"Pjesë përbërëse e kësaj kontrate është procesverbali mbi dorëzimin e banesës bartësit i përpiluar në prezencën e të dy palëve kontraktuese më ... ku është konstatuar gjendja e banesës me rastin e pranimit në shfrytëzim".

14. Më 2 gusht 1992, parashtruesi i kërkesës ka blerë (kontrata nr. 06-360-9/92-7) banesën e përmendur nga Komuna e Prishtinës si shitëse. Kontrata e shitblerjes është lidhur në bazë të kontratës për shfrytëzimin e banesës nr. 1193/3127, të lidhur më 16 korrik 1990. Kontrata e blerjes *inter alia* përcakton:

"*Kuvendi Komunal i Prishtinës me adresë në Prishtinë, rruga e Trepçës Nr. 2 (*në tekstin e mëtejmë: Shitësi*) i përfaqësuar nga Novica Sojevic, KK Kryetari i Komunës dhe Veton Berisha (*Parashtruesi*) nga Prishtina* Blloku III banesor nr. *4 (në tekstin e mëtejmë: Blerësi)".*

"Palët kontraktuese konstatojnë se shitësi është bartës i së drejtës në posedim të banesës nr. 4. në rrugën Blloku III banesor nr 4 në Prishtinë, me sipërfaqe prej 43,90 m² i cili ndodhet na parcelën katastrale KOB, ZKUL dhe përbëhet prej 2 dhomave, 1 kuzhine, 1 banjo me WC, 1 paradhome, 1 korridori, një tarrace, shpajzi, dhe lokale të tjera të cilat Blerësi (Parashtruesi) i shfrytëzon si bartës i së drejtës banesore (qiramarrës në kohë të pacaktuar) në bazë të kontratës për shfrytëzimin e banesës, numër 1193/3127, të lidhur më 16.07.1990".

"Palët kontraktuese pajtohen që çmimi blerës i patundshmërisë nga neni 1. i kësaj kontrate më datën 2.08.1992 është 88.810 dinarë (me fjalë: tetëdhjetetetëmijë e tetëqind e dhjetë dinarë). Shitësi e shet kurse Blerësi e blen patundshmërinë nga neni 1 i kësaj kontrate sipas çmimit prej 2.023 din. për m² që gjithsej arrin shumën e kontraktuar prej 78.597 dinarë (me fjalë: shtatëdhjetetetëmijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë dinarë). Çmimi kontraktues nga paragrafi 1 i këtij neni është përcaktuar pas uljes së rregullt. Pjesë përbërëse e kësaj kontratë është llogaritja e çmimit kontraktues të banesës".

"Të drejtat dhe obligimet e Blerësit barten tek trashëgimtarët e tij".

"Në ditën e lidhjes së kësaj kontrate, pushojnë të gjitha të drejtat dhe obligimet e bartësit të së drejtës banesore (Qiramarrësit në kohë të pacaktuar) dhe sipas kësaj baze lidhet Kontrata për shfrytëzimin e banesës nga neni 3 i kësaj kontrate me kusht që Blerësi është i obliguar që të paguajë shpenzimet për investime dhe mirëmbajtje sipas mënyrës së rregulluar me Ligj".

"Palët kontraktuese pajtohen që shpenzimet lidhur me vërtetimin e Kontratës në gjyq dhe për regjistrimin e së drejtës në pronë dhe barrën e hipotekës në librat publike, t'i bart Blerësi".

15. Më 14 korrik 1995, Gjykata Komunale në Prishtinë, në padinë për dorëzimin e pronës së patundshme, me Aktgjykimin P. nr. 866/94, e urdhëroi palën e tretë t'ia dorëzojë parashtruesit shupën për shfrytëzim dhe për posedim. Gjykata Komunale në Prishtinë arsyetoi:

"Në bazë të kontratës për blerjen e banesës vert. Nr. 12709/93 të datës 2.12.1993 gjykata ka vërtetuar se paditësi si bartës i së drejtës banesore nga komuna e Prishtinës si bartëse e së drejtës së posedimit, ka blerë banesën në bllokun e tretë banesor nr. 4, me sipërfaqe prej 43,90 m² dhe i cili përbëhet nga 2 dhoma, një kuzhinë, një paradhomë, një shpajz, një fllanik dhe një shupë".

"Nga Pl. Nr. 1.00 KK Prishtina të datës 3.02.1995 gjykata gjen se paditësi është regjistruar si pronar i banesës së blerë në Drejtorinë e gjeodezisë komunale të Prishtinës".

"Me dispozitën e nenit 20, paragrafi 1 i Ligjit mbi të drejtat themelore pronësore juridike është rregulluar që e drejta e pronësisë arrihet sipas vetë Ligjit në bazë të çështjes juridike dhe në bazë të trashëgimisë. Meqë paditësi ka fituar banesën në shfrytëzim së bashku me shupën kontestuese dhe atë e ka blerë në bazë të kontratës së përmendur ai ka të drejtë pronësie <u>edhe në shupë</u> si pjesë e tërësisë kryesore".

16. Më 30 gusht 2002, Drejtoria e Financave dhe Pronës e KK të Prishtinës përcakton *inter alia* (Vendimi 02, No. 03-2/2743) si vijon:

"Veton Berishës nga Prishtina i CAKTOHET taksa në transaksion të pronës së patundshme në shumë prej <u>100</u> euro.

Baza për caktimin e kësaj takse është marrë nga Aktgjykimi mbi vërtetimin e shitblerjes së pronës së patundshme e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë nr. 866/94 të 14 korrikut 1995.

... Nga dokumentacioni mund të shihet se Aktgjykimi mbi vërtetimin e shitblerjes së pronës së patundshme ndërmjet V. K. dhe Veton Berisha, objekt të shitblerjes ka 1 njësi (parcelë-at) të evidentuar në Fletën Poseduese nr. III Komuna Kadastrale III me kulturë shupë, ku secila njësi paguhet nga 100 euro".

Përmbledhja e fakteve që kanë të bëjnë me Ilfete Hazirin

17. Më 1 shkurt 1977, BVI (Bashkësia Vetëqeverisëse e Interesit) për Banim dhe Lokale Afariste nga Prishtina dhe Nazmi Haziri (bashkëshorti i ndjerë i Ilfete Hazirit) nënshkruan kontratën nr. 1193/3125 për shfrytëzimin e banesës. Banesa ka "gjithsej sipërfaqe të banueshme 43.90 metra katrorë, ka 2 dhoma gjumi; 1 kuzhinë, 1 banjo, 1 WC, 1 paradhomë, korridor, ballkon, 1 tarracë, shpajz, 1 bodrum, shupë dhe garazh.

18. Më 11 prill 1996, Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike e Komunës së Prishtinës, lëshoi vërtetimin nr. 2218/96, me të cilin Ilfete Haziri njihet si blerëse. Më tej, dëftesa tregon se Ilfete Haziri, Blloku banesor 3, Numër 3, Prishtinë, ka paguar me qëllim të blerjes së banesës.

Përmbledhja e fakteve për të dy parashtruesit e kërkesës

19. Më 20 qershor 2008, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës Civile – Inspektorati në Komunën e Prishtinës urdhëroi (Vendimi 07, No. 355-15711) "rrënimin e menjëhershëm të 3 shupave në hapësirë publike". Inspektorati arsyetoi se "shupat janë në hapësirë publike" dhe "po keqpërdoren për nevoja të ndryshme fiziologjike".

20. Më 30 qershor 2008, parashtruesit paraqitën ankesë kundër Vendimit të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit të Komunës së Prishtinës. Ata "ashpër ankohen për mënyrën dhe

procedurën e veprimit të një personi që ka hartuar dhe miratuar këtë vendim" dhe pretendojnë që *"para Vendimit për rrënim, organi i lartpërmendur duhet të ketë analizuar çështjet që lidhen me dokumentacionin e objekteve të dhëna, të paktën të kërkojë me shkrim nga pronari i lokaleve nëse ka ndonjë dokumentacion për pronësinë"*.

21. Në mbështetje të ankesës, ata ofruan "prova në lidhje me pronësinë e shupave të lartpërmendura", d.m.th.: shënimet kadastrale të pjesës së lagjes Dardania, ku mund të shihet ekzistimi i shupës; dy kontrata për përdorimin e banesës, ku mund të shihet ekzistimi i shupës; dy kontrata të shitblerjes së banesës; Aktgjykimin nr. 866/94 (i cili ka të bëjë me shupën); Vendimin e Drejtorisë së Financave dhe Pronës së KK të Prishtinës (i cili ka të bëjë me shupën); dhe Vendimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës Civile, Sektori i Inspeksionit Komunal.

22. Më 14 korrik 2008, Kryetari i Komunës së Prishtinës hodhi poshtë ankesën, "sepse në bazë të kontrollit inspektues, të bërë nga inspektorët e autorizuar, është konstatuar se shupat e vendosura në sipërfaqen publike janë duke u keqpërdorur në forma të ndryshme, andaj, me qëllim të mbrojtjes së sipërfaqes publike, u vendos të bëhet rrënimi i objekteve të lartpërmendura dhe se ankuesit nuk e arsyetojnë me asnjë provë faktin se këto objekte janë të ndërtuara me leje ndërtimi".

23. Më 20 gusht 2008, parashtruesit paraqitën ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, me të cilën kërkonin "të vërtetohet se paditësit Veton Berisha dhe Ilfete Haziri, me adresë në 'Musine Kokollari', nr. 3 dhe 4, janë PRONARË të kësaj patundshmërie – SHUPAT, dhe të shtëpive sipas kontratës për shitblerjen dhe dokumentet tjera".

24. Parashtruesit e ankesës në Gjykatën Kushtetuese pretendonin se "përkundër faktit se kemi ushtruar ankesë dhe i kemi prezantuar këto argumente – PROVA, shkalla e dytë e ka refuzuar ankesën e paditësve [Parashtruesve], dhe as që i ka marrë në konsideratë këto prova".

25. Parashtruesit më tej pretendonin se ata "janë posedues të përhershëm dhe legjitim të këtyre shupave dhe shtëpive, do të thotë të kësaj patundshmërie". Prandaj, ata kërkuan nga Gjykata Supreme "t'i prezantojë dhe nxjerr provat e propozuara në seancën e shqyrtimit".

26. Më 31 maj 2012, Gjykata Supreme (A. no. 1053/2008), hodhi poshtë ankesën e parashtruesve, duke gjetur se *"Vendimi i kontestuar është i drejtë dhe i bazuar në ligj, kurse pretendimet e padisë nuk ndikojnë në vërtetimin e një gjendjeje tjetër faktike"*.

27. Më 20 shator 2012, me kërkesë të Gjykatës, parashtruesit informuan me gojë se shupat janë ende të paprekura dhe të parrënuara.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

28. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se nga autoritetet publike ishin shkelur të drejtat e tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si dhe e drejta e tyre e pronës, por, ata nuk thirren në ndonjë dispozitë të posaçme kushtetuese. Sidoqoftë, bazuar në deklaratat e tyre, Gjykata konsideron se ata pretendojnë shkeljen e nenit 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

29. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, A. nr. 1053/2008, i 31 majit 2012, është i gabuar, sepse ai hedh poshtë padinë e parashtruesve për vërtetimin e të drejtave pronësore, për të cilat ata pretendojnë se kanë dëshmi të pakontestueshme.

30. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, A. no. 1053/2008, i 31 majit 2012, nuk i ka marrë parasysh të gjitha dëshmitë e prezantuara nga ta dhe të cilat përfshijnë: (1) kontratën e shitblerjes së banesës, e cila i përfshin edhe shupat, dhe (2) Aktgjykimin e formës së prerë,

Nr. 866/94, të 14 korrikut 1995, nga Gjykata Komunale në Prishtinë.

31. Për më tepër, parashtruesit kërkojnë që Gjykata Kushtetuese:

a) "Ta anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, A. nr. 1053/2008, të 31 majit 2012, (...) dhe aktgjykimin e vlefshëm me të cilin është vërtetuar pronësia"; dhe

b) Të vendosë masën e përkohshme në pajtim me nenin 27 të Ligjit, në mënyrë që "t'i mbrojë objektet (shupat) nga rrënimi nga ana e Inspektoratit Komunal të Prishtinës. Kjo masë është e nevojshme për t'i shmangur rreziqet ose dëmet e pariparueshme".

Pranueshmëria e kërkesës

32. Në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të gjykojë sa i përket ankesës së parashtruesve të kërkesës, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesit e kërkesës kanë plotësuar kushtet e pranueshmërisë që parashihen me Kushtetutë, siç janë specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

33. Neni 113.1 i Kushtetutës parasheh:

"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".

34. Neni 113.7 i Kushtetutës parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

35. Në rastin e tanishëm, Gjykata vëren se parashtruesit kanë kërkuar mbështetje për t'i mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre me procedurë administrative në dy organe të Komunës së

Prishtinës dhe, përfundimisht, në Gjykatën Supreme të Kosovës. Prandaj, parashtruesit janë palë të autorizuara dhe i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë dhe rrjedhimisht i plotësojnë të gjitha kriteret e pranueshmërisë sipas nenit 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës.

36. Neni 49 i Ligjit parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi*".

37. Nga dokumentet e dorëzuara mund të kuptohet se parashtruesit e kanë pranuar vendimin e Gjykatës Supreme më 25 korrik 2012, dhe e kanë dorëzuar kërkesën e tyre në Gjykatë më 30 korrik 2012. Kërkesa është dorëzuar sipas afatit të paraparë me nenin 49 të Ligjit.

38. Në rastin në fjalë, Gjykata është e bindur se janë përmbushur kërkesat kumulative procedurale për të qenë një palë e autorizuar, paraqitja e kërkesës brenda afatit ligjor dhe shterimi i mjeteve juridike. Kërkesa është e pranueshme dhe Gjykata tani do të shqyrtojë dhe do të vlerësojë meritat e çështjes.

Meritat

39. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Supreme (Aktgjykimi A. no. 1053/2008, i 31 majit 2012) nuk i ka marrë parasysh të gjitha provat e parashtruara nga ata për të drejtën pronësore dhe ku bën pjesë edhe kontrata e shitblerjes së banesës, e cila gjithashtu i përfshin shupat.

40. Në të vërtetë, Gjykata vëren se parashtruesit i kanë paraqitur dokumentet në vijim: shënimet kadastrale të një pjese të lagjes Dardania, ku mund të shihet ekzistenca e shupave; dy kontrata për shfrytëzimin e banesës, ku mund të shihet ekzistenca e shupave; dy kontrata për shitblerjen e banesës; Aktgjykimin nr. 866/94 (që ka të bëjë me shupat); Vendimin e Drejtorisë së Financave dhe Pronës (që ka të bëjë me shupat); dhe Vendimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës Civile, Sektori i Inspeksionit Komunal.

41. Parashtruesit argumentuan në Gjykatën Supreme se "edhe përkundër faktit se kemi (...) prezantuar këto argumente – PROVA, Shkalla e dytë, e ka refuzuar ankesën e paditësve, dhe as qe i ka marrë ne konsideratë këto prova". Ata përfunduan më tej duke kërkuar nga Gjykata Supreme "të nxjerr provat e propozuara në seancën e shqyrtimit" dhe "të vërtetoj se paditësit Veton Berisha dhe Ilfete Haziri (...) janë PRONARË të kësaj patundshmërie – SHUPAVE dhe shtëpive sipas kontratave për shitblerje dhe dokumenteve tjera".

42. Gjykata vëren se Sektori i Inspeksionit Komunal kishte vendosur të rrënonte shupat e lartpërmendura, në mënyrë që të mbrojë hapësirën publike dhe të ndalojë keqpërdorimin e tyre. Sidoqoftë, vendimi i lartpërmendur i Sektorit të Inspeksionit Komunal ishte marrë pa vërtetuar në fillim nëse ka pasur ndonjë çështje pronësore që ka të bëjë me shupat.

43. Gjykata vëren se Kryetari i Komunës së Prishtinës arsyetoi se shupat ishin duke u keqpërdorur dhe ishte urdhëruar që ato të rrënoheshin në mënyrë që të mbrohej hapësira publike dhe argumentet për pronësi, të sjella nga parashtruesit e kërkesës, nuk e kishin vërtetuar në asnjë mënyrë, me prova, se shupat e rrënuara ishin të ndërtuara me leje për ndërtim. Kryetari i Komunës nuk ofroi një përgjigje të qartë ndaj parashtresave të parashtruesve të kërkesës përkitazi me pronësinë e shupave.

44. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme e arsyetoi aktgjykimin e saj si vijon:

"Gjykata vlerësoi se pretendimet e paditësve janë të pabazuara, sepse janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga organet administrative deh me provat që ndodhen në shkresat e lëndës. Paditësit nuk i kanë argumentuar me asnjë provë pretendimet e veta për t'i mbështetur ato, kurse provat që kanë paraqitur nuk kanë ndikim në marrjen e një vendimi tjetër në këtë çështje juridike".

"Në Nenin 56.1 të Ligjit të Procedurës Administrative parashikohet që barra e të provuarit të fakteve të paraqitura bie mbi palën e interesuar në konfliktin administrativ, pa marrë parasysh detyrimin e administratës që t'u vërë në dispozicion palëve provat që i disponon ajo".

"Sipas vlerësimit të Gjykatës, vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë. Nisur nga kjo gjendje e çështjes, kjo Gjykatë konstatoi se gjendja faktike e kësaj çështjeje administrative është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditësve, prandaj nuk i pranoi pretendimet e paditësve, sepse nuk kanë ndikim në konstatimin e ndonjë gjendje tjetër nga ajo që kanë vërtetuar organet administrative".

"Në bazë të asaj që u tha më sipër, Gjykata konstatoi se vendimi i kontestuar është i drejtë dhe i bazuar në ligj, kurse pretendimet e padisë nuk ndikojnë në vërtetimin e një gjendjeje tjetër faktike".

45. Gjykata Supreme nuk ofroi asnjë përgjigje të qartë përkitazi me parashtresat e parashtruesve të kërkesës për të drejtat e pronës sa i përket shupave të lartpërmendura, por, në vend të kësaj,

theksoi se "*pretendimet e paditësve janë të pabazuara"* dhe "*paditësit nuk i kanë argumentuar me asnjë provë pretendimet e veta për t'i mbështetur ato, kurse provat që kanë paraqitur nuk kanë ndikim në marrjen e një vendimi tjetër në këtë çështje juridike".*

46. Gjykata Supreme nuk përshkruan se cilat ishin pretendimet, cilat *"ishin provat që ata i kishin prezantuar",* çfarë "*ndikimi në marrjen e një vendimi tjetër",* dhe as çka ishte "*çështja juridike"* për të cilën bëhej fjalë. Këto janë deklarata të përgjithshme, pa arsyetim ligjor dhe pa bazë logjike, pasi që argumenti i parashtruesve dhe provat e paraqitura nga ata kanë të bëjnë me thelbin e rastit, d.m.th. me rrënimin e kontestuar të pronës, e cila pretendohet se u takon parashtruesve.

47. Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës thotë:

> *1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
>
> *2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet (...)*

48. Në anën tjetër, paragrafi 1, i nenit 6 [E drejta për proces të rregullt] i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: Konventa), thotë:

> *"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile".*

49. Për më tepër, e drejta për një gjykim të drejtë, siç është mishëruar në tekstet kushtetuese dhe në nenin 6 të Konventës, është e natyrës thelbësore për t'i mbrojtur të drejtat themelore, në këtë rast të drejtën e pronës.

50. Në të vërtetë, neni 46 [Mbrojtja e Pronës], përcakton:

> *1. E drejta e pronës është e garantuar.*
>
> *2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
>
> *3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj ekspropriimin e pronës nëse ky ekproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.*
>
> *4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*

51. Përveç kësaj, neni 1, i Protokollit 1 [Mbrojtja e Pronës], i Konventës thekson:

> *"Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e*

parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera".

52. Përfundimisht, neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] përcakton:

Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

53. Prandaj, parashtruesit e kërkesës kanë të drejtë të marrin një vendim gjykate në harmoni me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), kur "kontestet lindin nga një akt i Republikës së Kosovës, ose nga autoriteti publik i Republikës së Kosovës". Kjo e drejtë përfshin obligimin e gjykatave që të ofrojnë arsye për vendimet e tyre, me bazë të arsyeshme, në nivelin procedural dhe material. E drejta për të pasur arsye për vendime të gjykatës kërkon shpjegime me arsye bindëse dhe ligjërisht të ndërtuara mirë për vendimin e marrë në çdo rast individual.

54. Kështu, e drejta për një gjykim të drejtë përfshin të drejtën për një aktgjykim të arsyetuar. GJEDNJ-ja konsideron se, derisa autoritetet gëzojnë liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme për të siguruar se sistemet e tyre gjyqësore janë në përputhje me kërkesat e nenit 6(1) të Konventës, gjykatat e tyre duhet "t'i tregojnë me qartësi të mjaftueshme bazat mbi të cilat e kishin bazuar vendimin e tyre". (Shih, *Hadjianastassiou vs. Greqisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33).

55. Në një aktgjykim të kohës së fundit, GJEDNJ përsëriti se "aktgjykimet e gjykatave dhe të tribunaleve duhet t'i theksojnë në mënyrë adekuate arsyet në të cilat ata bazohen". (Shih, *Tatishvili vs. Rusisë,* Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58).

56. Neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës i obligojnë gjykatat të japin arsye për aktgjykimet e tyre. Sidoqoftë, kjo nuk nënkupton të kërkuarit e përgjigjes së detajuar në çdo argument apo pyetje (Shih, *Van de Hurk vs. Holandës*, 19 prill 1994, paragrafi 61). Masa deri në të cilën aplikohet obligimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit. Megjithatë, nëse parashtresa është me rëndësi thelbësore për rezultatin e rastit, pasi që është pronë në një rast të rrënimit, atëherë gjykata duhet të merret në mënyrë të veçantë me të në aktgjykimin e saj.

57. Një funksion tjetër i vendimit të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar. Për më tepër, një vendim i arsyetuar i ofron mundësinë palës për t'u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e rishikimit të vendimit nga një organ ankimor. Vetëm duke lëshuar vendim të arsyetuar, mund të ketë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë. (Shih, *Tatishvili vs. Rusisë,* Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58).

58. Veç kësaj, e drejta e marrjes së vendimit gjyqësor në harmoni me ligj, përfshin obligimin e gjykatave të ofrojnë arsye për aktvendimet e tyre me baza të arsyeshme në nivel procedural dhe material. Sigurimi i arsyeve kërkon shpjegime me arsye bindëse dhe të ndërtuara mirë për vendimin e marrë në çdo rast individual, i cili duhet të përfshijë që të dyja: kriteret ligjore dhe elementet faktike në mbështetje të vendimit.

59. Në rastin *Hiro Balani vs. Spanjës*, parashtruesi kishte paraqitur parashtresë në gjykatë, me të cilën kërkonte përgjigje të veçantë dhe të qartë. Gjykata dështoi ta japë atë përgjigje, duke e bërë të pamundur konstatimin se nëse ajo thjesht e kishte lënë pas dore të merret me çështjen ose e kishte ndërmend ta refuzojë dhe nëse është ashtu, cilat ishin arsyet

për refuzimin e saj. Nga GJEDNJ-ja u gjet se kjo ishte shkelja e nenit 6 (1) të Konventës.

60. Rrjedhimisht, deklarata e arsyeve duhet t'i mundësojë personit, të cilit i drejtohet vendimi dhe opinionit në përgjithësi, për ta ndjekur arsyetimin, i cili e çoi gjykatën të marrë vendimin konkret.

61. Prandaj, arsyetimi i vendimit duhet ta theksojë raportin ndërmjet gjetjeve të meritave dhe reflektimit, kur t'i shqyrtojë provat e propozuara nga një anë dhe konkluzionet ligjore nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do ta shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, nëse arsyetimi i dhënë dështon të përmbajë fakte të vërtetuara dhe dispozita ligjore si dhe marrëdhënien logjike ndërmjet tyre.

62. Gjykata vëren se, në rastin në fjalë, arsyetimi i Gjykatës Supreme nuk është mjaftueshëm i shprehur dhe i përpunuar, pasi që raporti ndërmjet provave përkatëse, vlerësimit relevant të dispozitave të aplikueshme ligjore dhe gjetjeve të meritave nuk është konstatuar në mënyrë të qartë dhe të plotë.

63. Në këtë mënyrë, Gjykata konsideron se dështimi i Gjykatës Supreme të sigurojë përgjigje të qarta dhe të plota *vis-à-vis* kërkesave pronësore kritike i shkel të drejtat e parashtruesit që të dëgjohet, si dhe të drejtën për një vendim të arsyetuar, si një element i së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

64. Prandaj, Gjykata konkludon se ka shkelje të nenit 31 [E drejta për një Gjykim të drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës.

Masa e përkohshme

65. Siç u tha më lart, parashtruesi kërkoi nga Gjykata të vendosë masën e përkohshme, "në pajtim me nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Nr. 03/L-121, në lidhje me rastin që është objekt i procedurës për mbrojtjen e objekteve (shupave) nga rrënimi nga ana e Inspektoratit Komunal të Prishtinës".

Parashtruesi më tej thekson se "kjo masë është e nevojshme për të mënjanuar rrezikun ose dëmin e pariparueshëm.

66. Gjykata gjithashtu përfundon se kërkesa për masë të përkohshme është e bazuar dhe e arsyetuar në objektin e çështjes që ka të bëjë me pronën e patundshme. Për më tepër, Gjykata konsideron se kompensimi i mundshëm në të holla nuk korrigjon dëmin e pariparueshëm që do t'i bëhej parashtruesit nëse shupat do të rrënoheshin, sepse prona e patundshme është unike, si edhe shupat.

67. Në të vërtetë, objekti i çështjes ka të bëjë kryesisht me një urdhër të kontestuar për rrënimin e shupave në pronësi të pretenduar nga parashtruesit, nëpërmjet vendimeve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave në Komunën e Prishtinës dhe të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, të cilat u vërtetuan nga Aktgjykimi i Gjykatës Supreme.

68. Gjykata konsideron se prona e pretenduar dhe rrënimi i urdhëruar janë çështje të lidhura ligjore dhe të ndërthurura njëra me tjetrën, prandaj, si duket, Vendimi i Kryetarit të Komunës së Prishtinës, 01. Nr. 07-15711, i 14 korrikut 2008, me të cilin është urdhëruar rrënimi dhe zbatimi i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr. 1053/2008, i 31 majit 2012, mund të rezultojë në dëm të pariparueshëm për parashtruesit, duke ekzekutuar rrënimin e lartpërmendur.

69. Prandaj, Gjykata, në pajtim me nenin 116(2) të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 27 të Ligjit, më 5 dhjetor 2012, pa paragjykuar rezultatin përfundimtar të çështjes kontestuese, vendos për dhënien e masës së përkohshme, nga data e miratimit të vendimit e deri në rishqyrtimin përfundimtar nga Gjykata Supreme dhe që menjëherë ta pezullojë zbatimin e urdhrit për rrënim, siç është vërtetuar nga Aktgjykimi i Gjykatës Supreme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në seancën e 5 dhjetorit 2012, njëzëri:

SHPALL kërkesën si të pranueshme;

I. KONSTATON se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E Drejta për Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

II. SHPALL të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, A. no. 1053/2008, e 31 majit 2012;

III. KTHEN Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për rivendosje, në përputhje me aktgjykimin e kësaj Gjykate;

IV. LEJON kërkesën për masë të përkohshme deri në rivendosjen e çështjes nga Gjykata Supreme e Kosovës sipas *ratio decidendi* të kësaj Gjykate;

V. MBETET e përkushtuar ndaj çështjes në pritje të respektimit të atij urdhri;

VI. URDHËRON që ky aktgjykim t'u komunikohet palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, të publikohet në Gazetën Zyrtare; dhe

VII. DEKLARON se ky aktgjykim është efektiv menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Almiro Rodrigues	Prof. Dr. Enver Hasani

KO 63/12 datë 13 dhjetor 2012- Kërkesa e Alma Lamës dhe e 10 deputetëve të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82

Rasti KO 63/12, vendim i 10 dhjetorit 2012

Fjalët kyçe: Kodi Penal i Republikës së Kosovës, kërkesë e deputetëve të kuvendit, liria e shprehjes, liria e medieve, prezumimi i kushtetutshmërisë së ligjeve, përgjegjësia penale e medieve, mbrojtja e burimit të informatës

Parashtruesit paraqitën kërkesën bazuar në Nenin 113.5 të Kushtetutës së Kosovës duke pohuar se nenet 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës janë në kundërshtim me Kushtetutën. Parashtruesit pohuan se nenet e kontestuara janë në kundërshtim në kundërshtim me dispozitat kushtetuese që garantojnë lirinë e medieve dhe lirinë e shprehjes, si dhe ne kundërshtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, respektivisht dispozitat që mbrojnë lirinë e shprehjes.

Neni 37 i Kodit Penal rregullon çështjen e përgjegjësisë penale të kryeredaktorëve, botuesve, shtypshkronjave apo prodhuesve të publikimit të informative me anë të të cilave është kryer vepra penale, neni 38 rregullon mbrojtjen e burimit të informatës dhe neni 39 rregullon zbatimin e dispozitave të përgjithshme për përgjegjësinë penale për veprat penale të kryera me anë të medieve. Parashtruesit pohojnë se formulimi i këtyre neneve është mjaft i gjerë pa specifikuar veprat penale që mund të kryhen përmes medieve, dhe si të tilla rrezikojnë seriozisht lirinë e gazetarëve gjatë kryerjes së profesionit të tyre që përbën një pjesë jetike të funksionimit të demokracisë në Kosovë.

Gjykata konstatoi se parashtruesit janë palë e autorizuar dhe kërkesa është parashtruar brenda afatit të paraparë kohor, ata i kanë

përmbushur të gjitha kriteret e pranueshmërisë dhe, si rrjedhojë, kërkesa e tyre është e pranueshme.

Meqenëse Gjykata paraprakisht kishte vendosur për shtyrjen e këtij rasti, për të pritur rezultatet e një procesi legjislativ të iniciuar në kuvend për fshirjen e tre neneve kontestuese nga Kodi penal, e që paraqet një element të rëndësisë së veçantë për trajtimin e kërkesës së parashtruesit. Ndërkohë më 2 nëntor u përmbyll procesi legjislativ, respektivisht në Kuvendin e Kosovës u aprovua Ligji 04/L-129 që heq nga Kodi Penal tre nenet e kontestuara.

Duke marrë parasysh ngjarjen e papritur legjislative që ka ndodhur, Gjykata konkludon se parashtruesit e kërkesës tani nuk kanë rast apo kontest të pazgjidhur në lidhje me kushtetutshmërinë e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal. Çështja është faktikisht pa objekt shqyrtimi.

Prishtinë, më 10 dhjetor 2012

Nr. ref.:VTK327 /12

VENDIM PËR HEQJE TË KËRKESËS NGA LISTA

në

Rastin KO 63/12

Kërkesa e Alma Lamës dhe e 10 deputetëve të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësimin e

kushtetutshmërisë së neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë deputetët e Kuvendit të Kosovës: Alma Lama, Visar Ymeri, Rexhep Selimi, Afrim Kasolli, Albulena

Haxhiu, Albana Fetoshi, Albana Gashi, Glauk Konjufca, Albin Kurti, Florin Krasniqi dhe Afrim Hoti.

Objekti i çështjes

2. Kërkesa ka të bëjë me kushtetutshmërinë e neneve 37, 38 dhe 39 të **Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Nr. 04/L-82** (në tekstin e mëtejmë: Kodi Penal), të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, më 20 prill 2012, dhe të shpallur me vendim të Kuvendit më 22 qershor 2012.

3. Më saktësisht, parashtruesit e kërkesës i shtrojnë këtë pyetje Gjykatës Kushtetuese: "*A cenojnë nenet 37, 38, 39 të Kodit Nr. 04-L-082 Penal të Republikës së Kosovës të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Nenet 40 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me Nenin 10 te Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj*".

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenin 20 dhe 43 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë pas nxjerrjes së Vendimit për Pranueshmëri dhe Shtyrje nr. ref. VP318/12 i publikuar më 29 tetor 2012

5. Më 18 tetor 2012 Gjykata Kushtetuese vendosi ta shpallë kërkesën të pranueshme, të shtyjë vendimin për meritat e

kërkesës deri më 15 dhjetor 2012 dhe të mbetet e përkushtuar në këtë çështje.

6. Përveç kësaj, Gjykata kërkoi nga Kuvendi i Kosovës informacione për statusin e procedurës legjislative në lidhje me heqjen e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal, Ligjit nr. 04/L-82 të Republikës së Kosovës.

7. Më 12 nëntor 2012, Gjykata Kushtetuese e mori një letër nga Kryetari i Kuvendit të Republikës, me të cilën Gjykata njoftohet se "*Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur më 19 tetor 2012, e ka miratuar Ligjin nr. 04/1-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 04/L-082. Me miratimin e Ligjit nr. 04/1-129 janë shfuqizuar nenet 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës".* Për më tepër, letrës së 12 nëntorit i ishte bashkëngjitur Dekreti DL-048-2012 për shpalljen e Ligjit nr. 04/1-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës i 2 nëntorit 2012 i nënshkruar nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

8. Më 15 nëntor 2012, Alma Lama dorëzoi një shkresë në Gjykatë me të cilën kërkon disa sqarime përkitazi me Vendimin për Pranueshmëri dhe Shtyrje.

9. Më 5 dhjetor 2012, Gjykata mbajti këshillime për meritat e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve pas nxjerrjes së Vendimit për Pranueshmëri dhe Shtyrje

10. Më 19 nëntor 2012, Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin nr. 04/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Kosovës, Ligji nr. 04/L-082, duke përcaktuar si në vijim:

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim heqjen e neneve 37, 38 dhe 39 nga Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

Neni 2

Shfuqizimet në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Nenet 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës hiqen.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi me 1 janar 2013.

11. Më 29 tetor 2012, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës ia dorëzoi këtë ligj Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje.

12. Më 2 nëntor 2012, Kryetari i Republikës së Kosovës me Dekretin nr. DL-048-2012 e shpalli Ligjin nr. 04/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Vlerësimi i meritave të kërkesës

13. Kodi Penal i Kosovës duhet të hyjë në fuqi më 1 janar 2013, siç është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 20 prill 2012, dhe i shpallur me vendim të Kuvendit më 22 qershorit 2012.

14. Gjykata, në vendimin e saj për pranueshmëri dhe shtyrje mori parasysh se nenet e kontestuara 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal u miratuan nga Kuvendi i Kosovës më 20 prill 2012 dhe u shpallën me vendim të Kuvendit më 22 qershor 2012.

15. Sidoqoftë, dispozitat e kontestuara nga ana e parashtruesve të kërkesës u bënë objekt i një iniciative tjetër legjislative, një debati dhe miratimi nga Kuvendi i Kosovës. Në të vërtetë ky proces legjislativ u përmbyll më 2 nëntor 2012 me shpalljen e Ligjit nr. 04/L-129.

16. Neni 2 i këtij Ligji me nr. 04/L-129 përcakton që "*Nenet 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës hiqen"* kurse në nenin 3 thuhet se *"Ky ligj hyn në fuqi me 1 janar 2013."*

17. Prandaj, heqja e neneve 37, 38 dhe 39 nga Kodi Penal garantohet me hyrjen e njëkohësishme të Kodit Penal, Ligji nr. 04/L-082, dhe me Ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Ligjin nr. 04/L-129.

18. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se ky proces legjislativ është fakt i papritur që është relevant dhe ndikon në mënyrë substanciale në kërkesën e parashtruesve në bazat dhe themelësinë e saj.

Vendimi për heqje nga lista

19. Gjykata konsideron se ngjarja e papritur legjislative tregon se pozita e parashtruesve të kërkesës ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme. Pozita e tanishme është e tillë që kërkesa nuk ka arsyetim dhe qëllimi që kanë kërkuar të arrijnë është arritur plotësisht. Në dritën e kësaj, Gjykata konsideron se nuk ka më merita për të shqyrtuar më tutje këtë çështje.

20. Sidoqoftë, Gjykata e ka kompetencën dhe detyrën që të adresojë këtë çështje posaçërisht duke pasur parasysh Rregulloren e vet të punës.

21. Në të vërtetë, rregulli 32 (4) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese thotë se Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë kur konstaton se pretendimet janë pa objekt shqyrtimi apo nuk paraqesin më rast apo kontest. Ky rregull në pjesën relevante parashikon si në vijim:

Rregulli 32

Tërheqja e kërkesës dhe përgjigjes

(4) Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme ose që nuk përfaqësojnë një rast ose kontest.

(5) Sekretariati njofton të gjitha palët me shkrim për çfarëdo tërheqje, për çfarëdo vendimi të Gjykatës për të vendosur në lidhje me kërkesën, pavarësisht tërheqjes së saj, dhe për çfarëdo vendimi për ta hedhur poshtë kërkesën para vendimit përfundimtar.

22. Po ashtu, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut në pjesën relevante parashikon si në vijim:

Neni 37 Çregjistrimi i kërkesave

1. Në çdo fazë të procedimit, Gjykata mund të vendosë të çregjistrojë një kërkesë, kur rrethanat çojnë në përfundimin se:

a. kërkuesi nuk ka ndërmend ta vazhdojë çështjen; ose

b. çështja është zgjidhur; ose

c. për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës.

23. Si parim i përgjithshëm procedural, Gjykata nuk duhet të nxjerrë vendime për raste ku çështja nuk ekziston më dhe rasti mbetet pa objekt shqyrtimi. Gjykatat nuk merren me raste hipotetike apo akademike. Ky është parim i pranuar botërisht për sjelljen e gjykatave dhe është analog me parimin e vetëpërmbajtjes gjyqësore.

24. Për më tepër, Gjykata tashmë ka përcaktuar (në rastin 11/09, Vendimi nr. VHL112/11 të 30 majit 2012, paragrafi 46) se "Koncepti i të qenët pa objekt shqyrtimi është koncept i mirënjohur ligjor. Mund të paraqitet në një rast kur një çështje abstrakte apo hipotetike paraqitet për t'u vendosur në Gjykatë. Ka baza të mira që një Gjykatë të mos merret me situata hipotetike. Pa një çështje të vërtetë, të menjëhershme apo konkrete për të cilën duhet të vendoset, Gjykata mund të devijojë në marrjen e vendimeve që e obligojnë atë dhe publikun pa pasur arsye të mirë për të çfarëdo vendimi që Gjykata merr tani lidhur me këtë kërkesë nuk do të ketë efekt praktik".

25. Duke marrë parasysh ngjarjen e papritur legjislative që ka ndodhur dhe atë që u tha më lart, Gjykata konkludon se parashtruesit e kërkesës tani nuk kanë rast apo kontest të pazgjidhur në lidhje me kushtetutshmërinë e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal. Çështja është faktikisht pa objekt shqyrtimi.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 32 (4) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, njëzëri:

VENDOS

I. TA HEQË NGA LISTA kërkesën në pajtim me rregullin 32.4 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit do të publikohet në Gazetën Zyrtare.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Prof. Dr. Enver Hasani

KI 78/12 datë 14 dhjetor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012

Rasti KI 78/12, Vendim për masë të përkohshme të 24 shtatorit 2012

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, masë e përkohshme, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, shkelje e të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën e tij bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke e kontestuar aktgjykimin, Pkl. Nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012, sepse Gjykata Supreme pa ndonjë arsyetim të fortë, nuk i kishte shqyrtuar provat e propozuara nga mbrojtja. Për më tepër, mbrojtja kërkoi masë të përkohshme, sepse "Nëse një aktgjykim i favorshëm nga Gjykata Kushtetuese do të shkaktonte rigjykim të mundshëm të këtij rasti ku Parashtruesi do të mund të lirohej nga përgjegjësia, atëherë mungesa e kësaj mase të përkohshme do të linte Parashtruesin me një vuajtje të jashtëligjshme të një dënimi të pameritуar." Lidhur me çështjen e masës së përkohshme, gjykata konkludoi se pa paragjykuar vendimin përfundimtar të kërkesës, parashtruesi i kërkesës ka ofruar argumente mjaft bindëse se zbatimi i vendimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 70/2012 të 22 qershorit 2012, dhe i urdhër dënimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 485/09 të 26 nëntorit 2010, si dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Ap. nr. 134/2011 të 8 marsit 2012 dhe privimi i tij nga liria mund të rezultonin me dëmtimin e pariparueshëm të parashtruesit të kërkesës. Prandaj, Gjykata lejoi masën e përkohshme në kohëzgjatje deri më 31 dhjetor 2012 duke filluar nga data e miratimit të këtij Vendimi.

Prishtinë, më 12 dhjetor 2012

Nr. ref.: VMP325 /12

VENDIM PËR VAZHDIM TË MASËS SË PËRKOHSHME

në

Rastin Nr. KI 78/12

Parashtruesi

Bajrush Xhemajli

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Hyrje

1. Më 24 shtator 2012, Gjykata Kushtetuese lejoi masën e përkohshme përkitazi me kërkesën e sipërpërmendur. Në vendimin e saj, Gjykata Kushtetuese, ndër të tjera, vendosi:

   I. TË LEJOJË, me gjashtë vota për dhe dy kundër, masën e përkohshme;

   II. TË LEJOJË masën e përkohshme në kohëzgjatje deri më 31 dhjetor 2012, duke filluar nga data e miratimit të këtij Vendimi; dhe,

   III. TË PEZULLOJË MENJËHERË zbatimin e Vendimit të Gjykatës Supreme Pkl. nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012; urdhërdënimin me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. nr. 485/09, të 26 nëntorit 2010; si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Ap. nr. 134/2011, të 8 marsit 2012, për të njëjtën periudhë kohore.

Korrespondenca nga Gjykata Supreme

2. Më 21 shtator 2012, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga Gjykata Supreme ta dorëzonte dosjen e lëndës P. nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012, duke përfshirë procesverbalin e gjykatave të të gjitha instancave të përfshira në këtë rast.

3. Më 19 nëntor 2012, Gjykata Kushtetuese edhe një herë kërkoi nga Gjykata Supreme që ta dorëzonte dosjen e lëndës P. nr. 485/09, të 26 nëntorit 2010; AP. nr. 134/2011, të 8 marsit 2012; dhe Pkl. Nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012, duke përfshirë edhe procesverbalin e gjykatave të të gjitha instancave të përfshira në këtë rast.

4. Më 20 nëntor 2012, Gjykata Supreme iu përgjigj Gjykatës Kushtetuese, duke dorëzuar dosjen e lëndës P. Nr. 485/09, të 26 nëntorit 2010; AP. nr. 134/2011, të 8 marsit 2012; dhe Pkl. Nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012, duke përfshirë edhe procesverbalin e gjykatave të të gjitha instancave të përfshira në këtë rast.

5. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese merr parasysh nevojën për të shqyrtuar përgjigjen e Gjykatës Supreme, që tani është pranuar, duke përfshirë dosjen e lëndës P. nr. 485/09, të 26 nëntorit 2010; Ap. nr. 134/2011, të 8 marsit 2012; dhe Pkl. nr. 70/2012 dhe, gjithashtu, edhe procesverbalin e gjykatave të të gjitha instancave të përfshira në këtë rast.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 116 (2) të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të

Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit të çështjes më 5 dhjetor 2012,

VENDOS

I. Më shumicë votash, të vazhdojë afatin kohor të vendosur nga Gjykata Kushtetuese në Vendimin e saj të parë, të 24 shtatorit 2012, për një periudhë shtesë prej tre muajsh – deri më 31 mars 2013;

II. Të mbetet e përkushtuar në këtë çështje;

III. Ky vendim do t'u komunikohet palëve; dhe

IV. Ky vendim do të publikohet në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Kadri Kryeziu	Prof. Dr. Enver Hasani

KI 126/12 datë 14 dhjetor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Mlc. nr. 21/2012, të 8 dhjetorit 2012

Rasti KI 126/12, Vendimi për Kërkesën për Masë të Përkohshme dhe Aktvendimi për papranueshmëri i 13 dhjetorit 2012

Fjalët kyçe: barazia para ligjit, parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor, masat e përkohshme, kërkesë individuale, qartazi e pabazuar, të drejtat e fëmijëve, shkelje e të drejtave dhe lirive individuale

Parashtruesi i kërkesës, z. Bekë (Vesel) Gashi, e dorëzoi kërkesën bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës së Kosovës, duke e kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme,Mlc. nr. 21/2012, të 8 nëntorit 2012, duke pretenduar se ai u mor në kundërshtim me të drejtat e tij të garantuara nga neni 2 [Sovraniteti], neni 24 [Barazia para Ligjit], neni 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit gjyqësor], sepse kishte një varg shkeljesh të standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut si dhe standardeve tjera ndërkombëtare, si ato të OKB që garantojnë një proces të drejtë, të paanshëm, të bazuar në ligj etj. dhe atë në nenin 6 to KEMDNJ që ka të bëjë me të drejtën e paditësit, për një proces të drejtë dhe të paanshëm dhe për një administrim të mirë të drejtësisë. Për më tepër, parashtruesi deklaron se," Gjykata është dashur të marrë parasysh interesin e të miturve, zhvillimin e tyre fizik dhe psikologjik, shëndetin dhe edukimin e tyre, interesa këto që janë primare gjatë marrjes së vendimit." Parashtruesi kërkon më tej nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme. Në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, Gjykata vendosi se kërkesa ishte e papranueshme, sepse parashtruesi as nuk ka ndërtuar e as nuk ka dëshmuar një rast prima facie qoftë mbi bazën apo pranueshmërinë dhe rrjedhimisht kërkesa për masa të përkohshme duhet të refuzohej si e pabazë dhe Kërkesa të shpallej e papranueshme si qartazi e pabazuar.

Prishtinë, 13 dhjetor 2012

Nr. ref.:VMP/AP/328 /12

VENDIM PËR KËRKESËN PËR MASË TË PËRKOHSHME DHE AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 126/12

Parashtruesi

Bekë (Vesel) Gashi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,

Mlc. nr. 21/2012, të 8 dhjetorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendës – kryetar

Robert Carolan, Gjyqtar

Altay Suroy, Gjyqtar

Almiro Rodrigues, Gjyqtar

Snezhana Botusharova, Gjyqtare

Kadri Kryeziu, Gjyqtar

Arta Rama-Hajrizi, Gjyqtare.

Parashtruesi

1. Parashtrues është Z. Bekë (Vesel) Gashi, banor i fshatit Qyshk, Komuna e Pejës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Mlc. nr. 21/2012, të 8 nëntorit 2012, që i është dorëzuar Parashtruesit në një datë të pa specifikuar.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pohon se Aktgjykimi i lartpërmendur shkelë të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), nenet 2 [Sovraniteti], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [e drejta për Gjykim të

Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor].

4. Për më tepër, Parashtruesi pohon se Aktgjykimi i lartpërmendur gjithashtu shkel *"Nenin 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Fëmijëve dhe dispozitat tjera të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve."*

5. Për më tepër, Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), të vendosë masë të përkohshme

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 dhe 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009, (nr. 03/L-121) (në tekstin e mëtejmë: Ligji), rregullin 54 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e Punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 7 dhjetor 2012, Parashtruesi dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë.

8. Më 7 dhjetor 2012, Kryetari caktoi Gjyqtarin Almiro Rodrigues si Gjyqtar Raportues dhe Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga Gjyqtarët Kadri Kryeziu (kryesues), Enver Hasani dhe Arta Rama –Hajrizi.

9. Më 7 dhjetor 2012, Kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë Drejtësisë.

10. Më 10 dhjetor 2012, Gjykata shqyrtoi Raportin Paraprak të Gjyqtarit Raportues përkitazi me Kërkesën për masë të përkohshme dhe pranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 11 janar 2011, Gjykata Familjare në Hanover, në Gjermani, hodhi poshtë (me Vendimin 614 F 725/11) kërkesën e Parashtruesit mbi kujdestarinë për dy fëmijët e tij të mitur.

12. Më 10 shkurt 2011, Gjykata Familjare, në Gjermani, vendosi (Vendimi 614 F 725/11) që dy fëmijët e mitur do të jetojnë përkohësisht me nënën e tyre dhe se kërkesa e Parashtruesit për ndërrimin e banimit të fëmijëve nga nëna tek ai, ishte hedhur poshtë.

13. Më 2 nëntor 2011, Ministria Federale e Drejtësisë në Gjermani, duke vepruar në cilësinë e autoritetit qendror gjerman në përputhje me Konventën e Hagës të 25 tetorit 1980 për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve (në tekstin e mëtejmë: Konventa e Hagës), parashtroi një kërkesë në Ministrinë e Drejtësisë në Republikën e Kosovës për të urdhëruar kthimin e dy fëmijëve të mitur të Parashtruesit.

14. Më 31 tetor 2011, Gjykata Komunale në Pejë (Vendimi C.nr. 229/11) bëri zgjidhjen e martesës përmes marrëveshjes.

15. Më 6 dhjetor 2011, Ministria e Drejtësisë së Republikës së Kosovës, duke vepruar në cilësinë e autoritetit qendror të Kosovës në përputhje me Konventën e Hagës, njoftoi

Parashtruesin që duke mbajtur dy fëmijët e mitur me të, ai po mohonte të drejtën prindërore të nënës për dy fëmijët e mitur dhe që kjo është në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm në Gjermani, me Konventën e Hagës dhe me Ligjin nr. 03/L-238 për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve. Për më tepër, Ministria e Drejtësisë në Kosovë konstatoi se, nëse Parashtruesi nuk përgjigjet brenda shtatë ditësh, atëherë ata do të iniciojnë procedurë gjyqësore.

16. Më 29 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në Pejë (Vendimi E. nr. 805/11) e aprovoi kërkesën e nënës për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Familjare në Hanover, Gjermani.

17. Ministria e Drejtësisë së Republikës së Kosovës, sipas Konventës së Hagës, dhe Ligjit Nr. 03/L–238 për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve, kërkoi nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Neni 1 (1.8) i Ligjit Nr.03/L – 238 për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve) të lëshojë një urdhër për të siguruar kthimin e dy fëmijëve në Gjermani.

18. Më 10 shkurt 2012 Gjykata e Qarkut në Prishtinë e refuzoi (Vendimi C. nr. 1/2012) kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë në Kosovë. Gjykata e Qarkut në Prishtinë konstatoi se fëmijët janë të vegjël dhe "[...] duhet te mbrohen nga te gjitha streset me qellim te zhvillimit normal ne pikëpamje psikofizike. Prandaj, sipas vlerësimit te kësaj gjykate fëmijët ne Kosove me te atin e tyre kanë kushte për jete normale, pa marre parasysh faktin se në Kosovë gjenden pa pëlqimin e nenës se tyre, si kujdestare e përkohshme. Nga sa u tha më lartë, rasti konkret nuk mund të trajtohet si rrëmbim ndërkombëtar i fëmijëve në kuptim të nenit 3 te Ligjit mbi aspektin civil te rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve." Për më tepër, Gjykata e Qarkut në Prishtinë konstatoi se "[...] vendimi i përkohshëm i Gjykatës Komunale në Hanover i 22 shkurtit 2011 [...] është marrë deri sa

bashkëshortët kanë qenë në martesë, vendimi përfundimtar mbi besimin e fëmijëve është dashtë të merret pas zgjidhjes së martesës. Për ndryshe këtë e parasheh edhe Ligji mbi familjen i Kosovës, sepse martesa është lidhur në Kosovë [...]" Avokati i nënës ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër këtij vendimi.

19. Më 11 qershor 2012, Gjykata Supreme e refuzoi (Ac. nr. 40/2012) ankesën kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë si të pabazuar. Gjykata Supreme konstatoi se avokati i nënës nuk ka autorizim dhe nuk ka të drejtë të ushtrojë ankesë kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Vetëm Ministria e Drejtësisë ka të drejtë të ushtrojë ankesë kundër vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

20. Më 6 korrik 2012, Avokati i parashtruesit të kërkesës pranoi një ftesë nga Gjykata Familjare në Hanover që më 16 gusht 2012 të merr pjesë në rastin e caktimit të kujdestarisë mbi fëmijët.

21. Më 10 gusht 2012, Gjykata Komunale në Pejë (C. nr. 626/12) shqiptoi masat mbrojtëse (masën e përkohshme) dhe parashtruesi u obligua që t'ia kthejë fëmijët së ëmës.

22. Më 14 gusht 2012, Gjykata e Qarkut në Pejë (Ac. nr. 447/12) e anuloi vendimin e Gjykatës Komunale në Pejë.

23. Më 16 gusht 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (C. nr. 2/2012) sipas kërkesës së parashtruesit dhe në bazë të nenit 15.1.1 Ligjit për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve shqiptoi masën e përkohshme për tridhjetë ditë për ta ndaluar kthimin e fëmijëve nënës së tyre dhe e lejoi Ministrinë e Drejtësisë për iniciuar procedurën gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së masës së përkohshme. Nëna u ankua kundër këtij vendimi të Gjykatës Supreme.

24. Më 25 shtator 2012, Gjykata Supreme e anuloi (Vendimi Ac. nr. 61/2012) vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë sepse në bazë të nenit të 15.1.1 Ligjit për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve, masat e përkohshme mund të shqiptohen në bazë të kërkesës së Ministrisë së Drejtësisë ose Gjykata *ex-officio* dhe jo nga parashtruesi i kërkesës. Për më tepër, Gjykata Supreme konstatoi se çështja e kujdestarisë së përkohshme përcaktohet me vendimin e Gjykatës Familjare në Hanover, i cili është i formës së prerë dhe detyrues.

25. Më 16 tetor 2012, kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës (C. nr. 4/2011) për kthimin e dy fëmijëve të mitur nënës së tyre u refuzua, sepse rasti është *res judicata* me Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë (Vendimi C. nr. 1/2012) i 10 shkurtit 2012.

26. Më 8 nëntor 2012, Gjykata Supreme (Mlc. Nr. 21/2012), sipas kërkesës së Prokurorit të Shtetit për mbrojtjen e ligjshmërisë e ndryshoi vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë C. nr. 1/2012 të 10 shkurtit 2012, dhe vendimin e Gjykatës Supreme Ac. nr. 40/2010 të 11 qershorit 2012, duke aprovuar kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës si të bazuar dhe duke obliguar parashtruesin që t'ia kthejë fëmijët nënës së tyre.

27. Më 26 nëntor 2012, nëna u ftua nga Gjykata Familjare në Hanover që më 20 dhjetor 2012 të merr pjesën në rastin e caktimit të kujdestarisë mbi fëmijët.

28. Më 30 nëntor 2012, kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës për kthim në situatën e mëparshme dhe për përsëritje të procedurës (C. nr. 1/2012) u refuzua sepse rasti është *res judicata* me Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë (Vendimi C. nr. 1/2012) i 10 shkurtit 2012.

29. Gjykata Supreme konstatoi se *"„Me dispozitën e nenit 3. te Ligjit për Aspektet Civile te Rrëmbimit Ndërkombëtar te Fëmijëve, largimi ose mbajtja e fëmijëve konsiderohet si e padrejtë kur konsiston në shkeljen e të drejtave të kujdestarisë së dhëne një personi, një institucioni apo organi tjetër, qoftë bashkërisht apo individualisht, sipas Ligjit të shtetit në të cilin fëmija ka qene banor i përhershëm para largimit apo mbajtjes. Në rastin konkret kemi të bëjmë me shkeljen e të drejtave të nënës si kujdestare, lidhur me largimin apo me mbajtjen e padrejtë të fëmijëve të mitur, që konsiston në dispozitën e nenit 3 par. 1.1 të këtij Ligjit, për faktin se e drejta e nënës si kujdestare bazohet në vendimin e Gjykatës Komunale-Familjare të Hanoverit," "[...] Kur e drejta e kujdestarisë rrjedh nga një vendim gjyqësor apo administrativ, gjykata duhet ta marrë parasysh vendimin e shpallur nga autoritetet e shtetit ku fëmijët kanë pasur vendbanimin e përhershëm para rrëmbimit!! [...]".* Gjykata Supreme gjithashtu konstatoi se *"Të drejtat e kujdestarisë nuk janë të përcaktuara me ligj të Kosovës, por me vendim të huaj, kështu që vendimi në lidhje me kujdestarinë, që është marrë në Kosovë, nuk mund të jetë bazë për refuzimin e kthimit të fëmijës sipas këtij ligji, por gjykata mund të marrë në konsideratë arsyet e këtij vendimi kur të zbatojë dispozitat e këtij Ligji."*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

30. Parashtruesi pretendon si në vijim.

(vi) "Shkelja e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut për një proces të drejtë dhe të ligjshëm gjyqësor nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme në ndarjen e drejtësisë"

- Parashtruesi pretendon se *"Me aktvendimin e atakuar gjykata Supreme e R. se Kosovës beri shkeljen e Kushtetutës se R. se Kosovës, me një varg te shkeljesh të standardeve ndërkombëtare mbi te drejtat e njeriut, e veçanërisht te Konventës Evropiane mbi te Drejtat e Njeriut si dhe standardet tjera ndërkombëtare,* si *ato te OKB qe garantojnë një proces te drejte, te pa anshëm, te bazuar ne ligj etj. dhe atë n.* 6 *te KEMDNJ qe ka te beje me te drejte e paditësit, për një proces te drejte dhe te pa anshëm, dhe për një administrim te mire te drejtësisë. Ne baze te interpretimit te n. 6.1 te kësaj Konvente Gjykata Evropiane mbi te Drejtat e Njeriut qarte thekson se "... akcesi i një paneli gjyqësor duhet te jete REAL dhe jo thjeshte FORMAL .Sipas deklaratës se OKB mbi të Drejtat e fëmijëve. Deklarata mbi parimet shoqërore e juridike qe duhet te zbatohen për mbrojtje dhe mirëqenie të fëmijëve, në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet publike apo private për mirëqenie sociale, gjykatave, autoritetet administrative ose organeve legjislative, interesi i fëmijës do të jetë primar."*

(vii) "Shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenet 3, 24, 31 dhe 102"

- Parashtruesi i kërkesës thekson se *"Gjykata është dashur të marrë parasysh interesin e të miturve, zhvillimin e tyre fizik dhe psikologjik, shëndetin dhe edukimin e tyre, interesa këto që janë primare gjatë marrjes së vendimit."*

31. Me pak fjalë, parashtruesi pohon se Nenet 2 [Sovraniteti], 24 [Barazia Para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit

Gjyqësor] të Kushtetutës janë shkelur me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme.

Kërkesë për masë të përkohshme dhe pranueshmëria e kërkesës

32. Në rastin aktual, Parashtruesi kërkon nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme në zbatimin e aktgjykimit të Gjykatës Supreme Mlc. Nr. 21/2012 të datës 8 nëntor 2012 deri në gjykimin përfundimtar të Kërkesës. Parashtruesi nuk jep ndonjë argument shtesë rreth asaj se pse Gjykata do të duhej që të vendosë masë të përkohshme.

33. Në këtë drejtim, Gjykata merr parasysh se, në pajtim me Rregullin 55 (1) të Rregullores, *"Kërkesa për masë të përkohshme do të shqyrtohet me shpejtësi nga Gjykata dhe do t'i jepet përparësi para të gjitha kërkesave të tjera."* si dhe Rregullës 55 (6) *"[...] Rekomandimi i Kolegjit shqyrtues për aplikimin e masave të përkohshme bëhet vendim i Gjykatës, përveç nëse një ose më shumë gjyqtarë ia paraqesin ndonjë vërejtje Sekretarit brenda tri (3) ditësh. [...]".*

34. Neni 116.2 [Efekti Juridik i Vendimeve] i Kushtetutës përcakton:

2. Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme.

35. Gjithashtu Neni 27 i Ligjit parasheh:

"Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa te përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik."

36. Për më tepër, në mënyrë që Gjykata të vendosë masë të përkohshme në pajtim me Rregullin 55 (4) të Rregullores së Punës, ajo duhet të gjejë se:

"(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe

(..)

Nëse pala që kërkon masat e përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do ta rekomandojë refuzimin e kërkesës.

37. Gjykata rikujton Nenin 48 të Ligjit i cili përcakton se

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Rasti prima facie

38. Gjykata konstaton se Gjykata Familjare në Hanover ka vendosur se dy fëmijët e mitur do të jetojnë përkohësisht me të ëmën dhe kërkesa e Parashtruesit për të transferuar vendbanimin e fëmijëve nga e ëma tek ai është refuzuar.

39. Andaj, Gjykata vlerëson se shkelja e pretenduar e të drejtës së Parashtruesit për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm do të duhej të ishte ankimuar pranë Gjykatës Familjare në Hanover, e cila ka vendosur për kujdestarinë e dy fëmijëve të mitur.

40. Gjykata po ashtu konstaton se pretendimi për shkeljen e Neneve 2 [Sovraniteti], 24 [Barazia Para Ligjit] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës është qartazi i pabazuar. Në bazë të Konventës së Hagës dhe të Ligjit Nr. 03/L-238 mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve, vendimi i Gjykatës Familjare të Hanoverit është drejtpërdrejt i zbatueshëm edhe në territorin e Kosovës pa pasur nevojë për procedurë *ekzekuature*.

41. Në fakt, gjykatat e rregullta të Kosovës nuk janë kompetente për të vlerësuar bazën e atij vendimi; ato janë kompetente vetëm për ekzekutimin e vendimit të gjykatës familjare Gjermane, në pajtim me Nenin 3 (1.1) të Ligjit për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve i cili përcakton se: "Largimi apo mbajtja e një fëmije konsiderohet i padrejtë në

rastet kur konsiston në shkeljen e të drejtave të kujdestarisë dhënë një personi, një institucioni apo organi tjetër, qoftë bashkërisht apo individualisht, sipas ligjit të shtetit në të cilin fëmija ka qenë banor i përhershëm para largimit apo mbajtjes" dhe Nenin 11 të ligjit të njëjtë i cili përcakton: "Gjykata do të urdhërojë kthimin e menjëhershëm të fëmijës nga Kosova në shtetin kërkues nëse fëmija është larguar apo mbajtur pa të drejtë në Kosovë."

42. Për këtë arsye Gjykata Supreme me të drejtë ka vendosur se *"E drejta për kujdestari nuk është përcaktuar nga ligji i Kosovës por nga një vendim i huaj, andaj vendimi në lidhje me kujdestarinë që është marrë në Kosovë, nuk paraqet bazë për të refuzuar kthimin e fëmijës nën këtë ligj"*.

43. Gjykata Supreme gjithashtu mori parasysh se "*Kur e drejta e kujdestarisë buron nga një vendim juridik (...), Gjykata duhet të merr parasysh vendimin e lëshuar nga autoritetet e shtetit ku fëmijët e kanë pasur vendbanimin e përhershëm para rrëmbimit të tyre*".

44. Gjykata konstaton se "largimi apo mbajtja e një fëmije konsiderohet i padrejtë në rastet kur (1) konsiston në shkeljen e të drejtave të kujdestarisë dhënë një personi, një institucioni apo organi tjetër, qoftë bashkërisht apo individualisht, sipas ligjit të shtetit në të cilin fëmija ka qenë banor i përhershëm para largimit apo mbajtjes; dhe (2) në kohën e largimit apo mbajtjes këto të drejta janë ushtruar, qoftë bashkërisht apo individualisht, ose që mund të kenë qenë ushtruar me përjashtim të largimit apo mbajtjes." (Shih Nenin 3 të Ligjit mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve dhe të Konventës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve).

45. Gjykata më tutje konstaton se për një rast *prima facie* në bazë të kërkesës për masa të përkohshme dhe mbi pranueshmërinë e kërkesës, Parashtruesi duhet të dëshmoj se procedurat në Gjykatë Supreme, shikuar në tërësinë e tyre, nuk janë zbatuar në mënyrë të tillë që Parashtruesi të mos ketë pasur një gjykim të drejtë apo që shkelje të tjera të mund të jenë kryer nga ana e Gjykatës Supreme.

46. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet rregullës 36 (1.c) të Rregullores së Punës e cila përcakton se *"Gjykata mund t'i shqyrtojë Kërkesat vetëm nëse: c) Kërkesa është qartazi e bazuar."*

47. Gjykata thekson se nuk është detyra e gjykatës Kushtetuese që të trajtojë gabimet e fakteve apo ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jetë kryer nga Gjykata Supreme, përpos nëse dhe përderisa nuk i shkel të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (Kushtetutshmëria).

48. Andaj Gjykata nuk duhet të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet e marra nga gjykata e rregullta. Është detyra e gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse si të ligjit procedural ashtu edhe substancial (shih, mutatis mutandis, García Ruiz v. Spain [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

49. Për më tepër Parashtruesi thjesht pretendon "S*hkeljen e standardeve ndërkombëtare të të drejtave ndërkombëtare për një procedurë juridike të drejtë dhe të ligjshme nga ana e Gjykatës Supreme."*

50. Në fakt, Parashtruesi nuk arrin të provojë një pretendim *prima facie* mbi baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar dëshmi që tregojnë se të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga Gjykata Supreme.

51. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konstatojë se procedurat përkatëse në Gjykatën Supreme kanë qenë në ndonjë mënyrë të prekura dhe të përfshira me arbitraritet (shih mutatis mutandis, Shub v. Lithuania, vendimi i GJEDNJ për Pranueshmërinë e Kërkesës Nr. 17064/06 të datës 30 qershor 2009)

52. Për më tepër, nuk ka hapësirë për të pretenduar një shkelje të tillë, pasi Gjykata Supreme nuk është marrë me bazat e kësaj kërkese, por vetëm me urdhërimin e një vendimi të marrë në mënyrë të rregullt dhe të ligjshëm nga gjykata kompetente në Gjermani.

53. Prandaj, Parashtruesi nuk ka provuar *prima facie* pse dhe si i ka shkelur Gjykata Supreme të drejtat e tij të garantuara me Nenet 2 [Sovraniteti], 24 [Barazia Para Ligjit], 31 [E Drejta për një Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës ose që "*shkelje të shumta të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, në veçanti të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të standardeve tjera ndërkombëtare*" janë kryer nga Gjykata Supreme.

Dëmet e pariparueshme

54. Në këtë kuptim, Gjykata konstaton se në pajtim me Nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejt i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] Konventa për të Drejtat e Fëmijëve është drejtpërdrejt e zbatueshme në territorin e Kosovës.

55. Për më tepër, Gjykata është në dijeni se Neni 3 (1) i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve përcakton se

"*Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucionet publike ose private të mirëqenies shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsideratë parësore.*"

56. Gjithashtu Neni 5 i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve përcakton se *"Shtetet palë respektojnë përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat që kanë prindërit ose, sipas rastit, anëtarët e familjes së zgjeruar ose të bashkësisë, siç parashikohet nga zakoni i vendit, kujdestarët ose personat e tjerë ligjërisht përgjegjës për fëmijën, për t'i siguruar këtij, në përputhje me zhvillimin e aftësive të tij, drejtimin dhe udhëheqjen e duhur për ushtrimin e të drejtave të njohura në këtë Konventë.*

57. Për këtë qëllim, Ligji Nr. 03/L-238 për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve është, sigurimi i kthimit të shpejtë të fëmijëve që largohen apo mbahen pa të drejtë jashtë shtetit të vendqëndrimit, si dhe sigurimi i respektimit të të drejtës së kujdestarisë dhe të kontaktit me fëmijët, të cilët janë banorë të përhershëm të Kosovës apo të një shteti kërkues.

58. Siç u cek më sipër, largimi apo mbajtja e një fëmije konsiderohet e padrejtë në rastet kur konsiston në shkeljen e të drejtave të kujdestarisë dhënë një personi, sipas ligjit të shtetit në të cilin fëmija ka qenë banor i përhershëm para largimit apo mbajtjes.

59. Për më tepër, siç është vendosur me të drejtë nga Gjykata Supreme, fakti se një vendim në lidhje me kujdestarinë është marrë në Kosovë, nuk shërben si bazë për të refuzuar kthimin e fëmijës në gjendjen e vendosur më parë nga gjykata gjermane si organi i vetëm kompetent.

60. Gjykata vlerëson se, përpara asaj që është cekur më lart, interesi më i rëndësishëm dhe kryesor për t'u mbrojtur në këtë rast është interesi më i mirë i të dy fëmijëve, siç është vendosur nga Gjykata Familjare në Hanover, Gjermani.

61. Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se Parashtruesi nuk ka provuar se cilat janë interesat e tij që do të pësonin dëme të pariparueshme nëse nuk i jepet lirimi i përkohshëm.

62. Në fakt, Gjykata konstaton se parashtruesi thjesht deklaron se Gjykata duhet të vendosë masa të përkohshme deri në shqyrtimin përfundimtar të Kërkesës, pa ofruar argumente tjera shtesë apo dokumente përkatëse që shpjegojnë dhe tregojnë pse dhe si ai vet do të vuante dëme të pariparueshme.

63. Në tërësi, Gjykata konstaton se Parashtruesi as nuk ka ndërtuar e as nuk ka dëshmuar një rast *prima facie* qoftë mbi bazën apo pranueshmërinë, dhe rrjedhimisht kërkesa për masa të përkohshme duhet të refuzohet si e pabazë dhe Kërkesa të shpallet e papranueshme si qartazi e pabazuar. Gjykata më tutje konstaton se, duke qenë se Kërkesa është e papranueshme, kërkesa për masa të përkohshme është e pa bazë dhe duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 116 (2) të Kushtetutës, nenet 27 dhe 48 të Ligjit, dhe në pajtim me Rregullat 36 (1.c), 55 dhe 56 (2) të Rregullave, më 10 dhjetor 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TA REFUZOJË kërkesën si të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve; dhe

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në pajtim me Nenin 20(4) të Ligjit.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Almiro Rodrigues Prof. Dr. Enver Hasani

KO 97/12 datë 26 dhjetor 2012- Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012

Rasti KO 97/12, Vendimi për masë të përkohshme i datës 24 dhjetor 2012

Fjalët kyçe: ekonomia, masat e përkohshme, liria e asocimit, ligji në mospërputhje me Kushtetutën, mbrojtja e pronës

Parashtruesi ka parashtruar Kërkesë në pajtim me nenin 113.2 (1) të Kushtetutës së Kosovës, duke kontestuar kushtetutshmërinë e neneve 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit për bankat, institucionet mikro-financiare, si dhe institucionet financiare jo-bankare, nr. 04/L-093, të datës 12 prill 2012, sepse zbatimi i këtij ligji do të shkaktonte dëme të pariparueshme për shoqërinë civile.

Sa i përket masave të përkohshme, Gjykata konkludoi, duke pasur parasysh rolin dhe rëndësinë e shoqërisë civile dhe OJQ-ve si pjesë thelbësore e zhvillimit të demokracisë, që zbatimi i Ligjit nr. 04/L-093 për bankat, institucionet mikro-financiare dhe institucionet financiare jo-bankare, më saktësisht nenet e kontestuara 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116, mund të shkaktojë dëm të pariparueshëm në funksionimin e shoqërisë civile dhe demokracisë në Republikën e Kosovës.

Prishtinë, më 24 dhjetor 2012

Nr. ref.: MP331/12

VENDIM PËR MASË TË PËRKOHSHME

në

Rastin nr. KO 97/12

Parashtrues

Avokati i Popullit

Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar

Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar

Robert Carolan, gjyqtar

Altay Suroy, gjyqtar

Almiro Rodrigues, gjyqtar

Snezhana Botusharova, gjyqtare

Kadri Kryeziu, gjyqtar

Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Parashtruesi).

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) të anulojë nenet 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi, nga Gjykata, i kushtetutshmërisë së neneve 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012.

4. Parashtruesi më tej kërkon që Gjykata të vendosë masën e përkohshme për të pezulluar zbatimin e Ligjit për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012.

Baza juridike

5. Neni 113.2 (1) i Kushtetutës; nenet 22, 27, 29 dhe 30 e Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji); dhe rregullat 54, 55, 56, 57, 62, 64 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 11 tetor 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatë.

7. Më 31 tetor 2012, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KO97/12, caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin Nr. KSH.KO97/12, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 14 tetor 2012, kërkesa iu komunikua Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Qeverisë dhe parashtruesit të kërkesës.

9. Të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua Komisionit Parlamentar për Legjislacion, Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: BQK), Ministrisë së Financave, Ministrisë së

Administratës Publike, Departamentit të Regjistrimit dhe Ndërlidhjes me OJQ dhe Gjykata kërkoi nga këto institucione që të paraqisnin komentet e tyre. Deri më tash, asnjë nga institucionet e lartpërmendura nuk është përgjigjur.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 12 prill 2012, Kuvendi i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi), miratoi Ligjin për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, me 55 (pesëdhjetë e pesë) vota "për", 0 (zero) vota "kundër", dhe 4 (katër) "abstenime".[1]

11. Më 19 prill 2012, organizatat joqeveritare (në tekstin e mëtejmë: OJQ): Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), Lëvizja FOL, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe 55 OJQ të tjera mbështetëse, i drejtuan një letër Kryetarit të Republikës së Kosovës, duke kërkuar që ligji të mos shpallet, si dhe të kthehet në Kuvend për rishqyrtim.

12. Më 11 Maj 2012, Ligji për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 80 (5) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

---

[1] Në transkriptin e datës 12 prill 2012, në faqen 21, thuhet: 55 (pesëdhjetë e pesë) vota "për", 4 (katër) "abstenime", 0 (zero) "kundër" dhe 61 (gjashtëdhjetë e një) deputetë ishin të pranishëm. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës në kërkesë thotë se: "1. Më 12 prill 2012, Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare me pesëdhjetë e katër (54) vota 'për', asnjë 'kundër', dhe katër (4) 'abstenime'".

13. Ligji për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, hyri në fuqi më 12 prill 2012, në pajtim me nenin 118 të këtij Ligji.

14. Më 11 maj 2012, Institucioni i Avokatit të Popullit mori një parashtresë nga disa OJQ: Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), Lëvizja FOL, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe 55 OJQ të tjera mbështetëse, të cilat, së bashku, iu drejtuan Institucionit të Avokatit të Popullit, duke kërkuar që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në përputhje me detyrat dhe me përgjegjësitë e dhëna me Ligj, të vlerësojë kushtetutshmërinë e neneve 90, 95, (1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093.

15. OJQ-të e lartpërmendura konsideronin që këto nene përbëjnë shkelje të Kushtetutës dhe kërkuan pezullimin e zbatimit të Ligjit derisa Gjykata të nxjerrë një vendim meritor përkitazi me këtë çështje.

16. OJQ-të e lartpërmendura konsiderojnë se dispozitat në vijim: nenet 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, shkelin nenin 44 [Liria e Asociimit], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës], dhe nenin 10 [Ekonomia] të Kushtetutës, parimet ndërkombëtare të OJQ-ve jofitimprurëse dhe legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë që rregullon fushën e lirisë së asociimit të OJQ-ve.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi, në kërkesën e tij, i referohet mekanizmit të zbatueshëm juridik në vijim përkitazi me objektin e çështjes në Gjykatë:

18. Neni 44 [Liria e Asociimit] i Kushtetutës përcakton se liria e asociimit është e garantuar dhe e rregulluar me ligj:
"1. Liria e asociimit është e garantuar. Liria e asociimit ngërthen në vete të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate.

2. Liria për të themeluar sindikata dhe për t'u organizuar, me qëllim që të mbrohen interesat, është e garantuar. […]".

19. Neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës garanton në mënyrë specifike mbrojtjen e pronës:

"1. E drejta e pronës është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. […]".

20. Neni 10 [Ekonomia] i Kushtetutës ka të bëjë me rregullimin ekonomik të Republikës së Kosovës:

"Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës".

21. Neni 1 i Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Nr. 04/L-057, përcakton:

"Ky Ligj rregullon themelimin, regjistrimin, udhëheqjen e brendshme, veprimtarinë, shuarjen dhe çregjistrimin e personave juridikë të organizuar si organizata jo-qeveritare në Kosovë".

22. Sipas nenit 4 të Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Nr. 04/L-057:

"1. OJQ-ja nuk shpërndan të ardhura neto ose fitime për asnjë person.

2. Pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e një OJQ-je përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të përcaktuara për organizatën.

3. Pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e një OJQ-je nuk mund të përdoren për të sjellë drejtpërdrejtë ose tërthorazi përfitime, për ndonjë themelues, drejtor, zyrtar, anëtar, punonjës ose donator të OJQ-së, përveç pagesës apo kompensimit të arsyeshëm për personat që kryejnë punë për organizatën".

23. Neni 5 i Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Nr. 04/L-057, në mënyrë të qartë përcakton nocionin dhe qëllimin e themelimit të një OJQ-je në Kosovë:

"1. OJQ-ja vendore është shoqatë ose fondacion e themeluar në Kosovë për realizimin e qëllimit bazuar në ligj, për përfitim publik ose për interes të ndërsjellë. […]".

24. Neni 11.1 i Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Nr. 04/L-057, përcakton:

"1. OJQ-ja vendore ka statusin e personit juridik me regjistrim në përputhje me këtë Ligj".

25. Neni 20 i Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Nr. 04/L-057, përcakton kushtet për shuarjen e një OJQ-je:

"1. OJQ-ja shuhet:

1.1. me vendim vullnetar për shuarjen e OJQ-së, të marrë nga organi më i lartë udhëheqës në pajtim me statutin e saj;

1.2. kur OJQ-ja bëhet josolvente sipas ligjit në fuqi;

1.3. me kalimin e afatit për të cilin është themeluar, nëse një afat i tillë është I përcaktuar në aktin themelues;

1.4. në bazë të vendimit të plotfuqishëm gjyqësor".

26. Neni 21 i Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, Nr. 04/L-057, përcakton mënyrën dhe organet kompetente për çregjistrim dhe mënyrën e menaxhimit të pasurive të OJQ-së:

"3. Në rast të shuarjes ose çregjistrimit të OJQ-së, e cila ka shfrytëzuar lehtësi tatimore ose fiskale, donacione publike ose grante nga qeveria, e gjithë pasuria e mbetur pas shlyerjes së borxheve të OJQ-së i jepet OJQ-së tjetër me qëllime të njëjta apo të ngjashme. Kjo OJQ identifikohet në bazë të statutit të OJQ-së, ose me propozim të organit më të lartë udhëheqës të OJQ-së. Ministria themelon Komisionin për Shpërndarjen e Pasurisë së mbetur të OJQ-së së shuar dhe të çregjistruar me përfaqësues edhe të OJQ-ve, duke u bazuar në aktin nënligjor të nxjerrë nga Qeveria.

4. Në të gjitha rastet tjera, çdo pasuri e mbetur pas pagesës së borxheve shpërndahet në bazë të statutit apo të vendimit të organit më të lartë udhëheqës, dhe në të gjitha rastet në përputhshmëri me nenin 4 të këtij ligji".

27. Në këtë drejtim, parashtruesi pohon se *"[...] Ligji për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, kryesisht në Kapitullin II të tij, lejon OJQ-të Institucione Mikrofinanciare (IMF OJQ) që të transformohen në shoqëri aksionare, gjegjësisht në subjekte private në kundërshtim me qëllimin e themelimit të tyre. Si i tillë, ky ligj shkel parimet kushtetuese, shkel parimet ndërkombëtare të ligjit joprofitabil dhe është në kundërshtim me legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë që rregullon lirinë e asociimit në OJQ, dhe vë në rrezik të ardhmen e sektorit të shoqërisë civile në përgjithësi".*

28. Më tej, parashtruesi pretendon se OJQ-të Institucione Mikrofinanciare janë themeluar dhe janë regjistruar në pajtim me të drejtën për asociim, të garantuar me nenin 44 të Kushtetutës dhe me Ligjin për Lirinë e Asociimit në OJQ, Nr. 04/L-057. Sidoqoftë, siç pretendohet, Ligji për Banka, Institucione

Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, me ndryshimin e subjektivitetit juridik të OJQ-ve Institucione Mikrofinanciare, dhe duke lejuar transformimin e tyre në shoqëri aksionare, i largon ato prej fushëveprimit të nenit 44 të Kushtetutës, dhe pengon të drejtën e tyre për të vepruar në bazë të së drejtës për asociim.

29. Për më tepër, pretendohet se "Ligji për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, synon të rregullojë veprimtarinë e OJQ-ve Institucione Mikrofinanciare nëpërmjet rregullimit të parimeve dhe të procedurave të menaxhimit. Megjithatë, dispozitat e Ligjit adresojnë çështjet e subjektivitetit juridik të OJQ-ve Institucione Mikrofinanciare, duke lejuar kështu transformimin e tyre nga statusi i OJQ-ve në një subjekt juridik shoqëri aksionare.

30. Parashtruesi pretendon se "*Ligji për Lirinë e Asociimit në një OJQ, në nenin 4, paragrafët 2 dhe 3, nuk lejon një OJQ të transformohet në një subjekt tjetër juridik, aq më pak në një subjekt juridik profitabil. Një OJQ mund të pushojë së ekzistuari (gjegjësisht të anulojë statusin e saj juridik si OJQ) vetëm me ndërprerje, dhe në asnjë mënyrë me transformim. Duke qenë e themeluar dhe regjistruar në përputhje me këtë ligj (dhe rregulloret dhe ligjet e mëparshme të ligjit të tanishëm), statusi juridik i të gjitha OJQ-ve (duke përfshirë OJQ IMF) është e rregulluar ekskluzivisht me Ligjin për Lirinë e Asociimit në OJQ, dhe çdo rregullim i statusit juridik të institucioneve të tilla nga ligjet e tjera është i kundërligjshëm*".

31. Më tej, parashtruesi pohon se "*disa vende nuk lejojnë mundësi ligjore për transformim të tillë (siç është rasti në Kosovë), ndërsa të tjerët në mënyrë eksplicite ndalojnë transformimin e tillë me ligjet përkatëse, siç janë Ligji i Republikës së Bullgarisë për Subjektet jofitimprurëse, neni 12, neni 42; Ligji i Republikës*

së Maqedonisë për Shoqata dhe Fondacione, neni 6.2; dhe Ligji i Republikës së Estonisë për Fondacione, neni 1.3".

32. Sipas parashtruesit, parimi themelor universal për sektorin jofitimprurës është: "*Pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e një OJQ-je nuk mund të përdoren për të sjellë përfitime, për ndonjë themelues, drejtor, zyrtar, anëtar, punonjës ose donator të OJQ-së, përveç pagesës apo kompensimit të arsyeshëm për personat që kryejnë punë për organizatën".* Pretendohet se *"ky parim nënkupton që OJQ-ja nuk ka ndonjë pronar, dhe prandaj pronat e saj nuk mund të trajtohen si pronë private. Pasuritë, të ardhurat dhe fitimet e një OJQ-je përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të përcaktuara për organizatën",* përderisa në rastin e ndërprerjes së një OJQ-je *"pasuritë e asaj OJQ-je shpërndahen në një tjetër OJQ me qëllime të njëjta ose të ngjashme".*

33. Duke u bazuar në atë që u tha më lart, parashtruesi pretendon se "*këto dispozita sigurojnë që në asnjë mënyrë, qoftë gjatë veprimtarisë së tyre, ose edhe pas ndërprerjes së tyre, pasuritë e një OJQ-je nuk mund të transferohen në subjekte fitimprurëse. Në të kundërtën, Ligji për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, duke lejuar OJQ IMF të transformohen në shoqëri aksionare, lejon pasuritë e OJQ-së të transformohen në aksione/prona private".*

34. Sipas nenit 46 të Kushtetutës, askush nuk do të privohet arbitrarisht nga prona e tij, duke përfshirë pronën e personave juridikë. Rrjedhimisht, parashtruesi pohon se "*ky nen mbron pasurinë e organizatave joqeveritare. OJQ-të janë persona juridikë të themeluar në pajtim me jofitimprurëse të drejtat, dhe si të tilla, ato nuk janë në pronësi. Pasuritë e OJQ-së menaxhohen nga organet e menaxhimit të OJQ, por gjithmonë në bazë të parimit universal mosshpërndarjen e fitimit. Ligji për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare*

Jobankare, duke lejuar transformimin e OJQ IMF në shoqëri aksionare, në mënyrë arbitrare tjetërson pasuritë e OJQ-së, duke transferuar pasuritë nga OJQ te persona të tjerë juridikë apo fizikë për aksione".

35. Sipas parashtruesit, "*Ligji për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, duke lejuar transformimin e OJQ IMF në shoqëri aksionare, lejon që kapitali i fituar pa pagesën e tatimeve të injektohet në konkurrencën e tregut komercial në mes të bankave dhe institucioneve të tjera financiare, të cilat janë të detyruara të paguajnë taksa që nga themelimi i tyre".* Kjo pretendohet të jetë në kundërshtim me nenin 10 të Kushtetutës që parasheh se *"ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë për rregullimin ekonomik të Republikës së Kosovës".*

36. Sipas mendimit të parashtruesit, "Ligji për *Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, është gjithashtu në kundërshtim me Rekomandimin e Këshillit Evropian CMIREC (2007) 14, të Komisionit të Ministrave të vendeve anëtare për statusin juridik të OJQ-ve në Evropë, si dhe me Ligjin për Lirinë e Asociimit në OJQ, Nr. 04/L-057, një ligj themelor i cili përcakton krijimin dhe ndërprerjen e veprimtarisë së të gjitha OJQ-ve në Kosovë".*

Kërkesa për masë të përkohshme

37. Parashtruesi kërkon që Gjykata të vendosë masë të përkohshme, "*duke pezulluar zbatimin e Ligjit për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012, për shkak të dëmit të paripareshëm që mund të krijojë zbatimi i këtij ligji në shoqërinë civile, derisa të jepet një vendim meritor për nenet e përmendura*".

38. Në këtë drejtim, në mënyrë që Gjykata të mund të lejojë masën e përkohshme në përputhje me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, duhet të gjejë që:

"(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për papranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme, dhe;

(..)

Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".

39. Gjykata, duke pasur parasysh rolin dhe rëndësinë e shoqërisë civile dhe të OJQ-ve si pjesë esenciale e saj në zhvillimin e demokracisë, konkludon se zbatimi i Ligjit për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, më saktë: nenet e kontestuara 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116, mund të shkaktojë dëme të pariparueshme në funksionimin e shoqërisë civile dhe të demokracisë në Republikën e Kosovës.

40. Prandaj, pa paragjykuar rezultatin përfundimtar të kërkesës, miratohet kërkesa e parashtruesit për masë të përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në pajtim me nenin 116 (2) të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 27 të Ligjit, më 24 dhjetor 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TË LEJOJË masën e përkohshme;

II. TË LEJOJË masën e përkohshme në kohëzgjatje deri më 31 janar 2013 prej ditës së miratimit të këtij Vendimi;

III. TË PEZULLOHET MENJËHERË zbatimi i neneve 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116 të Ligjit për Banka, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012, në kohëzgjatje të njëjtë;

IV. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve; dhe

V. Ky Vendim do të publikohet në pajtim me nenin 29 (4) të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Snezhana Botusharova Prof. Dr. Enver Hasani

KO 131/12 datë 28 dhjetor 2012 - Vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësinë, Nr. 04/L-125; të miratuar nga Kuvendi, më 13 dhjetor 2012

Rasti KO 131/12, Ligji për Shëndetësinë, Nr. 04/L-125; të miratuar nga Kuvendi, më 13 dhjetor 2012

Fjalët kyçe; kërkesë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit, drejtat dhe liritë themelore të njeriut, vendim për masë të përkohshme.

Parashtruesi konsideron inter alia se Ligji për Shëndetësinë përmban dispozita që punëtorët shëndetësorë i vënë në pozita të pabarabarta me të punësuarit në institucione të tjera publike dhe, rrjedhimisht, edhe në pozitë të mos jenë të barabartë para ligjit me punonjësit e tjerë të institucioneve publike.
Gjykata konstaton se mbrojtja shëndetësore është "e drejtë e njeriut, e garantuar me Kushtetutë" dhe është pjesë e Kaptinës II të Kushtetutës, e cila i referohet të drejtave të njeriut.
Gjykata më tej thekson se, në përputhje me nenin 21, pika 1, të Kushtetutës, "të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës".
Duke qenë kategori kushtetuese, "Mbrojtja shëndetësore" pa dyshim se është në interesin publik të qytetarëve të Kosovës, duke qenë njëkohësisht edhe e drejtë e patjetërsueshme dhe e pacenueshme e njeriut për secilin individ.
Me qëllim të evitimit të cenimit të mundshëm të interesit publik dhe të së drejtës së garantuar me Kushtetutë për mbrojtje shëndetësore, Gjykata konsideron se ka arsye për aplikimin e masës së përkohshme për kohë të caktuar.
Gjykata Kushtetuese miraton kërkesën e parashtruesit për masë të përkohshme deri më 31 janar 2013, prej ditës së miratimit të këtij Vendimi dhe pezullon zbatimin e neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, të 13 dhjetor 2012, në kohëzgjatje të njëjtë.

Prishtinë, më 24 dhjetor 2012
Nr. ref.:MP334/12

VENDIM PËR MASË TË PËRKOHSHME

në

Rastin Nr. KO 131/12

Parashtrues

Dr. Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësinë, Nr. 04/L-125; të miratuar nga Kuvendi, më 13 dhjetor 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës: Dr. Shaip Muja, Nait Hasani, Ramiz Lladrovci, Petar Miletić, Azem Syla, Time Kadrijaj, Xhevdet Neziraj, Kymete Bajraktari, Kurtan Kajtazi, Hydajet Hyseni, Sasha Milosavlević dhe Sala Berisha.

Ligji i kontestuar

2. Ligj i kontestuar është Ligji për Shëndetësinë, Nr. 04/L-125, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, më 13 dhjetor 2012.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon vlerësimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën e Kosovës të neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit të kontestuar.

4. Më tej, parashtruesi ka kërkuar aplikimin e masës së përkohshme të pezullimit të zbatimit të Ligjit, deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës përkitazi me këtë kërkesë.

Baza juridike

5. Neni 113.5 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe neni 38 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Procedura në Gjykatë

6. Më 20 dhjetor 2012, nëpërmjet postës, parashtruesi parashtroi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

7. Bashkëlidhur me kërkesën, parashtruesi ka dërguar në Gjykatë edhe kopjen e Ligjit të Punës (Nr. 03/L-212), të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (Nr. 02/L-133) dhe të Ligjit Kundër Diskriminimit, për të cilat parashtruesi thekson se janë relevantë për shqyrtimin e kërkesës së parashtruar dhe janë në lidhmëni me këtë kërkesë.

8. Më 21 dhjetor 2012, Gjykata, nëpërmjet postës zyrtare, mori një kopje të Ligjit për Shëndetësinë, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

9. Kryetari i Gjykatës e caktoi Zëvendëskryetarin e Gjykatës, Dr. Ivan Čukalović Gjyqtar raportues, si dhe emëroi Kolegjin shqyrtues në përbërje nga gjyqtarët: Altay Suroy, Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.

10. Më 21 dhjetor 2012, Gjykata e njoftoi Kuvendin e Republikës dhe parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

11. Më 25 dhjetor 2012, në një seancë të mbyllur, Kolegji shqyrtues shqyrtoi kërkesën dhe njëzëri i propozoi Gjykatës për pranueshmërinë e kërkesës dhe për pranueshmërinë e kërkesës për masë të përkohshme.

Përmbledhje e fakteve

12. Më 13 dhjetor 2012, Kuvendi i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi) miratoi Ligjin për Shëndetësinë me 43 (dyzet e tri) vota për, 18 (tetëmbëdhjetë) vota kundër dhe 3 (tri) abstenime.

13. Më 27 nëntor 2012, para se Kuvendi ta miratonte Ligjin në seancë plenare, Komisioni për Legjislacion i Kuvendit të Kosovës kishte dërguar **Rekomandim (04/3239/l-125)** dhe, në pikën I, kishte marrë qëndrimin që Projektligji për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, nuk mund të procedohet për shqyrtim të mëtutjeshëm, duke i sugjeruar Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale që t'i rishikojë amendamentet 1, 3, 12, 34, 48, 49, 50, 51 dhe 52.

14. Më 17 dhjetor 2012, Federata Sindikale e Shëndetësisë e Kosovës, i kishte dërguar Avokatit të Popullit kërkesë për inicimin e procedurës së vlerësimit të kushtetutshmërisë së nenit 41 të Ligjit për Shëndetësinë, duke pretenduar se ky nen bie ndesh me Kushtetutën.

Pretendimet e parashtruesit

15. Parashtruesi konsideron *inter alia* se Ligji për Shëndetësinë përmban dispozita që punëtorët shëndetësorë i vënë në pozita të pabarabarta me të punësuarit në institucione të tjera publike dhe, rrjedhimisht, edhe në pozitë të mos jenë të barabartë para ligjit me punonjësit e tjerë të institucioneve publike.

16. Parashtruesi ka kontestuar në veçanti nenet pasuese të Ligjit, që kanë këtë përmbajtje:

Neni 18
Kujdesi parësor shëndetësor

1. Kujdesi parësor shëndetësor sigurohet në pajtim me politikat, planet, dhe standardet e përcaktuara me aktin nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

2. Kujdesi parësor shëndetësor përfshin:

2.1. Promovimin shëndetësor, parandalimin, zbulimin e hershëm, diagnostikimin, mjekimin, dhe rehabilitimin, që kanë të bëjnë me sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet, përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike;

2.2. Mbrojtjen parandaluese nëpërmjet programeve të promovimit të shëndetit dhe vizitave sistematike të fëmijëve dhe të rinjve në shkollat fillore, të mesme, dhe të larta në territorin e Komunës.

2.3. Ruajtjen dhe përparimin e shëndetit publik, përfshirë sero-profilaksinë, vaksino-profilaksinë, dhe kimio-profilaksinë në pajtim me ligjin, si dhe arsimimin dhe edukimin sistematik shëndetësor të popullatës;

2.4. Promovimin e shëndetit oral dhe kujdesit për shëndetin e dhëmbëve;

2.5. Diagnostikimin e hershëm dhe trajtimin e tuberkulozës;

2.6. Organizimin e shërbimeve të urgjencës dhe emergjencës mjekësore si pjesë e sistemit unik të shërbimeve në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor;

2.7. Shërbimet e kujdesit shëndetësor për nëna dhe fëmijë dhe shërbimet e planifikimit familjar;

2.8. Shërbimet e shëndetit mendor.

3. Komunat janë përgjegjëse për kujdesin parësor shëndetësor publik dhe për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin e tyre.

4. Komunat obligohen të zbatojnë me prioritet masat prioritare të promovimit dhe parandalimit në kujdesin shëndetësor.

5. Kujdesi parësor shëndetësor sigurohet dhe zbatohet brenda kornizës së shërbimeve të mjekësisë familjare, në pajtim me aktin nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

6. Përbërja e ekipit të mjekësisë familjare përcaktohet me aktin nënligjor nga paragrafi 1 i këtij neni.

7. Çdo qytetar dhe banor me vështirësi shëndetësore është i obliguar të lajmërohet fillimisht tek mjeku familjar, me përjashtim të rasteve emergjente.

8. Prej çdo qytetari dhe banori do të kërkohet të përcaktohet për një mjek familjar.

9. Çdo qytetar dhe banor ka të drejtë të përzgjedhë mjekun familjar në komunën ku jeton, brenda zonës së përfshirjes të përcaktuar nga komuna, dhe ka të drejtë ta ndërrojë atë.

10. Profesionistët në kujdesin parësor shëndetësor do të bashkëpunojnë me profesionistët shëndetësorë në nivelin dytësor dhe tretësor, në pajtim me këtë ligj.

11. Me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore, institucionet në nivel parësor të kujdesit shëndetësor do të sigurojnë bashkëpunimin ndërsektorial me shërbimet e mirëqenies sociale, me shërbimet edukativo arsimore dhe organet e sigurisë publike, me organizatat e veçanta profesionale, si dhe me organizatat humanitare qeveritare e joqeveritare.

12. Standardet e organizimit dhe funksionimit të shërbimit të mjekësisë familjare, përcaktohen me aktin nën-ligjor nga paragrafi 1. i këtij neni.

13. Me qëllim të mbështetjes së shërbimeve të mjekësisë familjare, Ministria mbikëqyrë dhe rregullon shërbimet e integruara të kujdesit parësor shëndetësor, në pajtim me këtë ligj.

Neni 19
Kujdesi dytësor shëndetësor

1. Kujdesi dytësor shëndetësor përfshin: shërbimet spitalore, shërbimet jashtëspitalore: diagnostiko, terapeutike, rehabilituese, transportin emergjent, si dhe shërbimet e shëndetësisë publike.

2. Organizimi dhe veprimtaria e institucioneve shëndetësore nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohet me akte nënligjore të nxjerra nga Ministria.

Neni 41
Parandalimi i konfliktit të interesit

1. Profesionisti shëndetësor i punësuar në sektorin publik shëndetësor, me orar të plotë ose të pjesërishëm të punës, nuk ka të drejtë të punojë në institucionet private të kujdesit shëndetësor.

2. Është e ndaluar që të referohen pacientët nga institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor tek institucionet private të kujdesit shëndetësor për shkaqe të cilat nuk mund të arsyetohen me argumente mjekësore, pavarësisht nga lista e pritjes.

3. Ndalohet rreptësisht çfarëdo shpërblimi formal ose joformal, financiar ose i llojit tjetër i profesionistit shëndetësor përfshirë shpërblimin për referimin e qytetarit ose banorit nga sektori publik në sektorin privat të shëndetësisë, dhe marrëdhëniet profitabile me industrinë farmaceutike.

4. Shkelësit e dispozitave të këtij neni do të jenë subjekt i dënimeve ose veprimeve ligjore të përcaktuara me këtë ligj dhe aktin e veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

5. Institucionet publike shëndetësore kanë të drejtë që t'ua mundësojnë profesionistëve shëndetësorë të punësuar në to, që të ushtrojnë veprimtari private shëndetësore brenda vet institucionit publik shëndetësor.

6. Veprimtaria private shëndetësore nga paragrafi 5 i këtij neni do të zbatohet në bazë të aktit të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

Neni 60
Financimi i institucioneve të kujdesit shëndetësor

1. Institucionet shëndetësore dhe personat e tjerë juridikë dhe fizikë, të cilët ushtrojnë veprimtari shëndetësore, janë të obliguara, që për çdo pacient të dokumentojnë shpenzimet si edhe llojin, vëllimin, cilësinë dhe çmimin e shërbimeve.

2. Institucionet shëndetësore dhe organizatat që marrin fonde publike për zbatimin e kujdesit shëndetësor, janë të detyruara të mbajnë llogaritë dhe evidencat në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe të sigurojnë informata të nevojshme për organet e autorizuara.

17. Parashtruesi thekson se Ligji për Shëndetësinë, i miratuar nga Kuvendi, është në kundërshtim me konventat evropiane që, sipas nenit 22 të Kushtetutës, janë drejtpërsëdrejti të aplikueshme në Kosovë, pa specifikuar se cilat konventa.

18. Më tej, parashtruesi ka theksuar se dispozitat e Ligjit për Shëndetësi, sidomos dispozitat e nenit 18 dhe 19, bien në kolizion të hapur me dispozita të ligjeve të tjera, si Ligji për Partneritetin Publiko-Privat dhe se edhe vetë ligji ka dispozita kundërthënëse në tekstin e tij.

19. Neni 41 i Ligjit për Shëndetësi, sipas parashtruesit, cenon nenin 49 të Kushtetutës, sepse ua ndalon punëtorëve shëndetësorë të drejtën e garantuar për punë dhe për zgjedhje të profesionit.

20. Përfundimisht, neni 60 i këtij Ligji, sipas parashtruesit të kërkesës, është në kolizion të hapur me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, sepse institucionet shëndetësore i përkufizon si institucione joprofitabile.

Vlerësimi për masë përkohshme

21. Kur vendos përkitazi me kërkesën për masë të përkohshme, Gjykata Kushtetuese i referohet nenit 116.2 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të pariparueshme".*

22. Gjykata më tej merr parasysh nenin 27, pika 1 dhe pika 2, të Ligjit Për Gjykatën Kushtetuese (Nr. 03L-121), i cili përcakton:

> 1. *Gjykata Kushtetuese, sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës, mund të vendosë përkohësisht masë të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.*
>
> 2. *Kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale.*

23. Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtuese, gjithashtu, specifikon kushtet për aplikimin e masës së përkohshme dhe, në këtë drejtim, ka paraparë se, në mënyrë që Gjykata të mund të lejojë masën e përkohshme në përputhje me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, duhet të gjejë që:

> *"(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për papranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme, dhe;

(..)
Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".

24. Duke shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga 12 deputetë të Kuvendit të Kosovës, Gjykata Kushtetuese gjen që:

Neni 51. **[Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale]** i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ka paraparë se:

1. Kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj.

25. Bazuar në përkufizimet e mësipërme kushtetuese, Gjykata konstaton se mbrojtja shëndetësore është "e drejtë e njeriut, e garantuar me Kushtetutë" dhe është pjesë e Kaptinës II të Kushtetutës, e cila i referohet të drejtave të njeriut.

26. Gjykata më tej thekson se, në përputhje me nenin 21, pika 1, të Kushtetutës, "*të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës".*

27. Duke qenë kategori kushtetuese, "Mbrojtja shëndetësore" pa dyshim se është në interesin publik të qytetarëve të Kosovës, duke qenë njëkohësisht edhe e drejtë e patjetërsueshme dhe e pacenueshme e njeriut për secilin individ.

28. Me qëllim të evitimit të cenimit të mundshëm të interesit publik dhe të së drejtës së garantuar me Kushtetutë për mbrojtje shëndetësore, Gjykata konsideron se ka arsye për aplikimin e masës së përkohshme për kohë të caktuar.

29. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh faktin se **Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]** i Kushtetutës qartazi parasheh:

> 1. E drejta e punës garantohet.
> 2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.

30. Për të evituar mundësinë e cenimit edhe të kësaj të drejte të garantuar me Kushtetutë, Gjykata rithekson nevojën për aplikimin e masës së përkohshme për kohë të caktuar.
31. Prandaj, pa paragjykuar rezultatin përfundimtar të kërkesës, miratohet kërkesa e parashtruesit për masë të përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në pajtim me nenin 116 (2) të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 27 të Ligjit, më 24 dhjetor 2012, njëzëri

VENDOSI

I. TË LEJOJË masën e përkohshme;

II. TË LEJOJË masën e përkohshme në kohëzgjatje deri më 31 janar 2013, prej ditës së miratimit të këtij Vendimi;

III. TË PEZULLOHET MENJËHERË zbatimi i neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 04/L-125, të 13 dhjetor 2012, në kohëzgjatje të njëjtë;

IV. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve; dhe

V. Ky Vendim do të publikohet në pajtim me nenin 29 (4) të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Prof. Dr. Enver Hasani

KO 148/11 datë 28 dhjetor 2012- Vlerësimi i kushtetutshmërisë të nenit 11 par. 1, nenit 32 par. 1 dhe 2, nenit 34 par. 2, dhe të nenit 38 në lidhje me nenin 11, 32 e 34 të Ligjit për Avokatin e Popullit, ligji Nr. 03/L-195 të 27 gushtit 2010, dhe i kërkesës për masë të përkohshme

Rasti KO 148/11, Ligji për Avokatin e Popullit Nr. 03/L-195 të hyrë në fuqi dhe është shpallur më 27 gusht 2010.

Fjalët kyçe; kërkesë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit, masë të përkohshme , Aktvendim për papranueshmëri.

Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar shfuqizimin e nenit 11 par. 1, nenit 32 par. 1 dhe 2, nenit 34 par. 2 dhe nenit 38 në lidhje me nenet 11, 32 e 34 të Ligjit për Avokatin e Popullit, ligjit Nr.03/L-195.

Parashtruesi konsideron *inter alia* se Ligji për Avokatin e Popullit Nr.03/L-195 përmban dispozita që në mënyrë të dukshme që ndërhyjnë në pavarësinë kushtetuese të tij të paraparë me nenet 132 dhe 133 të Kushtetutës.

Bazuar në faktet del se kërkesa e Avokatit të popullit për vlerësimin e përputhshmërisë së disa nene të Ligjit për Avokatin e popullit me Kushtetutën e Kosovës, si dhe kërkesa për aplikimin e masës së përkohshme janë të jashtë afatshme sepse janë parashtruar pas kalimit të aftit të paraparë prej 6 muajsh "prej hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar" me nenin 30 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Ligji Nr. 03/L-121), dhe kërkesa shpallet e papranueshme.

Prishtinë, dhjetor 2012
Nr. ref. RK/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KO 148/11

Parashtruesi

Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës

Vlerësimi i kushtetutshmërisë të nenit 11 par. 1, nenit 32 par. 1 dhe 2, nenit 34 par. 2, dhe të nenit 38 në lidhje me nenin 11, 32 e 34 të Ligjit për Avokatin e Popullit, ligji Nr. 03/L-195 të 27 gushtit 2010, dhe i kërkesës për masë të përkohshme

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama, gjyqtare

Parashtruesi i Kërkesës

1. Parashtruesi është Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës.

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar shfuqizimin e nenit 11 par. 1, nenit 32 par. 1 dhe 2, nenit 34 par. 2 dhe nenit 38 në lidhje me nenet 11, 32 e 34 të Ligjit për Avokatin e Popullit, ligjit Nr.03/L-195.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese është vlerësimi i pajtueshmërisë me Kushtetutën e Kosovës dhe shfuqizimi i nenit 11 par. 1, nenit 32 par. 1 dhe 2, nenit 34 par. 2 dhe nenit 38 në lidhje me nenin 11, 32 e 34 të Ligjit për Avokatin e Popullit, ligjit Nr.03/L-195 të 27 gushtit 2010, si dhe i kërkesës për masë të përkohshme lidhur me ndalimin e zbatimit të nenit 32 paragrafi 1 të të njëjtit Ligj.

Baza juridike

4. Neni 113.2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: "Kushtetuta"), si dhe neni 20 dhe 27 i Ligjit.

Procedura në Gjykatë

5. Më 16 nëntor 2011, parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

6. Më 6 dhjetor 2011, Avokati i Popullit i paraqiti Gjykatës Kushtetuese një kërkesë shtesë për aplikimin e masës së përkohshme, Kryetari i Gjykatës e caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar Raportues dhe e emëroi Kolegjin Shqyrtues në përbërje nga gjyqtarët Almiro Rodrigues, Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu .

7. Më 27 mars 2012, Gjykata njoftoi Institucionin e Avokatit të Popullit se kërkesa e parashtruar nga ky institucion ishte regjistruar me nr KO148/11 dhe se po trajtohej nga gjykata në përputhje me rregullat e parapara me Kushtetutë, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës të Gjykatës.

8. Më 13 qershor 2012, Gjykata Kushtetuese i kërkoj Kuvendit të Kosovës, komentet eventuale lidhur me kërkesën e parashtruar nga Avokati i Popullit.

9. Më 9 korrik 2012, Gjykata Kushtetuese kërkoi informacione shtesë nga Ministria e Administratës Publike dhe nga vet institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me pagën e Avokatit të popullit dhe të zëvendësve të tij.

10. Më 13 korrik 2012, Gjykata Kushtetuese ka pranuar përgjigje me shkrim lidhur nivelin e pagës së Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij edhe nga Institucioni i Avokatit të Popullit a edhe nga Ministria e Administratës Publike - Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil.

11. Më 5 dhjetor 2012, në seancën e mbajtur për shqyrtimin e kësaj kërkese, kolegji shqyrtues njëzëri i rekomandoi gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

12. Më 22 korrik 2010, Kuvendi i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: "Kuvendi") miratoi Ligjin për Avokatin e Popullit, ligjin Nr. 03/L-195, i cili është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr. DL-046-2010 të 9.08.2010.

13. Neni 2 i këtij ligji kishte përcaktuar se: "Me këtë ligj rregullohet organizimi dhe funksionimi i Institucionit të Avokatit të Popullit, duke përcaktuar procedurat për emërim dhe shkarkim, kompetencat dhe mënyrën e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit si dhe rregullon procedurat për parashtrimin e ankesave dhe hetimin e tyre."

14. Më 7 tetor 2011, sipas vendimit nr 04. V-210 Kuvendi i Kosovës ka zgjedhur për zëvendës të Avokatit të Popullit: 1) z. Basri Berisha, 2) z. Isa Hasani, 3) z. Bogoljub Staletović, 4) znj. Shqipe Ibraj-Mala dhe 5) z. Ibrahim Arsllan.

15. Neni 32.1 i po këtij ligji (Ligjit për Avokatin e Popullit Nr.03/L-195) përcakton se: "Niveli i pagës së Avokatit të Popullit dhe

zëvendësve të tij caktohet në pajtim me Ligjin për Pagat e zyrtarëve të Lartë Publik."

16. Disa nga zgjidhjet ligjore të parapara me ligjin për Avokatin e Popullit, e në veçanti kjo e përmendur më sipër, lidhur me pagat e Avokatit të popullit dhe zëvendësve të tij ka ngritur pakënaqësi tek këta të fundit duke konstatuar se kjo zgjedhje është më pak e favorshme se sikur parashihte rregullorja e UNMIK-ut 2006/6 për Institucionin e Avokatit të Popullit e 16 shkurtit 2006.

17. Rregullorja e UNMIK-ut pagën e Avokatit të popullit dhe zëvendësit të tij (atëherë ishte vetëm një zëvendës) e kishte përcaktuar (neni 18 pika 1 dhe 2) në nivelin e Kryetarit, respektivisht të gjyqtarit të Gjykatës Supreme të Kosovës. MAP, bazuar në këtë rregullore, me vendimin DASHC/MAP nr. 114/LLL&RR.Z të 7 korrikut 2009, kishte proceduar në sistemin e pagave me pagën e Avokatit të Popullit sipas Koeficientit 18 dhe të zëvendës avokatit të popullit me koeficientin 16.8 barabartë me pagën e kryetarit respektivisht të gjyqtarit të gjykatës supreme në atë kohë.

18. Ky përcaktim i nivelit të pagës nuk kishte ndryshuar asnjëherë deri në marsin e viti 2012, kur sipas rekomandimit të Komisionit për Buxhet e Financa pagës bazë të Avokatit të Popullit i janë shtuar 30% mbi pagën bazë. Koeficienti mbeti po i njëjti i përcaktuar nga MAP në vitin 2009.

19. Shqetësimet lidhur me normën ligjore që përcakton nivelin e pagës, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) e kishte ngritur disa herë në Institucionet e Republikës së Kosovës dhe sidomos në Kuvendin e Kosovës, në Ministrinë e Administratës Publike (në tekstin e mëtejmë MAP) dhe në Ministrinë e Ekonomisë, si organe më kompetente, duke kërkuar njëkohësisht zgjedhje të kësaj çështjeje.

20. Më 8 nëntor 2011, Institucioni i Avokatit të Popullit nxori Vendimin nr. 09/2011 për Caktimin e pagave të Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të tij dhe atë duke i ngritur në nivelin e tanishëm të pagës të kryetarit, respektivisht të gjyqtarit të Gjykatës Supreme

21. Në pikën tre të këtij vendimi ishte shkruar se pagesa për avokatin e Popullit do të bëhej në mënyrë retroaktive nga 1 janari 2011 e për zëvendësit e tij nga 7 tetori 2011.

22. Vendimi i sipërpërmendur iu dërgua MAP-it për procedim në sistemin e pagave.

23. Me 14 nëntor 2011, MAP, me shkresën e nënshkruar nga sekretari i përhershëm dhe drejtori i DASH/MAP (departamenti për administrimin e shërbimit civil), njoftoi se e kishin refuzuar zbatimin e këtij vendimi me arsyetimin se niveli i pagave i përcaktuar në vendimin 09/2011 të IAP ishte bazuar në nenin 18 të rregullores së UNMIK-ut 2006/6 për IAP, por që kjo rregullore ishte shfuqizuar me Ligjin për Avokatin e Popullit, ligji nr. 03/L-195, duke shtuar se, meqenëse Ligji për pagat e Zyrtarëve të Lartë Publik akoma nuk është aprovuar atëherë niveli i pagave të këtyre zyrtarëve duhet të caktohet nga Kuvendi i Kosovës.

24. Për pasojë, Avokati i Popullit ka vazhduar të realizojë pagën e përcaktuar më herët sipas rregullores së UNMIK-ut, ndërsa 2 (dy) nga zëvendësit e avokatit të popullit të zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës nuk kanë realizuar fare pagë deri në mars të 2012 dhe tre (3) të tjerët që kanë qenë më herët të punësuar në këtë institucion, por në pozita të tjera, kanë realizuar pagat për pozitat që mbanin më herët në IAP, por jo si zëvendësavokat.

25. Më 28 mars 2011, sikur shihet nga procesverbali i Komisionit për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Kosovës, ky komision, në pikën 4.3 e rendit të ditës ka shqyrtuar kërkesën e IAP dhe ka nxjerrë PËRFUNDIMIN që të përkrahet kërkesa e IAP dhe që Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij t'ju rritet paga në vlerën 30% mbi pagën bazë.

26. Më 13 Korrik 2011, Komisioni për buxhet dhe financa i Kuvendit të Kosovës prapë kishte shqyrtuar një kërkesë të IAP (pika 3 sipas procesverbalit) dhe nuk kishte marrë ndonjë vendim konkret pos që kishte konstatuar se duhet të mbahet një takim i përbashkët për zgjidhjen e këtij problemi.

27. Më 16 nëntor 2011, Komisioni për buxhet e financa i Kuvendit të Kosovës shqyrtoi kërkesën për "procedim të vendimit për

pagat e zëvendësve të Avokatit të Popullit të zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës më 07.10.2011 (pika 5 e procesverbalit) dhe me atë rast u nxor REKOMANDIMI që kjo kërkesë të trajtohet me rastin e shqyrtimit të buxhetit të IAP për vitin 2012."

28. Më 24 shkurt 2012, Ministra e Financave kishte njoftuar IAP se rekomandimi i tyre është se pagat e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij, deri sa të nxirret ligji për pagat e zyrtarëve të Lartë publikë, do të duhej të ishin në nivelin e përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/6 ose në nivelin aktual.

29. Më 8 mars 2012, MAP, duke marrë për bazë edhe rekomandimin e Ministrisë së Financave, ka marrë vendim të vazhdojë të procedojë pagën aktuale për avokatin e popullit sipas rregullores 2006/6 dhe gjithmonë sipas vendimit të vitit 2009, pra pa e harmonizuar këtë pagë me pagat aktuale të kryetarit dhe gjyqtarëve Gjykatës Supreme.

30. Më 17 prill 2012, Komisioni për buxhet e financa i Kuvendit të Kosovës ka shqyrtuar në mes të tjerash edhe kërkesën e IAP për nivelin e pagave me që rast në mbledhje të këtij komisioni ka marrë pjesë zëvendës avokati i popullit z. Basri Berisha i cili ka paraqitur qëndrimet e IAP lidhur me çështjen e pagave dhe në këtë mbledhje komisioni nuk morri parasysh kërkesat e IAP po megjithatë kërkoi ekzekutimin e pagave (edhe të pagave të mbetura për dy zëvendës) për IAP sipas ligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2011 dhe 2012.

31. Më 30 prill 2012, Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës duke shqyrtuar rekomandimin e Komisionit për buxhet e financa lidhur me Pagat e IAP nxori **Përfundim**, që: "Qeveria e Kosovës t'i ekzekutojë pagat për pesë zëvendësit e Avokatit të Popullit në nivelin e përcaktuar me Ligjin për Buxhetin e Kosovës për vitin 2011 dhe 2012."

32. Në pikën dy të përfundimit u kërkua nga Qeveria të përshpejtojë procedimin e Ligjit për Pagat e zyrtarëve të Lartë Publikë.

33. Gjykata Kushtetuese, bazuar në përgjigjet e marra nga IAP dhe MAP, konstaton se paga aktuale e Avokatit të Popullit është paga e përcaktuar nga MAP më 7 korrik 2009, pra e nivelit të

kryetarit të Gjykatës Supreme (para se të ngriheshin pagat e të gjitha niveleve të gjyqtarëve) dhe paga e zëvendësavokatit të popullit është niveli i pagës së Gjyqtarit të gjykatës Supreme (para se të ngriheshin pagat e të gjitha niveleve të gjyqtarëve)

Pretendimet e parashtruesit për shkeljet kushtetuese

34. Parashtruesi konsideron *inter alia* se Ligji për Avokatin e Popullit Nr.03/L-195 përmban dispozita që në mënyrë të dukshme ndërhyjnë në pavarësinë kushtetuese të tij të paraparë me nenet 132 dhe 133 të Kushtetutës.

35. Avokati i Popullit, po ashtu, "vëren se formulimi juridik i nenit 32.1 të ligjit që përcakton se: *Niveli i pagës së Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij caktohet në pajtim me Ligjin për Pagat e zyrtarëve të Lartë Publik* si dhe ai i paragrafit 2 të këtij neni që përcakton se *Niveli i pagës së personelit tjetër të Avokatit të Popullit përcaktohet në pajtim me Ligjin për Pagat e nëpunësve civil,* Avokatin e popullit dhe zëvendësit e tij **de jure i** lë pa paga sepse ato bazohen në një ligj që nuk ekziston ndërsa **de facto** pagat e tyre mbetet të përcaktohen në mënyrë arbitre pa u bazuar në ligj sikur edhe në fakt ka ngjarë më vonë".

36. Për më tepër, A. Popullit thekson se në draftin final të punuar nga grupi punues për Ligjin për Avokatin e Popullit, pjesë e të cilit ishte edhe ai vet, ishte përcaktuar se paga e Avokatit të Popullit të jetë e barabartë me pagën e gjyqtarit në Gjykatën më të lartë të Kosovës ndërsa e zëvendësve të A. Popullit të jetë 90% e pagës së A. Popullit e paga e stafit tjetër të IAP të popullit të jetë e barabartë me pagën e stafit të Gjykatës Kushtetuese. Por, që pas ndërhyrjeve nga ana e zyrës Ligjore të Qeverisë këto nene janë riformuluar dhe kanë marrë përmbajtjen që kanë në ligjin ekzistues.

37. Parashtruesi i kërkesës më tej konsideron se neni 34 par. 2. i ligjit në të cilin shprehimisht thuhet, se: "Pavarësisht nga dispozitat e ligjeve të tjera, Institucioni i Avokatit të Popullit përgatit propozimin e buxhetit të tij vjetor dhe ia dërgon atë për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës është degradim i solucionit të propozuar nga grupi punues i cili kishte marrë modelin e buxhetit të Gjykatës Kushtetuese" dhe konsideron që

për pasojë Qeveria dhe institucionet e tjera mund të ndërhyjnë pa pengesa në pavarësinë financiare të IAP dhe për këtë citon paragrafin 60 të vlerësimit të projektligjit për A. Popullit që ka bërë Komisioni i Venedikut i cili shpreh se: *"Edhe pse Kuvendi mund të konsiderohet si organ që siguron që institucioni do të merr mjetet finasiare për të funksionuar në mënyrën e duhur,neni 41 do të duhej të përcaktojë që mjetet e alokuara (dedikuara) janë në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e Avokatit të Popullit dhe marrin në konsiderate numrin e ankesave të parashtruara viteve të mëparshme" (opinion no 434/207 Strasbourg June 2007)*

38. Avokati i Popullit më tej paraqet pretendimin e tij lidhur me jokushtetutshmërinë e nenit 11 të Ligjit për Avokatin e Popullit duke theksuar se përcaktimi i imunitetit për Avokatin e Popullit dhe zëvendësit e tij në formën në të cilën është paraparë në ligj duke përjashtuar nga imuniteti zyrtarët e tjerë të IAP dhe duke e kufizuar imunitetin vetëm në kohën deri sa mbajnë funksion dhe jo pas përfundimit të tij paraqet cenim të integritetit të IAP sepse zyrtarët e IAP ligji i obligon për ruajtje të fshehtësisë edhe pas përfundimit të mandatit ndërsa nuk mbulon me imunitet për atë kohë që në fakt janë obligime ligjore por pa mbrojtje ligjore.

39. Përfundimisht, sipas Avokatit të Popullit, "neni 38 i këtij ligji i cili shfuqizon dispozitat e Rregulloreve të UNMIK-ut, që më parë kishin rregulluar pozitën e Avokatit të popullit, faktikisht kishte krijuar pozitën jokushtetuese të Avokatit të Popullit, zëvendësve të tij dhe stafit të IAP në raport me pagën, zyrat e punës, dhe imunitetin e tyre." Dhe mbështetur në faktet e paraqitura në kërkesë A. Popullit kërkoi nga Gjykata Kushtetuese ka kërkuar shfuqizimin e këtyre neneve të ligjit.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së Kërkesës dhe kërkesës për masë të përkohshme

40. Para se të përcaktojë kriteret formale për pranushmërinë e kërkesës Gjykata duhet të japë përgjigje në dy çështje themelore:

a. Nëse avokati i Popullit është palë e autorizuar për të ngritur këtë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese; dhe
b. Nëse çështja e ngritur përpara gjykatës është çështje kushtetuese.

41. Për të dhënë përgjigjeje të duhur në dy çështjet e lartcekura Gjykata i referohet nenit 113.2 të Kushtetutës i cili në mënyrë decidive parasheh:

"Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit, janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:

(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;
(2) përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën."

42. Gjykata gjithashtu merr për bazë edhe neni 135.4 të Kushtetues ku parashihet se:

"Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute".

43. Bazuar në përkufizimet e mësipërme kushtetuese është plotësisht e qartë së Avokati i Popullit ka kompetencë të parashtrojë çështje kushtetuese përpara Gjykatës Kushtetuese për sa i përket vlerësimit të përputhshmërisë me Kushtetutën të cilitdo ligj të miratuar në Kuvendin e Kosovës.

44. Ligji për Avokatin e Popullit pavarësisht faktit se për qëllim primar ka që të "rregullohet organizimi dhe funksionimi i Institucionit të Avokatit të Popullit" (neni 2 i ligjit) pra të vet parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese prapë se prapë është një ligj i Kuvendit, dhe Avokati i Popullit ka të drejtën Kushtetuese të "ngritjes së çështjes së përputhshmërisë me Kushtetutën " sikur edhe për secilin ligj tjetër. Andaj është e

qartë se kërkesa e Avokatit të Popullit për vlerësimin e përputhshmërisë së nenit 11 par. 1, nenit 32 par. 1 dhe 2, nenit 34 par. 2 dhe nenit 38 në lidhje me nenet 11, 32 e 34 të Ligjit për Avokatin e Popullit, ligji Nr.03/L-195 i 27 gushtit 2010, përmbush kushtin juridik të nenit 113.2 të Kushtetues. Prandaj, Gjykata Kushtetuese vendos se Avokati i Popullit është palë e autorizuar dhe se kjo çështje është çështje kushtetuese dhe është bazë tërësisht e përshtatshme për vlerësim Kushtetues nga Gjykata Kushtetuese.

Përmbushja e kritereve formale-procedurale për parashtrimin e kërkesës dhe kërkesës për masë të përkohshme

45. Për të pasur një kërkesë të përshtatshme për shqyrtim në gjykatën Kushtetuese Parashtruesi i saj ka për obligim t'i përmbushë kriteret e parapara për pranueshmëri, me Kushtetutën e Kosovës, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës të Gjykatës.

46. Me këtë rast gjykata Kushtetuese i referohet nenit 113.1 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të kushtetutës ku përcaktohet se:*"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar."*

47. Kur bën vlerësimin kërkesave për përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën, Gjykata pos që vlerëson kapacitetin juridik të" palës së autorizuar "për të parashtruar kërkesën në Gjykatë (*locus standi*), njëkohësisht bën edhe vlerësimin e afatit kohor ligjor brenda të cilit pala e autorizuar duhet të paraqesë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.

48. Në këtë drejtim Gjykata merr për bazë nenin 29 (saktësimi i kërkesës) i cili përcakton kompetencën për ngritjen e kërkesës sipas nenit 113.2 të Kushtetutës në bazë të cilit edhe u shtrua kërkesa e Avokatit të Popullit si dhe nenin 30 (afatet) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (**Ligji Nr. 03/L-121)** i cili shprehimisht përcakton se: ***"Kërkesa e ngritur ne pajtim me nenin 29 te këtij ligji duhet të***

parashtrohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit te kontestuar."

49. Rregulli i 6 muajve për paraqitjen e kërkesës në këto raste ka për qëllim t'i shërbejë sigurisë juridike dhe të kujdeset që çështjet që ngrenë pyetje Kushtetuese të shqyrtohen në një afat të arsyeshëm duke u evituar autoriteteve dhe personave te tjerë të interesuar ndjenjën e gjatë të pasigurisë. (shih në mes shumë të tjerëve, *P.M. v. the United Kingdom* (vend), nr.6638/03, vendimi i 24 gushtit 2004).

50. Duke shqyrtuar kërkesën e Avokatit të popullit për vlerësimin e përputhshmërisë së Ligjit për Avokatin e Popullit, Gjykata konstaton se kjo kërkesë në Gjykatë është paraqitur ***më 16.11.2011 dhe kërkesa shtesë për aplikimin e masës së përkohshme me më 6 dhjetor 2011, ndërsa Ligji për Avokatin e Popullit ka hyrë në fuqi dhe është shpallur më 27 gusht 2010 në gazetën zyrtare të Kosovës nr. 80.***

51. Bazuar në këto fakte del se kërkesa e Avokatit të popullit për vlerësimin e përputhshmërisë së disa neneve të Ligjit për Avokatin e popullit me Kushtetutën e Kosovës, si dhe kërkesa për aplikimin e masës së përkohshme **janë të jashtafatshme** sepse janë parashtruar pas kalimit të aftit të paraparë prej 6 muajsh "prej hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar" me nenin 30 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës **(Ligji Nr. 03/L-121),** andaj kërkesa duhet të shpallet e papranueshme.

52. Duke marrë për bazë si më sipër gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë dhe sikur janë paraparë me nenin 36 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese andaj nuk ka bazë për vlerësimin e meritës së kërkesës, dhe:

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës, nenin 20 dhe 30 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Rregullin 36 të

Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 dhjetor 2012, njëzëri:

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. TA HEDHË POSHTË kërkesën për masë të përkohshme si të papranueshme;

III. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe

IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Ivan Čukalović Prof. Dr. Enver Hasani

INDEKSI I TERMAVE

TERMI	NUMRI I FAQËS
A	
Actio popularis	-425
Ansambleja Komunale e Prizrenit	-425
Agjencia Kosovare e Pronës, Drejtoria për Çështje Pronësore-Banesore - HABITAT	852
Agjensia Kosovare e Privatizimit	-257
B	
Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucioonet Financiare jo-bankare	-1032
F	
`Forca e Sigurisë së Kosovës	-656
GJ	
Gjykata Supreme e Kosovës	-146, 212, 229, 274, 302, 396, 555, 620, 676, 770, 956, 1013
Gjykata Kushtetuese e Serbisë	-584
Gjykata Regjionale e Prishtinës	-112, 201, 526, 606, 826
Gjykata Regjionale e Gjilanit	-168
Gjykata Regjionale e Prizrenit	-325, 808

Gjykata Regjionale e Pejës -376, 405, 635

Gjykata Regjionale e Mitrovicës -595

Gjykata Komunale e Ferizaj -943

Gjykata Komunale e Prizrenit -565

Gjykata Komunale e Gjilanit -612

Gjykata Komunale e Prishtinës -826

Gjykata Komunale e Vitisë -376

Gjykata Komunale e Ferizajt-Dega Shtërpcë -584

Gjykata Komunale e Mitrovicës -925

K

Korporata Energjitike e Kosovës -595

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës -376, 405, 963

M

Ministria e Punës dhe Çeshtjeve Sociale -737, 918

Ministria e Shëndetësis -1047

O

Ombudspersoni i Republikës së Kosovës -1060

P

Presidenca e Republikës së -656

Kosovës

Presidenti i Parlamentit të Republikës së Kosovës -436, 925

Prima facie -274

Parlamenti i Republikës së Kosovës -998

R

Ratione temporis -188

U

Ushtria Çlirimtare e Kosovës -918

INDEKSI I NENËVE TË KUSHTETUTËS

Neni/Titulli **Vendimi/ Numri i Faqës**

KAPITULLI I
DISPOZITAT THEMELORE

2	Sovraniteti	-1013
3	Barazia para ligjit	-405

KAPITULLI II
TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE

21	Parimet e përgjithshme	-753, 883
22	Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare	-146, 436, 555
24	Barazia para ligjit	-239, 314, 526, 796, 883,1013
27	Ndalimi i torturës,trajtimit mizor,çnjerëzor ose poshtërues	-157
29	E drejta e lirisë dhe sigurisë	-157
30	Të drejat e të akuzuarit	- 249, 396

31	E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	- 249, 292, 526, 565, 703, 730, 1013
32	E drejta për mjete juridike	-146, 314, 347, 376
33	Parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale	- 157, 347
34	E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër	-833
46	Mbrojtja E Pronës	-112, 146, 302, 425, 753, 852, 883, 956
49	E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit	-325
51	Mbrojtja Shëndetësore Dhe Sociale	-146, 221, 283
52	Përgjegjësia për mjedisin jetësor	-268
53	Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut	-347
54	Mbrojtja gjyqësore e të drejtave	-146, 201, 206, 396, 684, 796, 883

KAPITULLI VII
SISTEMI I DREJTËSISË

102	Parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor	-212, 221, 283, 844, 1013

KAPITULLI XII
INSTITUCIONET E PAVARURA

132 Roli dhe kompetencat e avokatit të popullit -1060